

JETA KRISTIANE

REVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Viti i IV-të

Mars 1943-XXI

Nr. 1

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

LANDA : Jeta Kristiane në vitin e katërtë - Në vënt të predikimit - Feja dhe shkenca - Agjërimi i ynë - Një skicë shpirtit - Jetëshkrime shentorësh - Si duhet të qëndrojmë në Kishën e Zotit dhe të shënjtorevet? - Fjalë ngushëllimi - I biri i shtëpisë së David-it.

JETA KRISTIANE NË VITIN E KATËRTË

Me këtë numur revista e jonë mbush tre vjetë dhe hyn në vitin e katërtë. Gjatë kësaj kohe «Jeta Kristiane» u-përpoq me gjithë fuqit' e saja të plotësojë tërë pikat e programës që çpalli në fillim të botimit të saj dhe t' u përgjigjet, sa është njerëzish e mundur, shpresavet që kishin mbështetur në këtë Orthodhoksë të Shqipërisë.

Kjo përpjekje e revistës s' onë u njojt dhe u çmua, si duhet, jo vetëm nga intelektualët orthodhoksë, që besojnë se feja me të vërtetë është faktori më i math i çvillimit moral të një populli, po edhe nga këndonjës e vëzhgonjës të pa anëshëm, të cilët, ndonse pasonjës së një tjetër dogme ose të një tjetër feje, patnë kthjellësin' e lavdëruarshme të lavdërojnë qëllimin e lartër të revistës dhe të pohojnë se lënda e saj nuk ka të bëjë me parime e me doktrinën e një dogme vetëm, por shtrihet edhe më gjërë, dyke prekur përgjithësisht çvillimin e moralit e lartësimin e karakterit të çdo pjestari të shoqërisë njerëzore.

Me të vërtetë e shumë llojshme ka qënë lënda e

revistës s' onë dhe në shumë drejtime është drejtuar qëllimi dhe vepra e sajë. Me studime e bisedime apollogetike i drejtohet kryesisht klasës së intelektualëve, dyke u munduar t' u provojë me argumenta që mer nga përfaqësonjësit e vërtetë të shkencës, se feja është një cilësi shpirtërore e njeriut që ka kallur Perëndija vetë në shpirtin e njeriut, dhe që nuk është as pak krijesë ose pjellë e mendjes së njeriut për këtë ose për atë qëllim politik ose shoqëror; se është një nevojë e shpirtit të çdo njeriu e prandaj shifet e gjendet në çdo popull e në çdo kohë; se më në fund feja është faktori më i math i përparimit moral të njeriut dhe e forcon këtë në rast mjerrimesh më tepër se çdo tjetër sistem ose doktrinë filosofike e morale. U është drejtuar pastaj bashkëshortevet dhe, dyke interpretuar bukur e mirë mendimet e Apostojvet dhe t' Atërve të Shenjtë mbi martesën e mbi jetën familjare, u jep udhëzime dhe këshilla se si do të mundin të formojnë një familje të mirë e me jetë armonike, që është, si dihet, themeli i një shoqërije të përparuar e të qytetëruar. Edhe me problemet e edukimit të rinisë është marë shpesh herë revista e jonë, dyke dashur t' a largojë nga rrugë në të cilën përpigën t' a shpjenë predikime anarhike dhe immorale, dhe t' a influencojë me parimet e shëndosha të doktrinës Ungjillore. Gjithashtu edhe nga kryeveprat e letërsisë kishtare u ka paraqitur këndonjësvet herë pas here copë të zgjedhura sidomos nga ato të Gojartit, me qëllim që të marin një dije, qoftë edhe të vogël, të lartësisë së kësaj letërsije dhe mb'anën tjetër të mundin të përfitojnë nga mendimet e lartëra të saj e të frymëzohen prej këtyre në jetën e tyre si private, si publike. Më në fund me predikime dhe me shpjegime të thjeshta të thesarit Ungjillor, si edhe me fjalë të urta e me rëfenja të posaçme është munduar të ngjallë e të çvillojë ndjenjën fetare të grigjës orthodhokse, e sidomos të klasës s' atyre besnikëve që nuk mundin të përfitojnë nga studimet që kapërxejnë fuqit' e tyre mendore.

Me anën e një veprimi të këtillë që do t' a vazhdojë dhe paskëtaj revista e jonë ka besim të plotë se me ndih-

mën e Zotit ka për t' i arrirë më shpejt ose më vonë qëllimit të saj të shenjtë. Thomi se edhe vonë mund të dalin pemët' e prodhimi i mundimeve të revistës, sepse, siç dihet, parimet e lartëra shpirtërore dhe vlerat morale sjellin efektin e tyre në këtë botë pas një përpjekjeje të pa reshtur e pas një kohe të gjatë. E pra edhe kjo revistë nuk mund të mos ndjekë rregullin e këtij ligji historik; edhe kjo sigurisht ka për të sjellë pemët e dëshëruara në kohën e duhur dhe nuk do të shkojnë kot mundimet e saja, si kundër besojnë disa të cilët nuk kanë studjuar mirë kushtet e influencës q' ushtrojnë doktrinën e lartëra shpirtërore mbi shpirtin e njeriut.

Po, siç kuptohet lehtë, një punë e këtillë me një dobi aqë të madhe nuk mund të bëhet përveç se me sakrificat të mëdha morale e materiale. Në keto të fundit na duket se është e drejtë që të marrin pjesë edhe tërë shpresëtarët orthodhoksë të Shqipërisë. Këta, dyke marrë parasysh dobinë morale q' u sjell revista, le të mos kursejnë ndihmën e tyre të vogël materiale, që të mundin kështu të lehtësojnë barrën e rëndë që shkakton në buxhetin e vobekët të kishës botimi i kësaj reviste. Është e vërtetë se revista kaloi vështirësira të mëdha gjer sot e shpesh herë edhe rrezikun e mos botimit e përballoi, por vulineti i fortë dhe i mirë i kryetarit të kishës—me inisiativën e të cilit u themelua revista—triumfoi kundër tërë pengimevet ekonomike dhe kështu mundi t' u sigurojë besnikëve të grigjës së tij ushqim të pastër e të shëndoshë për shpirtin e për zemrën e tyre. Është pra plotësisht e drejtë që edhe besnikët t' a ndihmojnë botimin e revistës me një ndihmë të vogël nga ana e tyre, dyke marrë parasysh se me këtë sakrificë të vogël materiale sigurojnë botimin e një organi të kishës s' onë, i cili përveç dobisë që sjell, është njëkohësisht dhe një mburje e një element i rëndësishëm i prestigjit të saj.

Me këto shpresa të bukura pra për t' arthmen, «Jeta Kristiane» po hyn në vitin e katërtë dhe me ndihmën e Perëndisë po e vazhdon punën e saj të shenjtë me besimin e me zellin e gjertanishëm.

DREJTORIJA

E Djela e Orthodhoksisë

Fest' e madhe këjo për botën orthodhokse vlla i dashur. Fest' e së vërtetës, e dritës përmes furtunës së gënjeshtërës dhe skëterës s'errësirës. Edhe e feston këtë me gëzim orthodhoksia, e cila për njëzet shekuj shpërndan bukën e jetës përmes etjes së përgjithëshme që trondit themelet e shoqërisë.

Por këtu pikërisht qëndron fuqija e orthodhoksis, fuqija e besës së vërtetë të Krishtit, që në ditë të vështira të shkëlqejë më shumë edhe më pastër. Ungjilltari Joan në faqen e parë t' ungjillit të tij të shenjtë shkruan: «Dhe drita ndritë n'errësirë, dhe errësira nuk e pushtoi atë». Dy të vërteta të mëdha përmbajnë këto fjalë: e para që edhe një herë Kisha e Krishtit ron realitetin, që drita ndrit n'errësirë, dhe e dyta që e liga është e pa mundur të mposhnjë të mirën. Mbi këtë të vërtetë, mbi këtë shkëmb të patundur, mbështetet shpresa, e jonë.

Asnjë kishë tjetër, si Orthodhoksia, nuk e jetoi plotësisht këtë të vërtetë: Eshtë e pamundur që e liga të mundnjë të mirën. Errësira nuk do t' a pushtojë kurrë dritën, as gënjeshtira të vërtetën, as kashta grurin.

Dhe që t' a kuptojmë më mirë e më thellë këtë të vërtetë, le t' i hedhim një vështrim orthodhoksis në karakteristikat e sajë më kryesore e më të mëdha: 1) orthodhoksia është posaçërisht Kish' e deshmorëvet, gjaku i të cilëvevet u-bë farrë përhapjeje dhe forcimi të Krishtëritit. 2) Orthodhoksia është Kisha e shentorëvet dhe e shentëritit. 3) Eshtë Kish' e spiritualitetit dhe e brëndisë. 4) Eshtë Kish' e ekumenicitetit. 5) Kisha orthodhokse është përmbi kohën, është përjetësija brënda në kohë.

1. — Orthodhoksia, Kishë e deshmorëvet.

Orthodhoksia është posaçërisht Kish' e deshmorëvet. Në martyrologjin e sajë figurojnë më se dhjet milone dëshmorësh.

Me gjakun e tyre orthodhksia ka ndritur n' errësirën e pabesisë e të padrejtësisë. Gjaku i tyre si farrë u-derth në tokë dhe çoi krishtërimin në të gjithë botën. Gjaku i tyre u-bashkua me gjakun shpëtimtar të Krishtit në kupën e shenjtë të Kishës që të kryqëzohet e të ngjallet Krishti përmes gjeneratave e të shekujve dhe të shpëtojë njerëzija nga të këqijat e nga mekati.

E Djela e orthodhksisë është veçanërisht dita e deshmorevet të kishës. Deshmoret janë dritëmbajtës më të mëdhenj të Krishtit, miqt e Dhëndërit, shtyllat e orthodhksisë. Rrojnë shpirtin e doktrinës së Krishtit, i Cili tha «Asnjë s' ka dashuri më të madhe se ay që jep jetën e vet për miqt e tij». Jep jetën e vet që ata të ndriçohen, të ndreqen, të shpëtojnë. Këjo vepër përbën eroismën e dashurisë, hyjnizimin e sajë. Besa e orthodhksisë ka dal nga kockat e deshmorevet, përmbi të cilat ngrihen altare të shenjta, ndërtohen kisha, shërohen të sëmurë, shpëtohen shpirtëra. Nga deshmoret mësoi njerëzija të mos ketë frikë nga ata që dëmtojnë trupin.

Me deshmoret kisha e vërtetë Krishtit, orthodhksia, pa dritën e sajë të ndritnjë n' errësirë, pa triumfin e së vërtetës kundër gënjeshtërisë e ligësisë. Me deshmoret orthodhksia ndëroi Perëndinë, mbushi me gas engjëjt, ngriti ndërtesën e kishës gjer në qiell. Me deshmoret prifti sjell me zell para Zotit therorën e pagjakëshme, bëhet i denj të hajë bukën e engjëjvet, t' u japë ndihmën e tij të gjallëvet dhe prehje atyre që kanë ndërruar jetë.

Mësimi m' i math që na japin deshmoret është t' ia falim veten t' onë krejtësisht Zotit; t' ia falim veten, fajet t' ona, virtytet t' ona, mundimet t' ona, shpresat t' ona, vullnetit të tij të shenjt.

Edhe brezi i sotshëm bashkon përpjekjet e tij, vuajtjet e tij, mundimin e tij me gjakun e deshmorevet të besës dhe të së vërtetës për të rifituar të drejtat e vërteta dhe të mirat e njeriut, që edhe një herë të triumfojnë fuqirat spirituale përmbi lëndën brutale. Ka edhe sot njerës dhe popuj që gjetnë përseri vlerat e entuziasmës, të paanësis dhe të pastërtisë, fuqinë të vdesin për idealet e mëdhenj të njerëzisë.

Brutaliteti i jetës do të na bëjë të fortë. Pëngesat, përpjekjet, sakrificat, janë të domosdoshme. Na madhojnë, na bëjnë

shkëmbinj të rahur prej dallgavet, prej furtunavet. Shkëmbinj që të ndërtohet përmbi ne njerëzia e re. Sot më tepër se çdo herë tjetër do të tregojmë fuqin e besës s' onë, që të ndritnjë drita n' errësirë.

2. — Orthodhoksia, kishë e shentorëvet dhe e shentërimit.

Drita e orthodhoksis përmes shekujvet ka ndritur jo vetëm me anë të martyrizimit, por dhe me anë të shentërimit. Orthodhoksia është njëkohësisht dhe kish' e shenjtorevet dhe e shentërimit. Ka shenjtërim me shkëlqim, të përqëndruar në persona të caktuar por dhe shenjtërim modest, të derdhur.

Për këtë shenjtërim të dytë interesohet sidomos Orthodhoksia, shenjtërim ky që është plot dashuri e ëmbëlsi. Shenjtërim do të thotë të jetë njeriu i dhën' i tërë një instituti mirëbërës dhe t' i shërbejë atij. Të përballojë me durim e dashuri tërë vështirësit që ndodhen në të, parafonitë e ankimet, tërë punën e përpjekjen. Shenjtërim do të thotë të rrojë njeriu me durim e dashuri jetën dhe punën e zakonëshme dhe këtë t' a bëjë me qëllim e paramejtim të shërbehet i afërmi dhe të ndriçohet bota. Pas pikpamjes orthodhokse, jeta e krishtere përbëhet prej veprimesh të zakonëshme, por të shenjtëruarë me qëllimin e mirë. Te armonia e botës, te përsosuria, te Krishti, njeriu do të ngjitet nga udhët e zakonëshme. Vet jeta e përditëshme e shenjtorevet të mëdhenj përbëhet prej lutjes së rregulltë e prej konformimit me ligjet e jetës së tyre. Por lutja dhe puna e jonë të bëhet me etjen që bota të bëhet më e mirë, të largohohet nga mekati, të shpëtojë nga të këqijat, nga urija, nga lufta. Këtë agoni pati dhe Shën-Maria që kur ish vajz' e vogël dhe para se t' i çfaqej engjëlli Gavriel e t' i sillte lajmin e mirë. Ndjente një dashuri e simpathi të thellë për popullin e sajë, falej për të, studjonte profetitë në lidhje me Shpëtimtarin që pritej, dhe të gjitha këto i a shentëronin jetën. Po këtë bënte dhe Krishti, shumë kohë përpara jetës së tij publike, kur rronte në Nazaret. Rronte si të tjerët. Por punët e tij të zakonëshme i bënte me tejshekime të mëdhenj, me çqetësimin për shpëtimin e botës. Kish nisur veprën e tij shëlbenjëse, shumë kohë para Golgathajt.

Duhet të kryejmë punën t'onë të përditëshme me dashuri, dyke patur sytë t' anë të kthyer drejt infinitetit, drejt Perëndisë. «Në hani ose në pini, çdo gjë e bëni për lavdi të Perëndisë», dhe kini për t' u dhënë vlerë, shenjtërim, edhe punëvet t' uaja më të vogëla. Me këtë menyrë do të udhëzojmë jetën t'onë drejt idealit, drejt përsosurisë, drejt orthodhoksis.

3. — Orthodhoksia, Kish' e spiritualitetit dhe e brëndisë.

E treta karakteristik' e Orthodhoksisë është spiritualiteti i sajë, brëndia e sajë. Posedon të vërtetën, jo si amanet, por më tepër si jetë dhe rilindje. Orthodhoksia s' merret me shërbime të shumta; vë re më tepër Krishtin dhe dëgjon fjalën e tij. Të tjerët i ngjajnë Marthës, orthodhoksia Marisë.

Me orthodhoksinë Krishti është buka mystike, e përjetëshme e jetës. Sa sot s' ndjejnë uri si në shpirt ashtu dhe në trup! Ç' do sent na trondit, i brëndëshëm ose i jashtëm qoftë ky. Vini re fytyrat e njerësvet. Është shkruar mbi' to britma e agonis: «Vdesim prej urije. Kërkojmë një fjalë që t' a përdorim mbrëmanet për fëmijën t'onë, për gruan t'onë, për burrin t'onë, për vetën t'onë. Ah, sikur të kishim çka na lypset!»

Orthodhoksia me brëndin e sajë, na çel ungjillin dhe na thotë se dikush në shkretëtirë ushqeui vlezërit e tij. Ky ka edhe sot të na ushqejë. Orthodhoksia është ylli që do të na e tregojë udhën për te Ay. Orthodhoksia do të na e predikojë edhe një herë me fuqin, me pëstërtin, me entuziasmën, me të cilën e predikuan Apostojtë dhe deshmorët.

Me këtë brëndi të sajë Orthodhoksia është vazhdimisht e ripërtëritur. Me lindjen e Krishtit rilindet, me vuajtjet e tij vuan, me ngjalljen e tij ngjallet dhe me frikë pret që Zoti të vijë lavdërisht në këtë botë. Fitorja me të cilën u-mund bota është besa e jonë. Orthodhoksia beson dhe rron me brëndi në frymën e Krishterimit, që është mjaft' e fuqishme për t' a mundur botën. «Kini kurajë, un' e munda botën» (Joan 16.33).

4. — Orthodhoksia, Kishë Ekumeniciteti.

Karakteristika e katërt' e orthodhoksisë është ekumeniciteti. Fryma e sajë është e përbotëshme, ka për qëllim të rilindnjë e

të rindërtojë çdo krijesë q' arësyeton. «U dërgon frymën tënde dhe ndëtohen dhe përsërit faqen e dheut» (Psalm. 103) Këjo frymë krijonjëse cilëson orthodhohsinë.

Orthodhoksia ka qellim të përbotëshmë, se është kisha e vërtetë, kisha që posedon të vërtetën të plot' e të pastër më Frymën e shenjtë. Orthodhoksia do të përbëjë bazën për bashkimin e të gjitha kishave. Ky bashkim nuk do të kryhet me përpjekjet e njerësvet, sa me veprimin e Frymës së shenjtë që banon n' atë. Orthodhoksia është udha e brëndëshme, nevoja e brëndëshme, për kishën e përbotëshme, udha e brëndëshme për bashkimin. Orthodhoksia qëndron përmbi çdo kishë tjetër të krishtere. «Përmbi Orthodhoksin—thotë Sergji Bulgakof—s' ka tjetër kubë veç kubës së qiellit».

5. — Orthodhoksia, përjetësi brënda në kohë.

Kisha orthodhokse qëndron përmbi kohën, është përjetësia brënda në kohë. Njëzet shekuj po thuaj ndiqet, dhe me gjithë këtë qëndron. Ky fakt përbën sigurimin më të fortë për t' arthmen e sajë. Ecën me hap të qëndruarshmë e me qetësi, bile dhe në epokat më të turbullta, sepse e mbush ndjenja e përjetësisë. Ajo nuk hiqet prej kohës, por e udhëheq kohën. E përdor kohën për përjetësinë; me momentet që kalojnë ndërton përjetësinë; me kupën e kohës u jep besimtarëvet përjetësinë. Me Kishën Orthodhokse e ndjejmë Perëndinë, dhe e ndjejmë dyke na mbushur. Me atë ndjejmë të na frymzojë edhe fuqija e jonë edhe fuqija e përbashkët.

Kisha orthodhokse me spiritualitetin dhe brëndin e sajë e bëri njeriun të zot të kuptojë natyrën e tij të vërtetë e të plotë, të kuptoj vlerën e tij të vërtetë, të mar vesh që ndonëse lindet në tokë, është një qenie jo vetëm tokësore por dhe qiellore; i shtrohet vërtetë kohës por i përket përjetësisë. Prandaj orthodhoksia e mbështet njeriun në pjesën më të mirë të vetes së tij, dhe mbështetet dhe ajo në pjesën më të mirë të njeriut, në spiritualitetin, në brëndinë, në përjetësinë. Vazhdimisht ajo e shtyn dhe e ndihmon njeriun të kultivojë pjesën hyjnore që ka në vet-vete, vlerat e përjetëshme, jo të përkohëshmet. Njerës të mershës, «mos punoni për ushqimin që priset, por për ush-

qimin që mbetet për jetë të përjetëshme» (Joan 6,27). Të doni njeri tjetrin. Dashurija dhe bashkimi i njerësvet do të provojë se kemi origjinë hyjnore, se jemi bijë të Atit qiellor. Krishti kur falej natën e agonisë në kopshtin Gjethsimani, thotë: «At i shenjtëruar ruaj-i mbë emrin tënd ata që më dhe që të jenë një, sikundër edhe neve. . . . Që të gjithë të jenë një, sikundër Ti o At je tek unë dhe unë tek Ty» (Joan 17,11 gjer më 21) «Në më do ndonjë, fjalën t' ime do t' a ruajë edhe im-at do t' a dojë edhe do të vijmë tek ay edhe do të bëjmë të ndënjur tek ay» (Idem 14, 23). Por sidomos «në më doni, ruani porositë e mija» (Idem 14,15). «Prej kësaj do t' ju njohin të gjithë se jeni nxënësit e mi, në qoftë se kini dashuri njeri me tjetrin» (Idem 13,35). Me një vendosje të tillë mystike të hyjnisë të njeriu hyjmë në jetën e përjetëshme: «Këjo është jet' e përjetëshme, të njohim ty të vetmin e të vërtetin Perëndi edhe Jisu Krishtin që dërgove» (Idem 17,3).

* * *

Këto vija të pakta mjaftojnë kujtojmë për të provuar themën që Orthodhoksia është Kisha e Krishtit, që rron realitetin. «Edhe drita ndrit n' errësirë dhe errësira nuk e pushtoj atë».

Orthodhoksia, me deshmorët e sajë, me shenjtoret e sajë, me spiritualitetin, brëndin, pastërtinë, ekumenicitetin dhe përjetësin e sajë, është shkëmbi mbi të cilin qëndrojmë; është sigurimi i ynë, është kështjella që s' munt të merret, është përikja jonë.

Le të mbetemi pra të bashkuar me Orthodhoksinë, që të jemi të bashkuar me deshmorët dhe shenjtoret e sajë, me Krishtin. Lutja e jonë, e bashkuar me lutjen e tyre, fiton fuqi, shenjtërim. Përkjekja, vuajtja, sakrifica e jonë, e bashkuar me gjakun e tyre bëhet frytësjellëse, pjellore, ngjitet te Perëndija.

Të bashkuar le të sjellim gjatë meshës së shenjtë therorën t' onë. Le t' i lutemi Perëndisë që therorja e priftit përmbi tryzën e shenjtë dhe therorja e jonë, të jenë te mirëpritura prej Tij. Le të mbajmë duart të pastëra që të pranojë Zoti nga ato dhuratën e lutjes t' onë. Dhuratën t' onë le t' a sjellim bashkë me Krishtin. Le të sjellim Krishtin, vehtën t' onë, therore lavdërimi, të bashkuar me orthodhoksinë, me Kishën e tërë, që është nër anët e kohës e të dheut.

B.

Feja dhe shkenca

Problemi i jetës

XII.

Studime dhe pikëpamje të reja—Prova biologjike në kohët e fundit—Përfundimet e këtyre provave dhe profesori Driesch : Jeta vetëm nga jeta mund të dalë—Shkencëtarë Englezë kundër theorisë së lindjes automatike—„Besimi në këtë teori, thonë, është mohim i parimevet të thjeshta shkencore”—Astronomi Amerikan H. D. Curtis dhe teoria mekanike—I vetmi shpjegim logjik i lindjes së jetës: krijim prej fuqisë hyjnore—Kundërshtime foshujarake të Haeckel-it—Rrëzimi i këtyre kundërshtimeve prej shkencës e prej logjikës—Armoni e plotë midis fesë dhe shkencës.

Sulmi dhe polemika kundër theorisë së lindjes automatike, që filloi sidomos nga fundi i shekullit XIX, vazhdoi edhe gjer në vjetët e fundit, dyke patur në krye si flamurtar e si luftëtar shkencëtarët më të thellë dhe përfaqësonjësit më besnik të shkencavet pozitive. Nga bisedimet q' u-zhvilluan mbi lindjen e jetës dhe nga provat që u bënë herë pas here, u-provua me siguri të plotë, se *lindja automatike e jetës ëshië krejt e pamundur ; se nga lënda nuk mund të rrjedhë jeta me as një mënyrë ; se jeta vetëm nga jeta mund të dalë*. Studime dhe provabiologjike të, bëra me kujdes e gjatë shumë vjetëve prej shkencëtarësh të çquar, e sidomos prej profesorit Gjerman Driesch, përfunduan në vërejtje dhe vërtetime, që dënojnë edhe një herë materializmen dhe parimet e saj. Si pas këtyre pra studimevet, njeriu ruan formën e të parëve të tij, dyke trashëguar nga ata fuqi, cilësi

dhe djathtësi pikërisht si ato të atyrevet; mb' anë tjetër është provuar se njeriu nuk ruan dhe nuk sjell me vehte *as një nga elementet lëndore* nga të cilët përbëhej trupi i të parëve të tij, për arësyen se këto elemente çduken pa pushim e brenda në dhjetë vjetë ndërrohen krejt. Kur pra puua qëndron kështu, kur d. m. th. neve nuk sjellim me vehte dhe nuk trashëgojmë as një nga pjesët lëndore e trupore të të parëve t'anë, na del vetvetiu pyetja: me çfar mjetësh dhe elementesh na jepet neve forma dhe cilësit' e të parëvet? Celuli, nga i cili u-zhvilluam dhe u bëmë njerës, si munda të përmbajë me vehte tërë cilësit' e të parëve dhe me ndihmën e kujt fuqije na i dha ato? Përgjigja në këtë pyetje nuk është e vështirë: Po sa që celuli i ynë nuk mban as një element trupor të të parëve—se këto ndërrohen shpesh e çduken — atëhere me doemos shtërngohemi të pranojmë se veprojnë *disa fuqi dhe elemente të pa lëndëta e misterjozë*, të cilat i sigurojnë njeriut jo vetëm formën. po edhe cilësit' e të parëve të tij. I mbështetur në këto vërejtje e prova profesori Driesch thotë se *jeta nuk është e mundur të shpjegohet me anën e theorisë materjaliste ose mekanike* dhe se lindja, çvillimi dhe ruajtja e formës *s' është e mundur të rjedhë prej lëndës, po prej një faktori tjetër të palëndët e një qënjëje të pa lëndëte*. Këte qenje e këte fuqi të pa lëndëte e quajti profesori German *entelekia*, për kujtim t' Aristotelit, i cili predikoi i pari teorin' e qenjes jetëdhënëse. Një grusht i rëndë kundër materializmës u dha edhe n' Angli prej dy shkecëtarësh të dëgjuar: prej profesorit të Himisë Sir Frederik Hopkins dhe prej profesorit të Zoologjisë James Gray. Në mbledhjen e shoqërisë Britanike, q'u-bë në muajin Shtator të vitit 1933 të dy këta të ditur u-vërsulnë me fuqi të madhe kundër theorisë së lindjes automatike, dyke e dërmuar këte si një teori që nuk pajtohet me provat e me predikimet e shkencës së vërtetë. «Ndonse, thotë Sir F. Hopkins, ndonse studimet teoritike mbi lindjen e jetës shkakëtuan një lloj defrimi mendor, me gjithë këte duhet të pohojmë se ajo që dijmë mbi këte çeshtëje, është kjo: se nuk dijmë as gjë». «Besimi në lindjen automatike të jetës, shtoi profesori Gray, është një mohim i thjeshtë i parimevet, që janë themeli i mendimit shkencor Biologu i vërtetë duhet të pranojë gjendjen e jetës ashtu siç është dhe të mos i japë leje shkencës së tij që të mbështetet

mbi teori të thata, të cilat mund të jenë thematike dhe tërheqëse, po nuk janë as pak n' armoni me të vërtetën».

Edhe astronomi Amerikan H. D. Curtis kritikon rreptë materialistët, dyke e quajtur theurin' e tyre të vjetëruar e pa themel fare. Në një studim shkencor që botoi në vitin 1935 nënë titullin «Shkenca fizike e re dhe marëdhënjet e saj me fenë» shkruan midis të tjerave, dhe këto: «Ishte një kohë, kur shkencatarët besonin në një teori krejt mekanike, një teori q' i quante te gjitha si rjedhje dhe pjellë veprimesh fizike dhe himike. Por kjo teori duket më pak e besuarshme sot, se sa aty e 40 vjet. Çdo vëzhgonjës i pa-anëshëm i gjithësisë madhështore nuk sheh në këte tjetër, përveç se një mëndje e cila krijon, drejton e kontrollon».....

Nga sa u thanë gjer tashi mbi problemin e çfaqjes së jetës në tokën t' onë, del sheshit se teoria e lindjes automatike nuk ka as një themel të fortë shkencor, po përkundrazi ndodhet në kundërshtim me shkencën e vërtetë, siç u-provua kjo në mënyrë të qartë e me prova të gjalla prej shkencëtarësh me autoritet të math që prej kohëve më të vjetra e gjer në ditët e sotëshme. Po atëhere nuk mbetet tjetër shpjegim i lindjes së jetës, përveç se po të pranojmë se kjo lindi në planetin t' onë pas ndërhyrjes së një fuqije krijonjëse sipër natyrorë dhe të palëndëtë. Ja do të pranojmë se jeta lindi prej lëndës së vdekur, ja do të pranojmë se jeta u krijua prej një fuqie që qëndron për mbi çdo ligjë e për mbi çdo fenomen të botës lëndore. Tjetër shpjegim nuk ka. «Tertium non datur» thotë Wirhov-i. «Tertium non datur» përsëritin Haeckel-i me shokët e tij. Në se pra provohet e pathemeltë njera nga këto të dyja teori, duhet të pranohet tjetra me doemos dhe pa as një kundërshtim; e me qënë se teoria e lindjes automatike është rëzuar krejt—si kundër u-zhvillua gjer e gjatë,—mbetet vetvetiu në fuqi teoria tjetër, teoria që pranon se jeta edhe bota u-krijua nga një fuqi e një mëndje sipër-natyrore, e cila jo vetëm e krijoi botën dhe kujdeset për atë, po edhe i rregulloi me anë ligjesh çuditërisht armonike dhe madhështore. Kjo teori e fundit fuqizohet, përveç të tjerave, edhe prej punës se kudo ne gjithësinë si në krijesat më të mëdha, si edhe n'ato më të voglat, shihet hapur një armoni e një qëllim; kudo çfaqet *Mëndja krijonjëse* dhe *zbukuronjëse*

e filozofit Anaksagora. Kjo fuqi është ajo q' i dha *lëvizjen* lëndës, e cila si e vdekur q' është nuk mund të lëvizë vet-vetiu dhe kjo fuqi solli dhe krijoi jetën në tokën t' onë. Pa dyshim është shumë e arësyeshme të pranojmë se tërë kjo botë me një bukuri e një armoni të çuditëshme, si edhe tërë krijesat e saj u-krijuan me ndërhyrjen e një fuqije që vepron me arësye e me qëllim, se sa të besojmë se gjithësisja është përfundim dhe ka rjedhur nga lënda e vdekur, dyke u-bashkuar elementet e saj në një mënyrë të verbër dhe dyke vepruar pa as një rregull e pa as një qëllim.

Mirë po këtë teori, q' është aq' e arësyeshme dhe që pajtohet plotësisht me rregullën e me armonin' e gjithësisë, e kundërshtojnë me shumë forcë Haeckel-i me pasonjësit e tij, po pa paraqitur as një arësye të fortë. «Ose çvillim (évolution) natyral, thotë Haeckel-i, ose krijim sipërnatyror; është nevojë të zgjedhim një nga këto të dyja mundësi. . . Në qoftë se hidhet poshtë *monismi* (d. m. th. lindja automatike,) atëhere nuk mbetet tjetër Sjë, përveç se të besojmë *hypotezën* e krijimit, d.m.th. një mërekulli paraloge». Me fjalë të tjera kryeflamurtari i materjalistëve nuk e pranon teorin' e krijimit jo për no një arësye tjetër — nuk është në gjendje të paraqitë as një arësye të fortë — po vetëm e vetëm pse ndërhyrja e Perëndisë në punën e krijimit i duket si një mërekulli, e çdo mërekulli, si pas mendimit të Haeckel-it me shokë, është një gjë paraloge dhe jashtë logjikës e arësyes! Mërekulli pra e pa arësyeshme është krijimi i botës prej fuqisë hyjnore. Po atëhere dhe neve pyesim: mos dhe theoria e lindjes automatike e largon ngjyrën e mërekullisë dhe mos edhe ajo nuk është një mërekulli e vërtetë? Natyrisht as kush nuk mund të thotë seriozisht, se rjedhja e jefës pas një ndërhyrjeje të Perëndisë nuk është një mërekulli. Po gjith ashtu më e vogël mërekulli nuk është dhe teoria e lindjes automatike. Më e madhe mërekulli na duket që të besojmë se doli vetiu dhe rastësisht tërë kjo maqinë madhështore e organizmevet të gjalla, se sa të besojmë se kjo u-krijua prej një fuqije me mend e me arësye. Cila është mërekulli m' e madhe: të shoh një shtëpi të ndërtuar prej duarve të një mjeshtëri, i cili i rregullon elementet e ndyshme si pas një pllani të caktuar, apo t' a shoh atë të ngrihet vetvetiu dhe, elementet të bashkohen vetve-

tiu dyke-u-venë në levizje prej fuqirash misterioze të natyrës anorgane? Edhe theoria pra e Haeckel-it është një mërekulli dhe bile një mërekulli, të cilën mendja e njeriut — deri sa kjo nuk është errësuar prej mjegullës së para gjykimevet—nuk mund t'a pranojë, sepse është në kundërshtim të madh me përfundimet e shkencës dhe verejtjet e provës së përditëshme.

Kështu pra—që të mbarojmë me studimin e problemit të jetës—theoria e materialistëve mbi çfaqjen e jetës në tokën u-luftua egërsisht, që nga koha e predikimit të saj gjer në ditët e sotëshme, prej shkencëtarëve me të mëdhej të botës dhe u-rrëzua definitivisht nga provat e pëfaqësonjësve më të çqar të shkencave fizikohimike. Në këte mënyrë u-rëzua dhe u-çduk e një nga armët kryesore që ka përdorur materializma kundra fesë e kundra dogmës fetare mbi krijimin e jetës dhe të botës prej Perëndisë, dyke u-vërtetuar kështu edhe një herë se midis dogmave fetare dhe përfundimevet të zbulimeve të shkencës së vërtetë mbretëron gjithnjë pajtimi dhe armonija më e plotë.

Shprestari

MENDIME T' ARTA

Dobija më e madhe e m' e vlefshme, që mund t' i sjellim t' afërmit t' onë, është kjo: t' a sjellim në gjendje që të mësojë dhe të njohë të vërtetën, kjo është doktrina e Krishtërit; ky është qëllimi i tij i fundit.

* * *

Feja është mjete më fisnik dhe më i mirë për t' a shpënë njerinë në rrugën e virtytit.

* * *

Virtyti na porosit që të tregojmë respekt dhe kundrejt robës së lypsit.

* * *

Gjer sa ndodhemi në këtë jetë, është e pa mundur të shpëtojmë krejt nga ngasjet; se pse, si kundër thotë Job-i i drejtë dhe i shumë vojtori, jeta e njeriut në këtë botë është plotë me ngasje.

Agjërimi i ynë

Edhe kur të agjëroni mos bëhi të vrerëtë posi ipokritët: sepse ata prishnjënë fytyrat e tyre që të dukenë ndër njerëzit se agjërojnë

(Mat-the 6,16)

Për t' i arrijtë vepravet dhe qëllimeve të mëdha duhet një përgatitje e pashoqe. Po kje se dishrojmë qi t' a kryejmë një vepër me sukses nuk duhet t' a nisim deri sa mos t' i kemi vue bazat, tuej mejtue punën mirë se me ç' farë mjetesh do t' i a arrijmë qëllimit. Cili prej nesh ka aq guxim të marrë një udhë të gjatë pa pas sigurue të gjitha sendet e nevojshme për atë udhëtim?

Njeriu qi mendon të bajë një udhëtim të gjatë pa marrë masat e duhuna asht baras si ay qi udhton me mjete të vjetra e të shkatrueme. Mjetet e udhëtimit prishen e udhtarit i duhet me u ndalë në mes të rrugës pa mujtë të kryejë punët e tija sado urgjente qi të jenë.

Para nesh, prâ, qindron një problem me rëndësi. Dëshiri i jonë asht, qi udhëtimi qi jëmi tuej ba kah Shpëtimtari t' a kryejmë ma s' miri. Për këtë udhëtim na duhet të përgatitemi qi mos të mbetemi në mjes të rrugës tuej u kthye përsëri pa ja arrijtë qëllimit. Kjo udhë nëpër të cilën kemi marrë drejtimin nuk asht aq rafsh por kemi pengesa, të cilat duhen të largohen. Qëllimi i ynë asht qi të njohim të vërtetën, të vërtetën shembëllore, Jisuin Shpëtimtar, e udha qi na çon te Ay nuk mund të bahet pa përgatitje të themelta. Edhe ne nuk na ka hije të bajmë këtë udhëtim pa u përgatit si duhet, qi të jemi ma të sigurtë se do të vemi deri te Shpëtimtari. Këto pengesa qi na

ndalojnë të shkojmë te e vërteta, janë në né dhe jashta nesh. «*Shpirti asht gati, por mishi asht i dobët*» (Mark. 14,18). Shpirti na drejton kah udha shpëtimtare, por mishi (trupi i ynë) i mbuluem plot me epshe don të na dërgojë n' abiz të pa fund.

Në mjes të shpirtit e të trupit gjithnji asht një luftë dhe shpirtit i duhet ndihma e paprashme që zjarmin e epsheve t' a shuej. Na duhet të vërojmë më përpara shpirtin t'onë, pse «*Shpirti asht ay që jep jetë, mishi nuk vlen kurgja*» (Joan 6,63). Trupi nuk mund të na i largojë pengesat që kemi për këtë udhëtim të Shpëtimtari por vetëm shpirti; prandaj dhe na t' a zgjedhim këtë si drejtues i cili do të na dërgojë atje ku do të shohim Dritën e pambarueme, të vërtetën e të vërtetavet. Shpëtimtari me vdekjen e Tij, të gjithëve n'a siguroj që të kemi shpëtimin. Sejcili prej nesh mund t' a bajë këtë udhëtim e Shpëtimtari nuk do t' a kthejë sado mekatar i math që do të jetë. Le të jetë njeri me mëkate e po kje se ky i afrohet me një besim të gjallë, Jisui do t' a afrojë, por do të largojë atë i cili kujton se pa ndihmën e Shpëtimtarit mund të gjejë shpëtim.

Po afrohet dita të cilën e kremtojmë si kujtim kuer se Shpëtimtari pat ba vdekjen për të na liruë prej vdekjes së përjetëshme. Kjo ditë kujtimi për ne asht shumë e kënaqëshme, por për këtë kremtim lypset një përgatitje e veçantë, ma parë tuej forcue shpirtin me shëmbujt e Shpëtimtarit e së dytit tuej kujtue të metat t' ona. Por për t' a forcue shpirtin t' onë duhet t' a pajisim me lutje e me agjërime tuej e ruejt prej epshevet të cilat kanë qendrën në trupin e njeriut. Kisha e jonë e Shënjtë këto dy mjete: lutjen e agjërimit nuk na i rekomandon rastësisht. Na mëson që të vërojmë Shpëtimtarin, i cili para se të fillonte veprën e tij pat agjërue dyzet ditë e dyzet netë në shkretëtirë (Mat-the 4,2) Agjërimi dobson epshe e trupit t'onë e lutja na forcon të luftojmë kundra mekatis që asht ndër ne e për reth nesh. Por si mund t' u hikim ngasjevet kurse edhe Shpëtimtari kje ngacmue prej Satanajt? Shpëtimtari u dha një rëndësi të veçantë si lutjeve ashtu edhe agjërimit; prandaj edhe ne që duem të shkojmë mbas gjurmave të Tij nuk mund t' i largojmë prej vedit.

Ungjilli i sotshëm na tregon që agjërimi i ynë mos të jetë formal. Disa kujtojnë se për me shpëtue shpirtin mjafton agje-

rimi tuej mos ba kurrfarë vepre tjetër. Farisenjt e tregojshin vedin me sende të dukëshme se agjerojshin, prandaj edhe Jisui i përbuste. Agjerime të rrejshëm ka edhe sot; disa kujtojnë se mjafton qi në gojë mos të shtijmë kurrnji send prej ushqimeve të ndalueme, shka asht për t' u lavdërue kjo punë, por harrojnë se shka na thotë Apostoll Pavli: *Apo nuk e dini se të shtrembërit nuk do të trashëgojnë mbretënin e Perëndisë?* (I Korinthianët 6,9) Shpëtimtarit nuk i pëlqen qi të agjërojmë si për zakon e së mbramit tuej veprue n' udhën e mekatave.

Me ditën e nesërme fillojmë kreshmët e Pashkës së Madhe. Qysh nesër fillojmë të largohemi prej ushqimeve të tepërta dhe pijeve. Do të agjërojmë pse kështu pat ba edhe Jisui dhe Apostojt e Tij. «*Edhe tek ishin ata dyke i shërbyer Zotit edhe dyke agjëruarë*» (Punët e Apost. 13,2) Nderë për ne asht kur t' agjërojmë tuej mos e teprue në haje e ne pije.

Përpara një veprës së madhe qindrojmë, prandaj të përpiqemi qi këjo hymje në kreshmët të na jetë për dobi të trupit e shpëtim të shpirtit, tuej marë në ditën e caktueme Kungatën e Shenjtë.

Prof. I. B.

MENDIME T' ARTA

Tërë veprimet — dhe ato më të lartërat e më të çuditëshmet — do të prishen një ditë e do të çdukën; të pavdekura mbeten vetëm veprat e dashurisë dhe të filantropisë.

* * *

Mjeti m' i bukur, që të përparojë i krishteri në jetën shpirtërore, është ky: të mos mendohet kurrë se ç' të mirë ka bërë gjer sot, po të fillojë që sot gjithënjë no një të re.

* * *

Është e vërtetë se ç' do ligësi e shëmton dhe e prish karakterin e njeriut; po egoizma dhe kryelartësija janë helmi m' i fortë, q' arrin gjer në themelet e qënjes s'onë, helmon shpirtin nga rënja dhe e çkatëron krejt njerinë.

Një skicë shpirtit

Që të jepet një skicë e shpirtit në pak faqe, është një problem jo i lehtë. Me gjith' atë do të mundohemi t' a japim në formë popullore.

Realiteti i shpirtit

Ç' është shpirti ynë? Shpirti ynë është «Ego»-ja që ndjen, që meiton, që gëzohet, që don e vepron, domethënë vet-vehtja jonë e vërtetë.

Materializmi ja mohon shpirtit autonominë dhe e konsideron atë si prodhim të rjedhjeve të trurit, që domethënë se asgjësohet me vdekjen e trupit. Ungjilli, përkundrazi, e konsideron Shpirtin si realitet ndërgjegjës, të lirë dhe autonom, të lidhur përkohësisht me mishin, nga i cili çlirohet me anën e vdekjes dhe del si organizmë shpirtore, në një formë trupi ajror, plot me vetëdije, kujtesë, veprim dhe përparim për një botë më të lartë.

Le t' a kqyrim tani çeshtjen pa-anësisht:

Dy janë mbështetjet më të forta të materializmit: 1) Efekti i pamohuarshëm i landës mbi shpirtin-dehje narkotike, pësime të trurit.— Nga ky fakt ata nguten të nxjerrin përfundimin se shpirti është një me lëndën e nuk ekziston më vehte.

Mirë-po këjo menyre mejtimi provohet e gabuar. Sepse, sa është e vërtetë që lënda efektton mbi shpirtin, aq është e vërtetë se edhe shpirti efektton mbi trupin lëndor—kur pritet p.sh.

fatkeqësie të papritur etj.—e, pra, po të zbatojmë këtu silogjizmen e materializmit duhet të themi se, shpirti ka efekt mbi trupin, pra, trupi është shpirti dhe ky (trupit) nuk ekziston më vehte.

2) Mbështetja e dytë e materializmit është se s' kemi parë kurrë nonjë shpirt njeriu të vdekur. Pa prekur këtu çashtje spiritizmi, faneksje etj. fenomene të këtilla shpirtnore, vërejmë se arsytimi që «çdo gjë që nuk e ndjejmë në shqisat e trupit nuk ekziston» është foshnjarak e asnjëri nuk e pretendon sot seriozisht pas përparimeve të shkencës, e cila çfaqi kufit' e ndjenjave t' ona dhe shumë llojet e veprimit të përbotshëm. A mos i ndjejmë valët elektromagnetike (herciane)? A mos i shëkojmë transmetimet e televizionit? Me gjith' atë këto të gjitha ekzistojnë tani rreth nesh dhe bëhen të dukëshme kur kemi receptorët e duhur.

Asnjë, pra, nga këto argumenta s' ka seriozitet me vehte për të na ndalur në rrugën t' onë. E kështu e vashdojmë anketën mbi shpirtin dyke përdorur metodën e vrejtitimit që është e vetmja metodë pozitive dhe shkencore.

Vrejtim i paanëshëm

I. *Antagonizëm*.—Nga vrejtimi dhe eksperiencia e përditëshme del në shesh se midis «trupit» dhe «Ego»-së—Shpirtit—mund të ketë antagonizëm të madhe. Shpirti mund të luftojë ëndje dhe nevoja të trupit, të marrë drejtime të kundërtë me ngacmimet e tij e medje dhe t' a lerë trupin për vdekje, me gjithë protestimet dhe reaksionet e funksioneve të tij. Vdekje me dashje, me grevë agjërimi, vdekje martirike për të përkrahur një ç' farë-do ideologjie, të gjitha këto tregojnë se «Ego»-ja — Shpirti — është një realitet i ndryshëm nga trupi e medje më i lartë se ay, se kur don e mposht afë dhe e çon deri në vdekje.

II. *Rrena*.— Njeriu mund të gënjejë, domethënë të fshehë me qëllim nështypje që ka marrë truri i tij dhe t' i paraqesë ndryshe ngjarjet. Këjo mundësi tregon qartë se «Ego»-ja është një fuqi e ndryshme nga truri dhe vepron me liri e inisiativë kundrejtë botës së brendëshme të nështypjeve të tij. Nuk për-

bëhet nga veprimet e trurit, se atëhere do të shprehte me doemos ato që shtypen në trurin si pllakë gramofoni.

III. *Identiteti i «Ego»-së.*— Fiziologjia na mëson se gjatë jetës s' onë këtu celulet e trurit t' onë—dhe të tërë trupit—qiten gjithënjë jashtë me anën e rjedhjeve dhe zëvendësohen nga të tjera që futen më anën e ushqimeve. Një njeri tetdhjet vjeç e ka ndruar të paktën njëzet herë lëndën e trurit të tij. Mirëpo «Ego»-ja ose «shpirti» i tij ka dijeni të plotë se është i pandryshuarshëm, se është po ay që loste në moshën e fëminisë, mban mend skena të ndryshme nga jeta shkollore etj., kur se nga celulet e tij që kishin marrë ato nështypje s' ka asnjë në trurin e plakut. Shpirti pra është i ndryshëm nga trupi dhe i paprishëshëm.

IV. *Fjalimi për mendsh.*— Eksperiencia e përditëshme na dëshmon se njeriu mund të flasë vet me vehte, të mbajë fjali-me, të këndojë fare qartë, pa e lëvizur gjuhën lëndore të gojës së tij. Ky fakt tregon se shpirti e ka aftësin e foljes edhe pa gjuhën e trupit e, pra, është botë më vehte dhe e pavarrur nga trupi e nga truri.

Këto fakte na tregojnë se shpirti banon përkohësisht brenda në trupin prej mishi, ashtu si zogu brenda në vë, dyke u-pregatitur në këtë jetë për realitetin e përtejme.

Shpirti i kafshëve dhe i njeriut

Kafshët si edhe njeriu marrin me anën e veglave të tyre të shqisave ç' ka i ngacmon nga bota e jashtme, kanë përfytyrime, kanë kujtesë, çfaqje, gëzim, zemrim—. Mirë-po shpirti i kafshës s' ka aftësi që t' i analizojë e t' i sintetizojë përfytyrimet që merr nga bota e jashtme, të formojë kuptime e mejtim nga ato, ose të krijojë diçka të re dhe të përparojë. Kafsha lidhet me botën e jashtme vetëm nga an' e instiktit të saj—rrojtje e përtëritje e racës së saj—e nga asnjë pikpamje tjetër, e prandaj gjuha e saj s' mund të quhet gjuhë, se është aq e varfër dhe monotone. Shpirti i kafshës nuk ka auto-konshiençë, s' e njeh domethënë natyrën e tij, botën e tij të brendëshme, s' ka «Ego» s' është *personalitet*.

Përkundrazi shpirti i njeriut ka aftësira me anën e të cila-

vet ngrihet përmbi faktet e ndiesive dhe me anën e kuptimeve formon një botë teorike fort të madhe. Kështu njeriu thëllon në kuptimin e natyrës, zbulon ligjet e saja dhe i nënshtron për shërbimjin e tij dyke asgjësuar distanca, det e ajr. Shpirti i njeriut ka gjërësi të paanëshme dhe ka përbrenda edhe një zbrazësirë, e cila do të mbushet vetëm kur t' a njohë mirë *Krijëtarin* e tij të paanëshëm dhe të lidhet me t' të.

Njeriu, i pajosur me vet-konshiençë, me «Ego», është *personality*. I nderuar prej Krijënjësit të tij, me liri për zgjedhje, i armatosur me logjikë dhe me ndërgjegje morale si pedagog e udhëheqës, u-vendos mbi këtë Dhë si perfaqësonjës i Gjithësisë morale, që të zërë lirisht marrëdhënie Bese dhe Dashurie ndaj Krijëtarin e tij. Distanca që e ndan njerinë nga kafsha, nga këjo pikëpamje, është e pakufishme dhe del nga studimi i shpirtit të kafshës. Pretendimi i materialistëve mbi përngjarjen e truve të majmunit e të njeriut është kundër tyre, se provon që jeta shpirtnore nuk rjedh nga truri, sepse atëhere do të kishin po atë jetë shpirtnore majmuni e njeriu, sapo që kanë të njejtin tru. . . por e vërteta qëndron shumë larg. Dhe bjenë shumë poshtë ata që duan t' a përngjajnë njerinë me shtazën. Është koha që të bëhet «revanshi» i së vërtetës dhe të shkëlqejë realiteti shpirtnor i njeriut me të gjitha të drejtat e tij, por edhe me të gjitha detyrimet e tij kundër Krijëtarit të tij.

Në thëllësin' e fundit të anomalive të kohës së sotme qëndron edhe mos-kuptimi mbi njerinë. Ristorasja e së vërtetës mbi njerinë do të bëjë që të shkëlqejë bota më e lartë morale dhe hyjnore që do të shërbejë seriozisht edhe për mirëvajtjen e vllazërimin e kombevet.

V. Xh.

JETËSHKRIME SHENTORËSH

Shën-Vlashi

Ky shenjt jetoj në fillim të shekullit të IV-të. Kish studjuar degën e mjekësisë; dhe njohnit që morri prej asaj, e ndihmuan tepër të forcojë shpresën te Perëndia, se në studimin e trupit të njeriut, të këtij mikrokosmi të çuditshëm, shihte një shumicë shenjash urtësisje dhe arësyetimi që tregonin se njeriu nuk është krijesë e fatit por vepër e krijonjesit të tërë urtë e të tërë fuqishëm të gjithësisë.

Mjekësinë nuk ushtroi si mjeshtëri; e ushtroi me frymë thjesht vlla-dashjeje dhe mirë-bërësisje, dyke shkuar nëpër shtëpit e të sëmurëve të varfër, të cilët i shikonte dhe i shëronte me kujdes prej çdo sëmundjeje që vuanin. Përveç ndihmës mjekësore, u jipte atyreve dhe barrnat e nevojshme si edhe shpenzimet e shërimit. Sa herë nuk kishte vet, trokiste dyert e të krishterëve të mirë dhe, me fjalë mjaft prekëse, arinte t' u çelnjë atyre zemrat e sidomos kuletat.

Këjo kujdesje nuk e pengonte te merrej me këndimin e Shkrimit të shejtë. Me këtë menyrë mundi të bëhet një nga fytyrat më të çquara të botës së krishtere të kohës së tij dhe të gëzojë respekt e simpathi të madhe.

Dashuria e përgjithëshme që gëzonte, nuk vonoi t' a sjellë në radhët e klerit dyke u-bërë episkop i Sebastisë. Si i till imponohej edhe me anë të veprave edhe me anë të fjalës. Në fjali-met që mbante, përdorte tërë njohnit që kishte nga Shkrimi i shenjtë, nga shkrimet e atërvet apostolikë e të apologjetëvet, nga

studimi i trupit të njeriut dhe përgjithësisht nga dijenitë që kishte rreth natyrës.

Në kohën kur mbretëronte Lyqini, të cilin Galeri e bëri august më 307 pas Kr. dyke i dhenë në pushtet Lindjen, qeveritari Agrikor e përdha Shën-Vlashin në mundime. Pas shumë rahjesh, që i duroi me buzqeshje, i çanë mishin me thonjë prej hekuri dhe pastaj e hodhën në burg.

Gjatë kohës që po e mundonin, shtat gra prej atyreve që ndodheshin atje për të bërë seir, ndjenë një zemërim aqë të math për atë padrejtësi të egër që po bëhej dhe një simpathi e dashuri aq të fortë për shenjtin sa që, dyke mundur dobësin e tyre natyrale, i folën tiranit me një gjuhë tepër të guximëshme; sidomos, kur ay vuri në tallje besën e krishtere, ato me një guxim të pashembëlltë, treguan në menyrë të qartë kotësin e idhujvet e të besës pagane. Dhe qeveritari, dyke çfaqur prirjet e tij shtazore, i deklaroi të denjë për dënim. Por edhe para këtij rreziku të dukëshmë, gratë s'u-trembnë. Mbetnë përkundrazi të patundura në besën e krishtere gjërsa më në fund pësuan dënimin e kok-prerjes.

Këtë mbarim të përgjakëshmë, por dhe të lavdishmë, pati dhe Shën-Vlasi. Koka e tij e hijëshme, e cila aqë herë kish forcuar besën, kish mbajtur fen e vërtetë dhe kish pjellur aqë mirëbërësira, ra dhe ajo nën goditjen e xhelatit. Dhe keshtu jeta e tij e këtushme u-shua, por kujtimi i tij mbeti i pavdekshëm dhe i lulëzuar dyke e paraqitur atë si typ të gjallë të bashkimit harmonik të fesë me shkencën dhe të episkopit bari që di të sakrifikojë vet-veten për hir t' Atij që i ka besuar grigjën e vet mendore.

MENDIME T' ARTA

Trim dhe shpirt-madh nuk është ay që ndizet e zëmërohet kundër atyre q' e shajnë dhe q' e dëmtojnë, po përkundrazi ay që qëndron i paturbulluar e i qetë dhe që ka fuqinë t' a çpërblejë të keqen me të mirën.

Si duhet të qëndrojmë në Kishën e Zotit dhe të Shënjtorëve?

«Është shkruar; shtëpija jeme do të quhet shtëpi lutjesh»
(Matth. 21,13).

Porosi e Shpëtimtarit e parathënë prej profitëvet, është me plot kuptim sepse që në krye Zoti kur krijovi botën, punoj gjashtë dit dhe të shtatën ndenji e u-çlodh; kështu dhe në passit punojmë gjashtë dit, të shtatën vemi në shtëpin' e Zotit për t' u-falur, për të marrë Hir, dhe për të zbutur ndjenjat t' ona të forta gjatë ditëve të punës, në ndjenja bamirësije.

Në Kishë vemi që të falemi dhe të përhirojmë Zotin për mbrojtjen që na ëp çdo ditë dyke na ruajtur prej të këqijavet. Kisha është shtëpi e Zotit ku pret bestarët dhe ata të cilët e ndjejnë detyrën, që kanë kundrejt Atij. Sikurse Ay n' a pret në shtëpin' e Tija me plot butësi dhe mirësi, tue n' a falur mekatat, kështu dhe në kemi detyrë të çquajmë shtëpin' e Tija nga çdo vënd tjetër. Duhet që në hyrje të portës të matëm çapet e të qepim gojën, të unjim kryet, të zemë vënd kudo qoftë pa vënë ré në se jemi përpara ose në fund, dhe të falemi shpirtërisht dyke dëgjuar hymnet që këndohen atje deri në mbarimin e Meshës. Nga të gjitha sa thamë më sipër, më me rëndësi është *heshtja* dhe kjo u këshillohet më tepër *grave*, sikurse e thotë dhe Apostoll Pavli: «*Gratë t' uaja le të pushojnë së foluri sepse nuk' u-ndjenet atyre të flasën në Kishë; por vetëm të unjin kryet*». (I Korinth.14,34).

O njeri! Pse kur vete në një zyrë troket në portë, çapet e tua i ngadalëson, nxjer kapelën, salluton dhe kërkon lejë me përunjësi e frikë para se të pyesësh? Por shtëpin' e Zotit pse

nuk' e çquan? Pse fjalosesh dhe nuk mejtohesh mbi detyrën që ké, e përse ke vajtur në kishën e Shënjëtorëvet? Pse sjellë zemërim te Perëndija me zhurmën që prodhon? Dije pra se faji që bën dyke folur në Kishët, dot' të sjellë prishje dhe çkatërim, sepse le për vehten t' ende që nuk përfiton gjë shpirtërisht nga Hiri që është atje, por skandalis edhe zëmrat e qeta, që nga shkakut i yt qëndrojnë në shtëpitë dhe falen atje. Bëre faj të math, sepse ay që ndenji të falet në shtëpi, keq nuk bëri por Hirin që zbret në Kishët, t' i nuk' e le t' a përfitojë. Prandaj hiq dorë nga faji i yt, pusho së foluri, qëndro me përunjësi, kërko ndjesë, dhe vetëm tue mos e përsëritur fajin t'ënd do të ndjehesh prej Zotit, dhe do të përfitosh thesarë në Qiejt. Sikurse në kohën kur Jisu Krishti ishte mbi tokë, dhe nxori jashtë nga Kisha gjithë judenjtë që fjaloseshin dhe bënin për asgjë Kishën e Perëndisë; kështu dhe ata prëj nesh që në kohën e sotme nuk' çquajnë shtëpin' e Zotit, Jisuj ka për t' i nxjerë jashtë nga Drita e përjetëshme dyke j' u treguar errësirën sepse për atje do të jetë merita e tyre.

Ty që të pelqen të mbash emrin i Krishterë duhet t' a dishë se jo vetëm që ke detyrë të çquash shtëpin' e Zotit prej një zyre dhe një banese njerzish për vehten t' ende, tue mos folur dhe tue mos sjellë shkak skandali, por ke detyrë në të madhe akoma të këshillosh atë i cili nuk' e di këtë detyrë, dhe mos u-tremb në të kundështoftë se ke për t' u ngjarë profitvet, tue marë pagë të madhe sikundër thotë dhe Zoti: «Gëzoji dhe gazmoji, sepse paga e juaj është e madhe në Qiejtë, se kështu u-ndoqnë dhe profitët që kanë qënë përpara jush». (Mat-th. 5,12).

Nxënësi.

Njeriu në hidhërim

Për sa kohë gjëndemi në këtë jetë provizore dhe lundrojmë në detin e hapur të saj, s' duhet të mërzitemi, në qoftë se ne takojmë përpara furtuna dhe ciklonë, dhe çarkohemi prej valëve të rrëmbyëshme të ngushticave dhe të hidhërimeve.

Jeta është porsì ay deti i gjerë, i cili nuk qëndron përherë i qetë dhe i butë; por shumë herë ay tronditet, shkumbëzojnë dallgët dhe detari që lundron mbi' të është i detyruar të mundet e të luftojë ashpërsin' e valëvet dhe të dalë tej nga egërsimi i furtunës. Kështu që jeta në këtë rast, nuk është e mundur të çfaqnjë këtë pamje, por me gjithë këtë dhe kjo shumë herë bije lote dhe psherëtime të hidhëta në vënd të dallgëvet dhe njeriu që i jeton është i detyruar të luftojë me guxim dhe t' i presë me durim hidhërimet dhe ngushticat që i çfaqen. Vallë, vetëm kjo është detyra e tij e tërë? Natyrisht jo.

Sepse shumë herë hidhërimet dhe ngushticat kanë qënë dhe janë shkak i gabimevet t' ona, dua të them largimi ynë dhe kryengritja kundrejt ligjit të Perëndisë. Perëndija kur shikon se rruga që kemi zënë do të na sjellë në ayushën e vdekjes shpirtërore, kur shikon se jeta e jonë imorale do të krijojë varrin t' onë, Ay dërgon atëhere hidhërimin dhe sjell mbi në ato që neve na duken fate.

Qëllimi, për të cilin Perëndija na paraqit të këtilla raste të hidhëta, është që neve t' i ndjejmë mëkatat dhe gabimet t' ona, dhe t' i presim rrymën jetës s' onë mekatore, duke lypur në pëndim dhe në rrëfim mëshirën e Perëndisë; sepse hidhërimi është ay që përul njerinë, thyen zemrën e tij mekatore, shpon shpirtin fajtor dhe krijon në 'të një ndryshim t' atillë të cilin as ndonjë tjetër përveç se hidhërimin nuk do të mund t' a bënte.

Po, për disa shpirtra, që janë prej natyre si me thënë të fortë dhe pa ndonjë ndjenjë, i vetëmi bar-shpëtim për 'ta është hidhërimi, dhe mjeti për t' u-kthyer në shpëtimin e tyre, është pendimi.

Se sikurse shikojmë pothua për dita në jetën t' onë, nër ata që vazhdojnë jetën e paligjëshme dhe përbuzin këshillat, e verbohën ndaj shëmbëllat e mira, e shurdhohen në dëshmimin e ndërgjegjes atëhere vjen hidhërimi prej këtij ose prej atij shkakui.

Dhe atëhere ç' shikon? Ato zemrat e forta më perpara dhe pothua pa ndonjë farë ndjenje, pendohen, vinë në vet-vehte dhe më në fund lypin, me shpirt të përunjur dhe me zemër të thyer mëshirën dhe hirin e Zotit.

Të këtilla ndryshime bëhen për dita në shumë shpirta njerëzorë. Dhe për ata që kanë sy të shohin këtë ndryshim të çuditshëm që krijohet në zemrat e njerëzvet me mjetin e hidhërimit, nuk është myster i pazhvilluar se Perëndija përdor shumë herë këtë mjet për pendimin dhe shpëtimin e krijatyrave të tij mendore, të njerëzvet. Përndryshe kemi, për vërtetimin e atyre që thamë më lart, jo vetëm eksperiencat e përditëshme, po, më me rëndësi dëshmimin e Shkrimit të Shënjt, i cili, siç do t' a shohim, vërteton të thënat me anë të ngjarjeve. —

* * *

Hidhërimet që na dërgon Perëndija, nuk janë gjë tjetër veçse ilaçet ose barnat e shpëtimit dhe të pendimit t' onë; dhe këtë e shikojmë në ngjarjet e përditëshme të jetës s' onë së përkohëshme. Veç asaj këtë na e vërteton dhe Shkrimi i Shënjt, i cili me ngjarje vërtetimi të padyshimta, vërteton se hidhërimi dhe arësimi i Perëndisë, sjell pendimin dhe shpëtimin e njeriut mekatar. Dhe ja :

1) Kur Israilitët u-futnë në shkretëtirën, në dheun Edhom, folën kundra «Perëndis dhe Moisiut» duke thënë :

«Përse kështu, na nxore prej Egjyptit të na vraç, në shkretëtirë ?

— Atëhere Perëndija që t' i urtësojë dhe t' i sjellë të ndjejnë mekatën, dërgoi ndër' ta gjarpërinj vdekje-prurës, të cilët i kafshonin dhe vdisnin. Ç'ish kjo për izrailitët? Një hidhërim dhe provim, i cili solli në mes të tyre lote dhe zinë. Hidhërimet dhe provimet janë ato, të cilat e sjellin njerinë në ndjenjën e mekatës dhe e drejtojnë atë në rrëfimin e fajit të tij. Kështu dhe Izrailitët, nën pushtetin e gjëmës që u ardh'atëhere, çfaqen me zemër të thyer e të përunjur përpara Moisiut

pendimin e tyre duke thënë: Bëmë faj, folmë kundra Zotit dhe kundra teje. »Lutju pra Zotit që t' a heqë prej nesh gjarpërin» (Num. XXI, 1-9)

2) Mekaton Mbreti i Judenjve Manasia. Mëkata e tij ish adhurimi i idhujve, të cilat i futi brenda në Jerusalem dhe me anën e tyre (t' idhujve) zëvendësoi adhurimin e Perëndisë së vërtetë, në të tillë mënyrë, saqë «i urdhroi Manasia Jdenjt dhe banorët e Jerusalem të bëjnë të ligën më tepër se të gjithë kombet». Ç' bëri Perëndija atëhere që t' a urtësojë Manasinë dhe Judenjt dhe t' i sjell n' udhën e shpëtimit? E thotë Shkrimi i Shënjt: «Dhe shpuri Zoti mbë' ta Kryetarët e fuqishëm të Mbretit Assur, dhe e muarën Manasinë të lidhur në vargonjë dhe e shpunë atë në Babilonë». Cili qe përfundimi i këtij hidhërimi dhe i kësaj fat-keqësisje? Le t' a dëgjojmë: Passi u hidhërua Manasia, kërkoi menjëherë faljen prej Zotit të tij dhe duke u përurjur përpara Perëndis dhe etërve të tij kërkoi pendim, dhe u fal dhe ay, dhe e dëgjoj të thërriturit, dhe e ktheu atë në Jerusalem në Mbretërin' e tij, dhe e njojt Manasia, se Zoti ay është Perëndia (II. Paral. XXXIII; 1-13).

Ç' tregohet pra, prej këtyre ngjarjeve që përmëndëm nga Shkrimi i Shenjt? Tregohet ajo, të cilën e shikojmë pothua për ditë, domethënë se hidhërimet përbëjnë pendimin dhe shpëtimin e njeriut mekatar.

Prandaj kohën e hidhërimi, nuk jemi vetëm të detyruar t' a presim, sepse kjo është vetëm një pjes' e detyrës s' onë; po detyra e jonë më kryesore është të pyesim ndërgegjejen dhe t' a provojmë jetën t' onë. Në qoftë se jemi në mekatë dhe në mospendimin, atëhere jemi të detyruar të pendohemi dhe të ndreqemi. Sepse pa dyshim, hidhërimet janë mjeti me anën e të cilit Perëndija na fton të lëmë jetën e paligjëshme dhe mekatarë dhe të kthehemi në pendim te Ay.

Dhe që këtë shohim se hidhërimet, që na dërgon Perëndija janë një nga mirësitë më të mëdha te njeriu mekatar.

Përktheu: Murgu

I BIRI I SHTËPISË SË DAVID-IT

(Rrëfenjë)

XXII

I dashur baba,

Në këte letrë po vazhdoj tregimin e Joan-it reth ngjarjevet tragjike q' i ngjajtnë profetit në këto ditët e fundit:

«Mbasi tha këto, vazhdoi Joan-i, u-largua kaqë sa nuk dukeshe më. Unë, me gjithë porosinë që na dha, nuk mundnja me as një mënyrë të ndahem prej tij; desha të jem gjithë një pranë që ta ruanja nga çdo e keqe qi mund t' i ngjiste në këto ditë të zeza; i shkova pra pas, i u afrova dhe ç' të shoh! Jisui kishte rënë më gjunjë dhe faleshe ne Zoti plot me hidhërim e me agoni. Kur po e shikonja kështu, me një herë një rreze drite e fortë më goditi në sy aqë shumë, sa unë kujtova për një çast se po humbisnja dritën e syve të mija; po nuk kaloi shumë kohë dhe m' u çelnë përsëri sytë e atëhere o Zot! pashë një engjëll, i cili kishte zbritur prej qiellit dhe e ngushëllonte e e forconte profetin e hidhëruar. Pikërisht n'atë çast pashë dhe fytyrën e Jisuit; o Perëndi! sa i ndryshuar m' u-duk! fytyra e tij ishte krejt e ndryshme, një agoni e pa kufishme e kishte pushtuar dhe djersë e shumë mbulonte fytyrën e tij të bukur e t'embël! As një herë tjetër nuk e pashë aqë të transformuar nga trishtimi e nga agonija.

Engjëlli m' u-duk si kur i jepte kurajo dhe me dorën e tij i a tregonte qiellin. Jisui atëhere shtiri sytë në drejtimin e dorës së engjëllit dhe fort i mallëngjyer tha: «At i im, u-bëftë dëshira e Jote». Engjëlli pastaj, pasi e përqafoi me duart e tij, u-çduk me një herë, dyke e lënë profetin përsëri vetëm. N'ate çast u-përhap në vendin ku ndodheshim një erë e mirë dhe aqë e fortë, sa unë gjer n' atë kohë kurrë s' e kisha ndjerë.

Pas ikjes s' engjëllit Jisui u-duk më i qetë; me gjithë këte unë nuk desha t' i a trazoj mendimet, në të cilët kishte hyrë, e prandaj u-largova nga dalë së këtejmi dhe vajta atje ku ishin shokët e mij, Petroja dhe Jakob-i, të cilëvet dhe u-tregova tërë ato që pashë e dëgjova. U-shtrimë pastaj në tokë që të çlodhemi nga mundimet e nga mallëngjimet e ditës dhe pa dashur e pa kuptuar fare na mori gjumi. Po nuk kishte shkuar shumë kohë dhe ja po dëgjojmë një zë t' ëmbël e të njojtur: ishte zëri i mësonjësit të dashur, i cili me ëmbëlsirën e tij të zakonëshme na foli kështu: «Po flini, o djemt e mij? pse vallë? mos u-bë vonë dhe mos ka kaluar koha shumë? Mjerë! po shoh se nga shpirti vetëm jini të fortë, po jo dhe nga trupi. Ngrehuni të shkojmë prej këtej, se ja po afrohen ata që më kërkojnë».

Të tmeruar nga këto fjalë nuk pamë si u-ngritëm të gjithë, kur me një herë aty fellë vumë re dritëra që lëviznin në mes të shjelgjëvet e njëkohësisht dëgjuam dhe zëra njerëzish që po na afroreshin e që po flisnin në mes të tyre me zë të ulët. Atëhere i thomi Jisuit:

— Mësonjës, s' ka dyshim se këta njerës që po na vijnë kështu kanë qëllime të liga; prandaj pa humbur kohë le të ngjitemi mbi malin e së këtejmi le të marim rrugën e Bithanisë; kemi kohë të ikim e të shpëtojmë aga duart' e këtyre njerësve të pa udhë.

— Jo u përgjegj, jo, duhet të qëndroj këtu, se kështu është dëshira e Atit. Ju mund të shkoni, po unë duhet të shkoj atje, ku do të më shpjenë këta.

— Jo mësonjës, thotë Petroja. Ke kohë të largohesh e të shpëtojsh; po në qoftë se ti nuk dëshiron t' a bësh këte gjë, atëhere ja ku të thom se unë nuk loz prej këtej as një pëllëmbë dhe se do të të mproj me terë fuqit' e mija. Këto fjalë po thuaj i përsëritnë dhe nxënësit e tjerë, q' u ndodhnë aty; po Jisui tepër i mallëngjyer tundi kokën dhe tha:

—Nuk dini as se ç'thoni, as se ç'bëni. Këte vetëm ju thom: se po m' afron ora.

Nuk kishte mbaruar akoma së thëni këto, kur arijnë pranë nesh kriminelët dhe i ngritnë llambadhet, që të na shohin më mirë. Atëhere unë mbeta si i gurrosur, kur pa pandehur fare pashë Judhën në krye të këtyrevet!

Po habitja m' u shtua edhe më shumë, kur Judha pa një pa dy i afrohet Jisuit, e përqafton dhe e puth dyke thënë:

— Gëzohu, mësonjës! Jam i lumtur që po të gjej këtu.

— Judha! i përgjigjet Jisui, me të puthura kërkon të tradhëtosh Birin e njeriut? Po Judha pa i venë veshin këtyre fjalëvet të Jisuit, u-këthye nga turma që kishte prapa dhe dyke e treguar me gjisht mësonjësin, u thotë:

— Ky është, zereni dhe burgoseni. Me një herë nonjë-qind njerës u-sulnë kundër Jisuit. Po Petroja më Jakobin zunë vënd përpara me qëllim që t' a mprojnë, kur se unë qëndrova anës dhe u-bëra gati t' i bje çdo njeriut që do të guxonte të verë dorë mbi Jisunë. Një nga sulmonjësit, më guximtar e më i egër, u-afrua dhe ngriti shkopin përmbi kryet e mësonjësit; po n' at çast Petroja e nxori thikën dhe i a pret veshin kuximtarit të çmendur. Më vonë mësuam se quhej Malko dhe se ishte shërbëtor i kryepfritit.

— Petro, i thotë me një herë Jisui, vere thikën në vënd dhe mos e përdor më tjetër herë, se çdo njeri që përdor thikë, nga kjo ka për të gjetur vdekjen.

Kthehet pastaj nga turma dhe i pyet:

— Cilin kërkon?

— Jisun Nazareun! bërtitnë si të marrë.

— Unë jam! përgjigjet Jisui me një qetësi të çuditëshme. Atëherë një skenë e pa besuar u-çvillua përpara syve t' ona me një shpejtësi rrufeje: Terë kriminelët si të shtyrë prej nonjë fuqije misterioze dhe të pa dukëshme, ranë njeri për mbi tjetrin dhe u-shtrinë përdhe si të goditur; Judha vetëm qëndroi mbë këmbë dhe po e shëkonte herë Jisunë me nxënësit, herë kriminelët të shtrirë.

— Mësonjës, thotë Petroja, po sa që fuqija t' ende hyjnore kall tmer aqe të madh në shpirtin e këtyre keqbërësve, s' ke pse të trembesh fare. Më jep leje t' i bje e t' a vras Judhën?

— Jo, Petro, i përgjigjet Jisui gjithënjë i qetë dhe i ëmbël. Judha duhet të rojë, që t' a njohë mirë fuqinë t' ime dhe të kuptojë se, po të mos desha unë, as ay as ushtarët e tij nuk do mundnin të më bënin gjë të keqe.

Në këte kohë e sipër turma e shumë që vinte pas atyre që u-shtrinë përdhe, kur pa këte ngjarje të pa pritur të shkakë-

tuar nga fuqija e Jisuit, u-sul me tërbim më të madh kundër mësonjësit dhe e arestoi me në fund.

Ne, nxënësit e tij q' u-ndodhëm aty, u-përpoqëm t' a çkëputnim e t' a shpëtonim nga duart e këtyre njerësve të liq, po ishte krejt e pa mundur. Terë përpjekjet, si dhe terë protestimet për arestimin e një njeriu të pa fuqishëm, shkuan kot. Jisui u-arestua e atëhere ne u-tërhoqëm nga thellësiat e kopshtit, kur se bishat e egëra e shpunë. Jisun në qytet, si një rob të thjeshtë!»

Këtu e preu tregimin Joān-i i lodhur jo aqë nga të folurit, sa nga mallëngjimi e nga hidhërimi i pa kufijshëm. Këtë hidhërim na e kallu edhe neve, e kështu të gjithë bashkë zumë të derdhim lotë dyke mos nxjerë nga goja as një fjalë. Kur më në fund lotet e paksuan tristimin e madh, një mendim e një pyetje na e pushtuan mendjen: si vallë dhe pse Jisui-i cili siç u-provua, kishte fuqi me një të parë vetëm t' i çduk armiqtë — pse vallë u-la në duart e tyre, ndonëse e dinte mirë se ku do t' a shpinin?

Me gjithë këte, baba, ne këtu nuk pushojmë së patur besim të plotë në profeti dhe shpresojmë gjithënjë, se më në fund do t' i çkatërojë ndjekësit e dobët. Në pak ditë ndofta do të zbulohet misteri që mbulon profetin dhe që bëhet dita ditës më i errët. Sot për sot ngushëllohem me fjalët e tij të fundit:

«Çdo që ngjet tashi rrotull jush, hë për hë nuk mundni t'a kuptoni, po do t' a merni vesh më vonë; atëhere do të mësoni se me të vërtetë Ati më dërgovi. Kini besim të plotë në mua dhe të gjitha do t' ju zbulohen. Mundimet e hidhërimet e mija le të mos tronditin besimin t' uaj. Erdha në këte botë, jo që të mundem, po që të mund' e që të fitoj; po më parë është nevojë të përulem; e në se tashi përulem, këte e bënj se dua që kur të lartësohem unë, të lartësohet dhe bota bashkë me mua».

Bija jote e dashur

ADINA

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

REVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Viti i IV.¹⁶

Prill 1943-XXI

Nr. 2

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

LANDA : Kryetari i Kishës Orthodhokse pranë Mëkambësit të Përgjithshme - „Krishti u-ngjall” - Nga pësimet e Shpëtimtarit - Muzika në Kishat Orthodhokse - Krishti u-ngjall - Meditime me rastin e pësimevet dhe të Pashkës - Llambadhë gëzimi - Krishti u-ngjall! Me të vërtetë u-ngjall! - Shtylla për rininë - Shtylla e Kletit.

Kryetari i Kishës Orthodh. pranë Mëkambësit të Përgjithshme

Më 5 të këtij muaji dhe n' orën 6 pas mesdite Kryetari i Kishës s' onë Orthodhokse Kryepiskopi i gjithë Shqipnis Imzot Kristofor Kissi, i shoqëruar prej anëtarëvet të Këshillit Mikst dhe Ekonomik, u-paraqit përpara Shk. së Tij Mëkambësit të Përgjithëshëm të ri, për t' I parashtuar n' emër të Orthodhoksëvet të Shqipërisë përshëndetjet dhe urimet më të nxehta për detyrën e lartë që denjoi t' i ngarkojë Sovrani i ynë August.

Pritja ka qenë e përzemërtë dhe e frymëzuar prej bujarisë dhe fisnikërisë që e ka karakterizuar gjithënjë Mëkambësin e ri. Kryetari i Kishës, me një përshëndetje të shkurtër po plot me kuptim, çfaqi gëzimin e kthjellët të grigjës orthodhokse të Shqipërisë, sepse drejtimin e fateve të saj e merr në dorë një personalitet i shquar dhe i lartër, një personalitet që e ka dashur kurdoherë Shqipërinë dhe që ka mundur të njohë mirë, gjatë kohës që ka ndenjur këtu, elementet e Shqipërisë bashkë me karakterin e me virtytet e tyre. Ja tekstualisht përshëndetja e Kryepiskopit:

Shkëlqesë,

Duke interpretuar ndjenjat e Orthodhoksëvet Shqiptarë që kam nderin të kryesoj shpirtnisht, I uroj Shkëlqesës s' Uaj mirësardhjen dhe sukses të plotë në misionin e lartë që Ju ka besuar Madhërija e Tij Mbreti i ynë Perandor Viktor Emanuel III.

Dashurija që kini treguar për Shqipërinë gjatë qëndrimit t' Uaj të mëparëshëm në vëndin t' onë është për ne një garanci e fortë që na bind se, edhe tash e tutje, do të punoni për të mirën e vëndit dhe do të vazhdoni veprën e Predecessorit t' Uaj për të forcuar miqësinë shekullore që na lidh me Italin Perandorake, kundrejt së cilës dashurija e jonë është shtuar edhe më shumë qysh prej ditës që, me kontributin e Ushtris së saj heroike, u-realizue ëndërra e jonë patriotike e një Shqipërije më të madhe.

Si Kryetar i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë e quaj për detyrë të prek me këtë rast dhe një çështje që lidhet me gjendjen e besnikëvet të mij.

Shkëlqesë! Nga njerës që s' kanë njojtur shpirtin e Orthodhoksëvet dëgjohet shumë herë të thonë se gjoja Orthodhoksët; ose një pjesë e tyre, janë grekofilë. Kjo propagandë keqdashëse dhe antipatriotike ka krijuar, fatkeqësisht, keqkuptime që kanë rënduar mbi besnikët t' anë, të cilët, për shkak të kësaj, janë bërë shumë herë viktime padrejtësinash. Mund të siguroj Shkëlqesën t' Uaj se këto akuza janë krejtësisht të pathemelta. Orthodhoksët janë Shqiptarë jo më pak se vëllezërit e tyre të tjerë; këta, patriotizmën e tyre e kanë provuar me vepra dhe janë ata që me sakrifica të mëdha kanë punuar, në kohëra shumë kritike, për independencën e Atdheut t' onë. Janë gjith'ashtu, thellësisht besnikë të Sovranit t' onë August. Kemi besim se Shk. e Juaj, me prudencën dhe mirësinë që Ju shquan, do të kontribuoni për çdukjen e këtyre keqkuptimeve. Populli Shqiptar, sado që përbëhet prej elementesh të ndryshme nga pikpamja e besimevet, por, mb' anë tjtatër, është i bashkuar dhe me një mendje në çdo çështje që lidhet me interesat e tija kombëtare. Providenza Hyjnore deshi

që Shk. e Juaj, që e doni kaq shumë Shqipërinë, të ndodheni këtu dhe një herë në këto çaste historike që të kontribuoni për plotësimin e aspiratave t'ona patriotike, dyke lidhur kështu, emërin t'Uaj pazgjydhmënisht me historinë e Kombit t'onë.

Ju lutemi, Shkëlqesë, të keni mirësinë të bëheni interpret pranë Madhërisë së Tij Mbretit t'onë Perandor Viktor Emanuel III dhe pranë Shk. së Tij Kryetarit të madh të Qeverisë Mbretnore të Italis Benito Mussolini, të ndjenjavet të devosionit dhe të dashurisë s'onë.

Shkëqesa e Tij Mëkambësi i Përgjithëshëm, dyke u-përgjegjur, çfaqti kënaqësin' e tij të thellë për urimet q' I parashtroi Kryetari fetar i elementit Orthodhoks, të cilin element tha, e njeh mirë dhe e çmon sidomos për ndjenjat e tij patriotike dhe për kontributin që i ka dhënë çështjes s'indipendencës Shqiptare. Shtoi se dëshira e tij e vetëmjja është që t'a shohë Shqipërinë të lumtur e se, për këtë qëllim, do të punojë me gjithë shpirt e me gjithë fuqit' e tija.

Gjatë bisedimevet që u-zhvilluan, Kryepiskopi preku dhe ngjarjet e hidhura të Korçës; theksoi se Korçarët janë përgjithësisht qytetarë të bindur, punëtorë të ndershmë e besnikë dhe u-lut që të kqyret me drejtësi çështja e tyre.

Shkëlqesa e Tij e siguroi Kryepiskopin se, çështja do të kqyret me drejtësin më të plotë.

Si kryepiskopi ashtu edhe Këshilltarët mbetën shumë të prekur nga fjalët fisnike të Shkëlqesës së Tij.

MENDIME T' ARTA

Është një çmënduri të kërkosh të t'a ruajë tjatri të fshehtë, të cilën ti vetë nuk ke mundur t'a ruash, po e ke përhapur me gjuhën t' ende pa fre. Ndodhen e ca njerës që janë si ca arka të sigurta; besimi i të fshehtave në këta njerës, ruajtja e sigurtë e këtyreve dhe përdorimi i mirë i këtyreve në kohën e duhur, tërë këto krijojnë një lloj burimi mirësisje, një lidhje më të lartër e shumë herë dhe një mjet shpëtimi e lirimi.

„Krishti u-ngjall”

Pashka e shenjtë vjen t' i sqojë shpirtit t' onë tërë botën e tij magjike. Ditën e Pashkës të gjitha na thonë diçka. Na psalin alilluia-n më të bukur. Të tëra kanë një karakter kremtonjës, impononjës. Të tëra rilinden në djepin e natyrës së porsa squar.

Cili mund të na e menjanojë madhështin e tyre? Të na vjedhnjë një thesar të till? Të na helmatisnjë një gëzim të till? Mjerimi i jetës? Esht i pafuqishmë. Ligësia e botës? S' është e zonja. Influenca e djallit? Ay është fshehur prej turpit. Pesimisma e jonë? vuajtjet t' ona? As këto. Të tëra i përmbikalon shënjtërimi i ditës. Të tëra i ndrit bukuria e saj e pafishkur. Të tëra i pastron. I shtyn drejt çdo gjëje më fisnike, më të mirë, më të shënjtë që mund t' ekzistojë.

* *
*

Jeta del nga varri. Këcen në freskësin' e sajë më të kulluar. Pse të trembemi? Ç'ka se kish ardhur dimri! Lulet me nënqeshjen e tyre të ëmbël, me erën e tyre hyjnorë, e çpuan përsëri tokën që t' u apin kurajë atyre që janë lodhur, të japin premtimë në të gjithë. Pse të jemi të vrejtur si ipokritër? Do t' a lëshonin vall përmbi ne yjtë dritën e tyre qiellore, po të kishin të drejtë pesimistët? Cili është aqë shpirt-lig, aqë mosmirënjojtës, aq' i ulët, aq' i pazot, që të thotë se i u-rëndua jeta? S' është fjala të jemi të lumtur a fatkeqë, të shëndosh' a të sëmurë, të rinj a pleq,

të pasur a të varfër, por fjala është të kemi dashuri për jetën, besim në të, të jemi gati për të mirën.

Vetëm atëhere do të tregohemi të denjë të vetës s' onë, të denjë të dashurisë që tregoi Perëndia, i cili për njeriun u-bë njeri dhe derdhi gjakun e tij të kulluar sipër kryqit. Vetëm atëhere do t'a ndjejmë gëzimin e Ngjalljes dhe mallëngjimin që na shkakton përshëndetja: "Krishti u-ngjall,,.

* * *

Krishti u ngjall. Esht përshëndetja m' e bukur që mund t' i drejtojë njeri tjatrit. Esht trumbëtimi më entusiast i jetës. Atyreve që kemi në shtëpi, të sëmurëvet, le t' u themi: Krishti u-ngjall. Atyreve që na duan dhe atyre që na urrejnë le t' u themi: Krishti u-ngjall. Krishti u-ngjall le t' u themi dhe të vdekurvet t' anë. Më në fund "Krishti u-ngjall,, le t' i thotë gjithëcili prej nesh vetes së tij, dhe të gjithë së bashku le të psalim: «*Krishti u-ngjall*».

B.

MENDIME T' ARTA

Mjeku gjykon mbi gjëndjen, në të cilën ndodhet zemra e njeriut nga të rrahurat e saja, dhe jo nga fjalët që thotë goja e tij. Pikërisht ashtu edhe mirënjajtja e njeriut kundrejt mirëbërësve të tij — e sidomos ndaj mirëbërësit më të madh, Krishtit — gjykohet më tepër nga sjellja e tij dhe nga mënyra e jetës; dhe jo nga fjalët shprestarije që thotë orë e çast.

* * *

Shprestarija e vërtetë ka si shenja dallonjëse përlësinë dhe dinjitetin; kurse trimërija e vërtetë dallohet me anën e modestisë dhe të rëndësisë.

* * *

Nga tërë njohënit' e kësajë bote më e vështirë është kjo: t' a njohësh vehtën t' ende, thoshte fillozofi i vjetër Thales Milesiani.

Nga pësimet e Shpëtimtarit

„Ka besim ne Perëndia...!”

Dyke heshtur e pa nxjerë zë nga goja, po dëgjon i pamëkatëshmi të thirurat e të sharat e turmës së tërbuar. I dëgjon këto me kokë të ulur, po me një qetësi shpirtërore të patreguar, me atë qetësi që shkaktonte besimin, se vuan e pëson për hirin e së mirës, për triumfin e së vërtetës. Po të thëriste dhe ay vetë, do të përziheshin zërat e tij me britmat e gojëprishurve dhe kështu ndofta fjalët e liga nuk do t'arinin në veshët e Tij aqë të kthjellta dhe aqë të qarta. Po heshtja e Tij e fellë i a le sheshin e lirë britmës së çmëndur të ndjekësve të Tij. As gjë pra nuk dëgjohej, po vetëm sharjet e tyre, talljet e tyre, ironit e tyre, fjalët e tyre plot me helm e me ligësi. Sikundër gozhdët i a mbushnë duart e këmbët me plagë plot me gjak, me qelb e me dhëmbje, ashtu edhe të sharat e talljet e tyre i a plagosnin zembrën dhe i a gjakosnin në mes të dhëmbjeve trupore. Nuk arrinë këto të shara vetëm në veshët si një tingull i tmerëshëm që të shurdhon e të shkatëron nervat. Jo. Kuptimi i tyre hyn fellë në shpirt, e habit mëndjen dhe i plagos zemrën dyke derdhur helm të hidhur e të rëndë jashtëzakonisht

Po me gjithë këtë bota e brendëshme e të Drejtit është pushtuar çuditërisht me një hir të pa treguar të qetësisë qiellore. Ka dhëmbje të mëdha në trup. Gjaku e mbulon an' e mbanë. I ndjen këto dhëmbje që sjell kryqëzimi. Oh! sa dhëmbje e madhe! Po edhe shpirti pëson dhe vuan; dhe pëson jo aqë pse plagoset nga të sharat e të liqvet, sa pse i vjen keq për këta që kanë arritur në një shkallë ligësije e çnjerëzimi aq të pakufishmë!.....

* * *

E ç' nuk i thanë o Zot! Të shara të dobëta, të tallura plot me helm e me ironi, sarkazme të hidhura Kërkuan si e si t' a poshtërojnë më tepër, si t' a plagosin më shumë, si t' a hidhërojnë më fellë. I dëgjon tërë këto Dëshmori me heshtje, po jo dhe me apathi; i dëgjon me durim, po jo dhe pa dhëmbje fare. I dëgjon me dhëmbje, i dëgjon me vuajtje. Po mjerë! Nuk mjaftohen të liqt me këto që thonë. Kërkojnë një diçka tjetër që t' a plagosin më shumë. E gjejnë këtë diçka dhe i a thonë: «*Ka patur besim ne Perëndia; le ta shpëtojë pra tashi, në se me të vërtet e do. Se ka thënë q' është Bir' i Perëndisë*» (Matthe XXVII, 43).

Kjo ishte me të vërtet e fortë; kjo e plagosi pa dyshim më tepër se çdo tjetër. Kaloi një jetë të tërë në mes të një atmosfere q' ishte plot me dashurin e Atit të Tij. Do t' ishte për Atë një mijë herë më mirë, sikur t' a çkëputnin nga atmosfera e kështu t' i a këputnin jetën, se sa t' a largonin nga horizontet e dashurisë hyjnore. Shpirti i Tij ishte zhytur i tërë brenda në këtë atmosferë dhe era e kësaj e ngjallte më shumë se sa era e atmosferës lëndore q' i mbush dhe q' i lëviz mushkëritë.

Ishte me të vërtet i shtënë me mish e me shpirt pas Atit të Tij. E deshte aq sa asnjë tjetër njeri në botë, aq sa as tërë njerëzit bashkë nuk e kanë dashur; dhe besimi se edhe Ati e deshte, i a sillte tërë lumtërin e jetës në këtë botë. Ky besim përhapte në tërë botën e Tij të brendëshme një qetësi qiellore të jashtë-zakonëshme, një qetësi që shtrihej dhe në fytyrën e Tij madhështore.

T' i thonë pra se Ati nuk të do! T' a çkëputin nga dashurija Atnore! Të mundohen t' i shuajnë të vetmen shpresë të Tij! Të përpiqen t' i tronditin mbështetjen e Tij të vetme! Ah! Kjo është një hidhërim i madh për Atë, një hidhërim që s' durohet dot. «Kishe shpresë ne Perëndia i thoshnin. E quanje At; flisnje n' emër të Tij; paraqiteshe në sy të botës si përfaqësonjës i fuqisë së Tij dhe i dhuratave të Tij. Po ja pra që nuk të do; ja ku të la dhe hoqi dorë nga ty. Je pra tashi i lënë jo vetëm nga njerëzit, po edhe nga Perëndia. Në se të

do, pse nuk të shpëton? E në se të njeh si bir të Tij, pse nuk ndërhyt që të të lirojë nga vuajtjet?» Ja pra se ç' i thonë.

Në jetën e Tij nuk pati asnjë frikë tjetër, përveç se këtë: Se mos ndahej, qoftë dhe për një çast, nga i Ati. As gjë nuk e trembi: as të braktisurit e Tij prej miqvet, as trathëtija e nxënësit, as dënimi i pa drejtë, as vdekja e turpëshme, as dhëmbjet e forta të kryqit, as tërë ato q' i a bënë kupën të hidhur. Një mendim vetëm e hidhëronte: frika se mos gjatë martirizimit ngjiste ndonjë send që t' a hidhëronte Atin e të prekte, qoftë dhe pak, dashurin' e Tij. Kjo ishte e vetmja frikë e Tij. Po njerëzit zemër-gurë dhe pa mëshirë fare, u munduan t' i a kallin këtë frikë; në çastet e agonisë së fundit, kur vdekja po e rethonte nga të gjithë anët, në vënd që t' a forcojnë e t' a ngushëllojnë, çpikin gënjeshtren e turpëshme, se Ati e braktisi dhe e la, se Ati nuk e do dhe nuk e njeh si Bir të Tij.

* * *

Me të vërtet. Gjuha e njeriut bëhet nga ndonjë herë shumë më helmönjëse, se sa gjuha dhe dhëmbët e gjarpërit. Kthehet nga ndonjë herë në thikë të mprehtë, në armë që plagos rëndë, në shigjetë që hyn thellë në shpirtin t' onë. Dhe cila gjuhë? Gjuha e njeriut! Gjuha e atij q' është fytyrë e Perëndisë! Gjuha e atij që e vuri Zoti si mbret midis krijesave dhe si stoli të paçmuarshme të botës!

Mjerë! Njeriu, kur del nga rruga e drejtë, sa keq i përdor arsyen e tij, mëndjen e tij, pasurin e kuptimeve të tij? Nga tërë krijesat e gjalla që ndodhen në tokën tonë vetëm zëri i njeriut ka fuqinë që t' i a paraqitë tjetrit mendimet e tij më të thella. Është një venom (privilegj) kjo. Është një dhuratë e veçantë q' i dha Zoti njeriut. Është një cilësi kjo e jashtëzakonëshme q' e çquan njerinë. Kur këtë cilësi madhështore e përdor njeriu për të mirë, atëherë cila oratori mund të çfaqë, si duhet, punët e bekuara që sjell dhe lumtërin e pa treguar? Po kur e përdor keq, atëherë nxjer helmin e vërtete, një helm që t' a plagos aqë fellë shpirtin, sa që as thika më e mprehtë nuk mund t' a bëjë këtë të keqe.

Këtë pikërisht bëjnë tashi ata q' e shajnë Krishtin e që

tallen me Atë. E përdorin për keq dhuratën e bukur me të cilën na pajosi Zoti dhe me anën e së cilës qëndrojmë lartër, shumë lartër. E përdorim si bisha t' egra, si njerës pa pikë turpi, pa pikë mirënjotjeje. Po! Kurrë ndonjë herë gjuhë njeriu nuk foli aq keq, sa tashi gjuha e kryqëzonjësve. Gjithashtu edhe kurrë mosmirënjotja e mallkuar nuk pushtoj e nuk mbyti aq fellë gojën e njeriut aq sa tashi atë të ndjekësve gojëprishur.

O ju, që talleni me viktimën t' uaj me aq shumë zemërligësi! Sa ju ka verbuar mëkati dhe ligësija! E dini ju se cili është Ay q' e përqeshni dhe e shani? Është fjala e ameshuar e Perëndisë. Është ay q' ju pajosi me dhuratën e paçmuarshme të fjalës e t' arësyes, është Ay q' ju dha një pjesë nga diturija e Tij e madhe, me qëllim që t' ju lartësojë dhe t' ju bëjë fytyra të Tij të gjalla. E pra, o të mjerë, këtë pasuri ju tashi po e përdorni që t' a shani mirëbërësin e madh e t' i a plagosni zemrën?

* * *

O Zot! Të rethojnë dhëmbjet e vdekjes. Vuajtjet, që shkakton kryqi, po shtohen e po bëhen më të forta. Shumëzohen edhe shigjetat helmonjëse që hedhin kundër zemrës T' ende gjuhët e kryqëzonjësve. Sundonjësi i botës mëkatore bën kundër Teje sulme të tërbuara e një pas një me qëllim që të të tronditë. Po Ti e the me gojën T' ende. «Vjen kryetari i kësaj bote, po kundër meje s' ka asnjë fuqi». (Joan XIV, 30).

Me të vërtet! Nuk shihni? të gjithë thëresin e bërtasin si të tërbuar e si të çmëndur. Po Jisui qëndron i pa tundur dhe i qetë. I flet për punën e parajsës kusarit që u kryqëzua bashkë me Atë, kusarit q' e tërhoqi dhe habiti me fytyrën e Tij qiellore dhe me ëmbëlsirën e buzëvet të Tij. Shtje syt e Tij plot me respekt e me dashuri në nënën e Tij të dashur e, sikur të mos i ngjiste asgjë e keqe, kujdesohet që të mos mbetet kjo pa mbrojtës e pa përkrahës në jetën e saj!

O! ç' qetësi qiellore e pa treguar! O! sa e pa kufishme është paqja që ka pushtuar shpirtin e Tij në mes të dhëmbjeve e hidhërimeve trupore! Pa dyshim kryetari i kësaj bote, u vërsul me fuqi e me tërbim kundër Jisuit. Po ja ku s'paska asnjë fuqi mbi Dëshmorin e madh.

Adapt. prej Shpresëtarit.

Muzika në Kishat Orthodhokse

Gjithmonë na jepet rasti që të dëgjojmë për çdo të djetë dhe të kremte, muzikën bizantine psaltike të Kishës Orthodhokse, jo vetë t' onën, por dhe të kombevet që jetojnë në gjirin e kësaj Kishëje. Gjith' ashtu, kemi patur rast, që të dëgjojmë këngët dhe hymnet fetare të ekzekutuara me ndjenja të plota armonike dhe me një përsosmëni devosioni religjios, prej koresh, — që vjete me radhë i dëgjojmë dhe në disa Kishëra t' Atdheut —, melodi psaltike më një anë si dhe melodi fetare, më tjetër anë të kompozuara prej autorësh kompetentë, mbi tekste të ritit liturgjik. Kënga psaltike si dhe ajo korale religjioze ndër në, nuk është e pa njohtur; se sikurse thash në parë, kemi patur mundësi që t' a dëgjojmë kurdoherë. Por që t' i pëgjigjem ftesës që pati mirësinë të më bëjë Drejtoria e revistës «Jeta Kristjane» e pashë t' arësyeshme se duhet të thuhet — për herën e parë në këtë revistë — disa fjalë mbi «*Muzikën në Kishat Orthodhokse*» si dhe veçanërisht mbi zhvillimin e muzikës Kishëtare, psaltike dhe korale.

Muzika bizantine, nuk është shpërngulur kurrë prej ritit religjios Orthodhoks. Ajo ka shoqëruar pa ndërprerje, gjatë shekujsh, lutësin, në të gjitha ceremonitë fetare. Kurrë ndonji herë, në Kishën t' onë nuk ka eksistuar muzikë instrumentale, por, vetëm muzikë omofone psaltike dhe masandaj muzikë polifonike korale.

Kjo muzikë është e një tradite shumë të vjetër dhe vjen, pa dyshim nga Bizanti. Në Bizant sigurisht duket se kish ardhur prej të tjera vise, por vetëm aty, në kryeqytetin e imperatorisë Bizantine, ajo mori formën definitive, atë që e ruajti shekuj të tërë.

Muzika psaltike, shpesh herë ka qënë konsideruar si e pa pëlqyeshme, prej të huajve që e kanë dëgjuar; por kjo, nuk mund të jetë tjetër gjë, vetëm se një shije e thjeshtë, e cila në mënyrë krejt natyrale është e ndryshuarshme që në person në person, me fjalë të tjera, këtu është çeshtje gustoje. Ndëgjuësi i saj, po të mos ketë një përgatitje sado të thjeshtë për kupti-

min e plotë të vijave melodike të kësaj muzike, ajo mund të duket e çuditshme në fillim, bilé dhe e paduruarshme nga ndonjë herë; por, në se e dëgjojmë në një Kishë katundi, — dhe janë këngëtorë psaltër katundesh shumë më të preferuar se psaltët e Kathedraleve, sepse të parët, venë në melodin e këngës së tyre, një singeritet dhe një theshtësi shpirti, të cilat kalojnë shumë produktet influencuese të oksidentalizmave, sikurse dëgjojmë nga ndonjë herë, në Kishërat t'ona Kathedrale, ku ndonjë psalt lirik ose dramatik, na transformon melodinë e thjeshtë bizantine, dyke e denatruar në një mënyrë të kënduari, q'ay i thotë *moderne* —. At-herë nuk na shqetëson ajo që dëgjojmë, por mungesa e mos përgatitjes dhe e mos dijenis, për të dëgjuar një gjë së s' kemi qënë të mësuar t' a dëgjojmë.

Kjo muzikë, në Ballkan shumë herë ka pësuar transformime të mëdha, të cilat vetëm Historianët i njohin, mbasi në këtë gadishull historia e muzikës religjioze, nuk ka qënë e shkrojtur kurrë ndonjë herë, kështu që me këtë mënyrë të njiheshin ose të diheshin disa shënime të përgjithëshme mbi këto transformime të ndjehëshme dhe besoj bilé, se dhe muzika e orientit Orthodhoks ka patur po atë fat.

Është shumë e sigurtë se në Konstantinopol, kanë qënë shkolla të muzikës Kishëtare, si dhe në rrethin e qëndrave të mëdha patriarhale. Kështu, ishin në Aleksandri, në Antiohi, në Ierusalim; por sidomos në Konstantinopol, ka qënë një shkollë e cila do t'a meritonte një krye në histori, sadò të shkurtër, mbi zhvillimin e programit analitik të saj, si dhe mbi përhapjen e saj dhe ndër shtete të tjerë, kur filloj që dorëshkrimet muzikale të mos mbeten më nëpër dollapët e autorëve të tyre, por u botohen në volume të mëdha, mbasi u-provua se muzika bizantine ishte, është dhe do të mbetet krahu më i fuqishëm dh më i vërtetë, por për të mbajtur të gjall dhe gjithmonë lart, flaurin e ndjenjave fetare të Kishës Kristiane Orthodhokse.

Prof. KONSTANTIN TRAKO

KRISHTI U-NGJALL

Nëntëmbëdhjet shekuj, i dashur këndonjës, trumbetojnë shkëlqimisht ngjarjen e madhe dhe botëshpëtonjëse. Gjatë nëntëmbëdhjet shekujve me radhë, them predikohet në të gjitha anët e botës, ngjarja çuditëse dhe ekselente, sikurse ëshië ngjallja e Shpëtimtarit. Krishti u ngjall; është hymni gazmor që e psalin me ngazëllim, mijra dhe miliona besnikësh. Varri, nuk ish e mundur që t' a mbante për më shumë Kryetarin e jetës. Ferri nuk ish i zoti për t' a penguar Zotin e plotpushtetshëm, që theu prangat e sundimit të vdekjes. Dhe Iisuj, Mësonjësi i ëmbël prej Nazaretit, u-ngjall në krye të tre ditëve, simbas shkronjave. U-ngjall që të provojë të vërtetën e qënies së Tij të perëndishme. U-ngjall që të vulosij veprën e Tij shpëtimtare për njerëzit.

Dhe sido që Ngallja e Zotit është një ngarje e mbi-naty-rëshme që e tej-kalon fuqinë t' onë mendore, dhe si e atillë është më tepër objekt besimi, se objekt eksperimenti, prap se prap, një studim i rrethanave dhe i kushteve me anën e të cilëve u-shkak-tua, dhe më tepër, një analizim dhe një përshkrim i vërtetë i gjëndjes psikologjike të Apostujve përpara dhe pas Ngjalljes, na detyron të pranojmë qënien dhe formimin e një provës llogjike dhe historike, aq të shëndoshë dhe të fortë, sa që të mos mbetet më as një dyshim mbi të vërtetën e Ngjalljes, për ata njerëzit që nuk kanë një princip dhe si piknisje studimi dhe vëzhgimi, preokupacionin. Nuk është e çuditëshme, që u çfaqën njerës armiq të së vërtetës dhe mbrojtës të mosbesimit, të cilët dëshiruan të dyshojnë mbi realitetin e Ngjalljes. Dhe piksepari Krye-priftret dhe shkonjesit e Izrailit, ata që s'lanë pa përdorur asnjë mënyrë poshtërsie dhe intrige, deri sa që e kryqëzuan në majën e Gollgothajt, kur dëgjuan për Ngjalljen e Shpëtimtarit nga goja e ushtarëve që ruanin varrin, u dhanë të holla, kështu që ata, të shitur më, të përhapnin lajmin se gjoja nxënësit e Tij, duke ardhur natën, e vuadhë trupin e Mësonjësit të tyre prej varrit.

Por varrin e siguron një shpellë e madhe, dhe një guardë ushtarësh e ruan rreth e përçark. Si pra shpella u-rukullis? Si një guardë e tërë u-gënjeje, dhe si i vdekuri u-rrëmbye prej varrit? Ishin të zgjuar ushtarët dhe nxënësit mundën që t' a vidh-

nin mpshehurazi? U-transformuan vallë këta të fundit në njerës të pa-dukshëm, a po u-verbuan ushtarët aq, sa që të mos shohin, dhe u-shurdhuan aq, sa që të mos dëgjonin as pak gjemimin e gurit të math q' u-rrukullis? Mund të na përgjigjen Farisenjt e asaj kohe por dhe të tanishmit, dhe të na ndriçojnë mënden t' onë të hutuar e të habitur, përpara këtyre ngjarjeve të aq çuditëshme sa që, qënia e njerës shakton zhdukjen e tjetrës dhe anasjelltas? A po mos flinin ushtarët dhe u-vuadh trupi?

Farisenjt janë krijonjësit e parë, të kësaj prralle. Por flinte pra një guardë e tërë, një guardë aq besnike ne Farisenjtë, të cilës iu dhanë aq rekomandime, aq këshilla dhe aq urdhre, dhe e cila e dinte fare mirë se ç' shërbim u sillte kryetarëve të izrailit, në rast se pas kalimit të trë ditëve, trupi i Krishtit do të gjëndesh në varr, dhe që njëkohësisht nga ana tjetër kish dijeni të plotë se në ç' mëri dhe në ç' ambicje dhe dënim ekspozohet, në rast se, nga pakujdesia e saj, varri do të gjendej i zbrazur?

Ish llogjikisht e mundur, them, që të flinte një guardë e tërë deri në ushtarin e fundit, dhe në një mënyrë të atillë, sa që të bëhet një punë aq e madhe për ç' vulosjen dhe hapjen e varrit dhe rrukullisjen e gurrit, që pasohet natyrisht dhe nevojisht nga një zhurmë aq e madhe, pa u-mundur të zgjohet dhe ta ndjejë askush, një guxim aq të rrezikshëm dhe arrogant? Por dhe cilët ishin ata guximtarët e rrezikshëm dhe të pashembëllt, që do të mirrnin përsipër kryemjen e aq mrekullirave? Nxënësit? Dhe cili prej tyre? Petrua që u-friksua dhe nga pyetjet e vazave akoma, dhe e mohoi Shpëtimtarin, si që e dinë të gjithë, a po nxënësil e tjerë që e lanë në duartë e atyre që arrestuan në kopshtin e Gjetsthimanisë, dhe që qysh atë minut u-zhdukën dhe vendosën që të kthehen përsëri në profesionet e tyre të mëparëshme, të peshkatarëve?

Ata? Ata shpirtre të tmerruar, them, guxuan të rrëmbenin trupin e Iisuit nga varri që ish i mbyllur e i vulosur, dhe që rreth e për qark të cilit s' i pritte gjë tjetër përveç se bajoneta? Ata, patën apriori, mundësinë t' a dinin se do të flinte një guardë e tërë, dhe të cilën nuk do t' a zgjonte nga gjumi, as zhurma e këmbëve, as guri që do të rukullisej, as zelli që e sundonte, as frika që e inspironte, fundi as fati i thjeshtë? Të gjitha këto

hypotheza foshnjarake, jo vetëm që Ungjilli i përgënjeshtrohet, por dhe llogjika e thjeshtë, e bazuar në radhitjen dhe në natyrën e ngjarjeve, i dënon. Nuk u-ngjall Krishti? Po si Apostujt predikuan Ngjalljen e Tij, dhe si Ungjillorët e vërtetuan?

Dhe se mos na thonë se vetëm e digjuan? Por ata na thonë dhe se e panë të ngjallur përpara tyre, dhe e digjuan të flasë, dhe se e panë që hante, dhe se panë e vëzhguan plagët e Tij, të shkaktuara nga gozhdët dhe brinjen e çpuar nga bajoneta. Qe kjo një Optasi ose Ekstazë e shkaktuar, të na lejohet të themi, nga një prirje analoge, a po që një Pseudesthizi? Por prirja e Apostujve që kundra Ngjalljes, dhe prandaj kur u-çfaq për herën e parë përpara tyre, Krishti i Ngjallur, e muarrnë për Fandazmë. Pastaj nënë pushtetin dhe nënë sundimin e një ekstaze, mund të ndodhej një, dy, tre, dhe jo njëkohësisht të gjithë, dhe kaq herë dhe me aq mënyra çfaqjeje. A po Pseudesthizi? Por Pseudesthizi dhe kur e shihnin? Pseudesthizi dhe kur e digjonin? Pseudesthizi dhe kur e vëzhgonin? Pseudesthizi dhe kur u dëftonte duart? Pseudesthizi dhe kur u çfaqte brinjët? Pseudesthizi dhe kur i bekonte? Pseudesthizi dhe kur, pas dyzet ditësh, ngrihej në Qiejt përpara tyre? Por nëse të gjitha janë Pseudesthizi, cilat pra janë ngjarjet e vërteta? Ndofta vetëm foshnjarsia dhe verbësia e të pabesëve. Nëse Krishti s' u-ngjall, atëherë si mund të shpjegohet historia e Kishës së Tij, për të cilën Iisui i ngjallur së vdekurish, përbën gurin e themelit? Si mund të shpjegohen luftimet e Saj, veprat dhe triumfet e Saj? Të paditurit dhe injorantët, për një minutë transformohen në filozofë. Frikakakët në Eronj, sikurse u-treguan të gjithë nxënësit dhe Apostujt e Zotit pas ngjalljes. Ata që u-trembën përpara një vajzës, sikurse Petrua, marrin përsipër një luftë kundra gjithë fuqive të botës së atëhershme, dhe duke kaluar nga njera ndjekje në tjetrën, dhe nga i pari burgim në të dytin e në të tretin, më në fund e vulosin veprën e tyre apostolike me anën e terrorizimit, me anën e gjakut të tyre. Një predikim mjafton, që të tërheqij mijra. Të sëmurë shërohen, të verbër fitojnë përsëri dritën e paçmuar, filozofë munden dhe i dorëzojnë armët, bajoneta përulen, kriminelë shenjtërohen, gra të çndershme spastrohen; një frymë e re dhe një rilindje kollosale dominon shpirtret. Zemrat dhe buzët psalin Ngjalljen e Iisuit, dhe shpirtret e adoptoj-

në. Dhe me anën e besimit tek i Ngjalluri Zot, ngjallen familje prej kalbësirës, fiton jeta shoqërore, e harritur përpara greminës, popuj dhe kombe, lartësohen dhe jetësohen, më anën e këtij besimi. Të gjitha këto pra, janë pralla? Janë supozime? Janë fjalë të thjeshta? Por këto janë prova llogjikisht të paprekëshme, janë ngjarje universale, janë ngjarje historike, të provuara me anën e historisë së veprave dhe të transformimeve njerëzore. Dëshiron dikush të shohij, dëshiron që të vëzhgojë? Ja përpara tij Kisha e Krishtit, ja përpara tij mbretëria e përjetëshme e Kristianizmit ; provojnë një soj Ngjalljen, sikurse plagët e gozhdëve dhe brinja e Iisuit.

Në rast se nuk shë, në rast se duart e tij nuk gjejnë se ç' të vëzhgojnë e ç' të prekin, që të besojë, gabimi nuk është i Zotit, por i verbërimit të tij të pashëruarshëm. Se kristianizmi nuk është diçka që del në dritë në bazë të zbulimit arqeo-llogjik, nuk është them, diçka që i takon vetëm së kaluarës dhe për të cilin e tashmia është thjesht ftuar që të gjëkojë se ç' ka qënë. Por është një e tashme e vazhduarshme dhe e paprerë, është ngjarja më me rëndësi, ngjarje pan-botënore, e terëjetëshme, e tërëfuqishme. Dhe jo vetëm thjesht si Fe, por dhe si moral, dhe si histori, dhe si fuqi rrezistence, dhe si fuqi domini, rilindjeje dhe jete shkëlqenjese, nuk e ka, nuk mund ta ketë shkakun, shpjegimin dhe qënien, jashtë Ngjalljes së Zotit, nga e cila Ngjallje merr gjithë shkëlqimin, jetën dhe fuqinë. Dhe me qënë se Ngjallja e Zotit, është një realitet llogjik, është dritë dhe jetë, gjithë bota e mënçur, e papreokupuar dhe asnjë-anëshme, bota e civilizuar dhe që respekton njerëzimin e vet, e beson dhe e trumbeton. Dhe kjo e vërtetë e paluftuarshme dhe jetëdhënëse, terheq pranë saj, shpirtret dhe zëmrat, jo vetëm të popullit të thjeshtë, por, edhe më tepër akoma, mendjet më ndritëse dhe shkëlqenjese të shkencës, lëshojnë përpara Kryqit vajtimet e tyre dhe përshëndesin me entuziazmë Iisun' e Ngjallur së vdekurish.

Dhe shkrimtarë të famëshmë, duke vëzhguar e duke ubindur, qëndrojnë me përlësi në gjunjë përpara tij, duke përseritur fjalët e Thomait: «Zoti im dhe Perëndia ime»

Meditime me rastin e pësimevet dhe të Dashkës

Era e çmueshme

Banorët e qytetit të vogël të Vithanisë, i cili gjindet një orë larg Jerusalemit, ishin tronditur në një mënyrë të veçantë. Ajo shka nuk u mendonte, ndodhi këso here.

Llazari, të cilin e kishin vendosur në varrin e gurit, kje ngjallë prej së vdekunit. Në shpin e tij kje një gëzim i math e i pa treguem. Për anë të tryezës rrinte i gëzuem Llazari i ngjallun. Numuri i të thirunve ishte tepër i math. Të gjithë i kishin drejtue sytë kah miku çudibamës—kah Jisui. Prej gojës së Tij dilshin fjalë t' ambla, po ashtu sikurse hyn shiu në tokët e thata.

Udha prej Vithanisë deri në Jerusalem kje mbushë prej shumice të madhe populli. Sejsili dishronte me pa Lllazarin e ngjallun. Dyert e shpisë së Lllazarit rijshin të hapuna. Njertzia vinte palë palë, shikojshin Lllazarin e Jisuin çudibamës e mandej kthejshin për t' u tregue të tjervet se shka kishin pa në Vithani.

—„U-ngjall Lllazari. Në të katërtën ditë mbas vdekjes në thirje të Jisuit Lllazari duel prej varrit. Pamë varrin e zbrazët” i thoshin njani tjetrit tuej kthye prej këtij qyteti të vogël. Filloj t' erret. Për mjes të popullit hyn motra e Lllazarit, Marija e cila erdhi deri te Jisui dhe ra para kambëvet të Tij. Në dorë mbante një enë me erna të çmueshme. Si çili enën, era e mirë tërhoq vërejtjen e të gjithëve; sytë e tyne kjenë drejtue kah Marija e cila lyente kambët e Jisuit, dhe i fshinte me flokët e e gjata të saja. Fytyra e saj shkëlqente prej gëzimit, psc Jisui

dënjonte t' a nderojë tue e lanë që të lyejë kambët e Tija. Porsa filloj t' i vijë dhomës era e mirë, Judha prej Iskariotit, nxansi i Jisuit tha: Pse të shpenzohet kot kjo erë e çmueshme? A nuk do t' ishte kenë ma mirë t' a shitshim e të mershim disa pare të mira për të ja da të vobektëvet? Në dhomë mbretnon një heshtje. Kjo vërejtje e vrazhdë e Judhës trokiti ndër zemrat e ndëgjuesvet. Nji pjesë e madhe e popullit filloj t' a gjykojë veprën e Marisë. Prej vrejttjeve të syve të tyne Marija kuptoj se po e gjykojshin. Dishka i a shtrengoj zembrën dhe i u lidh fjala në fyt. Vuni duert mbi fytyrë dhe tue fsha e qa ra ndër kambë të Jisuit. Trupi i u dridhte prej vajit e flokët e saja të gjata i a mbluenë krahët e shpinën. Në shpirt të vet ndinte një dhimbje të madhe dhe pyeste vet-vedin: përse më gjykojnë? Unë desha vetëm të tregoj një falnderje Jisuit qi pati mirësinë me më ngjallun vëllan prej së vdekunit e ata me gjykojnë? Ndofta edhe Mësuesit çudibamës nuk i pëlqeu kjo pun' e eme. Atëhere ma fort i u çue zembra pesh tue kja me dnesë

Të pamët e syve t' ambël të Jisuit u-ndal në fytyrën e errët të Judhës e pastaj me një dashuni atnore shikoj Marinë. Të gjithë pritshin me padurim se shka do të thonte Jisui.

— Pse zemroheni, tha Jisui, vepra e saj është e shenjtë. Dhe Marija vetë nuk kupton se shka asht tue ba. Me lyemjen e kambëvet të mija tregon ditët e fundit të jetës s' ime. Të vobegët do të jenë përhera me ju, por unë jam për pak kohë. Ata që ishin me Jisunë nuk e kuptuen se shka donte të thonte, por, u-bindën se dishka do të ndollte në jetën e Tij. Fjalët e Jisuit sejcili i shpjegoj mbas mënyrës së tij, por ata q' ishin me zembër të pastër thojshin me vedi: «Nuk do të jetë ky vetëm profit, por Bir' i Perëndisë.»

— Gënjeshtar — ja pritën shkornjësat e farisenjtë.—S' asht e vërtetë. A thue se nuk na bind shikimi i sa smundejve të popullit Israelit, të ngjallunit, e të birit të vejës në Nain, e bijës së Jairit dhe s' mbramit të Llazarit?

— Prap farisenjtë: nuk duhet t' i besojmë.

— Na e besojmë se Jisui prej Nazaretit asht Mesia dhe Bir' i Perëndisë.

— Armiqt e Jisuit: do të shihni shpejtazi se ky Jisu do të jetë i vdekun.

Osana e popullit.

Një shumicë e madhe e popullit zbriti në Jerusalem. Prej të gjitha krahinave shprestarët kishin ardhun për të kremtue pashkën Izraelite në tempullin e madhueshëm të Sollomonit. Pa pritë e pa kujtue u-hap zani: Ja tek po vjen. Këtë «erdhi», e lajmuen me mija vetësh. Disa prej popullit me dega dafine i duelën përpara e fmitë me lule në dorë tuej këndue me zanin engjëllor psalmet e Davidit. Disa prej sish shtrojshin qylymet andej kah kalonte Mesia. Në mes të kësaj shumice njerëzish mbi një pulishte ishte vendosun Jisui. Prej fytyrës së Tij shkëlqente drita hyjnore. Ky popull në jetën e tij nuk kishte pas kurrë gëzim kaq të madh sa kuer erdhi Bir' i Perëndisë në Jerusalem. Prej mija gojësh kje ndigjue fjala përshëndetëse: *«Osana, Osana të Birit të Dhavidhit, i bekuar është Ay qi vjen më emnin e Zotit.»*

Osana mbretit të Izraelit. Të gjithë ishin të gëzuem përposë shkronjësvet dhe farisenjvet, dhe një prej sish u-turr të Jisui dhe i tha: Mësuës, thuej popullit le të heshtin. Ay përgjegji: Me të vërtet po u them, po kje se ata do të heshtin, gurrët do të këndojnë.

Pritja me të cilën populli përshëndette Jisuin i a mbushën sytë me lot, pse prej fjalës Osana shpejt po ay popull do të thrasë: Kryqëzoje, kryqëzoje në dru si kusar. Dhe porsa Jisui i shoquem prej popullit arrijti deri te tempulli, zbriti prej pulishtes por përpara shpis së Perëndisë qindrojshin tregëtarët tuej shitë sende të pa lejueshme për atë vënd të shenjt. Jisui thiri: Kryetarë të popullit t' em, a nuk e dini se shpija e eme asht vend lutjeje jo tregtije?

Fmitë që përcjellshin Jisuin pa pushue këndojsin: Osana të Birit të Davidhit

Por Farisenjtë në zembrat e tyre thoshin:

— A ty të birit të Josifit fmija të këndojnë si të Birit të Perëndisë?

— Po ju, a nuk e dini (do t' u përgjigte Jisui) fjalët e profitve: «se prej gojës së fmijve i ke tregue vedit lavdin» dhe s' mbramit hyni në tempull.

Judha tradhëtari.

Mjaft orë janë qysh se kish prendue dielli mbi Jeruzalem! Qielli i natës i stolisun me hyj të shkëlqyeshëm ndriçon mbi qytetin e Davidhit. Një frymë mistike mbretnon në të katër anët. Në anë të Jerusalemit, simbas zakonit oriental një dhomë e ndritun prej një drite llambe shkëlqen fytyrat e të gjith atyre qi rijshin reth sofrës, bashkë me Mësuesin e tyne. Me gjith se Apostojt e Jisuit ishin për një kohë të gjatë me Të, ende nuk e kishin kuptue Doktrinën Shpëtimtare, por ishin të lidhun shpirtënisht me mbretnin tokësore. U-mblodhën në Jerusalem për të kremtue pashkën Izraelite. Fytyrat e tyne ndritshin prej gëzimi. Por sikur se mbas dritës mbretnon errësina, mbas gëzimit mjerimi, edhe në këtë reth qindronte një shpirt i mbushun me trathëti, e ky kje, Judha Iskarioti. Vetëm ky nuk u-gëzue në shpirt si te tjerët për të Kremten e Pashkës, vetëm ky nuk u-gëzue në shpirt me gjith se kishte afër Jisuin Shpëtimtar.

Ndërgjegja e tij, porsi ajo rufeja qi në një natë t'errët përshkon qiellin prej një ane në tjetrën, po ashtu tërhiqte edhe në shpirt të tij vërejtejen tuej i thanë: tradhëtar pendohu Në zembrën e tij luftonte e mira me të keqen. Ishin disa momente qi në shpirt të tij shkëlqente drita hyjnore qi t' i bijë ndër kambë Jisuit tuej i kërkue ndjesë me tote për për faqe, por këto momente pendimit ishin të ralla, dhe një mejtim djallëzuer i thonte: «Jo . . . kjo nuk i takon Judhës qi të kërkujë ndjesë.» Në këtë mënyrë, mekati dhe argjendashja mbretnoj në shpirtin e këtij tradhëtari. Jisui si Perëndi, të gjithë këtë luftim shpirtnuer e shinte por fytyra hyjnore nuk u-tremb fare për pësime qi u përgatitshin, por me një buzëqeshje fliste me nxansit e Tij. Prandaj i tha mekatarit: «Shka ke ndër mënd për të ba, bane sa ma parë.» Judha u-nis për të krye misionin tradhëtar të tij, por prej gojës së Jisuit kjenë ndigjue vetëm këto fjalë: «O At fali-a se nuk din se shka ban.»

(Vazhdon)

Prof. I. B.

Në vënt të rrëfenjës

Llambadhe gëzimi

Po errej. Nëpër rrugat lëvizja shtohet, si çdo ditë n'atë orë. Mirëpo sonte, dark' e së Shtunës së Madhe, në të gjithë qytetin dhe përmbi çatitë, që errësira, e cila sapo vinte po shtohet, i bënte të mos dallohen njera prej tjetrës, ndjenje diçka si një re — prej fyromës thuhet t' asaj populatë që lëvizte me zhurmë nëpër rrugat e dyqanet.

Liqidhi, i ulur pas portës së xhamit të bar-it, me cigare në gojë, shikonte pa patur mendjen në vënt. I dukej sikur një gjum po i a shuante dal-nga-dal tërë përshtypjet e botës se jashtme brënda në një re mërziçjeje.

Pranë tij, nën një atmosferë të vakët që thithte erën e fundit të modës, burra e gra po bisëdonin. Mendonte të iknjë, se qe merzitur i vetëm, kur — pikërisht në orën e duhur — u-duk një mik.

— Mirë-mbrëma, Kostë. . . .

Liqidhi erdhi pak më vehte. Ftoi mikun të marrë vënt në trapezë, thirri garson-in, nisi diçka të thotë. . .

Ora kalonte. Dhe gjithënjë dukej sikur n' atmosferë derdhej shpresa për një diçka që pritej. Bota që vraponte në shtëpi e ngarkuar me plaçka, njerëzit e bar-it q' iknin grupe-grupe për në shtëpitë e tyre, bile dhe garsonat, tregonin se të gjithë prisnin diçka.

— S' munt të mar vesh, i dashur, se ç' po ngjitet me këtë botë. Përparuam, u-edukuam, u-bëmë më në fund njerës të civilizuar, por darkën e së Shtunës së madhe, do të shkojnë të gjithë po thuhet në kishë për Ngjalljen, si e ndjera gjyshja e tyre...

— Vërtet. Ke të drejtë. . .

— Dhe ca gjëra aqë jasht arësyes... Urdhëro, tha përsëri Liqidhi, dyke ulur zënë dhe dyke vështruar gjoja gjetiu, urdhëro, këta që janë pranë u-ngritnë bile. Sigurisht për në Kishë... S' të thash unë? Ja. . . Caktojnë pikëpjekjen për Kishën e Miropolisë. . .

Tjatri u-çfaq i një mendimi me 'të. Nënqeshi bile në shenjë talljeje për naivitetin e njerësvet.

Vazhduan bisedimin. Koha kish kaluar. Bar-i ishte po thuaj zbrazur krejt. Afrohej ora njëmbëdhjet. Njëpër rrugat levizja që pakësuar. Tek-tuk dukej ndonjë që vraponte dhe ay i nxituar për t' arirë me kohë.

Miku pa orën e vet dhe pastaj, me një lloj frike, i tha Liqidhit:

— Po shkoj dhe unë. Duhet të jem në shtëpi.

— Ja dhe një për në Kishë, tha me vete Liqidhi. Edhe ti i till je!

E përshëndeti pak si i zemëruar dhe, dyke ndrequr fronin për të ndenjtur më rahat:

— Udh' e mbarë — tha. Unë s' tundem që këtej!

Tani s' mbeti klient tjetër në bar. Garsonat s' po e vinin re — diçka përgatitnin në bufë. Porositi dhe një birë, vonuan t' ia sjellin, u-nevrikos, u-ngrit dhe iku.

— Më falni zotni Liqidhi. . . i tha garsoni q' e kish klient të rregulltë dyke vajtur gjer te porta.

* * *

Po tani' ku të shkojmë? Natyrisht jo në kishë. . .

Pa ndjer kish mar rrugën për në shtëpi të tij. Pastaj s' e pa të udhës të ndrorojë drejtim dhe eci përpara.

Arrijti, u-ngjit sipër dhe u-mbyll në dhomën e fjetjes. Ashu siç ishte, i veshur, u-shtri në shtrat me duart nën krye. Ish përhapur në dhomë një er' e ëmbel, një gjë krejt e ndryshme, aqë delikate, sa s' munt t' a kuptonte as vet ç' ishte. Me gjithë këtë i vinte sikur i zgjonte një përshtypje qetësie, q' e ruante në shpirt prej kohe.

Vërtet, e ndjente vehtën shumë më mirë këtu brënda. Llam-

ba e vogël e *veilleuse-s* përhapte një dritë t'ëmbël... Dhe ajo erë e hollë. . . Dhe qetësia. . .

Pa pritúr dëgjohen zëra, të qeshura, zhurmë prej këmbësh të vogla me këpucë të ra që kërcisnin:

— Shpejtë, Tulë. . .

— Vetëm aqë dëgjoi. Me një herë u-kthye më krahë, me një shenjë mërzitjeje dyke mbuluar veshët. Ishte e shoqja e tij me të dy fëmijët në dhomën tjetër. . . Pregatiteshin dhe ato për në kishë. . .

Ndjente aq' antipathi për atë grua! I dukej tepër prapanike, m' atë mirësi që kishte. E trashë or vlla, tepër e trashë.

I duhej një grua pas modës, me sy që të vetëtijnë. Kurse ajo e tij! E shante — dhe ajo e donte! Ia bënte jetën të mërzitëshme që t'a lënte e t'ikte, kish ndarë bile dhe odat e shtëpisë dhe e kish lënë — ka mjaft kohë tani — në fatin e sajë — dhe ajo, fshehurazi që të mos e zemërojë, kujdesej të mos i mungonte asgjë atij.

I vertiteshin në trut një shumicë mendimesh të tillë, si një maqinë q' e vunë me një herë në lëvizje zërat e fëmijvet. Tërë historia e ndarjes së tij nga e shoqja, tër' antipathia që ndjente për' të, i u-paraqitnë përsëri përpara. Sikur ndodhej atje, pranë tij, një vet-vete tjetër — Z. Liqidhi vet me kollaron e tij të ngrirë dhe me karfickën e gravatës — që ligjeronte me flagë dyke përmendur një-nga-një tër' ankimet që kish për gruan e vet. I theshte se ajo ndarje — brënda në po atë shtëpi — ishte një zgjidhje e marrë dhe se duhej t' ikte q' andej e të kërkonte divorc.

Por, sa koha kalonte, rota e makinës thua se e pakësonte furin e sajë. Tani oratori fantastik i bënte tërë levizjet e fjalimit, por zëri s' i ndihej. Orë-orë bile, ndalej krejt. Ahere, boshet e fjalimit i mbushte shumë mirë poterja e fëmijvet në dhomën tjetër. Pregatiteshin plot me qef e gëzim. Dhe vazhdimisht pyesnin t' ëmën.

— Edhe e panë, nëno, Krishtin q' u-ngjall?

— E panë bir i nënës! I u-duk herën e parë Maris Magdalenës, pastaj apostojvet dhe më në fund në më se pesqind veta.

* * *

Kishin orë që kishin shkuar. Liqidhi ri akoma i shtrirë. Po ajo qetësi. Vetëmija dhe hështja. Dhe ajo erë. . . Thua se është era e qetësisë.

Oh! . . . Po si nuk e kuptoi. . . Ishte erë temjami. . .

U-ngrit në këmbë. Ndezi dritën, hodhi një sy në pasqyrë dhe dolli.

Levizje e madhe nëpër rrugat. Grupe-grupe familjet shkonin në kishë. Të tërë mbanin llambadhe të bardha. Ay ishte i vetëm. Po i vinte diçka si turp.

— Në më se pesqind veta. Një grup i tërë. E të gjithë thanë: «po, e pamë».

Pa e kuptuar shkante i hutuar pas të tjerëve. Kështu që pa dashur u-ndoth para Kishës. Jashtë në obor, tribuna ish e rrethuar prej popullit që pret.

Qendroi pak si me një anë, nënë hien e një muri. I mbështjellur në pallto e me duart në xhep.

Ja, dalin. Vjt e qirinjvet shumohen, hapen. Tribuna mbushet me drita e robe ari. N' atë heshtje të natës, zërat e korit ngjiten pa ndalim. Për pakë këndohet ungjilli: «Dhe si u-gdhi e Shtuna, Maria Magdelaena dhe Maria. . . ».

Vë re me kujdes Liqidhi. Zëri dëgjohet i pastër e i fortë, sikur çan heshtjen e shekujvet. . .

. . . Dhe, natyrisht s'kanë qenë vagabonda. S' fituan gjë. Përkundrazi, i hodhën nëpër bishat, i dogjnë, i vranë me gurë, i kryqëzuan. Bile ishin njerës me parime dhe me nder që rallë vihet re. Të thotë njeriu se ishin të lojtur mentsh? Po si? të gjithë të lojtur mentsh, që të pesqind së bashku? Nga sa ay vet kish kënduar, e dinte se ishin njerës me kuptim e të ndriçuar. Pastaj. . . të mos besosh ngjalljen e të thuash se që të pesqind vetat q' e panë Krishtin të gjallë, qenë të gjith të lojtur mentsh, a nuk është një budallallëk? . . .

Pa pritur një ymn gazmor dëgjohet dyke u-pasuar dhe prej besnikëve. Dhe kambanat nisë të binin me nxitim dhe entuziasmë.

Një gëzim fluturonte n' erë. Liqidhi e ndjeu, n' atë hije të murit, t' i trokasë derën e zemrës për t' i a çelur. I dukej bile sikur ndjente dhe një zhurmë të hollë fletësh.

* * *

Yjt e vegjël u-çpërndanë tani. Liqidhi u-ndoth i rrethuar nga ata. Fytyra të gëzuara, të ndritshme. Thua se gëzimi ishte rîpasqyrimi i llambadhës.

Solli nër ment fytyrën e tij, t' errët e të rëndë. Ku ishte llambadha e gëzimit të tij? . . .

Pa pritur ndjeu në vete një këcim. Pa shih! . . . Ja, atje pak më përpara, fëmijt e tij së bashku me të shoqen. Flokët e tyre t'artë, të ndriçuar prej qirinjvet që mbanin në dorë, duke-shin një mrekulli.

Një kryengritje ahere bëhet në shpirtin e tij. Nuk e sundon më vet-veten. Një tjetër zë i tingëllon në zemrë. Esht i ëmbël, i gëzuarshëm ky zë dhe çpërndan një lloj ëmbëlsije. Zgjon ndjenja krejt të ndryshme, të harruara prej kohe. Kujton Liqidhi tani se thith me një lloj kënaqësisje, një ajr që nginj dhe freskon. S' është dot i zoti, nuk don t' a ndalojë ndryshimin që bëhet në veten e tij. E shikon gjithnjë me gëzim — dhe gjithënjë mer fyromë me kënaqësin më të madhe.

Një diçka e shtyn në menyre urdhëronjëse t'ecnjë përpara. Bile, para se t'arrijë t'a mendojë mirë-mirë këtë punë, bën ca hapa me nxitim dhe kalon dorën e vet në krahun e së shoqes

Mbetet gojë-hapur ajo, por me një herë i shtrëngon dorën me dashuri. Nënqeshja dhe syri i sajë lëshojnë aqe dritë, aqe gëzim!

Dhe ecin së bashku, ndërsa fëmijt për rreth atyreve kërcejnë:
— Babai, babai! . . .

N. B.

MENDIME T' ARTA

Pësimet e vuajtjet e njerësvet, edhe atyre që janë të mirë dhe të shenjtë, janë përfundim i mëkatëshmënisë së njeriut. Po me anën e këtyreve ndjek dy qëllime: mbë njanë të zgjojë njerëzit mëkatarë dhe t' i sjellë në rrugën e pendesës, e mb' anë tjetër të shtojë e të zmadhojë vlerën e njerëzve të drejtë e të mirë, t' i lartësojë këta në sfera me të lartëra me anën e durimit, e më në fund sjelljen dhe jetën e këtyreve t' u a paraqitë njerësve të tjerë si shembëll e si model.

Krishti u-ngjall!

Me të vërtet u-ngjall!

Sa bukur tingëllojnë këto fjalë midis dy të Krishterësh ditën e ngjalljes së Shpëtimtarit. Njeri lajmëron, tjetri vërteton fjalët e të parit dhe që të dy mbeten të kënaqur.

Natën, në oborin e Kishës, nën tingëllimin e këmbanave janë mbledhur pleq e të rinj, plaka e të reja dhe fëmijë me shumicë; të gjithë me qirinjtë në dorë, por edhe nuk' i kanë nderur; priftërinjtë edhe janë brenda në Kishë; populli i gjithë pret me agoni të dalën përjashta, të këndojnë e të lajmërojnë ngjalljen e Jisu Krishtit.

Mjedis të gjithëvet një i studiuar kërkon të ç'provtojë ngjalljen e Krishtit; pranë tija qëndron një plak i krusur dhe e dëgjon me vëmëndje, por nuk duron dot kur e dëgjon të thotë: «edhe kjo një prallë është, nuk' është reale». Bah! ja priti plaku, si qënka prallë? Si 1943 vjet e deri tani nuk' e ka bërë njeri prallë, dhe ti tashti dolle i ditur? Por i mësuari nuku u-mbajt dhe j' a priti: «kush mund të m' a provojë që t' a besoj? kush e pa?» — Unë të provoj thotë plaku me kuxim e pa frikë, dhe që tashti po të duash! — Pra të të shohëm! flet i riu me ironi. — Ja mor bir, kjo kuptohet farë lehtë se vehtë ti i pari e provon ngjalljen e Krishtit, dhe pastaj të gjithë sa janë mbledhur këtu. Ti, duke e ndjerë me të vërtet misterin e kësaj ngjarjeje u-ngrite në mes të natës, u-lave, u-veshe me të rejat, rrëmbeve qirinë dhe erdhe në Kishë me zell të math sikurse dhe të gjithë të tjerët. Kur u-ngrite një herë tjetër në mes të natës dhe shkove gjëkund me kaq gëzim se sa sonte? Po të ishte prallë përse nuku rinje në shtëpi? Ti me gojë e thua se do të tregosh mësimin t'ënd me

gjithë që në zëmër e ndjen shumë thellë; kështu dhe unë kur isha i ri flisnja në erë që të tregonja se isha i pa-provuar, pa çka, të gjitha u falen juve të rinjvet dhe në këto e sipër dëgjohen meshataret të dalën në obor dyke kënduar hymnet dhe pas pak këndojnë ngjalljen e Krishtit. I riu që fliste me plakun tashi qëndronte si i turpëruar dhe me buzët e tij pëshpëritte ngadale! VËRTET U-NGJALL!

Sa i kënaqur vallë vate në shtëpi plaku! Por sa i gëzuar ishte dhe ay djali pasi prej një plaku të pa ditur, siç kujtonte ay, mësoj të vërtetën!

Me të vërtet o vëllezër, me të vërtet u-ngjall, sepse këtë na e tregojnë Apostojtë, të cilët e panë vehtë që të gjitha dhe i shkruan me dorën e tyre, na e vërteton koha e gjatë qysh prej ngjalljes së Tija që ay mbetet i pa vdekshëm ndër né; n'a e tregon vehtë ndërgjegjeja e jonë, na thuhet brendësisht, na provohet nga gëzimi që na ndoth n' atë ditë, kur sqohemi nën tingëllimin e kambanave në mesnatë, vishemi me të shpejtë sido që gjumi n' atë orë është i ëmbël dhe vrapojmë për të dëgjuar ngjalljen e Jisu Krishtit dyke kënduar që të gjithë së bashku: *«Krishti u-ngjall së vdekurish, me vdekje vdekjen shkeli edhe të varrosurvet u-fali jetën»*.

Nxënësi.

MENDIME T' ARTA

Njerivrasësi — siç e ka qojtur Zoti djallin — e di mirë se mëkata është helmi i shpirtit, e se rrëfimi është më i miri mjet për t' a nxjerë nga shpirti këtë helm. Për këtë arsye i mban të mbyllura buzët e të krishterit dhe, fshen fellë në zëmër të fshehten e mëkatës, që të sigurojë mirë helmatisimin e shpirtit.

* * *

Eshtë i lumtur ay që ndjen plagën që ndodhet mbrenda në shpirtin e tij dhe i lutet mjekut që t' a shërojë, dyke i thënë si David-i «Shëromë, o Zot, se u-tronditnë eshtrat e mija», «O Zot, mëshiro-më, shëro-më shpirtin, se mëkatova për para Teje».

SHTYLLA PËR RININË

Fryma e kryelartësisë

Në çdo shoqëri ka mjaftë të rinj për të cilët bota thotë në mënyrë të qartë se «e kanë marë përsipër», se «s'janë në të», se «u kanë marë trutë erë»!

Dhe përse vall? Se sheh, që ata të rinj, para se të nisin mirë-mirë ndonjë veprimtari dhe pa ditur ndofta në se do të jenë në gjëndje të bëjnë diçka, çfaqim për vehtën e tyre idera të mëdha dhe pretendime të fryrë pa masë. Kujtojnë se janë të squar dhe të zotë për gjëra të mëdha, se qëndrojnë shumë më lartë nga shokët e moshatarët e tyre, se kanë një edukatë dhe kulturë të thellë, se janë të destinuar të lozin një rol të math në shoqëri. Prandaj ecin me kryet përpjetë, flasin shumë, mburin cilësitë dhe punët e tyre — natyrisht gjithënjë të fryra e fantastike—dhe çdo mos-sukses që kanë në jetë u ngarkojnë të tjerëvet dhe jo pazotësisë së tyre. Në fjalët e tyre, në sjelljet e tyre çfaqin një «erë» një guxim pa kufi, një paturpësi, që, kur e sheh të skuqet fytyra. Para të tjerëvet, të cilët i konsiderojnë si të vegjël, të paditur e budallenj, mbajnë një qëndrim sikur të jenë ata vet të mençëm në këtë botë e jo tjetër njeri. Në bisedimet e tyre s'pranojnë kundërshtime. Gjithënjë duan t' imponojnë pikëpamjen e tyre. Dhe sa u bëhet qefi kur të tjerët pranojnë mendimet e tyre dhe u japin të drejtë! Përkundrazi, ata vet janë kritikonjës dhe qëرتونjës të reptë në të tjerët. Nuk dijnë çdo me thënë zëmër-gjërësi dhe tolerancë, ndonëse për vehtën e tyre nuk durojnë as vërejtjen më të vogël.

Nën këta kushte natyrisht, s'ësh aspak e çuditëshme që ata të rinj pakë nga pakë t'a humbasin çmimin e njerësvet. Sepse shoqëria sheh, peshon dhe gjykon. Dhe në shumë raste çmon dhe klasifikon në mënyrë të saktë e të drejtë. Dhe ja pra

i riu i ynë fodull, që kujtonte se do t' imponohej me anë të fjalëve të mëdha dhe të sjelljes kryelarte, e humbet estimimin e botës. Bëhet antipathik dhe i mërzitëshëm. Miqt e vërtetë e lenë, dhe e rethojnë vetëm ata që kanë ndonjë interes. Edhe jo vetëm që s' çmohet, por lind dhe urrejtjen e tjetrit. Sepse jep shkak për keq-kuptime dhe skandale, dyke krijuar me këtë mënyrë shumë armiq e kundërshtarë, të cilët do të kërkojnë rast të volitëshëm për t' a goditur e për t' a çdukur.

Por s' janë vetëm këto. Përmbi kritikak e ndërësve, që fund' i fundit munt të mos i sjellin ndonjë dëm të pandrequr, është gjykimi i Prerëndisë. Si e gjykon Perëndia kryelartin dhe egoistin, na e thotë shkrimi i shenjt. Dhe meritojnë për t' u-vënë re ato shprehje të rënda me të cilat Shkrimi i Shënjt tregon zëmërimin e Perëndisë — ndonëse është Perëndi dashurije — kundër kryelartit. Sepse e thotë haptazi: «Perëndia u qëndron kundra kryelartëve» (Jak. 4. 6). I konsideron domethënë armiq, kundër të cilëve ka për të marë masa të drejta. Dhe ja Zoti, në paravolin e Kumerqarit e të Fariseut, thekson se fundi i atij që mburret e mban kokën përpjetë, ka për të qenë përujla, përbuzja domethënë dhe çnderimi. «Çdo njeri që e mban vehten lart do të përulet» thotë. Do të çvleftësohet dhe do të humbasë estimimin e botës.

Ky pra është përfundimi i kryelartësisë. Dhe duhet t' a theksojmë që tani, se prej kësaj sëmundjeje vuajnë sidomos ata të rinj që s' kanë lidhje me fenë. Pasi një i ri ose e re që kanë një edukatë të krishtere dhe kujdesohen të bëjnë një jetë të vërtetë, gjejnë në fjalët e Krishtit udhëzimet dhe ndihmën e duhur për të formuar një kuptim të saktë rreth çmimit të vet-vehtës. Mësojnë që «të mos mendoj (njeriu) për vehtën e tij më tepër se sa është e arsyëshme» (Rom 12. 3). Jeta e krishtere ka për fryt virytin e përulesisë që e bën të riun të jetë më tepër serioz e i urtë, më tepër zëmërgjer e krye-ullur, më tepër simpathik e i dashur. Mirëpo atje ku mungon drita e Ungjillit, është e natyrëshme të mbijë e të rritet çdo ligësi. Dhe nga më të parat është sidomos kryelartësija, që në esencë s' është gjë tjetër veç se një budallallëk, a shenj lojtjeje nga terezia mendore.

B.

SHTYLLA E KLERIT

Në këmbët e Shpëtimtarit

(Pas Anton Huonder-it)

c. Mizeria e qytetit — Mirëbërësia

« Edhe si u-ngrys, mbë të perënduarët të diellit, prunë tek ay gjithë të sëmurët e të djallosurit. Edhe tërë qyteti ish mbledhur te dera».

(Mark 1,32-33).

1. Këto përseriten vetëm në jetën e shentorëvet. Fjalimet dhe çudirat e profitit të math kanë shkakëtuar një përshtypje të gjallë. I tërë qyteti, i prekur nga personaliteti i tijë, e kërkon për t' a parë. Tërë vendet bosh para shtëpisë janë plot me njerëz, bile disa janë ngjitur mbi muret e çatitë. Gjithsejçili përpiqet të jetë sa më afër Atij. Para shtëpisë dergjen të sëmurët mbi tezgje dhe në krahët e atyneve q' i sjellin. Ka gjith-far-soj të sëmurësh, sakatë, ulogë, të verbër, me plaga, të sëmurë prej ethesh, prej mushkërinjsh e. t. j; çdo sëmundje e dobësi përfaqësohej atje. Fytyra të zverdhura, sy të shuar, pamje të dobëta; ishte një spital i vërtetë, një ekspozitë e tmerëshme të mizerjes së qytetevet me tërë pamjet e sajë.

Pikërisht si një motër, shkonte Shpëtimtari plot me mëshirë ndër ata «duke vënë duart mbi gjithsejçilin» (Lluka 4,40) që t' ju tregojë se Ay nuk trembet prej asnjë vuajtjeje dhe se fuqia shpëtimtare buron prej Atij personalisht.

2. Sa shpesh përeriten këto skena prekëse në spitalet, në fushat ushtarake, në vendet e përqendrimit të të kromosurve! Kudo çfaqet Krishti, me anë të perfaqësosjesvet të tijë. Shikimi drejt Shpëtimtarit u jep motravit aqe dashuri, aqe frymë sakrifice dhe meshtarëvet t'altarit aqe kurajë, që të vizitojnë të sëmuret që vuajnë prej sëmundjesh ngjithëse për të kryer misionin e tyre si ngushëllonjës dhe shpëtimtarë të shpirtëvet.

d. «Të tërë të kërkojnë», — Fuqija e personalitetit priftëror

(Marku 1,37)

1. Shpëtimtari qe bërë tepër popullor në qytetin e tij; të tërë e ndejnë veten të lidhur pas atij si prej një fuqije magnetike. Ky është efekti i paraqitjes së tij të butë e të denjë; i shikimit, i zërit, i gjesteve të tij, të cilët, ndonëse janë të thjeshtë, kanë me vehte diçka madhështore, i fuqis së Tij çudi-bërëse, q' i jep personalitetit të Tij karakterin përmbi-natyror. Një i till prift bën edhe sot po atë përshtypje në popull dhe tërheq admirimin, respektin dhe dashurinë.

2. «Të tërë të kërkojnë». Ç' fjalë të bukura! Sa gjë e lartë do t' ishte sikur këto të thuheshin dhe për ty uratë, që edhe nër qytetet t' anë të kalojë Shpëtimtari me anë të përfaqësosjesvet të tij të denjë dhe të tërheqë me anë të bukuris së tyre shpirtërore popullin nër tã. Ky popull i mjer' i gënjyer shkon pas «Shpëtimtarëve» dhe «Mësonjësve» të tjerë dhe nër' ta var tërë shpresat e tij. Faji i kësaj dekadence në disa vende a nuk i ngarkohet dhe klerit i cili nuk din t' udhëheqë grigjen e t' afrojë te Kisha? Munt të vihet re shumë lehtë një ndryshim në jetën e qytetarëvet po të vijë një misionar, një njeri pas vullnetit të Zotit.

«Të tërë të kërkojnë». Kur predikon, kisha ka për të qen' e plotë, froni i rrëfimjt do të vizitohet me shumicë që në mëngjes herët gjer në mbrëmje vonë, kudo që të shkojë ay, populli e pason dhe mijra sysh do t' a veshetrojnë me kënaqësi dhe mirënjotje.

3. «Edhe e kërkonin atë... dhe e mbanin që të mos ikënte prej atyreve» (Ll. 4. 42).

Vetëm ay munt të përfytyrojë së ç' u-bë atje, që ka parë ndonjë herë entuziasmën e shkaktuar në shpirtet e besnikëve të prej fjalimit të zjartë të ndonjë prifti lajmëtar të vërtetë të lajmit të mirë.

O prift i Krishtit, ç' mision të lartë ke, që t' u tregosh njerësvet të gabuar udhën drejt Shpëtimtarit, i cili ka ecur një herë në këtë tokë dhe në gjurmat e të cilit kanë mbirë kudo lulët e hirit hyjnor dhe të shpëtimit!

e. Lutja mëngjezore e Jisujt — Nevoja e përqendrimit në vet-vehte.

«Edhe ndë mëngjest fort me natë u-ngrit e dolli, edhe vate ndë një vënt të shketë, edhe falej atje» (Mark 1,35)

1 Veprimtaria pastorale në qytetet është bashkuar me rrezikun se mos bariu shpirtëror tërhiqet pas punëve të jashtëme të jetës, të cilat i ngacmojnë nervat si zhurma dhe zëri i një maqine. Kapet atëhere prifti në një rrjetë të mbleksur me mijra kujdesjesh, distraksionësh, detyrimesh konvencionale dhe gjithfar-soj problemash zyrtare. Në kontakt me këtë botë plot zhurmë, në mes të kësaj atmosfere të mbushur me mikrobet e mekatit, duhet të jetojnë disa priftërinj. Dash-pa-dash sheh jetën e çthurrur, dëgjon zërin e sirenës të gënjeshtarëve. Ay vë re anën më të errët të jetës dhe zemra e tij si bari shpirtëror duhet të lëviznjë n' aqë rrëfime, që burojnë nga thellësia e mizeries së mekatevet. Në mes të këtyre përshtypjeve dhe influencave të ndryshme prifti duhet të qendrojë i pastër, i fortë dhe i pa prekur. Po si munt të mbetet në se nuk rron me mëndjen në të përmbinatyreshmet, nëse shpirti i tij nuk është thelluar në lutjen e mbrendëshme, q' e pastron, e forcon dhe e ripërtërit? Këtë shembëll i a dha Shpëtimtari.

2. Mbeti në shtëpi të Petrit gjer natën vonë; me gjith këtë, ditën e dytë «që me natë u-ngrit dhe dolli me një vend të shkretë për t' u falur».

Nga këto shohim, ç' jetë asqetike bënte Shpëtimtari. Binte

vonë dhe ngrihej herët në mëngjes. Ay që ngrihet vonë nuk ka kohë për lutjen e mëngjezit q' e shejtëron, e forcon për punën e përditëshme. Jo prej shtratit, po prej lutjes e thërret Petri Shpëtimtarin që të vijë para gjëndjes e cila e priste.

O uratë, si do të munt të qëndrosh i patundur nëse nuk mbështetesh mbë Perëndinë? Si do të munt t' i shërbesh, po të mos bashkohesh me Atë me anë të lutjes? Si do të munt të jesh organi me anën e të cilit vepron Ay, po të mos shkrihesh me anë të lutjes me Frymën e Tij?

Një pus me shumë burime nuk thahet kurrë. Ay që harxhon ma shumë nga ç' ka mer, jep falimento. Këto fjalë kanë vlerë jo vetëm për jetën e përditëshme, por edhe për jetën shpirtërore. Që të pasurojë prifti jetën e t' u apë e të tjerëvet, duhet të kthehet drejt Shpëtimtarit dhe të kërkoj: «Mëso-na të falemi». *«Edhe Jisuj u-ngrit ndë mëngjest fort me natë e dolli, edhe vate ndë një vënt të shkretë. edhe falej atje».*

MENDIME T' ARTA

E Djela është kriteri me të cilin matet e gjykohet terë java që kaloi. E përdore këtë ditë për adhurimin e kthjellët të Zotit, për pastrimin e shpirtit dhe për prehjejn e trupit? Një përdorim i këtillë tregon se edhe punët e javës janë të bekuara. Po në qoftë se e kë përdorur dyke ndenjuri largë kishës, dyke u-shtënë pas defrimesh e punësh të liga, atëherë nuk është shumë e vështirë që të kuptohet se të këtilla janë dhe veprat e javës që kaloi.

* * *

Sa herë sheh ndonjë njeri që të bjerë në gabime, në vent që t' a qërtosh e t' a kritikosh, do t' ishte më mirë të pyesësh vetën tënde: «Mos jam dhe unë si ky?».

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

REVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Viti i IV-¹⁶

Maj 1943-XXI

Nr. 3

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

LANDA: Vetëm me anë të frikës — Lufta dhe Morali — Psë mejtohemi? — Meditime me rastin e pësimevet dhe të Pashkës — Shtylla e familjes — Nga kryeveprat e Gojartit — Monastiret kryesore të Dhioqezës së Beratit — Kryqit — Jetë, Fë, Moral — I Biri i shtëpisë së David-it — Lajme Kishtare.

Vetëm me anë të frikës

Njeriu qëndron në shkallën më të lartë nga të gjitha krijesat mbi dhe. Mirëpo bie në shkallën e shtazës. Dhe bëhet shpesh herë më i keq dhe se këjo. Kemi gjykim, që shtazëvet u-mungon. Dhe prandaj mundemi të jetojmë në orizonte më të lartë shpirtërorë dyke u-udhëhequr prej idealesh të lartë e qiejllorë, që as shtaza më e zgjuar s' mundet t' i kuptojë e t' i shijojë. Por, po t' a lemë mershën me prirjet e sajë të dobëta të na i zotërojë fuqit t' ona mendore, biem më një herë shumë poshtë. Gjykimi, që na dallon nga shtazët errësohet e nxihet. Dhe, në vënt që të na i çelë ata orizonte më të lartë shpirtërorë brënda të cilëvet çvillohemi dhe arijmë në qënëje shpirtërore, vihet në shërbim të mershës. Dhe zgjuarësija e veçantë, që e kemi për hir të logjikës, përdoret dhe shpenzohet për të gjetur mënyra të ra shijimesh shtazorë dhe barbarizmash e ligësish të dobëta. Kështu, jo vetëm që biem në shkallën e shtazës, por

e kapërxejmë dhe diçka. Dhe s' është aspak zor, të bëhemi nga shtazët më shtazorë dhe nga bishat, më të egër.

Të duket ndofta gjë e çuditëshme këjo. Me gjithë këtë është e vërtetë. Dhe s' ka për të të mbetur asnjë dyshim po të mendosh se kafsha dhe bisha lëvizin brënda kufivet q' u-janë caktuar, pa mundur të bëhen as më të mira, as më të këqija. Tigri, luani, janë sot po ata që kanë qenë para njëmij, dymij, tremij vjetësh. Deri sa domethënë ata gjënden në rrethin e tyre natyral, në natyrën e egër, as bëhen më fisnikë, as bëhen më të liq. Kështu është dhe me shtazët e tjera.

Mirëpo, po të vesh re njeriun-shtazë, do të shohësh se demoralizimi dhe egërsija e tij s' kanë kufi. Sill ndër mënt bagabondat e ndryshmë të qytetevet të Europës, ganksters-ët e qendravit Amerikane, katilat e malevet, typet e ndryshmë të demoralizuarish që të kujtojnë Sodomën e Gomorën, grat e rugave dhe njerëzit e bodrumevet, të hashishit e të alkoolit ... Dhe do të bindesh me një herë se, njeriu, kur del jasht udhës, s' përmbahet më në krimet e demoralizimet, por gjithënjë bie më posht dyke përdorur tërë fuqit e tij mendore, që e dallojnë nga kafshët e nga bishat, për t' a ngritur krimën e demoralizimin në shkallën e artit e të mjeshtërisë, që kafsha dhe bisha s' i dijnë.

Ç' gjë munt t' a përmbajë atë atëhere? Vetëm frika. Këshilla e vërejtje fisnike, argumenta logjike e mësimet të urta, shembëlla prekëse e vepra e sakrificat të mëdha, s' i bëjnë atij asnjë përshtypje. Qa përpara atij. Lut-e sa të duash. Trego interesimin dhe dashurin më të madhe për të. Të gjitha këto s' kanë për t' a prekur aspak, ose dhe nëse për një moment e prekin, këjo s' ka për të vazhduar shumë, se përseri ata instinkte shtazorë do të mposhtin e do çdukin krejt çdo influencë të mirë.

O! po. Eshtë më se psikologjike ajo që i dituri Solomon e tha një herë e përgjithëmon: «Siç është kamxhiku për kalin, e osteni për gomarin, kështu është dhe shkopi për një komb jasht ligjit» (Fjalë të urta 26,3). Duhet shkop. E vetëm shkop. Nëse ka për t' u-bindur i demoralizuar i e ligu, këjo do të bëhet, jo me anë të këshillës, por vetëm me anë të frikës. Si? Do t' a shohim në numurin tjetër.

B.

Lufta dhe Morali

Një nga problemet që na e vë përpara për studim nga pikëpamja e moralit të krishter Orthodhoks lufta e sotçme në të cilën janë përleshur popujt më të mëdhenj të botës dhe n'altarin e së cilës sakrifikohen për ditë mijra qenëjesh njerëzore, është dhe problemi i luftës në vetvete. *Cila është pikëpamja e moralit të krishter Orthodhoks e njëkohësisht dhe i Kishës mbi luftën?* Ja thema e jonë. Por para se të hyjmë drejt-për-së-drejt në' të, e quajmë t' arësyeshme të themi pakë fjalë mbi luftën përgjithësisht, mbi llojet, shkaqet dhe pasojt e sajë.

Lufta është një fakt shoqëror, që përbën mjetin më të tmerrshëm të çdukjes së jetës njerëzore; është një seri brutalitetesh t'egër nërmjet mazavet njerëzore, një olokaust milionash njerëzish, një kasaphane reciproke nërmjet njerëzish bile po t' atij gjaku, po t' atyre zakonevet, po t' atyre shërbimevet, që grihen e vriten që nga një pol në tjetrin, që nga një shtet në tjetrin, nërmjet krahinavet, nërmet fevet, nërmjet shoqatavet dhe, që nga Kaini e këtej, shpesh herë dhe nërmjet antarëvet po t' asaj familjeje.

Lufta s' është e kufizuar vetëm në kohë lufte, por është një plagë e përditëshme. Se për ditë njerëzit grihen e përleshën njeri me tjetrin të paktën shpirtërisht me anë t'urrejtës, të ligësisë, të vesevet të dobëta, të padijës, etj.

1. Përkufizimi dhe llojet e luftës.

Por neve këtu s' na intereson aqë lufta e kqyrrur nga pikëpamja e sajë e përgjithëshme, sa lufta nën kuptimin e zakonëshme të fjalës. Nën këtë kuptim pra lufta është një përpjekje e

përgjakëshme që bëhet ose në gji të një shteti, ose nërmjet dy a më shumë shtetesh. Prej këtij përkufizimi del dhe se kemi dy lloje luftërash: *të brëndëshme* e *të jashtme*.

Në luftërat e brëndëshme nëmërojmë *luftën civile* dhe *kryengritjen*. Me fjalën «luftë civile» nënkuptojmë përpjekjen e përgjakëshme që bën një parti për t' ardhur në fuqi, për të bërë që të triumfojnë interesat e saj përkundrejt interesave dhe pasioneve të partive të tjera kundërshtare, kurse me fjalën «kryengritje» nënkuptojmë një ndryshim rënjësor e të menjëhershëm të një ekuilibri shoqëror që është në virtyt të ligjeve të shkruara ose tradicionale, të njohura e të zbatuara. Shpesh herë fjalës «kryengritje», i japim kuptimin e luftës civile, gjë që s'është e drejtë, pasi karakteristika kryesore e një lufte civile është gjak-derdhja, kurse në kryengritje këjo është një diçka krejt sekondare e aksidentale. Dallojmë pastaj dy lloje kryengritjesh: *kryengritjen shoqërore* me të cilën nënkuptojmë një ndryshim të menjëhershëm të së tërë strukturës shoqërore duke ekuilibruar marrëdhënjet nërmjet individit, familjës, klasës dhe tërësisë së shtetasve; dhe *kryengritjen politike* me të cilën kuptojmë ndryshimin e menjëhershëm të strukturës politike ligjore të një shteti, që nga një kompleks të armonizuar legjislatyresh, në një tjetër kompleks më shumë ose më pak të armonizuar dhe më shumë ose më pak të përshatur se ai i pari në zhvillimin e tij për përparimin shoqëror.

Me fjalën «luft' e jashtme» kuptojmë sulmin me armë, me të drejtë ose të pa drejtë, të një shteti kundër një shteti tjetër dhe mbrojtjen e këtij të fundit për të siguruar të mirat e tij lëndore dhe morale nga të cilat mvaret ekzistenca e vet. Këtej del dhe se lufta e jashtme munt të jetë sulmonjse ose mbrojtëse, e drejtë ose e padrejtë.

2. Shkaqet e luftës.

Jeta e jonë e tërë është një luft' e vazhduarshme. Lufta nënkupton një armik dhe ky armik është e liga, e cila, që kur njeriu i parë ra në faj, na e bën jetën një sforcim të vazhduarshëm. Natyra vet na duket plot me të meta, gjë që na bën t' a kqyrim si një armik dhe na shtyn në përpjekje të përditëshme.

Shpirti i njeriut, nga shkak i fajit shtërgjyshor, bëhet

shumë lehtë rob i vesevet. Kështu që, e liga dhe vesi janë shka-ku kryesor i luftës dhe burim i të gjitha gjak-derdhjeve siç thot dhe një fjal' e urtë romake: «non armis, sed vitiis certatus». Nga e liga lindin luftërat—jo vetëm ato nërmjet shteteve, por edhe ato nërmjet individeve që janë më të shpeshta dhe që përbëjnë thelbin e luftës së vërtetë. Sepse lufta e vërtetë, domethënë përpjekja e përgjakëshme nërmjet popujve, s' është gjë tjetër veçse zgjerimi dhe fuqizimi i luftës së përditëshme e të fshehtë që bëhet nërmjet antarëve po t'atij populli, por e çuar në një tjetër fushë. Që të dyja, si çdo tjetër fatkeqësi, për burim kanë mekatën.

Dihet se njeriu është pajosur me instinktin e ruajtjes dhe të vazhdimit të racës dhe bën çdo gjë për menjanimin e të gjitha pengesave që i dalin përpara. Mirpo, ky instinkt i ruajtjes dhe i vazhdimit të racës, në njeriu i pakultivuar shpirtërisht çpërthen dhe çfaqet në një egoizmë të eksagjeruar. Dhe, atje ku kjo egoizmë zotëron duke thyer kufijt e sajë natyralë, padrejtësija bëhet parim jete dhe lutërat, të brëndeshme qofshin a të jashtme, janë fatale. Se «prima causa justi belli — thotë Hugo Grotius — est injuria mundum facta, quae petit aut corpus rem».

Ka p. sh. shtete të cilët dyke arirë në një gjëndje pasurije dhe fuqije të madhe, tregohen tepër egoistë kundrejt shteteve të tjerë më të vegjël e më të varfër dyke dëshiruar t' i çfrytëzojnë gjer në kockat, gjë që shakëton natyrisht një reaksion që munt të përfundojë në një luftë.

Ka edhe të tjera arsye për munt të shkakëtojnë një gjëndje lufte, si p. sh. prekja e nderit të një shteti, e nderit që është një gjë tepër e çmuar si në jetën individuale, ashtu dhe n'atë të një populli; largimi i afetarizmës dhe vendosja e besës dhe të moralitetit, siç karakterizohen luftërat e Dhjatës të Vjetër përgjithësisht; ambicjoni i disa shteteve, i çfaqur me anë të zhelosisë së konkurrencës mbi disa prerogativa; dëshira për një imperializmë të përgjithëshme; ambicjoni ose interesi personal i disa udhëheqësve shtetnorë, etj.

3. Pasojet e luftës.

Para së gjithash, çdo luftë ka si pasoje të drejt-për-drejtëshme shtypjen e një pjese të njerëzisë. Nga të dy luftonjësit, njeri duhet të fitojë dhe pra të realizojë, të paktën pjesërisht, atë që donte kur hyri në luftë. Natyrisht dhe këtë vetëm formalisht, se në të vërtetë, gjat një lufte, të gjithë pjesëtarët dëmtohen dhe humbasin. Vetëm formalisht munt të flitet për mundës e të mundur, se n'esencë të dy partitë janë aq të këputura, sa që s' munt të dihet se kush mundi e kush u-mund. Popullata civile, si e fshatravet ashtu dhe të qyteteteveve, gjat luftës shtrëngohet pa masë dhe vuan, se ligjet e drejtësija nuk respektohen, siç thot dhe një proverb latin «inter arma silent leges». Veprimtaria në çdo fushë shoqërore ndërpritet. Shkatërime të lloj-llojëshme krijohen. Vlefta e të hollave bie dhe çmimet e sendeveve më kryesore shtohen në menyrë fantastike. Mjafton të marrim parasysh luftën e kaluar, se këjo e tanishmja s' ka mar fund edhe që të caktohen dëmet e sajë, e cila hëngri jo më pakë se njëzet-e-tetë milione njerëzish dhe u-shpenzuan njëmij miliarda frangash franceze pas hesapeveve të Ministrisë Tardieu, që të kuptojmë dëmet çkatërimtare të luftës.

Por nuk duhet të harojmë dhe se, përveç pasojeve të këqija që u-përmendën më lartë, lufta ka dhe të mirat e sajë. Piksëpari lufta është një pastonjësi i shpirtëve njerëzorë, të cilët i mbush me fuqi veprimi. Spastron çdo gjë të ndyrë nga gjiri i popujveve dhe sqon ndërgjegjën e tyre. Nën kushte e rethana të caktuara ajo munt të jetë një sheronjësi i mirë i shumë plagave shoqërore, ose një shkëmb provimi për popujt, që shkund çdo gjë të kalbur. Tërë veprimtaria shoqërore ripërtëritet me baza të ra. Solidariteti nërmjet kombeveve bëhet tani më, një fakt i vërtetë. Egoisma ulet dhe shpirti i njeriut bëhet më i mëshirëshëm. Ndërgjegja fetare sqohet dhe Bibla bëhet shok këshillonjësi dhe ngushëllimtar i njerut.

Në numrin tjetër: lufta dhe Bibla.

D:

THEMË FILOSOFIKE

Psé mejtohemi ?

Newton-i u-habit me ramjen e mollës për dhé. Ky fakt i dha rastin të vrasë mëndjen e të pyesë veten: «psé ra molla? psé bien sendet? psé s' qëndrojn atjë ku ndodhen?» — Njeriu, qi kur se hap sýt për të parën hierë e deri sa i mbyll për jetë, s' bën gjë tjetër, veç të habitet përpara sendeve e faktevet të botës. Foshja, për ç' do gjë qi sheh, pyet: «ça është kjo? psé është? kush e ka bâ?». Secili nesh habitet me yjt në qiell qi lëvizin, me shiun, me borren, me vettimën. Habitemi me jetën, me lindjen, me vdekjen. Universi i gjith është një mirakull për né. Edhe esistenca jonë vetë na habit.

Kjo habi është primitive, instinktive, e pa vetëdijshme. Habitemi por nuk e dijm se habitemi. Vetëm filosofi ka vetëdije të saj. Vetëm ky habitet dhe din qi habitet. Kjo habi është një nevojë metafisike e shpirtit; andaj na dominon shpirtin e mëndjen; mendojm e veprojm si me pasë vetëdijë të qartë të sai. Kjo habi është shkaku i kuriozitetit dhe kurioziteti është shkaku i mejtimit për me njoftë botën, me gjetë të vërtetën, e pra shkaku i shkencës. Kështu biologu është kurioz me dijt çà është jeta, lindja vdekja; astronomi është kurioz me dijtë çà janë yjt, si lëvizin, psë lëvizin; himisti don me dijt çà është landa, prej sé përbâhet dhe kërkon elementet mâ t' imtë të sai; fisikanti studion fenomenet e naturës dhe kërkon me u-gjetë ligjat.

Tashti del vetiu pyetja: psé habitemi? nga vjen kjo habi? ku e ka arsyen? psé s' e pranojm botën për të vërtetë ashtu si

na shfaqet? psé s' i besojm botës ashtu si na paraqitet? — Fakti qi na, në kontaktin e parë me botën sensible, habitemi, provon se shpirti i on qënka i bindun se kjo botë, ashtu si na paraqitet, s' është e vërtetë, s' kuptohet, e për t' a kuptue na duhet të mejtohemi e të gjejm botën e vërtetë qi fshihet prapa botës së dukun. Kjo don të thotë, me fjalë tjera, qi midis mëndjes dhe botës sensible esiston një disakord absolut. Përpara këtij disakordi midis mëndjes dhe botës, na duhet të marrim njenën sosh për të vërtetë, se të dya s' mund të jenë. Psé s' marrim për të vërtetë botën dhe jo mendjen? Kjo mund të thuhet, por jo të mendohet e të bâhet. Se na, dashur pa dashur, jemi robër të disa ligjave logjike, të do parimeve themelore të mëndjes, mas të cilvet i vetmi kriter i së vërtetës është mëndja, dhe ç' do gjë qi s' akordohet me mëndjen është false. Besimi i on në këta parime është primitiv, themeluër, i patrandëshm dhe aq i fort sa, dhe pa pasur vetëdijë të tyne, na mendojm e veprojm mas tynë. Vetiu, pa dashur e pa dijtur tregojm mos-besimin t' on për ç' do gjë qi spajtohet më mendjen. Habia dhe kurioziteti i on instinktiv përpara ç' do sendi e fakti e përpara botës gjithë, studimet e kërkimet e shkencavet për me gjetë të vërtetën, a nuk provojn mos-besimin t' on te bota sensible dhe besimin t' on të plotë te mëndja?

Besimi i shpirtit t'on mbi disakordin midis mëndjes dhe botës është instinktiv, primitiv, i patrandëshm, nevojë metafisike e shpirtit. Esht shtimuli dhe fillimi i dijes. Esht besim e jo dijë; është besim, se është gjykim me motiv të pa njohun (gjykojm kështu ase ashtu, pa dijt psé gjykojm); kur-se dija është gjykim me motiv të njohun (gjykojm kështu ase ashtu, tue dijt psé gjykojm). Për me muejt me e naltsue këtë besim në gradën e dijes, na duhet me i gjetë motivin d. m. th. me gjetë arsyen psé besojm e gjykojm qi kjo botë materiale, a mâ mirë sensible, nuk pajtohet me mëndjen. — Këtë do t' a bajm n' artikullin tjetër.

K. T.

Meditime me rastin e pësimevet dhe të Dashkës

(vazhdim)

Prej Gollgothas

Qe afrue mezi i ditës. Shpëtimtari i botës qindron i mbërthyer mbi dru në mes të dy kusarve, tuej i bartun burnisht dhimbjet, të cilat bashkatdhetarët e Tij po ja përgatitshin. Qie-lli po vrahët dhe dielli i mshehi rrezet e tija, natyra krejt po varfnohet, pse krijuesi i sajë po dhunohet prej dorës së njeriut dhe me mija zanesh thrasin: «Mbërtheje, mbërtheje», por goja e Shpëtimtarit kurgja tjetër nuk thonte përposë fjalë përdëllimi: «faljau o At se nuk dinë se ç' bëjnë». O burrim i pashterun i përdëllimit, o dashtni e mëshirue me po a kurgja tjetër nuk ke për të thanë për anmiqt, vetëm tuej dhanë bekime? Nji erë e freskët fryni andej nga lindja thue se po ndigjoheshin fjalët e hymnografit:

«Populli im ç' të kam bërë apo me se të ngava? të vërbërit e tu i ndrita, leprozet i spastrova, burin q' ish në shtrat e ngrita më këmbë. Populli im ç' të kam bërë dhe si m'i çpagove! Në vënd të manës t' ëmbël, në vënd të ujit uthull, në vënd që të më donit me mberthyet në kryq. Mjaft kaq pra; do të thëres kombet, dhe ata do të më lavdojnë bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjt; dhe un do t' u dhuroj jetën e ameshuar.»

Si kje largue populli prej këtij vëndi të mjeruem për reth Jisuit nuk mbet kurkush tjetër përposë Nanës së Tij, Virgjëreshës Mari, Marisë Magdalenës, Marisë së Kleopës dhe Sallomës e nxansit të Tij, Joan. Zembra e nanës u coptue prej mjerimit kah biri i saj i vetëm po vdiste mbi dru si fajtor. Nji sy të përmallshëm Jisui hodhi mbi nanën e vet tuej i thanë për Joanin: «Grue qe djali i yt», e Joanit për Virgjëreshën: «Qe nana e yte.» «Goja e Jisuit kje mbyllë e si prej së largu tingëllojshin ndër veshët e shprestarëvet fjalë e hymnografit:

«Mos më vajto moj nanë, dyke parë në varr birin që zure në gjë pa atë se do të ngjallen e do të lëvdërohem dhe do

t' i lartësoj në lavdi pa pushuar, si Perëndi, ata që të madhështojnë me besë e me mall.»

Dhe si erdhi ora e nandët prej gojës së Jisuit kjenë ndigjue këto fjalë të mbrame: «Ili, Ili llama savahthani, qi don me thanë: Perëndija ime, Perëndija ime pse hoqe dorë prej meje». Jisuit i ardhi etje dhe në vënd të ujit i kje dhanë uthull përzie me tamth. Edhe një thirje e tij i kje drejtue Zotit: «Shpirtin t' em o At po e ap në duert e Tua».

Goja e Atij që për të gjithë jetën predikoj dashmri edhe për anmiqt, sot kje mbyllë me një dhunë përbuzje prej njerësve mëkatarë, të cilët kërkuen vdekjen e Shpëtimtarit: «*Edhe ja kurtin' e tempullit tek u-ça mbë dy prej së larti gjer poshtë; edhe dheu u tund; edhe gurët plasën; edhe varret u-hapën, edhe shumë trupa shenjtorësh që kishin vdekur u ngjallën; edhe duallnë nga varret pas të ngjallurit t' ati e hynë në qytet të shenjturuar edhe u-duk në më shumë veta.*» Rojtarët qi ruejshin Jisunë e mbërthyem mbi dru si panë çudinat i thanë njani tjetrit: «Me të vërtetë paska qënë Bir' i Perëndisë»;

Shkronjsa e Farisenj; ku jeni mshefë si do t' i hikni zjarrit të përjetshëm? Vrapo o popull, hik e bjer përpara Jisuit dhe kërko, falje për dhunë qi i bane. Dhe përpara se t' a zbrezin prej drurit një prej rojtarve i vue heshtën në një anë të trupit, prej kah duel gjak e ujë (Ungjilli pas Joanit Kr. 19,37). Josifi prej Arimatejet muer trupin e çmueshëm për t' a vendosun në varrin e gurtë që kishte pregatitë për vedi. Bashkë me të ishte dhe Nikodhimi. Dhe kufoma e Jisuit kje bartë prej tyre të përcjellun me hymnin:

Kur zbritë te vdekja Ti o jeta e pavdekur, atëhere ferin e vdiqe me shkëlqimin e hyjnisë; dhe kur ngrite të vdekurit nga fundet e dheut, gjithë fuqitë qiellore të thërisnin: Jetëdhënës Krisht. Perëndija jonë, lavdi më ty.»

Nana e Shpëtimtarit e shoqueme prej disa grave të tjera për së largu shikojshin varrimin e Jisuit. E tash qindron i varrosur i përvdekshmi në mes të të vdekunve. Por frika e madhe qi i kishte hymun Shkronjësve dhe Farisenjve prej fjalëve të thanme prej Jisuit se të tretën ditë do t' u ngjallte prej së vdekurit, shtyni qi të kërkojnë leje prej Pilatit, qi të forcojë varrin, mos të vijë kush me e marrun trupin e Shpëtimtarit. Roja u

kje dhanë; dhe qe: Roja e nderit e mbretit toksuer ruen varrin e Mbretit të mbretënve qi të jenë dishmitarë për ngjalljen e Tij.

Ngjallja e Jisuit.

Errsina e natës mbloj botën marë. Hana plot me dritë të shkëlxyeshme, ambël lëshon rezet e argjanta të sajat mbi qytetin e Davidhit. Edhe pak kohë e në kupën e qiellit do të fillonte agimi me trague shenjat e para të tijat. E gjith natyra ishte në heshtje. Vetëm hyjt e qiellit me dritën e tyne dridhen e shkëlxejnë. Rrojtaret për reth varrit të Jisuit, të kënaqun prej natës aq të bukur të Palestinës, fjalosen heshtas njani me tjetrin, tuej vrojtun se a asht vulozur mirë guri i varrit. Kur ja, në një shenj kohet si prej fundit të tokës po vjen një lëkundje. . . . u ndi një za, a thue se gjith natyra me dnesë po mer frymë, toka u-drodh . . . Një dritë e çuditëshme u shkëput prej qiellit dhe zuni vend mbi varrin e Shpëtimtarit. Rrojtaret të bindun prej kësaj drite hyjnore u trembën dhe ranë për dhe; dhe u frigosën. Engjëlli zbriti prej qiellit dhe porsa u afrue te varri i Jisuit hoq gurin prej këtij varri të shenjtë. (Matthe 27,2) dhe Jisui i shkëlxyem prej dritës së lavdisë u ngjall prej së vdekunish e ferri briti me të fshame: O sa lumni do t' ishte për mue, të mos kishe pranue Atë që lindi Virgjëresha, pse me ardhjen e Tij fuqija ime mbaroj dhe dyert e hekurta të mijat i theu; dhe si Perëndi ngjalli prej së vdekunish të gjith ata shpirten qi ma para i kishe zaptue.

Tani gjith natyra shkëlxente me bukurin e sajë. Legjeonet Engjëllore zëvendësojshin rrojtaret e tokës. Kerubimet dhe Serafimet me krahët e tyne kishin mbulue fytyrën prej dritës hyjnore dhe lavderojshin ngjalljen e Jisuit, e jehonat e tyre qiellore tingëllojshin në gjith natyrën.

Prej lindjes shkëlxen drita e asaj dite të ngjalljes e me rrezet e saja shndriti varin e zbrazët të Jisuit, prej kah kje digjue një za: Nuk asht këtu Jisui u ngjallë Zani i qiellit e i dheut u shndrue në një kushtrim të math dhe e gjith natyra murmuroj me zane engjëllore tuej u ndigjue fjala përshëndetëse: Krishti u Ngjall — Me të vërtetë u Ngjall.

Prof. I. B.

SHTYLLA E FAMILJES

Detyrat e bashkëshortëvet kundrejt njëri tjetrit

II. GRUAJA

21. Luksi i gruas në lidhje me familjen

1.— *Luksi s' i jep asnjë vlerë gruas.* Një nga plagat më të mëdha të jetës së sotme familjare është dhe *luksi*. Munt të themi bile, se shumë prej familjeve sot, s' vuajnë dhe aq për të ngrenë e për të pirë, sa nga mania e luksit dhe të zbukurimit. Ka gra, të cilat janë gati të hanë si mos më keq, por vetëm të kenë të siguruar kapelën dhe fustanin pas modës.

Dhe nëse kapelja e fustani «pas modës» do të duheshin një herë në vit, e keqja s' do t' ishte dhe aq e madhe për familjarin e ngratë, se, fund' i fundit, ay do të shtrengohej të kursente nga tjetër anë dhe do t' a plotësonte dëshirën e së shoqës, sidomos për të shpëtuar nga fjalët dhe nga shamatat. Por mjerisht, gruaja kërkon të ndjeknjë *këmba-këmbës* modën. Dhe moda s' ndërron vetëm një herë në mot, por të paktën katër-pesë herë, kështu që burri është i detyruar tërë vitin pothuaj të dëgjojë fjalët e gruas për robe e kapele, për këpucë e për guna, pas filanit a filanit figurin.

Që këto pretendime të gruas sjellin një çregullim familjar, kemi për t' a parë më poshtë. Hë-për-hë duam të theksoj-

më se ajo grua që kujton se me anë të luksit dhe të modës e lartëson veten dhe i jep një vlerë para botës, e ka fare kot. Luksi dhe moda s' e nderojnë kurrë gruan; përkundrazi e ulin sepse e paraqitin para njerësve t' urtë e të sjellshëm, si fodulle dhe mburavace, dhe njeriu fodull e mburaveç jo vetëm që s'fiton respektin dhe estimimin e njerësvet me mëndje në kokë, por përkundrazi kritikimin dhe përbuzjen. Dhe sidomos kur ajo nuk ka dhe mjetet e nevojëshme për përmbushjet e të gjitha kërkesave të modës, por shtrengohet nga financa dhe nga gjëra të tjera të nevojëshme që t' i bëjë ball modës, atëhere jo vetëm që do të kritikohet, por do të hyjë në gojë të botës dhe do të bëhet lodër, sepse bota i ve re të gjitha dhe i di gjer në hollësit më të vogla. Kështu që, ç'dobi të solli o grua luksi dhe moda, kurse me anë t' atyreve s' bëre tjetër gjë, veçse u-fute në gojë të botës?

Dhe mos është vetëm aqë? Gruaja, e cila jipet kryekëput pas modës, bëhet skllave e sajë, humbet lirin, ditë e natë s' mendon tjetër gjë, por si t'a ketë kapelen a si t'a bëj fustanin, që të mos kritikohet gjoja nga bota se nuk ndjek modën. Dhe kështu len me një anë punët e shtëpisë, len me një anë kujdesjen e fëmijvet, vetëm e vetëm për hir të tualetës.

Nga ana tjetër gruaja është dhe antare familjeje dhe një sjellje e tillë e sajë, sigurisht ka për t' influencuar dhe tërë familjen tjetër, sepse e bija ose i biri, kur sheh një shembëll të till në shtëpi, është e pa-mundur të mos influencohet. Kështu që, dale-nga-dale vjen vetiu dhe prishja e familjes.

2.— *Luksi krijon një gjëndje të vështirë ekonomike.* Një nga pasojat më të sigurta e të pa-evituarshme të luksit dhe të zbukurimit, është vështërsia ekonomike, ndofta dhe falimentimi ekonomik. Dhe, po të mirret parasysh se problemi ekonomik ka një rëndësi të posaçre për familjen, munt të themi se, atogra që, për hir të luksit e të modës, do të jenë shkaktare të një prishjeje të këtillë ekonomike, bëjnë krimin më të math kundër vet familjes së tyre.

Dhe s' është zor që të kuptojmë se luksi dhe ecja pas modës sjell çkatrimin ekonomik. Mjafton të marë njeriu parasysh që stofat e leshta a të mëndafshhta si edhe të gjitha ato sendet e tjera që nevojiten për formimin e tualetës, lypin sidomos në

kohën e sotme, një shumë mjaft të konsideruarshme që rëndon herë pas here arkën e familjes dhe sidomos xhepin e burrit. Kur bile të marrim parasysh se moda s'ndërron vetëm një herë në vit, por «figurin-ët» e saj zëvendësojnë njeri tiëtrin në mënyrë që për çdo herë të paraqitet dhe mod' e re, që edhe këjo pas dy a tre muajsh të ndërrojë përseri, atëhere marrim vesh më mirë se sa ka për t' u rënduar arka e familjes e ç' avari duhet të pësojë «xhepi» i burrit, për të plotësuar kërkesat e gruas!

Dhe nëse burri do t' a ketë atë fuqi dhe guxim moral për t' ia treguar gruas rrezikun që u kërcënohet, të protestojë e, në qoftë nevojë, të mos i japë më asnjë dhekare për gjëra të tilla, e liga mund të kufizohet dhe rreziku i prishjes ekonomike munt të menjanohet. Por të paktë janë ata burra që veprojnë kështu. Shumica ç'bëjnë? Për të shpëtuar nga fjalët e shamatat, i a përmbushin dëshirat gruas së tyre, e cila aqë do, sa të kuptojë domethënë dobësin e karakterit të burrit; pastaj e di vet se ç' bën. Dhe kështu burrat e varfër bien pa dashur viktimë të gravet të tyre, të cilat, të dehurat prej luksit e modës, harrojnë se në ç' kohë ndodhemi, harrojnë se t' ardhurat e shtëpisë duhen të prishen me ekonomin më të madhe për gjerat më të nevojshme e më të domosdoshme të shtëpisë, harrojnë se me këtë sjellje të tyre preगतitin varrin e familjes së tyre.

Luksi dhe moda kanë çkatëruar mirëgjendjen e mjaft familjevet. Prandaj duhet të kemi mendjen. Të kemi mendjen them, që të evitojmë dhe pasoje të tjera, po aqë të hidhura e çkatërimtrare, me të cilat do të meremi në numërin e ardhmë të revistës.

B.

MENDIME T' ARTA

«Është më mirë të fitosh emër të mirë, se sa pasuri të madhe» thotë Shkrimi i Shenjtë. Dhe është një lumtëri e madhe që emrin e mirë munt t' a fitojë çdo i krishterë, kur se pasuria e madhe është vetëm për një pakicë njerëzish.

Nga kyeveprat e Gojartit

1. Edhe të rinjtë edhe pleqtë.

Eshtë nevojë e domosdoshme që të kujdesohemi të njohim vehten t' onë, të mësojmë të metat e veset t' ona, sëmundjet e plagët e shpirtit t' onë. Se vetëm kështu do të mundim të gjejmë e të përdorim mjetet që duhen për të shëruar shpirtin. Eshtë krejt e natyrëshme kjo ; sepse njeriu që nuk di se nga çfar sëmundje vuan, si do të mundë të kërkojë e të gjejë ilaçet që duhen? Jemi mëkatarë shumë. Po, vëlla, e di mirë këtë. Të gjithë, kush shumë, kush pak, jemi për të dënuar nga ana e Perëndisë. Po s' duhet as pak të hidhërohemi jashtë masës e të humbasim shpresën. Se kemi një mjet shpëtimi shumë të mirë e shumë të shpejtë: kemi pendimin që na siguron ndjesën e faljen shpëtimtare. Mjafton të vendosim që t' a përdorim këte mjet.

Do të thuash nofta se je plak dhe se je në pragun e vdekjes. Kujton për këte shkak se për ty nuk është e mundur më të pendohesh e të gjeshë shpëtim? As pak. Të kesh para sysh se gjithënjë ke kohë për t' a përdorur këte mjet shërimi e shpëtimi. Dhe që të bindesh për këte, sill ndërmend kusarin, i cili mbi kryqin kërkoi dhe gjeti shpëtimin. Një kohë e shkurtër, fare e shkurtër, i kishte mbetur; po me gjithë këtë u-kurorëzua prej Krishtit si fitues e si triumfonjës. Pak çaste i mjaftuan që të pendohet e të shpëtojë.

Mos do thuash se je i ri dhe se ke kohë shumë për t' u-
penduar e për të kërkuar shpëtim? Gabohesh shumë, në qoftë se beson se kohën e urdhëron dhe e ke në dorën tënde. Me-

ndohu se ç' thotë Shkrimi i Shenjtë «Dita e Zotit, thotë, vjen si një kusar i natës». E pikërisht për këtë arsye Perëndija nuk na ka treguar ditën e vdekjes, me qëllim që të kujdesohemi ditë e natë për të jetuar si pas porositë të Tij e kështu të jemi gati në çdo çast t' a shohim vdekjen ballë për ballë. Nuk shikon, vëlla, se sa të rinj po rëmbehen prej vdekjes për ditë? Me shumë të drejtë pra një at i shenjtë i këshillon të rinjtë dyke u thënë kështu: «Mos e humb kohën, o djalë, po kthehu sa me parë ne Zoti e në rrugën e Tij; mos e ler punën e pendimit me sot me nesër, se s' është as pak çudi që të vdesësh në këto mendime e sipër.»

2. Kur do të vijë drita

Kur është natë dhe të gjitha mbulohen prej një errësire të fellë, shpesh herë i sheh njeriu sendet krejt ndryshe: shumë herë d. m. th. një litar mund t' a marësh për gjarpër, një mik që t' afrohet, t' a marësh për njëri të lik e të rrezikëshëm, e një potere të vogël t' a quash si një klithme të tmerëshme, që të tmeron e të bën të mos dish se nga t' i a mbash Po kur është ditë dhe çkëlqen drita e saj, atëherë as gjë nga këto nuk mund të ngjasë, po për kundrazi tërë sendet të duken tamam ashtu siç janë me të vërtetë.

Kështu pikërisht ngjet dhe në shpirtin t' onë: kur vjen hiri i shpirtit të Shenjtë dhe me fuqin' e Tij çpërndan e çduk errësirën nga mendja jonë, atëhere lehtë kuptojmë të vërtetën, marim vesh bukur e mirë vlerën e vërtetë të sendeve të ndryshme dhe më në fund ato që na dukeshin më parë të tmerëshme e të rrezikëshme, s'na bëjnë tashi as një përshtypje të keqe, po përkundrazi i përbuzim dhe nuk i përfillim fare. Me të vërtetë: as nga vdekja nuk kemi më frikë, sepse nga feja mësojmë se ajo nuk është vdekje e çdukje e vërtetë, po një gjum' i fellë e një fjetje e hepërherëshme; as n' a frikëson vobekësija, sëmundjet ose çdo gjë tjetër nga ato q' i quajmë zakonisht të liga e të tmerëshme; pse kemi besim të plotë e të pa tundur se po ecim për një jetë më të mirë, për një jetë që nuk di çdo methënë vdekje e prishje e që nuk ka as një vuajtje e fatkeqësi.

3. Puna nuk është ndalim për virtytin.

Apostul Pavlin, ndonse ky shpesh herë ndodhej në puntorin' e-tij, — ku, siç dihet, merej me mjeshtërin' e tendëbërësit — nuk e pengonte as pak puna që të përparojë në rrugën e së mirës dhe t'ushitrojë virtytin. Dhe ti pra, vëlla, mos thuaj se je një mjeshtër i vobekët e se vobekësia dhe puna nuk të lenë që t'arrish no një herë lartësin' e filozofisë së krishtere. Për kundrazi kjo është arësyeja, për të cilën do të mundësh t'arrish më shpejt e më lehtë. Se për të fituar shprestari e virtyt, më tepër do të ndihmojë vobekësia, se sa pasurija, më tepër puna, se sa pa punësija. Pasurija bije nga no një herë bëhet ndalim i madh, si do mos për ata që nuk e kanë mendjen në kokë.

Me të vërtetë: kur dëshiron p. sh. të lësh mbë njanë e t'a largosh prej teje smirën e nakarin; kur ke ndërmend t'a shuash inatin e zemërimin; kur vendos të sjellësh paqe në shpirtin t'ënd të turbulluar, të falësh me shprestari e me përulësi, t'a falësh e t'a ndjesh tjatin për të ligat që të ka bërë, të tregosh butësi, fisnikëri, e dashuri; kur pra dëshiron t'i ushtrosh tërë këto virtyte, çndalin do të sjellë puna dhe vobekësija? Kuptohet vetiu se nuk duhet të paguash të holla, për t'i ushtroar këto virtyte; e vetmja gjë që duhet të tregosh, është vullneti i mirë dhe dëshira e kulluar dhe e pastër.

4. Bashkëpunim midis ndërgjegjes e vullnetit.

Njohjen e virtytit dhe të së mirës na e calli Perëndija vetë dhe, mund të thomi, terë njerëzit, kush më pak, kush me shumë, e dijnë virtytin dhe vlerën e tij. Që t'a ushtrojmë këte dhe të ndreqim vetën t'onë me anën e tij, duhet të kemi vullnet të fortë, se vetëm me ndihmën e kësaj do të mundim pa shumë mundime t'a ushtrojmë virtytin e të bëhemi njerës të mirë, ashtu siç na ka porositur Iisui. Nofta është pak si e errët kjo që po ju thom, e prandaj do të mundohem t'a bëj më të qartë.

Që të mësojmë p. sh. se morali është gjë e mirë, s' kemi

nevojë për fjalë e për mësimë. Se prej natyre e dijmë dhe nuk është nevojë të mundohemi shumë, dyke kërkuar andej e këtej në se urtësija është me të vërtetë e mirë dhe e dobishme. Të gjithë me një zë pranojmë se morali është një virtyt, dhe askush nuk dyshon për këtë. Gjithë kështu të gjithë e quajnë imoralitetin ligësi dhe gjë të keqe; edhe për këtë nuk është nevojë të marim mësimë të veçanta, sepse prej natyre dijmë se sa mëkat i madh dhe sa e tmerëshme ligësi është. E lavdërojmë virtytin, qoftë edhe sikur të mos ushtrojmë sikundër edhe ligësin, e urejmë, edhe në qoftë se e bëjmë këtë shpesh herë. Dhe është kjo një e mirë e madhe që na kalli Zoti; sepse kështu që në fillim ndërgjegja dhe vullneti i ynë familjarizohen me virtytin, kurse përkundrazi me të ligën bëhen armiq e kundërshtarë.

Sikundër pra thashë më sipër, njohja e këtyre dy gjërave, d. m. th. e së mirës dhe e së ligës, ndodhet në ndërgjegjen e tërë njerëzvet dhe nuk kemi nevojë për mësimë të veçanta. Po ndreqja e jone, ndreqja e shpirtit t' onë mvaret në shkallën më të madhe nga vullneti, nga zelli e nga mundimet t' ona. Pse vallë? Sepse po të na i jepte tërë këto Zoti si dhurata natyrore, atëhere do t' ishim njerës pa nonjë vlerë, do t' ishim pa kurora e pa çpërblime; e sikundër kafshët nuk meritojnë nonjë lavdërim ose no një çpërblim për disa të mira që mund të kenë — se i a u dha natyra vetë — kështu dhe neve nuk do të ishim të denjë për as më të voglin lavdërim, mbasi për dhuratat natyrore nuk lavdërohen ata q'i kanë këto, po ay që i a u dha.

Për këtë pra arësye Perëndija nuk u dha njerëzve tërë të mirat si dhurata natyrore. Po mb' anë tjetër nuk e la vullnetin që të ngrerë kjo vetëm tërë rëndësin d. m. th. të marë përsipër ajo edhe njohjen e virtytit edhe punën e zbatimit të tij ose të ndreqjes s' onë, sepse ishte frikë se mos nga lodhja e nga mundimet e linte fare virtytin. E rregulloi pra punën kështu: Ndërgjegja të thotë e të tregojë se çduhet bërë dhe vullneti t' a dëgjojë e të marë përsipër mundimin që kërkon zbatimi i porosirave të ndërgjegjes.

5. Gjithënjë i mirë

Sa herë ndodhemi në kishë dhe dëgjojmë fjalën e Perëndisë, bëhemi më shprestarë dhe dbojmë prej nesh çdo zakon e ves të keq. Është një gjë e mirë kjo, po nuk është e mjaftë: nuk mjafton d. m. th. të bëhemi më të mirë e më të urtë vetëm kur jemi në kishë, po duhet të jemi të këtillë edhe kur dalim jashtë kishës, sepse jashtë na duhet më tepër shprestarija dhe sjellja e mirë. Ata që marrin ujë nga çezma, nuk kujdesohen t' i kenë stomnat plot me ujë vetëm kur ndodhen pranë çezmes, e kur arrijnë në shtëpi t' i derdhnin e t' i zbrazin. Jo. Përkundrazi në shtëpi kujdesohen më shumë t' i venë në vënd të mirë, që të mos përmbysen e t' u shkojë kot mundimi e lodhja. Si këta pra pikërisht duhet të bëjmë dhe neve; kur kthehemi d. m. th. në shtëpi le të mbajmë me kujdes edhe shtrënguar tërë këto të mira që dëgjuam e që fituam në kishë. Me të vërtetë: çdobi do të kini, në se fjalët e mira i ruani vetëm sa kohë jini brenda në kishë, e kur dilni jashtë saj, i hidhni poshtë ato dhe mbeteni të zbratur siç ishit para se të hynit në kishë?

Lojtari i mirë duket jo në kohën e përgatitjes, po në orën e ndeshjes. Kështu dhe ti, vëlla, mos m' a trego shpresëtarinë dhe mirësinë t' ëndë vetëm në kohën që dëgjove fjalën e Zotit, po edhe në kohën e zbatimit të saj në jetën t' ënde jashtë kishës.

6. Dhe përpjekje nga ana juaj

Në qoftë se dhe ju nuk na ndihmoni me përpjekjen t' uaj, atëhere, t' ju thom të vërtetën, këshillat dhe predikimet t' ona do të shkojnë kot e pa ndonjë dobi të madhe. Dhe dini pse? Sepse mjeshtërija jonë d.m.th. puna e predikonjësit nuk është si ajo e mjeshtërve të tjerë. Ay p. sh. që punon arin, punën që bëri sot, do t' a gjejë edhe të nesërmen pikërisht ashtu siç e la ditën tjetër. Gjithashtu edhe piktori, edhe skulptori, edhe skalistiu punën q' e lenë përgjysmë sot, e gjejnë të pa ndryshuar të nesërmen, kur do t' a vazhdojnë punën. Kurse me neve, që predikojmë ën kishë, nuk ngjet kështu, po krejt e kundërta: Nuk ju

gjejmë kurrë ashtu siç ju kemi lënë para pak ditëve; e kjo ngjet natyrisht, sepse neve nuk ndreqim sendet pa shpirtë, po krijesa të pajisura me arësye dhe me shpirt. E kuptuat mirë këte që po ju thom? Predikonjësi i mer besnikët, i ndreq me shumë mundime, i ndryshon nga shpirti, i bën njerës më të mirë e të krishterë më të nxehtë; mirë po këta, me të dalë jashtë kishës rethohen nga kujdesjet e nga kokëçarjet e jetës dhe pa kuptuar fare ndryshohen përsëri e kthehen n' atë gjendje që ishin, para se të fillonim predikimin t'onë. Por në këtë mënyrë, siç kuptohet lehtë, duhet neve të fillojmë përsëri nga A-ja gjë që shkakton shumë mundime e mërzitje si për neve si edhe për ata që na dëgjojnë.

Prandaj pra ju lutem shumë të më ndihmoni dhe ju pak në punën e rëndë që kam marë përsipër; sa mundohem unë këtu në kishë për të ndriçuar e për të ndrequr shpirtin t'uaj, aqë kujdes e përpjekje të tregoni dhe ju për shpëtimin e shpirtërave t'ueja.

Përkth. prej Shprestarit

MENDIME T'ARTA

Është e kotë të thëthihemi dhe të drejtohem në nderimet që mund të n'a bëjnë njerëzit.

Është e kotë të vazhdojmë pas dëshërimevet të trupit, e të kërkojmë diçka të keqe e cila do të n'a shkaktojë dënim shpirtnor.

Është e kotë të gëzojmë një jetë të gjatë pa mejtuar se duhet të jetojmë drejtësisht.

Është e kotë të mejtojmë vetëm për jetëm e këtushme dhe mos parashohim atë që ka për t'a pasuar.

Është e kotë të drejtohem në gjërat që mbarojnë shpejt e mos shpejtojmë drejt gëzimit që nuk mbaron kurrë.

Është shumë mirë që njeriu të tërheqë zëmrën prej dashurisë mbi gjërat e dukëshme dyke e drejtuar në të pa-dukëshmet.

Monastiret kryesore të Dhioqezës së Beratit

I.

1. Monastiret dhe jeta monastike përgjithsisht.

Para se të hyjmë në trajtimin e themës kryesore, e quajmë t'arsyeshme të japim disa shenime mbi jetën monastike përgjithsisht.

Jeta monastike kristiane bazohet mbi moralin e Ungjillit dhe mbështetet mbi temperencë të matur dhe vetemohim, që synon në persosmenin e mundur dhe në dashurin ndaj Perëndin. Kjo jetë shifet që shpejt midis të krishterve që banojnë në qytete e katunde. Por që në kohën e persekutimit të Decius-it shofim, se të këtillë iknin nëpër shkretira e male dhe kështu u-krijua jeta monastike dhe anahoretike.

Shembëllën e parë të anahoretit të krishterë kemi *Pavlin Thebasin* në Egjipt, por kryesisht ati i jetës monastike është *Shën Anton i Math*, (251-356). Kyj rrojti për shumë vjet në një shpellë e në kështjellë dhe midis përpjekjesh të ndryshme zhvilloi të këtillë aktivitetet dhe fitoi të këtillë stimë ndaj sunduesit e popullin, sa që shumë u-vunë, si erimitë e murgër, ndën mbrojtjen e tij dhe stërviteshin në banesa të vetmuara. Shembëllën e Sh. Antonit e ndoqën edhe shumë të tjerë e sidomos nxënsi i tij *Pahomi* (+ 348), në ishullin *Tavennë* të Nilit. Atje u-ngreh monastiri i parë dhe u-organizua jeta anahoretike dhe qinoviake (e përbashkët). Sipas këtij u-ngrehnë edhe monastire të tjera dhe prej Egjiptit, djepit të jetës monastike, këjo u-perhap edhe në vise të tjera të Orientit.

Veprimet e para në favor të jetës monastike u-kurorezuan

me të tillë sukses, sa që shofim, se që prej shekullit të V Etnit e Mbëdhenj të Kishës, duke marrë para sysh dobët e mbedha e lavdroshin jetën monastike, duke e quajtur engjellore dhe apostolike. Monastiret u-bënë strehim jo vetëm i atyre që vuajshin në jetë, por edhe shkolla për klerikë dhe institute për kthimin e paganve në krishterim. Gjith Etnit e përmendur të Kishës punuan për jetën monastike dhe të parimeve fisnike të saj, si dhe për rregullimin e saj, siç deshmojnë emërat e Sh. Vasilit të Math, Sh. Grigor Theologut, Sh. Gjon Gojëartit, Sh. Isidor Pelusiotit, Sh. Nilit etj. Sh. Vasili i Math jo vetëm krijoi monastir, por përpilloi edhe rregullore dhe veprimi i tij u-përkrah me të këtyllë entuziasmë, sa që, njer sa që i gjallë, pa vetehen e tij të pasohet nga 80.000 murgarë. Murgët duke ushtruar lutjet dhe duke ndjekur virtutet e vobegsis, të qashteris e të bindjes bashkë më agjërimitin e përkuljen mirreshin me studime theologjike dhe me leximin e Shkrimeve të Shenjta.

Që kur filloi jeta monastike shembëllën e burravet e ndoqën dhe grat; edhe këtu themelin e parë e vuri Sh. Antoni i Math për motrën e vetë dhe pastaj Pahomi krijoi edhe monastir grash.

Jeta Monastike e Kishës Orthodhokse, me gjith që u-kufizua shumë, që kur u-dukën Arabët, në viset e pushtuara prej tyre dhe me gjithë persekutimet që pësoi Orthodhoksia në kohën e ikonomahis, vazhdoi të jetë gjatë Mesjetës faktori kryesor i veprimt kishtar dhe u-bë strehim i gjithë klasave shoqënore dhe i mbretërve akoma. Më të shumt e monastireve çqubeshin jo vetëm për karakterin independent të murgëve dhe për virtutet monastike të tyre, por edhe sepse këta, me qenë se zotnoishin kulturë e dituri, i benë monastiret qendra të vërteta të letrave e të mjeshterive. Për shak të persekutimeve prej herezive dhe për arsye të tjera filloi të bjerë disi jeta monastike. Prandaj Theodor Studhiti në bazë të kanoneve të Sh. Vasilit të Math hartoi disa rregullime, duke e përcaktuar atë me përpikërisht.

Sa u-zhvillua jeta monastike në mesjetë tregon shumica e Monastireve në Lindjen e Afërme e në viset e ndryshme të Ballkanit, si në Greqi, Shqipëri e gjetkë. Ngjarje me rëndsi për jetën monastike të Lindjes është, se në Mesjetë kryesisht filloi

të vendoset këjo jetë në *Malin Athos* (Mali i Shenjtë — Agjion Oros) dhe të përparojë shumë. Më 924 u-themelua atje Monastiri i parë dhe pas pak të tjera, keshtu që e benë Malin e Shenjtë vatrën e vërtetë dhe qendrën e jetës monastike orthodhokse.

Edhe sot akoma Mali i Shenjtë është qendra e jetës monastike, ku permbahen akoma të njëzet monastiret Mbretnore e stavropigjiake të ndara si më parë në qinoviake e në idhiorrythme dhe qeverisen sipas ligjeve që kanë qënë në fuqi qëmoti.

Edhe pas pushtimit të Konstantinopolit prej turqve (1453) jeta monastike e Orthodhoksis, me gjithë çkatërrimet, vazhdoi të jetë faktori kryesor i veprimtarisë së saj, mbrojtëse nër hidhërimet dhe këshilltare nër nevoja. U-paksua disi numuri i Monastireve, por më të shumtat u-përmbajtën dhe janë akoma dhe disa lulzojnë dhe janë në gjëndjen të përmbushin qellimin e tyre. Tani po të vime në ndarjen e Monastireve do të shofim se këto kanë qënë ndarë:

I. *Sipas seksit*: në monastire të burrave e të grave.

II. Sipas autoritetit nga i cili mvaren: në dhioqezore ose episkopale dhe në patriarkale ose stavropigjiake.

Të parat ishin të mvaruna nga Episkopi i Dhioqezës, të dytat nga Patriku përkatës. Quhen stavropigjiake, sepse kur fillonte ngrehia e tyre ngulej në themele një kryq (stavros) i dërguar prej Patrikut. Patriku kishte të drejtë të ngrehij të këtilla monastire në të gjitha Dhioqezat e klimës së tij. Në këto monastire zihej në gojë emëri jo i Episkopit të Dhioqezës, por i Patrikut, i cili kish edhe mbikqyrjen dhe ushtronte pushtetin disiplinor mbi to, duke dërguar përfaqësues të jashtëzakonshëm. (eksark) Këto i paguajnë Patrikut një taksë në të holla ose në sende. Ishin edhe Monastire Mbretënore të ngrehura prej Perandorve të Byzantit, që përjashtoheshin nga çdo taksë dhe kishin privilegje të tjera. Edhe këto mvarreshin prej Patrikut, i cili emnonte dhe Igumenin.

III. Sipas menyrës së jetesës së murgëve në *qinovia* dhe *idhiorrythme*. Qinovia quhen monastiret në të cilat murgët rojnë në së bashku, duke marrë nga monastiri ato që u-duhen për veshmbathje ose në send ose të holla dhe hanë në tryezë të përbashkët. Pasuri të vërtetë në këto monastire murgët nuk kanë, por t'atë ato që fitojnë venë në dobi të monastirit.

Idhiorrythme janë monastiret ku murgët mund të kenë pasuri të vetë, përgatitin ushqimin në qelit e veta seicili dhe vetëm në të Diel kanë së bashku po n' atë tryezë.

Monastiret nga ana tjetër janë më vetëhe ose të nënurdheruara (metohe). Gjithashtu janë monastire burrash, që nuk lejojnë të venë në' to gra dhe anasjelltas dhe të tjera që kanë të caktuar numërin e murgëve a të murgereshave. Sa për pasurin e murgëve, atje ku këjo lejohet, janë dispozita të posaçme që e caktojnë.

Murgët ndodhen në shumë kategorira prej atyre që janë dorëzuar (hieromanakahë e hierodhiakonë) e njëj tek ata që kanë raso ose janë me sqimë të madhe a të vogël.

Jeta monastike nër viset e mvaruna dikur prej Patrikut të Konstantinopolit Bullgarí, Serbí, Greqí, Rumaní etj. përmbahet akoma mjaft e gjallë, siç e deshmojnë monastiret e shumta e të pasura që janë edhe sot. Këtu në Shqipëri me gjith që përmbahen nja 50 Monastire, përveç atyre të tonave të çliruara, mund të themi se jeta monastike është shumë e kufizuar. Pasurja e disave, nër të cilat në shkallën e parë vinë ato të Dhioqezës së Beratit për të cilat do të bëjmë fjalë, është e mjaftë dhe rëndësia historike jo e vogël.

Sipas Statutit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipëris autoriteti më i lartë për administrimin dhe kontrollimin e pasurive monastiriale është Këshilli Mikst, i cili ushtron kompetencën e tij me anën Këshillit Ekonomik të Përhershëm, sipas detyrave dhe të drejtave që f caktohen në rregulloren e administrimit të përgjithshëm të Kishës. Asnjë pasuri e patundëshme monastiriale nuk mund të jetësohet pa vendimin e Këshillit Mikst; për ndryshe jetësimi është i pa vlefshëm.

Këshilli Ekonomik i Përhershëm emeron e pushon administratorët e Monastireve, të cilët janë klerikë dhe mbajnë titullin Igumen. Kryetari i Këshillit, i cili është Kryepiskopi, dekreton emërimin e tij, tue pas veton për arsye shpirtnore. Në rast nevojë Këshilli Ekonomik i përhershëm mund të emerojë dhe administratorë laikë të monastireve.

Igumeni merr rrogën që i caktohet në buxhet. Igumeni ndihmohet prej keshillit Igumenial, i përbërë prej Igumenit dhe katër antarve laikë. Këta emnohen keshtu: Pleqësia kishtarë e qytetit më të afërm të Monastirit zgjedh dy kandidatë për antarë prej

atij qyteti dhe pleqia kishtare e katundit me të afërit zgjeth dy të tjerë. Emnat e katër kondidatve të përcjelluna me preces-verbalin relativ i paraqiten titullarit të Dhioqezës, i cili së bashku me pleqsin qendrorë të Dhioqezës emnon prej këtyre dy si antarë të Keshillit Igumenial, njerin prej qytetit dhe tjetrin prej katundit. Këta dekretohen prej Titullarit të Dhioqezës. Dy antarët e tjerë midis të cilve dhe arktari emnohen prej Keshillit Ekonomik të Perhershëm dhe dekretohen prej Kryepiskopit.

Kompetenca e Keshillit Igumenial është:

Të keqyrij mbarë-vajtjen dhe rregullin e Monastirit, të administrojë pasurit e tij, sipas urdherave hierarqike, të vërij në ankant çdo çfrytim të pasuris së tundshme e të pa tundshme, të mbledhij t' ardhurat e të mbajë libra kontabilteti të rregullshëm dhe të vendosij mbi nevojën e jetersimit të pasurive të patundëshme, i cili përmbushet, passi vendimi të aprovohet prej Keshillit Mikst, siç thamë.

Keshilli Igumenial mbledhet një herë në muaj rregullisht dhe në rast nevoje dy herë.

Peshkopi ruan mbi Igumenin të gjitha të drejtat kanonike për disiplinën kishtare si edhe për lejimin ose pushimin e meshimit për arsye kanonike dhe të justifikuara.

Pas këtyre që na u-dukën të nevojshme, në artikulli tjetër do të hyjmë në përshkrimin h Monastireve kryesore të Dhioqezës së Beratit, duke filluar nga Monastiri i Ardhenicës.

(vijon)

PAN.

MENDIME T' ARTA

Fjalët fillisofike nuk' e bëjnë njerinë të drejtë dhe të shënjtë, po një jetë e pastërt e bën të dashur pranë Zotit.

Është më mirë të ndjejmë gabimet se sa të dimë virtutet e vet-vehtes.

Është e kotë të mbledhin pasurira që prishen e të shpresojmë në to.

KRYQIT

Qëndrove i patundur atje lart mbi bregun e Golgothasë, pa pyetur aspak për erërat e këqija që frynin kur në të djathtën e kur në të mëngjërën, i papërkulur midis shekujvet të historis dhe i pandryshkur nën rethanat e ligësisë dhe e kalbësirës, i shkëlqyeshëm kur rrezet e drejtësisë mundnin t' arrinin qoftë edhe një pjesë të shtatit t' ënd t' imponuarshëm, i padukëshëm, kur rret' e zeza mbulonin dhe eliminonin çdo përpjekje të djellit të drejtësisë për të të dërguar një rrezë të tij.

Pë përpara teje të kalonin mijrat e pelegrinevet e të falësvet, pa sy e pa gojë, pa krahë e pa këmbë dhe mbete i paprekur përpara tyre. Nuk të hidhëruan të qarat e nënave që mbetën pa bij, as lotët e foshnjavet që mbetën bonjakë, as therorja e qindravet të heronjvet.

Mbete shurdhë kundrejt të mjeruarvet që bërtisnin me krahët hapur përpara teje dhe i verbër përpara martirizimit t' atyre që deshmuan për tyj:

Pse vallë?

Të qarat e nënavet të pa-fatë dhe të foshnjavet bonjakë, lutjet e njerëzvet pa sy e pa-gojë, pa-krahë e pa-këmbë, vuajtjet e burravet të gjymtuar dhe theroret e heronjvet, trishtimet e të mjeruarvet dhe martirizimet e deshmorëvet të tu, kanë lënë gjurma të thella agonije mbi tyj.

Çdo vuajtje e çdo mjerim i veçantë përgjithësecilin nga këta, ishte vuajtje dhe mjerim m' i math për Tyj! Dhe të gjitha këto, njeri pas tjetrit, u-mblodhën si një sorua kolosale mbi kurizin t' ënd, që me gjithë këtë, nuk u-përkul, por mbeti ashtu si që me veshtrimin e hedhur larg drejt rrugës së shpëtimit që duket i afërmë.

Dhe u-kryqëzove dhe Ti, o Kryq, mbi kryqin e vuajtjevet dhe të mjerimevet të besnikëvet të Tu dhe mbete i kryqëzuar, pas porosisë, por gjithënjë vështrimi i yt drejtohet nga shenja që paralajmëron agmin e shpëtimit t' onë!

Kr. Ç.

Jetë - Fé - Moral

FALUNI

Nuk e tepëronj aspak po të them se do t' ish e nevojshme që të thirret me një zë të digjuarshëm në tërë botën (f. v. me anën e radio-s) dhe t' u thuhet të gjithëve sa janë të lodhur e të dërmuar nga jeta, atyreve që dalin në jetë si burbuqe të pranverës me dëshira dhe me ëndërrime, atyreve që janë rrukullisur në batakun e mekatës si edhe atyreve që kanë mbajtur udhën e drejtë dhe atyreve që kanë përbrenda fuqi vullneti, t' u thuhet them të gjithëvet «*Faluni!*» S'ka për njerinë çaste më t' ëmbëla se ato kur falet. Falja e zbut dhëmjen, e lartëson njerinë. Lum ay që mund t' a ndjejë fuqinë dhe ëmbëlsin' e saj. «*Faluni!*»

Po, lum ay që ka vullnetin të falet! Jeta jonë është një luftë e paprerë. N' udhën t' onë këtu mbi dhé takojmë më shumë gjemba se sa lule. Rasje të ndryshme 'na bjenë mbi kokë si furtuna t' egëra, sëmundje të mërzitëshme na thyejnë fuqinë fizike e na dëshpërojnë, vdekje të të dashurve t' anë na pikëllojnë, dështim i qëllimeve dhe i shpresave t' ona na bëjnë t' a humbasin kurajën t' onë dhe shumë herë ndjehemi se s' kemi fuqi që t' i sigurojmë as bukën familjes s' onë.

Në të këtilla rasje, pra, ku do t' a gjejmë ngushëllimin? prej ngaj do të marrim kurajën e duhur për të vashduar jetën? Apo do t' a lëmë vehten të bjerë në greminën? Mos o Zot! Faluni! Po, faluni, dhe të falurit, që me krahët e padukshëm përshkon shtresat qiellore na çon përpara fronit të Zotit, ngushëllimtarit të Math. Dyke ulur kokën përpara Atit të Përjetshëm, i përkulim zemrat me pendim për gabimet t' ona të përditëshme, të bëra me dashje osë pa dashje, kërkojmë ndjesë, i qajmë hallin t' onë si bijtë prindit, lypim ndihmë dhe beki mi e hiri i Tij do të na e japë.

Prandaj, faluni!

Sa mirë do t' ish që t' i stërvitim fëmijët t' onë të bëjnë rregullisht lutjet e tyre ndaj Zotit, çdo mëngjes e çdo mbremje e sa herë që është rasti të venë në Kishë. A ka gjë më të bukur e më morale p. sh. se kur të shihen fëmijë të falen për prindërit e tyre në çdo rast, të bëjnë kryqin dhe t' i luten Zotit që t' i falë shëndet babës e nanës!

Faluni!

Ja shikoni edhe natyrën rreth nesh. Falet edhe ajo; falen tërë dheu, qielli yjt. Lulet me bukurin' e tyre dhe me kundërmimet e tyre, drurët me degëzat e tyre të lulëzuar ose të ngarkuar me pemë, zogjt me cicerimet e tyre, përruaçkat me gërgëritjet e ujrave të tyre, deti me shkumbavitjen e valëve të tij, malet me majat e tyre madhështore, të gjitha, të gjitha thurin dhe drejtojnë hymne e lutje Krijonjësit të math të Gjithësis.

A nuk na shembëllen edhe Zoti Jesu Krisht sidomos në rastin kur dyke ndërë pikëllim për vdekjen q' i pregatitej vajti e u-fal në kopshtin Gjethsimani? Faluni edhe ju, të dashur villezër, që lëxoni këto radhë. Asgjë tjetër nuk do t' a ëmbëlsojë jetën t' uaj më tepër se të falurit. Bëni për dita lutjen e porositur: «Ati ynë që jë në qiell. . .»

* * *

LAJME KISHTARE

Ditët e javës së Madhe si dhe ajo e Pashkës në qytetin e Korçës u-kremtuan me një frymë madhështore. Imzot Agathangjeli merte pjesë në Kathedrale kurse në Kishën e Shën Gjergjit kryesonte Mitrofor At Vasil Marko. Të Premten e Madhe të tri stanzat e Vajtimevet u-kënduan prej korit Miks «Vëllezërit mbë Krishtin», nën drejtimin e Prof. Dhimitri Kostandini, Vajtimet ishin të kompozuar në rritim Bizantin me katër zëra, të

harmonizuara prej Imzot Fan S. Nolit. Gjith' këto ditë kori këndoj në Kishën e Shën Gjergjit si përherë. Të gjithë Kishët e qytetit gjatë këtyre kremteve të mëdha mbusheshin me popull të pa numurt besnikësh.

Ditën e Hënë më 26 në ditën e Shën Gjergjit Imzot Agathangjeli meshoj në Kishën e Shën Gjergjit, kurse Mitrofor At Vasil Marko merte pjesë në atë të Shën Marisë.

I BIRI I SHTËPISË SË DAVIDI-T

(Rrëfenjë)

XXIII

Tërbimi i turmës — Qetësija shëmbëllore e Jisuit — Sharrjet e Judhenjvet — Jisui përpara Annës — Pycetjet e Annës — Heshtja e Jisuit — Tmeri i nxënësve të Jisuit — Mallëngjimi dhe lotet e Adinasë.

I dashur babë,

Në letrën e mëparëshme harova të të shënoj një ngjarje që ngjavi në çastin kur Jisui u-zu prej atyre të liqve dhe që na e tregoi Joan-i.

Kur turma, tha Joan-i, e zuri dhe e lidhi Jisunë, u-dëgjua prej qiellit një zë turumbetash aqe i fortë, sa të gjithë ata që u ndodhnë aty, kujtuan se një ushtëri e pa numurtë krijesash të pa dukëshme po lëvizte sipër përmbi kryet e tyre. Të habitur njerëzit ngritnë sytë në qiell, po asgjë nuk mundnë të shihnin e të dallojnë.

Atëhere Jisui me zë që çfaqte një madhështi qiellore, tha:
— Degjoni, o burra Israel. Po t' i lutesha Atit t' im, do të më dërgonte dymbëdhjetë legione engjejsh, për të më mbrotur. Por nuk e bënj këtë, sepse erdha në këtë botë që të vuaj, e prandaj me dashje po ju vij pas atje ku do të më shpini.

Turma e nderur më tepër nga këto fjalë të Jisuit, e shpinte me britma të mëdha në qytet, kurse priftërijtë dyke parë se profeti u zu, ndonse kishte fuqi hyjnore, i u vërsulën me të shara e me të tallura. Ca me një buzëqeshje satanike e pyesnin, pse nuk kërkon ndihmë nga të 12 legione t' engjejve; ca të tjerë dyke u tallur bënin sikur kishin uri dhe etje dhe i lute-

shin me ironi e sarkazma që të kthente ujët në verë dhe gurët e rrugës në bukë! Po Jisui nuk e çeli fare gojën dhe nuk nxori as një zë, duke i duruar sharjet me një durim e gjakftohtësi të habitëshme.

Në këtë kohë turma dyke u shtyrë e dyke bërtitur si e marë, arrivi përpara portës së qytetit; këtu me një herë ruajtësit romanë i urdhëruan të qëndrojnë dhe i pyetnë, pse po thërisnin e bënin zhurmë. Atëhere prifti Ilia q' ish në krye të turmës tha:

— Po sjellin Z. oficer, një njeri që gënjen botën, dyke predikuar pa pikë turpi, se është gjoja Messia dhe mbret i Israhel-it. E zumë këtë se bashkë me 12 shokë të tjerë po bënte plane, si t' a përmbysë fronin e Cezar-it e të bënet ay vet mbret i Judhenjvet.

— Rroftë Cezar-i, Rroftë Perandori: u dëgjuan atëhere shumë zëra; ne vetëm Cezar-in kemi mbret.

— Kur qenka puna kështu, u përgjegjën ruajtësit, shpjegoni përpara guvernatorit, që t' a gjykojë e t' a dënojë. Ne pilatoja! Ne Pilatoja!

— Në Anna, i a pritnë Judhenjt. Në Anna! dhe me një herë u nisnë për në shtëpinë e Annës. Ky i fundit kur arriti turma dhe zuri të thëresë doli në ballkan me rrobat e natës mbasi ishte mëngjes akoma, dhe s' u mbajt dot nga gëzimi që ndjevi për arrestimin e Jisuit. Urdhëroi pra t' ia sjellin pa vonesë për t' a njojtur e për t' a hetuar.

Urdhëri i Annës u zbatua në çast dhe Jisui i lidhur u suall përpara kryepriftit. Redhi i këtij ishin bërë gati t' a prisnin me tallje e më të shara; po pa pandehur hoqnë dorë dhe i lëshuan armët, pse u habitnë nga fytyra e qetë dhe madhështore të profetit.

Në pyetjet e shpeshta të Annës nuk u përgjegj fare Jisui. U-ndez pra nga kjo sjellje izraeliti ipokrit, e lidhi më shtrënguar Jisunë dhe urdhëroi të dërgohet në kryeprifti Kajafa, dyke thënë këto:

— Ne mua s' ke dashur të përgjigjesh, po këtë do të shtrëngohesh t' a bësh përpara Kajafës; do të flasësh aty, ti o i do-bët, që je mburur se ke fuqi t' a prishësh faltoren e Jehovasë dhe ke guximin e paturpëshëm të quash vehten t' ende Bir të

Perëndisë! Këput qafën o njeri i lik dhe gojëprishur: Për fronin e David-it! Pilatoja pa dyshim do të të njohë për mbret, do të t' a lëshojë fronin e, që të mos tronditesh, po të qëndrosh i sigurtë mbi atë, do të t' i shtrëngoje këmbët e duart!

Turma atëhere priti me britma të tërbuara fjalët e Annës dhe zuri të thëresë si e çmëndur: «Mbi Kryqin! Mbi Kryqin!» Ca të tjerë prapë bërtisnin: «Përpara Kajafës! T' a shpjemë në Kajafa, në kryepriftin e madhë!» e dyke thirur gjithënjë çante rrugat e qytetit me dritëra të ndezura.

Joan-i, i shtypur nga hidhërimi, ecënte pas me lote në sy; po një ushtar roman e njofti dhe do t' a zinte sigurisht po të mos fshihej në këndin e një rrugice, dyke përfituar nga errësira. Po edhe nxënësit e tjerë ndiqen pa mëshirë; pesë bile nga këta kanë erdhur këtu dhe fshihen në shtëpin e Rabinit Amos. Të gjithë, baba, neve na ka rëzuar hidhërimi i jashtëzakonëshëm; nuk dimë si të silleme: t' a lemë Jisunë pa ndonjë ndihmë fare, na duket një gjë e tmerëshme; po edhe sikur të provojmë t' a improjmë do të pësojmë dhe neve po ata fat. Po hidhërimin na e shtuan edhe ma shumë dyshimet që guxuan të çfaqin para nesh tre nga nxënësit e Jisuit; thanë d. m. th. se si mund të jetë Messia dhe Bir i Perëndisë, posa që pranon të lidhet e të gjykohet si kriminel i më i fundit!

Në se Jisui dënohet e vdes, atëhere, baba, për veç hidhërimit të pa masë, do të ndjejmë dhe një dëshpërim të math, se bashkë me atë do të çduket e çdo shpresë e rimbëkëmbjes së madhështisë të popullit t' Israelit.

Syt' e mija u-verbuan po thuaj prej lotëve dhe prandaj mezi po i jap fund kësaj letre.

Bija jote e hidhëruar
Adina.

MENDIME T' ARTA

Ay njeri që vazhdon rrugën e dëshërimevet trupore, e ndot shpirtin dhe humbet hirin e Zotit.

Lajme Kishtare

Panagjir' i Shën Thanasit në Pjeshkëz

Eshtë e pa mundur të mos i bjerë në sy udhëtarit që kalon nëpër rrugën e re që të shpije prej Tirane në Kavajë, kisha e vogël por shumë e bukur e Shën Thanasit, e ndërtuar me ndihmat e popullit të Durrësi dhe Pjeshkëz-ës mbi një kodër të mbuluar me blerim dhe të rethuar me bimë të ndryshme të cilat i japin pamjen e një kopështi të bukur.

Në këtë kishë pra, ditën e Djelë më 2 Maj u festua panagjir' i saj, ku muarën pjesë një shumicë e madhe besnikësh t' ardhur nga Durrësi, të cilët me inisiativën e Zavëndës Mitropolitit të këtij qyteti dhe në marrëveshje me shoqërinë automobilistike Sand Adriatik kishin organizuar një shëtitje fetare.

Meshën panagjirike e kryesoj Hirsija e Tij Imzot Irineu i cili kishte ardhur apostafat i shoqëruar prej Zavëndës Mitropolitit të Tiranës dhe drejtorit të Seminarit. Gjithë besnikët të cilët mbushnin kodrën e Shën Thanasit kishin dalë për t' a pritur Hirsin e Tij.

Ceremonija fetare u zhvillua me rregull, disiplinë dhe shprestarri. Në kohën e duhur Zoti Dhimitër Beduli, Drejtor' i Seminarit mbajti predikimin e ditës ku midis të tjerave theksoi nevojën e besimit me të cilin gjithsej cili besnik du-

het të jetë i pajisur për t' i bërë ballë reziqeve dhe nevojave të kësaj jete.

Mbas mbarimit të Meshës së Hyjnpueshme u-bë procesioni simbas zakonit, në mbarim të të cilit Hirsija e Tij Imzot Irineu mbajti një fjalim të shkurtër por kuptimplotë, duke përkujtuar të ndyerin Dhimitër Bixhi ish kujdestar i kësaj kishe (At' i kujdestarit të sotshëm) i cili për 20 vjet rrjesht u përpoq për të mirën dhe mbarëvajtjen e saj. Gjithashtu Imzot Irineu theksoi zemër-bujarin e popullit Orthodhoks të Durrësit, i cili sa herë janë çfaqur raste të këtilla nuk ka munguar të japë kontributin e tij më të math, dyke ju uruar njëkohësisht që rrugën e bamirsisë t' a vazhdojnë dhe paskëtaj për të mirën dhe mbarëvajtjen e Kishës s' onë Orthodhokse Kombëtare.

Më në fund si mbaroi dhe procesioni gjithë besnikët u shpërndanë grupe, grupe nënë hien e drurëve të bleruar ku kaluan disa orë të këndëshme dyke kënduar dhe dyke psalur hymne Kishtare.

Aty nga ora tre autobuzat filluan të shpijen përsëri besnikët në Durrë të cilët u kthyen nëpër shtëpitë e tyre shumë të kënaqur nga kjo shëtitje fetare.

Këshillojmë pra gjithë besnikët Orthodhoksë që në të këtilla raste të marin pjesë të gjithë, se përveç kënaqësisë shpirtërore që do të ndjejnë, do të kalojnë dhe një ditë plot gëzim dhe larg përkujdesjeve të kësaj jete.

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

REVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Viti i IV-të

Qershuer 1943-XXI

Nr. 4

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

LANDA: Nevojë për shkop — Shkenca dhe Feja — Lufta dhe Morali — Disakordi midis mendjes dhe botës — Mbi liri e drejtësi të doktrinës kristiane — Nga kryeveprat e Atërve të Shenjtë — Vartimeu — Ideja fetare Ruse — Fjalë ngushëllimi — I biri i shtëpisë së David-it — Sjelljet t'ona ndaj pleqtë — Lajme Kishtare.

Nevojë për shkop

Nuk e di në të ka qëlluar ndonjë herë këndonjës i dashur, të shohësh ndonjë gomar të zemëruar. Qëndron në vënt ku ndodhet, pa mar vesh të bënjë asnjë çap përpara. Nëse nuk heth me shkelma, pranon ndoshta që zotnia e tij t' a shtyjë e t' a heqnjë si ndonjë gjë të pa shpirt. Mirëpo, ku të përkulen e të lëvizin këmbët e tij! Në këtë rast, pra, vetëm shkopi i zotnis munt të sjellë ndonjë përfundim.

Kali nga ana tjetër, është diçka më kryelart. Dhe diçka më madhështor në zemrimin e tij. Në një orë të tillë, them, s' munt t' i afroresh aq lehtë si gomarit dhe as që munt t' a shtyjsh. Vetëm po të ariysh me ndonjë mënyrë dinake t' a kapësh nga veshi a nga buza a nga ndonjë vënt tjetër të ndijëshmë, munt t' a sjellësh me anën e frerit me një anë e të kamxhikut nga ana tjetër, përseri në vete.

E! këtë pikërisht ka parasysh i dituri Solomon kur thotë që: *siç është kamxhiku për kalin e thumbi për gomarin, kështu është dhe shkopi për një komb jasht ligjit.*

Ke të bësh me njerëz jasht ligjit, që s' njohin qërtimet e ndërjegjes, që s' kanë frikë nga Zoti e turp nga njerëzit? Mos i humb fjalët kot, thotë i urti Solomon. Mos pandeh se ke për të sjellur ndonjë përfundim me këshillat e lutjet e tua. Asgjë nga këto. Po të jesh kryetar dhe je thirrur t'i qeverisësh, duhet të përdorësh për ta masa të repta, që kallin tmerin dhe q' e përmbajnë shkelësin me anë të frikës e të dënimit. Do të bësh edhe ti atë që bën dhe udhëheqësi i kalit a i gomarit kur këto kafshë i zë ndonjë inat a ndonjë huq. Bërtit-i sa të duash gomarit. Ay s' tundet fare. Mirëpo, kur i zoti ose udhëheqësi me një dru të mprehur e çpon pakë, atëhere ay ecën me vrap. Gjithashtu edhe kali. Mjafton një lëvizje e kamxhikut në ajr për t' a bërë t' ecënj me shpejtësi. Një diçka të tillë duhet të bësh edhe ti kundër shkelësve të ligjeve kur je i thirrur t' i qeverisësh ose t' i kryesosh. Sot kërcënimi e nesër denimi. Sot qërtimi e nesër kamxhiku. Tani lëvizja e kamxhikut n' ajr ose ndeshkimi i leht, dhe nesër mbyllja në burg.

Natyrisht, s' jam i mendimit që shkopi është i vetmi mjet për t' a përmbajtur shkelësin brënda kufive të duhur. A! jo. Ka njerës për të cilët mjafton vetëm një gest, një veshtrim, një shenjë mos-kënaqësije. Po këtu s' është fjala për këta. Esht fjala për të paligjëjt, për ata që sistematikisht shkelin çdo lloj rregulli, që s' respektojnë kurgjë, që kanë hedhur posht çdo lloj turpi. Esht fjala për ata pikërisht që Solomoni, ndonëse e dinte mirë se pas cilësiveve psikike dhe mendore janë njerës, i radhiti në po atë shkallë me kalin e me gomarin.

Dij-e mirë se këta, po të mos ekzistojë frika, do të çthurren më tepër. Dhe sidomos po të kuptojnë që veprat e tyre kalojnë pa u-ndëshkuar, do të bëhen brënda një kohe të shkurtër kamxhikë për shoqërinë në të cilën rrojnë. Dënimi, shkopi, frika e ndëshkimit, nuk them se ka për t' i ndrequr krejt, gjë që ndoshta në disa raste dhe munt t' arrihet. Por sigurisht ka për t' i mbledhur të paktën, ka për t' i sjell pak në vete, ashtu siç e sjell «kamxhiku» kalin e «thumbi» gomarin.

Dhe çka vlen për individët, shumë më tepër vlen edhe për kombet. Po këtë do t' a shohim në numurin tjetër.

Feja dhe shkencë

Problemi i lindjes së njeriut

I.

Hyrje—Theoria e Darwin-it—Si e pritenë këte teori pasonjësit e lindjes automatike — Gëzim dhe entuziazëm e kotë — Darwinizmi nuk pajtohet me materialistët për sa i përket lindjes së jetës — Darwin-i dhe shokët e tij kryesorë besojnë në Perëndi krijonjës dhe jetëdhënës — Darwinizmi dhe dogma e krijimit.

Sikundër kemi thënë dhe tjetër herë, pseudoshkencëtarët që luftojnë fenë dhe dogmat fetare, thonë se doktrina fetare është në kundërshtim me shkencën, sidomos në këto dy pika themelore: në punën e lindjes e çfaqjes së jetës në tokë dhe në atë të lindjes e origjinës së njeriut. «Predikimet e fesë, thonë, se jeta lindi prej jetës vetë d. m. th. prej Perëndisë dhe se njeriu u-krijua drejt për së drejti prej krijonjësit me ndërhyrjen e tij të posaçme, këto predikime pra u-provuan të pa themelta, mbasi nuk pajtohen me zbulimet e shkencës, që ka gjetur se jeta lindi prej lëndës vet-vetiu dhe se njeriu rodhi nga kafshët e pra nukë është tjetër gjë, përveç se një kafshë e një majmun i përsosur»!!!

Për sa i përket problemit të lindjes së jetës, këndojësit që kanë kënduar me kujdes artikujt e kësaj shtyllë mundnë, siç besojmë, të binden se puna në të vërtetën nuk qendron ashtu siç predikojnë disa nga falsifikatorët e shkencës; përkundrazi, përfaqësonjësit e saj më të çquar që nga kohët e vjetra e gjer në ditët e sotshme janë vërsulur dhe kanë luftuar pa meshirë pretendimet e këtyrë pseudoshkencëtarëve, dyke i provuar keto krejt të pa themelta me anë argumentash e provash që nuk pranojnë as më të voglin dyshim ose kundërshtim, Provat e Paster-it, si edhe studimet e vëzhgimet q' u-bënë më vonë, rëzuan krejt theurin' e lindjes automatike dhe provuan qartazi, *se jeta n' as një mënyrë nuk mund të rjedhë prej lëndës së vdekur, po vetëm prej jetës vetë*, ose, siç thote Aristoteli, prej shkakut të parë q' i dha lëndës jetë dhe q' e vuri atë në lëvizje (to ki nun etion). Kështu pra theoria e lindjes automatike, pasi bëri bujë të madhe për një kohë të gjatë në fushën e diturisë

dhe të shkencës, hyri në kategorin' e theorive të vjetëruara dhe u-rëzua aqë shumë, sa që sot as një shkencëtar i vertetë nuk beson më në predikimet e saj të pa themelta dhe antishkencore.

* * *

Po këte fat pati, sikundër do të shohim, edhe theoria tjetër, theoria që mundohet të shpjegojë lindjen e njeriut dhe që njihet në botën shkencore me emrin «Theoria e Darwin-it», ose «Darvinizmi», ose «Theoria e çvillimit». Si pas kësaj theorie, të gjitha llojet e shumta të krijesave të gjalla në planetin t'onë paskën rjedhur nga një vetëm krijesë të gjallë ose të shumtën nga tre ose katër lloje krijesash të gjalla; prej kësaj pastaj ose prej këtyre llojeve me anë të një çvillimi (evolution) misterioz dhe me bashkëpunim të pakuptuarshëm fuqirash fizikohimike u-lindnë gjatë shekujvet tërë kafshët që ndodhen sot e më në fund dhe njeriu! Këtë teori e pritën me gëzim dhe e përshëndetën me entuziazmë të veçantë pasonjësit e theorisë së lindjes automatike, se pse në këte gjenin, siç kujtonin, armë të reja për mprojtjen e për fuqizimin e doktrinës së tyre të dërmuar definitivisht prej shkencës së vërtetë. Dyke u-mbështetur këta mbi predikimet e Darvinizmit, se terë krijesat e gjalla kanë lindur nga një ose nga disa krijesa të gjalla me anën e çvillimit, bëjnë këte syllogizme të pa vënd: «po sa që terë kafshët e krijesat e tjera të gjalla kanë rjedhur nga një vetëm krijesë të gjallë me ndihmën e çvillimit e të fuqive mekanike misterioze, çna ndalon të besojmë se edhe krijesa e parë mori jetë dhe lëvizje jo prej ndo një fuqije sipërnatyrore, po prej veprimit të verbër të kushteve e të fuqive fizikohimike që vepruan e në lindjen e krijesave të tjera»? Ky syllogizëm, sikundër mund të kuptojë edhe ay që ka mësuar elementet e para të llogjikës, ky sillogizëm pra është aqë i metë, sa edhe Darvinistët vetë nuk guxojnë t'a besojnë e t'a pranojnë. Darwin-i, si edhe nisiatorët më kryesorë të kësaj theorie, kanë protestuar kundër këtij arsytimi të gabuar të materjalistëve, dyke thenë se theoria e tyre nuk e prek as pa dogmën e krijimit të predikuar prej fesë dhe beson se një fuqi sipërnatyrore i ka dhënë jetë dhe lëvizje krijesës së parë. «Dëshëroj, thoshte Darwin-i, dëshëroj të thom hapur, se nuk po e prek çeshtjen e lindjes së jetës. Shkenca nuk na lejon të pranojmë se qenje

të gjalla lindin prej lëndës së vdekur. Besimi, se Perëndia krijoi së pari disa forma krijesash të gjalla që patnë fuqi të prodhojnë të tjera lloje me anën e çvillimit, ky besim tregon mendjen e fellë dhe lartësin' e atij q, e beson këte . . . Unë nuk kuptoj dot, si mendimet që çvillohen në veprat e mia mund të jenë në kundërshtim me ndjenjat fetare».

Kështu pra Darwin-i beson se jeta e parë lindi prej Perëndisë, e prandaj nuk kanë të drejtë t' entuziazmohen e të gëzohen pasonjësit e lindjes automatike me teorin' e çvillimit, dyke e kujtuar këte si mbështetje e si fuqizim të predikimeve të tyre të pathemelta për sa i përket lindjes së jetës. Kjo teori e Darwin-it, si kundër do të shohë këndonjësi i kësaj shtylle, është një hipotezë e thjeshtë dhe nuk ka themele shkencore, që të mundë të radhitet midis theorive fizike, të cilat janë pranuar në fuqshën e diturisë si aksioma e parime pa as një kundërshtim. Po edhe si kur t' ishte e vërtetë, prapë nuk kishin pse të trembeshin armiqt e materializmit, si edhe fetarët që besojnë Perëndinë si burim të jetës e si krijonjës së terë krijesave të gjalla të planetit t' onë. Sepse, si kundër u tha edhe më sipër, Darwin-i me shokët është e vërtetë se predikojnë se çdo gje e gjallë e tokës rodhi dhe lindi prej një protoplazme ose prej disa llojesh protoplazme të ndryshme, si pas ligjëve të çvillimit e nën influencën kushtesh e fuqirash fizikohimike e mekanike misterioze; po kjo ose këto protoplazme jetën dhe lëvizjen e parë e muarnë nga një fuqi sipërnatyrore, mbasi lënda e vdekur n' asnjë mënyrë nuk mund të japë jetë dhe lëvizje. Prandaj shohim shumë pasonjës së kësaj theorie të jenë armiq të materjalizmit dhe fetarë e besnik të vërtetë. Gjithë për këte arsye kemi dhe njerës të pajosur me zell e me ndjenja fetare, të cilët janë pasonjës së Darwinizmit, mbasi besojnë se Krijonjësi pajosi protoplazmën e parë me një fuqi të këtillë, sa që kjo me anën e çvillimit mundi të prodhojë terë krijesat e tjera të gjalla. Po si do qoftë, theoria e lindjes automatike s' ka për të fituar as gjë nga Darwinizmi dhe më kot e pritnë çfaqjen e tij me gëzim e me entuziazmë.

Pas kësaj hyrjeje vijmë në kqyrjen e në studimin e theorisë së Darwin-it, pasi të hedhim më parë një veshtrim të shkurtër mbi historin' e lindjes së saj.

Shpresëtar.

Lufta dhe Morali

Lufta në Dhjatën e Vjetër.

Në faqet e para të libravet të Dhjatës së Vjetër takojmë një vepër kriminele: vrasjen e Abel-it nga Kain-i, vepër që paraqitet si e para simptom' e luftës, si e para çfaqje e dobësis së njeriut të rënë. Këjo vepër është cilësuar prej Zotit vet si mëkatë' që thërret në qiell dhe është dënuar. Një tjetër simptomë lufte që lihet të kuptohet në Dhjatën e Vjetër, është dhe ajo në Kullën e Babel-it, kur kryelartësia njërezore deshi të matet me fuqin e Perëndis.

Q'atëhere, grindje dhe përleshje të vazhduarshme nërmjet njerëzvet të ndarë në popuj të ndryshme zunë në historin e njerëzis vëndin e paqes. Q'atëhere popujt, të përhapur në të gjitha anët e dheut, kalojnë një jetë luftarake, një jetë pagane, një jetë pa ndjenjë morale dhe fetare ndaj Zotit, krijojnësit të botës. Vetëm një popull, populli i zgjedhur i Israilit, vazhdoi të qëndrojë më afër Zotit. Historia e këtij populli përfshihet në librat e Dhjatës së Vjetër.

Këro libra kanë përgjithësisht një ngjyrë luftarake dhe me që s' janë shkruar të gjitha në një kohë, por në kohra e vënde të ndryshme, vetkuptohet se edhe pikëpamja e tyre rreth luftës, do të jetë e ndryshme. Çdo libër do të përmbajë eksigjencat, më shum a më pak qitura në shesh, të kohës së përpillimit të tij për luftën, domethënë siç e udhëhiqte Perëndia popullin Israilit, në paqe a në luftë pushtimi, në luftë mbrojtjeje a në luftë dënimi. Ashtu që, deri sa p. sh. në Nomin e Dytë (10,19-20) ndalohej që në luftë të bëhet plaçkë jashtë rregullit, në Librin e Mbretërvet (15,3) Perëndia urdhëron Saul-in — me anë të Samuil-it — të nisë luftë kundër Amalikut duke çdukur çdo gjë që do të gjejë përpara dhe duke sjellur kudo çkatërim e shkretë, pa mbajtur kurgjë për vete nga plaçkat e armikut. Në ca vën-

de shohim një dëshirë të gjallë për paqe, në tjetër anë dëgjojmë Jeremia-n duke thënë: «i mallkuar qoftë ay që ndalon këlleçin e tij prej gjakut» (48,10).

Dhjata e Vjetër përsa i përket luftës munt të ndahet në tre epoka.

Epoka e parë nis me patrikët. Kujtojmë Avraamin, i cili ndonëse ishte njeri paqëndashës sidomos me Lot-in (Të Bërët 17,8), detyrohet me gjithë këtë të hyjë në luftë për të shpëtuar këtë të fundit. Në pushtimin e Hanaan-it Avraam-i me njerëzit e vet vepruan pa gjakderdhje. Mirëpo, pas Avraam-it, duke filluar me çlirimin e popullit Israilit nga robëria egjyptiane, pason një periudh' e tërë luftërash nënë Moisi-un që paraqitet si një figurë e çquar luftarake në luftimet pushtonjëse të Tokës së premtuar dhe në luftëra me popujt fqinj që s' e linin të qet. Në këtë epokë ndjenja kombëtare e popullit Israilit njëjësohet me ndjenjën fetare. Jehovah paraqitet si një Perëndi e popullit Israilit dhe populli Israilit si «popull i zgjedhur» i Tij. Luftërat e popullit Israilit — sulmonjëse ose mbrojtëse qofshin — janë dhe të Jehovahjt. Suksesi ose humbja e luftës mvarret nga nxehtësia e besës që do të ketë populli për Jehovan. Ay e ndihmon popullin deri sa ky i fundit i a plotëson dëshirën; për ndryshe heq dorë nga ay.

Epoka e dytë nis me profetin Amos dhe mbaron me çkatërimin e mbretëris së Judhës. Gjatë kësaj epoke moraliteti i popullit Israilit bie, fitoret ushtarake pakësohen, luftërat nga sulmonjëse bëhen mbrojtëse, Perëndia paraqitet jo më si në periudhën e parë mbrojtës i Israil-it, por si një Perëndi i rregullit moral të përbotëshmë. Ay, duke parë gjëndjen e keqe morale të popullit, e dënon për ndreqje me invadimin e popujvet të huaj mbi të. Ndjenja kombëtare është dobësuar në favor t' asaj për rregullin moral. Të gjithë profetët po thuaj të kësaj kohe e theksojnë dekadencën morale të popullit, të cilën e përvëlojnë duke theksuar pasojt e këqija q' erdhnë mbi' të.

Epoka e tretë nis me kthimin e Judhenjvet nga robëria Babylonike dhe mer fund me çkatërimin e Jerusolim-it. Në këtë periudhë ringjallet gjëndja e parë kur, nënë Makabenjtë, ndjenja kombëtare njëjësohet me ndjenjën fetare. Kryepriifti është njëkohësisht dhe udhëheqës politik e shef ushtarak i popullit

Judhaik. Dihet se si Antioh-u i IV-të, që mbiquhej Epifanis, u mbylli atyre tempullin, u ndaloi krenntimin e së Shtunës dhe rethpresjen dhe i detyronte të sillnin therore para idhujvet të paganizmës. Dihet gjithashtu dhe se si populli në fillim ndenji pasiv, po pastaj u-detyrua të rëmbejë armët nën priftin Matatia dhe nën të tre Makabenjtë: Judha, Joanathan e Simeon, për t' i dal zot besës dhe traditavet të tij. Prandaj s' po zgjatemi rreth këtyre ngjarjeve.

Duke e kqyrur në përgjithësi pikëpamjen e Dhjatës së Vjetër për luftën, ajo na paraqitet e favorëshme, se të gjitha luftërat e Judhenjëvet ishin, ose të udhëhequra nga Jehovaj për t' i shpëtuar ata nga reziqet e popujvet të tjerë, ose të përdorura nga Ay për t' i denuar ata për udhën e keqe që ndiqnin. Luftërat e Judhenjëvet — si ato me frymë sulmimi, ashtu edhe ato me frymë mbrojtjeje — kanë qënë mjeti për realizimin e të gjitha premtimevet që u kish dhën' atyre Perëndia, dhë, me që me anën e tyre ndiqej arijtja e disa të miravet ethike të larta, ishte e natyrëshme që Zoti t' ish me anën e tyre dhe pra t' ishin t' arësytura dhe të lejuara, bile dhe të lypura nga morali, sado t' egëra që munt të kenë qënë. Me anën e këtyre luftërave qëllimi i vërtetë i popullit Judhaik s' u-kapërxye, por u-plotësua dhe si pasojë këto s' munt të jenë drejt-për-së-drejt në kundërshtim me Moralën, se siç dihet, edhe nga pikëpamja morale është e lejuarshme t' a çosh luftën gjer në pikën sa të mos kapërxehen qëllimet e vërteta: domethënë sigurimi i plot për ekzistencë.

Mirëpo baza morale e vërtetë e Dhjatës së Vjetër përgjithësisht nuk është jeta luftarake por paqja, të cilën në vijë të parë e kanë për qëllim të gjith veprimet dhe çfaqjet e një individi ose të një populli. Në Dhjatën e Vjetër, siç e theksuam dhe më sipër, lufta ka qënë vetëm një mjet mbrojtjeje të ekzistencës së popullit Judhaik që ky të mbetet gjër n' ardhjen e shpëtimit, ose ka qënë një mjet edukimi në dorën e Perëndis me qëllim që të shpëtohej njerëzia, të vendosej një rregull moral më i lartë, të mbretëronte *besa*, *drejtësia* dhe *paqja* në botë dhe me asdonjë mënyrë si qëllim.

Në numurin tjetër: Lufta dhe Dhjata e Re.

Themë filozofike

Disakordi midis mëndjes dhe botës

Në artikullin e mëparëshm me titullin «psë mejtohemi» treguam se dija dhe skenca janë bija të mejtimit, qi mejtimi shtimulohet nga kurjositeti primitiv, qi kurjositeti riedh nga habia primitive dhe qi habia vjen nga disakordi i mëndjes me botën sensible. — Tashti na duhet të gjejm arsyen e disakordit në fjalë.

Besimi instinktiv e i patrëndëshm i shpirtit, mbi disakordin absolut midis mëndjes dhe botës sensible, implikon doemos faktin qi shpirti paska idé të botës reale, me të cilën krahason botën sensible dhe prej krahasimit konstaton disakordin midis tyne. Se po të mos kish idé të tillë, do t'i mungonte modeli me kë të krahasonte botën sensible, dhe, për passojë, do t' a pranonte këtë botë doemos për të vërtetë; në këtë rasë mëndja do të kënaqej me dhâmat (dati) e nisavet (sensi) dhe nuk do të kish vend as për habi, as për kurjositet, as për mejtim, as për skencë; një qetë mendore absolute baraz me vdekje do të mbretonte.

Por nga i ka shpirti këto idena të botës reale? Siç dihet, dy janë burimet e idevet: *esperienca* dhe *arsya* (ratio). Dhe dija që na vjen nga esperienca quhet espermentale ase empirike ase à posteriori ase sensible më qi na vjen për miet nisavet (sensi); dija që na vjen nga arsyja quhet racionale (nga ratio) ase trascendentale (trascende-kapërcen esperiencën) ase à priori (përpara esperiencës) ase pure (lakuriq, e sveshun prej çdo elementi sensibël).

Esperienca është kontakti i mëndjes me botën për miet nisavet (sensi); p. sh. pa e pë një gjâ, s'mundem me e dijt d.m. th. me formue idé të sai. Por niset, qi shërbejn si urë për kontaktin e mëndjes me botën, kanë një cen të madh qi e de-formojn kryekëput objektin dhe nuk i-a-paraqesin mëndjes ashtu siç është; p. sh. një shkop kredhun n'ujë, sýt na e paraqesin si të thýer; një ré e zezë n' orizont na duket si mal; vibracionet e etherit, sýt na i paraqesin si dritë; vibracionet e ajrit, veshi na i paraqet si zâ; kjo gjan dhe me niset e t' jera. Kështu esperienca nuk na bân të njohun, veç një botë krejt të deformeue qi nuk gjan aspak me veten e sai të vërtetë. Dhe, po të mos kishim tjetër burim dijnje, mëndja e shkretë do t'ish e dënueme për jetë të mos e njihje kursesi botën reale, botën e vërtetë. Por lavdí pastë Zoti qi s' na la në t' errët; na fali *arsyen* dhe kështu na dha provë të dashunis së Tij të madhe për të vërtetën.

Arsya është kontakti direkt i shpirtit me botën reale; kontakt direkt d. m. th. pa ndërmyetsin e nisavet (sensi); andaj dhe idënat qi kemi prej këtij kontakti janë të sveshuna prej ç'do elementi sensibël, pra të pa deformeue, pure, të qarta dhe adequate me objektin. Me fialë t' jera, për mjet këtyne idéve racionale njohim botën lakuriq siç është, botën e vërtetë, botën reale, realitetin absolut. Këto idëna à priori qi formojn arsyen, essencën e mëndjes, shpirti i ka ab eterno që kur bën te pjesë t' essencës hyjnore para krijimit të botës. Shpirti me anën e tyne pasqyron botën reale, botën metafizike, të cilën e ka për model kur giukon botën sensible dhe e gjen këte të deformeue e në disakord me atë.

Cilat janë idënat racionale dhe parimet qi dalin sish? Këtë themë do t' a trajtojm n' artikull tjetër.

K. T.

Mbi liri e drejtësi të doktrinës kristiane

Mjetet për t' a çue njerinë deri në një shkallë të naltë kulture, në kohën pagane ishin: të gjitha landët shka kuptohej shkencë e filosofi. Por liri e drejtësi [këto mjete nuk epshin. Rezultate pozitive dhanë po atëhere kuer se kjo shkencë kje veshun me petkun e religjionit e moralit kristian. Edhe këtë shkencë kristiane e përhapën njerëz pa diplomë, peshkatarët e pa shkollë. Këtë e dhanë nxansit e Jisuit, Apostojt, mbasi qi po afër 2000 vjet më parë zbriti mbi ta Fryma e Shenjtë në formën e gjuhëve të zjarta. Këta njerës të thjeshtë e pa diploma i dhanë botës një ngjyrë tjetër me anë të Frymës e të Doktrinës Shpëtimtare tuej themelue lirin, drejtësin dhe civilizimin e vërtetë. Përpara nesh qëndrojnë faktet historike: atje ku në mes të njerëzve e të popujve ka hy Fryma e Shenjtë aty dhuna e padrejtësija dhe verigat e robnisë kanë ra poshtë, atje ku principet religjioze të Doktrinës së Jisuit janë përqafulue, aty kanë mbretnue lirija e dashurija vllaznore, paqja dhe drejtësija. Doktrina e Jisuit gjithkund ka prue ndër zemra të njerëzve dritë e shpirtmirësi. Ajo ka zbut ekzekutimin e ligjve, i ka dhanë randësi të drejtave njerëzore, ka shpallë haptazi se burri e grua-ja janë me të drejta të njejta si edhe përgjithësisht në mes të njerësve tjerë të barabarta. Gjatë kësaj kohe 2000 vjeçare Fryma dhe principet e Doktrinës Shpëtimtare janë dhe kanë për të kenë burimi i kulturës dhe civilizimi shpirtnuer të vërtetë i së drejtës njerëzore dhe i moralit të shëndoshë. Me anën e kësaj Doktrine kje ba përmirësimi i njerëzisë me gjith se ma para shkenca dhe filozofija kjenë në kulm. Frymës Kristiane duhet t'i

jemi mirënjohës për themelimin e një numuri të pa njuhun institutesh edukative dhe bamirëse.

Por asht e vërteta se fryma e ligë (satana) nuk ka mungue kurrë të qindrojë në mjes të njerëzve dhe të punojë kunda Frymës së Shenjtë të doktrinës shpëtimtare. Dhe tani kërkon se si të marrë pozitën qi pat pasë ma para — të dominojë botën. Prandaj hyn në mes të njerëzve e të popujve, i habit, i drejton të jetojnë në mëryrën ma brutale dhe barbare, prish harmonin e jetës tuej i vue në dy ballna njerin kundra tjetrit. Kjo frymë e ferrit tani predikon se shpresa në Perëndinë dhe dashunija ndaj njerëzisë asht me pak randësi. Nën sugestionin e kësaj fryme satanike disa kujtojnë se mund të krijojnë paqe, drejtësi, moral, liri e humanitet jo në bazë të principeve të Doktrinës Shpëtimtare por me anën e shkencës pagane dhe teknikës.... Edhe me të vërtetë në këto kohët e fundit me anën e [teknikës veç se çudina nuk po bahen kah asht tuej përparue, por me gjitha deri te paqja, drejtësija, lirija e humaniteti nuk po vihet. Me përparimin e teknikës e të filozofisë erdhëm deri te ky rezultat: egoizma e ka kalue masën aq sa njerëzit arrijtën deri aty sa të grabisin e vrasin njëni tjetrin për sende materjale.

Të marrim e të vërejmë gjëndjen haostoke të soçme qi u da bota në dy pjesë njana kundra tjetrës si t' ishin njerës t' egjër të kontinentave ma të prapambetun e jo evropjanë me të gjitha cilësinat e komoditetet e jetës e t' i pyesim drejtuesat e popujve të Evropës: Vallë a nuk mendoni se me egoizmën tuej po e çoni botën n' ambiz të pafund? Apo t' i drejtohemi popujve të kulturës e t' i pyesim: Quo vadis Europa?

Gjyqi i Hagës dhe Lidhja e Kombeve mbas luftës 14-18 nuk kjenë të zotë të sjellin paqe e drejtësi në botë, por kjenë shprazë tuej u përfutue si vendi ma i përshtatun për mëni e anmiqësi. Aso kohe njerëzit e shkencës, profesorët e shkrimtarët, diplomatët e strategët filluan të çojnë zanin e tyre tuej namë e mallkue për të da botën në dy pjesë njana kunda tjetrës, dhe lumi i gjakut shkante gjithmonë rrëkajë. E tani mund të pyesim: Përse shkenca e ditunija e lejuen këtë mjerim? Përse mundimi i sa instituteve dhe të drejtuesave të tyne nuk mujtën t' a ndalojnë këtë gjak derdhje? Përse? Ja edhe përgjigja: Përse kjo shkencë e dituni nuk ishte veshun me petkun e

religjionit kristian por me atë pagan, tuej e largue Frymën e Shenjtë prej shkollave të mesme sikurse qeverinat t' ona qysh se u ba Shqipnija e deri në ditët e soçme.

Përfundimi asht se vetëm me anën doktrinës së Jisuit dhe mësimit të Tij Hyjnuer mund të këputen verigat e rrobniisë dhe të mosmarëveshtjeve, tuej largue frymën barbare e në vend të saj tuej vue Frymën e Shenjtë. Edhe populli i ynë i vorfën u ba sakrific i disave, në zembrat të të cilëve nuk ishte Fryma e Shejtë. Por populli ynë asht i zoti të rojë, ay don të jet i lirë dhe i pamvarun shpirtnisht, don të përqafojë kulturën të veshun me petkun religjioz, që t' i pregatiti vedit ditë ma të lume e ma të mira për jetën e tij shprestare.

Atëhere liriya e jonë shpirtnore dhe drejtësija do të jenë të forta e të qindrueshme po kje se bazohen në Frymën e Shenjtë dhe në Doktrinën Shpëtimtare. Dhe ajo Frymë e Shenjtë, që aso kohe zbriti mbi Apostojt, për kujtim të së cilës kremtojmë Pentikostin, lusim qi të ndriçojë përfaqësuesit e popujvet qi të vijë sa ma parë një paqe e bazueme në liri e drejtësi shpirtnore si mbas fjalëve të Ungjillit: «*Aty ku asht Fryma e Perëndisë, atje asht liriya*» (II Korinth. 3,17

Prof I. B.

MENDIME T' ARTA

Çdo program arësimor, që nuk i jep vendin e parë mësimit të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë pregatit çkaterimin moral të brezit të ri.

* * *

Ipokrizija është vdekja e shpresëtarisë dhe e fesë.

* * *

Ajo shoqëri është pa dyshim më e përsosur dhe më e lumtur, e cila përbëhet prej familjesh që çquhen për moralin e për karakterin e mirë.

Nga kryeveprat e Atërve të Shejtë

Sjellja e njeriut të përlës

Si do të mundim vallë të largojmë nga neve zgjedhën e rëndë të kryelartësisë dhe të pajosemi me përlësinë shpëtimtare? Këte do t' a bëjmë, në qoftë se do t' ushtrojmë përlësinë në çdo sjellje t' onë dhe në çdo veprim e nuk do t' i lejojmë kurrë kryelartësisë të hyjë e të pushtojë shpirtin t' onë. Me të vërtetë është vënë re, se shpirti i njeriut zakonisht asimilohet e bëhet si ato që mendon e studion, mer trajtën e formën e atyreve që ushtron e që bën, dhe më në fund konformohet me ato plotësisht.

Prandaj pra çdo gjë, dhe ato më të voglat, duhet të drejtohet e të frymëzohet prej frymës shpëtimtare të modestisë e të përlësisë: edhe trajta t' onë e jashtme, edhe veshja edhe, të ecurit, edhe të ndenjurit, edhe çdo gjë tjetër le të jenë regulluar në mënyrë krejt modeste. Gjithashtu edhe fjalët, edhe këngët, edhe shoqërimet me të tjerët duhet të kenë si qëllim përlësinë dhe jo mburjen. Në kuvendimet të mos përdorësh kurrë fjalë sofistike dhe të shesësh mendje, që të lavdërosh vehten; të mos e transformosh zërin t' ënd, që t' a bësh me pahirë të bukur e të ëmbël, për të shkakëtuar habitjen e të tjerëve; të mos përdorësh fjalë të mëdha; përkundrazi të shkurtosh e të largosh çdo gjë, që mund t' a ushqejë kryelartësin' e mallkuar.

Për veç këtyre duhet të jesh i mirë kundrejt mikut t' ënd, i butë kundrejt shërbëtorit, zemërgjërë kur ke të bësh me njerës gojë-prishur, mëshirëplotë dhe filantrop për të vobektit e njerëzit e ulët, ngushullonjës i atyre që pësojnë dhe që vuajnë. Të shkosh dendur në njerëzit që ndodhen në mjerime, të mos përbuzësh asnjë nga njerëzit, qoftë dhe atë më të dobëtin, të jesh i ëmbël në kuvendimet me shokët, i ëmbël dhe fytyrëqe-

shur në përgjigjet, i butë kundrejt çdo njeriu. Mos lakmo të tregosh vepra të mira që mund të keshë bërë, me qëllim që të shkaktosh lavdërime për ty; gjithashtu edhe të tjerëvet mos u jep leje që të të lavderojnë e të të ngrehin gjer në qiell.

Të mirat që mund të kesh, përpiqu t' i mbulosh e t' i fshehësh, sa të jetë e mundur më shumë; për të metat përkundrazi të bëhesh ti vetë paditësi dhe akuzonjësi më i rebtë. Ti i pari të vërsulesh kundër veseve të tua dhe të mos presësh kurrë t'a bëjnë këte punë të tjerët, dyke imituar kështu njerin' e drejtë të shkrimit të Shenjtë (siç thotë libri i Proverbevet) dhe shembëllën e Job-it, i cili pati kuxim të pohojë gabimin e tij përpara turmës së qytetit.

Mos ji i rebët në qortimet që mund t' u bësh fajtorëvet, as të mos kritikosh me rëmbim ose të dënosh tjatrin për faje të vogla, si kur ti të jesh e drejta vetë dhe pa as një gabim. Përkundrazi të përpiqesh që t' i përmbledhësh ata që bjenë në gabime, t' i këshillosh e t' i ndreqësh shpirtërisht ashtu siç na këshillon apostul Pavli, dyke u-kujdesuar njëkohësisht që ti vetë të largohesh nga çdo gabim e nga çdo mëkatë. Me këto sjellje, vëlla, do të mundësh të shpëtosh nga egoizma që sjell, siç dihet, aqë shumë mjerime, dhe të fitosh përlësin' e mo-destinë shpëtimtare.

(Shën Vasili).

Nënë mprojtjen e Perëndisë

Sa herë të bën dikush no një të keqë dhe të sjell hidhë- rime, mos kërko t' i a marësh ti vetë hakun, po lere në dorë të Perëndisë, i cili sigurisht do t' a regullojë punën shumë më mirë, nga sa dëshëron ti. Për ty, që je i krishter i vërtetë, kjo detyrë të mbetet: *t' i lutesh Zotit për atë që të bëri të ligë*; e sa për punën se si duhet të gjykonet ay, Perëndia të thotë që t' ia lesh Atij t' a gjykojë e t' a dënojë.

Ti vëlla, kurrë nuk do të mundësh t'a mprosh vehtën aqë mirë, sa të mpron Perëndia; mjafton vetem që t' ia ngarkosh punët Atij, të mos kërko hakmarje kundër armikut t' ënd dhe prej Tij të presësh vendimin me bindje e me qetësi. Kurdo-herë pra të vihesh nënë mprojtjen e Perëndisë; asgjë nuk mund

të të shpëtojë, në rast se mungon dhe largohet prej teje kujdesimi dhe mprojtja e Zotit; e sa për armiqtë, e thomi edhe një herë, detyra e jonë është t' i falim, të mos kërkojmë t' ua shpërblejmë me të keqe, t' i lutemi Zotit që t' ua falë mëkatat e mprojtjen t' onë kundër tyre t' ia lemë Perëndisë, i cili edhe neve na mpron, edhe ata i gjykon, ashtu si e kërkon drejtësia e Tij.

Prandaj ca njerës nuk mendohen mirë. Shumë nga këta d. m. th. ndonse armiqt i ftojnë që të pajtohen e t' i harojnë armiqësit' e vjetra, nuk duan të pajtohen, por u pëlqen të mos kenë më marrëdhënje me armiqt e tyre. Unë shumë herë u kam folur këtyre dhe i kam këshilluar që të heqin dorë nga këto mendime dhe të pranojnë dorën q' u zgjatin armiqtë. Po këshillat e mija, siç po shoh, shkojnë fare kot. Dhe dini se ç' arësye venë përpara? Nuk duam, thonë, të pajtohemi me armikun, nga frika se mos ky bëhet m' i rezikëshëm në t' ardhmen, se mos bëhet m' i keq e se mos na përbuz e na urejë më shumë.

Për vëç kësajë thonë dhe këte: Në se unë i zgjat dorën armikut dhe kerkoj prej tij të pajtohem, kam frikë se mos të kujtojë bota se po e bëj këte nga frika ose nga dobësia.

Po tërë këto janë arësye të rema dhe pretekste me qëllim që me anën e atyre të mbulojnë e të fshehin dëshirën e tyre të vërtetë. Po më kot mundohen. Se syri i Zotit q' i sheh të gjitha, kupton fare mirë mendimin e qëllimin t' ënd të vërtetë. Kur gjykatësi, që do të të gjykojë, bindet për qëllimet e tua të mira, atëhere mos mer fare parasysh se çdo të thotë bota për ty. Sa për ate që thua, se ke frikë se mos armiku bëhet m' i rezikëshëm, mëso mirë se armiku nuk do të bëhet m' i keq, në rast se ti pajtohesh me atë. Se edhe njeriu m' i lik i botës, kur do të shohë se ti e harrove të keqën dhe i zgjatë dorën, do të pendohet për të ligën që të bëri, do t' a ndjejë fajin, qoftë sikur edhe të mos e çfaqë përpara të tjerëvet, do të habitet me sjelljen t' ënde të lartër e do të ndjenjë një respekt të fellë kundrejt teje. Po edhe në rast se ay do të vazhdojë të qëndrojë në ligësin' e më parëshme, edhe atëhere mos u-çqetëso, se ka për të gjetur nga Perendia dënimin q' i meriton.

(Gojarti)

Përkth prej Shprestarit



Në vënt të predikimit

VARTIMEU

Një ditë të bukur prenvere, pranë portës së madhe të Jerihonit rrinte mbë një skamni të vogël trikambëshe një burr në lule të moshës. I lartë sa një deve e shëndosh dhe i trash sa një ari plak. Faqet e tij ishin të kuqe si trëndafili i mëngjezit. Vetën ndën vetullat dukeshin dy netë të përjetëshme, dy shpella të errëta, dy vryma boshe. Ishte i verbër. Quhej Vartime, i bir' i Timeut.

Banorët e Jerihonit e njihnin prej kohe, kur si fëmi nuk lente pemë për pemë pa trazuar, kur si i ri plot gjallëri shkakëtonte admirimin e të rejavet, kur si trim u-vu nën flamurin e një ushtërije të huaj dyke mbushur qytetin me famën e trimërivet të tij të shumta dhe kur si rob u-kthye i vërbuar në vatrën e fëmijërisë të cilën e gjeti të shkretë

Banorët e Jerihonit e njihnin mirë dhe u vinte keq për të. Gjithsejçili i jepte diçka. Peshkatori një peshk. Bujku një copë bukë. Tregëtari ndonjë të hollë. Njëri një dhuratë, tjetri një fjalë të mirë.

Kur nuk kalonte ndonjë q' andej, Vartimeu hynte në mendime. Sillte ndërment kohën kur ishte fëmi, kur ishte i ri, kur ishte në ushtëri, kur luftonte dhe si ra rob në duart e armikut.

I dridhej mishi sidomos kur kujtonte vendin e Haldeasvet, ku qe zënë prej armikut, i urijsëm dhe i çveshur e qe lidhur me zhinxhire këmbë e duar e qe hedhur në burg e qe dënuar me humbjen e dritës së syvet për jetë pse kish luftuar kundra Haldesë. I kalonte ndërment koha kur i lidhën duartë pas, kur e ulën pranë një froni prej mendafshi ku rrinte me kryelartësi një gjykatës i veshur me purpër që mbante në të dyja duart nga një shtizë me majën të mrehur si një gjelpërë.

Gjykatësi e shikoi mirë në sy me një vështrim qërtonjës. Ngriti pastaj të dy shtijejat dhe, pa pikë mëshire, i a futi në sy. Oh! ç' dhimbje e ç' mjerim!. Qysh atëhere nuk sheh më as rrezet e diellit, as petalet e lulevet, as brezin e zonjës në qiell. Errësirë dhe vetëm errësirë . . .

Ç' deshirë kishte i ngrati të shihte pak dritë, pak bukuri.

Si dallëndyshja për prenverën! Si fëmija për gjirin e s' ëmës!
Si i sëmuri për shëndetin! Si robi për lirin.

Siç notonte pra një ditë ay në ujën e këtyre mendimevet dhe ndjenjave, një këng' e bukur dhe e ëmbël e solli në vete. Një këngë engjëjlore si prej strumentash dhe organesh të mirë-zëshmë. Zgjatë veshin dhe ç' të dëgjojë?

— Osana!

— Osana Krisht!

— Osana, Bir i David-it!

— Osana Mësonjës!

— Osana Mjek i shpirtvet dhe i trupevet!

I verbëri këceu prej gëzimit. Këto zëra i dhanë të kupëtojë se te porta e Jerihon-it po afrohej Çudi-bërësi i math i Gjenisaret-it, Jisu Krishti, bashkë me nxënësit e tij dhe populli e pritte me gëzim dhe kënga.

Dhe këjo ngjarje e papritur ndezi shpresën në zemrën e Vartineut. Galileas-i kish falur dritë në aqë të verbër; ishte e mundur të mos i a falte dhe Atij!

Prandaj kur ndjeu se gjindja po i afrohet portës, u-ngrit nga skamnjia, u-ul në gjunj dhe nisi të bërtas pa pushim:

— Jisu kij mëshirë për mua, kij mëshirë! Bir i David-it përdëlle-më.

Syt e Jisuit e panë, sepse ata i kërkojnë të përvuajturit dhe veshët e dëgjuan, sepse ata e dëgjojnë me një herë zërin e dhimbjes. Dhe zemra e tij u-mbush me dhimbje për këte shpirt të munduar, për këtë trup të math por pa dritë, sepse zemra e tij është një fron mëshire. Edhe qëndroi me një herë. Por atë kohë, disa nga gjindja u-kthyen nga Vartimeu dhe nisën t' a qërtojnë:

— S' të vjen turp që turbullon Mësonjësin!

— Pusho, njeri i çuditshëm dhe mëkatar! Ik q' andej!

Por Vartineu bërtiste më shumë.

— Jisu, kij mëshirë për mua! Bir i David-it përdëlle-më!

Jisuj atëhere i thotë nxënësit më të ri që ishte nga ana e djathtë.

— Joan sill-e këtu.

— Me një herë Mësonjës, u-përgjegj nxënësi.

Dhe dyke përçarë gjindjen Joani, vete te i verbëri që rrinte në gjunjë e i thotë:

- Kij kurajë, mik. Zoti të dëgjoj.
- Dhe ç' thotë Zoti? pyet i verbëri.
- Të ngrihesh dhe të viç me mua.
- Ku?
- Para Zotit.

— Me një herë, tha ay dhe, duke u-ngritur në këmbë, hodhi poshtë rroben që kishte, dhe i thotë Joanit:

- Shkojmë, o njeri i Perëndisë.

Dhe Joani dyke e marr për dorë, e sjell te Jisui ndërsa ay vazhdonte të thërresë:

- Jisu , kij mëshirë për mua. Bir i David-it përdëlle-më.

Si u-afrua Vartimeu, Jisui e pyet me ëmbëlsi:

- Bir, ç' kërkon prej meje?

— Të shoh o Zot.

— Beson ti që un munt të të bëj të shohësh?

— E besoj dhe e rrëfej.

Jisui vuri atëhere gjishtin e math në gjuhë, preku pastaj syt e Vartimeut dhe i thotë me zë të butë:

— U-bëftë pas besës t' ënde.

— Lavdi më ty o Zot, lavdi më ty, bërtiti atëhere me gëzim Vartimeu, dyke rënë në gjunjë para Zotit, se syt e tij u-hapën më një herë si lulja e mbrëmjes pas perëndimit të diellit. Bërtiste dhe puthte këmbët e Jisuit, i mahnitur nga rrezet, nga lulet, nga njerëzit dhe nga natyra e tërë.

Zoti i përgjigjet:

— Bir, besa jote të shpëtoi! dhe vazhdoi rrugën.

Vartimeu nuk pushoi së lavdëruari Perëndinë dhe bashkë me të dhe tërë gjindja tjetër, e habitur prej çudisë. I verbëri u-bë kandil drite shpirtërore . . .

* * *

Lut-u dhe ti këndonjës i dashur që të të çelnjë Zoti syt e shpirtit për të parë bukurinë e jetës pas Ungjillit e për të ecur n' udhën e virtytit e të besës që të shpie në lumtërin e vërtetë.

B.

N. Berdiaeff

Ideja Fetare Ruse

I.

Djelli lind në Lindje. Dhe nga Lindja vjen tërë drita fetare. Lindja është gjiri i të tëra fevet dyke u-përfshirë edhe feja e Krishtere.

Lindja është vëndi i zbulësës, Perëndimi vëndi i kulturës. Lindja qëndron më afër burimevet të nisjes së jetës, është mbretërija e gjenezës. Bota ka qënë krijuar në lindje që të çfaqet në Perëndim. Në Lindje duhen kërkuar burimet fetare. Në Perëndim feja është para së gjithash dhe mbi të gjitha një kulturë fetare e shoqërisë . . . Në Lindje Perëndija flet me njeriun drejt për së drejti, faqe për faqe. Në Perëndim janë shumë ndërmjetës. Lindja në esencë të saj është shumë më fetare se Perëndimi. Ky dallim gjeografik s' është një dallim fizik; pasqyrohet dhe simbolizon një ndryshim jete shpirtërore. Lindja dhe Perëndimi janë dy bota shpirtërore në jetën e njerëzisë, masa të shpirtit. Më tepër se në popujt e Perëndimit, koncepti i jetës dhe i botës u-ruajt aq nër popujt të krishterë sa edhe nër ata jo të krishterë të Lindjes; kudo gjëjmë gjyrma fetare me rëndësi . . .

Natyra e tokës Ruse është një element i dorës së parë për atë që dëshëron të kuptojë shpirtin Rus. Gjeografia materiale e një populli s' është tjetër veç pasqyra e shpirtit të tij. Dhe kjo s' është një gjë e rastit, që një popull rron në fushë ose në mal, në det ose pranë ujrave ku lëvizin vaporet, në jugë o në veri. Jugu ose veriu, malet, fushat, detrat, lumejt, ndodhen në shpirtin e popujvet. Pusurija dhe fushat e gjëra të

Rusis si dhe pakufishkërija e hapësiravet janë masë e brëndësh me e popullit rus. Dhe prap s' është gjë e rastit që qopulli rus ron mbi një tokë të pakufishme, me orizonte të pa mbarim, pa kufi të caktuar mirë; e tillë është edhe gjeografia e shpirtit rus. Ay shpirt ka vënde të hapëta pa mbarim, një hapësirë pa kufi, një mungesë caktimi kufish: orizonte pa mbarim që hapen për së largu për tek ay. Shpirti i popujvet të Perëndimit është i shtrydhur; kudo ay takohet në kufizime dhe kufira. Karakteristika esenciale e Perëndimit, është të ndarët, pjestimi dhe ndryshimi. Në formën e tokës, popujt e Perëndimit kanë kufi edhe anë të mirëcaktuara; malet, fushat, lumejt janë fikse. Në Rusi toka të jep lirinë. Rusi vuan nga pakufishmërija dhe nga hapësira e tokës së tij. Perëndimi vuan nga shtrydhëshmërija e tokës.

Mundet të thuhet se toka është një kategori e shpirtit rus

Rëndësija e tokës për shpirtin rus, për njeriun rus, është me të vërtet e gjërë. Rusi përkufizohet krejtësisht në lidhje me tokën. Nuk e zotëron njeriu tokën, por toka njerinë. Populli rus s' beson tepër në fuqin e pasjes, në gjërësin dhe në qëndrueshmërin e tokës. Ay e quan veten si udhëtar në këtë tokë dhe pret mirëbërjet e saja. Njeriu i Perëndimit e quan veten të zot të tokës; beson në detyrën edhe mbrojtjen e kësaj; qëndrimi i tij kundrejt tokës është aktiv. Toka e tij s' është pa kufi, por krejt e kufizuar, çdo gjë është e rregulluar mbi një vënd të vogël.

Armiku është gjithnjë afër njeriut të Perëndimit; që këtej dhe nevoja e mbrojtjes. Që këtej intensiteti i kulturës perëndimore. Te rusi ndryshojnë të tëra. Toka është e gjërë dhe prodhimtare, hapësija e pakufishme bëhet e ndijëshme reth tij. Toka Ruse ofron gjithmonë një strehë kundër tërë armiqvet. Që këtej rjeth karakteri i gjër i konceptit të jetës në Rusë, nevoja e dobët e një kulture. Në Perëndim çdo gjë është e veçuar me ndarje; çdo vënd është i caktuar; s' ka hapësira të mëdha. Força dionisiake elementare e jetës duket të jetë çpui-zuar në Europë. Ky është përfundimi i një kulture tepër të gjërë, i një aktualizimi perfekt. Civilizimi europjan është tepër Aristotelik në principin e tij; është themeluar mbi organizimin e lëndës. Te populli rus janë akoma fuqira të gjëra të fshehta;

elementi diosiniak i parë s' është prishur fare. Neriui i Perëndimit sheh qëllimin dhe kuptimin e jetës në posedimin e elementit, në pushtimin e elementit, të detyruar vullnetit dhe veprimtrisë së organizuar. Elementi i jetës është kallur në jetën e përditëshme, në një ekzistencë të rregulluar, të kultivuar dhe të civilizuar.

Si edhe popujt më të shumtë të Lindjes, populli rus rron jetën fetare. Ay s' është larguar akoma nga rythmi fetar i jetës, me tërë vjetet e shumta të kaluara të historisë së tij.

Populli rus ka një fushë edukate të kufizuar; nuk ka një moral të një shekulli; terma e së drejtës është për të e pacaktuar. Besa nuk i është ndriçuar prej thelogjisë. Populli rus ka patur shënjtore të mëdhenj, ka jetuar prej kultit të shënjtërisë dhe të shënjtorevet; ay nuk e ka njojtur ngjitjen e domosdoshme pas të mirave të tokës dhe në thellësinë e shpirtit të tij u-drej-tua drejt Jerusalemit qiellor.

Rusia ishte quajtur «Rusi e shënjtë», jo se populli rus ka qënë i shënjtë — populli ishte shumë mirë mekatar — por sidomos pse jetonte prej spiritualitetit, prej idealit të shënjtërisë, prej venerimit të shënjtorevet. Populli rus nuk pati idealin e popujvet telegjentë, si kombet e Perëndimit, por më i fortë ka qënë te ay idealit të shënjtërimin. Ay ka qënë lidhur me vetet e tij me jetën tokësore dhe me anë të virtytevet të tij drejtohej për qiejt. Ky është edukimi që i ka dhënë besa Orthodhokse. Njeriu i Perëndimit u-ngrit me anë të virtytevet të tij në një organizim të jetës tokësore. Aspiratat fetare të shpirtit kombëtar rus janë çfaqur në të gjithë kohën e historisë. Dhe në shekullin e XIX-të në mentalitetin rus, çfaqet një fuqi e vetme. Mendimi, letërsia ruse nuk ka qënë kombëtare veç se në masën e tentencavet fetare.

(vazhdon)

MENDIME T' ARTA

Buka e thatë që hahet me paqe dhe qetësi shpirtërore, është më e ëmbël, se sa gjëllët e shumta që shrohen në tryezat e shëtipivet, ku mbretëron grindja dhe zënjet.

Fjalë Ngushëllimi

DURIMI

Në Dhiatën e Ré bëhet shumë herë fjalë për durimin, të cilin detyrohen t' a kenë të gjithë ata njerës që duan t' i pëlqejnë Perëndisë dhe të marrin çpërblimin e jetës s' amëshuar.

Ç' është durimi? Durimi është ajo fuqi shpitenore, me anën e së cilës njeriu përballon me kuxim gjith hidhërimet dhe kundërshtimet e kësaj jete. Durimi është që të sillëmi me zemërgjërësi në padrejtësitë që n' a bëhen, pa patur kurrë kundërshtim. Durimi është që të presim me besim e siguri mbushjen e porosive të Zotit, pa u-tronditur në pengesat që n' a çfaqen dhe pa dyshuar për gjith' ato që thotë dhe zotohet Perëndija. Pa pasur këtë durim nuk' është e mundur t' i pëlqejmë Perëndisë, sepse nuk është e mundur që pa këtë virtut të mbetemi besnikë dhe të bindur në dëshirën e Perëndisë.

Në jetën t' onë do të çfaqen kaq e kaq raste të tilla, do të çtillen mijra ngjarje të pa ditura dhe shumë herë të pa pritura, sa vetëm virtuti i durimit mund të n' a mbrojë nga avusha e mërzitjes dhe e dëshpërimit dhe të n' a mbajë në durimin e Perëndisë.

Kështu pra, për dita shikojmë se sëmundja, vdekja, dhëmbja, loti, psherëtimi dhe hidhërimi janë shortë i gjithë njerëzvet që rrojnë në tokë, dhe as ndonjë prej tyre, sa do lart që të ngjitet, nuku do të mundnjë t' i largonjë mjerimet dhe mundimet, vuajtjet dhe hidhërimet pa pasur durim. Në jetën t'onë, pa drejtësitë dhe ndjekjet çfaqen përdita. Neve vetë shumë herë, qëndrojmë dëshmorë përpara padrejtësive dhe shohim se të vobektët nguten, të pa fuqishmit dërmohen, jetimët vuajnë, dhe shpresëtarët përbuzen me mënyra të ndryshme.

Dhe Perëndija zotohet se do të ngushëllojë të hidhëruarit dhe do të mbrojë gjith' ata q' u bëhen pa drejtësi; e në qoftë se ata do të mbeten besnikë në dëshirën Tij, do t' ja çpagojë me pa vdekshmëninë e jetës s' amëshuar. Mirë po shumica e njerëzve në disa raste, dyke mos pritur të plotësohen zotimet e Perëndisë, skandalisen, s' durojnë, mërzhiten kundra paramendimit hyjnor, dhe më së fundit e këputin lidhjen e të bindurit në ligjin e Perëndisë. Mirë po këta njerës dyke mos patur se ku të mbështetin zëmërat e tyre, këtu heqin o vuajnë me tepër, rihen nga errat e tërbuara dhe sillen në mes të detit të jetës si ajo anija pa timon, e destinuar të prishet dhe të mbytet. Ja sepse në Dhiatën e Ré, në Ungjillin, bëhet shumë herë fjalë për durim. Ay, Zoti t' onë tha: «Në durimin t' uaj fituat shpirtin» (Lluka XXI, 15). Apostoll Pavli thotë të rendim me durim në luftën e virtutit (Ebre. XII, 31), sepse me durim, thotë kemi nevojë që të bëjmë dëshirën e Zotit (Ebre. X, 6).

Shën Jakovi jo vetëm porositi që puna e durimit është e mbaruar (I, 4), po dhe i quan të aftëshmë për të lumëruar ata që kanë durim. «Lumërojmë, thotë, ata që durojnë» (V. II).

Me këtë mënyrë kuptojmë vleftën dhe nevojën e durimit, pa të cilin rrezikohemi të coptohemi dhe të mbytemi në pëllgun e jetës. Po si është e mundur të marrim fuqi (kurajo) në durimi?

Murgu.

MENDIME T' ARTA

Neriu është prej natyre fetar; u-lind që të besojë dhe të shpresojë, ka nevojë të besojë te Perëndia e t' adhurojë atë. Në fellësiat e shpirtit t' onë ndodhet një dëshirë e fshehtë, e cila gjithënjë e kërkon Perëndinë.

* * *

Në për shtëpit' e njerëzvet të drejtë mbretëron gjithënjë gëzim e fuqi, kurse pemët e të pa drejtëvet dhe atyre që nuk janë shpresëtarë do të humbasin shpejt a vonë.

I BIRI I SHTËPISE SË DAVID-IT

(Rrëfenjë)

XXIV

Hidhërimi i përgjithëshëm për arrestimin e Jisuit — Jisui, Mesia i vërtetë nuk ishte i denjë për një keqpërdorim të këtille — i ati i Adinasë beson në Jisunë — Letra e tij e gjatë q' i dërgon së bijës — Jisui i dërguari i Zotit — Jisui themeloujësi i lumtërisë së popujve — Jisui reformator i botës — Gëzimi i pa masë i Adinasë.

I dashur baba,

Si kundër të shkruanja në letrën e fundit, këtu tërë ata që i gjejnë punët mirë dhe me pa anësi të plotë, janë prekur fellë nga arrestimi i Jisuit prej Farisenjvet dhe nga sjellja brutale e këtyre të fundit. Me të vërtetë, baba, është për t' ardhur keq, se njerës që meren me studimin e shkrimeve të shënhta dhe q' e quajnë vehten si përfaqësonjës së dëshirës së Jehovasë dhe si interpretonjes së shpirtit të ligjëvet, është për t' ardhur keq, thom, se njerës të këtille ndjekin pa mëshirë Jisunë dhe sillen kundrejt Tij në një mënyrë aqë t' egër, si kundër të ishte Ky një nga kriminelët më të mëdhenj të botës! O Zot! Kujt i sillen kështu? Atij që tërë jetën e Tij e kaloi dyke predikuar parime dhe të vërteta që s' kanë dalë gjer më sot nga goja njeriu; Atij q' u-përpoq t' u tregojë njerëzve rrugën e vërtetë; Atij që luftoi mëkatën dhe të ligën pa mëshirë dhe më tërë fuqit' e Tij; Atij që shërovi të sëmurët, që ngushëllovi të hidhëruarit, që mprojti të vobekëtit, që përkrahu të dobëtit; Atij

që bëri vepra e çudira, të cilat për herë të parë i sheh bota; Atij që ushtroi në jetën e Tij gjithënjë virtytin e të mirën; Atij që është personifikim i së mirës, i së drejtës dhe i së vërtetës; Atij nga mëndja e të cilit nuk ka shkuar nonjë mendim i keq, nga goja e të cilit s' ka dalë kurrë nonjë fjalë e keqe edhe dora e të cilit s' ka bërë tjetër gjë, përveç se të mira, të mira, të mira Atij që më në fund provohet nga shkrimet e shenjta dhe nga tërë shënjat e tjera se është Mesia i vërtetë i popullit t' Izraelit, i dërguar nga Zoti që të sjellë mbretërin' e Perëndisë dhe shpëtimin jë vetëm të popullit të zgjedhur, por edhe të popujve të tjerë që jetojnë në çdo kënd të tokës. Ja pra pse hidhërohem i të gjithë, i dashur baba, dhe pse dridhem i mos Perëndija dërgojë nonjë poterë kundër popullit t' onë, që kuxoi të verë dorë mbi birin e Tij të pa mëkatëshëm e të Shenjtë.

Në mes të këtij hidhërimi, që më ka çurbulluar mëndjen e shpirtin, letra e jote që mora këto ditë më kallu një kënaqëci shpirtërore të fellë dhe ka qënë, mund të them, një lloj ilaçi që më lehtësoj mjaft nga vuajtjet që më rëndojnë. Më shkruan, baba i dashur, se ti më në fund besove në Jisunë dhe i mbështetur mbi shkrimet e Shenjta, si edhe mbi jetën e kulluar e mbi çudirat që ka bërë profeti, u-binde plotësisht se ky me të vërtetë është i dërguari i Perëndisë, është Mesia i pritur prej kohe q' erdhi të shpëtojë popullin e zgjedhur të Jehovahsë. Më kënaqi për së teprí edhe komplimenti i vogël që më bëre në fund të letrës, dyke thënë se në këtë kthimin t' ënd paskam ndihmuar mjaft edhe unë, e cila me anë të letrave të mia të shtyra për një studim më të imtë të profetive e të pjesave të tjera të Shkrimit të shenjtë që flasin mbi Mesian. Më pëlqen prandaj t' a këndoj shumë herë këtë letër dhe disa paragrafe bile të saj i kam lëçitur aqë shumë dhe me aqë kujdes të math, sa i kam mësuar më gojë dhe jam në gjendje t' i përsëris fjalë për fjalë në çdo orë e në çdo çast.

« Ti e di moj bijë, më shkruan, se sa e kam respektuar ligjin t' onë të shenjtë dhe me sa fanatizmë kam ruajtur porosit' e fesë s' onë. Kam qënë dhe jam Izraelit besnik dhe shërbëtor i bindur i të madhit Jehova. Si studjonjës i kujdesëshëm i shkrimeve kam përbuzur gjithënjë dhe kam luftuar çdo

predikim e çdo doktrinë, që më dukëj se mund t' a prekte ose t' a kundërshtonte sistemin e dogmave t' ona. Pikërisht për këte arësye kur më shkrojte për herë të parë për Jisunë, unë ndjeva një tronditje dhe një... pse t' a fsheh? zëmërim shpirtëror kundër këtij, se pse e mora si një nga të shumtët pseudoprofetë që janë çfaqur herë pas here vetëm e vetëm për të turbulluar popullin t' onë të shkretë. Prandaj pra në përgjegjen e parë që të bëra, të porositnja t' ishe shumë e rezervuar në këto çështje dhe të mos tërhiqej nga predikime të rea, që nuk pajtohen me doktrinën t' onë. Po mb' anë t' atër i shtytur unë nga letrat e tua fillova të këndoj edhe një herë e me *kujdes më të madh* librat t' ona të shënjtja, e si domos ato pjesa që flasin gjër' e gjatë mbi personin e Mesiut e mbi rolin që do ta lozte ky në botë

I këndova pra këto me kujdes e me pa anësinë më të plotë, i peshova mirë dhe i krahasova me predikimet e me veprat e profetit të ri, ashtu siç m' i përshkrojte ti dhe siç m' i vërtetuan këtu dhe njerëz të tjerë, q' i kishin parë vetë mirë bërjet dhe çudirat e Jisuit. Ky studim pra e ky krahasim m' a ndriçoi mendjen dhe nxori në shesh këtë të vërtetë: *se terë profetitë shpjegohen fare mirë dhe vërtetohen plotësisht në personin e Jisuit, se jeta dhe veprat e këtij paralajmërohen e për-caktohen çuditërisht prej profetëve t' anë dhe se edhe vuajtjet e martirizimet e Tij shënohen prej atyre me hollësitrat më të vogëla.*

Mora pastaj parasysh veprat e Tij, e sidomos çudirat e ndryshme që ka bërë herë pas here. Njerës të verbër ka shëruar dhe u ka dhënë dritën; të çalë dhe paralitikë (ulokë) i ngriti mbë këmbë; epilektikëve u a çkuli demonin e keq; e më në fund njerës të vdekur, si Lazari këto ditët e fundit, ka ngritur prej varrit dhe u fali përsëri jetën për gëzim të familjeve të tyre dhe për habi e admirim të botës, q' i ka parë këto çudira dhe q' i ka dëgjuar. U-mendova pra shumë kohë dhe thoshnja me vehte: A është e mundur t' i bëjë këto vepra dorë njeriu me fuqit' e kufizuara të tij? Po t' ishin të lehta këto punë, pse nuk i bëri nonjë prej të diturve t' anë që tundën e shkunden si dijetarë të fortë të ligjit hyjnor dhe si përfaqësonjës të vërtetë të të madhit Jehova? Pse nuk kanë bërë vepra të këtilla pro-

fetët t' anë të shumtë, që janë çfaqur herë pas here gjatë historisë së popullit t' onë? Cili pra njeri, dyke gjykuar këto me paanësin' e duhur, do të kuxojë të thotë se nuk është i dërguar i Zotit Jisui, i cili ka bërë gjëra që s' i ka bërë gjer sot dorë njeriu dhe ka predikuar të vërteta që s' i ka dëgjuar gjer sot bota e tërë?

Këto mendime pra, bijë e dashur, më bënë të besoj bashkë me ty se Jisui është i dërguari i Perëndisë, se është Ay që po e presim prej kohë për të shpëtuar popullin t' onë të shumë vojtur e se është Ay që do të sjellë shpëtim e dritë në tërë botën. Kam formuar bindjen, se Ay ka për t' i shtirë themelet e lumtërisë së popujvet, Ay ka për t' i vëllazëruar kombet e ndryshme, Ay ka për të sjellë mbretërin' e qiellit në tokën t' onë të mjerë dhe Ay me anën e doktrinës së Tij hyjnore do t' a çdukë të ligën nga kjo botë dhe njerëzit do t' i bëjë engjëj të vërtetë. . . . » Kur i këndoj pra, baba, këto paragrafe të letrës tënde, më pushton një kënaqësi shpirtërore dhe një gëzim që nuk e tregoj dot me fjalë. Babaj i im besoi në Jisui! Babaj im këputi zinxhirat e fanatizmës verbonjëse të Judenjve kryefetarë! O sa lumturi për mua! Dhe tashi, baba, m' u-shtua më tepër malli që të të shoh, të të përqafoj dhe të rrojmë paskëtaj bashkë me lumturi e me gëzim, *dyke hymnuar* e duke falenderuar Perëndinë për shpëtimin që i fali botës me anën e Birit të Tij të Tërëshnjtë.

Bija jote e dashur

Adina

Mbarim.

MENDIME T' ARFA

O i mjerë njeri! Jeton dhe ndodhesh në mes të një shoqërije q' është plot me mendime të liga e me plane çkatërimtare. Do të mundësh të dalësh i pa prekur dhe i gjallë moralisht, në qoftë se do të kesh si udheheqës e si dritë Ungjillin e doktrinën e Tij.

Sjelljet t'ona ndaj pleqtë

Po kalonjam nga një katund. Nënë hijen e një fiku, një plak i ve-
nitur nuk' mërzitet të vazhdojë së nëmëruari ruazat, që heq me gishtë-
rinjt' e tija të thata; duket i dëshpëruar dhe herë pas here psheretit thellë
dyke lëshuar lote të thata prej syvet t'ija. J' u-afrova, e përshëndeta tue
i puthur dorën. Ay mori kurajo, më kërkoi emërin. J' a dhashë dyke -më
suar të tijnë dhe pastaj ngriti sytë dhe më thotë: «Bir, ti që më nderon
mua, Perëndija le të të ndihmojë qet' të nderojnë fëmija t'ënde». E pye-
ta pse ishte aqe i dëshpëruar dhe ay lëshoi dy lote të nxehta, psherëtimi
dhe m' u-përgjegj këto: «Kam vetëm një djalë që të më rrojë; bota më
nderon dhe dō; ay nderon dhe u-bën qefin të rinjve dhe të rejave, por
mu . . . ah . . . mua sa herë që vjen mbrëmanet më thotë . . . (dhe në
këtë moment plaku qan sikur është ndonjë foshnjë) «akoma s' ke vdekur?»
Nuk' më vjen keq për fjalët se vdekjen s' e kemi në dorë, as unë as ay,
por më vjen keq se dō të shkoj i dëshpëruar nga kjo botë, se njerëzia dō
thonë: eh! Dhe i biri i xha Kostës u-bë hairsës, nuk' i ngjavi tet! Sa
shëmbëll prekëse në sjelljen barbare të një djali kundrejt tet. Shën Pavli
thotë: «plakun mos e qërto, po mëso-e pors i atë të rinjtë pors i vëllezër,
plakat pors i mëma dhe t'rejat pors i motra me zemër të qërruar». (Timoth.5.I-2).

A nuk na vjen keq kur shohëm rrate të tilla? Kur shohëm pleq të
lëshojnë lote hidhërimi? Kur djem' e vajza nuk nderojnë dhe respektojnë
të vjetrit? Robat dhe këpuçët passi vjetërohen hidhen në plehrat, por nje-
rëzia nuk hidhen sepse dō të rrojnë deri sa Zoti t'i marrë. Pra, kushdō që
kuxon të shajë, të rrajë dhe të hidhërojë pleqtë është njeri i demoralizuar
dhe është për t' u-dënuar ashpërisht në gjykimin e fundit. Hidhërimi dhe
mundimet e një plaku, barazohen me një vrasje.

Nuk ka njeri më të ditur e të mençur, se ay që nderon, respekton,
dhe zbut zëmërat e pleqve. S' ka më gjë të ashpër se sa të lëmë një plak
të vdesë i dëshpëruar nga ofendime, sharje edhe goditje: por dhe s' ka
kënaqësi më të madhe kur një plak vdes i qetë pa dëshpërim, sepse dhe
passi të vdesë n' a ndihmon moralisht në gjithë reziket e jetës s' onë.

Prandaj, o vëllezër, kur shihni pleq, nderoini, bëni pjesë në fjalimet
e tyre qofshin dhe të pa kënaqëshme sepse kështu kemi për të përmbushur
një detyrë njerëzore q' u-afrohet asaj të Shënjtoreve. Kur shihni ndonjë
njeri që përdor pleqtë keqas, folini tue mos patur frikë, sepse vetëm tue
e sjellë në rrugë kini për të mbaruar detyrën t' uaj. Duhet t' a dini se
jeta e plakut është dy herë më e dobët nga e fëmijës, pasi s' ka fuqinë
trupore dhe m' anën tjetër ka mëndjen të provuar që ndjen qoftë dhe
sharjen më të vogël. Kurrë mos shkaktoni të prodhoni dhimbje në pleqtë,
sepse ngashërimet e tyre kanë për të goditur në jetën t' uaj, që të bëhet
me ah! dhe oh! Por bëjuni sikundër u-bënë Shënjtoret dyke nderuar dhe
irrespektuar të vjetrit.

Doni që të kini jetë përpara Zotit? Doni që të qetësoni shpirtin e
atij që është gati për udhëtimin e vdekjes në jetën përtej varrit? Shoqë-
rohuni sa më tepër me pleqtë, mos u-a prishni kurrë qejfin tue marrë pa-
rasysh, se vetëm druri i njomë ndreqet, për të moe shkakuar dëshpërim,
dhe për të përmbushur detyrën më të lartër njerëzore. Nënësi

Lajme Kishtare

Këshilli Mikst dhe Sinodhi i Shenjt.

Më 27 të muajit të kaluar, Kr. H. Tij Kryepiskopi i gjithë Shqipërisë Imzot Kristofori thirri në mbledhje të zakonëshme këshillat e larta të Kishës s' onë: Këshillin Mikst dhe Sinodhin e shenjtë, për të shqyrtuar çeshtje të ndryshme që i përkasin administrimit të pasurive kishëtare dhe gjendjes shpirtërore dhe fetare të komunitetit si dhe për të hartuar buxhetin preventiv kishëtar të vitit financiar 1948-49.

Celja e mbledhjeve u-bë me dhoksollogjin e zakonëshme, në mbarim të së cilës Kr. H. Tij Kryepiskopi me një fjalim të shkurtër kujtoi misionin a lartër të këtyre këshillave dhe theksoi nevojën që: «këte vit të punchet me shumë se çdo herë tjetër për forcimin e beses fetare të popullit t' onë që është ujëra nga konditat më kryesore për mbarëvajtjen e kombit Shqiptar». Preku pastaj gjendjen ekonomike të vajtuarshme të klerit dhe shtoi se këshillat e larta do t' amarin në studim këte çeshtje dhe do të kujdesen për të shtuar, me sa të jet' e mundur, shpërblimet e priftërinjvet në mënyrë që këta të mundin të kryejnë me zellin më të math detyrat e tyre shpirtërore.

Me këte rast Kryepiskopi u dërgoi telegrame falenderimi u'emër të këshillavet: Shkël. Mëkëmbësit të Mbretit Gjeneral Alberto Pariani, kryeministrit Shkël. Libohova dhe

Ministrit të Drejtësisë Shkëlq. Dr. Andon Kozmaçi.

Mbledhjet vazhduan gjer më 9 të këtij muaji dhe u-shqyrtuan: përmirësimi i gjendjes së Seminarit Orthodhoks të Tiranës si dhe të klerit Orthodhoks përgjithësisht, ndihmatje veçanta që u jepën Mësuësve të Besimit që shërbejnë në Shkollat Fillore të Shtetit, botimi i rregullshëm i Organit të Kishës «Jeta Kristiane» dhe përmirësimi i tij i mundëshëm në dukje dhe në përmbajtje; botime të tjera fetaromorale të përshtatëshme për familjen dhe rininë, ndihmat që destinohen për famulltarët Shqiptarë që shërbejnë ndër kolonitë kombëtare të jashtme, shpezimet për mbajtjen e korevet ndër qendrat kryesore.

Kujdesi i veçant i u-dha këtë vit kaptinës së buxhetit kishëtar që i përket ruajtjes dhe konservimit t' antiqitetetev bizantine, që çquajnë rolin istorik të Kishës qysh prej shekujvet të parë të krishtërimit në Shqipëri.

Gjith' ashtu, u-pa e arësyeshme që të suprimohen taksat fakultative ose familjare që deri sot rëndojnë mbi popullin Orthodhoks

Përgjithësisht, qëllimi kryesor i këtyre përpjekjevet të Këshillavet të malta kishëtare ka qenë forcimi i ndjenjës religjioze dhe afrimi sa më shumë i popullit me fenë, duke patur parasysh se gjithnjë dobësimi i ndërgjegjes fetare sjell fruta jo të mira dhe jo n' interes të shoqërisë, të Shtetit dhe të Kombit, sikurse është e vërtetuar kurdoherë edhe sot.

Kryepiskopi me Sino- dhin pranë Shkëlqesës Kryeministrit.

Me rastin e mbledhjevet sino-
dhike të përvitshme, Kryepiskopi
së bashku me anëtarët e Sinodhit
të Shenjt vizitoj Shkëlqesin e Tij
Kryeministrin Eqrem Libohovën, i
shprehu përshëndetjen në emër të
Komunitetit Orthodhoks dhe të
Kishës Orthodhokse Autoqefale të
Shqipërisë, dhe e falnderoj për in-
teresimin e nalt që ka treguar për
komunitetet fetare.

Gjatë kësaj audience u-bisedua
mbi misionin e lart që kanë funksio-
narët fetarë që të punojnë për lartë-
simin e ndërgjegjes patriotike dhe
fetare të popullit t'onë. Pastaj Krye-
piskopi i u lut Shkëlqesisë së Tij
që të ndërmjetësonj për lirimin e të
burgosurve dhe të internuarve po-
litikë për të cilët nuk ekzistojnë
dokumenta të mjaftueshme fajsiqe,
dhe përshkroj veçanërisht gjendjen
e të burgosurve në Porta Romana.
Shkëlqesija e Tij u-përgjij se nuk
është kursyer dhe nuk do të kur-
sehet dhe pas kësaj të pledonjë
për ata që janë të pafajshëm, tue
shtuar se komisioni që është for-
muar për shqyrtimin e kësaj çeshtje
do t' i shpejtonj punët.

Meshime

Të Djelën e Pendikostis që
është festa e themellimit të Kishës
së Krishtere, në Kishën Katedra-
le të Tiranës meshoj Kryehirsija e
tij Imzot Kristofori i rrethuar prej
klerit dhe prej një shumice të ma-
dhe populli. Në fjalimin që mbajti
pas këndimit të Ungjillit Kryehi-
rësija e tij tha midis të tjerash:

Historija e njerëzisë, qysh prej çfaq-
jes së saj në sqenën e botës, ka
qënë gjithmonë një luft' e vazh-
duarëshme midis spirititës dhe lan-
dës, midis idhes dhe forcës, midis
dritës dhe errësirës. Vetëm me një
përpjekje të parreshtur të elemen-
tevet të dritës dhe të përparimit
kundra elementeve të kundërta,
njerzija arriti në shkallën e sotme;
dhe në këtë përpjekje idheja ka
dalë gjithmonë fitimtare sado të
mëdha që të kenë qënë reaksionet
kundër saj. Kështu, në shekullin
e pesmëdhjet, kur Turqija invadoj
tokën e Atldhent t'onë, herou i yn
kombëtar vetëm me një grusht
shqiptarësh, të shpirtëzuar prej
idhes patriotike, u bëri ball nshtë-
revët të panumarta të armikut.
Dhe në këtë rast idhea triumfoj
kundra forcës. Por, provën më të
shkëlqyer të superioritetit të ele-
mentit shpirtëror na e jep theme-
llimi dhe përhapja e Krishtimit që
festojmë në ditën e sotme, mbasi
Feja krishtiane u-impozua jo me
fuqin e shtpatës, por vetëm me lar-
tësimin e doktrinës së saj dhe me
enthusiasmin e apostujvet të saj të
parë». Pastaj Kryepiskopi bëri një
përshkrim të reaksionevet që ndeshi
Krishtërimi nga bota Judhaike dhe
pagane dhe veprimtarin e tij të
frytëshme për lartësimin e njerzisë.
«Këto fakte, shtoj Kryepiskopi, na
inspirojnë shpresën se dhe në luf-
tën e madhe që po shvillohet sot,
cilado qoft ana që do t' a fitoj,
më në fund do të triumfonj idheja
përparimtare, dhe njerzija, e pen-
duar për mekatet e saj do të kërk-
konj rugën e drejt të shpëtimit të
saj, i cili gjendet vetëm në bashk-
punimin vllazënor të të gjithë kom-
bevet».

Po atë ditë, në Durrës meshoi H. Tij Imzot Irineu, i dërguar prej Kryepiskopit. Në fjalimin e ditës Imzoti theksoi lidhjen që duhet të ekzistojë nërmjet kulturës dhe fesë për një edukim sa më të përsosur të rinis dhe nevojën e vënëjes nëpër shkollat e atdheut të mësimi të fesë..

Panairi i Sh. Jon Vlladhimirit.

Siç është lajmëruar me anë të shtypit, më 4 të këtij muaji Manastiri i hirëshëm i Sh. Jon Vlladhimirit pranë Elbasanit kremtoi me pjesëmarrjen e banorvet të rrethit, ditën e përvitëshme të panairit. Nga Kryesia e Kishës mori

pjesë H. Tij Imzot Irineu që mbajti dhe fjalimin e rastit. Kori i Elbasanit, nën drejtimin e Z. Prof. Fotaq Filipaut, këndoi tërë hymnet e Shenjta.

Intervenim.

Pas një lutjeje të shumë gjinokastritve dhe i mbështetur në misionin filantrropik të Kishës Kryepiskopi Imzot Kristofor Kissi, i drejtoj me datë 20-V-1943 një telegram urgjent Mëkambësit të Përgjithëshëm të Mbretit Perandor Shkëlqesisë së Tij Alberto Pariani tue lypur mëshirën dhe shpirtmadhësin Sovrane për të dënuarim me vdekje Kristofor Gjevreku.

MENDIME T' ARTA

T' i duash të gjithë njerëzit dhe t' i lutesh Zotit për ata sidomos që ndodhen në rrugën e shtrembër e cila mund t' i shpjerë në greminën më të rezikëshme.

* * *

Fjala e Ungjillit është me të vërtetë frymë e shenjtë dhe e gjallë; kjo mund të pushtojë krejt shpirtin e njeriut e t' a transformojë, mjafton të rjedhë nga një zemër të pastër e të mirë.

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT I IV-të

KORRIK - GUSHT 1943

Nr. 5-6

LANDA: Kamxhik për Kombet — Feja dhe Shkenca — Lufta dhe Morali — Këngëtorët Kishëtarë (psaltët) — Shtylla e Familjes — Nga kryeveprat e Gojartit—Ideja Fetare Ruse — Sh. Marena — Themë Filosofike — Dita e Djelë - dit'e Zotit — Nga kryeveprat e Atërvet të Shenjtë — Shtylla e Klerit—Ungjilli mbi të falunit e fajvet—Manastiret kryesore të Dhiqezës së Beratit— I penduari — Mbreti i diturit dhe hariu i thjeshtë — Pikturat më të vjetra të Jisu Krishtit — Fjalë ngushëlimi — Jisillia — Lajme Kishtare

KAMXHIK PËR KOMBET

Ajo që vlen për jetën e individëve themë në numurin e kaluar, shumë më tepër vlen dhe për jetën e kombëve. Prandaj dhe i dituri Solomon flet sidomos për një komb jashtë ligjit, për një komb d. m. th. që përbëhet në shumicë prej individesh të paligjës, të cilët qeverisen nga krerë që kënaqen me paligjësinë dhe që s'çajné kokë fare për të drejtën.

Në një komb të tillë, dal-nga-dal çdo kuptim për të drejtën e detyrën do të shuhet ose të paktën do të nxihet. Në rrojnë në gjí të tij edhe pakë njerës të ndërgjegjshëm dhe me frikë Perëndie, këta do të jenë gjithëmon ndënë shtypje e robëri të vërtetë.

Ku të gjejnë të ngratët të drejtë dhe përkrahje? Njerëzit e interesit, ata që janë të vetmit për të blerë nhërgjegjet dhe për të mbushur me lajka njerëzit në fuqi, ata që s'ndjejnë asnjë turp të shkelin sipër kufomavet dhe të trashen me gjakun e më të dobët, vetëm këta dalin sipër si vajët në ujë. Përkundrazi, njerëzit e detyrës e të karakterit, nëse zyrtarisht nuk ndiqen, lihen me një anë dhe shpesh herë transformohen në mazë spekulimi, në kurris të së cilës rrojnë shpirt-zinj dhe keq-bërësit. Është e mundur pra që kur virtyti e drejtësia jo vetëm që s'përkrahet e s'shpërblehet por dhe shtypet e ndiqet, të mos çduket dal-nga-dalë e të mos shuhet fare? Është e mundur, që thesari publik të mos grabitet e të mos priset kot nga spekulatorët e nga njerëzit pa ndërgjegje të detyrës, kurse nevojat shoqërore dhe qëllimet për dobi të përgjithëshme lypin përkrahjen e tyre?

Dhe kur e liga arin kulmin, mjerim dhe çthurje e plotë mbretërojnë në jetën e brëndëshme t'atij kombi të paligjet deri sa anarshia dhe dominimi i plot i elementeve trubullonjes sjellin përmbysje dhe çkatërim të plotë. Por për përjashta? Për përjashta bëhet fqinj i lig, prej të cilit vihet në rezik paqja dhe sigurimi dhe i popujvet fqinj. Është si ara pa rojtar dhe si vresht' i pathurur, që ngacmon oreksin e çdo udhëtari. Është gjahu i lehtë, që i a ka ënda shumicës.

Ç' do të bëhet pra me këtë komb jasht ligjit? Tjetër shërim veç shkopit s'ka. «*Siç është kamxhiku për kalin dhe thumbi për gomarin, kështu është dhe shkopi për një komb jasht ligjit*». Edhe këtu d. m. th. duhet frika dhe

kërcënimi i rezikut. Por edhe shkopi i denimit, edhe kamxhiku i epidemiravet, i krizavet ekonomike.....

Të tëra keto janë pasojet e këqija që rrjedhin prej administratës së keqe e të pandërgjegjshme. Janë kamxhiqe që mbijnë në mënyrë natyrale mbi greminat që krijon favorizimi, çpërdorimet e pasurris shtetnore, dominimi i padrejtësisë, t'interesit jasht ligjit, të paturpësisë dhe të mos-respektimit të ligjevet. Dhe në fillim, para d.m.th. që demoralizimi i një kombi t'arrijë në gjëndje sa të mos munt të shërohet më, këto të paktën munt të jenë «*sic është kamxhiku për kalin dhe thumbi për gomarin*». Munt të jenë si vegël e mprehur, me të cilën të çpohet ndër-gjegja kombëtare që të sqohet. Si kamxhik, i hidhur ndofta, pos me anën e të cilit të preket sedra kombëtare që të ngrihet. Dhe po të sqohet e po të ngrihet këjo sedrë, ç'kamxhik shpëtim-sjellës e ç'thumb mirë-bërës do të jenë këto atëhere!

MENDIME T'ARTA

*As ulku nuk ha ulkun, as shvjtani nuk lufton shajtanin
Përkundrazi njeriu e lufton njerinë dhe mundohet t' a çdukë.
Sa rënje e madhe!*

* * *

*Atje ku është dashurija, nuk ka lodhje e mundim. Po
edhe në pastë në një herë, edhe kjo bëhet e dashur dhe e këndëshme.*

* * *

*Dëshëron t' a zbukurosh trupin t'ënd me stoli të bukura?
Mos e stolis me margaritare, po vetëm me urtësi e me përulësi.*

Feja dhe shkenca

Problemi i lindjes së njeriut

II

Theoria e çvillimit për mes shekujvet - Filozofët e Jonisë dhe teoria e çvillimit - Anaksimandri dhe Empedokliu themelonjës së kësaj theorie dhe pararendës së fisiologëve Lamarck e Darwin - Mendimet e Atomistëve - Mendimet e Lukretit - Augustin-i hirëshëm dhe Thoma Akinati kundrejt theorisë së çvillimit.

Theoria e çvillimit nuk është, siç kujtojnë shumë, pjell' e shkencës së re, as është nonje çpikje e kohëve të reja, për të cilën këto kanë të drejtë të mburen e të krenohen. Jo. Përkundrazi farët e para dhe elementet kryesore të kësaj theorie i gjejmë në sistemet e në doktrinat e filozofëve fizikë të Jonisë, e sidomos n' ato të Anaksimandrit (611 p.K.) dhe t'Empedokliut (490 p.K.). Si pas Anaksimandrit tërë krijesat e gjalla që ndodhen në tokë si bimët e kafshët, ashtu edhe njeriu vetë, janë lindur prej një lloji të vetëm t'influencuar prej djellit. Veçanërisht për njerzit besonte se këta kanë rjedhur prej kafshësh me formë t'jtër ose njerëzit e parë kanë patur formën e peshkut dhe jetonin së pari në ujë; më vonë, mbasi fituan me kohë zotësinë që t'u-bejnë ballë nevojave të tyre, duallnë në tokë, kur u çvilluan dhe muarnë më në fund formën e njeriut të vërtetë. Edhe Empedokliu me predikimet e tij mbi *afrimin e largimin* (filotis-nikos) mund të meret si pararendës i theorisë së Darvinit për sa i përket rolit që lot zgjedhja (election) në punën e lindjes së llojeve të ndryshme. Tërë bimët e kafshët. predikon Empedokliu, kanë dalë prej tokës, po jo me një herë dhe të përsosura. Së pari d.m.th. formoheshin pjesat e ndryshme dhe këto me anën e fuqisë së tërheqjes e t'afritit bashkoheshin e lidheshin në mes të tyre; po me qenë se kun-

dërshtonte fuqia e largimit, krijesat e rjedhura nuk ishin të sakta dhe si te këtilla nuk kishin jetë të gjatë. Mirë po me kohë nga këto type të shëmtuara duallnë dal nga dal krijesa me trajtë të rregullshme, të cilat u shumëzuan shpejt me anën e lindjes.....

Edhe shkolla e Atomistëve (Leukipi - Demokriti) me predikimet e saj pranon deri diku lindjen e terë krijesave organike dhe anorgane, si dhe t' atyre me shpirt e me arësye, nga një qenje të vetëm me anën e çyllimit e të lëvizjes së pjesave të vogla (atome). Protoplazma, thonë, nga e cila rrodhnë qenjat e gjalla, ka qënë krejt e lëndëtë dhe pa as një fuqi shpirtërore ose mendore; Kjo përbëhej nga një shumicë të pa numërtë pjesash fare të vogla, që nuk pjestohen e nuk ndahen n' asnjë mënyrë (atome) dhe që lëvizin vet-vetiu pa pushim. Nga kjo pra protoplazmë junë lindur terë qenjat e gjalla me anën e lëvizjes e bashkimit të atomëve.....

Lukreti më në fund në veprën e tij *De rerum natura* predikon disa parime, të cilat ngjasin shumë me doktrinën e Darwin-it. Në kohët e para, thotë, u-çdukën shumë lloje kafshësh dhe nuk u-dukën fare më vonë. Kjo ngjavi, sepse terë krijesat e gjalla që shohim reth nesh, mbrohen kundër rezikut të çdukjes me anën e dinakërisë, të fuqisë ose të shpejtësisë, që i kane marë po sa u-lindnë. Shumë nga këto janë të dobishme për neve dhe prandaj shpëtojnë nga mprojtja që u japim neve njerëzit. Raca e luanëve e të egër-siravet të tjera mprohen me fuqinë e tyre të jashtëzakonëshme, dhelpira me anën e dhelpërisë që ka prej natyre dhe drenin e mpron shpejtësia e madhe. Për sa i përket kafshëve të pa dobishme që nuk i ka pajosur natyra me fuqinë e nevojshme për një jetë të pa mvarur, këto janë ushqim i kafshëve më të fortë, ndiqen prej këtyre gjer sa të shuhet krejt raca dhe lloji i tyre.....

Në kohët e krishterë Augustini i hirëshëm pranonte se Perëndia krijoi të gjitha me një herë (creavit omnia simul).

Po me qenë se nuk u-çfaqnë të gjitha me një herë dhe në një kohë e sipër, po në periudha të ndryshme, pre-

dikonte se Perëndia i krijoi në fillim terë krijesat jo të përsosura dhe me trajtën e tyre të plotë, po vetëm farën e tyre bashkë me fuqin' e nevojshme për të çvilluar farën (potentialiter atque causaliter) dhe se toka me detin muarnë nga Perëndia fuqinë që të prodhojnë bimët e kafshët (producendi accepisse virtutem) me anën e disa cilësivet q' i pajosi Zoti për të bërë këte prodhim (causales rationes). Kështu pra të gjitha u-krijuan në fillim në formë elementare e të thjeshtë, mund të thomi, dhe pastaj me kohë, po sa u-dhanë rastet e kushtet e nevojshme, u-çvillua se cilë krijesë dhe nxori formën e saj definitive. Qe t' a bëjë më të kuptuarshme theorin' e tij ati i hirëshëm, krahason lindjen e botës me ritjen e pemëve. Si kundër, thotë, në farën e pemës kanë qenë fshehur terë elementet q' u-çvilluan pastaj dhe muarnë formen e shelgut, ashtu pikërisht edhe bota kur u-krijua prej Zotit u-pajos në formë fare me terë ato elemente të fshehta, të cilat më vonë u-çfaqnë një nga një me formën e tyre, q' u-kishte caktuar Perëndia, kur krijonte farën e tyre.

Le të mos kujtojë dikush — sikundër besuan disa dyke shpjeguar keq fjalët e Augustin-it — se ati i hirëshëm me këto që thotë pranon theorinë mbi ndryshmënin' e llojevet. As pak. Se, sikundër thamë dhe më sipër, Augustin-i predikon se Perëndia krijoi që në krye terë llojet të ndara dhe veç e veç. Po ajo që del nga theoria Augustiniane është kjo: se as gjë nuk na shtrëngon t' a marrim *ad litteram* tregimin e Shkrimit për sa i përket krijimit të krijesavet të ndryshme dhe t' a pranojmë e t' a shpjegojmë fjalë për fjalë dhe në një mënyrë krejt të ngushtë.

Edhe në kohen e mesme u-prek çeshtja e mënyrës së krijimit të krijesavet të ndryshme në planetin t'onë. Thoma Akinati — q' e zëmë në gojë dhe në studimin t'onë mbi problemin e jetës — dyke ecur mbi gjyrmat e Augustin-it, pranoi theorin' e tij dhe u mundua t' a fuqizojë këte dhe t' a çvillojë më mirë i ndihmuar sidomos nga predikimet e Aristotelit që kishin shumë fuqi në kohët e tij.

Shpresëtari

Lufta dhe Morali

Lufta dhe Dhjata e Re

Librat e Dhjatës së Re kanë përgjithësisht një frymë paqësore. Vet Zoti i ynë Iisu Krisht është paralajmëruar nga profitët si *kryetar paqeje*. Lëndjen e Tij e kënduan engjëjt me ymnin e tërënjohur: lavdi Perëndisë më të lartat e *mbi dhenë paqë*. Dyke mbyllur jetën e Tij në këtë botë, *paqën* u lënte nxënësve të Vet. Dhe kur shkeli vdekjen, po me fjalët *paqë mbi ju* i përsëndet të dashurit e tij. Ndërsa mundej t'i lutej Atit të vet t'i dërgonte më se dymbëdhjedhjet legjeone engjëjsh për të çdukur kryqëzonjësit e tij, Ay si qëngj i pafaj u-çua në therje. Petrit që nxori thikën i tha: vër-e thikën në millë. Me organet e gjakderdhjes kurrë s'erdhi në kontakt. Edhe jo vetëm aqë, por dhe e tërë doktrina e Tij vërtitet vetëm rreth dashurisë dhe tolerancës. Le të marrim p. sh. në duart predikimin mbi mal. Ja ç'këndojmë atje: «Kini dëgjuar se është thënë sy ndë vënt të syrit edhe dhëmp në vënt të dhëmpit. Po unë po u them juve të mos i qëndroni kundër të ligut, por ay që të të bjerë ty një shuplakë ndë nofullët tënde të djathtë, kthe-i atij dhe tjetërën. Edhe ay që do të gjykonet me ty e të marrë këmishën t'ënde, lër-i atij edhe rrobenë edhe ay që të të marrë ty angari një mil, ec bashkë me atë dy. Ep-i atij që lypen prej teje edhe mos e kthe faqën me nj'anë prej atij që do të huhet prej teje. Kini dëgjuar se është thënë: të duash t'afërmin t'ënt edhe t'i kesh mëri armikut t'ënt. Po unë po ju them: doni armiqtë t'uaj, bekonit ata që u mallkojnë,

bëni mirë atyre që ju kanë mëri edhe faluni për ata që u bëjnë keq e u ndjekin, që të bëhi bij të Atit t'uaj që është në qiejt, sepse Ay bën diellin e Tij të lindnjë mbi të liq e mbi të mirë e lëshon shinë mbi të drejt e mbi fajtorë.»

Le të shkojmë pak më posht: Do t'a shohim Shpëtimtarin duke u mësuar pasonjësve të Tij këtë lutje: «edhe fal-na fajet t'ona sikundër edhe ne ja u falim fajtorëve t'anë». Le të kthejmë pakë fletë po nga ky ungjilltar. Do të shohim Iisun Krishtin duke i thënë Petrit të ndjejë vëllan e tij jo vetëm shtat herë por shtatdhjeteshtat herë nga shtatë. Shkurt. Thelbi i doktrinës Ungjillore është: paqja, dashuria, toleranca.

Mirë po nuk duhet të harojmë një gjë këndonjësi dhe dashur. Që toleranca s'munt të zgjatet gjer në verbëri dhe dashuria s'munt të anullovë krejt drejtësin, që kërkon dënimin e fajtorit. Paravolia e atij që detyronte një mij talante na rekomandon tolerancën për armiqt t'anë dhe prandaj na e paraqet Zotin e qiellit e të dheut duke i falur shërbëtorit të tij një borzh aqë të math. Mirë po këjo s'bëhet gjithnjë, ka kufit e sajë. Me një herë që shërbëtori nuk e tregon veten të denj të ndjesës, Zoti e dënon duke e përdhënë në mundime. Ashtu dhe në paravolin e vreshtit. Pronari ndjen një herë, dy herë. Por kur bujqit tregoben të pandreqëshëm, dënimi vjen pa mëshirë dhe të liqit keq e më keq humbasin. Po me këtë menyrë u-dënuar për sjelljen e tij fyese dhe ay që çnderoi dasmën. U-lith këmb'e duar dhe u-hohtë në errësirën e përjetëshme. Këtë fat pati dhe shërbëtori i pazot i paravolis së talantevet. Dhe po kështu do të pësojnë dhe tërë vepronjësit e së ligës, të cilëvet u rezervohet mbretëria e errësirës.

Dashuria hyjnore s'munt të jetë një sentimentalismë boshe. Është një përsosuri e vetë-dijëshme, arësjetonjëse e shumë-pamëse, që lëvis me anë të arterive të drejtësis. Vet Zoti i ynë Iisun Krisht ishte vërtet qëngj, po kur e donte puna bëhej dhe luan. Kështu, kur u-godit krejt pa arësye prej një shërbëtori, jo vetëm që s'ktheu dhe faqen tjetër, po kërkoi të drejtën e Tij. Kundër farisjarëve nxori fjalët e gjithënjohura "gjarpërinj, të pjellë neperkash", mbiemra këto që tregojnë një lloj zëmërimi të shenjtit dhe i përvëlooi ata pa mëshirë, me atë "mjerë" të përsëritur aqë herë, mbi të

cilin do të qëndrojë për jetë zëmërimi i Hyj-njeriut kundër ipokrizisë. Po vet, Iisuj i ëmbël, është ay që dënon rrogëtarin, i cili kur shikon ujkun duke ardhur, kris e ikën, kurse bariu i mirë, i denjë i vërtet qëndron në vënt i patundur në kohë të rrezikut dhe përballon ujkun me gur e me shkop, me shtijez'e me hark e me çdo gjë q'i vjen për dore që të shpëtojë grigjen e vet. Dhe fakti është, që Shpëtimtari i u vërsul së ligës jo vetëm me anë të fjalës, po dhe me dorën e Tij të shenjtë duke bërë një kamxhik e duke dbuar prej Kishës tërë tregëtarët, për të mos u-transformuar shtëpija e Zotit në shpellë kusarësh. Po të kesh bile i dashur këndonjës durimin e të vazhdojmë gjer te letra e Apostol Pavlit në Romanët, do të shohim se dorëzonjës i pushtetit botëror është vet Zoti, i Cili i vuri dhe shpatën në brez për t' a përdorur kundër atij që bën të ligën, pa marë parasysh nëse ay që vepron kundër institucionit, e bën këtë së mbrëndëshmi a së jashtmi.

Sepse pamja e Krishtërimit është e dyfishtë: e tanishmja dhe e ardëshmja, ajo që ndodhet në çvillim e sipër dhe ajo e përsosura, ajo që përpiket të çlirohet nga trashëgimet fizike e shtazore të së kaluarës dhe ajo që ka parasysh të nesërmen të ndriçme e të pastër, ajo në të cilën pasione të ndryshme egoiste përpiqen njeri me tjetrin dhe ajo në të cilën vetëm njeri dhe më i larti vulnet do të drejtojë klasat e shenjtorevet. Të parën Krishtërimi e toleron duke mbajtur një qëndrim pasiv gjersa të kalojë forma e këtij shekulli. Të dytën e ka si qëllim dhe për këtë ka përqëndruar e përqëndron tër fuqit e tij përmes shekujvet duke ecur nga-dale e me mundim përpara, ndonëse jo gjithënjë në vijë të drejtë por me zik-zake. Sepse Ungjilli është farë e brum dhe nuk vepron me një herë. E merr njeriun si është, që t' a bëjë si duhet të jetë. Ja pse në faqet e tij figurojnë dhe persona ushtarësh — ushtarët që kanë ardhur te Joan Pagëzori, Kryeqindësi i Kapërnaumit, Korneli i Veprave t' Apostojvet — edhe jo vetëm që asgjë kundër profesionit të tyre nuk shkruhet, por edhe u rekomandohet që «të kënaqen me atë që marrin», shprehje këjo me anën e së cilës njihet përrigja e përkohëshme të paktën e karrierës ushtarake, ndonëse Krishtërimi është feja e paqës dhe ka për qëllim kryesor paqësimin e të gjithë botës.

Por, ndërsa me një anë Feja e Krishtit duke mos dashur që t' i nxitojë punët pa u ardhur koha ndjek udhën natyrale, ndërsa së jashtini e pranon forcën e përkohëshme të shpatës si të vetmen hë-për-hë që të mbajë ekzistencën e shtetit, ndërsa jo me anë të përmbysjes me forcë të situatës, por me anë të udhës natyrale kërkon t' arrijë dal- nga-dal drejt të sipërnatyrëshmit, nga ana tjetër lufton me qëndrim e me mënyra të mbrëndëshme pasionet e ndryshme që përmbëjnë shkakun renjësor dhe të vetinin të luftravet e të betejave, sikundër në mënyrë tepër të vërtetë e psikologjike na e thotë Sh. Jakovi: «ngah luftërat dhe betejat ndër ne? a nuk vijnë nga epshet që ngrihen nër anët t' ona?» Dhe duke vepruar kështu feja e Krishtere është e bindur plotësisht që kur të thyhet e të çduket krejt shkëmbi i mëkatës, do të bie e do të çduket bashkë me këtë dhe kështjella e konfiktevet dhe e mosmarëvehtjebet dërmjet popujvet. Vetëm me një veprimtari të këtillë u-përpoq Krishtërimi dhe munda, lavdi Zotit, të çduknjë zakonin poshtëronjës të sklavërisë dhe të shitje-blerjes së njerësvet, e cila deri para pak vjetësh konsiderohej si një gjë natyrale. Vetëm me një veprimtari të këtillë të brëndëshme u-përpoq ay të lartësojë gruan , e cila si një lopë ishte e detyruar të rrinte mbyllur në harrem, vegël e prirjevet shtazore të burrit, viktimë dbimi në çdo huq të tij, injorante, e pashoqëruarshme, e shtypur, e varrosur shpesh herë e gjallë bashkë me burrin e sajë të vdekur. Vetëm me një veprimtari të këtillë të brëndëshme shpreson t'a kufizojë të paktën, në mos munt t' a çduknjë krejt, dhe bishën e egër të luftës së tmerëshme e të vendosnjë nërmjet kombevet paqen e vërtetë dhe të shumë-dëshiruar.

Në numurin tjetër: Lufta dhe Atërit e shenjtë.

Çdo program arësimor, që nuk i jep vendin e parë mësimit të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë pregatit çkatërrimin moral të brezit të ri.

KËNGËTORËT KISHËTARË

(P S A L T Ë - t)

Kur muzika kishëtare filloj të zhvillohet dhe të sbukurohet më shumë e më mirë, atëherë u ndje nevoja dhe për njerës të posaçëm, që të ekzekutojnë meloditë e saj, d. m. th. për këngëtorë kishtarë ose psaltër.

Krijimi dhe formimi i këngëtorëve kishtarë është shumë i vjetër; gjyrmat që gjenden, tregojnë se ata kanë ekzistuar qysh në kohën e Apostojve. Roli i tyre deri në fillimin e shekullit të IV-të, nuk është dhe kaq i rëndësishëm me qënë se këngët e tre shekujve të parë, ishin të thjeshta, kështu që gjithë veprimtaria e këngëtorëve, kufizoheshë më shumë në të dhënurit e shenjës popullit, për të filluar këngën; ose, më parë që t'a fillojnë ata vetë dhe më në fund t'a mbarojë populli. Por, qysh prej shekullit të IV-të e këtej, kënga kishtarë dyke u zhvilluar, perfeksionoheshë prej Etërve të kishës, kur, njëkohësisht filloj të dalë në dukje zmadhuëse dhe roli shumë i rëndësishëm i këngëtorëve. Këta, nuk mund të shkonin më në kishë, të pa përgatitur; por, duheshë të vinin të armatosur me do njoftime muzikale, që të mundin të këndojnë psalmet dhe hymnet të cilët tashi duhet të këndohen me më shumë art, se sa ndër kohët e kaluara. Kjo gjendje e detyroj sinodhin e Laodhiqesë (361), me kanonin 15, të krijojë një klasë personash, të cilët të këndojnë në kishë.

Përveç kësaj, këngëtorëve u kërkoheshë, që të mos jenë të pushtuar prej ndonjë vesi të keq të mos bëjnë lëvizje me dorë ose me këmbë, në kohën kur këndojnë, të

mos përkulin trupin në drejtime të ndryshme dhe të mos përdorin thirrje të fuqishme, gjatë këndimit të melodive kishëtare.

Me qënë se disa këngëtorë nuk mundnin të pushtonin ose më mirë të zotëronin vet-vehten, prej këtij zakoni të shëmtuar dhe deri diku nervoz, *sinodhi i IV ekumenik (680)*, me kanonin 75, vendosi që kësilloj lëvizjesh të ndalohen. Ja pra, qysh tingëllon ky kanon: *“Duan që ata që vijnë në kishë për të kënduar, të mos përdorin as thirrje të pa hijëshme as të mos mundojnë vehten që të gërasin me lëkundjen e qafës, dhe as të mos thonë gjësendi të pa përshtatëshme dhe të pa ngjajshme kishës; por, me shumë vemëndje dhe kujdes, t'i drejtojnë Perëndisë, kuptimin e plotë, të psalmeve. Sepse Fjala e Shenjtë, i mësoj të bijt e Israelit; që të jenë evlaviosë.”*

Numuri i këngëtorëve në kishën e vjetër, s'ka qënë i caktuar; por në kohën e Imperatorit Irakli (610), në kishën e Shenjtë Sofisë të Konstantinopolit gjendeshin 25 këngëtorë, 160 anagnostë, dhe 70 ipodhiakonë, të cilët formonin korret. Këngëtorët, kulturën muzikale e mernin në shkollat private të muzikës, prej muzikantëve më të famshëm. Hymnet muzikale në kishë, udhëhiqeshin gjithmonë prej një protopsalti, i cili kishte dhe ndihmës të tjerë, të quajtur *shhtëpiakë*. Zgjedhja e hymnevet, për t'u kënduar në kishë, i përkiste Episkopit; kurse arti muzikal, i qe besuar protopsaltëve. Emërimi i këngëtorëve, bëheshe prej Episkopit, dyke i betuar me këtë formulë: *“Shih, se c'këndon me gojë, të mbesosh me zemër; dhe c' mbeson me zemër, të konfir-mosh me fakte”*.

Për sa i përket shenjave muzikale, qe përdroreshin në kishë, është për t'u shënuar, se në tre shekujt e parë të Krishterimit, kënga kishtare dyke qënë e thjeshtë, nuk ishte nevojë për shenja muzikale; por, me një herë kur kënga filloj të zhvillohet, u ndje nevoja e përdorimit dhe çpikjes së shenjave, të cilat të tregojnë modulacionet dhe broderit e melodive. Se kanë eksistuar shenja muzikale, s'mbetet as më i vogli dyshim; sepse tërthorazi na tregon kanoni i 15 i sinodhit të Laodhiqesë. Një muzikolog i malh i shekullit t'onë, Arhimandriti Ioasaf Rossos, dyke folur mbi

formimin e shenjave të muzikës, thotë: “Se në shekujt e parë të Krishterimit, nuk kanë eksistuar shenja muzikale, mbasi në kishë nuk këndoheshin, vetëm se këngë të thjeshta, të quajtura irmologjike dhe stihivarike: por, ç’prej ditës q’u themeluan monastiret dhe filloj shërbesa e agrepnive, e mëngjzoreve, dhe mbrëmësoreeve dhe mbasi u kthye në kishë dhe kënga e sistemuar e quajtur papadhike, e cila përbëhej prej gjith farë lloj figurash të ndryshme melodike, u vunë në përdorim dhe shenja muzikale. Shenjat muzikale përbëheshin atëhere, pa tjetër prej shenjave të vjetra të muzikës Greke, d. m. th. prej shkronjave të alfabetit Elin, si dhe prej shenjave ieroglife ose konvencionale, të cilat përfaqësonin këthesa të ndryshme melodike”.

Por këto shenja muzikale, gjat vazhdimit të kohës u shtuan kaq shumë, sa të mësuarit e muzikës, sa po vinte po behëshe më i pa mundshëm; punë, që detyroj Shenjt Ioan Dhamasqinin, të bëjë një reformë në muzikën kishëtare.

Zhvillimin e muzikës kishtare në popujt orientale, qysh prej reformës Ioan Dhamasqinojt dhe deri në ditët t’ona, do t’na shohim gradualisht herë pas here, kur do t’na jepet rasti dhe mundësia që të shkruajmë në këtë të përkohëshme. Atë që dua të çfaq më shpejt është se: muzika psaltike në gjithë shtetet orientale, mbrohet dhe zhvillohet me gjithë mundësitë e forcave mendore dhe materiale mbasi u provua, se kjo është një muzikë me karaktere të lartra melodike, dyke çelur shkolla të posaçme, të quajtura “Shkolla Këngëtorësh Kishëtarë”, ku përgatiten me mijëra të rinj, me kulturën e plotë të këtij arti kaq të vlefshëm. Prej këtyre shkollave, dalin psaltër të mirë-specializuar në muzikën bizantine, dyke zotëruar me baza të shëndoshta istorin, teorin dhe praktikën e kësaj muzikeje. Përveç kësaj, të diplomuarit e këtyre shkollave, duhet të jenë të pajisur edhe me cilësira zanore talenti të dukshëm, që me zërin e bukur të ngrihen lart me hymnet, ndjenjat fetare të besnikëve shpresëtarë.

Për fat, ne në Shqipëri, nuk kemi mundur deri tash, të kuptojmë rëndësinë dhe rolin e math që lot psalti ngaj fronit i tij. Pse na mungojnë shkollat e muzikës për pre-

gatitjen e këngëtorëve kishtarë, jemi të detyruar, që për ç'do të kremte dhe të djelë, të dëgjojmë me shumë vëshirësi, zërat e ashpra dhe të çjera, pa kurrfarë muzikaliteti, frazimi dhe interpretimi, të hymneve kishtarë, ngaj goja e psaltëve t'onë, që natyrisht—pa tjetër,—s'kanë as më të voglën përgatitje muzikale dhe as cilësira zanore. Natyrisht, kur këta s'janë të përgatitur për një të tillë mision të lartë, përgjithësisht, karakteri muzikal tradicional dhe veçanërisht vija melodike, denatyrohen, dyke shkarë në karaktere melodish popullore vëndase.

Duhet pra, që sinodhi i Shenjtë i kishës t'onë, t'a ç'bërthejë këtë problemë me rëndësi kryesore, dyke i dhënë shtetit t'onë ç'prej Kishave të Kryeqytetit dhe deri n'ato të katundeve më të largëme të mbretërisë *këngëtorë me kulturë të plotë muzikale, me prirje dhe ndjenja artistike të pandara dhe me zëra të bukura e të mirë zhvilluara. Vetëm kështu, besnikët e kishës, do të mundin t'i drejtojnë më me evllavi, faljet e tyre të Plot juqishmit, dyke vajtur në kishen e Zotit, sa herë që zëri i këmbanës, do të dëgjohet.*

Prof. KONSTANTIN TRAKO.

MENDIME T' ARTA

E Djela është kriteri me të cilin matet e gjykohej tërë java që kaloi. E përdorë këtë ditë për adhurimin e kthjellët të Zotit. Për pastrimin e shpirtit dhe për prehjen e trupit? Një përdorim i këtyllë tregon se edhe punët e javës janë të bekuara. Po në qoftë se e ke përdorur dyke ndenjtur larg kishës, dyke u-shtynë pas dëfrimesh e punësh të liga, atëherë nuk është shumë e vështirë që të kuptohet se të këtylla janë dhe veprat e javës që kaloi.

* * *

Sa herë sheh ndonjë njeri që të bjerë në gabime, në vent që t'a qërtosh e t'a kritikosh, do t' ishte më mirë të pyesësh vetën tënde: «Mos jam dhe unë si ky?».

SHTYLLA E FAMILJES

Detyrat e bashkëshortëvet kundrejt njeri tjetrit

II. — Gruaja

21. Luksi i gruas në lidhje me familjen

(Vazhdon nga numuri 3)

3. Nga luksi vjen grindja. Nërmjet pasojëve të shumta e të dëmshme për familjen që krijon mania e luksit dhe e zbukurimit, munt të radhitet dhe grindja ose konflikti që lind nërmjet burrit dhe gruas.

Se, siç e thëksuam dhe në numurin e kaluar, është e pamundur që familja të mos vijë në gjendje të vështirë ekonomike, kur gruaja dëshiron të ndjekë këmba-këmbës modën e të pajtohet gjithënjë me ndryshimet që ajo pëson. Dhe natyrisht, vështirësia ekonomike do të ketë si pasojë të menjëherëshme grindjen e poterën në shtëpi, sidomos po qe se grueja s'don të bindet me asnjë mënyrë të heqë dorë nga kërkesat e sajë të jasht arësyes për kapele e këpucë.

Mos nuk i shohim për ditë? A po mos s'ndodhemi dëshimuntarë ngjarjesh të hidhura familjare që rrjedhin nga kërkesat e shumta e pretendimet e mëdhaja të gruas, që e ha burrin «gjer në kockë» për të fituar kapelën a robën?

Dhe deri sa ay ka e përpiqet t'u përgjigjet kërkesavet të sajë e t'a kënaqë me sa është e mundur, plasja e shamatës e të grindjes munt të evitohet. Por kur burri, i shtrënguar nga gjëndja e vështirë ekonomike, parashikon rrezikun që i kërcënohet familjes nga rruga e keqe që ka nisur gruaja, atëhere çel

gojën, i flet asaj dhe e fton të ndëroj udhë, të kufizohet, të mblidhet.

Por kujt i thotë? Ajo, e pushtuar më prej sëmundjes së luksit, e dhënë pas kërkesave të modës, e hequr nga mendimi i botës për 'të, aspak s'dëgjon të kufizohet e të mblidhet. Ngrihet shpesh herë kërcënonjëse, i qëndron burrit ball-për-ball dhe s'e ka për gjë t'i matnjë fjalët një-për-një me 'të.

Thërret ay? Bërtet këjo. Nxehet ay? Tërbohët ajo. Dhe kështu, brënda në familje kemi dy gojë që hahen njera me tjetrën, dy gjuhë që godasin njera tjetrën. Dhe ndërsa poterja mërin kulmin, fjalët e dobëta e përbuzëse mbushin shtëpinë, e cila bëhet kështu theatër shamatash.

S' është nevojë kujtojmë të themi se ç' influencë ushtrojnë mbi të gjithë familjen grindjet dhe mosmarëveshjet nërmjet bashkëshortëvet. Dhe as që duam të përmendim se ato gra që do të grinden me burrat e tyre, do të hyjnë në gojë të fqinjvet dhe të të gjithë botës duke u-bërë objekt kritike e fjalësh. Vetëm urojmë që grat t'a kuptojnë mirë udhën e keqe në të cilën i shpie ndjekja e modës këmba-këmbës dhe të kthejnë drejtim. Për hir të mirëqenjes së familjes dhe të nderit të burrit të tyre, le të sakrifikojnë çdo pretendim që do të lindte mos-kënaqësira e shamatë në shtëpi. Të heqin dorë nga robot e kapelet luksoze dhe përgjithësisht nga kërkesat e çmendura të modës që kështu të lehtësojnë familjen nga shpenzimet e tepërta, sidomos sot kur çdo gjë ka hypur aqë shumë sa s' tregohet, dhe ky gjest ka për të qenë njëkohësisht dhe një nder i math për 'to.

4. Nga luksi vjen demoralizimi. Një tjetër plagë që shkakëtohet nga luksi është dhe çthurra morale. Munt të themi bile se sëmundja pas luksit e pas modës ecën krabas me paralizinë morale dhe se, liberalisma që vihet re sot në çeshtjet e moralit e të nderit, çthurja e zakonevet të bukura familjare dhe përgjithësisht pikëpamja jo e drejtë rreth moralit, janë fryt' i «figurin-ëve» të herë-për-herëshme dhe të modës së fundit.

Nuk duhet të çuditemi.

Gra të klasës së fundit shoqërore, zonja aristokrate, të mëdhenj e të vegjël, të pasur e të varfër, presin herë pas here me agoni «figurin-in» e fundit që do të qarkullojë në qytetet

e mëdha të Europës së civilizuar (!). Dhe e presin që t'a kenë si model për të bërë edhe ato robe e kapele të njishme me ato që do të mbajnë zonjat e Paris-it, të Romës a të Londrës. S'ka gjë nëse robja del jasht kufive të modestisë e të hiesisë. S'ka gjë nëse kërkesat e modës janë kundër moralit dhe i paraqitin grat në mënyrë skandaloze. Mjafton që «figurin-i» të jetë nga Parisi. Mjafton që moda të jetë nga Perëndimi!!

Edhe dihet se në ç'gjëndje ka arrirë atje morali dhe nderi familjar. Por, pamvarësisht nga këjo çështje, është një tjetër pikë që duhet theksuar. Dihet se luksi kërkon shpenzime, e shpenzime jo të vogëla. Dihet gjithashtu se ndjekja e modës këmba-këmbës do të shkakëtojë vështiresira ekonomike në shtëpi.

Ç' do të bëjnë atëhere ato gra që janë mësuar t'i shërbejnë modës? Do të urtësohen vall e do të kufizohen? Do të vijin në nërmënt e do të mblidhen në shtëpi? Dhënt-Zoti t'a bënin këtë! Por mjerisht faktet tregojnë se zekthi i luksit e i modës i ka katandisur shumë gra gjer në shkallën sa të **shkelin kurorën e nderin familjar**. Eksperienca tregon se ka patur e ka ca persona që për një fustan mendafshi a për ndonjë tjetër stoli, kanë shkelur detyrat më të shenjta e më të ndershme familjare.

Ja pra pse u-theksua në fillim se një nga pasojet e luksit e të modës është dhe çthurra e zakonëvet të mira, të moralit.

5. Luksi pengesë për martesën. Do t' ishte një mungesë po të mos theksohej dhe se shumë martesë s' realizohen pikërisht nga shkak i së keqës së luksit e të stolisjes.

Të rinj e burra, të cilët do të mundnin si familjarë të ndershëm të vepronin në dobi të shoqërisë, mbeten të pamartuar, vetëm nga frika e gruas, e cila, po thuaj në përgjithësi, kërkon sot luksin e modën me çdo sakrificë

Dhe është e natyrëshme këjo. Kur ndonjë e di që më përpara se pas martesës do t'i vijin pretendimet për kapele luksoze e robe pas modës, kur e di se gjat një viti moda ndërton të paktën tri a katër herë dhe se shpenzimet për këtë qëllim do të rëndojnë mbi xhepin e vet, kur ay e di se do të ketë përpara një grua e cila s' do të kursehet të sakrifikojë çdo gjë për hir të modës e të luksit, si është e mundur të vendosnjë për t'u martuar?

Pajën s' munt t'a marrë njeriu për bazë, as që gruaja nuk duhet të mbështetet në pajë për të formuluar kërkesat e sajë. Se, me shpenzimet e shumta e të ndryshme të jetës së sotshme familjare e shoqërore dhe me sëmundjet që herë pas here çfaqen në familje, një pajë, sado e madhe që të jetë, është e pamundur që të mjaftojë po t'u shtohen sidomos këtyre shpenzimeve dhe ato të luksit e të modës për të cilat gruaja ngul këmbë e s' dëgjon kursesi të heqë dorë. Ju pyesim pra? Si do të guxojë burri i shkret, jo të vendosnjë, por të paktën të mendojë për martesë?

Edhe e keqja s' kufizohet gjer këtu. Luksi, dyke u-bërë shkak pengese për martesën, bëhet njëkohësisht me këtë mënyrë dhe shkak shtimi të demoralizimit dhe të paligjësisë dhe s'janë të pakta viktimat e jetës së çthurrur e plëngë-prishëse!

Natyrisht, s' duam të themi me këtë se martesë është i vetmi mjet për të kufizuar demoralizimin, që në kohën t'onë po shtohet me hapa të mëdha, pasi e dijmë që vetëm frika e Zotit dhe dashuria e Krishtit munt t' i mbajnë edhe të martuarit edhe të pa martuarit brënda kufive të përmbajtjes e të urtësis dhe përgjithësisht të moralit. Por dhe nuk munt t'a mohojmë se për shumicën martesë përbën një garth kundër demoralizimit e jetës së çthurrur përgjithësisht.

Lluksi pra dhe ndjekja e modës këmba-këmbës përbëjnë një rrezik edhe për familjen edhe për shoqërinë. Prandaj interesi i vërtetë i gruas dhe përgjithësisht i familjes së krishtere është t'evitohen shpenzime të tilla të marrëzishme dhe të mbretërojnë temperenca, modestia, masa dhe përmbi të gjitha fryma e Ungjillit të Krishtit. Sepse në rast se dëshira e pambajtur për lukse dhe ngjitja e marrëzishme pas modës kanë për të vazhduar, përfundimet q'u përmendnë gjer tani do të vijnë me doemos dhe përgjegjëse për këto si përpara njerësvet ashtu dhe përpara Zotit ka për të qenë gruaja.

Nga kryeveprat e Gojartit

1. Haroje të kegen e pajtohu me armikun.

Shumë njerës kujtojnë se është turp për ta të kërkojnë ndjesë nga armiku dhe të përpiqen të pajtohen me ate q' u bëri të ligën. Gabim i madh. Se, vëlla i krishter, pse të kesh turp e drojtje për një punë, nga e cila ti i pari ke për të dalë i fituar? Të kesh turp për një gjë që s' të sjell dobi, këte e kuptoj fare mirë; po të turpërohesh për sjellje e veprime që nuk të sjellin tjetër gjë, për veç se dobi e fitim, këte s' e kuptoj fare dhe më duket një gjë jo e arësyeshme dhe e drejtë. Pse vallë? Sepse të gjithë e kuptojmë, se njeriu që haron i pari të ligën q' i është bërë dhe q' i zgjat dorën armikut për t' u pajtuar, ky njeri pra jo vetëm prej Zotit do të çpërblehet, po edhe prej njerësvet do të çmohet, do të lavdërohet e do të lartësohet. Përkundrazi po të presësh gjer sa të vijë armiku e të të zgjatë ay i pari dorën, atëhere lavdërimi i terë i përket këtij dhe jo tynë. Do të thuash nofta se e pranove armikun dhe u pajtove me atë. Mirë po kjo as pak nuk të lartëson; se pse pajtimin e bëre jo se t' a desh shpirti, dhe jo për t' i u bindur dëshirës se Zotit, po vetëm e vetëm që të mos i a prishësh qefin e atij që të zgjati dorën. Kur se po t' a marësh ti vetë nisiativën, pa pritur të të lutet armiku dhe të të bjerë ndër këmbë, po të mundësh çdo dyshim e drojtje, po të vraposh të armiku që të ka berë të ligë dhe po t' i thuash: «eja t' a hedhim prapa krahet armiçësinë t' onë dhe të bëhemi miq», po t' i besh terë këto, atëhere fitorja e terë është e jotja dhe pra edhe çpërblimi i terë ty të përket.

Në qoftë se të thom «Mbaj kreshmë» më thua shumë

herë se nuk mund, pse vuan prej sëmundjeje të trupit. Kur të këshilloj e të thom «jep-u të vobektëvet», më përgjigjesh se qenke i vobekët e se paske fëmijë për t' ushqyer e për të ritur. Po të të thom «shko dendur në kishë e në mbledhjet fetare» më përgjigjesh se nuk të lenë kujdesjet e jetes. Në së të porosit e të thom «ki mëndjen n' atë» që dëgjon në kishë nga goja e predikatorit e përpiqu të hysh në kuptimin e thellë të tyre» ti më thua se nuk i kupton dot, pse nuk ke vajtur në shkollë. Kur më në fund të thom «Mundohu të sjellësh në rrugën e drejtë no një nga shokët e tu dhe t' a bësh të pendohet «ti më përgjigjesh «jo», nga shkakut se i paska përbuzur terë këshillat q' i ke dhënë gjer tashi. . .

Eshtë e vërtetë se terë këto arësye që ve përpara, janë të rema dhe s' kanë as një themel; po më në fund ke të thuash diçka qoftë dhe të pa themeltë. Po kur të thom «hiq dorë nga zemërimi e nga inati», çmund të përgjigjesh vallë dhe ç' arësye do të perdorësh? Nuk mund të vesh përpara as sëmundje të trupit, as vobekësinë, as paditurinë, as kujdesjet as . . . se pse as një nga këto nuk ka fuqi të të ndalojë nga kjo ligësi. Kështu pra kjo mëkatë më tepër se çdo tjetër nuk falet, po tërheq më të pamëshireshëm zemërimin e Zotit. E kur puna qëndron kështu, si do të guxosh, o i mjerë, t' i ngresh duartë në qiell, t' i lëvizësh buzët për t' u-falur dhe të kërkosh nga Perëndia faljen e mëkatavet të tua, po sa që ti nuk pranon t' ua falësh të tjerëvet mëkatat që mund të kenë bërë këta?

2. Çvuan ay që nuk haron të keqen.

Njeriu q' e mban mënd gjithënjë të ligën q' i ka bërë një tjetër e që kërkon me çdo menyrë t' i a kthejë të ligën e t' ia marë hakun, është me të vërtetë i mjerë; se nuk gjen i shkretëti qetësi e paqe n' as një çast të jetës së tij. Është përherë në zemërim e me shpirt të ndezur, ndjenjat e tij e mendimet bëhen dita ditës më të egëra e më çnjerëzore; fjalët e armikut si edhe veprat e sjelljet e këtij të fundit i dalin përpara dhe i a ndezin e i a turbullojnë mendjen; shumë herë mjafton të dëgjojë emrin e tij, që të egërsohet e të bëhet si një bishë e vër-

tetë: sa herë e shëkon qoftë edhe së largu, dridhet e përdridhët pikërisht si atëhere kur i ngjet no një fatkeqësi e madhe; po edhe miqt e tij kur i sheh e kur i takon, si edhe no një send të tij, turturohet shpirtërisht e pëson pa masë.

Se si kundër gëzohemi e kënaqemi, sa herë shohim shtëpit' e miqvet, shërbetorët e këtyre ose çdo send tjetër, ashtu pikërisht hidhërohemi dhe vuajmë, kur gjejmë përpara no një send t' armikut t' onë; një plagë na hapet në shpirtin t' onë dhe një dhembje të fortë ndjejmë si kur na kafshon no një gjarpër plot me dhembje e me helm. . . .

Shih pra se çvuan ay që nuk e haron të keqën e që ngul këmbë të mos pajtohet me armikun e tij. E pra na del vet-ve-tiu pyetja: Pse t' i shkakëtojmë vehtës aqë vuajte dhe aqë këqarje, kur se e kemi në dorë të shpëtojmë krejt nga këto mundime e këto hidhërimi? Edhe si kur të mos ishte denimi i Zotit për ata q' e mbajnë mënd për herë të keqen, vetëm e vetëm që të shpëtojmë shpirtin nga një martirizim të këtillë, duhet me do e mos të pajtohemi me armiqtë t' onë dhe të hedhim prapa krahëvet të ligat që mund të na kene bërë. Po kur e dijmë se për veç këtyre vuajtjevet në këtë jetë, kemi për të pësuar dënime të rënda e në jetën tjetër, atëhere nuk është i çmendur dhe i marrë ay prej nesh që me dëshirën e hakmarrjes përgatit ay vetë një turturë të përherëshme në këte jetë, dhe mundim e vuajte të përjetëshme për jetën e ameshuar?

Përkth. prej Shpresëtarit.

MENDIME T' ARTA

Shprestarija e vërtetë ka si shenja dallonjëse përulësinë dhe dinjitetin; kurse trimërija e vërtetë dallohet me anën e modestisë dhe të rëndësisë.

*
*

Nga të njohënit' e kësajë bote më e vështirë është kjo: t' a njohësh vehtën t' ende, thoshte filozofi i vjetër Thales Milesiani.

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

II.

Nuk mundemi të formojmë një ide mbi besën orthodhokse ruse pas theollogjisë zyrtare. Besa orthodhokse ruse nuk ka njojtur pikpamjen e doktrinës theollogjike të detyruar dhe të formuar në një sistem; ajo s' e ka njojtur skolastikën. Racionalisma theollogjike nuk u-pajtua me ndërgjegjën fetare ruse. Idea fetare ruse pohon se misteri i jetës hyjnore nuk mundet të paraqitet me një koncept racionalist. Theollogjia ruse zyrtare ka qënë influencuar prej theollogjisë katolike dhe prej theollogjisë protestante. Pas kuptimit orthodhoks rus anëtarët e jerarkisë kishtarë nuk kanë asnjë dhurëti të posaçme për të predikuar doktrinën. Një shkrimtar profan, Khomiakoff, ka qënë i pari theollog orthodhoks rus, themelonjësi i theollogjisë orthodhokse në Rusi. Fryma e orthodhoksisë ruse nuk mund të studjohet në bazë të veprave theollogjike. Kjo frymë ka qënë përhapur në tërë atmosferën në të cilën ka respiruar populli rus dhe që është jeta e tij. Këtë frymë e gjejmë në kult, në ikonat, në biografit e shënjtorëve rusë, në «startchestvo» rusë, në shprestarinë e popullit rus, në «streniki» (vizitorë) rusë dhe në disa aspekte të sekteve mystike, në veprat e shquara të letraturës dhe të mendimit rus. Fryma fetare ruse ndihet përmbi çdo gjë nën një mënyrë artistike ose esthetike më tepër se nën një formë llogjike ose racionale. Kjo frymë ka gatuar jo vetëm jetën e dukëshme të kishës dhe në doktrinën e saja, por tërë jetën shpirtërore të popullit rus. Eksperienca e madhe shpirtërore e shënjtorëve rusë, të «starzi» rusë do të mbetet pothuaj e pashpjeguarshme me fjalë ose me mendime; ajo s' ka lënë pothuaj asnjë vepër. Ja një ndryshim i thell ndërmjet botës katolike, ku shënjtërija dhe mystikizma ka lënë vepra letrare të çqurara! Rusi, dyke lënë botën, dyke pasuar udhën e caktuar, dyke arirë në shënjtëri, nuk mundet të shkruajë dhe të krijojë më. Ay vetë bëhet një vepër e mbaruar, një prodhim i artit hyjnor. Shënjtërija ruse dhe përjetimi mystik rus i mystereve hyjnore

nuk i dhanë asnjë ndihmë civilizimit, siç ka dhënë në Perëndim katholiqizma ku esthetikët çuditën me S. Françiskun de Assisi dhe ku njerës të një kulture të rafinuar këndojnë dhe rikëndojnë Shën-Terezën. Shënjtërija ruse, shënjtërija e Serafim Saroff-it, i cili ka jetuar në shekullin e XIX-të, nuk bëhet kurrë një fuqi aktive e civilizimit. Jeta shpirtërore mbetet e vendosur në thellësit e misterit! Orthodhoksia nuk ka krijuar një kulturë të madhe, imponojëse dhe të shumë-llojshme si katholiqizma në Perëndim. Orthodhoksia e Rusisë është përshkuar prej fesë orthodhokse dhe kjo nuk ka qënë një forcë historike të një fuqije të jashtme të krahasuar me atë të katholiqizmit. Nuk është veç se kulti orthodhoks ay që çfaq shpirtin e fesë ruse dhe që ka qënë një manifestim i kulturës së shpirtit. Të huajt kanë mundur t'i afrohen orthodhoksisë me këtë fuqi të kultit. Njerëzit e Perëndimit që kanë kaluar nëpër shkollat e katholiqizmit dhe të protestantizmit janë të mësuar me një fe normative, të racionalizuar dhe të adaptuar në gradën më të lartë civilizimit. Orthodhoksia ruse është forma më pak normative e krishterimit. Në orthodhoksinë ruse eksperiencia shpirtërore ka një rol më të vogël në tjetër anë, pra është më pak e kultivuar dhe e zhvilluar, si në kuptimin të cilin e ka kjo në Perëndim.

Perëndimi i mësuar me format e posaçme të krishtërimit me zor mundet të kuptojë si besa orthodhokse udhëheq shpirtet e rusëve dhe si i lartëson për një jetë më të mirë. Udhët e tyre janë të ndryshme nga ato të të krishterëve të Perëndimit. Edhe kjo, jo aqë me anë të predikimeve dhe të mësimëve, të rregullave të udhëheqjes me të cilat besa orthodhokse edukon popullin rus, por me anë të kultit, me anë të meshës, me anë të misterit të thetores hyjnore. Orthodhoksia Ruse është një fe *esencialisht liturgjike*.

Besa orthodhokse e ngre popullin jo me ndihmën e rregullave të udhëheqjes, por me shëmbëllën e jetës fetare; besa orthodhokse ve të falurit, që është bashkëfjalimi me Perëndinë dhe jo një disiplinë e jetës. Orthodhoksia nuk është lidhur dhe aqë me jetën tokësore dhe të përkohëshme, por beson më shumë se konfesionet e tjerë, që njeriu është i destinuar për jetën qiellore dhe të përjetëshme; ajo më shumë se të tjerët ka ruajtur lidhjen me traditën e krishtërimit të parë dhe është më pak e

shtruar influencës botërore. Katholizmi dhe protestantizmi u-bënë fe tepër të civilizuar, tepër të dhëna pas perspektivave tokësore. Në orthodhoksi çdo gjë që ka të bëjë me organizimin tokësor, me jetën e civilizuar, mbeti më pakë e zhvilluar. Orthodhoksia nuk bazohet dhe aq në disiplinën e saj, as në veprimtarinë e saj historike; armatimi mbrojtës dhe i pushtimit mendor, është lënë më një anë. *Orthodhoksia bazohet më tepër në dhurëtit harismatike, në veprimin e hirit hyjnor, në fuqin e faljes.* «Startchestvo» është i vetmi mjet për të udhëhequr shpirtet e vërtetë të orthodhoksisë ruse.

Igumeni është gjithmonë një kallogjer, por ay nuk është një anëtar i hierarkisë kishëtare. Ay është pajosur me dhurëtira, me hir të posaçmë, që nuk ka të bëjë me asnjë shënjë të jashtme dhe normative. Igumenët ndiqeshin prej episkopëve dhe autoriteteve kishëtare, ata shikoheshin si reformatorë dhe afro sektarë... Besa në autoritetin e igumenit është një besë në dhurëtit e posaçme shpirtërore të kuptuara prej popullit dhe të bindura vullnetit të igumenit, por kjo nuk do të thotë që t' i bindesh një autoriteti të ligjshëm dhe objektiv siç është bindja te një direktor i ndërgjegjes në katholicizëm, por do të thotë që të liresh nën pushtetin e fuqis mirëbërëse të udhëheqjes së Perëndisë, fuqi e cila vepron mbi personin e igumenit. Dhe këtu pikërisht qëndron mungesa e racionalizmit, e thellë dhe rënjësore, mungesa e udhëheqjes, mungesa e formalizmit së orthodhoksisë. Asnjë termë përkufizimi, nuk mundet të çfaqnjë dhe të përcaktojë kishën orthodhokse. Këtë e thonë theologët dhe mendimtarët më të çqar rus. Këjo do të thotë: *Kisha orthodhokse është ajo që qëndron më afër esencës së parë të kishës; domethënë, në histori dhe në civilizim ajo ka qënë shumë më pakë e shtruar influencës së botës.* Iderat e rregullës, të së drejtës, të racionalizmit, të formalizmit dhe të legalitetit, janë armë të përgatitura prej kulturës laike me qëllim të një organizimi tokësor.

Kisha orthodhokse ka qënë drejtuar gjat kohës drejt përjetësisë, se sa në sende të përkohëshme. Karakteri eshtologjik i krishtërimin të parë u-ruajt më tepër në orthodhoksinë lindore, se në krishtërimin perëndimor.

Nga jeta e Shenjtorëvet

SHËN - MARENA

Shën-Marena, deshmorëja e madhe e besës s' onë, ishte nga Andiohia e Pisidisë, një qytet në Azin e vogël, dhe jetoi në kohën e Perandorit Klavdiut të II-të. Mëma e saj i kish vdekur pak ditë pasi e lindi; kështu që ajo mbeti nën kujdesjen e babajt të vet, i cili quhej Edes dhe ishte jo vetëm pagan, domethënë jo i krishter, por dhe prift i idhujvet. Ky i a besoi vajzën, që t' a ritnjë e t' a edukonjë, një gruaje tjetër, e cila banonte në një çiflik jasht qytetit. Atje klima ishte shumë e mirë për shëndetin dhe Edesi ishte shumë i kënaqur se pse vajza e tij, nën ato kushte, do të rritej e do të madhohej për bukuri. Kohë më kohë pastaj shkante dhe vet për t' a parë vajzën dhe për t' a mbushur me të puthura e përkëdhelje.

Mirëpo Edesi, me gjithë këtë kujdesje të madhe që tregonte për vajzën e vet, s' ishte në gjendje t' i jepte asaj një edukatë të shëndoshë, sepse jo vetëm që ishte pagan, por as vet nuk e kishte atë edukatë. Ay donte që vajza e tij të kishte vetëm një trup të shëndosh, të bukur dhe elegant, ashtu domethënë siç e donte shoqëria e atëherëshme.

Por Marena e vogël kish trashëguar prej nënës së sajë mjaftë cilësira të mira, cilësira të cilat, me kujdesjen e asaj gruaje që e ritte, u-shtuan dhe u-thelluan. Ajo grua kishte një ndërgjegje të pastër e të çvilluar, e cila, siç na thotë Apostol Pavli, po të ruhet mirë bëhet për njeriun, udhëheqës drejtësije dhe shpëtimi. Me kohë pastaj, pse ka qenë e mirë edhe e ndershme prej natyre, kish pranuar dhe besën e krishtere. Bashkë me këtë grua, u-katihis e u-bë e krishtere dhe Marena e vogël, e cila në këtë kohë ishte po thuhet 12 vjeç. Babajt të sajë Marena nuk i tregoi gjë për këtë punë, se ay si fanatik pagan që

ishte, s' munt t' a kuptonte mësimin e lartë dhe të bukur të fesë s' onë.

Kishin kaluar qysh prej asaj dite që u-pagëzua tre vjet; gjat kësaj kohe, dyke degjuar rregullisht predikimet dhe e ndodhur gjithënjë në mësimet, që zakonisht bëheshin prej priftërinjvet nëpër shtëpit e të krishterëvet, mundi t' a kuptojë fare mirë mësimin e Krishtit dhe të njohë tërë porosin morale të Ungjillit.

Mirëpo ajo nuk kënaqej vetëm me mësimin. Dëshironte sidomos jetën e krishtere. Prandaj falej rregullisht dhe me zemër, kungohej sa herë e donte nevoja dhe pasi më përpara pendohej dhe rrefehej, kujdesej për pastërtin e shpirtit dhe të jetës dhe ruante me përpikmëri porosin e Jisujt që kanë lidhje me mendimet, me dëshirat, me fjalët dhe përgjithësisht me tërë sjelljen e njeriut kundrejt Zotit dhe të afërmit. Dhe Marena kish një trup shumë të bukur, ish një nga krijesat më të përsosura të krijonjësit.

Si u-bë 15 vjeç, e pa të arësyeshme se nuk duhej më t' i a fshihte këtë punë babajt. Ky lloj taktike, që i dukej si ipokrizi, nuk pajtohej as pak me karakterin e sajë të pastër. Nga ana tjetër, e shtytur dhe prej dashurisë së krishtere dhe prindërore, e quajti si detyrë të domosdoshme të përpiqej t' a ndriçonte dhe atë e t' a kthente n' udhën e shpëtimit. Kështu që një ditë, kur erdhi ay për t' a parë, i a tha se si u-bë e krishtere dhe e luti që edhe ay t' a pranonte këtë fe.

Kur e dëgjoj Edesi këtë punë, u-trondit pa hesap. Urrej-tja që ay ushqente për të krishterët, para këmb-nguljes së vajzës, s'vonoj të çfryhej dhe kundër asajë. Se pasi me qërtime, me lutje dhe me kërcënime nuk mundi t' a kthejë Marenën përseri në fenë pagane, iku dyke e mallkuar dhe dyke i thëne se kjo sjellje e sajë e kish dëshpëruar pa masë dhe e kish bërë që të mos e njohë më për bijë. Por nuk i a tha as njeriut këtë punë, as nuk e akuzoi ne autoritetet, sepse kishte frikë mos ata i thoshin se si ay, prift i idhujvet, e la vajzën e vet të kapet në rrjetat e të krishterëvet.

Ca muaj më vonë hynte kaluar në Andiohië qeveritari Olivrë, i shoqëruar dhe me një kompani kalorije. Rastësisht ky pa në rrugë Marenën, bukuria e së cilës ishte jashtë çdo

përshkrimi dhe që qeveritarin e bëri të shtanget. Ndali pra kalin dhe e pyeti vet si quhej dhe ku banonte. Ajo, i dhë përgjegjen e duhur dhe, e turbulluar për këtë takim të papritur, u-kthye me një herë në shtëpi ku u-dha pas faljes për të gjetur qetësin e sajë shpirtërore.

Por Olivri nuk mbeti i qet; dëshira shtazore e lindur në zemër të tij për këtë krijesë të pafajëshme, e ngacmonte pa pushim; gjumi s' e zuri fare natën, dyke pritur me padurim agimin. Të nesërmen pra, pakë kohë pas lindjes së diellit, dërgoi ca njerës nga të tijtë në shtëpi të Marenës, që t' i thonë të përgatitet shpejt e shpejt se e donte qeveritari. Dhe ajo si u-fal me zemër te Zoti që t' a forcojë të ruaj besën e tij gjer në fund të jetës së sajë, u-nis pas të dërguarvet. Si iku, gra e vajza të tjera shpresëtare, u-falën te Zoti për të.

Olivri kur e pa mbeti më se i gëzuar. Dhe si u-larguan të tjerët që andej, ay i tha Marenës se kish vendosur t' a mirte ndën mbrojtjen e tij dhe se kishte për qellim t' a mirte dhe për grua. Me të dëgjuar këto fjalë Marena u-zverth nga fytyra, u-bë si dylli. Olivri e kupëtoi trubullimin e sajë shpirtëror dhe i çqetesuar i thotë: pse u zverdhe o Marenë? nuk të pëlqen ky propozim i im? shumë vajza, bile nga familjet aristokrate, do t' a kishin zili fatin tënd!

Shën-Marena nuk nxori fjalë nga goja dhe duke ulur syt për dhe, po kuptonte se e prisnin mundime të mëdha dhe prandaj lutej fshehurazi te Zoti që t' a mirrte ndër mbrojtjen e tij.

Po Olivri i lypi me doemos përgjegje dhe ajo, dyke marrë guxim, i thotë: *është e pamundur*.

E pa mundur? Si? Një vajzë nga klasa e ulët e shoqërisë, femi po thuaj, dyke mos patur asnjë stoli tjetër veç bukurisë, hedh poshtë me kaq lehtësi një nder aqë të math që po i bëhej prej një qeveritari! Egoisma e tij u-prek dhe gjaku i u-ngjijt në kokë.

— Pse është e pamundur? bërtiti; mos i a ke dhënë zemrën tënde ndonjë njeriu tjetër?

Shën-Marena u skuq: por s' u-tremb, s' e humbi kurajon.

— Jam e krishtere o qeveritar, u-përgjegj me një ton të qëndruarshëm.

Olivri u-trondit. Një valë zemërimi e pushtoi. E krishte-

re? . . . Shumë herë gjer atëhere këta pasonjës të fesë së Krishtit e kishin çqetësuar. Dhe e dinte se sa të fort' e të pathyer ishin. Asnjë fjalë s' munt t' i bënte të ndërënin mendim, as një kërcënim s'i trembte, as një premtim nuk i gënjente; bile dhe mundimet e torturat më të tmerëshme s' kishin asnjë fuqi para durimit të tyre të pashoq. Edhe Marena pra, këjo vajzë e re dhe e pafajëshme, ishte e krishtere? Një dashuri e fortë dhe një zëmërim i math u-përpoqnë në shpirtin e tij. Dhe për ca kohë zotëroi dashuria. Passi me mundim të math e mbajti për ca kohë vehten, u-kujdesua t' a bindnjë Marenën dyke zënë për gojë një nga një tërë nderimet, kënaqesit dhe defrimet që do të kishte po të bëhej grua e tij. Po kur pa se ajo nuk ndërënte mendim por qëndronte e pathyer në besën e Krishtit, e la zëmërimin që të çfryhet me tërë fuqin dhe egërsin e tij. E shau tepër ligisht vajzën e shenjtë, i tha tërë ato fjalë që përdorin njerëzit e demoralizuar kur janë në fuqi dhe e itoi që të deklarojë zyrtarisht se ishte e krishtere. Shën-Marena atëhere e përseriti edhe para gjykatores rrëfimim e besës së sajë te Krishti me aqë guxim të math sa që tërë sa ndodheshin atje mbetën me gojë të hapët për eroizmin e kësaj vajze të re.

Për këtë rrëfim publik që bëri, u-dënua që herën e parë të rrihet me kamxhik. Kamxhiku ishte gjëmbe-gjëmbe, kështu që nga të rahurat trupi i Shën-Marenës u-mbush me plaga ngah gjaku i sajë i kulluar rrithte si rrëke. Olivri, i cili shpresonte se me këtë menyrë do t' i a kthente mendjen, kur pa qendrimin e sajë të fortë në besë, u-habit. Me gjithë këtë kujtoi se kur Shën-Marena pas atyre plagave do të hidhej në burg, do të vinte në vehte dhe do t' a kuptonte gabimin që bënte dyke i hedhur posht premtimet e tij. Por edhe në burg ajo mbeti e pathyer. Në mes të dhimbjevet që ndjente, falej me zemër e me besë; dhe kur e zuri për pakë gjumi, përseri bërtiste: «jam e krishtere»

Të nesërmen e suallnë prapë para gjyqit. Më kot u-munduan t' a bindin me fjalë të buta e premtime të ndërënte mendim. Ajo si ditën e parë, si në gjum, ashtu edhe tani thoshte siç thoshnin të gjithë dëshmorët e besës s' onë: «jam e krishtere». Atëhere përdorën tortura dhe më të rënda; i a çanë mishin me thonjë prej hekuri. Vajza e re s' munt të mbahej nga

dhimbjet e mëdha, por më gjithë këtë besa dhe lutja dualinë triumfonjëse. Mbeti gjer në fund e pathyer dhe e fortë. Pastaj e hodhën prapë në burg.

Atë natë një çudi e shkëlqyer u-krye. Ndërsa Shën-Marena po falej e ulur në gjunjë, tërë plagat e sajë i u shëruan me një herë. Këjo ngjarje e papritur i dha edhe më shumë kurajo. E pa me syt e sajë dashurin e Perëndisë për të dhe e falënderoi nxehtësisht.

Edhe një herë të nesërmen e nxuarnë para gjyqit, ku qenë mbledhur mijra qytetarësh. Dhe kur këta të gjithë bashkë me qeveritarin dhe gjyqtarët e panë shën-Marenën krejt të shëndoshë, u-habitu. Një shumicë burrash e grash pa as më të vogelën frikë e pranuan besën e Krishtit dhe lavdëruan Perëndinë. Qeveritari u-bë jasht mentsh para kësaj pune të papritur; dhe që këjo të mos kishte pasojë dhe më të medha, çpërndau gjyqin dhe bëri sikur urdhëroi t' a çojnë Shën-Marenën në burg. Por me një urdhër tjetër të fshehtë Shën-Marena u-çua në vendin e vdekjes. Atje ajo tha lutjen e sajë të fundit në tokë dhe pastaj kelleçi i xhelatit, dyke i prerë kryet, e kurorëzoi me kurorën e diamandtë të deshmorisë.

Kujtimin e sajë Kisha e jonë e shenjtë e kremton më 17 të muajit korrik.

MENDIME T' ARTA

Kurrë armiqt e Krishtit nuk do të largoden nga ata as një herë në jetën e tyre.

* * *

Është një çmënduri të kërkosh të t' a ruajë tjatri të fshehtë, të cilën ti vetë nuk ke mundur t' a ruash, pa e ke përhapur me gjuhën t' ende pa fre. Ndodhen e ca njerës që janë si ca arka të sigurt; besimi i të fshehtave në këta njerës, ruajtja e sigurtë e këtyreve dhe përdorimi i mirë i këtyreve në kohën e duhur, tërë këto krijojnë një lloj burimi mirësije, një lidhje më të lartër e shumë herë dhe një mjet shpëtimi e lirim.

THEMË FILOSOFIKE

Jdenat dhe parimet racionale

Si mas premtimit qi dhamë në artikullin e mëparëshm nën titullin «disakordi midis mëndjes dhe botës», na duhet të tregojm këtu cilat janë idenat rationale dhe cilët janë parimet qi riedhin sosh.

1. **Idena rationale.** Idena rationale janë ato qi kanë për objekt gjâna metafizike, si p. sh. Perëndi, vënd, kohë, shpirt, substancë, esistencë, numur e t'jera; kurse idena empirike janë ato qi kanë për objekt gjâna sensible, si p. sh. lis, kafshë, gëzim, dëshir e t'jera. — Siç dihet idenat dallohen në: a) *subsistente* dhe *inherente*; b) *absolute* dhe *relative*. Subsistente është idea e një gjâje; inherente është idea e një cilsie; absolute është idea e një gjâje qi esiston vetiu qi arsyen e esistencës e ka në veten e saj; relative është idea e një gjaje qi nuk esiston vetiu, qi arsyen e esistencës e ka në një gjâ tjetër. — Prej idevet rationale, idena subsistente dhe absolute janë vetëm dy: idea e *Perëndis* dhe idea e *vëndit*; kur-se t'jerat janë idena inhereute (p. sh. esistenca, koha, numri) ase relative (p. sh. shpirt, substancë)

a) *Idea e Perëndis.* Idea e Perëndis është gjithmon presente në shpirtin ton si idé e një kohe infinite (pa fillim, pa mbarim, pa suksession) d. m. th. si idé eterniteti. Tash-ti, idea e kohës nuk është koncept, se nuk është idé gjenore (generale); nuk është idé imagjinare se s'përmban kurnji element lânduër; është idé individuale, se i riferohet një sendi, pra është intuitë; është dhe idé pure, se s'përmban asnji element sensibil; pra, është intuitë pure, dhe si e ti-

llë duhet doemos të ketë vlerë objektive d. m. th. t' i riferohet një objekti adekuat. Idea e kohës infinite s' mund të na vijë nga esperienca, se kjo s' na offron veç gjana me jetë të kufizueme. Gjithashtu s' mund t' a identifikojm me jetën e shpirtit, se na jemi të bindun qi shpirti nuk është absolut, u krijue dikur para botës dhe prap dikur, me një akt divin, do të ketë mbarim, kurse koha s' ka as fillim as mbarim. As mund të themi si Kanti qi koha, si dhe vëndi, nuk është veç formë a priori e sensibilitetit d. m. th. formë krejt subjektive, se kjo kishte me qënë efekt pa shkak dhe kishte me pasë kuptimin qi bota dhe mëndja filluan nga në e jo nga Perëndia; përkundrazi, shpirti jon nuk i kupton dot gjënat e kësai bote bash për arsyen q i paraqiten të kufizueme në kohë e në vënd, dhe për t' i kuptue i duhet me i svesh prej cilsvet të suksesionit dhe estensionit. Pra, koha infinite si idé duhet t' i riferohet një objekti adekuat, një sendi infinit; si idé inherente duhet t' i riferohet ndonji atributi të sendit në fjalë. Idea, pra, e kohës infinite nuk mund të jetë veç se idea e sendit infinit, e jetës së Perëndis. Idea e kohës është doemos presente në shpirt; se, kur-se të gjithë sendet e faktet e botës mundemi t' i supprimojm me imagjinatën t' onë dhe t' i mendojm si të paqënë, kohën nuk mundemi kursesi t' a mendojm si të paqënë. Kështu, presenca e idé së kohës në shpirtin t' on dishmon esistencën e Perëndis si realitet objektiv; idéa e infinitetit të kohës dishmon esistencën eterne të Perëndis; presenca e domosme (necesaria) e idé së kohës dishmon esistencën e domosme të Perëndis d. m. th. qi mund të mos esistojë.

b) *Idea e vëndit* (espace). Idea e vëndit është gjithmon presente në shpirtin t' on si idé e një estensioni infinit (pa fillim, pa mbarim, homogjen) d. m. th. si idé immensiteti. Tashi, këtu mund të persërisim sa thamë për idén e Perëndis, d. m. th. qi idéa e estensionit nuk është koncept, se nuk është idé gjenore (gjenerale): nuk është idé imagjinare, se s' përmban kurrji element landuër; është idé individuale, se i riferohet një gjaje (estensionit); pra, është intuitë; është dhe idé pure, se s' përmban asnjë element sensibël;

pra, është intuitë pure dhe si e tillë duhet doemos të ketë vlerë objektive, d. m. th. t' i korrispondojë një objekt adekuat. Idea e estensionit infinit nuk mund të na vijë nga esperienca me anën e abstraksionit, se kjo s' na offron veç gjâna me estension të kufizuem. As qî mund të themi si Kanti qi vëndi, si dhe koha, nuk është veç formë a priori e sensibilitetit d. m. th. krejt subjektive, për arsytet qi treguam mâ nalt e sidomos pse estensioni si attribut i sendeve formon kontradiksion për shpirtin dhe është arsya kryesore e habis primitive, e kuriozitetit dhe e mendimit, shkaku kryesuër për të cilin shpirti s' mundet kursësi me kuptue sendet e botës dhe, për t'i kuptue, duhet me i svesh prej atributit të estensionit dhe, pasi t' a ketë krye këtë punë, vetëm ahëre kënaqet e qetohet. — Pra, estensioni infinit si idé duhet t' i riferohet një objekti adekuat, një gjâje infinite: dhe si idé inherente duhet t' i riferohet një atributi të gjâs në fjalë. Idéa, pra, e estensionit infinit nuk mund të ketë objekt korrispondent veç estensionit infinit si cilsu esenciale të vëndit real. Idea e estensionit është doemos presente në shpirt, se, kur-se të gjitha gjânat e botës mundemi t' i suprimojm me imagjinatën t' onë dhe t' i mendojm si të pa-qëna, estensionin nuk mundemi kursësi t' a mendojm si të paqënë. — Kështu, presenca e idé së estensionit në shpirtin t' on dishmon esistencën e vëndit si realitet objektiv; idea e infinitetit të estensionit dishmon immensitetin e vëndit; presenca e domosme (necesarie) e idé së estensionit dishmon esistencën e domosme të vëndit, d. m. th. qi ky nuk mund të mos esistojë.

2. Parimet racionale. Prej të dy idéve racionale të Perëndis e të vëndit dalin parimet racionale themeltarë. Këta janë tre: *parimi i identitetit*, *parimi i diversitetit* dhe *parimi i të tretit t' eskluduëm*. — *Parimi i arsyes* (ragione sufficiente) abuzivisht quhet parim; ky është postulat dhe burimin e vet e ka: a) te besimi themeluër i shpirtit qi kurgjâ s' është e vërtetë, veç idenat racionale; b) te nevoja metafizike e tij me kuptue të gjitha dhe, për me i kuptue, i duhet me ridukue ç' do gjâ në arsyen e vetë d. m. th. në idenat racionale. Prandaj formula e ketij postulati kish-

te me qënë kjo: «ç' do gjà, për m' u-kuptue, duhet ridukue në arsyen e vetë».

a) *Parimi i identitetit*. Në secilën idé racionale (të Perëndis e të vëndit) shpirti konstaton, veç atributit t' esistencës, dhe mungesën absolute të ç' do dryshimi d. m. th. qi secila sosh është gjithmon po ajo. Këtej lind idéa e identitetit absolut dhe shpirti affirmon e gjukon: *Perëndia është Përëndi; vëndi është vënd*. Ky parim esprimohet në Logjikë me formulën symbolike *A është A*.

b) *Parimi i diversitetit*. Shpirti, tue krahasue të dya idenat racionale, njenën me tjetrën, konstaton se këto, veç atributit s' kanë asnji tjetër atribut komun d. m. th. qi janë absolutisht të ndryshmë (divers) dhe qi njana s' mundet kursesi të ridukohet te tjetra. Secila është negacion i tjetrës, andaj dhe në Logjikë esprimohen me symbole kontradiktore: *A, mos-A*. Këtej lind idéa e diversitetit absolut dhe shpirti gjukon: *Perëndia s' është vënd; vëndi s' është Perëndi*. Formula symbolike e këtij parimi kishte me qënë kjo: *A s' është mos-A*.

c) *Parimi i të tretit t' ekluduëm*. Shpirti, tue hetue orizontin metafizik për me gjetë dhe donji idé racionale themelore tjetër, konstaton se, veç idévet të Perëndis dhe të vëndit, tjetër nuk esiston. Këtej lind idéa e inesistencës absolute dhe shpirti affirmon dhe gjukon: *Veç Perëndis dhe vëndit, gjà tjetër s' esiston*. — Ky parim i sbatuëm në esperience mer këtë formulë: *ç' do gjà riedh o nga Perëndia ose nga vëndi*. Formula symbolike e tij është kjo: *A është o B ose mos-B*.

Konkludim. Prej espozitës deritashme rezultoi se elemente esenciale të mendjes janë dy idena absolute dhe tre parime themelore. — Në përdorimin e tyne empirik, idenat na shërbejn si kriter i së vërtetës; dhe parimet na shërbejn si ligja për mendimin e drejt të pagabuëm; — Në përdorimin e tyne trascendental idenat dhe parimet na bëjn të njohur botën reale, të vërtetë e, sidomos, për sa intereson fën, esistencën e Perëndis dhe immortalitetin e shpirtit.

Dita e Djelë ditë e Zotit

Dita e Djelë është e shenjtë ndër të gjithë të krishterët. Të krishterët e parë ia kishin kushtuar faljes n'aj Zonin këtë ditë të parë të javës, në vend të së shtunës që kish patur judaizmi e prandaj e quajtnë *ditë të Zotit* (dies dominica, dies resurrectionis, dies primus hebdomadis). Dhe shquhen këjo ditë si ditë gëzimi, e prandaj të krishterët nuk agjëronin as kreshmonin atë ditë dhe faleshin më këmbë e jo ulur më gjunjë; sepse në këtë ditë Krishti, me ngjalljen e tij e ngriti prapë në qiell njeriun e rrëzuar.

Në kohërat e para, përveç të Djelës kremtohej edhe e *Mërkura*, se atë ditë u-vendos vdekja e Krishtit, edhe e *Premtja* për pësimet dhe vdekjen e Shpëtimtarit, që ndodhën atë ditë. Perandori Kostandin' i Math, siç shkruan historiani Sozomeni, nxori një dekret-ligj me të cilin urdhërohej që, të Premten dhe të Djelën të pushonin gjyqet dhe zyrat e tjera shtetnore dhe njerëzit të merreshin n'ato dit qetësisht me falje e vepra hyjnore. Në Antiokia dhe në Kostandinopojë bëhej meshë kishtare si të Premten ashtu dhe të Djelë. Si pas tregimeve të Eusebit, Kostandini i Math ndaloj edhe ushtrimet ushtarake që bëheshin ditën e Djelë. Me ligj tjetër, më 386, u-aprovuan përsëri urdhërimet e vjetër të Kostandinit dhe u-ndalua çdo akt zyrtar e politik në ditën e Djelë.

Qysh në kohërat e para të krishterimit pra, Djela ka qënë, është dhe mbetet dit' e Zotit. Në këtë ditë, të gjithë shpresëtarët dhe adhuronjësit e Zotit i lënë punërat dhe kujdesjet e përditëshme që kanë për jetën e tyre mbi dhé dhe e ngrenë mendimin e tyre lart ndaj burimi i qënies së tyre, mendojnë se kanë një rjedhje e një qëllim hyjnor. Të paktën ky është kuptimi i pushimit të së Djelës. . .

Dyke u-marrë para sysh nevoja e pushimit të njeriut një ditë në javë, në ditët e sotme e Djela është caktuar me ligje politikë si ditë pushimi e përgjithëshme.

Në këtë ditë pushon parmenda e bujku, pushojnë edhe veglat e puntorit dhe maqinat e fabrikave dhe shkollat ku edukohet rinia mbyllen.

Çdo klasë e çdo moshë e njerësve, qytetarë e katundarë, shkundet këtë ditë nga pluhuri i ditëve puntore dhe vishet me

rrobet kremtnore. Çdo njeri ka rastin të çlodhet nga mundimet e tërë javës, të qetësohet dhe të lartësohet shpirtërisht. . .

Dita e Zotit është ditë pushimi; veçanërisht për të krishterë. Këtë ditë, fuqitë t'ona shpirtnore, të thithura ditët e tjera nga kujdesi i punës dhe nga përpjekjet për rrojtjen, janë të lira e të qeta për t'iu kushtuar burimit të tyre, vet-vehtes, qënies së vërtetë të njeriut. Dyert e kishave janë të hapura për t'u dhënë prelljen e kënaqësinë hyjnore.

Por, mjerisht, sa ka sot nga ata që, ndonse pjestarë të grigjës së Krishtit, qëndrojnë lark kuptimit të vërtetë të pushimit të së Djelës, qoftë për snobismë, ose për mungesë të ndjenjës kristiane! Zënë që në mëngjes fronat e kafeneve e shumë herë mbyllen n'atmosferën e tyre mbytëse, në vend që të kalojnë të paktën një orë në një vend të shenjtë që u kujton predestinatën e tyre të lartë! Harrojnë ose s'duan të kuptojnë se kisha u jep diçka shumë më të lartë, i shtyn që të lakmojnë diçka më të vlefshme se parja: pastrimin dhe qetësin' e shpirtit të tyre dhe dashurin për njerëzit e për vepra të mira. Disa nga këta duan të thonë se pastrimin moral e veprat e mira mund t'i venë në zbatim edhe pa vajtur në kishë; por harrojnë përsëri efektin shpirtnor që ka falja e përbashkëtë n'atë shtëpi Zoti dhe digjimi i fjalëve ungjillore etj. të kishës. . .

Pushimin i ditës së Djelë, o i krishterë, të jep mjaftë orë të lira; përfito nga kjo dburatë dhe shko, ti e fëmija jote, të paktën një orë të digjosh fjalët e Zotit e po të mundësh përsëriti e komentoj-i ato në rrethin e miqve e të familjes s'ende. Do të kënaqet zemra; do të bëhesh më i mirë; do të gjesh ngushëllim në rasje hidhërimesh dhe shpresë e fuqi në orë nevoje.

Natyrisht, nuk do t'i lësh pa shijuar edhe kënaqësit' e tjera e gëzimet e kësaj dite; si njeri që je do t'i japësh vehtes kënaqësitë që kërkon dhe që gjen pas gjashtë ditsh pune e mundimesh. Zoti të ka krijuar edhe ty me të drejtë që të shijosh gëzimin e kësaj jete, si edhe çdo krijesë. Por ruaj-e vehten që të mos largohet nga gëzimet e hijshëm dhe të denjshëm; mos e ler të zhytet në dëfrime të paudhëshme, në skena të shëmtuara dhe në vepra të mekatëshme për të cilat do të pendohesh pastaj. Se atëhere shkelet Dita e Zotit, q'është e shenjtë.

Xh. V.

Nga kryeveprat e Atërvet të Shenjtë

Në çrast gëzohet armiku.

Armiku i ynë i padukëshëm d. m. th. djalli nuk kënaqet e nuk gëzohet, kur na sheh se ndodhemi në hidhërimet e në vuajtje. Jo. Hidhërimet t'ona nuk i sjellin as një gëzim. Ky këuaqet e kërcen nga gazi atëhere vetëm kur kupton se neve të shtypur prej vuajtjevet e humbasim shpresën, epemi përpara hidhërimit, largohemi nga besa ne Zoti dhe lemë të na shpëtoj nga goja no nje ankim e no nje qarje kundër providencës hyjnore. Abere po gazëllohen demonet, kërcejnë prej gëzimit dhe i fërkojnë duartë, pse neve rëshqitëm dhe u-larguam nga Perëndia.

Si shembëll të kësaj të vërtetë kemi Jov-in. Ky, siç dihet, humbi pasurin' e tij; fëmijët i vdiqnë; trupi i u mbush me plagë; më në fund u-mbulua me krimba e u kalb i terë. . . . Me gjithë këtë armiku nuk ndjevi as më të voglin gëzim e kënaqësi. E pse vallë? Sepse Jov-i me gjithë të këqiat q' i ngjajtnë, nuk e humbi shpresën, nuk u-mund prej fatkeqësivet, i duroi këto me një gjakftohtësi shembëllore dhe e falenderonte Zoti, dyke thënë pas çdo fatkeqësie; *Zoti i dha, Zoti i mori. Qoftë i bekuar emri i Tij*. Vetëm atëhere do të kënaqej armiku, në rast se ky njeri i drejtë do të epej, do të dëshpërohej, e do të nxirte nga goja no një ankim kundër Zotit, sikundër e këshillonte gruaja e tij.

Gjithë kështu ngjavi dhe më apostuli Pavlin. Kur pësonte ky e vuante të zif' e ullirit; kur e rëndonte dhe e shtypte urija dhe etja; kur e përballonte të ftohtën i xhveshur; kur lodhej pa masë dyke shëtitur botën pa pushim

e pa çlodhje. . . . ; kur i bënte terë këto, demoni nuk ndjevi as më të voglën kenaqësi. Përkundrazi pësonte ky, hidhërohej dhe këputej, kur shihte se apostulli i duronte këto vuajtje me aq trimëri shpirtërore, sa të thotë me një përbuzje e një apathi shembëllore këto fjalë: «*Kush do të mundë të na ndajë dhe të na largojë nga dashuria e Krishtit?*»

(Shën Vasili)

Nuk do të trembemi

Kur ke besim ne Perëndia dhe ne Krishti, mund t' a quash vetën krejt të forcuar e të siguruar. Mund të përmbysen të gjitha; mund të tundet toka nga termete; malet mund t' a lenë vëndin e tyre dhe të rrokullisen në mest të detit; mund të behen edhe shumë gjera të tmerëshme; po ti nuk do të trembesh as pak, mbasi ke Perëndinë si strehë e si azil, ke Perëndinë që të jep fuqi, të ndihmon e të ngushëllon në fatkeqësitë. Këtë besim pikërisht kishte dhe profeti David, kur thoshte: «*Perëndia e jonë është përikja dhe fuqi dhe ndihmës në lanërimet e forta që na plakosin.*»

Prandaj nuk do të trembemi, kur do të tundet dhe e k... do të rëzohen male mu në zemër të detëve.

(Shën Vasili)

Sasia dhe cilësia

Kur shëkon qytetarët e një qyteti të kërcejnë, të dehen, të këndojnë, të shajnë, të betohen, të shkelin betimin, të gënjejnë. . . atëhere thuaj me vete: Mjerë ti, o qytet; çpësove? Përkundrazi kur shesh në tregun e një qyteti njerës të pakët, po të urtë, të mençur, të matur e me moral, atëpëre lumuroje këte qytet. Sepse popullsia e pakët s' ka për t' a dëmtuar as fare, kur mbretëron aty virtyti dhe e mira, si kundër edhe shumica nuk mund t' i sjellë as një dobi, kur ndodhet në mes e liga,

Në se, thotë Perëndia në Shkrimin e Shenjtë, munuri i bijvet t' Israel-it është si shuri i detit, pak nga këto

do të shpëtojnë d. m. th. vetëm të mirët e të drejtët. Shumica, thotë, nuk do të më bëjë që t' i mëshiroj ata.

Kështu bënte dhe Krishti. Vajtoi për qytete, jo pse nuk kishin popullsi të madhe, as pse nuk ishin kryeqytete; po vetëm e vetëm pse brënda në to kishte hyrë e liga. Mos nuk qavi dhe për Jerusalem-in, ndonse ishte qytet i madh? Çtha? Jerusalem, Jerusalem, ti q' i vret profetët dhe të dërguarit e Perëndisë. . . . Pra, o të dashur, le të mos lozim e le të mos dëgjojmë se çthotë njeri e tjetri, po duhet të mësojmë se ku qëndron vlera e vërtetë e një qyteti dhe cila është ajo gjë, q' e bën këte të çquar e ndër të parët.

Në se do të kërkosh p. sh. t' i thurësh lavdërime qytetit t' onë, Antioqisë, mos fillo të flasësh për Dafnin e bukur, ose për shumicën e për lartësin' e selviavet, as për popullsin' e madhe, as për punën që banorët rijnë gjer pas mes nate në treg, dyke pirë e dyke biseduar, as më në fund për shumicën e sendeveq ushqimore. Terë këto janë sende lëndore e të përkohëshme që jetojnë aqë sa vazhdon jeta në këte botë.

Prandaj pra hiq dorë nga këto dhe mundohu të m' a lëvdosh qytetin ndryshe. Si vallë? Dyke më thenë, se banorët e qytetit janë njerës të ndershëm e të mirë, se janë të sjellshëm e plot me mëshirë e dhemçuri për ata që vuajnë, se janë fetarë dhe dëgjojnë rregullisht e me kujdes fjalën e Zotit. . . . Këto janë lavdërimi m' i madh i një qyteti dhe jo pasuria ose madhëria e ndërtesavet.

(Gojarti)

Përkth. prej Shprestarit.

MENDIME T' ARTA

Është i lumtur ay që ndjen plagën që ndodhet mbrenda në shpirtin e tij dhe i lutet mjekut që t' a shërojë, dyke i thënë si David-i shëromë, o «Zot, se u-tronditnë eshtrat e mija», «O Zot, mëshiro-më, shëro-më shpirtin, se mëkatova përpara Teje».

Në këmbët e Shpëtimtarit

(Pas Anton Huonder-it)

17. E vjera e Petrit — Jisuj dhe prifti në shtratin e të sëmurëvet.

(Lluka 4,38. Mark 1,29. Matthe 8,14).

Vizitimi i të sëmurëvet është një nga detyrat më kryesore të priftërisë. Ç' shembëll të bukur na jep Shpëtimtari!

1. Në shtëpin e varfër të një peshkatari për anë liqenit, është gjëm' e madhe. E vjera u Petrit vuan nga ethet. Shpëtimtari e dëgjoj dhe deshiron t' a shohi. Na vjen sikur e shohim si i ngjit shkallat e ulëta që çojnë në dhomën e gruas së sëmurë, siç janë shkallat e banesave nëpër fshatrat e Lindjes; me ç' ëmbëlsi i përshëndet njerëzit e shtëpis dhe i pyët me pasion! S' munt të përshkruhet gëzimi i tyre pse patën nderin të presin në shtëpi një mik të till.

Jisuj në shtratin e gruas së sëmurë. Hap syt uratë, dhe vër re Jisujn si bën, si sillet m' atë! Si hyri në shtëpi, i përshëndeti dhe u dha kurajo të gjithëve. Pastaj i a nis punës: «e mer prej dore dhe e ngre. Shih se si duart e rudhura të plakës mbështeten në të djathtën e Tij të shënjtë, dhe nga syt e tij lëshohet përmbi të një vështrim i but e plot me mirësi. Një rrëqethje i ndëpërshkon trupin, syt i lëshojnë shkëndira gëzimi dhe e tërë fytyra i shkëlqen. «O Perëndi e ime, jam e shëndoshë». Pastaj e sho-

him të mirret me punët e shtëpis, dyke hapur pëlhurën më te mirë dhe dyke vënë peshkun më të mirë në tryezë.

Sa të lumtur e ndjen ajo që priti dhe i shërben Atij, i Cili i solli në shtëpi gëzim, ngushëllim dhe bekim!

2. E çon dhe ti vall po atë ngushëllim nëpër shtëpitë kur viziton të sëmurët? Ç' mirësi munt të përhapësh në raste të këtilla, po të dish si të sillesh! Përkundrazi, ç' gjë e keqe është, kur ti paraqitesh në dhomën e të sëmurit indiferent dhe pa ndonjë ndjenjë mëshire dyke bërë shërbesën e efgelisë dhe të kungimit të shenjtë në menyre mekanike, pa u dukur në syt e tu një rezë dashurije dhe dinjiteti! Një vizit' e tillë, jo vetëm që nuk do t' u sjellë ndonjë dobi të sëmurëvet, por dhe do t' i dëshpërojë pa masë. Të ngratët, kanë për të marë fyromë më lehtë, nëse shpëtuan pas një vizite miqësore.

18. Të shtrënguarët e gjindjës — Ditë zgjimi.

(Lluka 5, 1-3)

1. Predikimet e thata, pa frymë, pa jetë dhe dashuri, që mbajnë shkronjësit, s' i japin popullit asnjë ushqim shpirtëror. Ay dëshironte diçka të re. Prandaj shtrëngohet të shkojë me shumicë pas Shpëtimtarit, i Cili me predikimin e fjalës së Zotit në tërë bukurin e thellësin e sajë, i nginji plotësisht. Sa i ushqyer keq është dhe sot populli në punët spirituale!

Ay bari shpirtëror që i jep popullit zgjuarësin e tij të vogël, në vent që t' i predikojë me fuqi dhe bindje fjalët e jetës së perjetëshme, nuk e do grigjen. Populli i varfër, ç' etje ndjen për ndonjë gjë të re dhe si grumbullohet kur vjen një lajmëtar i vërtet i fjalës së Zotit:

2. *Populli grumbullohet.* Kur ka një dëshirë të flagtë, ay grumbullohet, s' mendon të shkojë pas rregullavet të mirësjelljes. Kështu është dhe sot. Si grumbullohen e shtrëngohen në disa raste, siç është ujët e bekuar, inagurimi i një kisha etj! Në këto raste prifti porsa munt të yihet re prej gjindjes.

Mirëpo Shpëtimtari di se si të ndihmohet e t' u për-

shtatet rethanavet. Hypën në një lundrë, e largon nga bregdeti dhe kështu rregullon në mes te valave një amvon. Çdo dëgjonjës zë vënt anës së liqenit dhe dëgjon me vëmendje zërin e pastër dhe tingëllonjës t' Atij që flet nga lundra. Ay kurrë në raste të këtilla nuk çfaq ndonjë shenjë padurimi dhe zemërimi. «Nukë do të bënjë fjalë, as nukë do të bërtasë, as nukë do të dëgjonjë ndonjë zën' e Atij ndëpër rrugat». (Matthe 12,19)

19. Përtej! — Heqje dorë nga mirënjojtja dhe çplodhja.

Populli i entusiasmuar dhe i shpirtëzuar dëshiron qe t' a ndalnjë. Mirëpo ay do që të shkojë më tej. «Duhet që edhe ndëpër qytetet e tjerë të ap zën' e mirë për mbretërin e Perëndisë; le të vemi ndë kryefshatrat më t' afërta që të leçis edhe atje, sepse për këtë punë kam dalë». (Lluka 4,43 Mark13,8)

1. Degjon o uratë si flet Shpëtimtari pasi mbaroi një punë të mirë: «të hidhemi përtej!» Ay nuk ndalet për të dëgjuar lëvdatat dhe përkëdheljet e njerësvet por vete përpara dyke ditur se shumë punëra po e prisnin akoma. Kështu edhe ti, pasi ke bërë ndonjë vepër të mirë, mos prit që të mbledhësh lëvdatat e atyre që të shohin, por ec përpara, në punë tjetër.

2. Më tej! Sa gjë e rëndë është këjo për një prift, i cili u-mësua në një vënt ku për shumë vjete rrjesht ka punuar me ndërgjegje dhe ka fituar besimin e besnikëvet dhe tani detyrohet të shkojë në tjetër vënt! Gjë e rëndë është vërtetë të lerë ay që të korrë tjetri çka vet ka mbjellur, ndërsa ay duhet të shkojë më tej, për të filluar përsëri nga puna, ndofta në ndonjë ugar shumë më të fortë! Sa i hidhur ka për të qenë një largim i till! Mirëpo prifti duhet të jetë gati për të shkuar atje ku e thërresin nevojat e mbretëris së Perëndisë dhe ku e dërgon Kisha. «Sepse për këtë punë kam dalë».

3. Më tej. «Duhet që edhe ndëpër qytetet e tjerë të ap zën' e mirë për mbretërin e Perëndisë». Këto fjalë duhet t' i zbatosh edhe në vetën t' ende uratë, sepse ti pikësëpari duhet të përparosh duke shtuar njohnit e tua dhe dyke for-

cuar virtytet, në do që të udhëzosh dhe të tjerët më tej n' udhën e jetës së krishtere.

20. Sill lundrën ndë ujërat të thella — Në hapësirën e jetës

“Sill-e ndë ujërat të thella” (Lluka 5.4).

1. Dëgjon i dashuri bari shpirtëror? «*Sill-e ndë ujërat e thella*»! Të mos mbetesh anës së liqenit por fut-u atje ku të presin suksese më të mëdha. Mos u-kënaq me sukseset e vogola të përditëshme që e fiton me lehtësi, por përmblihdh-i fuqit e tua, hyr në të thellat e punëvet, dhe prek problemet e mëdha të jetës. Dil nga rrethi i ngusht i kishës e fut-u në jetë, në mes të popullit. Ç' lloj peshkatarit ka për të qenë ay, që do të ketë frikë prej ujit, prej erës e prej dallgavet?

2. *Sill-u në të thellat!* A nuk i tingëllon në vesh këjo fjalë dhe çdo prifti të ri, i cili në rrethin e ngusht të vepërimitaris së tij, nuk gjen punë të mjaftë pas fuqis dhe etjes për punë që ka? «Dil në thellsinën e detit» «Eja eja ndër ne», dëgjohej zëri së largu, këtu ka më shumë punë, këtu të presin fryte të pasura, këtu është vendi për të vleftësuar fuqit e tua, këtu munt t' u vish në ndihmë mijrave njerëzish që thërresin për shpëtim. Lart pra, përvish-i duartë dhe dil në hapësirën e jetës!

MENDIME T' ARTA

Njerëorasësi — siç e ka qojtur Zoti djallin — e di mirë se mekata është helmi i shpirtit, e se rrëfimi është më i miri mjet për t' a nxjerë nga shpirti këtë helm. Për këtë arsye i mban të mbyllura buzet e të krishterit dhe fshen fellë në zemër të fshehtën e mekatës, që të sigurojë mirë helmatimin e shpirtit.

Ungjilli mbi të falunit e fajevet

Ungjilli i së Dielës kalushme, këndonjës të dashun, na mëson një nga virtutet ma të nalta të doktrinës hyjnore, na mëson mbi faljen e fajevet njani tjetrit. Shpëtimtari, gjithë jetën e Tij e mësonte këte virtut me fjalë e me vepra. Dhe kur ishte i varun mbi kryq e përsëriti tue than: «O At ndjej ata sepse nuk din çfar bajn! Kurr ndo një herë nuk asht ndëgjue në vendin e egzekutimit një kësoj fjalë, por përkundrazi njerzit e asaj kohe thërritshin perëndit për hak-marrje. Kur Zoti Krisht e lut Atin e Ttj qiellor me ja falun fajet atyneve qi e kryqëzuen. Në vuetjet e pa-meritueshme mbi kryq, i madhnueshëmi mbi çdo madhëni të kësajë hote dhe i naltësuem mbi dietarët e mësuesët, mbi mbretnit dhe gjykatsit, mbi reformatorët dhe revolucionerët, Zoti Krisht me shembllën e faljes së Tij mbi kryq, e volosi Ungjillin e Tij.

Për me tregue se pa falje, as mbretnit s' duhet me mbretnue, as gjykatsit me gjykue, as dietarët me fillosofue as mësuesit me mësue, as reformatorët me reformue, as kryengritsit me veprue. Dhe mbi të gjitha, Zoti deshi me tregue se pa falje njerzit nuk munden as me e kuptue as me e zbatue Ungjillin e Tij të Shenjtë.

Çfar kishte me qen shoqnia njerzore pa falje? Nji pyll i tmershëm plot me egërsira. Çfar kishin me qenun ligjët e njerzve të mos i zbusi falja, veç se pranga të pa durushme?

Pse, a kishte me u quejtun moma, mom, pa falje, dhe miku mik, dhe i krishteni i krishten? Jo, falja ka përmbajtjen kryesore të këtyne titujve.

Të mos ishin fjalët: më fal! dhe: hajt se t' a kam falun, jeta njerzore kishte me qen krejt e pa-durueshme. Nuk egziston nji e till dije mbi dhet e cila të kishte vuem rregull dhe paqe ndërmjet njerzvet, pa shembllën e faljes. As qi egziston nji shkoll ose pedbagogji, e cila të mundet me krijue njerz shpirtgjan e fisnik pa me u stërvitun si me falun.

Çfar vlefte ka për njerin dija e gjithë kësajë bote, kur ky nuk asht në gjendje me i falun t' afërmit tij fjalë ofenduse ose nji vështrim ofendues? Kurgja. Dhe çvleftë kan për njerin njiqind okë voj para alltarit, kur ky nuk do me e zbut zemrën e me i falun fajet fajtorvet tij?

Si, dhe sa herë lypset njeriu me falun, u përgjegj Zoti kur e pyeti Petri: shtat herë, dhe masandaj shtat herë shtatdhit. Por për me e spjegue ma mirë këte Zoti tregon nji parabull ku krabason Perendin me nji mbret të mirë dhe njerzit me shërbetorët e tij.

Mbretnija e qiejvet u përgjajt me nji njeri mbret i cili deshi me bam hlogari me shërbetorët e vet. Mbretnija e qiellit nuk mundet me u zografis me bojë as me u përshkrue me gojë, veç se me u përgjajtn me ngjarjet e kësajë bote. Njeri mbret d. m. th. mbret i mirë, i cili do me bam hlogari me shërbetorin e vet. Këtij i pruen përpara nji borxhli qi i kishte borxhë 10,000 tallanta. Këto me paren e soçme bajn 2.310.000 lira sterlina. Kjo borxhë asht e madhe dhe për nji shtet e ku për nji njeri. Po ç' asht kjo? Shum ma i math asht numri i mëkatevet t' ona para Perëndisë i borxhvet t' ona kundrejt Atij. Prandaj dhe përdoret ky numër i math qi kur të krabasohet me mëkatet t' ona tjet krejt i përshtatshëm.

Edhe mbasi skishte me ja lam, i zoti atij urdhënoj me u shitun ai, edhe grueja e atij, edhe të bijt, edhe gjithë ç' kishte edhe me u lam borxha. N' atë kohë mbas ligjvet si rromakvet ashtu edhe judhenjvet borxhlin i fukarosuni mundesh me u shitun skllav bashkë me gjithë familjen e tij. Kjo pra, qi urdhënon mbreti asht mbas drejtësisë dhe ligjës. Kuptimi i mbrendshëm i urdhenit të mbretit asht ky: Kur mëkatet t' ona kalojn çdo të matme, atëhere Zoti

na i merr dhuratat e Shpirtit Shenjt, të cilat e bajn njerin njeri,

Shërbëtori pra i ra ndër kamb, e i lutej, tue thanë, Zot, bahu zemërgjan mbë mue, edhe kam me t' i lam të gjitha. Edhe të Zotit si i u dhims ai shërbëtori, e lëshoi, edhe i a fali borxhën. Çfar ndrëshimi i përnjihershëm dhe çfar mëshire e pamatun! Falet borxha aq e madhe dhe epet lirija! A nuk asht kjo me të vërtetë dhurat mbreti? Kështu nuk veprojn mbretit e dheut. Nji të këtill mëshirë mundet me treguem vetëm Mbreti qiellor. Dhe Ai këte e ban shpesh herë. Kudo qi njeriu vjen në vehte dhe pendohet idhët për mëkatet e tij, mbreti qiellor asht gati me ja falun 10.000 dengje mëkatesh dhe me ja kthiem prap të gjitha dhuratat e Shpirtit Shenjt. Kështu dhe me shërbëtorin borxhli të Ungjillit soçëm.

Por ai shërbëtori si duel, gjeti nji prej shërbëtorvet shokvet vet, qi i kishte detyrë 100 dinar, edhe si e zuni, e kapte për fyti, tue thanë, më laj borxhën qi më ke. Vështroni çfar sken e tmerrshme krijohet prej shërbëtorit lik. Këtij ju fal borxha e jeta, ky mbyl shokun e tij për 100 dinar.

«Atëhere pra shërbëtori shoqi vet i ra ndër kamb, e i lutej tue than: bahu zemërgjan mbë mue, edhe kam me t' i lam të gjitha». Dhe ai nuk donte, por shkoj edhe e vunë në burg deri sa t' i laj borxhën. Kështu silllet njeriu kundrejt njeriut. Dhe nji sjellje e këtill e njerzvet e ktheu mëshirën e Perëndisë në drejtësi. Sa herë qi njeriu tall mëshirën e Perëndisë ja mbërrin drejtesija e Perëndisë; dhe drejtesija e Perëndisë asht ma e tmerrshme mbas të tallmes mëshirës së Tij. Mos u gënjehi, thot Pavli: kombevet, Perëndija nuk përbuzet me të tallun, sepse çtë mbjelli njeriu ate do të korrë. Vlezën jo me tall Perëndin, se tmerr asht me ran në duerët e Perëndisë gjall (Jlp. 10,31). Dhe ja si asht tmerr:

Edhe shërbëtorët shokël e ati kur pan se çfar ngjau u idhnuen fort edhe erdhën e i dëftyen të zotit vet gjith çka ngjau. Atëhere i Zoti ati e thiri e i tha: shërbëtor i keq, gjithë atë borxhë ja lash, sepse mu lute; nuk duhesh

edhe ti ta ndjenje shërbetorin shokun tand, si kur se të ndjeva dhe unë? Njeriu mbret, si mbretnit dhe gjykatsit e mirë nuk do t' a dënoj shërbetorin e keq pa i tregue fajin e tij: dhe fjalën e mbaron në form pyetje qi të mos ket si të përgjigjet shërbetori i lik. Mba një heshtje të tmerrshme epet vendimi i tmershëm i gjyqit. Edhe i Zoti ati u zemëruë edhe e dha në duer t' atyneve qi mundojnë deri sa të laj gjithë borxhën qi kishte. Kështu asht i tmerrshëm vendimi i Zotit kur kthehet mëshira e Tij në drejtësi. Njeriu mbret e dorzon shërbetorin e keq në duer t' atyneve qi mundojn — në duer të frymave të liga të djajve; deri sa të paguej gjithë borxhën e tij d. m. th. për gjithë jefën, mbasi ai nuk ka mundësi me e lam një të till borxhe.

Kështu edhe em At qiellori ka me u bam juve ndë mos i falshi me gjithë zemër gjith se cili vllajt vet fajet e atyneve. Ky asht kuptimi ma kryesor i kësaj parabule. Këto fjalë nuk mund të kuptohen ndryshe, veç se egzakt kështu si i thot Zoti. Njashtu si do të sillemi neve me vllëznit t' onë gjithashtu ka me u sjellun edhe Perëndija kundrejt nesh. Nde mos u falshim fajet vllëzëvet t' onë, dhe jo për sy e faqe, por me gjithë zemër, atëhere Perëndija, Krietari jonë dhe i vllëzënvët t' onë, ka me na bam neve ashtu si kur se e bani njeriu mbret me shërbetorin e tij të keq, dhe ka me na dhan në duert e tyneve qi mundojn — djajvet në mbretnin e erresinës, ku ka me qen vaj e paprajtnun dhe të ngërculluemit e dhambëvet. E të mos ishte kështu a kishte me e than Zoti Krisht këte? Prap thot: sepse me çfar gjykimi gjykoni keni me u gjykuem edhe me çfar matsi matni kan me u matun juve. Të jemi gjithë fajtorë ke Perëndija. Dhe kur të ndjekim ndonji fajtorin t' onë duhet të kujtohem si fajtor jemi na ndaj Perëndija. Dhe kujtohem si me çfar matsi masin, m' ate kan me na matun.

Prandaj, vllëzën, le të rendim, me i falun fajtorët t' onë për me zbatue premtimin qi apim në lutjen Ati ynë si kur se dhe neve ja falim fajtorvet t' onë, qi kështu të plotsojmë porosin e Zotit në të cilë varet jeta e jonë Amin.

Ushtari i Krishtit.

Manastiret kryesore të Dhioqezës së Beratit

II.

2. *Manastiri i Ardhënicës*. Udhëtari që shkon nga Lushnja për në Fier do të shofij me një herë mbi një breg të lartë, i cili ndan të dy Myzeqet, Monastirin e Hirshëm të Ardhënicës, midis selvive e pemve, ku dallohet kambanorja madhështore.

Për të vatur atje do të ndalet afër katundit Kolonjë dhe, pasi të marrij rrugën përpjetë, pas gjysmë ore afro, në këmbë ose kaluar, arrin në Monastir. Këto koherat e fundit është goditur dhe rrugë për automobil, që shpie mu brënda në oborr të Monastirit, e përdorueshme në verë

Ky Monastir i Shenjtë është godin' e gjerë dhe, si ndërtesë e fortë, që të jep të kuptojsh, se mund të ketë sherbyer dhe për qellime ushtarake. Dhomat janë rreth e rrotull Kishës bashkë me kthina të tjera, që sherbejnë për të pritur katundarët që venë për ditë festash e panairesh. Shumë reliefe e mbeturina arkitekture të ngulura nepër mure janë sjellur që të gjitha nga Pojani. Te një burim i vogël, sot pa ujë, në oborrin e Monastirit ndodhet një fund shtyllë e vjetër. Një cung shtyllë sherben për të mbajtur tryezën e altarit të Kishës së shën Triadhës, që gjendet pranë Kishës së madhe. Te qilari i druve gjendej në mur një kok' e gurtë me mjekër dhe te kambanorja, prap në mur, ndodhet një kok' e rruar e një Perandori të stolisur me kurorë dafine.

Kur është themeluar ky Monastir nuk dihet me siguri, pasi nuk kemi ndonjë burim të saktë historikisht. Duket, se është themeluar në kohën e Dhespotatit të Epirit, d. m. th. në Shek. 13 a 14. Kisha e tij në emër të Sh. Mëris e demtuar nga koha, u-rindertua gjene në vjetet 1743-44, siç duket nga mbishkrimi i poshtëshenuar, që gjendet sipër derës së Kishës nga brënda në gjuhën greqishte: «U-ndër-tua këjo Kishë e Hirshme në kohën e Mitropolitit të Bera-

tit Imzot Methodhit, të Igumenit Andon, të hieromanahve Pangrat, Klement, Viqent, Manasi, Mitrofan, të hierodhia-kojve Josif e Jerothe dhe të monahve Vasil, Theoktih, Kozma, Joaqim, të cilët për mundimet e tyne fitofshin mbretrin e qiejve. Viti nga mishërimi 1744. Shkurt. Me dorën e vëllezve Konstandin e Thanas nga qyteti i Korçës.»

Por përmbi Portën e Madhe të Monastirit nga an' e brendëshme duket e gryer mbi gurë këjo datë e thjeshtë greqisht 1477, 1 Maj, e cila ndoshta në kohëra të lashta qe vënë mbi Kishën dhe kur u-rindërtua këjo, u-vu këtu ku gjëndet sot. I këtij mendimi është edhe Mitropoliti i dikurshëm i Beratit Anthim Aleksudhi, i cili ka berë një përshkrim shumë interesant të Dhioqezës së Beratit. Ky libër i shkruar më 15 Jenar 1868, u-konsakron disa faqe edhe Manastirëve të Beratit, që stolisin siç thotë atë Dhioqezë moralisht e shpirtërisht dhe tregojnë përdëllimin e themeltonjësve të tyre.

Kambana e madhe ka datën shënuar mbi të të vitit 1707. Njëra nga kambanat e vogla ka datën 1738 latinisht. Nuk dihen peripetit e këtij Monastiri në kohërat e pastajme të okupacionit turk, sepse një zjarr aksidentalisht më 1932 dogji, veç një pjese të dhomave edhe bibliotekën bashkë me qimilet dhe gjërat e tjera të vjetra, që kish. As që dihet me siguri pasuria dhe t'ardhurat me të cilat mbahej shkoila dhe ushqeheshin e visheshin mjaft nxënës të vobegt, të katundeve rreth, veç strehimit që gjëjshin udhëtarë e shprestarë që e vizitojshin nga çdo anë. Nga sa shkruan i sipërpërmenduri Mitropoliti Anthim, Monastiri i Ardhenicës, që prej fillimit të sh. 17 e gjer në të 18-in kishte ndihma të shumta nga një shoqëri, që qe themeluar në Poloni e në Ungari, e cila mblidhte të holla e gjithfarsoj ndihma të tjera dhe i a dërgonte Monastirit ose drejt për së drejti ose me anë të miqve e gjinis, që kishin pjestarët e asaj shoqërie në Voskopojë, e cila lulzonte asi kohe, ku Monastiri i Ardhenicës kishte Metoh të vetë.

Misa të asaj shoqërie prej vitit 1777 gjer në vitin 1795 përmenden nga korrespondenca, e cila gjendej në arkivën e Monastirit, siç thotë Anthim Aleksudhi, midis të tjerëve

edhe Naum Moska, e motra me të birin Mihal, Papa Gjergji i Papa Simos, Athanas Gjergj Tupu, Nasto Kapu Mare, Naum Gjergj Tantani dhe Marko Rajko në Budapest të Ungaris. Në Poloni antarë të Shoqërisë përmenden Naum Jani Shaguna, Adham Kosta, Naum Dhimitri e të tjerë shpresëtarë që mirreshin me tregti n'ato vise, emërat e të cilëve qenë të shkruara në dhiptyhet dhe përmendeshin sipas rregullës.

Sipas një tradite, e cila përmendej gjer von në tërë Dhioqezën, thuhej, se në një nga tregjet e Vienës Monastiri i Ardhenicës kish një kandar, me lejen e qeveris Austriake me të cilin peshoheshin sendet që shiteshin në atë treg. T'ardhurat e kandarit i dërgoheshin Monastirit prej epitropve të venë për këtë qëllim. Nuk dihet se për ç'arsye u-syprimua këjo e drejtë aty nga viti 1815.

Monastiri i Ardhenicës më von, si duket, paska rënë në dekadencë dhe nuk përmendet gjë për 'të. Këto kohërat e fundit me përkujdesjen e administratorit të tashëm z. Luc Bozdos ka filluar të mëkambet e të përmirësohet. Shumë nga dhomat e qelit janë meremetuar, Kisha e Sh. Mëris është zdukuruar brënda e jashtë dhe vitin e kaluar është ringrehur pjesa më e madhe e dhomave që qenë djegur. U-bënë nja dy dhoma moderne dhe një taracë e mirë e kthyer nga perendimi prej nga vjen er'e freskët e detit. Edhe një pjes'e vogël që ka mbetur besojmë, se do të ndërtohet për së shpejti, në bazë të planit të studiuar mirë prej një kompetenti dhe të aprovuar prej Këshillit Ekonomik të Përhershëm të Kishës Autoqefale.

Të gjitha këto përmirsime u-bënë të mundshme edhe nga shkakut i vleftës së madhe që kanë sot prodhimet bujqësore. Dhe ky Monastir ka një pasuri jo të vogël. Nja 38 shtëpi bujqësh në katundet rreth, afro 1000 renjë ullinj të mbëdhenj e të vegjël rreth Monastirit e në Vlor' e Elbasan dhe gjë të gjallë. Një mungesë që ka është ujët. Që nga kohërat e lashta ka pasur një sternë brënda oborrit. Ndonjë çerek ore është një burim i vogël prej nga marrin me kafshë ujët. Përpjekjet për zgjerimin e burimit dhe sjelljen e ujit afër nuk patën sukses. Por duhet punuar edhe, se është një

mungesë e ndieshme për një të tillë Monastir, sidomos në kohë panagjiri kur besnikët janë të shumtë.

Na u-dha rasti të ndodhemi më 8 Shtator, kur është dita e Lindjes së Hyjlindses, që feston Monastiri. Që në mbrëmje të së 7-ës besnikë nga katundet rreth kishin mbushur Kishën mjaft të madhe të Shën-Mëris, si dhe hajatet e dhomat e shumta. Të nesërmen që në mëngjes nga tërë anët ngjiteshin shprestarët të tërhequr nga zëri i kambanave, që janë në kambanoren e lartë, prej nga pamja është me të vërtetë madhështore. Jashtë oborrit nga an'e perëndimit, ku duket se ka qenë hyrje e posaçme midis një serie selvish nga të dy anët, që pazari me lloi lloi sende dhe ushqime. Dreka u-shtrua në një sallë të madhe, ndërsa në dhomat e tjera grupe grupe qytetarë e katundarë bënë abenge dhe sazet binin pa pushuar. Zogt e pjekur dhuratë e besnikëve të katundeve rreth, sipas një zakoni të vjetër, paraqiteshin vazhdimisht nga shërbëtorët e Monastirit e s' kishin mbarim. Passi dolli dhisku dhe pelegrinët blatuan dhuratën e zakonshme, gjindja filloi të rallohet e kënaqur e plot zell fetar, që mburon nga Shën-Mëria e Ardhenicës ose Ardhevusa, siç quhet në gjuhën fetare greqisht, e përtëritur nga ajri i pastërt dhe nga ambienti sugjeronjës.

Në kohërat e para, siç thamë, Monastiri mbante shkollë dhe s'kursente ndihmën në tër' ata që i paraqiteshin. Edhe sot pritja e pelegrinve dhe vizitorve është e përzemërt dhe kontributi për arkën e Kishës s'onë Autoqefale jò i vogël. Edhe si vend klimaterik është fare i mirë me ajr të malit e të detit dhe me natyrë të kandëshme. Panorama është nga më të bukurat që kam parë. Tejt nga lindja ngrihet madhështor Baba Tomori. Poshtë nga jugu duket Karaburunit e Sazani dhe syri humbet në Adriatikun. Dhe rreth e rrotull fush'e bukur e Muzeqes me katundet këtu-këtje, me arat e punuara, me pyjet e livadhet e gjelbërta. Meriton, pra, t'a vizitohet çdo shqiptar e shprestar që të vaditet shpirtnisht te Shën-Mëria Ardhevusa (vaditje).

PAN.

I PENDUARI..

Motra dhe vëllezër!

Drejtuesi i radhëve të mëposhtme është një nxënës; bile më tepër se një nxënës; është një i penduar; dhe ja tregimi i pendimit:

Kisha mbyllur sytë dhe po ecnja, po ecnja pa pushim. Isha në moshë të pa-pjekur; më dukesh se çdo gjë që flytyronte haesh; nuk' mernja parasysh asnjë lëvizje të botës, më pëlqente mburja; desha të këshillonja e jo të më këshillonin; desha që gjith' bota të fliste për mua dhe kur dikush më pyeste për rrugën që isha tue ecur, gjenja shpejt arsyen që të mburresha!! Dhe, tuke ecur pa pushim si thashë, me sy të mbyllura, u-përpoqa pas një shkëmbi dhe nuk di në i ardhi keq Zotit për mua të mjerin, porse, dikush më tha: — Ej. Hapi sytë, ku po shkon? U-sqova nga gjumi i rëndë që më kish zënë, pashë tri rrugë: një më të djathtë që ish plot dritë, një më të mëngjër plot erësirë dhe ajo që po shkonja unë; herë ishte me gjëmba, gurë, shkëmbënj; herë luadhe, rëzime, të përpjeta e tatëpjeta. Ndenja për një kohë, gati për një vjet, dhe po mejtohesh, po mejtohesha cilën rrugë të mirnja! Por sa i marrë që kam qënë! Një vit të mejtohem për rrugën që do mirnja! I dhashë kurrajo vet-vehtes e i thashë: — ej, njeri! nuk sheh? kaq budalla je? Dritën, errësirën apo gjëmbat preferon? U-hodha përpjetë, mora kuxim pshertita e thashë: DRITËN; DRITËN!! Që nd' atë ditë mora rrugën e dritës; Ecënj si i tërbuar. Kërkoj të gjej fundin por më është e pamundur; qanj si foshnjë për marëzinë t' ime por nuk gjej ngushëllim, e pas një udhetimi mjaft të gjatë ndjej të

kem një libër në dorë. Nuk e kuptova si m' u gjent; gjë e pa-pritur është por dhe e çudiçme! Këthej kryet, prapa që të shoh gjëmbat dhe errësirën, por shoh vetëm dritën dhe n' atë kohë, pasi më kishin hipur dirsë të holla ndenja më një vënt e po mejtoja të shkuarën. . . . oh! Pse po ri më kot! Pse po qëndroj pa kur-farë veprimi? Pse mos bëj diçka? kështu pyesnja vet-vehten. Dritë kam, pra le të shoh këtë librin çdo të jetë, çdo të ketë interesante? Do të jetë roman apo shkencë? Barrën e kam mbi kuris, mos kujtoni se kam barrë plaçkash. Ishte barra e rëndë, barra e fajit. Në këtë kohë drita bëhet m' e fortë. Hapa librin pa prituri ku më ndodhi dhe lexova këto: *«të shëndoshët s' kanë nevojë për shëronjës, po ata që vuajnë; s' kam ardhur për të thirrur të drejtët po fajtorët në pendim»*. (Mark 2. 17)

Nuk shkova më tutje. Barra e ime u-bë dhe më e ndijshme. Në këtë çast kuptova të mirën e të keqen, mburjen që më pëlqente dhe pendimin. Të gjitha i harrova. Lotët e mija rrjedhin porsì rrëke, këmbët më dridhen, fuqitë më priten. Rashë përbys dhe nuk mbaj mënd për sa kohë qava. Vetëm se kur u-ngrita isha i lehtë. Toka ku kishin rënë lotët ishte vaditur dhe kishin mbirë gjith' farësh lule të bukura. (Ishin lulet që prodhoj pendimi).

U-pendova, hapa librin e lexova në faqen e parë: «DHIATA E RE E ZOTIT DHE SHPËTIMTARIT T' ONË JISU KRISHT». Ky libër është shpëtimi që shpie në rrugën e Dritës; djalli është rruga e errësirës: gjëmbat, të përpjetat, gurët dhe drizat janë veprat e këqija në të cilat shkel njeriu pa ditur se ku shkon.

Pra, o i dashur vëlla e këndonjës! Në di tjetër të vuajë si mua, tregoj-i rrugën e pendimit, sepse vetëm me anën e asaj do mundë të shpëtojë kushdo që është lidhur tepër pas botës e kotësive të saj. Vetëm kur bëjmë një faj dhe pendohemi dhe nuk' e përsëritim, lirohemi nga errësira dhe marrim jetë të përjetëshme.

I penduari.

Mbreti të diturit e bariu i thjeshtë

Një mbret Arap pasi kish dëgjuar shumë herë të bëhej fjalë për Perëndinë dhe Ekzistencën e Tij në botë si i tërëfuqishim, dhe mbasi nuk i mbushej mendja për këto; porse m'anë tjetër ndërgjegja pasi nuk e linte, por e shtynte të dyshonte më diçka, thiri gjith të diturit e u tha: «Dua të më gjeni ç'farë bën Perëndija, cila është Perëndija e kush e bëri Perëndinë. Këto i dua brenda një kohe prej tre ditësh.»

U kthyen të diturit, u mejtuan shumë por më kot, nuk mundën të gjejnë përgjigjen reth pyetjes që ju kërkonte mbreti; pastaj u kthyen te mbreti e i thanë se nuk mundën t'i përgjigjen, por ay u zemërua fort, mbajti gjashtë më të diturit dhe i detyroj që mbrenda një kohe dhjetë ditësh ose të jepnin përgjigjen ose do të dënoheshin me varje.

Passi këta u munduan më kot për mjaft dit, ditën e nëntë kishin dalë jashtë qytetit, dhe tue ecur nga hidhërimi nuk dinin se ku vinin, asnjë zë nuk dëgjohej prej tyre ecnin si të çmendur dhe pasi ishin larguar mjaft nga qyteti, pa prituri kaluan nëpër mes të një kopeje dhënsh të cilat dhe i trepnë dhe u bënë shkakëtarë që ato të çpërdahen me furi. Çobani ngrihet, fillon të qetësojë dhëntë pastaj ju flet të dijturve pse bëjnë një pa-drejtësi duke mos shkuar në rugë por shkojnë duke përçarë dhëntë. Të diturit me përlësi e vajtim i përgjigjen: «Falna për këtë sepse nuk e kemi mendjen pasi nesër do' varem nga mbreti». Me kureshtje çobani ju drejtohet përsëri: «Po pse? ç'kini bërë?» «Ata ju përgjigjnë: «Mbreti na kërkon pa tjetër t'i përgjigjemi ne keto pyetje: — se ç'farë bën Perëndija, — cila është Perëndija dhe kush e bëri Perëndinë. «Bariu u përgjigj e tha: «Po këto pyetje kaq të lehta nuk i gjeni, juve që kini mbushur botën plot dituri? juve që çuditni njerëzit ç' do dit me fjalët t'uaja? Unë do t'i përgjigjem në këto. «Atëhere ata e ftuan barinë që të vinte bashkë me ta dhe ay u-tha se më të nesërmen kish për të vajtur në vëndin që caktuan dhe që andej te mbreti.

Passi vajti çobani në të diturit, u-nisën që të shtatë e

hynë në pallat të mbretit tue u paraqitur përpara tij.

— A e plotësuar detyrën, dhe a do më çpjegoni? pyeti mbreti.

— Të diturit i thanë; «neve nuk muntmë që të gjejmë gjë, por ky bariu ka për t'ju shpjeguar.

— Atëhere mbreti i drejtohet bariut: «I di konditat o njeri?

— Po o mbret; se po të mos përgjigjem mbi sa kërkon Madhërija jote dënohem me varje; por që të munt t'ju provoj sa kërkonti o mbret, dua që edhe juve të më jepni një shkresë ku do të shkruani se do të bëni sipas urdhrave të mija.

Me nj'herë e shkrojti mbreti dhe bariu filloj të shpjegojë.

— Kërkon të dish o mbret se ç'farë bën Perëndija?

— Po, dua.

— Sipas shkresës ju lutem o mbret të çvisheni laku-riq. — Në krye mbreti u zëmërua dhe nuk desh po pastaj passi pa se vehtë kish pranuar të bënte, u çvesh fare. Këtë bëri dhe bariu dhe i tha mbretit:

— E shëkon o mbret, se që të dy jemi një lloj, nuk kemi asnjë ndryshim?

— Po një lloj jemi. — Pastaj bariu vajti në vendin e robave të mbretit, veshi robat e mbretit dhe mbretit i tregoj robat e tija që ti veshë; dhe e pyeti përsëri: — Tani a jemi një lloj o mbret?

— Jo, tha mbreti me hidhërim. — Passi bariu i çveshi robat e i ndroj me mbretinë tue marrë gjithkush të tija: — Pra o mbret, këto bën Perëndija: që ty të beri mbret dhe mua bari, kurse në të vërtetë jemi një lloj të dy.

— Me të vërtet, e ke gjetur përgjigjen e parë; të lumtë i tha mbreti, tani më shpjego të dytën.

Mbasi ishte mesditë bariu ju lut mbretit t'a pasonte deri në kopësht jashtë, gjë që u bë dhe atëhere bariu i tha:

— Shtjer sytë përpjetë edhe shiko diellin mirë. — Mbreti j' u bind fjalës së bariut porse nuk' munte t' a shikonte dhe mbyllte sytë e këthente kryet më nj' anë.

— Bariu i tha: Pse o mbret nuk' bën si të them? Pse nuk' shikon diellin mirë?

— Mbreti përgjigjet: Nuk mundem, më vret sytë është i fortë.

— Bariu ja priti: Po kur nuk' mundesh të shohësh Djellën që është vetëm një krijesë e Zotit, si do mundesh të shikosh Zotin, Drita e së Cilit ndrit gjithë botën?

Me të vërtet më binde dhe në këtë, përsëriti Mbreti bariut.

— Sa për të tretën që kërkon të dish o mbret, se kush e bëri Perëndinë, kjo është më e lehtë nga të parat. Pra, o mbret nëmëro numura dyke filluar nga të mëdhatë për në më të poshtmet. — Ahere mbreti filloj nga dyzet e harriivi deri në tri, por bariu i tha që të zbresë akoma më poshtë, kështë ay zbriti deri në zero, dhe bariu ju përgjegj:

— Zoti u-gjënt i vetëm nga hicja dhe nga hicja krijovi njerinë.

Mbreti u-kënaq prej përgjigjeve prej bariut të thjeshtë dhe që ahere e mori dhe e mbante në pallat duke lavdëruar Perëndinë.

Përmblodhi: I Penduari.

LAJME KISHTARE

Panaire:

— Më 26 Korrik u-bë panairi i zakonëshëm në Kishën e vjetër dhe historike të Sh-Premtes në Kavajë. Në ceremonin q'u-kryesua prej H.Tij Imzot Irineut të dërguar nga ana e Kryesis së Kishës muarnë pjesë një shumicë besnikësh, jo vetëm nga Kavaja, por dhe nga Tirana e nga Durrësi. Në fjalimin që mbajti H. Tij Im. Irineu bëri një përshkrim të bukur të virtyteve të larta të shënjtorës së madhe, të cilën — shtoi — duhet që çdo i krishter dhe sidomos grat t'a kenë si shembëll në jetën e tyre.

— Më 15 të muajit Gusht Manastiri i hirëshëm i Shën-Vllashit festoi ditën e panairit. Mesha u-kryesua prej vet Kr. H. Tij Kryepiskopit t'onë Im. Kristoforit, i Cili në fjalimin e ditës theksoi detyrën e lartë dhe të bukur të mëmës së krishtere nga duart e së cilës mvarret edukata e parë e fëmijës. Kishin mar pjesë në panair një shumicë besnikësh nga Durrësi e nga rrethet.

Dorëzime:

Pas lutjes së katundevet respektive dhe aprovimit të Sinodhit të Shenjtë, janë dorëzuar në gradën e priftërisë këta kandidatë:

1. At Jovan V. Kosta për katundet: Peshtan, Konjsko, Terpeziça, Olshan e Lubanisht të rrethit të Sh. Naumit.

2. At Martin Murgu për katundet Selcë, Bumnec, Osholnicë dhe Delgosht të rrethit të Dibrës.

3. At Metodie Rosto për katundin Volino të rrethit të Struges.

Për shkak të vakancave verore revista kësaj here del dy numra bashkë.

Pikturime të vjetra të Jisu Krishtit

Që nga shekulli I.rë pas Krishtit. Në katakonmbet e Romës dhe mbi një copë stofë. Pkirusa "negative,, e trupit të Shpëtimtarit.

Për shumë kohë besoheshe përgjithësisht se të parat piktura të Jisu Krishtit filluan të çfaqen ndaj fundi i shekullit të II-të. Ky mejtim bazoheshe në hipotezën se, kujtimi i Shpëtimtarit ish shtypur aq fort në kujtesën e besnikëve të parë, sa që s' kishin nevojë për përfytyrime për t' a patur gjithënjë para syve të tyre.

S' ka dyshim se, ata që patën fatin t' a shohin dhe të dëgjojnë predikimin e tij, s' mund t' a harronin më fytyrën e tij. Mirë-po të tjerët? Si ish e mundur që të mos dëshëronin t' a shohin fytyrën e tij?

Kështu, në katakombat e Romës u-zbulua, në brendinën e një varri, një tikografi që tregon Krishtin. E disa elemente të padyshuarshëm provojnë se këjo është bërë në shekullin e I-rë.

Më me rëndësi është një pikturë e Jisujt mbi një copë stofe të linjtë, e cila konsiderohet si veprë e Apostol Petrit dhe gjendet në një kishë të Romës. Duket se Petri e pikturoi për mëndsh, për vajzat e një të krishteri Roman, i cili e priti mysafir në shtëpi të tij, si edhe Apostol Pavlin.

Zbulimi i këtyre dy pikturave ka, sigurisht, rëndësi të madhe nga pikëpamja historike. Janë, siç u-tha më sipër, pikturat më të vjetra të Krishtit, nga sa njihen deri më sot.

Por kemi para sysh ato piktura që janë bërë me dorë njeriu. Se ka edhe të tjera, të dala në menyra të tjera e super-natyrale. Ja këto:

Në Torino t' Italis, në një kishë private të familjes mbretërore, gjendet një kujtim i vyer i Shpëtimtarit: «Sindona» (çarçafi) me të cilën e mbështolli trupin e Tij Josifi, kur e çvarri nga Kryqi. Mbi këtë është shypur krejtësisht dhe qartë piktura negative domethënë me çkëmbim të ngjyrës së zezë e të bardhë, si në pllakat fotografike, e trupit të Shpëtimtarit, si nga përpara ashtu dhe nga prapa. Kështu është mësuar se Krishti kish gjatësi shtati prej 1,80 m.

Ky përfytyrim paraqet një realizmë që bën përshtyp-

je të madhe. Kur shëkohet me kujdes, dallohen të gjitha shenjat e Pësimeve të Krishtit: vijat e kamçikëve, çerrjet e lëkurës, plagët nga gjembat, të çpuarit e brinjës vrimat e goshdëve në duart dhe në këmbët. Dhe fytyra e Dëshmorit u-duk edhe më e gjalli kur u-fotografua piktura e asaj mbulese dhe u-bë një kopje pozitive me ngjyrat të rregullshme.

Ka edhe të tjera pikturime të Shpëtimtarit, të cilat, si pas traditës, s'janë bërë me dorë njeriu. Por nuk është vërtetuar ende autenticiteti i tyre.

E para nga këto është ajo që ndodhet në kishën e Shën-Bartolomeut, në Gjenovë. Legjenda thotë se një mbret i kohës së Jisujt, i cili vuante nga një sëmundje e pashëruarshme, dëgjoi të flasin për mrrekullirat e Jisujt dhe i shkroi dyke i u-lutur që të vinte në vendin e tij t' a shërojë, ose të paktën t' a lejonte piktorin e tij Anania që t' a pikturonte fytyrën e tij. Krishti s' mundi t' a bëje atë udhëtim. Por i kërkoi Anasisë një shami dhe fshiu me t' të fytyrën e tij. Atëhere u-bë një çudi: Mbi shaminë mbeti e shtypur qartë fiziognomia e tij. Kjo shami ruhet në kishën e Shën Bartolomeut.

Në Shën Pjetrin e Romës, gjendet një tjetër shami, e famëshmjja shami «e Veronikës». Gojëdhënëja — jo Ungjilli — thotë se një grua e qojtur Veronikë, e mallëngjyer nga vuajtjet që hiqte Jisui, kur ngjitej në Golgota, dolli me kuxim nga turma, e cila e shante dhe e pështynte Shpëtimtarin, që t' ja fshijë dirsën dhe gjakun që i ridhnin në fytyrë.

Karakteristikat e Jisujt u shtypnë atëhere mbi atë pëlhurën e hollë dhe mbetën ashtu edhe deri sot gjatë shekujvet.

Në një libër fetare, Shën Augustini shkruante se «fiziognomia e vërtetë e Jisujt na është e panjohur». Këjo ndofta ish e vërtetë n' ato kohëra kur qarkullonin shumë ikona të Jisujt të ndryshme midis tyre. Por jo dhe sot, që arti i fotografisë lejoi të përdoret lipsani i vyer i Sindonës së Shenjtë. Studimi i hollësishtë i kësaj fotografie do t' u lejojë artistëve që të nxjerrin piktura të Krishtit të njejtë me origjinalin.

Përmb. V. Xh.

Fjalë ngushëllimi

Dy të vërteta

Do të jetë krejt e pa mundur të sjellim me durim hidhërimet dhe padrejtësitë e kësaj, jete dhe me durim të presim mbushjen e porosive të Perëndisë, po të mos bazojmë zemrat tona në këto dy të vërteta themeltare.

E para: Që të gjitha ngjarjet e përditëshme të jetës tonë Perëndia i di, ndofta dhe i lejon.

E dyta: Që gjith sa lejon Perëndia janë të drejta, të vërteta dhe të dobishme sado të hidhëta që mund të na duken.

Pa këtë bindje, e cila duhet të jetë rrënjosur si shkëmb në shpirtet tona, në ngushticat më të vogla do të tronditemi, do të shqetësohemi, dhe në hidhërimet më të mëdha do të bërtasim dhe do mos durojmë. Është e natyrshme që njeriu i dobët të kërkojë mbështetje dhe ngushëllim, kur e takojnë borërat dhe fortunat jetsore. Po këtë mbështetje dhe ngushëllim, të cilin ay kërkon, as gjëkund i gjetkë nuk mund t' a gjenjë përveç se në besën në të dy të vërtetat për të cilat thamë më lart. Pò këto të vërteta mbështeten vall në bazë të sigurtë që të kemi besim nër to? Po. Mbështeten në besimin e merituarshmë të Jisu Krishtit, fjalët e të cilit kanë një rëndësi t' amshuar dhe të pa prishur. Ç'tha Jisu Krishti? — Ay tha se Perëndia dhe Ati, i cili paramendon dhe sundon gjithësinë, ka nëmëruar akoma dhe qimet e krerëve tona, se as një shpend s' mund të bjerë në tokë, po të mos dojë Perëndia. Dhe këtë e çfaqti Krishti që të mundnjë njeriu i llogjikshmë të gjëkonjë e të thotë:

Në është se Perëndia është i ditur dhe bile di dhe numurimin e qimevet të kokës s' ime, si është e mundur të

jenë ne Ay të pa-ditura mundimet të cilat unë i provonj për ditë, hidhërimet të cilat unë i vuanj? Dhe përsëri; në goftë se ky shpend, kriatyrë më e vogël, nuk do të binte në tokë po të mos e lejonte Perëndia, si do t' ish e mundur të bie dhe unë në këtë vënd, me kaqë hidhërimë dhe ngushtica, po të mos donte Perëndia?

Oh! po; Perëndia i di të gjitha sa na ngjajnë. Dhe Perëndia i lejon të gjitha sa na vijnë. Po Perëndia ç' është? Sunduës i gjith' urtë i gjithësisë, i cili me urtësinë e paanëshme drejton mizën e dheut, krimbin e dheut, por dhe aqë më tepër njerinë, kriatyrën më të zgjedhur të Tij.

Perëndia ç' është? Ati i ynë i tërë mirë, i cili lëshon shinë mbi të drejtët dhe të pa drejtët, dhe lind diellin mbi të liqtë dhe mbi të mirët. Është At mëshirash, i cili mëshiron dhe përdëllen dhe fal jetën e amëshuar në kriatyrat e tij mendore.

A është pra e mundur që çdo gjë që lejon Perëndia të mos jetë e drejtë, e vërtetë dhe e dobishme? A është pra e mundur të lejonjë Perëndia të dëmtohemë nga çdo gjë që na vjen për-para? Ah! jo, jo, është e pa mundur.

Këndonjës i im, shiguroje dhe ti zëmren tënde në këto të vërteta.

Janë të vetmet, të cilat mundin të ngushëllojnë zëmren tënde dhe të të frymëzojnë guxim pa dhembje dhe shumë durim.

Murgu

MENDIME T' ARTA

➤ — *Pësimet e vuajtjet e njerësvet, edhe atyre që janë të mirë dhe të shenjtë, janë përfundim i mëkatëshmenisë së njeriut. Po me anën e këtyreve ndjek dy qëllime: mbë njanë të zgjojë njerzit mëkatarë dhe t'i siellë në rrugën e pendesës, e mb'anë tjetër të shtojë e të zmadhojë vlerën e njerëzve të drejtë e të mirë, t'i lartësojë këta në sfera më të lartëra me anën e durimit e më në fund sjelljen dhe jetën e këtyreve t'u a paraqitë njerësvetë tjerë si shembëll e si model.*

JISILLA-U

Pu, pu! Ç' potere, ç' britma, ç' zhurmë! Thua se i tërë katundi është ngritur në këmbë. Rrugica e ngusht që lith mëhallen e poshtme me sheshin qendror, është mbushur me fëmij. Që nga ata pesë vjeçarët e deri në gjashtmbëdhjet vjeçarët, të tërë janë mbledhur e marin pjesë në sulm.

— Forca, Jisilla, forca a a a.....!

S' po mar vesh asgjë nga këjo histori. Miqt e mi, të gjithë vendas, më shikojnë, pse s' munt të hyj çështje.

Isha gati të kërkoj shpjegime, kur prapa një muri të prishur u-dëgjuan ca britma të ngjirura, që në fillim s'munt t' i dallonje në ishin rrenkime kafshe a po britma njeriu. Po atë orë, nga shtëpia e gjysmërrëzuar dolli te dera e zezë një fytyr' e egër.

— Plasje bre, do t'ju pi gjakun, bij ujqërish. Thyeni qafën këtej se.....

Dhe nisi të hedhë me gurë.

— Oh, oh!

Fëmijet u-shpërndanë andej-këndej. Ca u-futën brënda portavet, ca u-larguan aq, sa s' i zinin gurët.

— Jisilla, Jisilla, verë, na, verë. Forca a a a!

Dhe tani nisi kundrasulmi. Gurë të mëdhenj e të vegjël nisinë të binin mbi muret e mbi çatin e prishur të shtëpis së vjetër. Teneqet e vjetra dëgjoheshin me zhurmë. Fytyra e egër ishte mbledhur në një qoshe dyke pëshpëritur me zemërim fjalë të ndyra.

Miqt e mi vendosnë të ndërhyjnë.

— Ajde, shkoni, rrugacë. Në shtëpi tani. Pse e mundoni more njeriun?

Kryetarët e grupit dhanë shenjë të pushonjë sulmi. Por me gjithë këtë, për mjaftë orë teneqet tingëllonin ende dhe zërat e fëmijvet dëgjoheshin mirë.

— Jisilla, Jisilla.....

Vamë për në shtëpin e prishur. Isham kurioz t'a shikonja s'afërmi atë fytyrë t' egër. Kish dalë nga qoshja ku ishte fshehur dhe qëndronte te porta.

Ë vështrova. Ishte një njeri kock' e lëkurë. Fytyra e

tij e tmerëshme, pa ngjyrë, veç syvet dhe hundës q' ishin të skuqura si gjak. Mjekra e tij e zezë, e madhe. Flokët e tij, t' ashpëra, zbrisinin gjer në krahë. Ishte mbështjellur me recka q' i mbulonin gjysmën e trupit. Q' moshë munt të kishte? Di edhe unë? Munt t' a mirrje edhe për të ri edhe për plak.

U-nisa të shkoj për ne porta. Por porsa bëra çapin e parë, ay na hodhi një vështrim t' egër, plot me urrejtje, nxorri nga goja një fjalë të ndyrë dhe na ktheu krahët.

— Jisilla i mjer, pëshpëriti njeri prej nesh.

Mbrëmane, pas darkës, siç ishim të mbledhur në dhomën e ngrënjes së shtëpis ku qesh mik, morra vesh shpjegimin e skenës.

* * *

Ishte një ditë para Krisht-lindjes.

Teto Katingo-ja, q' e kishte shtëpin te rrugica e ngush-të që lith mëhallen e poshtme me sheshin e qendrës, ishte plot gëzim. Që kur qe zbardhur drita ishte në këmbë dhe, me gjithë pleqërin e sajë, s' kish ndenjur asnjë minut të çplodhej. Bashkë me 'të dhe vajza e sajë Evgjenia. E vërteta është se, me që ishte darkë Krisht-lindjeje dhe të gjitha shtëpit ndodheshin në lëvizje e sipër, s'munt të mbetej pas teto Katingo-ja. Po s' ishte vetëm këjo. Ajo q' i bënte t' ishin të gëzuara të dy gratë, ishte lajmi që dje më darkët u suall-në ca fshatarë nga qyteti: Djali i tyre, fëmia e tyre e mërguar, Ajisilla-u i tyre i dashur, kish ardhur në Pirë. Po atë darkë kish dhe vapor për në ishull. Do të arinte në qytet me të gdhirë dhe po atë ditë do t' a kishin në mes të tyre.

Gjë e pa-besuarshme i dukej këjo Teto Katingo-s. Do t' i vinte pra i biri? Si do të jetë vall? Do të jetë i shëndosh, i trash, i bukur? A po mos e ka dobësuar puna? Pa të shohim; motrën e tij Evgjenia do t' a njohë me një herë? E kish lënë dymbëdhjet vjeç. Tani është njëzetedy. Vërtet. Ka dhjet vjet që mungon. Dhjet vjet!

Dhe ndërsa Teto Katingo-ja rregullon shtëpin e shkund këtej e pastron andej, mëndja e sajë fluturon në kohët e kaluara.

Njëzet e-tre vjeç ishte Ajisillau i sajë, kur shkoi në

kurbet. Kish mbaruar gjymnazin posht në qytet — ç'mundime vërtet për të gjetur të hollat që i duheshin! — hyri si sekretar nja dy vjet në një zyrë dhe pastaj bëri shërbimin ushtarak një vit. Si u-lirua nga ushtëria, dëshira e tij që të shkonte në vaporët. Do të mbetej katër a pesë vjet në një vapor, dhe pastaj do të vazhdonte shkollën e marinës e do të dilte kapiden i tretë. Teto Katingo-ja dhe barba Kristua i ati i tij — se atë kohë rronte i ndieri — i dhanë uratën me gjith shpirt e zemër.

— Ec, or bir, udha të qoft e mbarë dhe Zoti me ty.

Zbriti në qytet. Gjeti vapor dhe s' e humbi rastin. Hyri në shërbim me një herë. U nis në për Detin e Zi. Ngarkuan mall në Kōnstancë për Masali. Pastaj ngarkuan hekur në Roterdam për në Aleksandri dhe më vonë mandarine e portokalle nga ishulli Hios për në Danzik. Bënë dhe-udhëtime të tjerë. Javë të tëra udhëtonin nëpër oqeanet.

Por s' kish mbyllur edhe një vit, dhe Ajisillau ndërroi program.

Bënë një udhëtim për në Argjentinë. Do të ngarkonin grur në Buenos Aires për t' a çuar në Sauthampton. Aritën afër mbremjes në skelë, e pastaj ekuipazhi u-la i lirë gjer në drekë të ditës nesërme. Dolli dhe ay. Në një qendër, krejt rastësisht, njojt atë mbrëmje një bashkatdhetar. Nde-njnë bashk e u-fjalosnë. Dhe ay punën e kish nisur me vaporët. Por kur gjeti rastin, preferoi të dali atje e të punojë. Pse të vërtitej nëpër detrat? Këtu e kish gjetur mirë. Rrogë e kënaqëshme, pun' e sigurtë. Ajisillau e dëgjonte me vëmëndje. Pastaj ay shtoi se shoqëria kërkon tani dhe një tjetër nëpunës dhe se, po të dëshironte, munt të hynte ndërmtjetës.

— Ç' thua. mbetesh a po jo?

— Si jo? mbetem.

Dhe mbeti. Në vapor s' e panë më. Ngarkuan dhe iknë — dhe Ajisillau i la me shëndet për gjithmon detrat e oqeanet.

Dal-nga-dal u-njojt me shumë njerës. Miku i tij—ishin bërë miq të ngushtë më — e çonte në të gjitha anët. E çoi dhe në një klub «mendimi i lirë» ku shkojshin njerëzit e civilizuar...

Me kalimin e kohës letrat për në shtëpi bëheshin sa më të ralla. Po teto Katingo-ja i jepte të drejtë. — Do të ketë shumë punë im-bir .Pastaj, kurrë s'e kish haruar krejt. Gjithënjë do t'i çonte diçka, që t'i a bënte jetën më të lehtë.

— Lavdi past Zoti!

Bën kryq plaka dhe, e palodhur, breth posht-e-lart dyke shkundur, dyke pastruar e dyke bërë pregatitje bashkë me të bijën Evgjenia.

*
*

Shtëpia e vogël e teto Katingo-s, e ndërtuar në rrugicën e ngushtë që shpie nga mëhalla e poshtme në sheshin qendror, panigjirizon. Ç' kallaballëk është mbledhur! S'kish kaluar gjysmë ore që Ajisillau kish zbritur te porta e shtëpis së tij prindërore, dhe gjysma e fshatit ishte mbledhur atje. T'afërmë miq, të tërë vrapuan t'a përshëndesin nga zemra e t'i urojnë mir-s'ardhjen.

Teto Katingo-ja këcen nga gëzimi. Tani qëndron për të shikuar me mburrje djalin. E shikon, e shikon dhe s'nginjet. Tani vrapon të ndezë të dy llambat e vaj-gurit dhe të tri bishtoret me vaj të mirë. Evgjenia, vajza e sajë, me tabakan në dorë, qiras vizitorët me llokum e ujë.

Dhe Ajisillau në mes të dhomës, nënqesh i kënaqur dhe u flet të gjithëve. Të tërë e pyesin dhe të tërë e dëgjojnë dhe të tërë duan të mësojnë për Amerikën, për qytetet që kaloi, për botën që pa. Dhe të tërë me gojën hapur dëgjojnë tregimet që ay u thotë për ata vise të çuditëshme që kur neve kemi ditë ata kanë natë, për njerëzit e çuditëshmë, të zezët si vorba, të kuqët si paparunë, për shtëpit e larta me të pesdhjet katet, nga të cilët vetëm një munt të nxërë tërë fshatin!

Pa pritur në portën e jashtme të shtëpis u-dëgjuan trokitje dhe zëra fëmijsh.

— Teto, mirse-na-prite. Për shumë mot. T'i themi? dhe pa e pritur përgjegjen, nisë të tërë së bashku të këndojnë me zërat e tyre t'ëmbëla, këngën e Krisht-lindjes.

Ajisillau, porsa dëgjoi fjalët e para, e ndërroi me një herë tonin. Morri një qëndrim plot përbuzje.

— Uf tani.....

Të gjithë e vështruan me habi. Ç'ngjau kështu? Ndërkaq përjashta, zërat e ëmbëla të fëmijvet po vazhdonin dyke kënduar kolendrat.

— Thuaj-u të pushojnë, i tha i zëmëruar Ajisillau motrës së tij. Na jep-u-a dhe këtë që të pushojnë.

Fëmijt muarnë me gëzim paren prej sërmu dhe u-nisnë për tjetër shtëpi, dyke thirrur:

— Për shumë mot, teto Katingo, për shumë mot!

— E pra, ku mbetmë? tha Ajisillau dyke gjetur qefin e parë. A, po; më erdhi ndër mënt. Dhe nisi përsëri tregimet e tija.

Të tjerët e dëgjonin prapë me kujdes, dhe brënda një kohe të shkurtër incidenti ish harruar krejt.

Sa orë kishin mbetur kështu dyke biseduar? Asnjë s' e kish vënë re. Por për një moment u-dëgjuan dyke kënduar këndesat.

— Mesnata! tha njeri nga ata.

Ajisillau vuri dorën në xhep të jelekut dhe nxori orën e tij të varur në mes me një kadhenë të trashë prej ari.

— Dymbëdhjet pa çerek, tha.

Ca u-ngritnë nga vendet e tyre.

— Është kohë të shkojmë, tha dikush. Duhet t' u lëmë edhe juve të qetë. Nesër, do të ngrihemi para se të gdhijë.

— Pse? pyeti Ajisillau.

— Është për të pyetur? Nesër kemi Krisht-lindje. Dit' e madhe. Kush mbetet pa shkuar në Kishë?

Ay tundi kokën për shenjë keq-ardhjeje:

— Këta rrojnë akoma në njëmij e katërqind, pëshpëriti. Ç' errësirë..... Ajde; natën e mirë, tha me zë të fortë.

I thanë natën e mirë dhe iknë një-një. S' muarnë vesh mirë-mirë ç' kuptim kishin ato fjalë q' i tha si me gjysmë zë. Po një plak, që kish parë shumë gjëra në botë, pëshpëriti si zbriste posht dhe goditte kalldërëmin me shkop:

— Shkoi dhe ky i mjerë. I a prishi trut kurbeti.....

(Fundi në numurin tjetër)

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT I IV-të

SHTATOR

1943

Nr. 7

LANDA: Plaga shërimitare e shpëtimtare — Feja dhe Shkenca — Lufta dhe Morali — Themë Filozofike — Mejtime mbi Krishtin — Nga kryeveprat e Atërvet të Shenjtë — Besa e fëmijës bëhet bes' e të riut — Fjalë ngushëllimi — Jisilla-u.

Plaga shërimitare e shpëtimtare

Epidemira, kriza ekonomike, çrregullime dhe luftëra. Kamxhiq dhe plaga të vërteta që s'godasin vetëm një dhe dy, por shoqëria dhe popuj të tërë.

Përse të bëhen? pyet me një lloj agonije e habije. Këndonjës i dashur, pjesa më e madhe, që të mos themi tërësia e këtyre plagave, është pasoj' e domosdoshmë e administratës së keqe, të zotërimit të frymës së klikës, të vënëjes së interesave personale përmbi interesat e përgjithëshme...

Kur pasuria shtetnore hyn në kuletat e njerësvet në fuqi dhe të lloj-lloj spekulonjësve e abuzonjësve, nuk e kupton, se kanë për të munguar mjetët me anën e të cilëve të luftohen folet e sëmundjeve ngjitëse e të mirren masat preventive kundër përhapjes së tyfos-it, të ethevet, të kolerës etj.? Në një vënt të till—them— mos prit masa për mbrojtjen e shëndetit, as rrjeta kanalesh, as tharje kënetash... Ndoshta populli i ngrat paguan për këto të gjitha dyke u-tak-

suar rënd. Po s' tepëron. E di kur ka për të tepëruar dhe kur kompetentët do të detyrohen të bëjnë diçka? Kur plaga e epidemisë do të përhapet me hapa të shpejta dhe incidentet do të shtohen dita-ditës në mënyrë tmeronjëse. Kamxhik i vërtet, këndonjës i dashur, i cili bie pa mëshirë mbi kurizin e qeveritarëve që s' interesohen për fatin e popullit të tyre si edhe mbi kurizin e popullit që flë.

Kur pasuria shtetnore — them — hyn në xhep t' atyreve që janë në fuqi, si është e mundur të tepërojnë fonde për vepra prodhimtare e kundër mbytyjevet, për ndreqje rrugash e urash? Bujku, punonjësi i thjesht i tokës, bariu, prodhonjësi, do të jenë gjithëmon nën rrezikun e rrebeshevet, që asnjë njeri s' munt t' i evitojë, dhe të çregullimit më të vogël të stihijavet të natyrës. Puna e tij i është ekspozuar furris së përkoheshme t' atij përroi, i cili në muajt më të shumtë të vitit paraqitet si pa ndonjë rrezik. Prodhimi i tij është në rrezik të kalbet, sepse transportimi në vëndet e tregut e të shitjes, nga mungesa e rrugavet e të mjetëvevet, është tepër i vështir... Munt të tepërojnë me gjith këtë të holla nga buxheti i shtetit dhe për këto qëllime, që nga njerëzit në fuqi konsiderohen si çështje të dorës së dytë. Po e di se kur? Kur mbytyjet që vijnë njera pas tjetrës do të krijojnë prishje të pallogaritëshme për prodhimin kombëtar. Kur prodhimi nuk do të disponohet por do të mbetet i mbyllur nëpër depo-t e do të kalbet e do të prishet. Kur tregëtia do të qëndrojë dhe kriza ekonomike do të bie si ndonjë thatësi që çduk dhe freskësinë më të vogël n' atë vënd. Kamxhik e plagë më thua pastaj. Vërtet. Por kamxhik dhe plagë që përdoret si thumb për të çpuar gomarin e rënduar të maqinës shtetnore. Do të lëviznjë vall? Sikur të lëviznjë, ky kamxhik do të bëhet thumb shpëtimtar, plagë mirëbërëse e urtësonjëse për atë komb.

Feja dhe Shkenca

Problemi i lindjes së njeriut

III

Theoria e çvillimit gjer në kohën e Darwin-it — Mendime «pro» dhe «kundra» theorisë së çvillimit — Bakon-i kundrejt theorisë së çvillimit. — Mendimet e filozofëve Descart, Leibnitz dhe Kant mbi këtë teori — Naturalisti Buffon, përkrahës i theorisë së çvillimit dhe pararendës i Darwin-it — Lamarcku, një nga themeltonjësit kryesorë të theorisë së çvillimit. — Kundërshtimet e forta të fisiologut G. Cuvier.

Edhe me teorinë e çvillimit ngjavi pikërisht ashtu siç ngjavi me atë të lindjes automatike të jetës. Sikundër d. m. th. kjo pati shumë peripeti gjatë kohëve dhe kaloi nëpër faza të ndryshme herë duke u-përkrahur prej të diturve dhe herë duke u-luftuar prej tyre, kështu edhe Darwinizmi pati herë pasonjës fanatikë-sidomos në fillim-dhe herë armiq e kundërshtarë të rebtë, gjer sa u-çfaq n' orizondin shkencor fiziologu K. Darwin, i cili i dha theorisë një shkëlqim e një fuqi të re, aqë sa do të kujtonte dikush se triumfoi kjo definitivisht dhe mori vulën e theorivet fizike të pranuar prej shkencës. Po, sikundër do të shohim më poshtë, ky çkëlqim ka qenë i hëpërhëshëm; se pas pak kohe dualinë shkencëtarë të dëgjuar, të cilët me argumenta të

forta i u vërsulnë kësaj theorie, e luftuan me fuqi të madhe dhe provuan se është një hipotezë e thjeshtë, si shumë hipoteza të tjera, që mundohet të shpjegojë lindjen e krijesave të gjalla e më në fund edhe atë të njeriut.

Kështu p. sh. në kohët e reja Bakon-i-që të zëmë në gojë vetëm të diturit kryesorë të këtyre kohëve-duket se pranon teorinë e çvillimit dhe ndryshmënin' e lojevet ; çfaq mendimin bile që të krijohej një lloj llaboratori për të studjuar problemin se si u-shumëzuan llojet dhe si muarnë trajta të ndryshme.

Gjithashtu edhe filozofët Deskart, Leibnitz dhe Kant mund të radhiten midis pasonjësvet të theorisë së çvillimit. Si mbas Deskart-it, është më lehtë dhe më afër menç të pranojmë se lindja e llojevet të ndryshme të gjalla në planetin t' onë u-bë me anën e çvillimit, dyke rjedhur një lloj prej tjatrës, se sa të besojmë se çdo lloj i gjallë u-krijua prej krijonjësit me ndërhyrje të tij të veçanta. Leibnitz i ngul këmbë mbi thezën e tij, se çdo gjë në natyrë çvilohet e shkon përpara ngadal e shkallë shkallë (Natura non facit saltum) dhe se as një doktrinë filozofike nuk mund të jetë e përsosur, në qoftë se nuk mbshtetet mbi çvillimin. Kant-i më në fund, përkrahës i fortë i predikimevet të Buffon-it, besonte në ndryshmënin' e llojevet të gjalla, e cila rjedh nga zgjedhja, nga influenca e redhit, nga përshtatja e nga adaptimi, si edhe nga trashëgimi

Po ay që predikoi një teori të saktë disi dhe me një farë vlere shkencore, ka qenë natyralisti frëng Buffon (1707—1778). Me parimet e tij mbi influencën e redhit dhe mbi ligjin e luftës së jetës quhet me të drejtë si pararendës jo vetëm i Lamarck ut, po edhe i Darvinit vetë. Është e vërtetë se teorit e tij gjetnë kundërshtime të forta prej profesorëvet të Sorbon-it, të cilët çfaqnë mendimin se shumë nga parimet e Buffon-it nuk pajtohen me frymën e fesë, ashtu siç çvilloheshin këto në të tre volumet e parë të veprës së tij *Histoire naturelle*. Po Buffon-i në volumnin e katërtë çpalli që në fillim se besonte pa pik dyshimi në shkrimin e Shenjtë për sa i përket krijimit «po këte krijim e bën natyra me anën e mjetëvet q' i ka dhënë Krijonjësi».

«Çnuk mund të bëjë, shkruante, natyra me mjetet që ka në dorë? Çdo gjë mund të bëjë, përveç krijimit ose çkatërimit, të lëndës. Këte fuqi të fundit e ka ruajtur për vetë Perëndia: Krijimi dhe çdukja janë cilësi të Terëfuqishmit; e natyrës i ka lënë fuqinë të ndryshojë, të çvillojë e të krijojë trajta të ndryshme.»

Edhe natyralisti Le Monet de Lamarck (1744—1829)—për të cilin ka thënë një i ditur i asaj kohe se mund të quhet m' i madhi themelonjës i theorisë së lindjes së llojevet të gjalla nga natyralistet që kauë jetuar midis Aristotelit e Darwin-it - e çvilloj me hollësi të plota këte teori-në tre nga veprat e tij kryesore: «*Philosophie Zoologique*», «*Histoire des animaux sans vertèbres*» dhe «*Système des connaissances*». Si mbas Lamarck-ut, natyra dhe faktorët e çvil-limit të llojevet të ndryshme përmbliidhen në këto katër ligje: 1) Jeta më fuqit' e saja lakmon gjithënjë të shtojë volumen e çdo trupi dhe t' i zgjerojë pjesët e tij gjer n' ate kufi, të cilën e ka caktuar ajo vetë. 2) Lindja e një organi të ri në një trup të gjallë rjedh nga një nevojë që çfaqet dhe nga levizja që shkakton kjo nevojë. Kështu p. sh. qafa e gjatë e gamilavet rodhi nga puna se këto kafshë shtrëngoheshin t' a zgjatnin qafën, që të mundnin t' ushqehen prej shelgjevet të lartëra, mbasi pemë të vogla e t'ultra nuk ndodheshin n'ato vënde. 3) Çvillimi i veglavet dhe fuqia e veprimit të tyre është analoge me përdorimin e këtyre veglavet. Kështu p.sh. syt' e kafshëvet që jetojnë n'errësirë, nga mos përdorimi pësuan atrofi, u-svogluan shumë dhe pothuaj nuk punojnë fare. 4)Ç do cilësi që kanë fituar organizmet e gjalla në jetën e tyre, është rojtur me anëu e lindjes dhe është transmetuar në pasardhësit e këtyre organizmevet me anën e ligjit të trashëgimit. Pra-nonte përveç kësaj se tërë kafshët përbënin një seri e një kategori të vetëm që përmbliidhte kafshët që nga m'e vogla gjer në njerinë...Po kjo teori u-provua krejt e gabuar prej Cuvier-it, i cili provoi se mbretëria e kafshëvet përbëhet prej shumë grupësh, të cilët jetojnë krejt të veçuar njëri prej tjetrit.

• Është për të theksuar këtu, se Lamarck-u, në kun-

dërshtim me të tjerë Darwinistë, pranon një qëllim e një plan të caktuar që plotësohet prej çvillimit. Shkalla ose kategoria e bimëvevet dhe kafshëvevet, q'e zumë në gojë pak më sipër, u-formua dhe u-bë, si mbas Lamarck-ut, me anë mjetësh që mori prej Krijonjësit dhe pasqyron rregullën e rradhën e pa ndryshuar, që vuri Krijonjësi në ç'do krijesë të planetit t,onë. «Pa dyshim, thotë, çdo gjë është dhe qëndron më vullnetin e Krijonjësit të të gjithë sendevët. Po a mundim nëve t'i caktojmë rregulla në zbatimin e vullnetit të Tij, ose të gjejmë mënyrën që ndoqi për këtë qëllim? Me të vërtetë, cili do qe ka qënë vullneti i Tij, fuqia e Tij e pa kufishme është gjithënjë po ajo; dhe në ç'do mënyrë që të jetë zbatuar ky vullnet, as gjë nuk mund të pakësojë madhërin' e Tij».

Po theorit' e Lamarck-ut, si domos për sa i përket ndryshmënisë së llojevet, i luftoi me shumë fuqi Cuvier-i (1766-1832), i cili me veprën e tij "*Recherches sur les ossements fossiles*" u-bë i përmëndur n'atë kohë dhe ushtroi një influencë të madhe mbi botën shkencore. Cuvier-i u-vërsul kundër theorisë së Lamarck-ut mbi ndryshmënin e llojevet, mprojti me fanatizmë thezën e tij mbi pa ndryshmëninë dhe në ndeshjen që bëri brënda n'Akademinë frënge me paso njësin e Lamarck-ut Geoffroy-Saint-Hilaire kori një fitore e një triumf të rallë. Cuvier i provoi, se gjatë periudhaves gjeologjike të ndryshme çfaqeshin lloje dhe kategori organizmësh të gjalla krejt te veçanta dhe të përsosura dhe se çdo lloj u-krijua veç e veç dhe n'asnjë mënyrë nuk rodhi njeri prej tjetrit. Predikimet e Cuvier-it shkakëtuan një bujë të madhe midis shkencëtarëvevet t'asaj kohë, shumica e të cilëvevet i pranuan këto predikime që rezonin krejt theorin' e çvillimit.

Kështu pra kjo e fundit nënë grushtet e forta të Cuvier-it humbi çkëlqimin e parë, u-braktis prej te diturvet të përmëndur t'asaj kohë me përjashtime fort të ralla dhe kaloi n'ërsirë, gjersa dolli në orizondin shkencor Karl Darwin-i, i cili e nxori nga lethargu' në të cilin ndodhej theoria e çvillimit,dhe i dha fuqi të re e shkëlqim të ri.

Shpresëtarë.

Lufta dhe Morali

Atërit e shenjtë dhe lufta

Atërit e shenjtë përsa i përket luftës kanë mendime të ndryshme. Një pjesë nga ata e dënon, një pjesë tjetër në disa raste e lejon. Ndryshimi i mendimeve rrjeth natyrisht nga karakteri, mënyra dhe qëllimi që kanë patur luftërat në kohën e tyre. Por në parim të gjithë janë si edhe Bibla kundër luftës.

Shën-Irineu (†202) duke dashur të tregojë frymën e dashurisë dhe të paqës që vaditte të krishterët, thotë: të «krishterët kanë kthyer këlleçët e tyre në vegla paqeje dhe kanë haruar mënyrën e të luftuarit». *Klimenti i Aleksandrisë* (†215) thotë që i krishteri s' munt të përdornjë asnjë vegël luftime. *Apologeti i math Tertulian* (†220) thotë: „si mundet një i krishter të shkojë në luftë e të mbajë armë në kohë paqeje kur Shpëtimtëri na e ndaloj përdorimin e thikës?” *Laktanci* (†330) gjithashtu thotë, që një të krishteri nuk i lejohet të mbajë armë, njeriu është i shenjtë dhe kurdoherë „është një krimë t' i a marrësh jetën”. *Shën-Thanasi i Math* (†373) ndonëse është kundër luftës se thotë që „porsa popujt kuptojnë doktrinën e Krishtit mirren me punimin e tokës në vent që të venë dorë mbi armët”, bën me gjith këtë dallim nërmjet vrasjes me qëllim të keq e vrasjes në luftë duke theksuar se këjo e fundit në disa raste munt të lejohet. Po i këtij mendimi është dhe *Shën-Vasili i Math* (†379), i cili thekson se „vrasjen në fushë të betejës atërit nuk e konsiderojnë si vrasje”. *Shën-Grigori i Nissës* (†394) e dënon luftën duke thënë: „ay që ju premtan ndonjë dobi po të hiqni dorë nga lufta, u jep dy: të parën dyke ju ruajtur nga shumica e fatkeqësivët që e pasojnë luftën dhe të dytën dyke ju ruajtur nga lufta vet”.

Augustini i hirëshmë (†430) është edhe ay në parim kundër luftës. „Të mos jetosh në paqë. — thotë — do të thotë të mos dëgjosh Krishtin”. Me gjith këtë ay pranon luftën mbrojtëse duke theksuar se ushtari munt të vrasë kur s' mundet ndryshe të mbrojë vet-vetën dhe vëllezërit e tij. Gjithashtu, duke qenë se e keqja e vërtetë e luftës është dëshira e keqe për çka tërim, pasioni për të zotëruar, brutaliteti i egër, hak-marrja e

tmerëshme, është tepër e arsyeshme që këjo plag' e së keqes të dënohet n' emër të së drejtës nga bota e mirë me luftëra kundër vjollencës së rebelëvet, qoftë nën udhëheqjen e Perëndis si në Dhjatën e Vjetër, qoftë nën udhëheqjen e një qeverimi të ligjëshmë. Të drejtën e çpalljes dhe të drejtimit të një lufte për të mirën e përgjithëshme e ka vetëm prijsi cilido e sido qoft' ay. Ushtarët e kanë për detyrë t' i binden dhe nënshtetasit të japin bashkëpunimin e tyre. Vetëm në një rast ka përjashtim: Kur duket haptas se lufta bëhet krejt në kundërshtim me ligjin e Perëndis. Një luftë që s' ka për qëllim paqën, quhet e padrejtë. Një lumtëri e madhe për njerëzinë do të jetë nëse shtetet do të jenë sa më të vëgjël e të jetojnë në paqë si fqinj të mirë. Të çdukësh luftën me anë të fjalës, të fitosh paqën jo me anë të luftës, po me anë të paqës, është një lavdi shumë më e lartë nga ajo të vrasësh njerëzit me armë. Pas të hirëshmit Augustini: „iniquitas partis adversae justa bella ingerit”.

Isidor Pilusioti (†440) është edhe ky në parim kundër luftës. „Unë po ju them — thekson ay — që ndonëse vrasja në luftë duket si e ligjëshmë, ndonëse u ngrihen monumente fitonjësvet për t' u kujtuar pasardhësvet krimet e tyre të famëshme, me gjith këtë po të marrim parasysh vllëzërimin e pamohuar të njerësvet, këta fitonjës s' munt të lahen nga faji”.

Shën-Ambrosi (†397) nuk lejon as mbrojtjen e ligjëshmë t' individit prej atakimevet të huaja. Sa për luftërat e Dhjatës së Vjetër ay i kqyr si një mjet të domosdoshmë që e përdori Perëndia për shpëtimin e popullit të zgjedhur. Mbi moralitetin përgjithësisht të luftës ose mbi faktin nëse lufta është e lejuarshme a po jo pas parimevet të krishtere, Shën-Ambrosi nuk çfaq ndonjë mendim. Me gjith këtë thekson që i krishteri e ka për detyrë të mbrojë nga padrëjtësia më të dobëtit.

Duke i dhënë fund këtij artikulli theksojmë se, me që në shekujt e parë të krishtërimit shumë ushtarë ishin në rrezik të binin n' idhullolatri ose n' apostasi se ishin të detyruar të merrnin pjesë në ceremonit e kultevet pagane dhe me që shumica e luftëravet atëhere bëheshin për shkaqe të pa-arësyeshme nga pikpamja morale, me plot arësye kujtojmë, atërit e shenjtë kanë mbajtur një qëndrim përgjithësisht t' ashpër kundër luftës.

Në numurin tjetër: Kisha dhe lufta.

THEMË FILOSOFIKE

LOGJIKA

Pa fillue trajtimin e logjikës na duhet të themi dy fjalë mbi dobin e saj.

Dobia e Logjikës. Logjika, skenc' e mejtimit, shërben si gramatikë, si algebrë e gjithë skencave. Si gramatika dhe algebra, ashtu dhe logjika nuk na mëson gjâ të ré. Na flasim gramatikisht drejt, édhe pa mësue gramatikën; kalkulojm drejt édhe pa mësue algebrën a arithmetikën; gjithashtu giukojm dhe arsyetojm drejt, édhe pa mësue logjikën. Por me këtë a provohet padobia e këtyne skencave? — T' ishte puna sa për nevojat e rutinës së përditëshme të jetës praktike, mund të thoshim se as gramatika, as algebra, as logjika s' na duhen, se ligjat për me folë, me kalkulue dhe me mejtue drejt na i ka falë Zoti vetë dhe i kemi vetiu në mendje qysh prej lindjes. Por, posa të largohemi pak prej fushës së jetës praktike dhe të naltësohemi nër spekulime skencore dhe mejttime teorike, kemi me ndie sakaq nevojën e domosme të logjikës, ashtu si shkrimtari ndin nevojën e gramatikës dhe matematiku nevojën e algebrës. Se në rrugën e errët, të ngushtë të vështirë e plot pengime të spekulimit skencuër nuk miafton qi ligjat e mejtimit t'i kemi në mendje e t'i përdorim pa vetëdije, por duhet dhe të dijm q'i kemi e q' i përdorim si dhe cilat janë ato dhe si i përdorim, për me muejt kështu me u kontrolue përdorimin e pa vënd dhe për t' e-vitue gabimet. Me fialë t' jera, nuk miafton mejtimi natural e spontan, por duhet dhe mejtimi reflektiv, q' i shërben të parit si feneri syvet në t' errët. Por mejtimi reflektiv, don të thotë Logjikë. Logjika na jep kriterin e legjitimitetit të mejtimevet

dhe të koherencës midis tyre, konditë esenciale e skencës, hap' e parë për njohjen e realitetit. Na bën të vefëdijshme ligjat logjike, sbatimin rigoroz i të cilavet na ruan nga gabimet e sofizmat. Me ushtrimet e dëndur logjikë, qi janë për shpirtin si gjimnastika për trupin, abituohemi në qartësi, precision, koherencë dhe rend; dhe mbassi mendimet determinojn veprimin, koherenca në mendime siell pas vetiu dke koherencën në veprime d. m. th. formimin e karakterit të fort. Me studimet e logjikës dhe gjenorisht (en general) të filosofis, hapet përpara syvet të mëndjes orizonti i gjån i universit, ndai të cilit na, tue paë veten tepër të vogël, bindemi për kotësin e rëndsis q' i japim dhe në zëmrrën t' onë fillojn vëset m' u-ritirue e virtutet m' u-foruce, kondit e domosme për bashkërojtjen harmonike të shoquis nierzore. Kriteret dhe koherenca logjike na shërbejn si strumbullar i jetës, qi na regullon mejtimin e veprimin — si strumbullari në lamë regullon lëvizjen e kalit — dhe s' na len të biem n' anarqi mendore e morale, ashtu si kemi râ ne shqiptarët sod dhe si bien gjithmon popujt pa tradita të thella e pa kulturë filosofike, në mëndjen e të cilvet idenat e reâ hyjn e dalin pa kurnji kontrol, pranohen e lëhen për modë e snobismë; pa këtë strumbullar, s' ka stabilitet as në mendime, as në veprime, dhe nierzt, individë e popuj, sillen tutje e tëhu pa drejtim të caktuar, si vapori pa timon.

Dobia, pra, e Logjikës qenka shum'e madhe; andaj këshillojm rinin shqiptare të merret me studimin e sai si dhe të degavet t' jera të filosofis, e sigurt se nuk do të pendohet për mundimin qi do të bëjë.

I. Objekti dhe definimi i Logjikës

Për-me definue një degë dijnie d. m. th. një skencë, duhet mâ parë me gjetë e caktue objektin me të cilin merret, të cilin skruton e studion. Kur objektin t' a kemi gjetë e caktue s' na jet veç me i-a shtue këtë si differencë specifike konceptit gjenuer (general) *skencë* dhe me të dya këto terma të formulojm definimin. Kështu, p. sh. arithmetika, qi ka për objekt numrin, definohet skenc' e numrit; geometria qi ka për objekt

figurat, definohet skenc' e figuravet; fizika, qi ka për objekt fenomenet naturale, definohet skenc' e fenomenevet naturalë; psikologjia, qi ka për objekt shpirtin dhe faktet shpirtnorë, definohet skenc' e shpirtit dhe e faktevet shpirtnorë. — Tashti pyesim; çili është objekti i Logjikës, qi me ndihmën e tij të japim definimin e kësai skence?

Mbi objektin, për passojë dhe mbi definimin e Logjikës, filosofët nuk janë një mendimi. Për ne, Logjika është pjes' e psikologjis. Siç dihet, psikologjia ka për objekt gjithë jetën shpirtnore, gjithë faktet shpirtnorë. Këta fakte klasifikohen në tri kategori: 1) jeta aktive, 2) jeta affektive, 3) jeta mendore. Jeta mendore dahet në katër funksione: a) pronzuer (acquisitiv), b) konservativ, c) inventiv, d) elaborativ. — Sosh Logjika nuk studion as jetën aktive, as jetën affektive, as jetën mendore të gjithë, por vetëm funksionin elaborativ d. m. th. *idenat*, *giukimin*, dhe *arsyetimin*. Këto të tria, me një fjalë, quhen *mejtim*. Logjika, pra, ka për objekt mejtimin; andaj mund të definohet *skenca e mejtimit*.

Psikologjia dallohet në psikologji empirike dhe psikologji racionale; andaj dhe logjika, si pjes' e sai, dallohet në logjikë empirike dhe logjikë racionale. Psikologjia empirike, kur studion mejtimin, s' është veç logjikë empirike dhe s' bën gjatë tjetër veç punën e kësai; kjo studion mejtimin empirikaz dhe kërkon me i-a gjetë ligjat induktivaz. Logjika racionale, pjes' e psikologjis racionale, studion mejtimin racionalisht, a priori, dhe kërkon me i-a xjerë ligjat deduktivaz prej parimevet themelore të mëndjes.

Veç logjikës empirike dhe racionale, kemi dhe logjikën e naltë, qi studion mëndjen vetë (jo mejtimin). elementet esenciale të mëndjes d. m. th. *idenat absolute* dhe parimet themelore. Këtë, disa filosofë, e quajn *metalogjikë*. Mbassi idenat dhe parimet në fjalë e kanë rënjën te Perëndia, metalogjika, si skenc' e tyne, duhet me bā pjesë të thelogjisë racionale.

Na këtu do të merremi me logjikën empirike.

K. T.

FILIP SCHAF

Mejtime mbi Krishtin

Çeshtja e personit të Krishtit asht çestje e Kristjanizmit, i cili asht zbulesa e jetës Tij në botë; Kjo asht çeshtja e kishës, e cila qëndron mbi te si mbi gurin e qëndrueshëm; ky asht problemi historisë, e cila rrutullohet rreth Tij, si rreth diellit central të botës morale; Ky është problemi i çdo njeriu i cili instiktivisht randon nga Ai si objektit të dëshiravet tij ma të pastra dhe ma fisnike.

Personi i Krishtit asht çudi e madhe centrale e historisë. Jeta dhe karakteri i Jësu Krishtit janë me të vërtetë e shenjtja e të shenjtavet të historisë botnore. Veprat e Tij të çudiçme dalin prej personit të Tij të çudiçëm si konsekuenca të doemosdoshme. Hyjnia e Tij asht i vetmi zbërthim i kënaqshëm i problemit të karakterit Tij të çudiçëm.

Krishti ka rrojtun gjith fazat e jetës njerëzore prej fëminisë deri në burni, dhe në çdo fazë krijoj figurën e Tij ideale që të mundte me e shpëtue dhe me e shejtënue njerin në çdo fazë të jetës së tij, dhe nëse cilën nga këto faza na dha shembëll për me imitue. Ai ka qën fëmija ideale, çuni ideal, djaloshi ideal, burri ideal.

Krishti me anën e përljes, me lindjen e thjesht, me vobeksinë, me zanatin zdruktar, dhe me bindjen e plotë ligjevet të shoqnisë e ngriti prestigjin e vërtet dhe nderin aq nalt, sa ma parë nuk e kishin para-ndim, dhe përgjithmon e hudhi dhe e çduku at kriterium, me të cilin matesh pr stigji i njerëzvet dhe i sendevet prej së jashtmes së tyne, dhe me të

cilën identifikojin madhështinë morale me dijen e imoralitetin, me pozitën e ulët në jetë.

* * *

Çfar kan qen burrat e mëdhej për një kohë ose për një popull, njajo asht Krishti për gjith njerzimin dhe për gjith kohnat. Si kur se ngrihen piramidat mbi fushat e Egjyptit, njashu ngrihet Krishti mbi gjithë mësusët e njerzvet dhe themelusët e fenavet e të sektavet. Gjetei nxanës dhe admiruës ndër Judhejt, tue mos qen në as ndo një nga sektat e Judhejvet; e adhurun dhe Grekët — me gjith që nuk predikoj sisteme të reja filosofike, dhe Romakët — me gjith që nuk dha as një betejë, as që themeloj ndo një shtet. Afrikanët, të zest e egër dhe Amerikanët lëkur-kuq e pranojn aq lehtë dhe shpejt si dhe popujt e civilizuem. Krishti, Ky asht i vetmi dhe i pa krabasueshmi shëmbull për të krishtenët e të gjithë kohnavet, e të gjith krabinavet, e të gjithë popujve dhe rasavet.

Sa ma shumë fellohemi në vuetjtet e Krishtit aq ma fort e ndiejm se ato nuk munden me u krahazue me vuetjtet e as ndo njëu, e aq ma shumë vërtetohemi se i Drejti vdiq për të pa ligjë, i Shejti për mekatarrët, se i Drejti me gjakun e Tij i lan mëkatet e botës që kishte ranun. E ndiejm dhe me frikë — deri mkrusemi para flisë pajtuese, sakrificës së dashunisë së pa fundshme. Vetëm ky mejtëm se Emanueli (Perëndi - njeriu) Shpëtimtari vuetji bashk me botën, e cila mundohet ndën barrën e mëkatit e të vdekjes, vetëm kjo ide bahet e pa-tregushme e nalt dhe përmba në vehte një fuqi të madhe tërhekse. E ç mundet me u than vetëm mbi fatin e realt? Ky asht myster hyjnur, prej burimit qiellur, myster aq i hirshëm dhe i frytshëm në përfundimet. Kjo asht thema ma e shejt për me u mendue, arma ma triumf-pruse kundër mekatit dhe djallit, burimi ma i fellë i ngushëllimit për njerzit ma të mirë e ma fisnik.

Në të gjith historinë Krishti nuk ka as ndo një paralele: Kurr epoha para Krishtit dhe mbas Tij nuk dha as ndo një të till, i cili, së paku, kishte me ju afruem karakter

terit të Tij, me përjashtimin e imitacionit zbet nga ana e apostojvet Tij të vërtetë.

As ndo një biograf moralist ose piktor nuk mundet me sukses me dhan bukurin dhe dritën e cila muer shtat në personin e Isujt prej Nazareje. E ndjejm se ajo ep ma shum se sa munden me dhan të gjitha pikturat dhe veprat, dhe, le të jenë ato veprat e pendës ose të vurrës njeriut ose të gjuhës engjullore. Po me at sekses mundet me u provuem qi ujnat e oqeanevet të mbëlidhen dhe të futen në një kanal të vogël, ose ndriçimi i së lemes diellit, ose qielli me ndriçimin e yjevet mundet me u përshkrue me bojë. As një ikonë e shpëtimitarit qoft ajo vepër e dorës së mjeshtrit Rafaelit, të Direrit ose Rubensonit; as një ep qoft ai i genialitetit Dantit ose i Miltonit ose i Klapshtokut, nuk asht në gjendje me kalue parabulat e thjeshta t'Ungjillit, madhështija e gjith fuqishme e të cilit përmbahet në të vërtetën. Këtu, vetëm këtu eksperiencia ma e halt mbet mbrapa së vërtetës historike, dhe fantazija nuk ka vend me idealizuem realitetin, sepse këtu neve kemi idealin apsollut në realitetin e tij të gjall.

* * *

Personi i Krishtit është një mister i math dhe i shejt. Ai nuk mundet me u shpiegue me anë të parimevet humane. Ai nuk mundet me qen produkt i fuqivet morale dhe intelektuale të kohës kur rrojti Krishti. Personi i Krishtit qëndron në kundërshtim me botën e judhejvet dhe të kombevet të cilët e rrethojin, me botën qi ishte përmbrenda në dekadencë dhe qi duhesh të shemesh shpejt në renime para vepravet të reja të Jesu Nazareasit. Krishti asht përjashfim apsolut dhe i pa mbërrishëm për gjithë rasën njerzore. Të gjitha çudit e Tij janë vetëm manifestime natyrale dhe të doemosdoshme të personit Tij të çudiçëm, dhe prandaj janë bam ato me aq lehtësi me sa bajm neve punët t'ona ordinare të jefës s'onë të përdiçme. Ungjilli i Sh. Gjonit i quen çudijat fare thjesht dhe me të drejtë veprat e Tij. Por çudija ma e madhe kishte me qen, kur se Krishti, qi asht çudija ma e madhe, të mos kishte bam as një çudi. Kjo do të thoshte me pranuem ka-

uzën dhe mos me pranuem consekvenca, ose me pritun prej qiellit errësinë. Personi i Krishti spjeron gjithë gjana e çudiçme të bame në histori. Ai asht shkak i mjaftushëm i të gjithë vepravet Tij. E mbinatyrshme dhe e çudiçme në Krishtin asht “Schechinah” e vërtet (presentsija, fuqija e Perëndisë) e cila shkëlqente në gjithë lavdinë e sajë, n’Ate banonte shtatënisht plotësija e Perëndisë.

Të gjithë mbretninë e vet dhe dokrinën e vet e themeloj në personin e Tij. Personi i Tij si Emanuel Njeri-Perëndi — asht thema e tij e përdiçme. Ai Vet asht Ungjill.

Personi i Krishtit asht aq i mbaruem sa qi nuk mundet kurr me e magjinue fantasija e njeriut e ranun e mëkatore.

Njerzimi ma leht kishte me humb gjith kullturën greke, rromake, gjermane, engleze, franceze dhe kullturën amerikene se sa me humb historin mbí Jesu Krishtin. Pa atë historia asht shkretinë e pa banushme, problem i pa zgjidhun, kaos ngjarjesh pa kuptim, pa qëllim; kur se me Ate asht fare e bukur zbulesë hyjnore dhe harmonike; mengadalë por me sigurim zhvillimi i planit të dijes pa-fundshme dhe dashunisë hyjnore; e gjithë historia e vjetër i asht drejtue ardhjes Mesisë, e gjithë historia e re fiton prej Tij dritë dhe jetë. Ai asht lavdija e së kaluemes, jeta e së tashmes, dhe shpresa e së ardhmes, pa Ate nuk do të jemi në gjendje me kuptue vehten. Me plot të drejtë thohet kjo në një provërbë të Judhejvet vjetër:

“Mysteri i njeriut asht mysteri i Mesisë.” Ai asht drita e madhe centrale e historisë botës, dhe bashk me Te drita e çdo shpirti të krishten veçan. Vetëm Ai mundet me zgjidhë problemin e gjendjes t’onë dhe me e ngimun etjen t’onë intelektuale për të vërtetën; çdo pjerrje morale qi kemi për të pastërtën dhe për të shejtën, dhe dëshirën e zjarrit të zemrës t’onë për paqen dhe lumtëninë. — Ai ka me e plotsuem.

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

III.

Cilat janë karakteristikat më të shënuara të idesë fetare në mendimin rus të shek. të XIX—të? Pikë së pari të habit-liria e madhe e mendimit fetar rus.

Mendimi katolik dhe mendimi protestant janë të krishtalizuara, të mirë organizuara, kanë kufi të caktuara tradicionale. Në Europën perëndimore, mendimi fetar u përket të parëvet të kishës ose profesorëvet të seminarevet dhe të fakultetevet theollogjike; këtu mendimi fetar është më tepër një mendim theollogjik. Theollogët janë shërbenjësit dhe udhëheqësit e një ushtërije të rregulluar dhe të disiplinuar. Fryma profetike është pothuaj se e shuar në mendimin e krishter të Europës perëndimore të shek. të XIX—të.

Kisha orthodhokse nuk ka dashur kurrë të jet një kishë luftonjëse dhe jerarquia e kishës nuk është konsideruar kurrë si një ushtëri. Në Rusi ka mundur të ngjajë që një oficer i gardës dhe pronar, siç ka qënë Khomiakoff-i, të jetë një theollog i klasit të parë të kishës; që profetër Rusë të jenë shkrimtari laik Dostoeievvski dhe filosofi laik Solovief. Problemat më të shënuara fetare kanë qënë prekur prej shkrimtarëvet laikë Leontieff dhe Rosanoff; iderat më të guximëshme për të arthmen e krishtërimin kan qënë çfaqur prej N. Teodoroff-it, një bibliotekar i ulët dhe pothuaj i panjojtur. Mendimi fetar rus në shek. e XIX—të dhe të XX—të është profetizma e lirë. Ky e

kuptonte krishtërimin si një fe të lirisë. Kjo është karakteristika kryesore e idesë fetare ruse.

Ideja e lirisë krishtërore ka qënë çfaqur prej Khomiakoff-it. Si parim të parë të pikëpamjes së tij mbī kishën ay ve *iden e liris së* mendimit. Këjo ide nuk gjindet në theollogjinë zyrtare, nuk ekziston në lidhjet zyrtare ndërmjet kishës dhe shtetit, por liria mendore është përhapur në atmosferën që s' mund të tregohet me fjalë të orthodhoksisë ruse, të krishterimit rus. Kisha nuk është autoritet, ajo është liri; ajo nuk është organizim, por është *një organismë mystike*, ajo nuk është një institut por është vetë jeta shpirtërore. Tradita e kishës nuk është diçka e jashtme; në jetën e mbrëndëshme - të vdëkur dhe të gjallë - gjeneratat e krishtere janë në një lidhje organike; kjo jet' e brëndëshme është jeta në liri. Ndërgjegja fetare ruse përkufizon të dy botat me më shumë fuqi se ndërgjegja perëndimore. Ajo nuk lejon që cilësira të ndryshme që i përkasin botës natyrale të futen në botën hyjnore. Parimi i Nomit, parimi i Dhjatës së Vjetër është më pak i çfaqur në kishën orthodhokse, se në kishën katolike. *Kisha është një njëjësi në liri, njëjësi në dashuri dhe jo njëjësi formale dhe juridike*. Në iden slavofile të lirisë së krishtere, radikalisma është më e fortë se te Lutheri, por është më e lidhur me mbjojtjen e traditës së shënjtë, me nderimin e shtërgjyshtësvet, me parimin e sinodhevet të pergjithëshme.

Dostoeievski ka qënë prurës i math i lirisë së mendimit. Në analet universale nuk ekziston shprehje e idesë së lirisë fetare e lirisë së mendimit, më rënjësor edhe më thellë, se te Dostoeievski. Këjo ide përbën themën e tij të parë; ay thotë që mohimi i lirisë së mendimit, zëvendësimi i saj me një organizatë autoritare, është një soj me vet frymën e *Andi—Krishtit*. Këjo ide përbën themën e veprës së tij «*Legjenda e Inquisitorit të math*». Jisu Krishti i rrëzoi të tre ngasjet në shkretëtirë në emër të liris së mendimit. Liria e krishtere është një e drejtë, një rivendikim, është një detyrë dhe një detyrim. Perëndia pret prej njeriut liri; Ay nuk pranon veç se ata që janë të lirë. Perëndia ka dashur që dashurija e njeriut të jet e lirë.

Është rëndë për një njeri të mbajë barën e lirisë. Liria përmban vuajtje të panumurta të jetës dhe njeriu heq dorë

lehtë prej lirisë, por Perëndia ka nevojë për lirin e njeriut. Mendimi perëndimor e kupton lirinë para së gjithash si një të drejtë, si një kërkesë. Ay ve të drejtat e njeriut karshi atyreve të Perëndisë. Mendimi fetar rus kqyr me kujdes iden' e lirisë dhe e kupton si një detyrë të vënë prej Perëndisë, si një trimëri të shënjtë. Rusi ka një shpirt të lirë, më të lirë në jetën fetare; ay është më pak i lidhur me formën, me organizimin, me të drejtën dhe regullin. Liria e mendimit s' është një pasoje e një disipline, e një organizimi; ajo është atmosfera jetike, e cila mbulon jetën kishtare dhe ekzistencën e përditëshme, është një diçka e vjetër e parë. Në mendimin fetar rus, liria nuk është e lidhur me individualismën siç ngjan shpesh herë në mendimin e Perëndimit. Përkundrazi Khomiakoff-i dhe Dostoievvski, të cilët paraqitnë në mënyrën më të qartë iden e lirisë fetare, kan qënë andi-individualistë, ekstremistë dhe radikalë. Liria në ndërgjegjen fetare ruse është lidhur me njerëzinë.

Këjo njerëzi është kuptuar si një organismë e lirë, një komunitet i lidhur lirisht me anë të dashurisë. Individualisma, e cila e përçan njeriun dhe e ve kundër të tjerëvet dhe botës, e bën rob te nevojave të jashtme.

Liri nuk ka veç se në shoqërin e shpirtëvet të bashkuar me anë të dashurisë. Kisha është një komunitet i lirë dhe një liri e perbashkët: është bashkimi i lirisë dhe i dashurisë. Jashtë dashurisë, jashtë këtij komuniteti të përbashkët, liria humbet dhe kthenet kundër vetes së sajë. Dostoievvski e ka provuar me një fuqi gjeniale, si liria pa Perëndi, një liri individualiste, një liri arbitrare dhe rebeliste, ndryshohet në shtypje, shtrëngim dhe tirani. Ky rezik është fshehur gjithmon në lirin ruse. Fryma e popullit rus, e ruan në vet-vete dhurëtin e liris së shënjtë, po ajo ruan në vet-vete dhe rezikun që ajo të kthehet në tirani të lartë. Ja tregimi i Dostoievvskit, profetit të kryengritjes ruse.

Një karakteristikë tjetër e idesë fetare ruse është forcimi i tërësisë së frymës dhe qëndresa kundër çdo pjesëtimi të frymës në kategorira. Feja nuk përbën një fushë të veçantë të shpirtit, një sferë partikulare të civilizimit; ajo është jeta e pandarë e frymës. Jeta shpirtërore nuk mund të jetë ndarë në sfera të veçanta, që mvaret tërësisht prej vatrës fetare. Pjesëtimi i

shpirtit dhe i kulturës, formimi i sferavet të ndara prej qendrës shpirtërore të jetës, do të thotë vdekje për shpirtin, humbje të kuptimit fetar. Ideja fetare ruse nuk pranon marrëdhënëje eteronome, shtrëngim të jashtëm, ndërmjet kishës dhe fushavet të tjera të jetës dhe të fesë. Në idenë fetare ruse nuk ekziston universalitet me anë forcë të jashtme. Këtu nuk flitet për bindjen e një veprë në tjetra; këtu flitet që njeri dhe tjetri të jenë të lidhur organikisht, të shtrënguar dhe të përputhur në mënyrë ontologjike, në menyrë të ngushtë, në një mënyrë të lirë dhe jo të imponuar së jashtmi. Mendimi rus është esencialisht integralist. Fuqit e tij krijonjëse kanë për qëllim ndryshimin e botës. Ky realitet i dukshëm i shpirtit rus është pengesa kryesore që i vihet përpara krijimit të një civilizimi nga fushat e ndryshme. *Letratyra ruse është ndëpërshkuar prej idesë fetare. Ideja fetare qëndron dhe në bazën e filosofisë ruse.* Tema e aspiratavet dhe e lëvizjevet shoqërore ruse është një themë fetare dhe jo një themë politike. Dostoeievski e ka çfaqur në mënyrë të çuditëshme, që kryengritësit rusë nuk interesoheshin kurrë për politikë dhe as që nuk bënin politikë. *Problemi i Hyjnisë, i pavdekësisë, i atheismës, i shpëtimit të njerëzisë, ja ç' i tërhiqte ata.*

Në shkencë, në politikë, në artet rusi ka për qëllim të realizojë idenë ruse në një mënyrë *pozitive* ose *negative*.

Përsa i përket idesë ruse, ajo nuk është një ide civilizimi, por një ide shpëtimi dhe ndryshimi fetar, një ide e qëllimit të historisë dhe jo i çvillimit historik, një ide e qëllimit krishtëror ose andikrishtëror.

MENDIME T' ARTA

*As ulku nuk ka ulkun, as shujtani nuk lajflon shajtanin.
Përkundrazi njeriu e lajflon njerinë dhe mundohet t' a çdukë.
Sa rënje e madhe!*

* * *

Atje ku është dashurija, nuk ka lodhje e mundim. Po edhe në pasë no një herë, edhe kjo bëhet e dashur dhe e këndëshme.

Nga kryeveprat e Atërvet të Shenjtë

Fytyra dhe shpirti

Kur sheh no një njeri të gjatë, me trup të madh, me fuqi më të madhe se të tjerët, mos e admiro kete dhe mos i ki zili, para se t'i a njohësh mirë shpirtin. Le t'i lumurojmë të tjerët jo pse janë të bukur nga fytyra, por për bukurin' e mirësin' e shpirtit. I vogël ishte David-i dhe i shkurtën nga trupi; po ky i vogël nga trupi dhe i shkurtër, ndon se pa as një armë në dorë, mundi të rëzojë e të hedhi poshtë tërë ate kështjellë mishore Galilathin; dhe e dini me se? vetëm me një gurë të vogël.

Prandaj Shkrimi i Shenjtë thotë: Të mos lëvdërosh tjetrin për bukurin e tij trupore, as të mos mërzhitesh me shemtimin e ndo një tjetri. Edhe bleta është e vogël në mes t'atyre që flytyrojnë, po mjalti që na jep, është m' i ëmbël nga tërë ëmbësirat.

Kështu ngjet edhe për privatët e për qytetet.

(Gojarti)

Gëzimi i vërtetë

Zoti i tha nxënësve të Tij në mbrëmjen e darkës mystike: Dot t'ju shoh përsëri e atëhere do të gëzoheni; dhe gëzimin tuaj as kush nuk do të mundë t'ju a mar. Fjala e shkurtër kjo, po me gjithë këte ka brenda një ngusdëllim të madh. Le të shohim pra çkuptim kanë fjalët «gëzimin t' uaj as kush nuk do të mundë t'ju a marë». Ja se çkuptim ka: Në qoftë se ke pasuri dhe gëzohesh për këte; këte gëzim mund të ta marin shumë njerës e në shumë raste; kusari p. sh. q' e çpon murin ose shërbetori i

yt, të cilit i ke ngarkuar ruajtjen e të hollavet të tua.... Kur je në fuqi, përsëri shumë janë ata që mund të t'a rëmbejnë gëzimin që të jep nofta fuqia: Së pari vendi që ke të sjell shpeshherë shumë çeshtje të vështira dhe kokëçarje, që t'a pakësojnë, në mos t'a heqin fare, gëzimin; fuqia pastaj nuk është një gjë që s'ka mbarim; përkundrazi, si çdo gjë e kësaj bote, është e shkurtër, me të marë pra tatëpjetën, rëshqet edhe fuqia gjer sa të çduket fare. Mund të më thuash se gëzimin t'a jep shëndeti i mirë dhe fuqia trupore që ke. As pak. Se një sëmundje e shkurtër, t'a rëzon shëndetin e bashkë me këte edhe gëzimin. As mos më thuaj se ke një bukuri trupore te rallë, e se për këte me të drejtë gëzohesh; gabim i madh. Sepse të plakos pleqëria, e çduk bukurinë t'ëndë e kështu t'a mer gëzimin.... E kjo ngjet, vëlla i dashur sepse terë sendet e kësaj bote janë të përkohëshme dhe ndryshohen shpejt shpejt, e për këte arsye nuk mundin të na japin një gëzim të përhershëm e të vërtetë.

Po krejt e kundërta ngjet me shprestarin' e me virtytin. Bën p. sh. lëmoshë dhe shpëton një familje të terë nga uria e nga reziku. S'ka dyshim se ndjen për këte një gëzim të pa treguar; po m'e madhja është se këte gëzim e ke nga herë, e ke gjer sa të vdesësh; se as një fuqi në botë nuk është e zonjë të t'a çdukë e të t'a marë. Si kur të vërsulet një ushtëri e terë si kur terë armiqt të bashkohen, nuk do të mundin të t'a pakësojnë këte gëzim. Gëzimi që fitove mbetet për herë; se është regjistruar atje sipër në qiell. *U dha të vobektëve, thotë Shkrimi i Shenjtë, dhe drejtësia e tij mbetet në jetë të jetëve.* Dhe me shumë të drejtë. Se është mbyllur dhe ruhet në arkat e qiellit, ku as kusari s'mund t'a rëmbejë, as vjedhësi s'mund t'a grabitë, as mola t'a hajë. Ose bën lutje të dendura ne Zoti dhe falesh dit' e natë, si në kohë mjeftimesh, si edhe në kohë gëzimesh. Edhe pema e këtyrevet mbetet përjetë e as kush nuk mund të t'a marë, sepse ka zënë rënja atje lartë i sigurt dhe i lirë nga çdo çpifje ose mësymje. Në se më në fund të dëmtojnë dhe ti u bën të mirë, flasin keq për ty të tjerët dhe ti u sillesh me dashuri si një krishter i vërtetë, në se të shajnë dhe ti u përgjigjesh me bekime e me mirësi, gëzimi që ndjenë nga këto sjellje është i për-

hershëm, se as një njeri nuk mund të t'a rembejë me as një mënyrë. Pse? Sepse këto janë veprime shpirtërore që s'vdesin kurrë, e pra edhe gëzimi i rjedhur nga këto mbete për jetë.

(GOJARTI)

Mëshirë me drejtësi

Po të gjykonte Zoti veprat t'ona me drejtësin' e Tij dhe po të tregonte një rebdësi të barabartë me ato, atëhere nuk do të na mbetej as një shpresë shpëtimi. Me të vërtetë: Kush mund të shpëtojë, në se Perëndia ushtron drejtësin' e Tij ashtu siç e kërkon sjellja e jonë dhe veprat t'ona? Këtë pikësisht kishte para sysh edhe profeti kur thoshte: «O Zot, o Zot, po t' i vesh re paudhësit t'ona, kush vallë do të mundë të qëndrojë e të durojë?»

Po për fat të mirë Perëndia vepron krejt ndryshe: Si gjykatës d.m.th. i veprave t'ona nuk ushtron vetëm drejtësinë po mer për krah me këte edhe mëshirën e Tij të madhe. Kështu pra mbi fronin e Tij mbretëron qëndrojnë mbë njerën anë drejtësia, e mb' anën tjetër mëshira. Drejtësia dhe mëshira e Zotit janë lidhur në mes të tyre aqë ngusht, sa që as mëshira vetë të mos mundë të te sjellë një lloj përtacërie ose mos përfilljeje, as prapë drejtësia vetë të mos mundë të të kallë mërzitje dhe dëshpërim. Gjykatësi i lartër dëshiron të të mëshirojë e të për hapë mbi ty tërë butësin' e Tij.

Po që të veprojë kështu, duhet të plotësosh, vëlla, disa kushte. Cilat janë këto: Të të gjëjë së pari të pendurr e të përulur pas çdo mëkate që mund të bësh, të të gjëjë të dërmuar e të ndryshuar krejt shpirtërisht e moralisht; të të shohë se qave e vajtove për punat e liga që ke bërë se pa pikë drojtjeje ke rëfyer tërë mëkatat e tua, se më në fund kërkove ndihmë nga vëllezërit e tu të të ndihmojnë që të ndreqesh e të bëhesh njeri i mirë...; Kur pra do të shohë, se ti u-bëre i denjë për mëshirën e Tij, atëhere do të derdhë mbi ty pa kursim mëshirën e Tij të madhe.

Po në qoftë se do të shohë se ti për kundrazi ke një zemër të pa ndrequr, se shpirti i yt ëhtë plot me mburje e me

kryelartësi, se nuk beson në jetën e ameshuar, se nuk e përfill fare gjyqin e ardhëshëm, atëhere nuk përdor më mëshirën, po lëshon kundra teje dënimin e Tij të drejtë. Se Perëndia në fillim, si një mjek i zoti dhe njerëzidashës, mundohet të pakësojë fuqin' e sëmundjes me barëra të ndryshme ; po kur sheh se sëmundja nuk shirohet, atëhere heq dorë fare nga ilaçet dhe mer në dorë thikën.

Zoti pra e mban mëshirën për ata që pendohen, kur se për ata që ngulin këmbë në mëkatën, ruan dënimin.

(Shën Vasili)

Përkth. prej Shprestarit

MENDIME T' ARTA

Krishti mbasi i dha gjindjes me hëngër në shkretëtirë, nuk i dërgojë me sjei në krevatet e tyre, por i thiri me ndigjue prap sjalët hyjnore. Gjithashtu le të bëjmë edhe ne. Le të mësojmë dhe neve vehten t' onë me hëngër aq sa na duhet për të mpajtur jetën t' onë, jo deri sa me tiranuem e me rânduem stomakun dhe gjithë trupin t, onë. Sepse nuk jemi krijuem dhe nuk jemi në jetë për me hëngër e me pi, por hamë që të rrojmë.

Jeta në fillim nuk është bër për me hëngër por e ngrana është dhënë për me rrojtur. Dhe neve se kur erdhëm në botë për të hëngër e për të pirë, ne këte prishim dhe vehtën t' onë dhe humbim kot gjithë kujdeset t' ona.

* *
*

Pasuria është e mirë jo kur ruhet nëpër arka në mëngrë argjendashese, por kur përdoret për të ndihmuar ata që kanë nevojë.

Filloni

PËR RININË

Besa e fëmis bëhet bes' e të riut

Në rast se këto që po shkruaj bien në duart e ndonjë këndonjësi të ri, që ka humbur besën, s'kërkoj prej tij gjë tjetër veç së t'i bëjë vetës lirisht këtë pyetje: ç'kam humbur dyke humbur besën dhe ç'fitova me pabesërinë.

Sill ndër mënd kur ishe ende shumë i vogël. Ç'besë e gjallë vaditte shpirtin t'ënd! Do të deshronja të të vë ty të 17 ose 18 vjeçarin djalosh pranë fëmis 7 a 8 vjeçare, siç ishe një herë.

Pjekje e çuditëshme!

Ajo fëmi e vogël, me sytë krejt të çelur, me veshje marinari, të shikon me tmer ty djaloshin e mbushur dhe me mystak të porsa-dalur. E me gjith këtë, ti ke qenë një herë ajo fëmi, ti vetë!..... Dhe ishe i lumtur atëhere!

Kujtoui!..... Sqoeshe në mëngjes nga krevati i yt i vogël, i bardh; i bardh ishte dhe shpirt'i yt. Thoshnje lutjen t'ënde të mëngjezit drejtuar Atit, Birit e Shpirtit Shenjt. Sa me gëzim kalonte dita! Nxetësia e ëmbël e asaj lutjeje mëngjezore, të gjallë dhe freskojnëse të pasonte gjithënjë dhe kur pas lujes së mbrëmjes puthje prindërit e tu: natën e mirë mama! të zënte gjumi me nënëqeshje në buzët..... Kujtoui..... sa i lumtur ishe!...

Më vonë, të ra një ditë në duart një libër..... ose ndoshta të të ketë tronditur ndonjë bashkë-fjalim me ndonjë djalosh të lehtë nga mendja..... a ndonjë tjetër ngjarje t'i ketë vënë mendjes s'ate që ka nisur të piqet, ketë pyetje:

«Janë vall të gjitha të vërteta, siç i besoj? Besa ime bazohet në realitet?.....»

Në fillim dyshimi guxoi vetëm të pëshpëritnjë. Plot me frikë, ti e dbove.

Po kot. Erdhi prapë dhe nisi të të flasë me zë më të math. Pasuan muaj plot me dhimbje. U nis një luftë nërmjet besës dhe pabesërisë, dhe shpirt' i yt i ngrat u-bë fushë lufte.

«Ik, o besë fetare e paprekur! S' ke më vënt në këtë shpirt! Kishte vërtet fëmija besë absolute, por i riu s'munt t'a mbajë më këtë besë. Don të rojë, don të shijojë jetën! Tani është i ri! I lejohen shumë gjëra tani!» Të këtilla të tha pabesëria.

Besa u-përpoq të kundërshtojë.

«Dua të mbetem! A nuk qesh gjer tani jeta, gëzimi, lumtëria e kësaj fëmije? Shkëlqimi i syvet të sajë, qetësia e shpirtit të sajë, gëzimi i ditëve të sajë, të gjitha këto i detyroheshin besës së sajë të panjollëshme!

Dyke u-kthyer pastaj nga ty, vazhdon:

«Unë të jap fuqi e kurajë, mos më le!»

Por pabesëria e ndërpret:

«Në t' ardhmën unë do të të enkurajoj, unë do të të tregoj udhën që duhet të ndjekësh....- unë do të të bëj të piqesh.... mba-më!»

Kjo histori është e përpiktë, a nuk është kështu? Mos vall pabesëria del gjithëmon ftonjëse në këtë luftë? Zakonisht jo; besa e fëmis nis të ndryshohet, të piqet. Bëhet besa e të riut. Mirpo kij mëndjen mos t'a humbasësh gjat këtij ndryshimi! Kij mëndjen mos të t'a djegë këtë zjari i ndjenjavet të tua që për ditë bëhen më kërkonjëse! Gjat këtyre vjetëve të luftës, duhet që të falesh me gjallëri të dyfishtë: «besoj o Zot, ndihmo-më në pabesërinë t'ime». E përktheu B.

MENDIME T' ARTA

Ay që flet keq për baban e tij është sikur fyen Perëndinë.
Menandre

a) Shumë njerës të mdhenj katandisnë të mos kenë as të ndenjtur. Dhe njerës pa rëndësi me rrymat e kohës dhe të jetës mbajtnë kurorën mbretërore.

* *

b) Shumë njerës të pushtetit dështuan në mënyrë të tmerëshme dhe njerës me lavdi të madhe botërore u-katandisnë skllëvër.*

* *

c) Pa hetuar mirë mos qërto. Dhe pasi të hetosh qërto me
Nga fjalët e urta të Sirahut

Fjalë ngushëllimi

Dy të vërteta

Nuk do të jetë pa qëllim —, ndofta do të jetë shumë, e dobishme të mësojmë se ata që durojnë hidhërimet dhe ngushticat e kësaj jete kanë për të pasur një fitim shumë të madh dhe se për këtë detyrohen të forcojnë zëmrat dhe ti kalojnë ditët e tyre me shumë durim.

Shën Pavli në kryen e XII të letrës nër Ebrenjtë ka ndërmjet të tjerave edhe një fjalë për të cilën të krishterët detyrohen të qëndrojnë të palujtëshmë në besë, dyke duruar pa klithmë ç' fardo hidhërim dhe provim nga Perëndia, edhe këjo është që Perëndia arësen «për fitim». Dhe se vetëm ky vërtetim me rëndësi, pa as ndonjë hollësi tjetër do të ish i aftë të futte guximin në ata që u mungonin shpresë në të dëshpëruarit, të frymëzonte durimin në ata që s' qëndrojnë para vuajtjevet dhe hidhërimevet të jetës.

Sepse kur neve shohim që fjala e Perëndisë na ka vërtetuar prej kohësh se Fat-bar-dhësisht Shën Pavli cakton dhe sendin e dobisë, të cilin do t' a kemi prej arësimit dhe provimit, të cilin na e dërgon Perëndia, duke zbuluar me këtë mënyrë një të vërtetë, dijenia e së cilës është e aftë të shpërndajë gëzimin në ato zëmra, të cilat dëndur hidhërohen dhe s' kanë durim.

Ç' thotë? «Perëndia arësen për fitim, që të merni pjesë në shënjtërimin e tij». Ja fitimi, ja dobia. Të pjesëtojmë dhe ne nga shënjtërimi të cilin e ka Perëndia. Të bëhemi dhe ne shënjtore siç është shënjt dhe Perëndia. Dhe me këtë mënyrë të bëhemi pjesëtarë të lumërimit, në të cilin na thëret Perëndia.

Që të merni nga shënjtërimi i tij thotë: «Sado që të

na duket gjë e çuditëshme, sado që na duket e papërshtatëshme në dobësinë t' onë, me gjith këtë është e vërtetë, sepse këtë nuk e thotë njeri, por e vërteton fjala e Perëndisë, e cila është jashtë ç' do dyshimi. «Perëndia arësen për fitim, që të marim nga shënjtërimi i tij». Pësimet, vuajtjet dhe hidhërimet e kësaj jete e përbëjnë dhe e përmbarojnë shpirtërisht njerinë, e qashtërojnë nga ndyesitë dhe nga njollat e mëkatit, dhe e sjellin më afër Perëndisë. Ç' do hidhërim dhe ç' do provë e jetës është për ne të gjithë një vizitim i mirësisë së Perëndisë, i cili si At i ditur drejton bijt e tij dhe i rregullon që t' i marrë në Mbretërinë e tij Qiellore.

Me të vërtetë, në qoftë se neve shohim vetëm kohën e tashme e ndjejmë shtërngimin e hidhërimit dhe dhëmbjen e provimit. Por do të vinjë koha — kur do të binde mi me siguri, se do të mësojmë që pikërisht n' ato ditë të hidhërimit dhe të provimit Perëndia përpunon edukimin e njeriut për të vetëmin qëllim të naltë: «që të marrën pjesë në shënjtërimin e tij». Prandaj mos u-mërzit ti o këndonjës i dashur. Në është se ditët deri tash t' u ndodhën të hidhura dhe fshive për herë lote nga syt' e tu, në është se e shihnje dhe shikon rrotull teje zinë dhe hidhërimin, dubet t' a dish se gjith këto s' ishin as që janë pa ndonjë për dobin t' ende të vërtetë.

Është një e vërtetë që meriton ç' do besim, se Perëndia arësen për dobinë t' onë që të bëjmë pjesë në shënjtërimin e Atij». Dhe mbassi kjo është e vërteta, përse të mos i kalojmë ditët t' ona duke duruar dhe duke pritur me besë punët e Perëndisë dhe duke mbetur besnikë në dëshirën e tij?

Margu.

MENDIME T' ARTA

*Dëshëron t' a zbukurosh trupin t' end me stoli të bukura?
e Mo sstolis me margaritare, po vetëm me urtësi e me përlësi.*

JISILLA-U

(vijon nga numri i kaluar)

-- Un po të them që s' je në 'të.

— Edhe un po ju them se kini lojtur mentsh në besoni budallallëke të këtillë.

Ky dialog po bëhej një ditë të Djelë pas dreke në kafene-n e fshatit, dhjet ditë pas kthimit të Ajisillaut. Nja pesmbëdhjet fshatarë rinin nëpër kanapet e karigat e kafenë-së e po bisedonin.

Ajisillau nuk tregonte më për viset që kishin natë kur neve kemi ditë, as për njerëzit q' ishin të zezë sterë si tenxhereja.

Dhe katundarët s' e dëgjonin më tani me gojën hapur, si atë darkë.

Jo. Të gjithë ishin skandalizuar nga sjellja e tij. Dëgjo aty, Krishtlindje dhe Vit i ri, ditë të mëdha e të shenjta, dhe ay të mos shkelë në Kishë! ku është dëgjuar këjo? Një nga ata s' u-mbajt dot dhe e bëri fjalë në kafenë. Dhe bisedimi u-ndes.

— Un po të them që s' je në vete, i tha një katundar i zemëruar.

— Edhe un po ju them se kini lojtur mēntsh në besoni marrëzira të këtilla. E thash e po e them prapë: Ndo-dheni në errësirë. Në Amerikë, ku bota është ndriçuar, s'ndërtojnë kisha më.

— Po ç' ndërtojnë?

— Ndërtojnë banka. Ndërtojnë teatro e cinemara. Këto janë për njerëzit e civilizuar.

— Ndoshta ka edhe kisha po s' i ke parë ti, tha një katundar i ri. Mua më ka shkrojtur vjet Kola, kushërir' i im, se të krishterët n' Amerinë mblodhnë ndihma për të ndërtuar një kishë të madhe. Dha edhe ay pesdhjet dollarë.

— I ndërtojnë priftërinjt për të patur ç' të hanë.

— S' i ndërtojnë priftërinjt po të krishterët, tha një tjetër. Edhe neve këtu në fshat me djersën t' onë e me ndihmën e djemvet t' anë që janë në Amerikë e në Australi, e bëmë kishën t' onë.

— Edhe ç' fituat? U jep të hani?

— Si s' na jep? Po të mos kesh Zotin si ndihmës, puno e mbill sa të duash.

— Zoti? Ku është ky Zot? Un s' e kam parë. Un shoh vetëm të hollat që kam. Shoh parat, arin, q' e mbaj në dorë dhe blej ç' të dua. Me ato ha, me ato vishem, me ato rroj. Mua që më sheh, kanë kaluar nga duart e mia të hollat e dynjas. Parà me bisht, mer vesht? Parà që as n' ëndër s' i kini parë juve. Po të mos kisham unë tridhjet mij dollarë në Bankë, në Amerikë, ç' do të më bënte feja? Feja s' më jep të ha! Un pra po mbaj dollarët e mi dhe ty po të fal fenë. Me fenë s' ngope, me të hollat mbush barkun.

— Neve, gjërsa kemi shpresë te Perëndia, kurrë s' mbelemi pa bukë, i tha një fshatar plak. Vetëm kur ikim nga udha e tij, mbjellim e nuk korrim. Me këtë besë kanë rrojtur prindërit t' anë, këtë do t' u a lemë dhe ne fëmijvet t' anë. Perëndia të ka dhënë duar që të punosh e të fitosh të holla, por të ka dhënë dhe tru që të kuptosh. Të hollat shpesh herë bëjnë krahë, e di a po s' e di?

Budallallëke! tha Ajisillau dhe u-shtri me përbuzje në kanapë dyke ndezur një puro. . . .

* *

E pikëlluar thell në zemër është teto-Katingo-ja e mjerë. Ah! Pse Ajisillau i sajë të ndërtojë aq tepër në kurbet? Sa keq i vinte kur dëgjonte fshatarët t'a quajnë të «pa fë». Sa ish dëshpëruar e shkreta kur ay një darkë i tha: kush i beson Perëndis është budallá. U-trondit e shkreta dhe për pak do të

shtrihej për dhé. Kish dëgjuar një herë për një tjetër që çau me sopatë ikonat e shtëpis dhe i u-droth mish' i tërë. Po ja që, ato të cilat i dëgjonte për botën, i shihte tani brënda në shtëpi të sajë. E zuri tmeri.

—Mos bir; për emërin e Zotit, mos fol kështu. Do të na gjejë ndonjë e keqe e madhe.

S'shkoi shumë kohë.... Një ditë si hyri nga kuzhina në dhomën e djalit të sajë, teto Katingo-ja uxori një britmë dëshpëronjëse dhe u-turr brënda si e marrë. Ajisillau, i ulur mbi karige, i verdh, me kryet hedhur me një anë, me syt të shuar, dukej si i vdekur.

Në britmën e sëmës rendi dhe Evgjenia. E pushtuan, nisën t' i flasin, t'a tundin. U hodhi një vështrim të dobët, pa u folur. Lëvizti duart me dridhje dhe ia të bjerë posht një letër. E muarën atëhere dhe e shtrinë në shtrat dhe i bënë gjithçka dinin për t'a sjellur në vehte.

— Letra? Ku është letra? Ithirri. Ah, të hollat e mia, vanë të hollat e mia! Dhe nisi të qajë si një foshnjë.

Evgjenia ndërkaq kish mar letrën që kish rënë për dhe. Me duar që qo i dridheshin, me buzë të shtrënguar nga agonia, i hodhi një sy të shpejtë.

Buenos Aires. 28 Jenar 1932.

I dashuni mik Ajisilla.

Jam shumë i hidhëruar se.... Porsa pardje të shtunën pasdreke, morra letrën t'ende, në të cilën.. Pas udhëzimevet të tua do të shkonja sot në Bankë për të bërë porosin të të dergojnë të 30 mij dollarët që.... Mjerisht nuk.... Sot në mëngjes pikërisht, kur qesh gati të dal, këndova në gazetë për falimentimin e Bankës Staifel, që u-hë nga shkaku.... M' u-duk si e pabesuarshme. Vajta të sigurohem më mirë. Mjerisht, Ajisilla i dashur, ka qënë e vërtetë....

Miku i yt

Evgjenia e këndoi me shpejtësi nga frika dhe pastaj

përmbajtjen i a tha s'ëmës. Mbetnë për një moment pa folur, dyke vështruar njera tjetrën. Po britmat dëshperonjëse të Ajisilla-ut i detyruan t'i afrohen prapë.

— Ah, të hollat e mia, të hollat e mia, vanë të hollat e mia, therriste i shkreti dhe i binte me grusht kokës, gjoksit, ajrit.

E ëma mundohej t'a qetësonte.

— Pusho bir, qetësohu xhan, mos bën këshu. Vetëm shëndet të kesh pa të hollat i fiton prapë. Qetësohu bir, ka Perëndia.....

Ka Perëndia..... O, po; këto të dy fjalë të shkurtëra qenë ato që kishin hedhur në shpirtin e plakës së mirë balsamin e ngushëllimit në aq'e aq'ë furtuna të tjera q'ë kishin gjetur. Atëhere kur i sëmureshin fëmijët, atëhere kur vdiq barba-Kristua dhe e la të ve, pa të holla, pa ndonjë përkrahës e me shtëpinë peng, atëhere kur i suallnë mandatin e hidhur që i vdiq në luftë djali i saj tjetër, Stavrua i saj i dashur, q' ishte dy vjet m' i vogël se Ajisillau — në të gjitha orët e'vëshlira që mjerimi turrej si rebesh për t'a rrëmbyer, n'ato të dy fjalët gjente ajo kurajon të mbahej e fortë dhe t'i bëjë ball dhimbjes e mjerimit. Ka Perëndia thoshte. E më në fund... kishte Perëndia gjithënjë për' të.

Ka Perëndia! Po; por ajo ishte, si dihet, nga ata që rronin akoma në njëmij e katërqind. Ajo s'kish marë pjesë në klub-in «mendimi i lirë». Mirëpo ay? Ku do t' a gjente atë fuqi? Kurse mbështetja e tij e vetme, shpresa e tij e parë, të hollat e tij, e kishin lënë, ku do të munt të mbështetje? Ah, s' kishte asnjë mbështetje.

— Të hollat e mia, ah! të hollat e mia, bërtiste. Dhe vazhdonte t' i binte kokës me deshpërim.

Dhe nana e shkretë i lutet pa pushim; dhe motra e ngratë bashkon gishtërinjt dhe shëkon me dhimbje shpirti.

— Aman or bir, pusho. Mos u-dëshpëro. Ka Perëndia. Do të të ndihmojë. Do t' i fitosh përsëri.....

— Perëndia? Ç' është këjo Perëndi? Të hollat e mia, ah, të hollat e mia!.....

U-hodh përpyjet i egërsuar, si i marrë. S' mnudnë t'a përmbajnë. Me tri hapa u-gjend në rrugë. Tërë ditën s' e

panë më. As natën. Qarje e ulërime në shtëpi të teto-katingo-s. Në të gdhirët u a suallnë në shtëpi gjysmë të vdekur ca katundarë. E kishin gjetur pesë hapa jasht pijetores, të shtrir në kalldërëm si të vdekur.

Atje, në pije, kish kërkuar i mjeri ngushëllimin e vet.....

* * *

Kaluan qysh atëhere gjasht vjet. Teto katingo-ja, si duroi me qëndrim dhe këtë fatkeqësi të fundit, fle tani gjumin e sajë të qetë përmes dy qiparisash, në qimitirin e fshatit, për anë varrit të barba-Kristos. Evgjenia e sajë ka shkuar në një vënt tjetër për të rrojtur dhe qan prishjen e shtëpis së vet. Ajisillau, ose siç e quajnë katundarët Jisilla, pi, gjithnjë pi. Në fillim pinte që të ngushëllohej. Tani as ay vet nuk di pse pi. Arat e pakta, që barba-Kristua i kish fituar me mundime, janë mbushur me ferra e gjëmbe Herë pas here gjëndet ndonjë nga fshatarët e blen ndonjë pjesë, më tepër për mëshirë, që t' i japë djalit të mjerë, që dëshiron më tepër të pijë se të hajë, ndonjë dhekarë.

Dhe vetëm shtëpia e vogël, e ndërtuar në rrugicën e ngushfë që lidh mëhallën e poshtme me sheshin e fshatit, e gjysmë-rrëzuar dhe kjo, e tymosur e mos më keq, ofron të katër muret e sajë për të ruajtur nga gurët «fytyrën e egër», lodrën e rugaçvet.

Gjynah për atë djal trim!.....

MENDIME T' ARTA

Çdo program arësitor, që nuk i jep vendin e parë mësimin të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë pregatit çkattërrimin moral të brezit të ri.

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT i IV-të

TETOR 1943

Nr. 8

LANDA: Prej gërmadhavet lëvizje e re — Feja dhe Shkenca — Themë Filosofike — Ideja Fetare Ruse — Qëtetërim shtëpior dhe Qytetërim mekanik — Monastiret kryesorë të Dhiogëzës së Beratit — Njeriu që ankohet se nuk beson në Perëndinë — Mbi lirin e Jisuit — Zakheu.

Prej gërmadhavet lëvizje e re

Një simptomë tjetër e administratës së keqe në një komb të paligjët është dhe çregullimi i brëndshëm. Kusarë e grabitës me një anë, gjejnë rast të fillojnë zanatin e tyre përseri dyke mar shpesh herë aqë guxim sa të ndalojnë komunikasjet, të hyjnë nëpër qytetet, të grabisin popullin. Njerës të dështuar politikisht nga ana tjetër, të përkrahur nga klika e tyre, nisin dhe lëvizin prap për të shtënë në dorë fuqinë e për të shijuar të mirat e sajë. Demonstrata e greva këtej, turbullima e ngatëresa andej. Aq' e aqë spekulime e pasoje të tjera të keq-administrimit, krijojnë një gjëndje anarshije, e cila munt të përfundoj në një luftë vllavrasëse.

Këndonjës i dashur: të gjitha këto janë pla-

ga. Plaga vërtet të tmerëshme që shkakëtojnë përmbysje e krijojnë gërmadha. Por njëkohësisht janë dhe shkop. Shkop i cili munt të përdoret për urtësim e zgjim të kombit të paligjët, ashtu siç përdoret dhe «*kamxhiku për kalin e thumbi për gomarin*». Nëse në gji t' atij kombi gjënden e ca fuqira jetike, sigurisht këto kanë për t' u-squar e kanë për t'u-ngritur. Nëse ka, them, edhe ca elemente të shëndoshë, të cilët para se të arrijë këjo çthurje e maqinës shtetnore mbaheshin prej frikës, këta do të këcejnë tani më me guxim. Rreziku i përbashkët, do t' i armatosnjë me një lloj kurajoje që përpara s' e kishin. Dhe me që nga shkaku po i kësaj gjëndjeje anarshike të brëndëshme shumica e popullit ka për të qenë e pakënaqur, këta elemente të shëndoshë do të gjejnë në këtë pjesë një mbështetje të fortë. Dhe ka për të këcyer atëhere nga mezi i gërmadhavet një jet' e re, një levizje e re për ringritjen e shpëtimin e shtetit të çthurur.

S' munt të mohohet natyrisht se disa herë ngjan që paligjësia t' a këtë demoralizuar mjaft thellë kombin. Dhe s' do mënt që këto plaga munt të shënojnë në këtë rast çkatërimin e plot të tij. Mirëpo, ndërsa prishja s' ka arirë ende gjer në kockë, ka për të lindur me doemos ndonjë reaksion që do t'i bashkojë në një të gjith' ata q'u është shkelur dhe mbytur e drejta, të gjith' ata që rrojnë me frikë e pasiguri jete, të gjith' ata në kuris të të cilëve rrojnë «të majmët». Dhe këta të gjithë pastaj do të lëvizin, do të ngrejnë zërin, do të kërkojnë përmirësimin. Do të lëvizin me këtë mënyrë dhe ujrat e kënetës. Do të largohet mjaftë baltë. Dhe, në qoft se s' do të vijë pastrimi i plot, do të shënohet me

gjith këtë një përmirësim i dukëshëm, që do t' a bëjë gjëndjen më respektonjëse të së drejtës dhe të së mirës së përgjithëshme.

Kështu qëndron puna, këndonjës i dashur. E tha dhe i dituri Sollomon : *«sic është kamxhiku për kalin e thumbi për gomarin, ashtu është dhe shkopi për një komb të paligjët»*.

MENDIME T' ARTA

Krishti mbasi i dha gjindjes me hangër në shkretëtirë nuk i dërgoi me fjetë në shtratet e tyre, por i thiri me ndigjue prap fjalët hynore. Gjithashtu le të bëjmë edhe ne. Le të mësojmë dhe neve vehtën t'onë me hangër aq sa na duhet për me mbajtur jetën t'onë, jo deri sa me tiranuem e me randuem stomakun dhe gjithë trupin t'onë. Sepse nuk jemi krijuar dhe nuk jemi në jetë për me hangër e pi, por hamë që të rrojmë.

* * *

Nuk është e mundur të kuptosh fellë të vërtetën e krishterë dhe të kënaqesh me atë, në qoftë se nuk kujdesohesh më përpara të rregullosh jetën dhe sjelljen t'ënde simbas urdhërave dhe porosirave të kësaj të vërtete.

Feja dhe Shkenca

PROBLEMI I LINDJES SË NJERIUT

IV

K. Darwin-i—Studimet e tij mbi llojet e bimëve e të kafshëve të Verejtja themelore mbi të cilën mbashteti theorinë e tij. — Përmirësimi i racave me anën e zgjedhjes artificiale - Atë që bën njeriu me anën e zgjedhjes, e ka bërë natyra gjatë shekujve me anën e zgjedhjes natyrore !

Theoria e çvillimit ndodhej, sikundër u-tha, në rëzim e në erësirë, kur u-çfaq në orizondin shkencor K. Darwin—I (1809—1882), i cili e ringjalli, mund të themi, dhe i dha shkëlqim të ri kësaj theorie, e cila prandaj u-pagëzua me emrin e natyralistit Engles. (*) Darwin-i, i ri akoma (23 vjeç), pati rast të bukur që të studjojë me kujdes e për një kohë të gjatë llojet e ndryshme si të bimëvevet, si edhe të kafshëvevet. Bashkë me shkencëtarë Englezë të tjerë bëri një udhëtim shkencor në Amerikën e Jugut dhe këtu pas studimesh e vërejtjesh që bëri në pesë vjet e sipër, vuri përsëri problemin e rjedhjes së llojevet të ndryshme të jetës. Kur u-kthye pastaj në Angli, i vazhdoi këto studime, dyke venë re e dyke studjyar me një kujdes të madh tërë mënyrat e methudhat, me anën e të cilavet ata që merren me përmirësimin e bimëvevet e të kafshëvevet arrinë të nzejerrin e të krijojnë shumë lloje bimësh e kafshësh, dyke përdorur për këtë qëllim *zgjedhjen artificiale*. Kjo vërejtje pikërisht bashkë me ligjet mbi *zgjedhjen natyrore* e mbi *luftën e jetës* ka qenë themeli kryesor, ku e mbështeti tërë ndertesën e theorisë së tij.

Pikë së pari le t'a kqyrim me kujdes vërejtjen q' e shtyri

(*) Siç dihet, theoria e Darwin-it pas vdekjes së tij pati mjaft ndryshime dhe modifikime prej pasonjësve të tij. Kështu p. sh. kemi Neodarvinizmin e Veismann-it, theorinë e përcadapimit të predikuar prej Cuenot-it, Neolamarkezimin të çvilluar prej një grupit Darwinishtësh dhe çvillimin krijonjës të predikuar prej Bergson-it. Po në këtu nga shtyllat e kësaj reviste do të merremi vetëm me Darwinizmin e thjeshtë dhe do t'a gjykojmë këtë vetëm, mbasi ky është themeli dhe baza e tërë këtyre modifikimevet e ndryshimevet të pastajme.

Darvin-in të krijojë ipotezën e tij. Vuri re d. m. th. natyralisti në fjalë, se ata që merren me kultivimin e me përmirësimin e racave të bimeve, si edhe të kafshëve, kanë mundur me anën e zgjedhjes e me anën e bashkimit të posaçëm të llojeve të një kategorije, kanë mundur pra të sjellin në këto lloje shumë ndryshime; këto pastaj me anën e ligjit të trashigimit dyke shkuar në pasardhësit e këtyre llojeve, formuan shumë lloje deleesh, kuajsh, pullumbash e t. j. Njeriu d. m. th. që meret me ritjen e me përmirësimin e deleve f. v., zgjedh dy dele, mashkull e femër, me bisht të gjërë; dyke i bashkuar këto, si edhe pasardhësit e tyre, krijon një seri të madhe deleesh me trajta e vetija krejt të ndryshme. Me këte mënyrë u krijuan 150 llojë pullumbash, 180 llojë qenjsh dhe shumë lloje kuajsh e kafshesh të tjera shtëpiake. Ky fenomen kështu provon dy gjera: 1) se bimët e kafshët kanë këtë tendencë dhe prirje: të ndryshojnë, sa të jetë e mundur më shumë, karakteret e cilësive e vjetra dhe të largohen nga këto dyke marrë të tjera cilësi e vetija; 2) se këto cilësi të reja, po sa dalin në shesh, lakmojnë të shkojnë në pasardhësit e të bëhen pronë e tyre me anën e ligjit të trashigimit.

Mi këtë pra ngjarje e mbështeti Darwin-i dhe e ndërtoj teorinë e tij. «Në se, thotë, njeriu me zgjedhjen e me mjete të tjerë artificiale arrin të krijojë aq shumë llojë bimësh e kafshësh, ç' nuk mund të bëjë natyra gjatë shekujve me anë të një zgjedhjeje krejt automatike dhe natyrale? Prandaj unë kujtoj se për kafshët që ndodhen në planetin t' onë rrodhnë dhe u lindnë prej katër ose pesë llojesh vetëm. Kjo bile mund të më shtyjë ndofta që të shkoj edhe më tutje: të besoj d. m. th. se tërë kafshët u lindnë prej një protoplazmë të vetme; po kjo ipotezë do t' ishte mjaftë e guximëshme. Atë që bën në një rreth të ngushtë dora e njeriut dyke përdorur zgjedhjen artificiale, atë pikërisht mund të bëjë dhe natyra me anën e zgjedhjes natyrale (*Natural Selection*). Midis kafshëve shifet një lloj lufte jete, në të cilën disa fitojnë e jetojnë, kurse ca të tjera thyhen e çduken; shpesh herë bile këto të fundit janë ushqim' i të tjerëve. Kuptohet vetiu se gjatë kës. j. lufte ato kafshë që fitojnë e që jetojnë, janë të forta dhe janë pajosur prej natyre me cilësi e vetija më të mira. Mbetën pra në jetë ato më të fortat të cilat u japin pasardhësve të tyre tërë ndryshimet që kanë; e kështu me kohë krijohen lloje të shumta e të ndryshme pikërisht ashtu siç krijon edhe njeriu seri të shumta llojesh me anën e zgjedhjes artificiale».

Shpresëtar

THEMË FILOSOFIKE

LOGJIKA

II. Logjika është shkencë formale

Logjika, në shumicën e traktatevet të saj, dahet në dy pjesë : 1) *Logjikë formale* dhe 2) *logjikë reale* ose *praktike*, ose *e aplikuar*, ose *methodologji*.— Kjo damje, thonë, është pasojë naturale e faktit që, në secilin mejtim dallohet nga njena anë *forma* e mejtimit dhe nga ana jetër *lânda* e mejtimit. Logjika, kur studion vetëm formën e mejtimit, pa vue re objektet e dryshmë të tij, është dhe quhet formale. Dhe kur studion sbatimin e formës mbi këtë ose atë objekt të veçant, logjika është dhe quhet reale. Puna e logjikës formale, thonë, është kjo : «me vue mejtimin në godi (accord) me veten d. m. th. me ligjat e mendjes, në mënyrë që mejtimi të mos implikojë kontradiksimin a inkoherencën». Kur se puna e logjikës reale është kjo : «me vue mejtimin në godi (accord) me realitetin». Logjika formale na jep të vërtetën formale, kur se logjika reale na jep të vërtetën reale. Kemi kështu dy farë të vërteta, formale dhe reale, të cilat mund të ndodhen, njena me tjetrën, herë në pajtim, herë në kundërshtim.

Kritikë. Logjika është vetëm formale ; logjikë reale s' mund të ketë, për këto arsye :

1) Është e vërtetë që në ç' do mejtim dallohet forma dhe lânda ; por në logjikë lânda e mejtimit është prapë mejtimi, andai dhe definohet «shkencë e mejtimit». Lânda e logjikës është mejtimi natural, spontan, dhe jo lânda e

mejtimit natural. Logjika nuk vren lëndën (objektin) e mejtimit, por mejtimin vetë, d. m. th. punën që bën shpirti kur mejtton objektin.— Si algebra që nuk merret me numra konkretë, ashtu dhe logjika nuk merret me sende konkretë; si në algebrë termat e giukimevet enoncohen me sheja a shkroja ($a - b - n$) që symbolizojn numra me vlerë të pacaktuëme, abstrakte, kështu dhe në logjikë enoncohen me shkroja ($A - B$) që symbolizojn sende gjenorisht (en general) e jo sende konkretë e të caktuëm; dhe në-se dëndur përdoren emna sendesh si terma të giukimevet, kjo bëhet me qëllim shpalimi (shpëigimi) të mësimit me shëmbulla; bie fiala, kur thuhet «Tomorri është mal», kjo bëhet për të tregue çka është e si formohet giukimi (forma abstrakte e të cilit është: $A - B$), dhe s' don të thotë që logjika merret me Tomorrin e me malet, se abere nuk do t' ish më logjikë, por geografi.— Vtëmja e mejtimit në godi (accord) me realitetin nuk është mejtim, por dijë objektive; po t' ishte kjo pun' e sai, logjika do t' ish skenc' e dijës objektive, si dhe skencat e t' jera, gjà që s' pajtohet me definimin e sai si skenc' e mejtimit.— Logjika studion vetëm mejtimin dhe legitimitetin a illegitimitetin e tij; mejtimi është legitim kur vepron mas ligjavet të mëndjes; është illegitim, kur vepron kundër këtyne ligjave. Me kaq mbaron pun' e logjikës; pra kjo s' ka aspak punë me realitetin objektiv, as me të vërtetën, as me renën, me të cilat merren skencat objektive. Pra, s' paskemi dy farë të vërtetash, formale dhe reale, por nga njena anë legitimitet formal dhe nga ana jetër të vërtetë reale; logjika na mëson të parin; skencat objektive, të dytën.

2) Logjika reale ase methodologjia ase logjika e applikueme. siç tregon emni i sai vetë, është sbatimi i logjikës formale mbi botën objektive për me gjetë të vërtetën. Tashiti, sbatimi i një skence nuk mund të jetë prapë skencë, se do të kish po atë objekt dhe do t' ishte identike me shkencën që sbaton. Kështu dhe methodologjia, që kërkon të bëhet skencë më vete, nuk bën gjà tjetër veç të merret me lëndën e logjikës formale e me na përsëritë po ato që kemi mësue atje. Për njimënd, në piesën e sai gjenore

(generale), metodologjia merret me të katra reglat e Descartes-it, qi formulohen kështu : a) «mos prano kurgjâ për të vërtetë, veç çâ është evidente»; b) «da-e ç' do vështirsi nër elementet e vet, për me e sgjdhë mâ mirë»; c) «procedo me rënd. tue fillue prej objektit mâ simpl tek mâ i komponuemi»; d) «bâj enumerime të plota për mos me omettue kurgjâ».— Tashti, prej reglavet të sipërme, e para, qi Descartes-i ë quan reglë t' evidencës racionale, nuk është veç *postulati i arsyes* (ragione sufficiente), qi e ka burimin e vet te besimi themeluer e natural i shpirtit qi kurgjâ s' është e vërtetë, veç idenat racionale, dhe i cili është objekt i metalogjikës; metodologjia vjen tepër von me na e më-sue. E dyta është regl' e analizës; e treta, e synthezës; dhe e katërta i riferohet analizës dhe synthezës bashkë. Kështu, na jet për të giukue analizën dhe synthezën. Metodologjia, në piesën e çai farore (speciale) na jep format e dryshme të tyne (t' analizës e synthezës), qi janë këto : *dedukimi* (deduction), *indukimi* (induction), *analogjia*, *hypotheza*, *prova*, *definimi*, *divisioni*, *klasifikimi* si dhe *observimi* dhe *esperimentimi*.— Tashti, dedukimi, indukimi dhe analogjia janë të tri format e arsyetimit, objekt i logjikës formale. Hypotheza s' a gjâ tjetër veç një farë regredimi nga efekti te shkaku d. m. th. indukim, pra objekt i logjikës formale. Prova është arsyetim i sbatuëm mbi realitetin, për me tregue vërtetsin e një giukimi (thèse, theorëmë), pra, si formë, është objekt i logjikës formale. Definimi, divisioni dhe klasifikimi s' janë veç giukime; i pari, giukim identik, i dyti giukim divisiv, dhe i treti varg giukimesh divisivë; si giukime, janë objekt të logjikës formale. Sa-për observimin dhe esperimentimin, këta s' janë aspak mejtime, por momente t' esperiencës, veprime të vulnetit e të trupit mdi botën e jashtme, veprime fiesht lëndorë, kur-se mejtimi është veprim mbi idena; pra s' kanë punë me logjikën, e cila, si skenc' e mejtimit, fillon bash atjë ku mbaron esperienca; dhe është për t' u-habatur si bëhet fiailë për të nër librat e logjikës.— Kështu, metodologjia nuk i jet kurnji objekt studimi.

Konkludim. Kritika e sipërme na tregoi se logjikë rea-

le ase metodologji nuk ka dhe s' mund të ketë, pse i mungon objekti. E ashtu-quejtuna logjikë reale nuk është gjatë tjetër, veç sbatim i logjikës formale mbi objektet e esperiencës për me formuë dijen objektive. Sbatimi, veç, mund të jetë art, ushtrim, praktikë, teknikë, por shkencë jo. — As methodë nuk ka, veç methodës naturale qi mëndja vetë na e sugjeron spontanisht dhe qi, për këtë arsye, më mirë se methodë, duhet të jetë e të quhet *postulat* i mëndjes, formul' e të cilit është kjo: «me shkue prej së njohurës tek e panjohura». Processet e dryshme mendore s' janë veç forma të këtij postulati, mënyra sbatimi të tij dhe të ky e kan rënjën. Kështu, kur na është i njohun individi, efekti, fakti, passoja dhe duam të gjejm gjenin (genüs), shkakun, ligjën, parimin, mejtimi doemos është induktiv (analytik); kur na është i njohun gjeni, shkak, ligja, parimi dhe duam të gjejm individin, efektin, faktin, passojën, mejtimi është doemos deduktiv (synthetik).

K. T.

Artikulli „Kisha dhe lufta”, për arsye të lëndës së shumtë, mbeti për numurin që vjen.

MENDIME T' ARTA

Çdo program arësitor, që nuk i jep vendin e parë mësimin të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë pregatit çkatërrimin moral të brezit të ri.

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

IV.

Ontologjisma dhe realisma ontologjike janë pika të ndër-gjegjes dhe të idesë fetare ruse. Destini tragjik i civilizimit të ri qëndron në pjesëtimin e burimevet të jetës, në pamundësinë për t' u ngritur gjer në një ontologjismë, e cila të ndëpërshkojë të gjitha sferat. Në pjesën udhëheqëse të botës Europjane besa në mundësin e një çpërnguljeje të veprimit hyjnor në këtë botë është shtrydhyr; po kështu dhe besa në influencën e drejt-për-drejtëshme, në fuqit hyjnore përmbi jetën e njeriut dhe të njerëzisë. Një pikëpamje dualiste zotëron përsa i përket lidhjes ndërmjet botës dhe Perëndisë, ndërmjet kësaj bote tokësore dhe Zotit. Këjo botë ekziston vet-vetiu, dhe lidhja e saj me botën tjetër është kuptuar nën formën e një symbolisme idealiste, e cila duhet shquar prej symbolismës realiste.

Orthodhoksia është para së gjithash ontologjike. Ontologjisma është dobësuar në krishtërimin perëndimor për arsye të ndryshimevet të mëdha të historisë dhe të kulturës intelektuale. Orthodhoksia beson me këmbë-ngulje në mundësin e çpërnguljes së energjisë hyjnore në jetën e botës dhe të njerëzisë. Orthodhoksia, më tepër se katholiqësia, përcakton të dy botat; ajo nuk e lëjon fare kalimin e karakterevevet të botës së këtushme në mbretërin qiellore dhe në kishë, por ajo ca më pak nuk lejon dualismën ndërmjet kësaj bote dhe Perëndisë. Lidhjet ndërmjet Perëndisë dhe botës dhe marrëdhënjet reale ndërmjet të dy botave, janë të mundëshme. Një simbolismë realiste dhe idealiste është karakteristika e orthodhoksisë. Prandaj ideja e një autoriteti të jashtëm, është e huaj për orthodhoksinë. Një autoritet i jashtëm dhe formal nën-kupton mun-

gesën e një vazhduarshmënie ndërmjet të dy botave, një çkrifje të burimevet të jetës, një dyshim përmbi njeriun dhe botën. Ndërgjegjja ideale e orthodhoksisë ruse njeh autoritetin e brëndshëm të qënëjes hyjnore, e cila vepron ndër ne. Veprimi hyjnor që çfaqet ndër ne, ka një autoritet ontologjik dhe jo juridik dhe racionalist. Kriteri i së vërtetës fetare gjendet në eksperiencën shpirtërore, e cila çon në lidhje ose bashkim me jetën e vërtetë, qiellore, hyjnore. Perëndia vet me fuqitë e tij dhe dhurëtitë e hirit të tij përcakton një ndryshim ndërmjet së vërtetës dhe gënjeshtërisë. Në terma filosofike domethënë, kriteri i së vërtetës është intuitiv, është i bazuar në përvetimin e jetës hyjnore. Autoritarisma dhe racionalisma janë pasojat e largimit prej burimevet të para të jetës, pasojat e çkëputjes së botës nga Perëndia, e njeriut nga Perëndia. *Ontologjizma është bazuar në besën që natyra njerëzore nuk i është e huaj natyrës hyjnore, që jeta shpirtërore është një jetë përmbi-individualiste.*

Populli rus ka si karakteristikë shpirtërore radikale heqjen dorë prej botës dhe mirësive të saj. Kjo heqje dore nuk do të thotë që populli rus është më pak mekatar se popujt e tjerë të Europës. Është një popull mjaft mekatar, bile më mekatar se popujt e tjerë të Europës. Me anë të mekatarëve të tij populli rus është ngjitur pas të mirave tokësore, pas punërave të kota e të përkohëshme të dheut. Edhe ky është ngacmuar mjaft prej qefevet dhe dëshërimevet të kota, si edhe popujt e tjerë. Por me anë të virtytevet të tij, me termën e së vërtetës dhe të së drejtës, me idealin e shënjtërisë, nuk është aspak i lidhur me të mirat dhe punët e përkohëshme të botës. Në thellësinë e shpirtit të vet ekziston një heqje dorë e madhe, një pamvarësi kundrejt lidhjevet dhe virtytevet të përkohëshme të kësaj bote. Popujt e Perëndimit, pikërisht me anë të virtytevet të tyre, me anë të termave të së mirës dhe të së ligës janë lidhur me të mirat tokësore, me punëra të përkohëshme dhe të kota. Në ndërgjegjen Perëndimore përmbizotëron ideja që e mira dhe virtyri duhet t' i shërbejnë organizimit të jetës tokësore, fitimit të të mirave të dheut. *Nderimi i fuqisë që shihet në këtë botë është karakteristik' e Perëndimit.*

Problemet e Jetës

Qytetërim shpirtnor dhe Qytetërim mekanik

Rreth qytetërimit të shoqërisë shumë herë ndodhin keqkuptime. Ndodhin edhe bisedime dhe çfaqje pikëpamjesh të ndryshme. Është e natyrëshme që të ndodhë kështu, se qytetërimi, si një fenomen shoqënor e politik, është i lidhur me forma të ndryshme të jetës, shpirtnore e lëndore, e prandaj ndjek evolucionin e kësaj jete.

Kur qytetërimi nuk shkon në armoni me jetën e një vendi, kur nuk shvillohet paralelisht me traditat, zakonet dhe kulturën e një populli, atëhere kemi forma të tij të cekëta, që hasin kundërshtime e qortime.

Mund të kemi, f. v., qytetërim të jashtëm, përmirësim të kushteve të jetesës, në veshje e mbathje, në banesa, në ushqim. Por kur nuk e kemi atë shvillim në shkallën e duhur edhe në jetën t' onë shpirtnore, atëhere nga ky qytetërim mund të kemi më shumë të këqija se sa të mira. Një gjë e këtillë ndodh mjerisht në vendin t'onë, ku qytetërimi ka ardhur me valë aq të rëmbjera, sa që populli ka mbetur gadi i mbytur dhe ska ditur ç' të marë e ç' të lërë më parë.

Mos-pajtimi i jetës me format e saja ose të qytetërimit, mos—pajtimi që ka ndodhur midis formave të së drejtës, t' ekonomisë, të politikës e të fesë në përballjen e veprimtarisë së fuqive më të gjalla e më dinamike, si pas kushteve të jetës,

ka shkaktuar në botë, ndër këto vjetët e fundit, një dobësim dhe një paralizim, një farë sëmundje shpirtnore.

Për t' a kupëtuar më mirë këtë themë, duhet bërë një kqyrje dhe analizë e kuptimit të qytetërimit, që është dy formash: qytetërimi shpirtnor ose i brendshëm, dhe qytetërimi mekanik ose i jashtëm.

Qytetërimi shpirtnor ose moral, sipas dijetarëve të shquarë, është ajo form' e jetës, që përmban shfaqjen e drejt-përdrejtë të shpirtit, domethënë mendimin dhe ç' ka mund të dalë prej tij. Spegler-i e përcakton qytetërimin si një organizmë, i cili ka drejtim të caktuar dhe një qëllim: bashkim shpirti, vullneti dhe fitimesh të jetës.

Më qartë, mund t' a përcaktojmë qytetërimin shpirtnor si gjendjen e kuptimit të përbashkët mbi fushën e fesë, të moralit, t' artit, të shkencës dhe të filosofisë, që u-krijua në një shoqëri të caktuarë njerzish, të lidhur ndërmjet tyre prej gjaku ose sidoqoftë prej fisi etj.

Kur pushon ky përbashkim i kuptimit, për arësye biologjike ose për tjetër arësye, atëhere fiton fryma e artit mekanik dhe dyke dalë më të fortë elementet e emancipuara dhe të bazuara vetëm në logjikën, krijohet ose mbetet ajo gjendje që quhet qytetërim i jashtëm a mekanik, ose thjesht: përparim.

Është provuar se qytetërimi i jashtëm mund të jetë i vetëm, kur se ay shpirtnor ka lidhje kurdoherë edhe me disa shfaqje të qytetërimit të jashtëm. Në kohë kur sundon qytetërimi moral, qytetërimi i jashtëm i nënshtrohet gjithënjë vullnetit t' atij të brendshëm ose shpirtnor.

Qytetërimi moral-shpirtnor mund të karakterizohet si sintezë e shpirtit dhe e mendjes, e natyrës dhe e lirisë. Dhe qëllimi i tij është të përpiqet të bashkoj shkencën, artin, moralin, fenë, familjen e të tjera në një terësi për t' ariatur një qëllim të përbashkët.

Prandaj, mund të quhet me të vërtetë i qytetëruar përbrenda dhe i shvilluar moralisht, vetëm ay njeri i cili ka vetëdijen se, nga njera anë është krijesë e dy botrave, q' i ka përbrenda, dhe nga ana tjetër, që është edhe krijonjës i atyre botrave, mbassi merr pjesë në gjithësinë. Nga kjo kuptohet se qytetërimi shpirtnor ka karakter fetar. Qytetërim shpirtnor pa fé

nuk ka. Dhe mejtimi i thelluar e ka pranuar kurdoherë lidhjen midis qytetërimit të brendshëm dhe fesë. Atje ku janë shteruar burimet e vërteta të fesë, qytetërimi e ka humbur vlerën dhe esencën e tij të vërtetë.

Prandaj, për t' arritur forma qytetërimi shpirtnor të vërtetë, për t' arritur qëllime ideale, duhen pastruar shpirtat e njerëzve. E këtu e ka fjalën kryesisht edukata. Kjo s' duhet të mjaftohet vetëm dyke dhëmë disa njoftime, por të ketë sidomos për qëllim që të japë edukatë dhe kulturë përgjithësisht.

Çdo reformë e vërtetë-politike ose kultorore, duhet të fillojë nga njeriu. Ay që ka ambicjen të krijojë një formë të re jete, e gjendje të re, duhet të gatujë më parë njerinë. Tipi ideal i njeriut është ay që, pasi i shërben rrethit të «egó-së» dhe e shton veprimtarinë me anën e vullnetit, kërkon të lartësohet ndaj kuptimin e Hyjnisë. Me anën e veprimit krijonjës, dyke ushqyer ndjenjën fetare dhe dyke marrë kuptim të botës, i afrohet mbretëris së Zotit. Një njeri i tillë që respekton veten, me anën e ndjenjës fetarë e forcon lirin' e shpirtit të tij e lartësohet moralisht.

Mund të presim diçka vetëm nga ay njeri, i cili rron e vepron, jo sepse pret këtu ose në botën tjetër nonjë shpërblim, por sepse e quan veprën morale si qëllim final. Vetëm njeriu i moralshëm është krijonjës. Sepse vetëm me anën e moralit na jepet aftësija që t' i japim kuptim botës e kështu e përsosim atë.

Pra, që të dalë një brez i ri me një qytetërim shpirtnor të vërtetë-siq u-tha më sipër-duhet të punojmë për një tip njeriu me shpirt dhe mëndje të shëndetshme dhe fisnike. Dhe ky tip njeriu mund të gatujë një shoqëri të lumtur dhe një qytetërim të vërtetë, plot me moral dhe me idera të larta e shtytëse për vepra të mëdha.

V. Xhaçka

Monastiret kryesorë të Dhioqezës së Beratit

II.

3. *Monastiri i Shën Kozmait.* — Kyj Monastir i Shënjtë në emërin e Dëshmorit të Ri dhe Isapostolit Kozmait gjendet në katundin Kolkondas të Myzeqes së Vogël, në bregun e majtë të Semanit.

Shën Kozmai lindi më 1714 në katundin Mega Dhendhron të Etolis, në Greqi. Emeri i tij i pagëzimit ka qënë Kostë. Te të vjeç u-dërgua në Sigdhicë të Parnasidhës, ku ndenji për dhjetë vjetë rresht pranë hierodhidhaskalit Lyçika dhe më von shkoi në Malin e Shënjtë (Agjion Oros), ku studioj në shkollën e famshme Athoniadhë. Kur mbaroi, vate në Manastirin e Shënjtë të Filotheut, u-bë murg, duke u-quajtur Kozma dhe më von mori ofiqin e priftërisë. Por jeta monastike monotone nuk i pëlqente Kozmait, sepse donte të zhvillojë veprimtari në dobi të shoqëris. Prandaj e la manastirin dhe shkoi në Stamboll ku, u-takua me të vellan Hrysanthin, mësonjës në shkollën Patriarkale. Me rekomandimet e këtij u-njoft me shumë prelatë dhe me Patrikun Serafim dhe pasi mori leje me shkrim prej Patriarkatit filloi predikimin e Ungjillit më 1760 nga kryeqyteti. Pastaj shkoi në ishujt e Egjeut, Maqedhoni, Thesali, Greqin e Sterës, Ishujt Joniane, duke predikuar pa prerë fjalën e Zotit. Predikimet e Kozmait, me qënë se bëheshin në gjuhën popullore, bëjshin përshtypje të madhe. Populli me mijra degjonte predikonjësën e dashur me gojtari të rallë, i cili vinte fshat më fshat, duke predikuar solidaritetin, shprestarin dhe dashurin për dituri. Zelli i tij për arsim duket nga fakti, që përshkoi 30 krahina dhe themeloi 10 shkolla qytetse e 200 shkolla fillore. Jo vetëm të krishterët, por dhe musulmanët e respektojshin Kozman dhe dëgjonin me verejteje këshillat e tij. Në çdo vënt që predikonte ngulej një kryq i drunjtë, si shënjë e kalimit të tij. Në apostulatin e tij Kozmai shoqërohej nga shumë priftërinj e murgër, të cilët pastaj, si pas shembellës së tij, përhapeshin nëpër katundet, duke predikuar e duke kënduar fjalimet e tij.

Por me qenë se stigmatizonte edhe keq-sjelljet e sundonjësve, beri edhe armiq. Kështu nga ishujt Joniane u-detyrua të ikij më urdhër të sunduesit engles dhe u-hodh në Shqipëri. Me guxim e vetëmohim filloi edhe këtu predikimin dhe arriti në krahinën e Tepelenës, ku gjeti mbrojtje në Sarajin e Hankos, s'emës s'Ali Pashës. Aliu, duke dëgjuar shumë gjëra për Kozman, thuhet se u-takua me 'të në malin e Leklit. Atje Kozmai i dha shumë këshilla Aliut dhe u-përpoq t'a bindij të pajtohet me Leklotët e Hormovitët. Shën-Kozmai i tha Aliut, siç e deklaronte vetë kyj i fundit, se do të hypij lart shpejt dhe do të bëhet njeri i math, gjë që shpjegon nderimet e Aliut kujtimit të shenjtit.

Nga Tepelena Shën Kozmai shkoi në krahinën e Beratit, ku vazhdoi predikimin për të mbajtur të krishterët në fen e tyre. Por çpifje të ndryshme e bindën sundimtarin e atëherëshëm të Beratit Ahmet Kurt Pashën, që të urdherojë kapjen e tij. Ata që muarnë urdhërin e vunë në litar më 24 Gusht 1779, kur qe 65 vjeç.

Panajot Aravantinoi në historin e Ali Pashës thotë, se i ati i tij kish dëgjuar prej Ali Beut, të nipit të Kurt Pashajt, se vrasja e Kozmait u-bë, kundra dëshirës së Kurt Pashajt, kësisoj: Kur mori Pashai raport prej një taksindari (tagrambledhësi), se arka shtetnore dëmtohej, sepse të krishterët e Myzeqes e neveritshin bujqsinë, duke shkuar pas një kallogjeri, urdhenoi t'a bejnë *terbie* shkaktarin e dëmit të arkës, pa i dhenë fjalës kuptimin e vrasjes. Por tagrambledhësi i dha kuptim të gjerë asaj fjale dhe e zuri isapostolin dhe e vrau. Kur Pashai e mori vesh vrasjen, u-zëmërua kaq shumë, sa që urdheroi kapjen e taksindarit dhe desh e vrau, po të mos e kishin shpetuar ndërhyrjet e miqve të tij të fortë pranë Pashait.

Një bashkë-kohës i Shenjtit në jetë-shkrimin greqisht të Kozmait, që është përkthyer shqip prej Kryehirsis së Tij Kryepiskopit të gjithë Shqipëris Imzot Kristofor Kisit, thotë se fama e Shën Kozmait në krahinën e Beratit qe kaq e madhe, sa që sundimtari i Beratit Kurt Pashai dha urdhër që t'i a prezantojnë përpara dhe kaq shumë u-kënaq prej fjalëve të tij, sa që i ndreqi një shkam, të cilin i a veshi me kadife, që të hipte mbi t'ë dhe t'i predikonte popullit së larti. Por Israilitët e shpifën tek

Pashai, duke i dhënë dhe një shumë të madhe të hollash që t'a nxjerin nga jeta. Kurt Pashai u-muarr vesh me hoxhën e vetë dhe vendosi që t'a vriste me anën e ketij. Vrasja u-realizua kësisoj, gjithënjë sipas jetë-shkruësit të sipërpërmendur:

Shën Kozmai kishte zakon kudo që vinte për të predikuar, të mirrte më parë lejen prej Dhespotit të vendit ose prej zëvëndesve të tij; gjithashtu dërgonte të krishterë, të cilët mernin lejen nga qeveritarët e vëndit dhe keshtu bënte fjalimet pa asnjë ndalim. Kur vajti në katundin Kolkondas mori lejen e Dhespotit të vendit. Pastaj duke marrë vesh, se Hoxha i Kurt Pashës, sundimtarit të vendit, banonte aty pranë, i dërgoi një njeri, mori lejen dhe predikoi. Mirpo nuk ishte i kënaqur dhe u-mundua për t'u-siguruar më mirë të vinte vetë te Hoxha. Mori, pra, 4 kallogjerë dhe një prift, si dragoman dhe vajti tek Hoxha. Kyj i thotë, se kishte një letër prej Kurt Pashajt, i cili e urdhëronte që t'i a dergonte Shënjtin në Berat, se gjoja donte të kuvëndonte me 'të. M'anë tjetër porositi njerzit e tij t'a rruanin Shënjtin dhe, njer sa t'a dërgonte te Pashai, të mos t'a linin të dilte nga oborri. Atehere predikuesi i bekuar kuptoi, se do t'a vrisnin dhe lavdëroi Zotin Krisht, që e meritoi të mbaronte udhën e predikimit si deshmor. Pastaj duke u-kthyer murgve që e shoqeronin u-tha fjalët e psalmit: "Shkuam përmes ujit dhe zjarit dhe na nxorre në defrim" dhe tër'atë natë lavdëronte Zotin me psalme, duke mos çfaqur asnjë hidherim, po përkundrazi, kishte fytyrën të qeshur, sikur do të vinte në gëzime e zbavitje.

Kur u-gdhi e muarrë shtatë xhelatë dhe e hipën mbi një kal, gjoja sikur do t'a shpinin te Kurt Pashai. Por kur u-lar-guan nja dy orë e prunë në një vënd, ku shkoute Semani dhe atje, pasi e zbritën nga kali, i rëfyen urdhërin që kishin nga Kurt Pashai që t'a vrisnin. Shën Kozmai e priti me gëzim këtë vendim dhe i u-fal Zotit dhe e lavdëroi, se për dashurin e Tij u-meritua të therorojë jetën, sikunder e kishte dëshiruar kurdoherë shpirti i tij. Pastaj u-ngreh dhe bekoj kryqësisht të katër anët e botës dhe u-lut për të gjithë të krishterët që të rruanin porosit e tij. Xhelatët e prunë afër një peme dhe deshën t'i lithnin duart; por Shenjti nuk i la, duke thënë, se nuk kishte me u kundërshtue dhe i kryqëzoi duart, sikur ishin

lidhur. Pastaj mbështeti kryet e tij n'atë dru dhe barbarët i shkuan litarin në grykë dhe posa që i shtrënguan litarin, shpirti i tij fluturoi në qiell dhe kështu i tërlumuarshmi Kozma, ay njeri kaq i dobishëm, që ishte vërtet stoli në botë u-meritua të marij dy kurora së bashku, si isapostol dhe si deshmor. Xhelatet, passi e xhveshën lipsanën e tij të shenjtë, e hodhën në lumë me një gur të math në grykë.

Kur e muarrën vesh këtë gjë të krishterët, rendën shpejt që t'a nxirnin nga lumi, por sado që e kërkuan me rjeta e mjete të tjera, nuk e gjetën dot. Pas tri ditësh një prift besnik, i quajtur Papa Marko, famulltar i Kishës së Shën Marisë, të katundit Kolkondas, që është pranë lumit, hyri në një lundrezë dhe passi bëri kryqin, u-nis për t' a kërkuar dhe për njëherësh sheh lipsanën e Shenjtit, që po lundronte mbi ujerat dhe po qëndronte e ngritur, sikur ishte e gjallë. Q' atë çast rëndi, e përqafoi dhe e nxori nga ujët. Masandaj e veshi me rason e vetë dhe e pruri në Kishën e Shën Marisë, ku u-varros në Narthikun e asaj Kise, në ditët e Dhespotit të Beratit Ioasaf, i cili ndodhi dhe vetë në varrimin e Shenjtit.

Kurt Pashai u-pendua, se u-gënjeje që për një fitim të kotë shkaktoi vrasjen e një njeriu të qetë e të pafajshëm. Urdhëroi, pra, Hoxhën e tij që kallogjerët e Shenjtit, të cilët ay mbante, t'i linte të lirë të shkonin në Monastirin e Shën Marisë dhe të qëndronin atje. Keta kur vajtën në Monastirin në fjalë, e gjetën Shën Kozman të varrosur. Bashkë me disa prifterinj dhe të krishterë të tjerë e qitën nga varri dhe sado që kishte mbetur tri ditë në lumë nuk kishte as një ndryshim, por dukesh sikur flënte dhe nga gjithë trupi i tij dilte një er'e mirë. Passi, pra, e puthën me përvujtesi, e kallën prap n' atë vënd, ku u-ngrit Kisha e Shenjtë, që nderohet me emerin e tij».

Kisha dhe Monastiri u-ngritën në menyrenë që pason: Kur hyri Ali Pashë Tepelena në Berat, duke ndjekur të vjerin Ibrahim Pashën, i a-kujtuan fjalën, që Shën Kozmai i kish thënë për nderimet e mbëdha që do të mirrte nga Porta e Lartë dhe që do të bëhej njeri i math dhe i dëgjuar në të gjithë botën, që do të pushtonte shumë qytete të Shqipëris dhe të hynte edhe në selin' e Kurt Pashës. Me nje herë, pra, thiri Despotin e Beratit; të nipin e atij që ishte në kohën e Shenjtit dhe e poro-

siti të bënte anakomidhin e Shenjtit dhe të ngrihesh një Monastir mbi emërin e Shën Kozmait.

Pas ca kohë u-bë anakomidhi e lipsanit të Shën Kozmait, kreu i të cilit u-argjëntua me urdhërin e posaçëm të Vezir Ali Pashës. Atehere Aliu dha urdhër që të bëhet një ndihmë e përgjithëshme për të ngritur Kishën e famshme të Shën Kozmait. Kështu, pra, u-ngreh kejo Kishë e Shenjtë që nga themeli më 1813-1814, me ndihmën dhe pas urdhërit të tërë-fuqishmit Ali Pashë Tepelenës, me përkujdesjen e Dhespotit të Beratit Joasaf i II dhe të Kolë Mitro Kapetanit dhe Haxhi Janko Cinxos, të dy nga paria e Beratit.

Këtu poshtë botojmë dy bujurdira të Vezir Ali Pashës, që kanë të bejnë me ngrehien e këtij Monastiri, q'i kemi marrë nga Libri i të ndjerit Mitropolitit të Beratit Anthin Aleksudhit:

1

Prej Lartësis se tij Vezir Ali Pashës tek ju Rum të Nahies së Beratit, Myzeqarë dhe Vllehë Grabovarë, katunde e çifliqe.

Ju bëj të njoftur, se ja tek vura Epitrop, që të më ndreqij Monastirin e Plakut Kozmait dhe ndihmova dhe unë me të holla dhe të ndihmoni dhe ju, si t'ju thotë Dhespoti, me qëllim që të udreqet kyj Monastir. Dhe për atë, që nuk do të japij ndihmë, do të më mbetet hatëri dhe pastaj do t'i paguajnë dyfish.

Si kunder ju urdhëroj kështu të bëni, pas ketij vendimi.
Gjirokastrë më 12 Shtator 1813

2

Aliu

Hair duaxhit e mi Mitropolit i Beratit dhe Kol Mitro dhe Haxhi Janko, ju ngjatjetoj dhe ju kallëzoj, se sa më shkruatë i mora vesh dhe u-bëra vakuf dhe me anën e Igumenit dhe u-gëzuaç shumë që u bëtë mukaet për plakun Kozman. Ja tek po vjen aty Igumëni dhe Nikolla bashkë me kryemjeshtrin dhe të vini të ndreqij odat dhe kullan e Monastirit, që të çquhet nga të gjithë Monastiret, sepse tash me ardhjen t' ime do të vij aty dhe dua t' a gjej të mbaruar. Të përpiqeni, pra të gjithë që t'a ndreqni dhe të gjithë Rumët e Beratit, të mbëdhenj e të vegjël të ndihmojnë.

Po i shkruaj edhe Ibrahim Arapit që t' ju ndihmojë në çdo punë. Të bëni sikundër ju shkruaj dhe ju përshtendes.

Janinë më 12 Shtator 1814

Kështu u-themelua Monastiri dhe kisha e shën Kozmait, madheshtore për ato kohëra, ku nga çdo anë të Shqipëris besnikët vinin për t' u-përhulur përpara Lipsanit të Shenjtë dhe për të nderuar Shenjtin mrekulliberës. Mjerisht mbathjet e Semanit, që shkon atje pranë e çkatëruan kishën e vjetër, e cila u-neverit dhe u-bë e pa-përdorëshme. Pranë saj është ngrehur një kishë tjetër modeste, ku rruhet Lipsani i Shenjtit, që mburon shërime në shpresetarët, që e vizitojnë.

Për t' a mbrojtur nga vershimet e lumit janë bërë sfrate provizore dhe tash von u është rekomanduar epitropve të behet një pendë më e qendrueshme, se është frikë, se mos çkatrohet edhe kisha tjetër si edhe dhomat e Monastirit, që nuk janë në gjëndje të përshtatëshme.

Sidoqoftë edhe sot e vizitojnë këtë Monastir të Hirshëm shumë, sidomos nga qytetet e katundet e Myzeqes. Prandaj duhet bërë që është e mundur, që të meremetiset e të rregullohet në bazë të një plani, pasi edhe dhuratat e shprestarve janë të shumta edhe t' ardhurat jo dhe aq të vogla, duke marrë parasysh çmimin e math të prodhimeve bujqesore. Çdo përpjekje e këshillit Igumencial në këtë drejtim do të gëzojë besnikët e pelegrinët dhe do të gjejë aprovimin e autoriteteve Eprore.

Duke përfunduar themi se kujtimi i Shën Kozmait ka mbetur i gjallë në tërë Shqipërinë e Jugut dhe mrekullit, këshillat e profetit e tij të shkruara ose nga gojë në gojë rruhen në mëndjen e të gjithëve nëpër qytete e katunde, f. v. këjo Kishë apo ajo Shkollë është ngritur në kohën e Sh. Kozmait, i cili tha që do të bëhet këjo e këjo aty. Profitirat dhe këshillat e tij që rruhen në për katundet e Delvinës, Gjirokastrës, Vlorës, Beratit nga shkoj, do t' i përmendim në një artikull të posaçëm hollësisht. Tash urojmë që fytyra e madhe e Sh. Kosmait të qëndrojë e gjallë përpara syve t' ona dhe të na kujtoj karakterin e lartë të Fes dhe parimet e larta për të cilat punoj Shenjti, i cili i vërtetoi dhe me shëmbëllën e tij të bukur dhe sidomos me mbarimin heroik, duke ofruar jetën e vetë si theror në altarin e idealit që ndiqte.

PAN.

Episkop Nikollaj

Njeriut qi ankohet se nuk beson në Perëndinë

Çfar mëkati ke bam qi të të gjejë kjo fatkeqësi mbi gjith fatkeqsinat qi të kan gjet? me prem lidhjen me burimin e jetës dhe dhëruesin e mendjes? me mohuem Ate, qenja e të cilit asht gjithmon ma evidente se qenja e jonë momentale dhe qi vetëm me egzistencën e të cilit mundet me u vërtetue dhe egzistenca e jonë? Perëndija nuk mëçifet prej njeriut. Njeriu mëkatar mëçifet prej Perëndisë; mëçifet dhe mëçifet deri sa t'a humbi fare prej syvet tij. Sikur se asht shkruem për krye-prindënit e njerzvet kur mëkatuen!

«Dhe u mëçef Adhami dhe grueja e tij përpara Perëndisë ndërmjet pemvet në kopësht». Si atëhere ashtu dhe tashti. Kur do qi njeriu ban mëkat të rand ai mëçifet prej Perëndisë mbas shpinës natyrës. Dhe humb ndërmjet krijesavet, humb ndërmjet drujvet dhe kafshëvet, gjua kushurivet vet, fundoset në hijen e natyrës. Dhe si kur se flitet mbi t'errsuemen e diellit kur se hana e mbulon këte mbret të ndritçëm të natyrës, kështu kishim me muejt me folun mbi «errsimin e Perëndisë,» Diellit drejtësisë, nga ana atyneve të cilët me natyrën mëçefën Kriestarin e natyrës. Kjo asht mynyra e të folmes tonë njerzore; sepse e errsuemja e diellit nuk d. m. th. se dielli e humbi dritën e vet, por se ajo dritë asht zanë, për syt t'onë, prej ndo nji gjaje. Gjithashtu dhe e errsuemja e Perëndisë nuk d. m. th. se Perëndija humbi fare dhe se nuk egziston ma, por se ndo nji gja ka qëndrue ndërmjet Perëndisë dhe njeriut dhe e

ka zanë Perëndinë qi të mos duket prej mendjes njeriut. Dhe ajo gja asht mëkati i njeriut.

Nuk ka faj natyra në se atheisti e adhuron. Ajo e gjithë i kundërshtohet mohimit Perëndisë, dhe mohisit e Perëndisë e adhurusit e vet i ka mëni për vdekje. Natyra e gjithë çprej diellit math e deri ke atomi i picërt, me nji za e me nji harmoni, tregon qenjen dhe emfluencën e Kriestarit sajë. Misirasit e vjetër adhurojn të gjitha sendet dhe mbi të gjitha nji ka të zi qi e quejshin apis. Si mbas nji legendë erdhi nji faraon me i bam fli apis-sit. Por kur u përul dhe ju fal si Perëndisë kau i bije me brij dhe e huth tej. — Tashi shof se je ka dhe jo Perëndi!, thërret faraoni i inatosun. Në këte apis-i ju përgjegj: këte dhe dhesha të sho-fish! dhe tashi t' i falesh atij qi më ka krijue mue dhe tyj.

Ti më shkruen zor m'asht me besuem pa pamun! Por me çfar me pam me sy apo me shpirt. Në dëshëron me më pam me syt e trupit, atëhere Ai qi asht ma i math se gjithjsija duhet të zvogëlohet dhe të qëndrojë me të pamen tate të kufizueshme. A e shef ti mendjen tate me sy? Por kishje me u inatosun kur kishte me të than ndo nji se ske mend, për arsye se ai nuk mundet me t' i pam. Në qoft se do me e pam me frym ose me shpirt atëhere mundesh me e pam, sepse fryma e njeriut asht ma e gjan se gjithjsija dhe sepse Perëndija asht frym, Veç se, shpirti jot duhet të jet i pastër sepse të pastërvet i asht premtue se kan me pamun Perëndinë.

Ik sa ma shpejt prej asajë errësine, e cila të asht ende si mirimang në shpirtin t' at. Kur mëkatoj Adhami ai u mëçef prej Perëndisë. Por Kriestari përdyllyes nuk e lã krijesën e Vet, Por ju afrue dhe e thërriti Adhamin: Adham, ku je? Dhe tyj ai të thërret: Petër ku je? Ktheje fytyrën tate nga Drita, o bir i Dritës. Ati i dritës po të thërret me dashuni të flak. Ndëgjo dhe dije: as nji në fisin tat ska adhuruem gja tjetër veç se të madhnueshmin Perëndi.

Paqtim më tyj dhe përdëllim prej Zotit!

Ushtari i Krishtit

Mbi lirin e Jisuit

Koha e jonë do të kalojë edhe na bashkë me të.

Koha e jonë do të kalojë, e ata qi vinë mbas nesh do t' apin gjykimin e veprave t' ona. Hi e pluhun do të bahemi e ky hi e pluhun do t' i mlojë veprat t' ona. Ato qi vinë mbas nesh do t' i zgjojnë prej një harrese veprat t' ona ma të shkëlqyeshmet. Do të gjyrmojnë qytete të mlueme, do të studjojnë faqet e shkrueme ku bahet fjalë për ne. Të gjitha nuk mund t' i dijë, pse të gjitha i din vetëm një Perëndi; ashtu edhe nuk mund të jenë gjykatsa mbi veprat t' ona, pse gjykatsi ma i madhi asht vet Perëndia: por ato vepra, të cillat velen në dukje mbi ta do të flitet e do të shkruhet, tuej prue gjykimin e sajë vetë historija. Vetëm atëhere na përket më tepër gjykimi i Perëndisë se sa ay i njerzve. Ato shka sot asht në rendin e ditës në jetën e ardhshme do të zhduket fare si mos t-ishte. Historija nuk mund ti binë gjykimin e fundit mbi të gjitha veprat t' ona, por edhe si t' ishte, me gjykimin të përjetshëm nuk mund të barazohet. Ay kuptimi i madh—Zoti—krjuesi i kohës dhe i jetës s'amëshuar. Ay asht vetëm i dejë të bajë një gjykim të vërtetë. Koha e ynë asht vetëm një pjesë e jetës s'amshueme; burrimi i jetës nuk shtrret kurr por përhera rrin i freskët. Lisi qi asht mbi këtë burrim jete ndofta do të motnohet, degat e thame era do t'i thej, por burrimi qi rjedh nder rrajtë e këtij lisi do të burrojë pa pra tuej, murmullue kangën e jetës së përjetshme. Të gjitha të shndrohen por burrimi i jetës kurr nuk do të shshtrras. A thue njerzit besojnë se janë një pjesë e asajë jetës s'amshueme tuej e lidhë jetën e kësaj bote me at t'ardhshmen? Një meshtar më tregonte se si ishte një herë i thirrur për të kungue një plak të smuet. — U lutem të Krishtent e mi, një meshtarit mund t' i ndalohet çdo e drejtë por misioni i tij fetar nuk mund t' i ndalohet. Këtu asht fuqija e detyrës së tij. Njeriu nuk mund të bindet kurr se me vdekje asht mbarimi i jetës së tij, vetëm në kte rast logjika e tij e pa gabueshme asht e bindun se feja e jonë asht ma e fortë e ma e fuqishme se çdo shkencë e fillozofi. E më tregonte ky meshtari se

si i smueti, qi donte të rrëfehej e të kungohej, se me sa fuqi shtrëngonte Kryqin me duart e tija tuej e puthun me lot për faqe për mëkatat e bame. Un sot due të ju flas mbi lirin e Jisuit. Ndofta jam largue prej themet? Por Jo! Qëllimi i ardhjes së Jisuit në botë është qi prej kësaj jete t'a përcjellin njerin në jetën e amshueme. Të gjitha pyetjet e përgjigjet e Jisujt janë themeli i jetës s'onë, të cillat bajnë fjalë për të gjith shekujt, për të gjith popujt e smramit dhe prej lirin e tij Hyjnore,

Shpresa në Perëndinë, dashtntija ndaj Të dhe ndaj njerin nuk mund të kuptohen e të plotësohen pa lirin e Jisuit. Kurrnji liri tjetër nuk mund të jenë e qindrueshme dhe objektive vetëm ajo qi na dha vet Shpëtimtari.

«Ungjilli është baza e lirisë».

Nuk ka kristianizëm pa liri as liri pa Krisht. Ato të cillt nuk e kuptojnë se shka është Kristianizma thonë se është religjon i robve. E përkunderata, Kristianizma është rreligjon kundra zgjedhjes fizike, morale dhe shpirtnore. Kristianizma libroj njerin prej frikës së natyrës, dhe t'adhurimit të natyrës. Kur se me anën e derdhjes së gjakut të dëshmorve filloi me ague drita e Kristianizmit në Forum Romanum, qi atëhere njeriu i shitun si një plaçkë filloj të gëzojë lirinë personale. Nji prej të shitunve si rob kje edhe Platoni. Kuer se Kristianizma fillojë të predikojë se të gjith njerzit janë vllazën njani me tjerit si të birtë e Perëndisë dhe në mes të tyne nuk do të thuhet se ato janë Grek ose Ebrej, kuer se theu verigat e robnisë dhe një heri e përgjithmouë kputi zgjelljen qi ekzistonte në mjes të zotnisë dhe të sherbetorit të gjith filluen me e përçafue këte rreligjon mbasi ishte doktrina ma e përshtatun për një liri të pastër e të drejtë. «*Ku është fryma e Perëndisë aty është edhe liria thotë*» Apostoll Pavli. Herojt ma të mëdhajt e historisë janë ata të lirisë shpirtnore. Dëshmort e ramë për Kristianizëm janë kenë njerzt qi kanë gëzue lirin ma të madhe shpirtnore, pse kanë pasë përpara sysh psimet e Jisuit, psimet e Atij qi i pruni botës lirinë ma të madhen. Kur se këto dëshmorë i qitshin përpara bishve t'egra, këta herroj bajshin vdekjen me buzë në gaz tuej i

drejtue lutjet Perëndisë, qi i denjojë t'apin jetën për Të. Kështu edhe mekatartë gjetën shpëtimin tuej ndjek gjymet e këtyne deshmorve të herojit ma të madh të botës, të Shpëtimtarit. Ashtu edhe historia e Kishës Kristiane nuk mund të kuptohej pa një liri. Si mos t'ishite lirija e jetës personale nuk do t'ishite Kisha Kristiane, nuk do t'ishin të drejtë e mëkatarë, nuk do t'ishite ndëshkimi e shpërblimi. Vetë Perëndija ja dha njeriut themën mbi lirin qi na zgjilli me anë të dashtnisë. Perëndia don qi njeriu t'a duen me anën e lirisë, sepse dashtnija pa liri nuk është dashtni. Shpëtimtari na thotë. *«Të duash Zotin Perëndin t'and me gjith zemrën t'ande me gjith shpirtin t'and edhe me gjith mendjen t'ande; Të duash t'afërmin t'and porsì vehtën t'ande».*

Tani po kthehemi përsëri te ay plaku i smuet.

Përqafimi dhe puthja e kryqit, rrfimi i singert dhe prandimi i kungatës së shenjtë, këto janë përshëndetjet ma të mrame të njeriut para vdekjes, kuer don të qahet prej kësajë jete këto janë trokitjet e mrame në portën e përjetëshme..... Të gjitha këto akte bahen vetëm prej një dashtnisë qi kemi ndaj Perëndinë, tuej lypë pastrimin prej mëkatave dhe me anën e kungatës bashkimin me Jisuin Shpëtimtarin t'onë.

Porosia e dytë e nomit na tregon: *«Të duash t'afërmin t'and porsì vehtën t'ande»* edhe një herë pytem ke një kryetar familjet se si i lutej Zotit? Ay pak u hutue, por mbas pak kohe më përgjegji: Nuk dij të thom shumë fjalë por vetëm këto: *Zot nëp mua shika i dëshiroj t'afërmit t'em.* Apos. Pavel në kartat e Gallatianëve Kr. 5, 1 thotë: *“Qëndroni pra në lirit më të cillën na liroj Krishti, dhe mos hyni përsëri ndër zgjedhët e skllavërisë”.*

Sakrifica ma e madhe kje kuer se Jisui kje merthyer në kryq për mëkatat t'ona, por smramit lutej edhe për armiq. *“Falju o Zot pse nuk dinë se shka bajnë. Këtu është kunora e dashtnisë. Por koha e sotshme s'është kurgja tjetër përveç një largim prej Jisuit, një largim prej Doktrinës Hyjnore të tij. Shkrimtari i math Rus Dostojevski në veprën e tij Krimi e Dnimi na shkruen në personën e Ras-*

kolenikovit se si të hangunit e ndërgjegjes e shtynë të lajmojë deliktin kuer vrau plakën me anën e nji spate. Nuk ka robni mâ të madhe se atë të Raskollnikovit qi ra tue u pshtetun me disa mejtime t'a tyne shkrintarëve të cillt largohen prej Jisuit. Edhe këtij djali i mbushet mendja se banë nji vepër të mirë kuer myti at plakën e cilla prante sende me nji faiz të tepërt; Sonja mëkatore i lexon Raskollnikovit nji pjesë t'Ungjillit ku thotë e motra e Lazarit: "*O Zot po t'ishe Ti këtu vllau i jonë nuk do të vdiste*" O Zot po t'ishe Ti bashkë me Raskollnikovin ay nuk do të vriste ndërgjegjën dhe plakën faiztare. Po t'ishe Ti o Zot përhera me njerëz nuk do të ndodhshin krime dhe vet vrasje në këtë shekull. Sot dominon nji mosmareveshje për sa i përket fjalës liri. Kurnji fjalë nuk përdoret ma tepër se fjala liri. Njerzit bajnë fjalë për nji liri politike, liri fjale e shtypi, liri arti, liri shkrimi e tjera e. t. j, por kurkund nuk flitet për lirin e Jisuit me gjith qi fare mirë dihet se kurnji liri nuk është e sigurt sa ajo e shpëtimtarit. Atje ku Jisui nuk nderohet e besohet ndiqet e përbuzet atje nuk ka armoni as liri, por luft e anarki. Njeriu me anën e pagzimit është antarë i lir i Kishës, dhe atje ku në mjes të njerëzve është kjen në kulm shpresa në Zotin, atje edhe vuejtjet durohen ma tepër tue pasë përherë parasysht Flinë e Gollgothasë e smramit Ngjalljen e Shpëtimtarit.

Edhe populli i jonë ndër sa e sa vuejtje gjatë shekujsh mujti me qindrue në lirinë e Jisuit i fortë e i patundëshëm.

Prandaj Kisha e jonë Orthodhokse si bartsia e kësaj liriye i drejton lutjet Zotit të largojë çdo pengesë qi na ndalon të bashkohemi me Shpëtimtarin.

Kisha Orthodhokse i lutet Zotit për të gjith popujt e botës qi të qindrojë në mjes tyne Fryma e Apos. Pavlit ku thotë: "*Qëndroni pra në lirit në të-cilëve na liroj Krishti, dhe mos hyni përsëri në zgjedhët e skllavërisë, sepse ju, o vëllezër u thëriti në liri*" (kar. e Apos. Pavlit mbë Gallatijanët Kreu. 5, 1 dhe 13).

Prof. I. B.

Në vënt të rrëfenjës

ZAKHEU

Mbrëmje e bukur!

Në një palat mermeri në qendrë të Jerihon-it qenë mbledhur kumerqarët e vëndit për të nderuar të parin e tyre.

Palati ish zbukuruar me tërë stolit e bukurit e botës. Rreth tryezës së gëzimit rrinin lloj-lloj të ftuarish me robe të çmuarshme e stolira të ndryshme. Dhe në krye të tyre, mbi një fron të veshur me ar, i zoti i palatit.

Njera pas tjetrës vinin gjellërat e shijëshme dhe pirjet e kërdëshme, të shoqëruara dhe prej fjalimesh të rastit.

Një nga të ftuarit i drejtohet të zotit.

— Je, i thot, më i madhi pasanik i qytetit t' onë të shquar. Zoti të dhënt shëndet.

I dyti shtoi :

— Je njeriu m' i mënçëm i kombit t' onë. Mëndja jote është kandil! Zëmra jote vatrë mirësie! Lavdia jote magjeps botën! Rrofsh e qofsh me nder!

Dhe i treti :

— Të lumërojmë e t' urojmë, se je njeriu m' i lumtur i botës!

Morri pastaj fjalën ay vet e u thotë :

— Miq të mi të dashur! Ju falem-nderit për fjalët e urimet t' uaja të bukura! Vërtet jam i pari pasanik i qytetit t' onë. Vërtet jam aq i lavdëruar sa s' e kisha ëndëruar kurr! Por i vërtet është dhe rrëfimi që do të bëj tani : Me gjith që kam aqë thesar të ditur e të paditur prej jush, me gjith lavdin

e shkëlqimin që gëzoj, jam me gjith këtë i mjer !... Më i mjer dhe se një lypës !....

Të ftuarit habiteshin.

— Mos vuan gjë prej ndonjë sëmundjeje ?

— Jam plak, po i shëndosh sa s' bëhet ! Dhe me gjith këtë, jam m' i mjer dhe se i kromosuri që tretet i gjall.

Ata habiteshin dhe më tepër.

— Mos vall pse s' ke fëmij ? shtoj një tjetër.

— Fëmij s' kam, por kam nipër t' urtë e të denjë. E me gjith këtë s' jam i lumtur ; jam m' i mjeri njeri i botës !...

Të gjithë të ftuarit u-hidhëruan e thanë si me një gojë.

— Ne s' e marrim vesh dot përse-n.

— O njerës të pakuptuarshëm ! Dije-ni se mëndja ime është natë ! Zëmra ime, ferr ! Shpirti im plot me ligësi. Qënëja ime, det mjerimi !...

— Po pse vall ?

Fytyra i u-verth si dylli. Syt i u-skuqën. Buzët i u-vyshkën. Porsa munda të pëshpëritnjë :

— Sepse nuk kam besë.

N' anët e syvet i duallnë lotët. Vështronte me dhimbje ata që i rrinin përqark dhe që hështnin si në kishë. Nguli pas-taj syt në një dritore të madhe q' ishte nga udha, ngaha vinte zëri i ëmbël i një lypësi.

— O miq të mi ; tërë lavdia, tërë pasja dhe shkëlqimi im janë gjëra tepër të vogëla e të pa rëndësishme në krahasim me besën e atij lypësi q' është atje posht. Ngrehu-ni të gjithë në këmbë që të munt t' a shihni më mirë ! Vini re si vë me një anë shkopin, si ri në shkallë, si falet me përulësi e flet me Zotin. Vini re mirë ! Ay, vetëm me trup ndodhet mbi dhe ! Shpirti i tij lundron në dritën e parajsës qiellore ! Shikoni sa i ndrit fytyra prej dritës qiellore ! O, sa e shenjtë, sa e ëmbël, sa ngushëllimtare munt të jetë besa !....

Të ftuarit heshtnin. Syt e tyre thithnin me kënaqësi nga lumtëria e lypësit besatar, gjersa ky zuri vënt përseri për-anë udhës i kënaqur. Atëhere, ay që festonte, shtoj me dhimbje :

— Jam me të vërtet mallkimi i pabesisë !....

Ky rrefim i dhimbshëm i futi dhe ata në mendime e, pas

pakë minutash, iknë të gjithë. Udhës takuan lypësin që mbështetej i qet mbi shkopin e vet.

— Pse shkove nga ajo portë e s' u fute brënda, o plak? i tha njeri nga ata.

— Nuk hyra, shtoj me dhimbje plaku, sepse radhën e kaluar e kam pësuar shumë keq atje. Më kanë ratur ligisht pse guxova të mar një copë bukë nga të derravet!.....

* * *

Zakheu kish mbetur tani vetëm në palatin e vet të stolisur. Kandilabrët lëshonin m' ëmbëlsi dritën e tyre, por smunt t' a shpërndanin errësirën e shpirtit. Qymvalet tingëllonin gasmorisht, po ay i porositi të këndojnë pjesë vajtimi. Vera shkëlqente nëpër kupat, por ay kish kthyer faqen për të mos e parë. Mëndja i qe trazuar dhe zëmra i rihte fort. Në mes të kësaj gjëndjeje shpirtërore pëshpëritte :

— Ç' madhështor jë o pallat i mermert, që mban emrin e Zakheut! Por sa i mjer jam unë që rri në ty e në të gjitha stolit e tua të çmuarshme! Sepse je ndërtuar prej mundimit, prej djersës dhe prej gjakut të të shtypurve që s' kanë mbarim e numur! O, sa njerës me gjëndje të mirë i ka prishur lakmia e natyrës s' ime! O, sa njerës të shëndoshë, i ka sëmurë dëshira ime e panginjur për të holla! O, sa të drejtë ka shtypur e munduar ligësia ime e pashoqe! O, sa njerës i ka kallur në varr para kohe zëmra ime pa pikë meshire e dhëmbje!

Syt e lotuar i vanë mbi gjellërat e tryezavet.

— O panginjësi pa kufi, sa gojë kanë mbetur të urëtuara dhe sa stomahë të zbrazur, për hirin t' ënd! Me ç' dhimbje më kërkonin ndihmë aqë nëna të varfëra për fëmijt e tyre të vdekur nga uri ja dhe unë i dbonja si qenër! Edhe skilevët e sakatët si i ndiqjam nga govatat e derravet!

Hodhi pastaj vështrimin mbi rrobet e veshjet e arta.

— Po për ju o gjëra të tepërta dhe për kotësin e fodullëkut tuaj sa jetimër kam lënë të çveshur dhe sa trupe të dobët i kam bër të ngordhin nga të ftohtët e nga të ngrirët.

Pa më në fund roben që kish veshur mbi të cilën shkelqenin gurë të panumurta xhevairi.

— O qiell, ti s' ke aqë yjë dhe ti det aqë vala, sa janë mekatat e mia të bërë për këta gurë xhevairi ! Jo. Jo.

Kështu zinin mendimet në kokën e tij tërë natën. Pushuan vetëm atëhere kur nisi të zihet dita me natën. Dhe atëhere ra e fleti. Gjumi s' mbajti shumë. E sqoi me të lindurit e diellit një zhurm' e madhe. Dukej sikur ish' bërë ndonjë kryengritje. Dolli te dera të shikojë ç' po ngjiste. Udhës rendnin kalballëk i math. Shumë theshnin :

— Vjen ay që çduk pabesërinë ! Afrohet ay që ngushëllon zëmrat ! Ja ay që ndjen fajet !

Zëmra e Zakheut u- mbush me gëzim, mëndja i u-ndriçua. I zoti i pallatit humbi me një herë përmes fletëve të një mani për t' a parë më mirë atë që vinte. Për të kapur diçka nga fjalët e tij. Diçka që t' i ndihmonte pabesëris së tij mundonjëse. Diçka që t' i sillte shpirtit të tij të turbulluar ngushëllim e qetësi.

Në sy i pasqyrohej drita e shpresës. Por për një moment fytyra i u-vrejt përsëri.

— Kush e di, tha më vet-vete, u jep vall ndjesë dhe kumerqarëvet !

Po ndërsa Zakheu notonte në detin e këtyre mendimeve, Jisuj kish ardhur afër manit e kish qëndruar atje. Një i verbër i qe afruar pran dhe i lutej nga zëmra t' u falte syvet e tij t' errësuar dritën e shumë-dëshiruar.

— Beson, o mik ? e pyeti Jisuj të verbërin me zë të but e tingëllonjës.

— Besoj o Jisu, Bir i Dhavidhit.

— U bëftë te ty pas besës që ke !

Dhe, në minutën kur prej gojës së Jisujt dualinë fjalët e sipërme, i u-hapnë syt të verbërit, i cili nisi me një herë të lavdërojë Perëndin për mrekullin që i bëri me anë të Birit të tij : Jisu Krishtit.

Zakheu i dëgjoj me kujdes të gjitha fjalët, ndërsa me vet-veten pëshpëritte.

— Ç' besë e shenjtë, e çuditëshme dhe e bekuar ! Besoj o Jisu ! Besoj edhe unë ! Beson edhe Zakheu ! Beson edhe kumerqari mekatar !

Jisuj, si e shëroi të verbërin, ngriti kryet për pjet për të

falënderuar Atin e tij qiellor. Dhe, si shikonte lart, syt e tij të but' e të kulluar si vesa e mëngjezit takuan syt e deshpëruara të kumerqarit që ishte fshehur nërmjet gjethevet të manit dhe në pasqyrën e tyre vuri re turbullirën e shpirtit të tij te munduar nga mekatat, vuri re fillimin e pendimit dhe yllberin e besës. I erdhi keq për të, prandaj i tha me mirësi :

— Zakhé, zbrit shpejt q' andej, se sot duhet të vij në shtëpin tënde.

O, me ç' shpejtësi zbriti Zakheu prej manit, me ç' gëzim pritë Atë q' i sillte shpëtimin në shtëpi, me ç' vendim premtoi dhënëjen e gjysmës së pasjes së tij për ndihmën e të varfërve dhe për ndreqjen e të gjitha padrejtësitë që kish bërë !.... Dhe kur iku jisuj, me ç' besë vrapoi ay në tempull që t' i rrëfejë dhe atit Qiellor dhimbjen e pendimin për mekatat që kish bërë. Me ç' përulje dhe thyerje zëmre falej ay, pa marë parasysh përbuzjen që çfaqte për të një farise egoist.

* * *

Kish kaluar një ditë q' ahëre. Dielli po i afrohej perëndimit dhe vishte në ar muret e Jerihonit. Lypësi plak, i mbështetur në shkopin e vet, po kalonte përseri nga porta e pallatit të Zakheut. Ishte i dirsur e i lodhur. Kish nevojë për pakë çplodhje. Po pallati i kumerqarit i a bënte mishin të dridhej. Prandaj po nxitonte të kalojë me shpejtësi q' andej. Mirëpo para portës së hekurtë, e kapi një nga dera.

— Ler-më Zakhé, se nuk hyj ! thiri plaku i tmeruar.

— Mos u-tremb, o plak i mirë.

— Si të mos trembem ? Akoma më dhembin këckat nga të raturat që më bëre radhën e parë.

— Eja se dua t'a nderq gabimin që bëra.

— Ler-më të lutem mos më gënje ! Nuk shikon si më dridhen këmbët nga lodhja ? Ler-më të shkoj.

— Ajde të çplodhesh në qilimat e mi, i tha Zakheu më dashuri.

— Ç' janë këto që thua ? ti s' më ke lënë të flë as në grazhdin e bagëtivet ? A po s' e mban mënt ? Lë-më të fitoj ndonjë copë bukë.

— Ajde, or plak, brënda se të jap unë të hash.

— Ti s' më ke lënë të mar ndonjë cop nga govata e derravejt e tani më thua ajde brënda? Le-më të lutem, se po vjen nata e kam të ftohet.

— Të jap unë robe të reja, shtoj me ëmbëlsi Zakheu, pa fut-u brënda.

— S' po kuptoj dot se ç' ngjet me ty sot o Zakhé, tha plaku, që më jep aqë premtime. Ti s' e ke bërë kurrë këtë punë. Si kështu sot? Mos nuk je në 'të?

Zakheu uli kryet. Dy lotë i dualinë në sy e me dhimbje i përgjigjet lypësit!

— O plak i mirë; tani jam në 'të si duhet; tani e kam gjetur mëndjen dhe e kam kuptuar jetën e vërtetë.

— Po si, o Zakhé?

— Me anën e Jisu Krishtit, Zotit të vërtet.

— O! E kuptova, o kumerqar, çudin e madhë. I bekuar qoft Ay për jetë. Dhe e bekuar qoft shtëpia jote e shpëtuar me mëshirën dhe hirin e tij qiellor.

Dhe i pari i kumerqarëvet priti në shtëpi të tij me dashuri vllazërore lypësin plak.

LAJME KISHTARE

FLETA E PREDIKIMIT.

Me inisiativën e Kr. H. Tij Kryepiskopit t'onë Imzot Kristoforit nisnë të botohen në fletë të posaçme predikimet mbi ungjillin e çdo të Djele. Këto fletë pastaj u dërgohen famulltarëve të qytetevejt e të katundevejt për t'u kënduar në kishë.

Eshtë për t'u lëvduar këjo inisiativë e Kryesis së Kishës sidomos sot, që më tepër se çdo herë tjetër, ndihet nevoja e fjalës së Zotit.

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOÇI

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PERMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT I IV-të

NËNTOR-DHETOR 1943

Nr. 9-10

LANDA: «Kryetar Paqeje....» — Plag' e tmerëshme dhe e paduruarshme — Feja dhe Shkenca — Lufta dhe Morali — Për një program vlefësimi i thesareve të Orthodhoksis Shqipëtare — Themë Filosofike — Ideja Fetare Ruse — Nji vllaj të vogël i cili kërkon nji përallë Krishtlindjesh — Kolendrat — Andrea i paratburrur — Nga Kryeveprat e Gojartit — Nga studimet Fetare — Zëri i shpellës së Vithleem-it — Tri pyetje... — Fjalori i vogël i Dhjatës së Re — Le të përgatitemi për Lindjen e Krishtit — Krisht-lindje me dëborë — Librat e reja fetare për shkollat fillore.

«Kryetar Paqeje.....»

Tetëqind vjet më parë Isaia me gojën e tij profetike trumbetoi dhe paralajmëroi, se Shpëtimtari që do të lindë, do t'ishte *Perëndi i fuqishëm, Perëndi me pushtet të madh dhe kryetar paqeje*” Dhe kur erdhi koha q'u- mbush kjo profeti e lartër, kur Foshnja Hyjnore u-lind prej Virgjëreshës, ushtëria e Engjejvet e këtyre këngëtarëve dhe hymnonjësvet të madhërisë Hyjnore, zbriti me një herë n'orizontin e Bithleem-it, për t'i çpallur botës ngjarjen gazmore, ngjarjen shpëtimtare. Një nga këta atëhere u-

çkëput prej grupit ëngjëllor vrapoi në katundin e bekuar dhe barinjvet të lumtur u ungjillëzoi se “*U lind sot Shpëtimtari, q’është Zoti Krisht*”. Mb’anën tjetër ushtëria qiellore me një ton jashtëzakonisht gazmore me një melodi që s’tregohet dot me fjalë, lajmëroi se foshnja e lindur rishtas është “*paqja mbi dhe*” dhe se u-dërgua prej Atit qiellor, që të sjellë dhe të ngrerë ndërtesën madhështore “*të paqes mbi dhe*”.

* * *

Paqe Oh! me sa zemër të dredhur të kujton bota, sidomos në ditët e sotme! me lote në sy po të kujtojnë njerëzit e shkretë. . . .! me një padurim të jashtëzakonëshëm po presin ditën e bekuar që të të përshëndoshin e të të shijojnë zemrat e zhuritura. . . .! Pleq e të rinj, burra e gra, djem e vajza nga çdo kënd të planetit t’onë të mjeruar e fatkeq ngrehin në qiell or’e çast syt’ e tyre plot me lote dhe i luten “*kryetarit të paqes*” të zbresë edhe një herë për t’u dhënë fund mjerimevet e vuajtjevet të tyre. . . . Mjerë! Është i pesti vit ky që kalon bota me hidhërime, me pësime, me vuajtje: pesë vjet me radhë (terribile dictu!) kryetari i luftës dhe i së ligës me shpatë e me flagë në dorë po tërbon në botë, dyke vrarë e copëtuar, dyke djegur e shkretuar, dyke përvëlur të gjitha, dyke çkatëruar të gjitha! për pesë vjet radhazi u-çduk paqja e ëmbël nga faqja e dheut dhe vëndin e saj e zuri zija dhe lufta pjell’ e tmerëshme e Ferit e të Djallit! Mjerë! është e pesta herë kjo që thëritet bota e krishtere të presë Foshnjën Hyjnore dhe të kremtojë lindjen e Saj Shpëtimtare! Me qindra miliuna njerës po gati-

ten në mes të gërmadhavet e të zisë të kremtojnë Krishtlindjen, këtë kremte t'ëmbël të paqes e të dashurisë!

Me sy plot me lotë, me rënkime e me zemër të hidhëruar e të pikëlluar po shohin jo “paqe mbi dhe” po luftë, çkatërim e prishje.

* * *

Le të pushojnë kritikak dhe ankimet pesimistët dhe njerëzit e “mendimit të lirë” dhe “sociologët modernë”. Le të pushojnë së derdhuri lote krokodili, dyke thënë me një dhëmbje ipokritike: «Ku është pra paqja mbi dhe? Ku shkoi premtimi, që dha Krishti dhe Krishterimi, se do të mbretërojë paqja mbi dhe?» Janë akuzime këto të pa arësyeshme dhe ankime krejt të pa themelta. Le të shohim! E ka kërkuar ndonjë herë bota me gjithë zemër paqen e vërtetë, paqen e Krishtit dhe ky i fundit i a mohoi? Kur kanë dashur popujt e qytetëruar (sic) të regullojnë marëdhënjet në mes të tyre si pas frymës së doktrinës së Krishtit, e ky s'ka dëgjuar të na japë? E dëshiruan me gjithë zemër ndonjë herë paqen e Krishtit si kryetarët e drejtonjësit e shteteve, ashtu dhe popujt vetë? Mjerisht! as të parët nuk kanë patur themel e mbështetje të shëndoshë në kërkimin e paqes, as të dytët.

Drejtonjësit e fatevet të popujvet kujtuan se dhurata hyjnore e paqes është krijesë ligjesh e marëveshesh njerëzore dhe se mund të sigurohet kjo me anë kongresesh e bisedimesh. Pa u-frymëzuar ata vetë nga fryma e paqes së vërtetë e të kthjelltë—siç është ajo e Krishtit—, u-munduan të kri-

jojnë në botë paqe! Pa u-hërë vegla të “kryetarit të paqes” të vetëmit paqebërës e paqepurës, kujtuan se mund të bëhen themelonjësit e paqes midis popujvet; E larguan Krishtin nga bisedimet: ranë jashtë; ç’gjë m’e arsyeshme dhe m’e natyrëshme?

Po edhe popujt në shumicën më të madhe nuk e kanë dëshëruar paqen e vërtetë të Krishtit. Quhen të krishterë, po qëndrojnë të pa prekur në shpirt fellë prej Krishtit e prej paqes së Tij. Muarnë emrin e Tij, po në jetën e në veprimet e tyre kanë mbetur, mund të thomi, idololatrë. Prandaj edhe paqja që kërkojnë, nuk është paqja e Krishtit, po paqja e botës, siç e quajti Shpëtimtari. Shijimi d.m.th. i lirë i të miravet të kësaj bote dhe liria e pa fre për të jetuar të zhytur në mëkatë. Një paqe e këtillë lind fatalisht e çvillon ligësinë; ushqen armiqësitë, urejtjet, egoizmet dhe ndarjet; u shërben interesave të çfrytëzohësve të urejtjes e të «tregëtarëvet të vdekjes»; përsërit herë pas herë luftërat e çkatërimet....

Gjendemi pra për fat të keq përpara një bote që kërkon paqen, po nuk do që të lidhë marrëdhënie të ngushta me Atë që dhuron paqen e vërtetë. Përpara një bote që largon nga jeta kryetarin e paqes!

* * *

Po cila është vallë paqja, që paralajmëroi ushtëria qiellore e engjëjvet? cila është paqja e vërtetë? Është ajo e kryetarit të paqes; është ajo e Krishtit. “Paqen t’ime po ju a fal, jo si atë të botës” tha Shpëtimtari, kurgatitej të bënte mbi kryqin therorën e madhe të paqes. *Paqja e Krishtit*: d.m.th. largim nga udha e mëkates dhe kthimi në Perëndia. Duam paqe të vërtetë?

Le të mohojmë pasionet dhe instiktet e liga, që na kanë pushtuar shpirtin; le të luftojmë me tërë fuqit t'ona ambicjen, lakminë dhe sidomos egoizmen, që na shtyn t'urejmë tjetrin e t'a shtypim. Le të këthehemi pastaj nga Krishti dhe le të kërkojmë ndihmën e Tij në luftën t'onë kundër mëkatës. Sigurisht atëhere do të korim një fitore të madhe, një fitore që ka për të na sjellë pastrim të shpirtit, qetësi të brendëshme dhe paqe të vërtetë. Se mekata është ajo që shkakëton tërë të ligat në botë. Ajo na ndan e na largon nga Perëndija, ajo na kall urejtjen kundër njerëzvet të tjerë, ajo na mbush me lakmin' e me dëshira e qëllime egoistike, që përfundojnë shpesh herë në luft' e në kërlshje. O ju, që kërkon paqen! nuk mund t'a gjeni këtë të sigurtë e të përherëshme, po të mos e pastroni më parë shpirtin t'uaj nga mëkata e nga ligësija. Mekatari uren të afërmin e tij, familjen e tij, bashkëqytetarët e tij dhe më në fund edhe botën e tërë; urejtja sjell zënje dhe grindje dhe këto lindin luftërat e çkatërimet. Çdukeni pra mekatin nga shpirti t'uaj, adoptoni frymën shpëtimtare të Krishtit, kryetarit të paqes, kallenit fellë në shpirt dashurinë kundrejt të gjithëve, e atëhere-besomëni-do të mbretërojë sigurisht paqja e vërtetë, jo vetëm brenda në shpirtin dhe në ndërgjegjen t'uaj, po dhe në marrëdhënjet t'uaja me njerëzit e tjerë, gjë kjo që ka për të siguruar paqen e vërtetë në këtë botë.

*
* * *

S'ka dyshim se paqja e Krishtit do të përhapet e do të mbulojë një ditë tërë botën. Duhet të jemi

plotësisht të bindur, se kjo paqe do të jetë trashëgimi i përgjithshëm i botës. Prandaj pra lark nesh ankimet e kritikave, lark pesimizma, melankolia dhe hidhërimi, me të cilin shumë njerës do t'a presin e do t'a kremtojnë kremten Shpëtimtare të Krishtlindjes. Në vënt të rënkimevet e të psherëtitjevet le të ndjekim këtë rrugë: Të drejtojmë mendjen dhe zemrën t'onë nga hymni ëngjëllor, që na fton të shërbejmë e të vihemi nënë sundimin e "Kryetarit të paqes": të kthehemi pa vonesë në Perëndia dhe me anën e Krishtit të fillojmë me Atë marëdhënje të frymëzuara prej paqes. Dhe atëhere le të bëhemi gati t'a presim paqen e vërtetë, e cila do të mbretërojë në jetë të jetave jo vetëm midis personave, po edhe midis kombevet e popujvet të botës së tërë.

Shpresëtari.

MENDIME T'ARTA

Virtyti na porositi që të tregojmë respekt dhe kundrejt robës së lypsit.

* * *

Gjer sa ndodhemi në këtë jetë, është e pamundur të shpëtojmë krejt nga ngasjet; se pse, si kundër thotë Job-i i drejtë dhe i shumë vojturi, jeta e njeriut në këtë botë është plot me ngasje.

* * *

Trim dhe shpirt-madh nuk është ay që ndizet e zëmërohet kundër atyre që shajnë dhe që dëmtojnë, po kundër ay që qëndron i paturbulluar e i qetë dhe që ka fuqinë t'a çpërblejë të keqen me të mirën.

Plag' e tmerëshme dhe e paduruarshme

Plag' e tmerëshme për një komb është dhe lufta. Plag' e t'la shkakëton gjak-derdhje dhe dobësim të plot. Nuk prish vetëm fuqit ekonomike të kombevet, dyke përdorur t'ardhurat e tyre për pushkë, municijone dhe mjete të tjerë, qëllimi i vetëm të cilëvevet është vrasja dhe çkatërimi. Nuk lith vetëm aqe dur, të cilat, në vënt që të merren me vepra prodhimore e paësore, detyrohen të mbajnë dit' e natë pushkat për të drejtuar t'arin dhe hekurin kundër anës kundërshtarë. Nuk ekspozon vetëm tokën e atdheut në rrezik të shkelet e të shkretohet prej rrmiqvet në rast se këta fitojnë. Por dhe sakrifikon në fushat betejavet vërsat më të mira, lulen e rinis, pjesën më të shënoshë të shoqërisë. Dhe vadit tokën me gjak boll, gjak jo pleësh, por të rinjsh, gjak i cili, në shumë raste munt të themi se derdhet padrejtësisht.

Aqë shtëpi mbyllen e aqë familje mbeten pa përkrahje e qe gra në moshën më të re mbuloen me velon e zis plot helve. Aqë fëmij humbasin prindin e tyre pa arirë t'a njohin, aqë prindër humbasin fëmijt e tyre, shumë nga të cilët i kanë të vetëm dhe që përbëjnë të vetmin ngushëllim për nënën e ngushëlluar dhe për atin e mjeruar!

Vërtet; dhëmbje e prov' e tmerëshme, plag' e kamxhik i paduruarshme katandis lufta. E me gjith këtë, këjo plagë ipesh herë bëhet shkop shpëtim-sjellës. O! po. Cili don që t'i oditen krahët me shkop të rënd e të trashë. Cili s' e quan për fjerim të bie në duart të kamxhik-mbajtësve, të cilët me kamxhiqet e tyre t'i a bëjnë lëkurën krejt të zezë? Shum më tër pra lufta, sidomos kur bëhet për qëllime pushtimi, bëhet shkop e kamxhik i ashpër që bie në kurrin jo vetëm të njëre dy, por të të gjithë popujvet.

Po si të bëhet? Deri sa në kombet zotëron paligjësia, deri sa qeverit rregullojnë dëshirat e qellimet e tyre më tepër në bazë t'interesit se sa të së drejtës; deri sa fryma e vllëzërimit të popujvet ndiqet se gjoja shkakëton trathëti kombëtare dhe çdo komb vë si ideal pushtimin, në është e mundur, të të gjithë botës dhe përpirjen e çdo kombësije tjetër; deri sa. nuk e kupton, që si pasoj' e domosdoshme e të gjith këtyre shkaqeve të dëmëshme do të vijë lufta?

Esht me fjalë të tjera një dënim. Dënim i rëndë. Dënim i cili na mundon për të kaluarën e na urtëson për t'arthmen. Kamxhik në kuris të kalit—siç thot i dituri Solomon në Fjalët e urta—i cili e lajmëron se fle dhe se duhet të sqohet. Thumb në kuris të gomarit, që e detyron të bëhet m'i gjall dhe të shpejtojë ecjen e tij të ngadalëshme. . .

Vërtet; Shtëpit e mbuluara në të zeza, zëmrat e helmatisura, kujtimi i vuajtjevet dhe i mungesavet gjat luftës, varret e heshtur por që tregojnë shumë gjëra t'ushtarëvet, invalidët e luftës, dëmet e shumtë dhe prishjet e ndryshme sjellin më në fund dhe një urtësim. Dhe deri sa nuk harrohen, plasja e një tjetër lufte s'është dhe aq' e lehtë. Detyrojnë qeverit të vijnë në marëveshje dhe të diskutojnë divergjencat me frymë paqësore. Kështu bëhen — mjerisht pak me vonesë — hapat e duhura që do t'i drejtojnë popujt në vllëzërim të plotë dhe do të lurojnë krejtësisht rastin e plasjes së ndonjë lufte tjetër.

O, po shum' e ëmbël do të jet' ajo ditë këndonjës i dashur. Një nga ditët më gasmore të njerëzisë. Po më përpara duhet të çduket paligjësia. Mjerisht! Lufta është shkop. Dhe deri sa do të ketë kombe të paligjët, kombe që s'respektojnë të drejtën, shkopi është i domosdoshëm për t'i urtësuar.

MENDIME T'ARTA

Dobija më e madhe e m'e vlefshme, që mund t'i sjellim t'afërimit t'onë, është kjo: t'a sjellim në gjëndje që të mësojë dhe të njohë të vërtetën, kjo është doktrina e Krishtëritimit; Ky është qëllimi i tij i fundit.

Feja dhe Shkenca

Problemi i lindjes së njeriut

V.

«Atë që bën njeriu me zgjedhjen artificiale, këtë bën dhe natyra me zgjedhjen natyrale»-Arësyetim e syllogjizm' i guximshëm dhe përfundim i gabuar-As kush dhe n' as një kohë s' është parë no një veprim i këtillë i natyrës-Çdo të thomi për një monument të vjetër-Dora e njeriut dhe mendja e ka bërë këtë - S'kemi as një fakt që të na bind, se edhe natyra mund të bëjë vepra të tilla-Edhe një tjetër arësyetim i gabuar-Në se natyra bën atë që bën njeriun, vetëm katër llojë krijesesh të gjalla duhej të kishim në tokën t' onë!

Si kundër pamë n' artikullin tjetër, Darvini me shokët u-munduan t' a mbështetin dhe t' a fuqizojnë theori-në e tyre, dyke bërë këtë arësyetim : «Ate që bën njeriu me anën e zgjedhjes artificiale, këtë e ka bërë natyra gjatë shekujvet me anën e zgjedhjes natyrale». Po këtu tashi çdo njeri që ka mësuar elementet e logjikës ka të drejtë të bëjë këto pyetje : Në se njeriu me mjete artificiale mund të prodhojë trajta të ndryshme të një lloji, del vallë si përfundim i nevojshëm se edhe natyra me anën e zgjedhjes natyrale i arin këtij qëllimi? Gjer sa s' kemi fakte e njarje të vërteta që të vërtetojnë një veprim të këtillë të natyrës, kush na dind që të besojmë se atë që bën njeriu me mendjen e tij dhe atë që e shohim me sy, të pranojmë

pra, se po këte ka bërë edhe natyra, dyke vepruar verbërisht e në një mënyrë të pa kuptuarshme, mbasi ky veprim kështu as nuk është parë no një herë, as nuk shihet? Le t' a çvillojmë pak më qartë këte pyetje dhe këte kundërshtim.

Shpesh herë njeriu, dyke zbatuar mjetet e çpikur prej tij, ose dyke ndjekur methudha që krijoi ay vetë me ndihmën e shkencës e të provës, ka mundur të nxjerë përfundime dhe të bëjë vepra, të cilat natyra n' asnjë mënyrë as nuk i ka bërë, as nuk i bën dot. Zer-e p.sh. se ndodhemi përpara një faltoreje ose nonjë monumenti tjetër shumë të vjetër dhe se nuk dimë historinë si edhe kohën e ndërtimeve të tij; pa dyshim do të thomi me një herë, se kjo ndërtesë është vepër e dorës dhe të mendjes së njeriut. Në se tashi na thotë dikush, se edhe natyra vetë gjatë shumë shekujvet mund t' a ketë bërë këte monument, dyke i bashkuar dal nga dalë atomet e lëndës, në se pra na thotë këtë, neve me një herë do t' a hedhim posht këtë pretendim dhe do të thomi me të drejtë të plotë: «Me sa mbahet mend e nga kohët më të vjetra, dora e mendja e njeriut është ajo që ka bërë të këtilla monumente, kurse as njeri s' e ka parë nonjë herë natyrën të ndërtojë ajo vetë të këtilla vepra». Është e vërtetë se njeriu me anën e zgjedhjes artificiale ka arirë të ndryshojë trajtën dhe cilësitë e kafshëve; po a mund vallë edhe natyra t' a bëjë këtë me zgjedhjen naturale dhe të nxjerë një lloj nga një tjetër? Ja një gjë që s'e kemi parë kurrë: dhe pasonjësit e Darwin-it nuk mundin të na tregojnë as një rast të këtillë d.m.th. të na provojnë se natyra, dyke vepruar me anën e zgjedhjes natyrale-si kundër vepron njeriu me zgjedhjen artificiale-ka mundur të prodhojë nga një lloj kafshësh, një lloj tjetër. Kështu pra hipoteza që bëjnë Darwinistët, gjersa këta nuk janë në gjëndje të na paraqitin nonjë ngjarje të vërtetë, nuk mund të ketë as një mbështetje logjike dhe bje vet-vetiu.

Po le të bashkohemi me kundërshtarët e le të pranojmë për një çast, se edhe natyra ka mundur gjatë shekujvet të bëjë atë që bën njeriu me mjete artificiale. E pra edhe në këtë rast teorija e çvillimit nuk fuqizohet as

pak e përsëri nuk mund të qëndrojë më këmbë dhe ja se pse: sikundër u-tha dhe më sipër, njeriu me një zgjedhje e një bashkim të posaçëm mundi të sjellë ndryshime të mëdha në disa llojë kafshësh shtëpijake, dyke nxjerë kështu 150 pullumba të ndryshme, 180 qenjë e.t.j. d.m.th. veprimi i ujeriut kufizohet këtu: ndërron trajtat e cilësit' e pullumbavet dhe të qenjvet, po nuk ka mundur n' as një mënyrë të nxjerë një lloj prej një tjatri p.sh. shpeshë prej peshqësh, dele prej qesh, ose lepura prej qenjsh. Kur pra puna qëndron kështu dhe, si pas mendimit të disa darvinistëve, natyra vepron pikërisht si njeriu, duhet të pranojmë se edhe natyra nuk mund të prodhojë një lloj prej një tjetër, po vetëm trajta të ndryshme po t' alij lloji. Mirëpo, si mbas theorisë së Darwin-it, natyra me anën e zgjedhjes natyrale ka mundur të krijojë jo vetëm ndryshime kafshësh të një lloji—si kundër bën njeriu me zgjedhjen natyrale/po dhe tërë llojet e bimëvevet e të kafshëvevet që ndodhen në tokë i nxjer nga katër llojë ose nga një protoplazmë të vetëm. Kështu pra veprimi i natyrës është në kundërshtim të plotë me atë të njeriut, e pra edhe hipoteza që bëjnë se natyra ka vepruar si njeriu, rëzohet krejt prej pretendimevet të tyre. Ose pra natyra me zgjedhjen natyrale vepron eshë siç vepron njeriu me zgjedhjen artificiale, dhe atëhere në tokën t' onë nuk duhej të kishim më shumë se katër llojë krijesash të gjalla; ose duhet të pranojmë se pretendimet mbi veprimin të njëllojshëm të natyrës me atë të njeriut janë krejt të pa arësyeshme dhe të pa themelta.

Se si një lloj nuk mund të dalë prej një tjatri (ligji i pandryshmënisë) këtë kemi për t' a parë në një artikull tjetër.

Shpresëtar

Lufta dhe Morali

Morali, Kisha dhe lufta

Nga sa u-theksua n' artikullin «Lufta dhe Dhjata e Re» (shih Jeta Kristiane nr. 5—6 k.v. faqe 135), Shpëtimtari për sa i përket luftës s' ka dhënë asnjë porosi ose mësim të posaçmë. Po kështu dhe Apostojt e Shenjtë. Si duket lufta atëhere s' ka qenë një problem që kërkonte zgjidhje të shpejtë. Mirëpo këjo s' do të thotë që lufta nuk është një problem, bile me rëndësi, për moralin e krishter e, si pasojë, dhe për kishën. Shpëtimtari pati mjaft luftime me farisenjt dhe e ka thënë fjalën për shumë probleme. Por s' ka përpunuar asnjë moral sistematik e kazuistik, prej të cilit të munt të shpjegojmë moralitetin ose imoralitetin e të gjitha veprave konkrete nga jeta e individëve dhe e popujvet.

Në rastin t' onë, duke marr parasysh se në Dhjatën e Re flitet tepër shumë për paqën dhe theksohet me insistim si nga ana e Shpëtimtarit, ashtu edhe t' Apostojvet nevoja e sajë, neve munt të kuptojmë lehtë, që lufta s' është aspak e dëshiruar, bile duhet që me sa të jet' e mundur të evitohet, si një nga të këqijat më të tmerëshme.

Edhe morali i krishter pra për sa i përket luftës nuk pranon me asnjë mënyrë hak-marrje me vrasje. Por deri sa ay lejon mbrojtjen e ligjshme, bile dhe e imponon si një detyrë, atëhere, si pasojë, lejon dhe luftën mbrojtëse.

Gjithashtu edhe Kisha e jonë. E bazuar ajo në parimin e mësipërmë të Moralit të Krishter si edhe në qën-

drimin e Shpëtimtarit dhe t' Apostojvet, në parim është kundër luftës. Por deri sa edhe ajo, për mbajtjen e armonis e të rregullit në shoqërin njerëzore njih dhe pranon si të nevojëshme shtetin dhe ushtërin—e për këtë do të flasin ndonjë herë tjetër—nuk është në mënyrë absolute kundër luftës. Fakti pastaj që ajo nuk e dënon luftën që është çpallur në bazë të së drejtës, do të thot se e lejon. Dhe luftë e çpallur në bazë të së drejtës, është lufta mbrojtëse ose defensive ose kundër-lufta, duke u-kuptuar me këtë në disa raste dhe lufta në favor të një shfeti tjetër mik, i cili atakohet e shtypet padrejhtësisht. Në teori pra kështu qëndron puna. Kisha domethënë pranon vetëm luftën mbrojtëse. Mirëpo në praktikë puna ndryshon. Sepse është shumë zor të dallosh një luftë mbrojtëse nga një luftë sulmuese. Të gjitha luftërat, ndonëse në teori janë të padëshiruarshme, në praktikë paraqiten si mbrojtëse ose defensive, gjejnë domethënë një justifikim, bazohen gjoja në një parim drejtësisje, quhen shkurt si një detyrë.

Kështu që, para një lufte, të nisur bile dhe prej vet shtetit të sajë, Kisha qëndron si para një dilemi të math. Mirëpo ajo ka me shtetin marrëdhënëje të përbashkëta shërbimesh dhe detyrimesh. Kur shteti pra është ngatëruar në një luftë, Kisha, e mbështetur n' urtësin e udhëheqësve të shtetit, e konsideron atë luftë si defensive, t' arësytuar dhe të lejuar nga pikëpamja morale. Vetëm në rast se Kisha është e bindur plotësisht në bazë dokumentash që udhëheqësit e shtetit në veprimet e tyre luftarake nuk mbështeten në parimet e moralit të Krishter, nuk i jep shtetit asnjë përkrahje morale. Por që të mbajë Kisha një qëndrim të përgjiibmonëshme kundër luftës, këjo do të thotë që në disa raste ajo të caktojë vet për veten e sajë dënimin me vdekje duke mekatuar në këtë rast rënd dhe kundër Atij që e bëri një institut historik, shoqëror dhe shenjtëronjës gjer në mbarim të jetës. Ajo pra e ka për detyrë të jetë brënda historisë (kohës) dhe në shoqëri (vëllim).

Prandaj në këtë çështje Kisha duhet të veprojë me urtësi e të ketë gjithmon parasysh qëllimin në t' arthmen

si institut historik, shoqëror, shenjtëronjës dhe shpëtimtar. Me gjith këtë ajo në përgjithësi luftën duhet t' a lejojë si *ultima ratio*.

Por ndërkaq, nuk duhet të harojë Kisha dhe misionin e sajë kryesor në favor të paqës. Duke shkuar pas gjyrmavët të Themelonjësit të sajë hyjnor, të Apostojvet të shenjtë dhe të Atërve të mëdhenj, duhet të përdornjë të gjithë mjetet që ka në dispozicion për të zbutur e për t' evituar egërsirën gjak-pirëse të luftës. Dhe këtë mund t' a bëjë duke e edukuar njeriun në mënyrë që ay të bëhet më i mirë, më shpirtëror dhe duke i ngritur ndërgjegjen gjer në shkallën e një ndërgjegjeje umane, e cila të përfshijë jo vetëm dashurin për njerin më t' afërmë por për njërëzin e tërë. Vetëm kështu lufta do të bëhet nga-dale po sigurisht, një rrëfenj' e thjesht' e së kaluarës, dhe në vënt të ministrive të luftës, do të formohen ministrin e paqës, sepse, siç dihet, për të evituar një luftë duhet ndaluar përgatitja e sajë dhe këjo do të thotë organizim të paqës.

Duke e përfunduar këtë studim i dashur këndonjës, me të cilin s' kam patur pretendimin t' i japë një zgjidhje të plotë problemit «Lufta dhe Morali» por vetëm sa t' a shtroj për rahje nga ana e të tjerëvet që munt të jenë më kompetentë, po theksoj që, nëse për moralin e krishter lufta paraqitet theoritikisht, një problem i zgjidhur se ajo është një e keqe dhe si e tillë e denuarshme nga pikëpamja morale, për Kishën, në praktikë, lufta mbetet përgjithënjë një problem dhe ndoshta problemi m' i rënd. Dhe me që luftërat pasojnë po thuaj n' intervale të shkurtër njera tjetrën, ky problem mbetet gjithënjë aktual edhe urgjent.

B.

Për një program vleftësimi

i thesareve të Orthodhoksis Shqipëtare

Qënia e qëndrimi afron dymijë vjeçar i Orthodhoksis shqipëtare, me gjith sulmet e valët e rrepta që kanë kaluar në këto vise, ka prodhuar vepra spirituale të paçmuara.

Sintheza e këtyre është, kryepari, vetë jeta dhe fryma orthodhokse, me atë urlësin e saj pa shoqe ("Isofia") e cila mburon nga Ungjilli i shenjtë e nga jeta model e Shenjtorëve dhe martirëve t'anë.

Si rezultatë e këtij asimilimi të Fjalës e cila është faktori zotëronjës i Orthodhoksis, ky element paqe-dashës jep një përqindje të ultë fort në kriminalitet e shkelës të ligjit dhe një përqindje të naltë e elementash ndërtonjëse, në gjithë degat.

Orthodhoksija ka qënë e është, në gjith atë kohë, një mburim i pa shterar prodhimesh vepra arti, që nga ndërtesa e gurtë e manastireve edhe kishave e gjer ne kënga popullore.

Shumica e madhe e këtyre veprave, prodhim i shekujve dhe i spiritualitetit orthodhoks, kanë mbetur gjer më sot të pa vleftësuara si duhen.

Po kjo nuk do të thotë se nuk janë e nuk vazhdojnë të jenë.

Për një fillim të vleftësimi të tyre mer barrën t'a kryejë sot revista e jonë.

Ftojmë gjith besnikët t'anë edhe veçanërisht klerin e gjithë Shqipërisë, për mbledhjen e lëndës që përbën një pjesë të shprehjes të frymës Orthodhokse.

Një program minimal për kryemjen e kësaj vepre mund të përmblihet në këto që vijon:

1) Përshkrimi i vëndeve të shejtë, ku ka patur ose ku ka: kisha, manastire, ujra të shejta (ajazma), mbi sa dijet

gojë mbas goje mbi ngrehjen e tyre e mbi ata që i kanë ngrehur, mrekullitë e kryeme, etj.

2) Përshkrimi i veprave artistike të këtyre viseve të shejta (afreska, kora, koperta librash, etj.)

3) Gjojdhana e rrëfime në lidhje me shenjtoret e me viset e shenjta.

4) Mbledhja e kondikeve dhe e shkrimeve të lindura prej frymës Orthodhokse.

5) Mbledhja e folklorit me karakter Orthodhoks (këngë kolendrashi, këngë Pashke, këngë Llazore, etj.) Mos harrojmë se një nga më të zgjedhurat e më të vlefshmet vepra të shpirtit shqiptar vallja popullore "besa që i dha s'emës" ose "Kostandin vogëlthi" që e kanë edhe sot arbërit e Italisë është pikërisht një prodhim i Orthodhoksis Shqiptare.

Kleri dhe laikët janë të porositur të mbledhin këto vepra me kujdesinë e duhur dhe t'ja dërgojnë revistës s'onë për vleftësimin e tyre.

Si fillim po shtypim në këtë numur disa këngë Pashke që këndohen në Pogradec, të mbledhura prej Zotit M. KUTELI, frymëzonjësit të kësaj inisiative.

"JETA KRISTIANE"

KËNGË PASHKE PËR VALLE

I. O Risto, Ristostanesti

O Risto, Ristostanesti,
 Ristozi bëke një kishë,
 Nd'atë kishë ç'paske brenda,
 Qënke trimi edhe vasha:
 — "Trim, o trim, që gjojte malë,
 "Gjojte mal e gjojte fushë,
 "Trim, një lule pse s'më solle ?
 — " Vasha ç'u djegërka mali
 Veçe lul' e verdhë mbetka".

II. Një tjetër motërzim i saj

O Risto Ristostanesti,
 Ristozi bëke një kishë,

Nd'atë kishë ç'qënke brenda :

— Qënke trimi edhe vasha :

Trimi mësonte gramatinë!

Vasha mësonte të qëndisë

Trimi plasi mbrëmavet,

Vasha plasi në mëngjes.

III. *Sbret Velikua që nga mali*

Sbret Velikua që nga mali,

Veliko, zonja Veliko,

Duke dredhur-a mëndafsh,

Veliko, Zonja Veliko,

— “Qysh e derth atë mëndafsh ?

Veliko, Zonja Veliko.

— “Ja bëj Zot-Ristos një rizë.

Veliko, Zonja Veliko,

“Të kungojë trimërinë,

Veliko Zonja Veliko,

“Trimërinë, nusërinë

Veliko, Zonja Veliko.

IV. *Këndon qyqja lis më lis*

— Këndon qyqja lis më lis,

Asamineja, /
Babaxhaneja \ Ref.

Pa dëgjoni qysh ja thotë :

— Çupatë që lashë vjet,

Ardhi t'i martoj simvjet,

Kur ardha i gjeta më djep.

— Këndon qyqja lis më lis,

Pa dëgjoni qysh ja thotë :

Plakatë që lashë vjet,-

Ardha t'i kungoj simvjet,

Kur ardha i gjeta në dhet,

Asamineja,

Babaxhaneja

Mbledhur në Pogradec prej

M. KUTELIT

THEMË FILOSOFIKE

LOGJIKA

III. Damje e Logjikës

Mejtimi përbàhet nga dy elemente: *landë* dhe *formë*: Lând' e mejtimit është *idéa* (jo sendi qi përfaqeson idéa, se ky është objekt i esperiencës; idéa është objekt imediat i mejtimit; sendi është objekt imediat i esperiencës dhe objekt mediat i mejtimit). Form' e mejtimit është *veprimi mbi idé*.— Andaj dhe logjika, si skenc' e mejtimit, duhet të dahet në dy pjesë: pjes' e parë merret me *idénat*; e dyta, me *veprimet mbi idénat*.

IV. Idena

1. Definim

Idé është kopie precepti. Pra, nuk është idé *nima* (sensation) dhe percepti (perception); Këta janë momente t' esperiencës dhe, si të tillë, s' mund të jenë objekt imediat i mejtimit, se kur experimenton kush gjithë vrejten e drejton kah bota objektive për të pronzue (acquerir) nima e percepte, già qi e ndalon të mejtohet; përkundrazi, kush mejton nuk vështron mâ sendet e faktet vetë, por mbyll syt e ballit dhe me syt e mëndjes vështron kopjet e percepteve qi janë shtypun në mëndje d. m. th. idé e sendet. Kështu, për idé kuptojm *hurmat* (images) dhe konceptet empirikë si dhe idénat racionale.

2. Dallim i idévet

1. Si mas origjinës së tyre, idénat dallohen në: *empirike* dhe *racionale*.— Empirike janë ato qi na vijn nga

esperienca d.m.th. nga perceptet sensitive të jashtëm a të brëndëshme; p. sh. idëa e një mali që kam për, idëa e një gëzimi që kam ndië, idëa e malit asë e gëzimit gjënorisht (en général).— Racionale janë ato që i kemi gati në mendje dhe që na kanë ardhun nga percepte racionale d.m.th. prej kontaktit me botën metafisike; p.sh. idëa e Perëndisë, e vëndit, e kohës, e shpirtit, e substancës e t'jera.

2. Si mas objektit të tyre idënat dallohen në: *subsistente* asë idë sendi dhe *inherente* asë idë cilsie. — Subsistente është idëa e sendit (gjës); quhet subsistente se esiston në veten e saj dhe jo në një jetër idë: quhet idë sendi se i referohet sendit, p.sh. *gur*, *pulë*, andaj dhe enuncohet me emën sendi, vetuër a gjënuër (general) p. sh. *Bardhyll*, *Tiranë*, *mal*.— Inherente është idëa e cilsis; për cilsi kuptojmë që do mod (modus) esistence, aty brënda dhe gjëndjen, veprimin dhe pësimin e sendit; quhet inherente se nuk esiston në veten e saj, por në një idë subsistente, p.sh. bukuria nuk esiston veç më vete por në idëna e sendit të bukur; quhet idë cilsie, se i referohet cilsis së sendit; dhe enuncohet me çdo fjalë, veç emën sendi, d.m.th. me çdo pjesë tjetër të fjalës, p.sh. *bukuri*, *i madh*, *shkruan*, *i oni*, *sod*, *këtu*.— Në logjikë idëa subsistente simbolizohet me gërmë kryesore p.sh. A; Idëa inherente simbolizohet me gërmë të vogël p.sh. a.

3. Si mas relatës, idënat dallohen në: *independente* dhe *korrelative*.— Independente është idëa që mund të mendohet më vete, pa relatë me jetër idë, p.sh. *mal*, *lis*, *Shkodrë*.— Korrelative është idëa që s' mund të mendohet më vete, por në lidhje me një jetër idë p.sh. *at*, *bir*; *shkak*, *effekt*.

4. Si mas cilsis së emnit, idënat dallohen në: *idëna me emën pozitiv* dhe *idëna me emën negativ*.— Me emën pozitiv janë idënat, emni i të cilave formulohet pozitivaz, p.sh. *mal*, *pulë* (A,B). Me emën negativ janë idënat, emni i të cilave formulohet negativaz, p.sh. *mos-mal*, *mos pulë* (mos A, mos B). Siç merret vesh, negimi nuk i referohet idës vetë, por emnit të idës. Idëa vetë është gjithmonë positive, pasi i vetmi mod (modus) presence i idëve është pozicioni; presence negative e idës është kontradiktore, se don me thënë

mos-presencë: me fialë t'jera, me pasë idé negative—mos me pasë kurnji idé.—Mbiemni negativ nuk e bën emnin negativ, p.sh. *i padrejt*—*nir i padrejt*, pra emën pozitiv. Negimi duhet t' i referohet emnit të sendit dhe jo emnit të cilsis.— Nën idën me emën negativ duhet të mendojm gjithë idénat paralele t' idé së neguëme dhe vetëm këto, p. sh. kur themi *mos-pulë* s'duhet të mejtojm gjithë idénat possible veç pulës, por vetëm gjithë idénat paralele të pulës d.m.th. gjithë shpesët veç pulës; Kur themi *mos-mal*, duhet të mejtojm çdo pjesë toke q'is' është mal.

5. Si mas estensionit, idénat dallohen në: *individuale* dhe *gjenore*.— Individuale është idéa e një individi d.m.th. idéa q' i referohet një sendi ase cilsis së një sendi, p. sh. *Tomorri*, *lartsi e Tomorrit*, *kjo shpi*, *bukuri e ksai shpie*. Gjenore është idéa e një gjeni sendesh a cilsinash d.m.th. idéa q' i referohet një numri indefinit sendesh ase cilsinash individuale, p.sh. *mal*, *lartsi*. Nën idéa *mal* mejtojm gjithë malet: dhe nën idën *lartsi*, gjithë lartsinat e sendeve individuale. Idéa gjenore quhet me një fialë *koncept*.— Koncepti nuk duhet konfundue me idën *kollektive*, e cila është individuale. Idé kollektive është grupi ase gjithia e shumë idéve individuale, p.sh. *popull*, *ushtri*, *bibliotekë*, *tufë*, *trumbë*: është individuale, se është idé e një grupi sendesh. Kur-se koncept është gjithia e elementeve komunë të shumë idéve individuale, p.sh. se cila nga kafshët ka karakteristika të veçanta si p.sh. formën e shtajit, numrin e këmbëve, zarin, qimen, moshën e t'jera q' e dallojn si individ; por nga ana jetër kanë dhe karakteristika të bashkëta (komune) si trupin, organicitetin, sensibilitetin; këta të tre elemente komunë formojn konceptin *kafshë* (=trup organik sensibil).

6. Si mas sasis (numrit), idénat janë të gjitha *jenore* (singuliers). Por logjika e shkollës i dallon më trish: *jenore* (singuliers), *piesore* (particuliers) dhe *gjithore* (universelles), p.sh. *gur*, *disa gurë*, *gjithë gurët*. Sosh, thonë, idé jenore është ajo q' i referohet një individi vetëm (send a cilsis). Idé piesore është ajo q' u-referohet disave vetëm individëve të konceptit të dhënë, d.m.th. estensioni i saj shtrihet mbi

nji pjesë t' estensionit të konceptit të dhënan. Idë gjithore është ajo, estensionin e cilës shtrihet mbi gjithë estensionin e konceptit të dhënan d.m.th. mbi gjithë individët e këtij koncepti.

Kritikë. Kjo dâmje është e gabuëmë, se më së bazë estensionin e idëvet, kur-se këtu është fiala për dâmje në bazë të sasis. Mas estensionit, siç u-tregue më nalt, idënat dallohen në individuale dhe gjenore, pra pjesore s'ka. Mas sasis, për të cilën trajtohet këtu, idëa individuale është gjithmonë jenore. Idë pjesore është një termë pa kuptim, një idë pa komprehension dhe pa estension. Pa komprehension, se me termën *disa gurë* nuk na jepet diferenca specifike, me ndihmën e së cilës të formojm konceptin subaltern të konceptit *gur*; pa estension, se për mungesë të differencës specifike, s' kemi asnjë kriter, me ndihmën e të cilit të caktojm individët q' u-riferohet. Ça mendon mëndja kur goja thotë p.sh. *disa trupa*? trupat inorganikë apo organikë? trupat e bardhë apo të zez? trupat e mëdhej apo të vegjël? asnjë sish. Cilat janë notat e idës *disa gurë*? na nuk shohim veç notën *gur*; ahërë të dyja idët identifiko-hen. Kur goja thot: *disa gurë*, mëndja e shkrehhtë vjen rotull e s'din ç'a me mendue dhe shtrëngohet me mendue një nga këto të tria: o idën gjenore *gur*, ase idën kollektive *nji togë gurësh* ase, fundi, aqë idëna guri, veç e veç, sa janë dhe gurët; në të tria rasat idëa është jenore (*gur*; një tog gurësh; guri A, guri B, guri C, q' secili është idë më vete). Idë gjithore, gjithashtu, është një shprehje goje, por jo idë; se kur goja thotë *gjithë gurët*, mëndja s' meiton veç konceptin *gur*, q' është jenuër (singulier). S' ka, pra, idëna pjesore e gjithore, por terma pjesore e gjithore: këto mund t' i thotë goja, por jo t' i mëndoje mëndja; andaj me to mund të merret gramatika, por logjika jo.

7. Si mas naturës së objektit të tyne, idënat dallohen në: *konkrete* dhe *abstrakte*.— Konkrete është idëa e një sendi të veshun me të gjitha cilsinat e tij; pra, idë konkrete janë hûrmat (images) q' na vijn drejt nga perceptet sensibëlë p.sh. idëa e *Tomorit*, e *Platonit*, e *Bucefalit* e *nji shpie* q' kam pàë, ashtu dhe idënat racionale si *Perëndi*, *vënd*, *shpirt*. Me

fialë t' jera, idëna konkrete janë idënat subsistente individuale.—Abstrakte është idëa e një sendi të sveshun prej do cilsive ase idëa e një cilsie të kqyrun më vete: pra, idëa abstrakte janë konceptet (idënat gjenore), p.sh. *mal, nËr, kalë shpi*, ashtu dhë idënat inherente, individuale ase gjenore qofshin, p. sh. *lartsia e Tomorit, bukuri, madhësi*. Me fialë t' jera, idëna abstrakte janë idënat subsistente gjenore dhe idënat inherente.

8. Si mas komprehensionit të tyne, idënat dallohen në: *papåle* (=pa palë=simplex=sine plex) dhe *paloshe* (=me palë=composé). Idë papåla është idëa qi s'ka veç një notë (element); e tillë është idëa e *gjås*, qi ka për notë vetëm *esistencën*. Paloshe është idëa qi ka më tepër se një nota; idënat paloshe, të krahasuëme njëna me tjetrën, janë më papåle ase më paloshe, si mas numrit relativisht më të vogël a më të madh të notavet, p.sh. idëa *mbimë*, qi ka dy nota (trup organik), është ma papåle se idëa *kafshë* qi ka tri nota (trup organik sensibël), dhe kjo e dyta është më paloshe se e para. Idë krejt paloshe është idëa individuale, se numri i notavet të sai është i pakufizuem.

9. Si mas karakterit të tyne, idënat dallohen në: *kontigente* dhe *të domosme* (necessaires). Kontige te janë ato idëna qi kanë për objekt gjåna qi mund të jenë e mund të mos jenë, p.sh. idëa e botës (univers), passi esistenca e sai (e botës) nuk është e domosme, se Perëndia mund edhe të mos e krijonte. Të domosme janë ato idëna qi kanë për objekt gjåna qi nuk mundin të mos jenë, p.sh. Perëndia, vendi, koha, passi esistenca e tyne është e domosme.

10. Si mas objektit dhe karakterit të tyne, idënat dallohen në: *absolute* dhe *relative*. Absolute është idëa subsistente dhe e domosme: të tilla janë vetëm dy: idëa e Perëndis dhe ajo e vëndit (espace). Relative janë gjithë idënat e t' jera.

K. T.

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

V.

Ndërgjegja ruse asht krejt e ndryshme, prej asaj të perëndimit. Ajo nuk ka një ideologji, e cila të mund t'i justifikojë pozitën shoqërore të privilegjuar. Nuk ka ekzistuar kurrë një ideologji borgjeze në Rusi. Pronarët rusë nuk kishin një siguri të pa tundur të së drejtës së plotë mbi tokën edhe e zotëronin më pakë virtuos dhe më me pak siguri se ata të Perëndimit. Klasa e tregëtarëve rusë nuk ka qënë kurrë e sigurtë mbi pasurin e saj. Tregëtari rus, ay më lakmimtar, i cili ka mbledhur miliona dhe që për mekatat e tij ish lidhur pas të miravet tokësore, mendonte në thellësin e shpirtit të tij se do të bëjë më mirë të hyjë në ndonjë manastir, se të udhëtojë nëpër vëndet e shejta. Borgjezia ruse nuk ka patur kurrë një ndërgjegje ideologjike borgjeze, e cila të mundej të forcohej nga pikëpamja morale. Kjo heqje dorë, kjo liri shpirtërore është shkak i ngritjes ruse kundër botës borgjeze dhe në këtë revoltim: Herzen – revolucionari dhe K. Leontieff—revolucionari, piquet plotësisht.

Ne të krishterët jemi udhëtarë për shpresë në këtë botë, neve nuk kemi në këtë tokë një vënd, neve kërkojmë atë që do të vijë. Dhe neve nuk mund të jemi shpirtërisht shumë të lidhur me këtë botë. *Dashurija për udhëtime shpresatare (stranni tchertvo), nomadisma shpirtërore është një vijë karakteristike ruse, një pjesë e pandarë e idesë ruse.* Tipi pelerin (strannik) nis prej popullit dhe është tipi më i duk-

shëm. Rusët kanë patur udhëtarë shpresëtare të një niveli kultural tepër të ngritur; *shkrimtarët dhe mendimtarët rusë janë të tërë kërkonjës të së vërtetës hyjnore. Gogol, Tolstoi, Dostoievvski, janë pelerinë, aqë me anë të mendimit të tyre sa edhe me anë të destinimit të tyre. Solovieff-i gjithashtu. Dashuri e pelerinazhit vjen në kundërshtim me borgjezinë në kuptimin e vërtetë moral të fjalës. Në thellësinë e shpirtit të tij, rusi nuk është me doemos i lidhur as me pronësinë, as me familjen, as me shtetin; ay e ndjen karakterin e kot dhe të përkohëshëm të të mirave dhe të thesareve tokësore. Të tëra do të mbarojnë, do të kalojnë dhe të tëra do të ringjallen, kur do të fillojë një jetë e re, Jeta e mbretërisë së Perëndisë. Kjo i detyrohet besës ortodokse, e cila e ka lartësuar popullin rus. Ajo nuk ka kultivuar në njeriun rus virtutet tokësore të domosdoshme për fitimin e një fuqije në këtë botë dhe për organizimin e jetës së përkohëshme. Në se populli rus ka mundur të rezistojë në këtë botë dhe të ketë një histori, kjo i detyrohet gjer më një pikë faktit të fuqisë së Carëvet, të cilët kanë kryer një vepër tokësore. Asnjë person nga bota nuk ka hequr dorë më lehtë se rusi prej pronësisë, prej fuqisë, familjes dhe të mirave të tij. Kjo na shpjegon mirë punët dhe karakterin e pa fat të kryengritjes ruse. Nëse një kryengritje e tillë mundi të ngjajë, dhe në se komunizma ka mundur të fitojë aq kollaj, këjo u-bë pse rusët nuk dëshën, nuk dijtën të luftojnë për të drejtat dhe privilegjet, për zotërimin e tyre. Çpërndarja e të mirave tokësore është një cilësi e çuar por njëkohësisht dhe e rrezikëshme e shpirtit kombëtar rus. Populli rus me anë të organizimit të tij shpirtëror, është një popull i cili jeton në rezik. Këtë na e tregoi kryengritja ruse, edhe këtë e zbuloi Dostoievvski në thellësinë e shpirtit rus. Heqja dorë ruse është një virtutë krishtërore, i cili ndryshohet lehtë në nihilismë. Nihilizma ruse është kundërtja e heqjes dorë ruse. Rusi dëshiron që çdo gjë të marrë fund sa më shpejt; që gjithçka që është e përkohëshme të mbarojë, që koha të ndalet dhe një botë e re, një jetë e re të fillojë. Ay nuk sheh një ecje graduale zhvillonjëse drejt kësaj jete të re drejt kësaj bote të re. Kur rusi humbet besën*

e tij fetare, kur trathëton krishterimin, gjithëcka çduket në të. Ay nuk sheh asnjë virtut të civilizuar. Atëhere gjithëça humbet. Në përrëndim, morali është një fe e shekullarizuar, një mbeturi-në e besës fetare, e cila jep themelin e jetës. Rusi nuk do dhe nuk njeh asnjë moral të shekullarizuar. Në se nuk ekziston Perëndia, as pavdekësia, atëhere s'ka as të mira, nuk ekziston as moral, atëhere çdo gjë është e lejuar. Dhe atëhere Mbretëria e Nihilizmës çfaqet, atëhere forcat elementare të natyrës ruse hyjnë në të drejtat e tyre. Dostoievski e tregoi në një mënyrë gjeniale. Në Rusi është vetëm një klasë e kultivuar; shum i vogël është numuri i atyreve të cilët mund të jetojnë pas një morali të shekullarizuar. Në se populli rus nuk ka një moral të shenjtë, në se e ka haruar Perëndinë, atëhere ay ra në nihilismë. Rusi nuk mer parasysht vlerat e civilizimit. Ay nuk di të disiplinohet në emën të ketyre vlerave. Ay kërkon shpëtimin dhe shpërfytyrimin me anën e jetës.

Nihilisma është poli negativ i shpirtit rus. Poli i tij pozitiv është kthyer drejt apokalypsës.

Nihilisma ruse është apokalypsa ruse nga ana e saj e keqe, e kthyer drejt anës së saj të dobët, që është aspirata e shpirtit rus për mbarim.

MENDIME T' ARTA

Tërë veprimet—dhe ato më të lartërat e më të çuditëshmet—do të prishen një ditë e do të çduken; të pavdekura mbeten vetëm veprat e dashurisë dhe të filantropisë.

* * *

Mjeti m'i bukur, që të përparojë i krishteri në jetën shpirtërore, është ky: të mos mendohet kurrë se ç' të mirë ka bërë gjer sot, po të fillojë që sot gjithënjë no një të re.

EPISKOP NIKOLLAJ

Nji vlaj të vogël i cili kërkon nji përallë Krishtlindjesh

Kam me të treguem një përallë të cilën ma kanë tregue Arapët orthodhoksë prej katundit Betxhale pranë Vithleemit. Në kohë të vjetra, shumë të vjetra, lark lark para lindjes Krishtit, ishte në Vithleem një njeri me emnin Jesej, i biri Ovidit, i nipi i Vozit dhe Rutit. Dhe ky Jeseu kishte shtatë djem. Biri ma i vogël i Jeseut quhesh Dhavidh. Dhavidhi ishte bari, dhe kulloste dhent reth Vithleemit. Libri i shejt e përshkruen Dhavidhin si djalosh me shtat të bukur, me flokë të verdh dhe fytyrë të bukur. Veç kësaj ky bari i bukur ishte i fortë dhe i shkathët për çudi. Kur kishte me i rëmbye luani ose ariu delen, ai do t' a mbërinte egërsinën, do t' ja rëmbente delen dhe egërsinën do t' a vriste. Dhe kështu pra, Dhavidhi ishte me të vërtetë bari i mirë dhe i zoti për dhent e vet. Dhe shumë e nderonte atin e tij, si Perëndinë. Shpesh herë Dhavidhi flinte në livadhet, në shtratin e tij të gjanë të dheut, i mbuluem me qilimin t' endun me arë, të qiellit me yje. Por atë qi do të rrëfej nuk ndodhi në fushë të hapët ndën yjet por në nji shpellë të Vithleemit.

Ishte nji ditë e nxehtë, sikur se janë përgjithësisht ditët n'atë dhe lindor. Dhent e Dhavidhit bajshin vapë në hije t'ullijvet. Dielli piqte me gjithë fuqin e vet,

dhe dhent mezi mershin frymë prej vapës. Por dhe Dhavidhit vapa ju ba shumë e mërzitëshme, prandaj ai hyn n'atë shpellë, për me u mbrojt prej vapës dhe me u shpłodhun. Në shpellë asht freskët në ditët e verës dhe ngrofët dimnit. Me të hymun në shpellë bariu i ri me një herë ndiu lezet, dhe u ul; për pak kohë filloj me dremitun, u shtri dhe fjeti. Mirë po nuk kaloi shumë dhe Dhavidhi ndjeu një ftohtësi në duert e veta, dhe u trondit prej gjumit. Kur çeli syt, ai pa një gjarpën të tmerrshëm si i mështillesh në krahanor dhe i rrethonte duert e tij! Akoma kishte ngritur kokën e tij mbi fytyrën e tij dhe i ngërcëllohesh me gjyhnën. Me sy të egërsuem, por si xixa zjari e shikonte në fytyrë djaloshin. Në shpellë errësinë, dhe n' errësinë syt e asaj egërsine të tmerrshme si dy zjarrna! Dhavidhi i gjithë u trondit prej frikës. Gjendja e tij ishte e mjerueshme, jashtë shpëtimit. Në se lëviz pak dorën ose kryet, gjarpni sigurisht do t'a gërricte, dhe do t'i derthte helmin në gjakun e tij. O, sa ma lehtë do t' ishte me lëftue me luanin qi ulurin dhe me arin se sa me këtë egërsinë rreshqitse të vështirë! Çfar të baji? Përnjiherë e kujtoj Dhavidhi ndifsin e tij të vjetër në nevojat, Zotin Perëndin e vet, dhe thiri prej zemrës, me plot dhimbje dhe lot: „Mos më len mue o Zot Perëndija im, mos u largo prej meje! Shpejtôhu në këto të zeza të më ndihmosh o Shpëtimtar i em!” Por sa tha ata fjalë, ndriçoj një dritë e çudiçme në qoshin e shpellës. Drita ishte në formë të një rethi të math në gjatësi të njeriut. Në mes të këtij rrethi Dhavidhi pa një vajzë të bukur, të mirë dhe në një kohë serjoze. Vajza rinte me krye t'ulun, dhe mbante në duer një fëmi, aq fëmi të bukur sa që i bir'i Jeseut kurrë skishte pam me syt e vet. Përnjiherë u drejtua fëmija në prehnin e s'amës tij dhe e shikoj rept gjarpnin me syt e vet, si me dy shkryptina. Dhe fëmija shtrini gishtin e vet drejt derës së shpellës sikur e urdhëronte gjarpnin me dalun. Mat ças gjarpni u zgjith prej duervet të Dhavidhit, u shtri dhe tue u tërhjekë duel jashtë. Dhavidhi u ngrit dhe u shtri mbi dhet para vajzës dhe fëmisë në dritë. De-

shte të tregonte falenderimin e tij, për shpëtimin e pa pritun, dhe sa i erdhi fjala në gërmac, ai hapi sytë, mirë po nuk pa ma asgja. N'atë e gjithë shpella u mbush me një erë të kandëshme si prej thimiamë të shtrejtë dhe izmirne.

Dhavidhi deri në vdekje nuk mundte me e harrue këtë ngjarje të çudiçme. Prej bariut u ba mbret, mirë po kjo s'i hiqesh prej mëndjes. Si mbret ai ka bam dy kangë të bukura; një nga *Ma të bukurit prej të bivet njerëzvet* dhe tjetrën prapë *Mbretneshës, me rrobe t'arta*. Dhe këta kangë ai i këndoj me harfë në pallatin e nalt në Jerusalem.

E ti, birë, tashi gjije: kush asht ajo shpella? Çfar do të thot ai gjarpni i rrept? Kush ishte ajo vajza dhe kush fëmija? Qi të mund të ndifmoj me i gjet të gjitha unë të përshëndes me përshëndetjen e gëzueshme: Krishti lindi!

Përkthye prej Ushtarit të
Krishtit.

MENDIME T'ARTA

Kur sheh no njeri të mëkatojë, në vënd që t'a qortosh e t'a kritikosh, është shumë më mirë të kthehesh nga tynë dhe të pyesësh veten dyke thënë: «Mos jam i këtillë dhe unë?»

* * *

Po t'i peshojmë mirë fjalët që nxjerrim nga goja, atëhere këto kurrë nuk mund të bëhen thikë që plagos, zjarr që përvëlton, ose helm që çkatërron e që vret.

KOLENDRAT

Nga të kremtet e mëdha fetare të botës së krishtere, Krisht-lindja është ajo që ka prekur më tepër shpirtin popullor. Njëzet shekuj afro kanë kaluar dhe po ay gëzim e shoqëron Lindjen e Zotit t'onë Jisu Krisht. Ndonëse e kremtja e Lindjes së Shpëtimtarit ka nisur të festohet nga fundi i shekullit të IV-të, ajo zuri shpejt-e-shpejt një vend me rëndësi në rrethin e të kremtevet të krishtere duke dhënë shkak të lindin një shumicë zakonesh të bukura dhe një letërsi po thuaj popullore që njihet me emrin e përgjithëshmë "kolendra".

Kolendrat janë disa kompozime popullore në vargje, që këndohen ose thuhën, pas një zakoni të vjetër, prej fëmijvet nëpër shtëpit e të krishterëvet, një ose dy netë para Krisht-lindjes, për të lajmëruar këtë ngjarje të shenjtë. Çdo kolendrë përmban pik-së-pari ndjenjat e gëzimit e të shprestarisë së kolendratorëvet për lindjen e Zotit t'onë Jisu Krisht, pastaj tregimin në mënyrë përmbledhëse të kësaj ngjarjeje dhe, më në fund, urimet përkatëse për ata q'i kanë pritur kolendratorët.

Nga emri e nga mënyra e çfaqjes, kolendrat duket se e kanë origjinën në disa zakone të vjetërsis paganë. Këto i gjejmë po thuaj në të gjithë popujt e krishterë, me ngjyrrat natyrisht e karakteristikat e çdo populli. Krishterimi, pas një lufte prej shumë shekujsh me fet e vjetra politheistike e pagane, u zuri vërtet vëndin atyreve, po s'mundi të çduknjë krejt të gjithë supersticionet e lidhur me perëndit e pa numurtë e me kultin e tyre. Ay ka qen' i detyruar të pranojë, duke u ndryshuar pak a shumë formën,

jo vetëm ca besime por dhe ca seremoni e formula të vjetra. Kështu, fjala *kolendër* i përngjet plotësisht fjalës latine *calenda* me të cilën kuptohej dita e parë e çdo muaji. Kalenda më e shënuar në romanët ka qen' ajo e vitit të ri kur ata, me një degë të njomë dafine, uronin njeri tjetrin që "të shkojnë me të mira vitin e ri që nis e për shumë vjet të tjerë", shkëmbenin dhurata edhe këndonin. Ashtu që kolendrat rjedhin nga disa kremtime pagane të festuara nga romanët në fillim të Jenarit, që quheshin "festum calendarium" Krishtërimi, duke mos mundur që t'i çdukjnë krejt këto kremtime, u dha një karakter fetar, i bëri të përputhen me Lindjen e Zotit dhe i vendosi si kënga fetare popullore për kujtim të kësaj ngjarjeje.

Kolendrat zhvillohen në këtë mënyrë: Një ditë para Krishtlindjes, mbrëmëne ose në mëngjes, fëmijt dalin grupe-grupe duke mbajtur në dorë: ose ikonën e lindjes së Shpëtimtarit ose ndonjë yll prej karte që simbolizoni yllin që udhëzoi magët e ditur në vëndin ku ish lindur, Zoti ose një arkë në formë shpelle që simbolizon shpellën ku u-lind foshnja Hyjnore dhe shkojnë nëpër shtëpit e të krishterëvet duke kënduar dhe duke uruar për ditën e madhe që vjen. Familjet, të pregatitura për këtë qëllim, i presin fëmijt me gëzim e kënaqësi si disa engjëj të vërtetë dhe i darovisin me kuleçër, gështenja, arra e me nga ndonjë lek. Nuk ka shtëpi atë ditë që të mos jetë çelur për të pritur këta lajmëtarë të pafajshëm të Lindjes s'Atij q'është Miku m'i ngusht i tyre dhe që neve të mbëdhenje na sjellin nër mënt ato kohëra të lumtura kur si fëmij prisnim me padurim ditën e bukur të kolendrave. Këngat që këndohen atë ditë, ndryshojnë pas vëndit. Këtu po shënojmë vetëm një që këndohet në qarkun e Beratit dhe që tingëllon kështu:

Dil moj zonj' një llaf të t'them
 U-lind Krishti n'Vithleem
 N'Vithleem të Jahudis
 Për shpëtimin e njerzis
 Prej një vajze virgjëresh
 Qell' e dheut mbretëresh.

Yll' i bukur që në qell
 Dëften udhën dituris
 Për të gjetur këtë djell
 Q'është i bir i Perëndis.
 Ty o Zot lavdi të qoft
 Për kto dit' që po na vijn
 Edh' e nesërmja na qoft
 Për gëzim edhe për ndihm.

Ka edhe shumë të tjera, më të bukura e më të vjetra, që ruhen në gojë të popullit e që duhen mbledhur e botuar. Barra u bie priftërinjvet dhe mësuesvet të Fesë si edhe çdo të krishteri q' interesohet për folklorin t'onë të bukur. Sepse kolendrat së bashku me zakonet e tjera popullore, me përallat, me muzikën e poezin, me një tjalë traditat janë arshivat e popujve. Me ato mund të rindërtohet koha e errët e së kaluarës. Me njohjen e këtyreve mund të ndriçojmë origjinën si fis, gjuhë, komb, prirjet natyrale të popullit si edhe krishterizimin e të parëvet t'anë.

Edhe një diçka tjetër. Këto zakone të bukura fetaropullore duhet të përpiqemi që t'i gjallësojmë, t'u japim shkëlqimin dhe bukurin e kohëve të para, siç bëhet dhe gjetiu. Është mirë që mrekullin e besimevet të mos e mënjanojmë. Ne që jemi në moshë, të përpiqemi të fisnikojmë fëmijërin t'onë të larguar dhe të vegjëlvet t'u a shpërblejmë pafajësin e moshës së tyre ditën e kolendrave. T'i presim kolendratorët si disa lajmëtarë hyjnorë, me zëmër të hapur para misterit të math që na çmysterizohet me anë të zëravet të tyre fëmijore e të pafajëshme sidomos në kohët e sotshme aq të turbullta e kritike. Edhe bashkë me t'a, t'i drejtohemi edhe ne Atij q'është i vetmi themel për një paqe të vërtetë e të duruarshme duke i thirrur hymnin ëngjëllor: *"lavdi Perëndis më të lartat e mbi dhe në paqe e mbi njerzit mirëdashje."*

J. D.

Andrea i parathirrur

Peshkatarët e shpirttravet. Nga liqeni i Tiberiadës në lavdin' e shenjtërim

Një nga fytyrat më të shquara të Kishës s'onë Apostolike është edhe Sh' Ndreu, ditën e të cilit e kremton populli besnik në fund të këtij muaji (Nëntor), dhe nga e cila ditë ka marrë edhe emrin ky muaj, sikundër që muaji i mëparshëm ka marrë emrin e Shën-Mitrit, prova të nderimit të math që ka patur Krishterimi kundrejt martirëve të fesë së tij.

Andrea ishte peshkatar nga mjeshtëria. Të gjithë, i ati Ionaj, i vllaj Pjetri dhe far' e fisi i tij tjetër, gjuanin peshk në liqenin e Tiberiadës, ata peshq të ëmbël që lëvdohen prej turistëve. Atje në breg të liqenit, kur po ecte një ditë Jisuj, i pa të dy vëllezërit që po lëshonin rjetat e tyre dhe u tha:

— Ejani me mua dhe unë do t'ju bënj peshkatarë njerëzish! . . .

Të dy peshkatarët i lanë rjetat me një herë dhe u-bënë nxënës të mësonjësit të math, që premtonte mbretërin' e qiejvet. Përandaj dhe Kisha e quan Andrenë të parathirrur. Dhe është e vërtetuar nga ungjillorët se Jisuj kish një dashuri të veçantë për' të. Mrekullin' e pesë bukëve dhe të dy pishqëve të vegjël, me të cilët Jisuj ngopi pesë mijë njerës dhe tepruan dymbëdhjetë shporta plot me copra, e bëri Krishti pass i tha Andrea se ish nevojë të ushqehesh populli i urtuar i Judejve, që ish grumbulluar për t'a dëgjuar.

Pas ngjalljes triumfonjëse të Shpëtimitarit, Andrea filloi veprën apostolike të përhapjes së krishterimit. Shtegtar

dhe udhëtonjës i pa lodhur, u-nis nga Jerusalemi dhe vinte qytet më qytet, në të gjithë bregdetin e detit të Zi. Që andej shkoi në Iberi, u-ngjiti në brigjet e Kalqidës dhe arrijti në vëndet e Lazejve, ku ra në mes të Kërketëve. Këta ishin kusarë të tmershëm dhe paganë të egër. Me gjith' atë Andrea i zbuti, duke hedhur në shpirtin e tyre primitiv dritën e krishterë. Dhe ata kusarët atëhere i lanë vrasjet dhe u-bënë një shoqëri e qetë dhe puntore, shëmbëll e lartë e efektit qytetëronjës të fesë kristiane. Prej andej e gjejmë Andrenë në Paflagoni e pastaj në Trapezundë, ku e pa kronografi i asaj kohe Epifani dhe na e përshkruan:

"Andrea ish i shkuar nga moshë, trup-gjatë, pak i kruhur, me hundë të gjërë dhe me vetulla të dendura".

Një tjetër kronograf, Murgu Rus Nestor, shkruan se Andrea u-ngjiti deri në majën e malit të Kievit dhe nguli atje një kryq shumë të math. Në atë vënt u-ndërtua më von manastiri i famshëm i Peçerskit.

Që andej zbriti në Bizant, i cili n'atë kohë kish shumë pak banorë. Mbreti i tij ish n'atë kohë Zefksipi, njeri gjakatar dhe pagan i tërbuar. Ky i priste udhtarët me dinakëri dhe u thoshte se gjoja desh të bëhej i krishterë dhe sapo i dëgjonte të thonë se ishin të pagëzuarë n'emër të Krishtit, i hudhte në egërsirat. Andrea shkonte pa droje, për në Bizant. Befas, natën, dëgjoji një zë:

— Ndro udhë, André! Mos shko në vëndin e atij që lëfton krishterimin, por shko në vëndin e Helenëve, ku është misioni yt i math. . .

Ë kështu Sh' Ndreu, duke kaluar nga Thraka e Maqedhonia arrijti në Thesali e pasi u-cloth pak e vazhdoi udhën e tij apostolike ndaj Patra e Akaisë, kryeqytetin e Peloponesit. Atje bëri mjaft mrrekullira dhe u-shqua për zellin e tij të zjarrtë dhe për kurajën kundër ndjekësve të fesë, gjer sa gjet vdekjen martirike, i dënuar të varet mbi kryq me kok ta-të-pjetë, në moshë 70 vjeç. Kur arijti para kryqit thirri: O Kryq i admiruarshëm, Kryq i dashur, të përshëndosh! . . . Ti je porta, nga e cila do të hyj në mbretërin' e qiejvet"! .

V. XHAÇKA

Nga kryeveprat e Gojartit

Çkëlqimi i Krishtlindjes

Ato që prisnin me pa durim patriarkët, ato që trumbetonin profetët me gojën e tyre profetike dhe ato që dëshëronin nga zemra njerëzit e mirë dhe të drejtë, tërë këto, o vëllezër, u-plotësuan sot dhe u-realizuan. Sot Perëndia vetë u-çfaq në botë me fytyr' e trup njeriu dhe u-bashkua me njerëzit.....

Le të gëzohemi pra, o të dashur, dhe le të ngazëllohemi. Në se Joani, siç thotë Ungjilli i Shenjtë, u-hodh dhe kërcëu në barkun e s'ëmës, kur Virgjëresha Maria hyri në shtëpin' e Lisabetës, shumë më tepër neve që shohim jo Marinë, po shpëtimtarin vetë të lindet sot, duhet të gëzohemi dhe të habitemi për mëshirën hyjnore, e cila është aq e madhe, sa kalon çdo mendje dhe çdo fantazi. Me të vërtetë; mer-e me mend se sa e çuditëshme gjë do t'ishte, si kur pa pandehur e me një herë të zbriste djelli nga qielli në tokë dhe si kur të shpërndante rezet e tij nëpër tërë anët e dheut. Po në qoftë se të gjithë do të habitëshin, po të ngjiste një gjë e këtillë në qiellin lëndor, sa e madhe vallë duhet të jetë habitja e jonë, kur t'a shohim djellin e drejtësisë të ndrit' e të çkëlqejë me fytyrën që mori dhe të ndriçojë shpirtërat t'ona me dritën e Tij hyjnore !...

Le të gëzohemi pra, o vëllezër, për këtë mirësi të madhe që na bëri dhe le të lavdërojmë Perëndinë për këtë përrulësi të Tij aqë të çuditëshme dhe le të mendohejmë, si pas fuqisë s'onë, t'i a këthejmë nderimin e çpërblimin q'i ka hijë. Po cili vallë është ky çpërblim ? Çpërblimi q'i pëlqen Zotit është një i vetëm : të përpiqemi të qëndrojmë gjithënjë në rrugën e së mirës, të mos largohemi nga kjo as një çast, t'i paraqitim kështu shpirt të pastër e të kulluar, një shpirt që të ketë të drejtë të kërkojë shpëtim n'orën e gjyqit të lartër.

Përkth. prej Shpresëtarit

Nga kryeveprat e Atërve të shenjtë

Hidhërimet e njerëzvet të drejtë,

Jeta e njerëzvet të Shenjtë është po thuaj e tërë plot me vuajtje dhe me hidhërimet. Zoti i ynë ka thënë: «Rruga është e ngushtë dhe plot me hidhërimet»; edhe poeti i psalmëve thotë: » Të shumë janë hidhërimet e të drejtëvet». Prandaj edhe Apostul Pavli thoshte përvehten e tij si dhe për apostujt e tjerë, se or' e çast ndodheshin në hidherime e në mjerime. Këtë të vërtetë e thekson edhe libri i punëve, i cili na mëson se duhet të kalojmë nepër hidherime të shumta, që të mundim të hyjmë në Mbretërin' e Perëndisë.

Profeti David në një psalmë tjetër thotë: «I u luta Zotit nxehtësisht e pa pushim dhe Ay m'a dëgjoi lutjen e më liroj nga tërë hidherimet». Po në çmënyrë vallë i liroi Perëndia njerëzit e shenjtë dhe të drejtë nga vuajtjet? Jo dyke i lënë krejt pa mundime e hidherime, po dyke u falur ndër këto durim. Pse, në qoftë, se; si pas shkrimit të shenjtë «hidhërimi sjell durim, e ky i fundit (sjell) provë», kuptohet vet vetiu se ay që nuk e pranon hidhërimin, ia mohon vehtës provën, e pra nuk pranon të çfaqet i zgjedhur dhe i denjë. Sikundër pra asnjëri nuk mund të fitojë kurorën, pa patur ndonji kundërshtar, ashtu dhe asnjëri s' mund të bëhet i denjë dhe i zgjedhur, në qoftë se nuk kalon nepër vuajtje e hidherime.

(SHËN VASIL)

Rënja e njeriut

Njeriu u-nderua shumë prej Krijonjësit. Me të vërtet; u-krijua dhe u-formua si pas fytyrës së Tij. Nderim i madh ky dhe i jashtë-zakonshem: u-nderua më tepër nga dielli, më shumë nga vallet e hyjevet. Cili qiell u-quajt fytyrë e Perëndisë? Çfytyrë hyjnore ka dielli? Çfytyrë

ka hëna dhe hyjet e tjerë? Të gjithë këta janë volume lëndore pa fytyrë e pa shpirt që kanë trupa të ndritëshme, po në këto nuk ndodhen as mëndje, as liri, as lëvizje me dashje dhe me qëllim të caktuar. Shkurt, janë robër e sherbëtorë të ligjevet natyrale, q'i drejtojnë dhe q'i sundojnë, e prandaj vijnë gjithënjë e sillen rreth e rrotull po t'atyre vendëvet.

Po njeriu për fat të keq, ndonëse u-nderua aqë shumë nuk e ndjevi këtë nder aqë sa duhej. Dal nga dal pushoi të jet' imitonjës i Zotit dhe të bëhet fytyr' e gjallë e Tij, zgjodhi përkundrazi rrugën e keqe, dyke u-bërë shërbëtor i verbër i pasionevet të tij, dhe kështu, siç thotë David-i «u-bashkua me kafshët e pa mënd dhe u-bë si këto». Prandaj e shohim këtë herë t'i hedhë sy gruas së tjatrës, si një kalë që çmëndet pas femrës: herë të rrëmbejë me dinakëri sendet e huaja, si një ulk që grabit e që rrëmben, herë më në fund të gënjenjë vëllan e tij, dyke përdorur tërë dredhit'e një dhelpre dinake.

(SHËN VASILI)

Një Apologji (Mbrojtje) e pamjaftë

Na thonë disa: si është e mundur të shpëtoj shpirtin t'im, po sa që ndodhem brenda në botën. brenda në aqë kokëçarje, turbullime dhe çqetësime? Ti, njeri, që po flet kështu, a je në vehte? Ajo që na shpëton, nuk është vëndi, po mënyra dhe vulneti i mirë. Mos dëshiron prova për këtë që thua? Ja këto. Dëgjo. Adám-i ka qënë brenda në parajsë, si në një liman të mbyllur e të sigruar, po me gjithë këtë aty mbrenda e pësoi shumë keq. Përkundrazi Lot-i gjendej brenda në qytetin Sodoma, si në një det plot me stuhi e me dallga, e me gjithë këtë shpëtoi. Jobi rinte për mbi plehun, po kjo nuk e ndaloi të bëhet e të çpallet njeri i drejtë. Kurse Saul-i që jetonte brenda në pallate madhështore, humbi jo vetëm mbretërin e kësaj bote po dhe atë të qiejvet.

S'është pra arsye e fortë ajo që thonë disa, se nuk mundim të shpëtojmë shpirtin, me qënë se jetojmë në një

botë plot me kokëçarje. Dhe doni t'ju thom se nga rrjedhin këto arësye e këto pretekste të pa themelta? Vijnë nga që ju skinin dashur kurrë t'a shtërngoni vehten që të largohet e liga dhe as që keni kërkuar me gjithë zemër për këtë qëllim ndihmën e Zotit, dyke ardhur rregullisht në Kishë dhe dyke u falur me zemër të pastër e të qëruar.

(GOJARTI)

Një orë në javë

Kam parasysh ca njerëz, të cilët në kohën e meshës (liturgjisë) hyjnë flasin e bisedojnë si pa gjë të keqe! Çpo bën, o vëlla? A ke menduar nonjë herë, se sa mekat' e madhe është kjo? Para pak kohë kur prifti thëriste «Le t'i ngrehim lart zemrat t'ona», dhe të ftonte që t'a çonje e t'a drejtonje mendjen t'ende në Perendia, ti i dhe këtë përgjigje: «I kemi ne Zoti». E pra kur ke dhënë një përgjigje e një premtim të këtillë si guxon t'a shkelësh e t'a hedhësh poshtë? Nuk ke frikë, nuk skuqesh nga turpi, kur gënjen në një çast aq të lartër e aq madhështor?

Me të vërtetë: Tryeza mystike është gati, Qengji i Perëndisë po bëhet fli për shpëtimin t'end, prifti në këtë çast ndodhet n' agoni, një zjarr shpirtëror po del nga tryeza e shenjtë; Heruvim-et ndodhen aty pranë, Serafim-et po flytyrojnë aty rrotull, tërë fuqitë pa trup e pa lëndë bashkë me priftin po i luten Zotit për tynë, flaka shpirtërore po zbret në këtë orë, gjaku derdhet nga briri i pamëkatshëm mbrenda në kupën (Potirë) për pastrimin e për shpëtimin t'end-tërë këto bëhen në këtë çast-dhe t'i nuk trembesh, nuk skuqesh e nuk ke turp që guxon të gënjesh në këtë orë aq të lartër e të tmerëshme?

Një qint e gjashtëdhjetë e tetë orë ka java dhe Zoti mbajti nga këto vetëm një orë që të falen njerëzit e të kuvendojnë me Atë. E pra! ti edhe këtë orë ke ndërmend t'a spenzosh për bisedime e për sende qesharake dhe të parëndësishme të kësaj bote?

(GOJARTI)

Përkth. prej Shpresëtarit

F A R I S E N J Ë T

Në për Ungjijt e shenjtë që lexohen nëpër të Djela dhe në për festa e më tepër Javën e Madhe në Kishat t'ona, shpesh herë bëhet fjalë mbi Farisenjtë, me të cilët Krishti pati kundërshtime dhe i luftojë. Formimi i grupit të Farisenjvet është shumë i herëshme se ay i Dhjatës së Re.

Studimin t'onë sot po e kthejmë mbi Farisenjtë duke u huajturë thelpin e këti studimi prej konferencës të mbajtur prej Prof. Vasil. M. Bella, Profesor në Universitetin Kombëtar t'Athinës.

Farisenjtë historikisht shfaqen në vitet pas kthimit të Iudhenjvet nga shpërngulja e Israelit në Babilon, pas vitit 538 para J. K. Gati në kohë Esdra e Neemia. (nga mezi i I i shekullit V-të para J.K), Iudaismit, që i mungon më fuqija politike; duke përbërë një komunitet fetar, me karakteret fisënie, ka të përballojë në atë Palestinë rezikun e asimilimit prej popujvet fqinjë. Për këtë Esdra merrë masa të ndryshme, njëra prej të cilavet ish edhe ndalesa e martesavet mikste. Kundra këti reziku u shfaq një rezik edhe më i math që kanosesh të shuaj a të treti karakterin kryesor të Fees Israilite, e cila përmbante qëndrimin fisënor të Iudhenjvet. Ky rezik filloj të përshkruhet edhe me kalimin e kohës bëhesh më i dukëshme, që kurë se u dukë fryma e qytetërimit helinik, veçanërisht nga shekulli i IV-të fillojë të tërheqi Anatolin (Lindjen e Afërme), dhe të shkëmbej dhe formoj kuptesa e kujtesa të reja e gjendje të re. Fryma e re që frynte, nuk u vonua të duket e të goditi

edhe rrethet iudaike të Palestinës, prej të cilvet shumë me kënaqësi filluanë të pranojnë nënështypjet e këti qytetërimi të ri dhe të poltisin të mirat e tij.

Marëdhënja me këtë qytetërim të ri sgjerojë në këta Iudenjë orizondet frymore e mendore dhe rregullojë jetën e tyre. Nënë këtë shtytje të ré, drejtime të reja frymore dhe kufisma të jetës u krijuanë, që nuk i drejtonin kundra fisënis së tyre, po në një qytetërim të huaj siç mejtoheshin këta Iudenjë, as në mohim të kombësisë së tyre, as në mohim të fesë atënore, veç se i drejtonin në një mënyrë të lirë në përmbajtjen e urdhëresavet të Ligjit Mosaik dhe rruajtjen krejt të jetës Iudhaike.

Gjendja e këti llojë shvillimi, tërhoqi shpejt kundërshtimin e atyre Iudhenjve, të cilët parapanë këtë rezik, në të cilën iudhaizmi në këtë gjendje të ré shvillimi po rezikohesh, filluanë kuidesin për shpëtimin e iudhaizimit nga këto valë, nga njera anë të kundërshtojnë me ndërgegje ç'do element të ri, dhe nga ana tjetër të thekësojnë vetitë e posaçme të Fees israilite dhe me anë të saj, karakterin e posaçmë fisënor të Iudaizmit. Për këtë nuk thekësohen ndryshimet teorike të Fees israilite, po të shtatë shenjat e përjashtme, që shquajnë Iudhenë nga Kombëtari, rrethpresija (synetllëku), Sabbati (e Shtuna), theroret etj. kurse paralelisht dhe shquarësisht nënëvizohet prierja e Israelit prej Perëndisë në ndarjet fisënore të Iudhës prej popujvet te tjerë,

Kështu që shvillohen në Iudhaismë dy shkallë, njera ish ngjitur në Ligjët, duke ndaluarë ç'do element të huaj ; dhe tjetra më e lirë kundrejt Ligjës, duke marrë frymë lirisht dhe me kënaqësi në frymën e re të asaj kohe. Shkallën e parë e përbënin ata që në Dh. e V. quheshin "*Hasidim*" (Asidei) që d.m.th. të nderushmë (eusevis), në kundërshtim me të tjerët që quheshin të përcmuar (të panderçmit, asevis) dhe përqeshës të Ligjit (siç do të thoshim neve sot t'pa Tenzot-ateist), Është e ditur se ata që i quanin përcmuës, të parët e vërenin dhe në pikpamje kombëtare të dyshimtë, se duke u larguar prej Ligjit, shënonte rezik kombëtar. Kështu që hasidimët shfaqen si përmbajtësit e

fees dhe të ndërgjegjies kombëtare të iudhaismit, që ish shkalla e caktuarë të kundraqendroj kundra rymës së qytetërimit helinik dhe më vonë të ati Roman. Besnik në parimet e tyre hasidimët vrapojnë në kohrat Makkabaike (168 para J.K), kur priësit e Syrisë dhe veçanërisht Andi-ohu i IV Epifanus u atentua helinizimi i ngutëshme i Iudhevet, vrapojnë të bashkuarë me Makkabenjët dhe shumë prej tyre shpesh gjejnë vdekjen martirike. (A! Makk. 2, 42. 7, 12. B! Makk. 14, 6). Në këtë çast të kritikëshme, marrin për shquarje të këtyre parimeve, dukjen e emërit “*Farisenj*”, e cila shënon të ndarët, të shquarit prej kombëtarvet, prej luhenjvet të lirë, prej botës së ndarë. Pas kalimit të ati çasti kritik mbeten Farisenjët si një griq fetar, që i shquante përpajtja e përpikt e Ligjit dhe neverijtja e ç’do gjëje që nuk ish Iudhake (elementi), për përmbajtjen e ndërgjegjies kombëtare dhe fetare. Për këtë thekësonin prierin e Israelit prej Perëndis, dhe fisvillësin prej Abraamit(Matth. 3, 9), madhështor se ishin “*Ebrenjë prej Ebrevet*” (Filip. 3, 5) Si të këtillë ebrenjë të kulluarë, jo vetëm që bënëin të gjitha sa thosh Ligja Mosaike, po edhe gojdhinat e pleqvet i mbanin dhe i lavronin ato, siç na dëshmon shkrimtari lósipos “*Tani dhe disa gojdhane të ligjëshme që gjenden, të trashëguara prej Etërvet, që nuk shkrahën prej ligjit të Moisiut, Farisenjët i mbajnë në ligjët*”. (Arh. XIII. 10, 6). Prej mbajtjes së formës së jashtme të Fesë, thekësonin elementin moral të saj, me ndryshimin që vetë nuk plotësonin sa predikonin, duke krijuarë në këtë mënyrë një besim të remë, për të cilën pikërisht edhe Zoti i Ynë thot: “*gjithë sa u thon (Frisenjë) juve, mbani, mbani dhe vepëroni, po pas veprave të tyre mos bëni, thonë po nuk bëjnë* (Matth. 23, 3).

MENDIME T’ARTA

Feja është mjeti më fisnik dhe më i mirë për t’a shpënë njerinë në rrugën e virtytit.

Zëri i shpellës së Vithleem-it

Një natë e jashtë-zakonëshme u-paraqit për njerëzinë. Natë q'ish caktuar të ndajë historin e botës në dy pjesë krejt të ndryshme. Natë që do të mbulonte erësinë për gjithënjë dhe do të jepte nisjen e lindjen e një drite të re spirituale e morale. Natë misterioze, e pakuptuarshme që mbante në gjidritën e pambaruar. Në vetmin' e shpellës së Vithleemit, atje ku një heshtje e thellë mbretëronte, udëgjua pa prituri zëra të ndryshme. Tingujt fyello-rë të barinjvet të thjeshtë, kënga e ushtëris së engjëjvet, banda njerëzore e përziher me bandën hyjnore, sepse në një mënyrë të çuditëshme vinte në kontakt atëhere e kufizuara me të Pakufishmin. Ymne i drejtoheshin Atij që çfaqej si Hyj-njeri në shpellën e thjeshtë, Atij që pak më vonë do të predikonte: «un jam drita e botës: ay që më pason, si do të ecnjë në erësinë, po do të ketë dritën e jetës».

Drita e Vithleemit shpërndante dhe çdukte errësinat e shekujvet, ret e zëra të ligësis dhe jepte dritën shkëlqenjës të botës së re, të njeriut të ri. Ylli i përmbinatyrëshmë q' udhëhiqte magët, simbolizonte dritën që dilte brënda nga shpella.

Njerëzia, të cilën për shekuj rrjesht e paraqite në gjëndje të mjeruar Promitheus-i i Lidhur,

e harronte zërin e mjerimit të sajë, qetësonte zërat e qarjevet të sajë dhe degjonte e gëzuar dhe e entuziasmuar zërin gasmor që oshëlitte në murët gati për t' u-rrezuar të shpellës së shejntëruar: «Lavdi Perëndis më të lartat e mbi dhën paqe e mbi njerëzit mirëdashje».

Këtë zë që zbret nga qielli i qiellit s'munt t'a mbytin as britmat e të fortëvet të dheut, as zhurmat e armëvet, që nga ajo m' e vogël gjer te m' e mahnitëshmjja. Fuqia e zërit të Vithleemit ndryshon nga britmat e tjera sa ndryshon puna hyjnore nga punët e njerësvet, qielli nga dheu.

Të dëgjuarit e krismavet të mjetevet vrasëse të njerësvet, sado shurdhonyës që munt të jetë ky, është i përkohëshëm. I përkohëshëm në lidhje me jetën e njerëzisë, jo të njeriut. Impononyës e triumfonyës pason zëri i Vithleemit: «lavdi Perëndis më të lartat e mbi dhën paqe e mbi njerëzit mirëdashje».

N' analizimin e këtyre fjalëve gjejmë elementet e përparimit të vërtet e të lumtëris së njerësvet. Gjejmë librin e botës se lindur, të njerëzis së rindërtuar. Perëndia dëshiron, krijonyësi i Përjetëshëm kënaqet me përparimin e virtytit, të së vërtetës, të së drejtës, të dashurisë për t' afërmin. Kënaqet me përparimin që përbëhet prej elementesh më të lartë, spiritual' edhe moralë. Këta elemente formojnë dhe zbukurojnë korën e vërtetë të Perëndis, sipër-njeriun e Krishtit. Në këta njerës sidomos drejtohet zëri i Vithleemit «dhe mbi njerëzit mirëdashje».

B.

LEON TOLSTOI

TRI PYETJE...

???

Një mbret u-mendua një herë, që po të dinte ay gjithënjë kohën kur të fillojë një punë, edhe po të dinte me cilët njerës duhej të mirrej e me cilët jo, edhe sidomos po të dinte gjithënjë se cila nga të gjitha çështjet është m' e rëndësishmja, atëhere n'asnjë punë s'do të dështonte. Dhe dyke u-menduar kështu ay mbret, i a bëri të njohur tërë vëndit të tij, se do t'i jipte një çpërblim të math atij që do t'a mësonte si të njohi pikërisht kohën e çdo pune, cilët janë njerëzit më të nevojëshëm dhe, që të mos gënjej. cila punë nga të gjitha është më me rëndësi.

Nisnë atëhere të vijnë ne ay mbret njerës të ditur nga të gjitha anët dhe i dhanë përgjegje të ndryshme për ato tri pyetjet.

Në pyetjen e parë ca i u-përgjegjnjë që, për të ditur pikërisht kohën e çdo pune duhej të formojë që më përpara një tabelë të punëve, të rrjeshtuara pas ditëve, muajve dhe vitëve dhe të mbahej mirë pas asaj tabelë. Vetëm atëhere-thoshin ata-dotë bëhej çdo punë në kohën e sajë.

Të tjerët thoshin, se s'munt të caktohet që më përpara ç' punë duhet bërë në filan kohë dhe se, s'duhet të gënjehemi me hesape të kota, por gjithëmon të kemi mëndjen n'ato që ngjasin dhe atë kohë të bëjmë çka duhet.

Të tjerët thoshin që sadó të ketë mëndjen mbre

n'ato që ngjasin, është e pamundur për një njeri vetëm të caktojë gjithënjë me saktësi kohën kur duhej të bëhej një punë, por ky ka nevojë për një këshillë prej njerëzish të mençëm, këshill' e cila do të caktonte çka duhej bërë e kur duhej bërë.

Të tjerë më në fund thoshin se ngjasin dhe punë të këtilla që s'të mbetet kohë të pyesësh këshilltarët, por duhet të vendosësh me një herë në është a po jo koha që të nisësh një punë. Dhe që të munt t'a dish këtë duhet të dish që më përpara ato, që kanë për të ngjarë. Po këtë s' munt t'a di tjetër veç se magët. Kështu që, për të ditur me saktësi kohën e çdo pune, duhet të pyesësh magët.

Të këtilla përgjegje të ndryshme i dhanë dhe për pyetjen e dytë. Ca thoshin që njerëzit më të nevojshëm për mbretin ishin këshilltarët e tij, ministrat. Të tjerët thoshin që njerëzit më të nevojshëm për një mbret ishin priftërinjt. Të tjerët thoshin se mjekët janë njerëzit q' i nevojiten më tepër mbretit, kurse të tjerët shtonin se ishin magët.

Në pyetjen e tretë: *cila punë ishte më me rëndësi, ca i u përgjeginë që punët më të rëndësishme në botë janë shkencat; të tjerët thoshin se është arti ushtarak dhe të tjerët se është adhurimi i Zotit.*

Në të gjitha pyetjet, përgjegjet kanë qenë të ndryshme; prandaj mbreti s'pëlqeu ndonjë nga ato, dhe s'i dha shpërblim kurkujt. Por që të kishte dhe ca përgjegje më të sakta në pyetjet e tij, vendosi të pyesë për këtë çështje një asqiti, që ishte i famëshmë në të gjithë botën për mençurin e tij.

Ky asqiti rronte në një pyll, s'shkonte m'asnjë vënd dhe pranonte të fliste vetëm me njerës të klasës së ulët. Prandaj mbreti u-vesh me robe të thjeshta dhe, para se t'arinte në qelin e asqitiut, zbriti nga kali, la atje gardën që shoqëronte dhe shkoi vetëm n' asqitiu.

Kur mbreti i u-afrua asqitiut, ky punonte me shat vendin q' ishte para qelis së tij. Dyke parë mbretin i u-përgjegj përshëndetjes dhe vazhdoi punën. Asqitiu ishte i do-

bët dhe i lodhur dhe dyke kthyer me lopatën plisa jo dhe aqë të mëdhenj, mirrte frymë me zor.

Mbreti i u qas më afër e i thotë:

—Un, o asqiti i mençëm, kam ardhur ne ty të të lutem që të më përgjigjesh në këto tri pyetje: *Cila është koha më e mirë për t'a përfutuar, që të mos pendohesh më vonë? Cilët nga njerëzit janë më të nevojshëm, d.m.th. me cilët duhet të meresh më shumë e, me cilët më pakë? Dhe cilat janë punët më me nevojë dhe pra cilat nga këto duhen kryer më përpara?*

Asqitiu i a vuri veshin mbretit, por s'i dha asnjë përgjegje; vetëm pshtyu pëllëmbat e duarvet dhe nisi përseri të punojë tokën.

—Ti u-lodhe—i thotë mbreti; nëm-a dhe muar shatin të punoj.

—Ju falem-nderit, tha asqitiu dhe dyke i dhënë shatin, u-ul përdhe.

Si çeli nja dy gropa, mbreti u-ndal dhe përsëriti pyetjet e tij. Asqitiu s'i dha asnjë përgjegje, por u-ngrit dhe zgjati dorën drejt shatit dyke thënë:

—Çplodhu tani ti dhe nëm-a të punoj unë.

Mirëpo mbreti s'i a dha shatin, por vazhdoi të punojë vet. Kaloi një orë, kaluan dy; dielli nisi të fshihej prapa pyllit. Atëherë mbreti nguli shatin në tokë e tha:

—Un, o asqiti i ditur, kam ardhur te ty të mar përgjegjen e tri pyetjevet e mia. Nëse s'munt të më përgjigjesh, thujm-a ahëre që të kthehem në shtëpi.

—Pa shiko,—i thotë asqitiu—një njeri po vjen me vrap këtej. Cili do të jetë vall?

Mbreti u-kthye dhe pa se me të vërtet nëpër pyll ecte me vrap një njeri me mjekër. Ay mbante barkun me duart, ndënë të cilat rrithte gjak. Si erdhi para mbretit, njeriu me mjekër ra përdhe dhe dyke ulur syl, mbeti i palëvizur dhe mëmzi merte fyromë.

Mbreti bashkë me asqitiun i hoqën robët. Ay kishte në bark një plagë të madhe. Mbreti e lau si munda dhe e lidhi me shamin e vet dhe me rizën e asqitiut. Po gjaku

s'pushonte, ashtu që mbreti që i detyruar t'i heqë të lidhurat mjaft herë, të lajë pjagën me ujë e t'a lidhnjë përsëri.

Kur pushoi gjaku, i plagosuri çeli syt dhe kërkoi ujë për të pirë. Mbeti atëhere solli ujë të frëskët dhe i dha të plagosurit.

Ndërkaq dielli perëndoi dhe koha u-ftoh. Mbreti i ndihmuar dhe prej asqitiut, e çoi të plagosurin në qeli dhe e vuri në shtrat. Si u-vendos në shtrat, i plagosuri mbylli syt e ra në gjum. Po kështu dhe mbreti, duke qenë i lodhur nga të ecurit e nga puna, u-shtri posht dhe flejti tërë natën e shkurtër të verës. Kur u-squa, s'mundi për një kohë të kuptojë ku ndodhej dhe cili ishte ay njeri i çuditëshmë me mjekër që rrinte shtrirë mbi shtratin dhe e shikonte drejt në fytyrë me sy të ndritçëm.

— Fal-më, i tha me një zë të dobët njeriu me mjekër, kur pa se mbreti që squar dhe po e shikonte.

— Un s'të njoh dhe s'kam për ç'gjë të të fal, u-përgjeggj mbreti.

— Ti s'më njeh, po unë të njoh. Unë jam ay hasm i yt, që kam bërë be të mar hakun, pse më ke vrar t'im-vëlla dhe më ke marë pasurin. Mora vesh se ke ardhur vetëm në asqitiu dhe vendosa të të vras kur të ktheheshe. Por dita e tërë shkoi dhe ti s'po vinje. Dolla atëhere nga vendi ku qesh fshehur për të parë se ç'u-bëre, po njerëzit e tu më kuptuan, më njohën dhe më plagosnë. I u dhashë këmbëvet. Por duke humbur një shumicë gjak, do të vdisnjam, po të mos m'a kishe lidhur ti plagën. Kështu që un kam dashur të të vras dhe ti më ke shpëtuar jetën. Që tani po të rroj, do të të shërbej si një rob besnik tërë jetën dhe t'u lë fjalë dhe bijvet të mi që të bëjnë kështu. Më fal!

Mbreti mbeti tepër i kënaqur që mundi aqë lehtë të pajtohet me hasmin e tij dhe jo vetëm që e fali, por i premtoi se do t'i a kthente pasurin e do të dërgonte shërbëtorët e mjekun e tij për t'a shëkuar.

Si u-përsëndet pastaj me të, mbreti dolli jasht, që të piqet me asqitiun. Para se t'i lënte shëndet' deshi që për herë të fundit t'i lutej t'i përgjigjej në tri pyetjet q'i bëri.

Asqitiu ishte jasht duke ecur mbë gjunjë pranë gropavet dhe duke mbjellur farra zarzavatësh,

Mbreti i erdhi afër e tha:

— Të lutem për herë të fundit o plak i urt, të më përgjigjesh për çka të kam pyetur.

— Ti përgjegjen e more, tha asqitiu, duke u-mbështetur në gjunjë dhe duke vështruar që posht mbretin, i cili po rrinte në këmbë para atij

— Ç'përgjegje morra? pyeti me habi mbreti.

— Ja, shtoi, asqitiu. Në rast se ty dje s'do të vinte keq për dobësin t'ime e nuk do të punonje për mua, por do të ktheheshe i vetëm, ay trim do të qe hedhur përsipër dhe ti do të pendoheshe që s'ndenje me mua.

Domethënë se koha më e përshtatëshme ka qen' ajo kur t'i punonje tokën, dhe njeriu m'i nevojshëm kam qenë unë dhe puna më e rëndësi ka qenë mirësia që më ke bërë mua. Pastaj kur ay ka ardhur te në, koha m'e përshtatëshme ka qenë ajo, kur t'i u-përkujdesë për t'ë, se po të mos i a kishe lidhur plagën, ay do të vdiste pa u-pajtuar me ty. Domethënë se njeriu më me nevojë ka qenë ay, dhe ajo çka i ke bërë ti atij, ka qenë puna më e mirë.

Ashtu pra mba-e mirë mënt, që koha më e përshtatëshme është: e *tashmja*; dhe është këjo pse vetëm brënda kësaj ne jemi të zotë të vet vetës. Dhe njeriu m'i nevojshëm është ay me të cilin u-takuam në *të tashmën*, sepse asnjë nuk munt t'a dijë në do të munt të takohet me ndonjë tjetër; dhe puna më me rëndësi është *të bësh mirë me një herë*, sepse vetëm për këtë ka ardhur njeriu në botë.

E përktheu D.

MENDIME T'ARTA

Është e vërtetë se çdo ligësi e shëmton dhe e prish karakterin e njeriut; po egoizma dhe kryelartësija janë helmi m'i fortë, q'arrin gjer në themelet e qënjes s'onë, helmon shpirtin nga rënja dhe e çkatëron krejt njerinë.

Fjalor i vogël i Dhjatës së Re

Kur njeriu këndon Dhjatën e Re, në çdo hap takon emra, që tregojnë institute të ndryshme fetarë, politikë e shoqërorë si edhe vënde të ndryshme të kohës së veprimtaris mesianike të Shpëtimtarit. Për t'i ardhur pra në ndihmë këndonjësit që të kuptojë më mirë përmbajtjen e Dhjatës së Re, do të botojmë në çdo numër të kësaj reviste nga një pjesë të këtyre emrave me shpjegimet e tyre përkatëse, natyrisht në mënyrë të shkurtër e pas radhës alfabetike.

ABA ose **AVA**, që rrjeth nga fjala *ab* (at). Në kohë të Shpëtimtarit shqyptohet *aba* ose *ava* dhe gjëndet në Dhjatën e Re te *Marku* 14, 36; te *Romanët* 8, 15 dhe te *Galatianët* 4—6, si emër i dhënë Perëndis.

ABILENA. — Ka qënë një krahinë e vogël ose tetrahinë (Lluk. 3, 1), me kryeqytet *Abila*. Në kohë të Tiberit qeverisej prej tetrarhut Lisaniás. Gërmadhat, që janë edhe sot (Sukuadi-Barada), tregojnë vëndin e kryeqytetit *Abila*, në një distrikt, që laget nga Barada, n'anën lindore të Anti-Libanit, nërmjet Heliopolis-it (Baalbek) e Damask-ut, 30 km në veri-perëndim të Damask-ut.

AHAIA. — Ky emër, para pushtimit romak, tregonte një krahinë në veri të Pelopenesit, gjat gjirit të Korinthit. Pas pushtimit të sipërpërmendur emri Ahaia i u dha Pelopenesit, Greqis qëndrore dhe ishujvet t'afërmë. Me këtë kuptim të fundit, emri Ahaia përmëndet nga autori i veprave të Apostojvet dhe nga Ap. Pavli (*Vep. Ap.* 18; 12, 27;

19, 21; *Rom.* 15, 26; *I. Korinth.* 16, 15; *II. Korinth.* 1, 1; 9, 2; 11, 10; *I. Thesas.* 1, 7, 8). Pas atyreve, e tërë toka e Greqis europaike ndahej në dy pjesë: *Ahaia* e *Maqedhonia*. Kra-hina romake Ahaia ka qënë me radhë, perandorakë e sena-torjale. Kur Ap. Pavli vajti atje, në udhëtimin e tij misi-onar të dyt, këjo krahinë ishte senatorjale dhe kishte në krye një prokonsull (anthipatos), që quhej Galion, vlla i Senekës.

Pas një mbishkrimi q'u-gjent në Delfi, Ap. Pavli ka qē-në qitur para gjykatores së Galion-it më 52 p. Kr. (*Revue Biblique*, 1933, f. 36), Nga qytetet e Ahaisë, Dhjata e Ré për-mient *Athinën*, (*Vep. Ap.* 17, 16), *Korinthin*, vëndi ku rrinte prokonsulli (*Vep. Ap.* 18, 1) dhe *Qenhrën*, skelën lindore të Korinthit (*V. A.* 18, 18; *Rom.* 16, 1).

ANA ose **HANAN**. —Ka qen' i bir' i Sit-it. Kish marë gradën më të lartë të priftërisë në kohën e Qyrin-it, dele-gat perandorak në Syri dhe në vitin 6 ose 7 të erës së krishtere. Ndonëse në vitin 15 e në fillim të mbretërimit të Tiber-it, qe hequr nga prokuratori Valerius Gratus, populli e nderonte shumë, duke e quajur të gjithë kryepriift, dhe këshillohej me 'të për çështje të mëdha. Që të pesë bijt e tij kanë hypur njeri pas tjetrit n'atë grad të lartë. Në kohën e prokuratorëvet romakë, krerët e kishës Judhaike ndëro-heshin shumë shpesh; me gjith këtë kryepriifti plak Ana gëzonte autoritet të math duke udhëhequr të tërë këshillën priftërore. Kajafa, dhëndër'i tij, s'ishte gjë tjetër veç se një vegël në duart e tij; kështu që, përgjegjësia më e madhe për dënimin e Zotit t'onë Jisu Krishti duhet të bie, pa dy-shim, përmbi Anën. Të gjithë djemtë e tij kanë qënë ndjekës të zjartë të krishterimit. Më i vogëli i cili quhej po Ana, vuri e vranë Apost. Jakobin, vëllan e Zotit.

ANTIOHIA. — Dy qytete përmenden shpesh herë në veprat e Apostojvet po me këtë emër: Antiohia e Pisidisë dhe Antiohia e Sirisë.

1. *Antohia e Pisidisë* osë më mirë *afër me Pisidinë* pas shprehjes së Strabon-it (12, 8, 14), ishte në Frigjinë Galati-ane. Këjo pjesë e Frigjisë që mvarrej nga Galatia romake, me që ishte afër Pisidisë, u-përpi pak-nga-pak prej kësaj;

prandaj dhe u-quajt Antiohia e Pisidisë. Ky qytet, pas Strabon-it, qe ndërtuar n'anën veriore të malevet që ndajnë Frigjin Asiatike nga Pisidia. S'kanë mbetur prej asajë veç se pak gërmadha 3 km nga *Ialobaci*, një fshat i vogël në rrzë të *Sultan Dag-ut*. Ishte një koloni romake ku gjin-deshin shum Ebrenj. Ungjilltari Lluka tregon me hollësi-
ra si hyri në krishterim ky qytet prej Ap. Pavlit dhe Var-
navës. (Vepr. Ap. 13, 14-15 dhe 14, 20-22; shih dhe II Tim. 3, 11).

2. *Antiohija e Sirisë*, kryeqytet i krahinës romake të Si-
risë, ishte një qytet i math, 15 km anës s'Orontit. Nërmjet
murevet e sajë, të lartë 25 metro e të gjërë 6, përfshinte një
popullsi prej afro 500.000 banorësh, sirianë, ebrenj, grekër,
e romakë. Ishte pothuaj si kryeqendër i Lindjes romake.
Kur plasën ndjekjet në Jerusalem kundër të krishterëvet
dhe pas vrasjes së kryedhjakon Stefan-it, nxënësit e Zotit
erdhën në Antiohië ku kanë lëçitur dhe Ungjillin (Vepr.
Ap. 11. 19).

Që këtej u-nis predikimi i Ungjillit dhe nër paganët;
shumë të kthyer prej kombesh e gjuhërash të ndryshmë,
që të mos përziheshin me ebrenjt, muarnë emrin: të kri-
shterë (Vep. Ap. 11, 26). Ky qytet, nga shkakut i pozitës së
tij dhe i karakterit kosmopolit të popullatës, ka qënë e
para qëndër për kthimin në krishterim të paganëve; *ka
qënë pikë-nisja e udhëtimevet misionare t'Apost. Pavlit*. (Vepr.
Ap. 11, 19, 28; 13, 1; 14, 26; 15, 36; 18, 22; Galat. 2, 11).
N'Antiohi rrinte pretor-i m'i math i krahinës perandorake të
Sirisë; prej atij varej dhe qeveritari i Judhesë.

ARIMATHIA. — Pas disa historianëve të kohës së re,
ky qytet — për të cilin ungjilltari Lluka (23, 51), thotë se
do të jetë ndonjë qytet në Judhë, — është po ay me *Rama-
taim-Sofim*, vënt i Samuelit, pranë malit Efraim, pozita e
të çilit shihet edhe sot mbi një kodër pitoreske në veri-pe-
rëndim të Jerusalemit, *Nebi Samuel*. — Të tjerët pëlqejnë
pikpamjen e autorëve të vjetër që Arimathia është një me
Ramleh-un e sotçëm, qytet me 3.000 frymë, i vendosur në
fushën Saron, 3 km. në jug të Lida-s (ose Diospolis) dhe

tetë orë në këmbë nga Jerusalemi. Por Ramleh-u, pas Abulfeda-s, është qytet pothuaj i ri dhe se nuk ekziston asnjë lidhje nërmjet *Ramleh-at* që do të thotë “rërë” dhe *Ramah-at ose Romata-s* që do të thotë “lartësirë”. Më mirë është që Arimathia të identifikohet me *Rentis-in*, vënt që ndodhet nja 3 levgje në veri-lindje të Lida-s. Në kohën e Euseb-it, Arimathia quhej *Remfis* ose *Remtis* (shih *Vigouroux. Dict. biblic. t. I. kol. 960*).

ASIA — Dhjata e Rë nuk tregon me këtë emër atë që kuptojmë neve sot, po vetëm krahinën romake të Asisë. Ajo përfshinte: Eolidën, Lidinë, Joninë, Karinë, Misinë, gjer te mali Olimp edhe një pjesë të Frigjisë. Këjo krahinë i qe lënë Senatit romak në pjesëtimin e vitit 27 para Kr. Qeverisej prej një prokonsulli që kishte të ndënjurit në Efes. Të shtat Kishat që përmenden në Zbulesë (1-3) janë qytetet më me rëndësi të kësaj krahine. Me këtë provohej që me fjalën «Asi» kuptohej vetëm krahina romake me kufit e saj zyrtarë. (Apok. 1, 4). Ungjilltari Lluka me fjalën «Asi» kupton një krahinë të ngushtë rreth e përqark Efesit duke e dalluar nga Frigjia e nga Misia (vepr. Apos. 16, 6). Esht ajo krahinë që Eunop-i (edit. Didot f. 466-467) e quan «Asia e përqarq Efesit». Si duket edhe Ap. Pavli, po me këtë kuptim e mer emrin «Asi» (I. Korinht. 16, 19; II. korinht, 1, 3; II. Tim. 1, 15).

ASIA E VOGËL. — Edhe ky emër në Dhjatën e Rë ka tjetër kuptim nga ay i sotçmi. Vëndet ose krahinat që formonin Asin e Vogël përmenden në Dhjatën e Rë me emrin e tyre të veçant: Asia, Bitinia, Galatia, Pamfilia, Kapadokia etj.

Le të përgatitemi për LINDJEN E KRISHTIT

Jovani i vogël vinte gjithmonë në shkollë, dhe nga gjith mësimet i pëlqente studim'i fesë. Kishte lexuar Lindjen e Iisu Krishtit dhe vizitën q' i kishin bërë magët. Kish dhe tre javë akome dhe afrohej festa e Krisht-Lindjeve.

Një ditë kur Jovani u kthye nga shkolla, pa gjyshin e tij që kish dalë ne porta dhe po ngrohej nën rezet e Djellit. Ju afrua pranë; i tha mirdita, e puthi në dorë, pastaj si shpuri librat në dhomën e tij, erdhi përsëri pranë gjyshit dhe me frymë vogëlsore e pyeti: «Babi».

—Fol' o shpirt.

—Do të përgatitemi për të pritur Jisu Krishtin ?

—Si të përgatitemi o bir? Do të vemi në Kishë dhe t'a presim.

—Po magët pse vajtën e i shpunë dhurata të çmuara, ar, livan e smirnë ?

—A o bir, po Ay ahere u-lind në grazhd dhe ata vajtën t'a shohin dhe t'i falen, kurse në sot bëjmë kujtimin e Tij dhe vemi t'i falemi me bes'e shpresë që të n'a falë mëkatat.

—Ah! Jo, o babi, Iisu Krishti nuk pritet vetëm me vajtje në Kishë e me falje, po Iisu Krishti pritet.....

—He: Pa më thuaj o bir si pritet Iisu Krishti ?

—Unë kam kënduar se Iisu Krishti thotë: «çdo që juve u-bëni atyre që vuajnë dijeni se m'a kini bërë mua». Pra, o babi, n'atë kohë magët e pritnë Iisu Krishtin dyke i shpënë dhurata, kështu dhe ne sot le t'u apëm atyre që s'kanë, që t'a presim Iisu Krishtin tue vajtur të gjithë në Kishë, të veshur e të gëzuar, dhe me shpresë shpëtimi.

—Po çfarë t'u-apëm o bir? ç'thua ti ?

—Unë o babi kam dy palë roba, prej të cilave njerën palë t'ja japim Kolit, j cili vjen i grisur në shkollë, dhe njerën palë t'a mbaj për vehte. Pastaj o gjysh ditën e Krisht-Lindjeve unë do të vete t'a mar Kolin në shtëpi, dhe bashkë me të do të vete në Kishë për të pritur Iisu Krishtin.

Gjyshi rrëmbeu Jovan e vogël në krahët, e puthi, qavi nga mallëngjimi dhe i tha: «Të lumtur prindërit që të kan' o bir, le të bëhet pas dëshirës s'atë». Pastaj hyri në shtëpi bashkë me të për t'u-treguar prindërve të tij, dhe t'i plotësonin dëshirën.

*
*
*

Ja një shembëll prekëse dalë nga mëndja e një fëmije të vogël! Ja një vepër e Krishtere që plotësisht vërteton fjalët e Iisu Krishtit që thotë: «Le të vegjëlve është Mbretëri e Perëndisë»?

Por në o vllëzër nuk do t'a presim shpëtimtarin? Nuk do të vemi me duar plot për të parë Lindjen e Tij? Nuk do të vemi t'i falemi dhe t'i themi me zëmër të gëzuar: Ja 'o zot! erdhëm të shohim Lindjen t'Ënde! Erdhëm të të sjellim dhuratën t'onë! Njeri dha roba të ay që ishte i grisur, tjetri dha të holla të ay që s'kishte e nuk mundte të ndërte dorën për të kërkuar passi më parë kishte qënë në gjëndje të mirë; një tjetër dërgoj bukë n'ata që s'kishin dhe vuanin nga urija, dhe një tjetër, vizitoj, ngushëlloj dhe përdëlleu të hidhëruarit e të sëmurët.

Me të tillà vepra pritët shpëtimtari. Me të tillà do të mundemi të ndjejmë gëzimin në shpirtet t'ona, në çastin kur lindet Iisu Krishti. Mjafton dhe një fjalë mirë do të n'a gëzojë zemrën për të marë pjesë bashkë me magët në pritjen e Shpëtimtarit. I cili ka për t'ju dhuruar shpëtim të përjetshëm në jetën Qiellore pranë Atit Tija.

Pra është koha që tani, të shohim ata që kanë nevojë dhe vuajnë për ndihmën t'onë, dhe le t'u-bëjmë atë që është e Perëndisë me dhurata të fshehta, sikundër thotë dhe vehtë Iisu Krishti: «le të mos shohë e djathta juaj se çbën e majta juaj».

Është e njejtë dhurata e magëve, që i shpunë Iisu Krishtit në grazhdinë e Vithleemit me atë që çdo i Krishter do të preferojë të bëjë n'ata që kanë nevojë e që vuajnë, dhe sigurisht të tillët të Krishter do të gjejnë Hir pa-

ra Zotit në ditën e Lindjes së Tija, dhe gëzimi ka për të qënë m'i math se kurdoherë.

Yrysh o vllëzër në këtë vepër njeri-dashëse që pregatitet për ditën e Lindjes së Iisu Krishtit, dhe Perëndija le t'u jetë ngushëllimtar e ndihmës. AMIN.

I penduari

Librat e reja fetare për shkollat illore

Duallnë prej shtypit 4 libra të reja fetare për mësimin e besimit në shkollat fillore, të përpiluara prej H. Tij Episkopit Im. Irinë Banushit dhe t'aprovuara prej Kryesisë së Kishës e prej Ministris s'Arimit si tekste shkollore.

Libri i parë, i destinuar për klasën e dytë, përmban lutje të shkurtëra që thuhën në fillim e në mbarim të mësimit, mësimë në mënyrë të thjeshtë, pas kuptimit të fëmijëve, nga jeta e Zotit t'onë Jisu Krisht si dhe jetën e dy shenjtorëve të mëdhenj të Kishës: të Shën—Gjergjit e të Shën—Mitrit. *Kushton 1 Fr. Shq. copa.*

Libri i dytë, i destinuar për klasën e tretë, përmban shpjegimin shkurtimisht të lutjes së Zotit: «Ati ynë», lutjet e Pashkës së Madhe e të Shën-Mëris dhe mësimë mbi të kremtet e mëdha të Kishës s'onë. *Kushton 1 Fr. Shq. copa.*

Libri i tretë i destinuar për klasën e katërtë, përmban historinë e Dhjatës së Vjetër e të Dhjatës së Re. *Kushton 1.50 Fr. Shq. copa.*

Libri i katërt, i destinuar për klasën e pestë, përmban shpjegimin e Ligjëratës së Zotit në mal, paravollit e mrekullit e Shpëtimtarit, formimin e Kishës së parë të Krishtere, ndjekjet që ajo pësoi, triumfin e saj në kohë të Shën-Kostandinit e të Shën-Elenës si edhe shpjegimin e Simbolit të besës që shkurtimisht përmban tërë doktrinën e Krishtere Orthodhokse. Në mbarim të librit janë shtuar përgjegjet e Meshës së Hyjnuarshme si edhe përlëshoret e të kremtevet më me rëndësi të Kishës që do t'i vlejné mësonjësit për orët e këngës kishtarë. *Kushton 1.50 Fr. Shq. copa.*

Të tri librat e para, përveç lëndës q'u-përmënd më sipër, janë pajisur e me figura të ndryshme, q'i bëjnë vërtet tërheqëse. Janë shtypur në shtëpinë botonjëse «Kristo Luarasi».

RRËFENJË

Krisht-lindje me dëborë

I mbaj mënt këto Krisht-lindje sikur të jenë tani! Ishin Krisht-lindjet e para që do të kalonja larg kryeqytetit dhe këjo s'më pëlqente dhe aqë. Festa, ditë të mëdha, or vlla, e të gjëndesh në malsi. . . . Po ç'të bësh. Kështu e ka njëriu kur është nëpunës.

S'qesh njeri saloni, as nga ata që dridhen kur dëgjojnë në fjalën «të ngrirët — në kryeqytet bile isham antar në një shoqëri ekskursioni. Po Dhjetori i malsis më bënte ta dërgoj për ava dashurin që ndjenja për natyrën. S'ishite shaka atje sipër ku ndodheshim.

Na kishin dërguar, mua edhe tre të tjerë, një mekanik, Aleko Kamvisin, Pavlo Janidhin, e një shef seksioni, Petro Paladhaqin, për një inspektim në punimet idraulike. S' isham i kënaqur nga shoqëria që kisha: përkundrazi. Bënim një parë me nam, Me Pavlo Janidhin njiheshim që nga universiteti. Ishim të dy një moshe dhe kishim po ato guste. Kamvisi, edhe ay njeri i njohur nga kryeqyteti. Paladhaqi ishte, sigurisht, m'i math nga mosha se ne, i kish kaluar të tridhjet e pesat, qëndronte pak si më larg, si shef seksioni, njeri serioz, por, si zemërbardhë që ishte, i përshtatesh pa zor parës s'onë. Pastaj, njeri i that fare s'qe as një nga ne; të gjithë dilnim dhe pak jasht rrethit të punëvev t'ona, pak a shumë mirëshim e me lëvizjen mëndore. Pavli bile shkruante dhe vargje — këtij i a detyrojmë që tani n'agim, kur ende është natë, natë Krisht-lindjesh, të veshur me robet e lashta e me jakat e ngritur, ecin njeri mbas tjetrit, në dëborë, dyke shke-

lur me kujdes mbi gjurmat që kanë lënë këpucët e trasha të katundarit të parë që çeli udhën për në Kishë.

Na i çau veshët ky Pavlë, për të na bindur të ngriheshim që më natë e të mirrnim një orë udhë për të shijuar «Krisht-lindjet e kulluara të stanit» si na thoshte: «S'duhet t'a humbasim këtë rast, lypset të shkojmë në një fshat malsor që të na dehet syri nga bukuria e kostumevet të çuditëshme të katundarëvet. Në kryeqytet, për një a dy kostume artificiale prishim botën, shkojmë në ekspozitë, dhe tani këtu që jemi dy hapa larg panairit, dy hapa prej shfaqjes së pastër të katundarëvet, prej Krisht lindjes brënda në stanet, të rrijmë me duart kryq? E t'i humbasim të gjitha këto për një a dy orë gjum! S'është turp?»...

Eshtë e vërtetë që Pavli me fjalët e tij na kish sjellur ndërmend gjithëka kishim kënduar si fëmij për «Krisht-lindjet në katund» e kështu na u-lind dëshira t'a jetojmë rrëfenjen e Krisht-lindjevet me dëborë, bashkë me katundarët e me haivitetin e tyre. Këjo histori kishte në vet-vetëhe mjaft poezi dhe do të kishim kështu shumë gjëra të bukura t'u rëfejme shokëvet e njerëzvet tonë, kur të ktheheshim në kryeqytet.

Edhe ja, pra, tek ecim pa nxjer zë nga goja, njëri pas tjetrit. E vetmja gjë që dëgjohejt është të kërciturit e çuditëshëm që bën posht këmbëvet t'ona dëborë q'ish bërë si kristal.

Tani po i lemë shtëpit e fundit të fshatit e ngjitemi në majë të një kodre të vogël për të shkruar të «Zoti Krisht», në kishën që sot festonte. Njeri s'takojmë para nesh. Shënjë këjo që tregon, se jemi të vonuar. Katundi i tërë do të jetë ngjitur atje sipër.

As një nga ne nuk flet, bile dhe Alekua nuk tregon ndonjë nga shakat e tij të zakonëshme. Për ne q'e njihnim, ishte gjë e çuditëshme.

Marja e fyromës, sa po ngjiteshim, bëhej më e dendur. Në mes të kesaj qetësije më duket sikur dëgjoj melodinë e njohur të një kënge të Krisht-lindjes. Po s'është gjë..., kështu m'u duk... ndoshta pse e këndonja vet brënda në shpirt atë melodi.

Passi edhe era ishte prerë, dëgjojmë me lehtësi edhe zërat e largëta të lopëvet. Kthehet njeri dhe shikon tjetrin. Qëndrojmë për një moment dhe prapë pa folur gjë shkojmë përpara. Pas pakë dëgjojmë tinguj zilesh.

Pavli kish mbetur pakë më pas. Kish haruar ku ndodhej. Alekua deshi t'a thëresë, por e lë — i vjen ndërmënt se është poet.

Dua të çfaq me ndonjë mënyrë atë që ndjej në shpirt, më vijnë nër mënt njëmij e një vargje. Dhe me gjith kë-të s'guxoj t'i shpreh. E mbyll gojën dhe hesht. Pse? Pas pak ndjej si për shpëtim ca psalmodhira, dalloj ca zëra të holla fëmijsh. Mar frymë nga thellësia e zemrës. Mendja tani më shkon në kostumet e katundarëvet. Do të jenë aqë të bukura, siç na thosh Pavli?

Zërat tani po forcohen, të psalurat dëgjohen më mirë. Kisha është plot me drita. E tani që hyjmë n'oborr e çlodhemi pak nga të ngjiturit, shohim se ajo është mjaft e madhe. I tërë katundi ndodhet këtu brënda. Katundarët dëgjojnë me vëmëndje; psaltët i ka zëvendësuar një kor prej fëmijsh.

Pa e ditur pse, muzikën kishëtare nuk e pëlqenja dhe aqë. Po këtë moment, gustet e mija kishin ndryshuar. Si duket, vëndi... udha... paramendimi, më kishin influencuar. Më bënë t'i kqyr të gjitha krejt ndryshe. Vë re fjalët e troparit e i gjej të bukura. S'më shkon mëndja andej-këtej si herë të tjera. Por edhe të tjerët qëndrojnë me vëmëndje. Si duket ambienti ka bërë punën e tij shumë mirë. Pa shiko! zoti Aleks, me ç'shpresë që qëndron! Ku e ka përcjellur ftohtësin e tij të përparëshme për Kishën?

Më vjen në buzë një nënqeshje. Mëndoj se çdo të na thotë nesër, kur do të dojë të arsyetohet: «për shkaqe të një psikologjie të përbashkët, u-influencova, zotërinj. As gjë për t'u-çuditur, u-influencova».

Vërtet, asnjë nuk shikon kostumet e veshjet. Dehja sentimentale kish shkuar shëtitje. Ajo që na tërhoqi më tepër tani, është qëndrimi i katundarëvet. Ç'pamje që të kanë këta njerës të thjeshtë!

Gjithsejçili përbën një fytyrë me vete. Të tërë marrin pjesë në kremtim. Në çdo tropar që këndohet, fytyra e tyre lëshon shkëndira nga kënaqësia, mbushet me gëzim. Plot gjalleri janë këta njerës.

Në një minut dëgjoj Paladhaqin t'i thotë nga-dale Pavlit:

— Për herë të parë po mar pjesë me aq dëshirë në Meshë. . .

Poeti i ynë buzëqesh triumfalisht. A nuk i a detyrojmë atij që kemi ardhur këtu sipër? Pa pritur e shoh të vrehet. Pse? Një po pregatitet të predikojë dhe i preu shijimin sentimental: Oh të shkretën, tani gjeti dhe ky të mbajë fjalim!

Ay që do të mbante fjalim s'është prifti. Është një i ri 30-32 vjeç, pak i dobët. Nisi të flasë me zë të ulët, thjesht e qet. Gjeste nuk bën dhe fjalimi tij s'ka forma retorike. Filloi të më hyjë edhe ky në zemër. Shkoj pak nga e djathta për t'a parë më mirë. Dalloj një fytyrë të qetë e t'ëmbël. Ato që thotë janë me plot kuptim. Dhe fshatarët e dëgjojnë me vëmëndje, me syt të mbërthyer sipër atij.

Po shoh se edhe miqt e mi po kështu bëjnë! Ay njeri e di mënyrën t'imponohet. Duket se është me kulturë. Shprehjet e tij, të lidhura bukur, tregojnë një shpirt me një botë të tijen mjaft të pasur. Flet në mënyrë naturale. Paraqet tani madhështin e Lindjes së Zotit. Siç flet me siguri, të jep të kuptosh se ky njeri do të ketë për ditë Krishtlindje. Pastaj flet për Vitheleemin. As një përshkrim poetik për shpellën ose për grazhdin! I njeh mirë dëgjonjësit. Barinjvet t'u flasë për stane e për zile? Por edhe tani që flet për magët, as për devera flet, as për veshjet anadolake. Shih për ç'flet! Për dëshirën e tyre që të gjejnë të vërtetën. Që nga u-nisnë ata njerës të ditur t'asaj kohe. Dhe të diturit e sotëm ç'bëjnë? Sa larg qëndrojnë nga magët!

Ky është ankimi i tij. E thekson thjesht, si fëmi, dhe katundarët e mirë e vështrojnë në syt. Një fraz' e tij më tingëllon edhe në vesh: «Ç'ta bëj unë dijën kur nuk më ndihmon të gjëj gëzimin edhe kur më lë hapësirën e mëkatit të paplotësuar?» A; këto sigurisht i thot për neve-

bre qerataj! Këtu pas, që jemi ne, ku na vuri re? Mirë-
o, të kanë një sy këta katundarët!

Shikoj me bishtin e syrit miqt e mi. Të tërë qëndrojtë në majë të këmbëvet për t'a vënë re më mirë! Morë bravo. Ay u a heth, edhe ata e dëgjojnë me kujdes?

Po është e vërtetë që ky njeri ka një diçka që e bën ë dashur. Por edhe fjalët e tij të venë në njëmij mendine. E dëgjoj pa rezervë.

Ndërkaq po humb mentërisht dhe unë. Më vijnë në ru shumë gjëra. S'interesohej për asnjë nga ata që më inë pranë. Mëndja ime kthehet pas, në kohët kur isha ëmi. Ç'kohë të lumtura. Krisht-lindjet në shtëpi, festat, në a ime, vëllezërit e mi. Ç'kujtime të vjetra!... I humbur është në mendimet e mia, s'kuptova kur morri fund pre-
ikimi. Po pse të mbarojë aqë shpejt?

..... Tani vë re një skenë të bukur: Një prift, i lart i mbushur, zotni i vërtet, një prift si ata të biblës me ajekër të bardhë, qëndron te Dera e Bukur e kungon ka-
undarët. Skenë prekëse. Një, një besnikët shkojnë përpara, gjiten nëpër shkallët dhe kungohen. Fëmijt psalin: «Në arkën t'ënde mystike mer-më sot pjesëtar o i bir i Pe-
ëndis. . . .»

Për një moment mëndja më shkon në kryeqytet. Më jen nër mënt zhurma dhe e keqja që bëhet në raste e ë ditë të këtilla. Ndeshje të tëra! Ç'ndryshim këtu në ka-
und! Me ç'edukatë sillen katundarët! Të tëra këtu brënda ëhen me rregull; të gjithë, fëmijët, epitropët, katundarët ëvizin sikur t'i ketë mësuar ndonjë njeri.

Sigurisht, do të jenë këshillat e mikut t'onë që foli ak më parë. Shumë gjëra të mira i detyrohen atij njeriu ë gjall.

Të lumt ore Pavl, që na solle këtu dhe ndjemë Krisht-
indje me të vërtet!

* * *

Kur duallmë nga Kisha, ishte bërë po thuaj ditë. Një itë për bukuri. Qielli, krejt i kaltërt. Majat e malëvet për-
ark, krejt të bardha. Të çlodhet syri.

Katundi shtrihet para nesh krejt i bardh. Të tëra janë të bardha. Sot kuptova pse e bardha është ngjyra e qashtëris dhe për herë të parë u dhash të drejt atyre shkrimtarëve që i lypin, qoft edhe me zor, Krisht-lindjet me dëborë.

Miqt e mi s'e venë re dhe aqë këtë bukuri të vëndit. Ata po fjalosen për Meshën e për predikonjësin. Surpriz' e vërtetë. Shumë komente për fjalimin e tij. Pavli thotë: «këngë më të bukur për Krisht-lindjen s'ka dëgjuar». Paladhaqi shton: «Duhet që ky i ri të vijë në kryeqytet të edukohet. Këtu ka për të shkuar kot, kurse atje mund të bëhet një personalitet kishtar. Duhet t'interesohej për këtë». Dhe Pavli kur dëgjon atë «duhet t'interesohej», tund kryet.

Mua më bënte përshtypje gjallëria e atij njeriu, dhe, të them të vërtetën, më prekte. Mendoj sa lart qëndron ky njeri prej disave nga ne.

Mendimet e mija i ndërpreu «mir-mëngjesi» i kryeplakut dhe i paris së fshatit, që, si njerës të edukuar, erdhën të na urojnë mir-s'ardhjen. Ishte pastaj dhe koha që t'i japim fund mendimevet e fjalëvet: katundarët si dalin nga Kisha, paraqesin me të vërtet një pamje të mrekulluarshme. Shijojmë bukurin e veshjevet.

Ja dhe fëmijet e shkollës: të tërë të veshur bukur e plot gëzim. Bashkë me ata është dhe i riu që predikoi.

A! qënka mësuesi i fshatit.

E vështrajmë me kënaqësi. Na kuptoi. Diçka u thot fëmijvet e pastaj vjen nga ana e jonë. Z. shefi pregatitet t'a përgëzojë për predikimin. Bile bëri edhe planin si t'i thotë, mirpo i zihet fyti pak. Çudi, ky që në raste të këtilla gjithmon oratoron!

Mësuesi na afrohet. Qëndron karshi meje e me buzët në gas më thotë:

— Jorgj, nuk më njeh?

E vështraj mirë-mirë.

— Jam Toni Marini

— Toni Marini? E pamundur...

Toni Marini, bashkënxënës'i im i vjetër, shoku i fëmijëris. Marini atheisti. . . . Sa ka ndryshuar!

— Ti Toni? Predikonjës ti?

— Nuk të shkonte ndonjë herë nër mënt? . . . Je i pari nga të njojturit që po shoh pas ndryshimit t'im.

Miq e mi s'kuptojnë as gjë nga këjo frazë. Mirë po mua, m'a zgjidhi misterin. Mrekullinë thoni, sepse për mua ishte mrekulli që Marini të bëhet predikonjës. E njihnja që kur ishim fëmij. Shtëpit t'ona në një rrugë. Në shkollë rrinim në një bankë. N'universitet u-ndamë. Ay u-shkrua në mjekësi. Xhaxhaj i tij q'e studjonte, deshte t'a bëjë mjek që pastaj t'a dërgonte në Evropë për të studjuar anthropologji. Këjo ishte ëndëra e të dyvet. Vetëm që s'u-përmbush. Marini n'universitet s'nxorri gjë në shesh. Gjithënjë e shihnja n'oborr me ca shokë të çuditëshmë që i a ngritën mëndjen. Gjithënjë bisedime e fjalime. E gjithënjë po për ato gjëra: materjalizmë, evolucionismë e të tjera të këtij lloji.

Pastaj duket se u-trazua e me ca shoqëria të këqija. Mësimet i la me njanë. Shpënzoi dhe shumë të holla—xhaxhaj në fillim i dërgonte mjaft. I a kufizoi pastaj, po ishte vonë. Toni ishte mësuar të prishte pará. Filloi të shiste librat që kishte, shpenzonte të hollat q'i dërgonin për regjistrimin n'universitet. Në fund nisi të bëjë e ca batakshillëke të vogla. Babaj i tij, kur i mësoi të gjitha këto, i a mbyllli derën e shtëpis. Atëherë e hodhi dhe ay jasht fare. Luante kartëra dhe gdhihej andej e këtej. Kështu edhe xhaxhaj, pa ç'pa e u dha fund ëndërave të tij për anthropologjira dhe Evropa. Pak kohë më vonë, vdiq dhe plaku me dhimbjen e djalit në buzët. Dhe pas kësaj vdekjeje, Toni u-çduk krejt.

. . . . Dhe ja tani, ishte përpara meje, personi që i falte rythmin tër asaj klase, asaj njerëzije. Këto të dy fytyra, Marini i vjetër dhe predikonjësi i sotçëm, ishte e pamundur të qëndronin dhe në mëndjen t'ime njera afër tjetrës. I till kundërshtim eksistonte në mes të dy fytyrave.

Po atë ditë, në shtëpin e Marinit, pas drekës së Krisht-Lindjes, desha të mësoj si e pësoi këtë çvillim jeta e mi-

kut tim. Më tha që s'ishte predikonjës. Qe emëruar mësonjës në fshat me që ideja e mjekësis kish dështuar. Në Kishë fliste, pse e quante për detyrë «që të mos e fshihte dritën q'i ishte zbuluar».

Mirëpo me kaq nuk u-kënaqa. Desha të mësoj shkakun e ndryshimit të tij më të thellë. Dëgjova atëhere prej gojës së tij vazhdimin e historis, historin e një shpirti të rahur prej shumë dallgash. Siç më tha ay vet—e mbaj mënt akoma të ulur karshi meje, me atë vështrim t'ëmbël por të qëndruashëm—ishte një histori e zakonëshme; edhe të tjerë munt të tregonin historira të këtilla: Kish provuar tërë ftohtësin e një je e që nuk vështronte kurrë hapësirat e lira të qiellit edhe s'lënte shpirtin të marë fyromë. E ka rahur çdo lloj ere e çdo lloj furtune. Deri sa një herë, me zemrën të mbushur nga këjo ftohtësi, u-gjënt para luadhit të një jete të Krishtere. Në kohën d.m.th. kur ish në gjendje të mirë e bënte një jetë qefi (kishte atëhere një punë të mirë e fitonte shumë të hoila) njoiti një fshatar plak shpresëtar. Edhe ay, njeriu me kulturë, njeriu që «e gëzonte jetën», u-prek nga dija e thjeshtë por e thellë e plot me kuptim të plakut fetar, si edhe nga jeta e qëndruarshme e tij që i a mbante zemrën, edhe tani që kish mbushur të tetdhjetat, të freskët e të palodhur si të fëmisë.

Ishte një mrekulli, tha. Në gjëndjen t'imë janë aq' e aqë të tjerë. Nuk u mungon atyre as rasti që të njohin të vërtetën e jetën e Krishtere. E me gjith këtë nuk kthehen.... Edhe un vet s'e mar vesh dot këtë ndryshim. Esht një mrekulli.

E veshtrova prapë, ashtu siç rrinte karshi meje. Çpërdante rreth tij një erë imponimi. Fuqi përmes ëmbëlsisë. Më erdhi nër mënt dhe Marini i vjetër.

Po..... ishte një mrekulli.

T. P.

PËRSHTYPJE DHE MENDIME

«Edhe mbi dhenë paqe»

Në veshët e atyreve që s'besojnë hymni ëngjëllor që u këndua ditën e Lindjes së Shpëtimtarit do të tingëllojë më tepër si ironi se sa si një lajm i një realiteti të shumë dëshiruar. Mirëpo, për besnikët paqja mbi dhë që u lajmërua prej ëngjëjvet ishte është e do të jetë një fakt i pa tundur siç ka qënë e është për ta lufta edhe para çpalljes së saj zyrtare. Sepse paqja mbretëron ndërmjet besimtarëve dhe në zemrat e tyre që kur kryetari i paqes e pajtoi njeriun me Perëndinë dhe rrëzoi mesmurin e armiqësisë. Dhe lufta ekzistonte edhe para se të kriste topi edhe para se të pëlçiste rrebeshi luftarak kundër njerëzisë. Ishte lufta dhe armiqësija, të cilën e lind mëkati dhe largimi nga Perëndija dhe të cilën me mënyra të ndryshme di t'a kallë ndërmjet njerëzvet, pa marrë parasysh në është kohë paqeje a kohë lufte. Mirpo, Zoti i ynë Jisu Krisht, me gjith plasjet e luftëravet e të turbulliravet është me të vërtet paqja e vërtetë, paqja e jonë.

«Zëri i Kryepiskopit»

Kryehirësija e Tij Kryepiskopi i ynë Imzot Kristofori, me rastin e ceremonis së varimit të ndierit Idhomenë Kosturit, tha ndërmjet të tjerash dhe këto: Në mes të fatkëqësisht, nuk e ka lënë të pa prekur dhe vëndin t'onë, një dilemë i madh paraqitet përpara nesh: Ç' qëndrim duhet të mbajmë në gjatë kësaj krize të përbotëshme? Përgjigja në këtë pyetje është shumë e thjeshtë: ne duhet të mbajmë atë qëndrim që lypë shpëtimi i Shqipërisë dhe interesat e nalta të kombit. Deri këtu akordi është i plotë dhe nuk munt të eksistojë asnjë kundërshtim. Ndryshimet e pikpamjevet lindin porsa që preket çështja: ç'drejtim duhet të ketë ky qëndrim i ynë? Si Kryetar i Kishës Orthodhokse Autoqefale, që qëndron përmbi partitë politike, nuk kam asnjë kompe-

tencë që të caktoj këtë drejtim, por cilësija ime fetare më imponon të këshilloj bashkim e vëllazërim, dhe m'atë tjetër, mendohem se pikpamjet e ndryshme nuk janë të papajtuarëshme. Porsa që të gjitha partinat politike ndjekin një qëllim, shpëtimin e Atdheut, porsa që të gjitha partinat e dëshirojnë, pa asnjë dyshim, këtë bashkim të shenjtë, është vallë e pamundëshme që të gjendet një bazë marrëveshjeje e përbashkët dhe mbi pikën tjetër, të drejtimit që duhet të mari qindrimi i ynë në këto çaste kritike? Un besoj thellësisht, se, po të këmbehen mendimet midis partive të ndryshme me gjak ftohtësi, mund të arrihet një marrëveshje dhe, kështu, ne të bashkuar të gjithë të marim një rrugë të vetme atë që imponon shpëtimi i Atdheut.

“Koha e mirëbërësisë”

S'ka kohë më të përshtatëshme se sot, për të çfaqur i krishteri ndjenjat e dashurisë kundër vëllezërvet të tij në shtrëngim. Dimri ka ardhur. Shtrenjtësija ka ardhur në kulm. Rethanat e luftës së sotëshme kanë sjellë mjaft mjerim. Familje të tëra kanë mbetur pa strehë e pa ushqim. Vërtet Kisha e jonë ka bërë për to gjithçka ka qënë e mundur. Por nuk mjafton aqë. Duhet që edhe gjithsecili prej nesh në mënyrë private të japë kontributin e vet atje ku mundet e me sa mundet. Sidomos tani që po na afrohen edhe festat e Shenjta të Krisht-lindjes, të Vitit të Ri e të Ujit të Bekuar, gjatë të cilavet çdo, njeri lypset t'a ndjejë gëzimin. Është detyra e jonë e parë kjo. Detyrë që na e imponon vetë Zoti, i cili thotë: “atë q'i bëni njerit nga këta vëllezërit e mij të vegjël ma bëni mua”.

MENDIME T'ARTA

Çdo program arësivor, që nuk i jep vendin e parë mësimit të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë pregarit çka tërrimin moral të brezit të ri.

Drejtor - Përgjegjës: PROTODHJAKON PETRO DOCI

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT I IV-të

KALLNOR 1943

Nr. 11

LANDA: Urim. — Feja dhe Shkenca. — Logjika. — Apologjija e Orthodhoksisë Shqiptare. — Ideja Fetare Ruse — Këngë Pashke. — Fjalor i vogël i Dhjatës Re. — Përshtypje dhe mendime. — Farisenjët. — Nga Kryeveprat e Gojartit — Lajme të brëndëshme.

ME RASTIN E VITIT TË RJ

U R I M

— Të kërkojë udhën e drejtë!

Është urimi, urimi që del brënda nga zija e përgjithëshme e luftës. Është, bile, shpresa . . . , e vetmja që shpëton e paprekur nga bombardimet e mjerimet e tjera të luftës!

— Nëse tmeri i luftës do t' a bëjë njerëzinë të vijë në vete, të paktën tani, e të kërkojë të kthehet n' udhën e drejtë! . . . Kurrë s' është vonë! Ky mendim është, natyrisht, ngushëllonjës. Po ka dhe një të met. Atë fjalën e vogël „nëse”. Nëse lufta e sotme do t' a sjellë në vete njerëzinë! Mirpo do të bëhet vall këjo?

Vështirësia qëndron vetëm në një pikë. Në rrëfimin e sinqert të gabimit. Asnjë mësim s' munt të pranohet nëse nuk ekziston dispozita e sinqert për të pranuar mësim. Edhe këjo dispozitë psesypoizon rrëfimin se kemi nevojë për mësim, se gjer tani s'i kemi ditur të gjitha. Dhe diçka më tepër. Që gaboheshim. Që u-gabuam në shpresat që kishim mbështetur mbi „liberalismën” e famëshme „të njeriut të ndriçuar” të të dy shekujve të fundit.

Në duam pra që nga ky njerim i përbotëshmë të dalë diçka e mirë, duhet pa dyshim, të rrëfejme q' u-gabuam, Dhe këte detyrë, të rrëfimit të sinqert, e kanë piksëpari „intelektualët”.

Këta duhet të rrëfejne me guxim, drejtësi e sinqeritet :

Që shpresat që kishim mbështetur vetëm në trut e vegjël „të njeriut të famëshme modern”, i cili ish gjoja në gjendje të krijojë një civilizim si duhej, nuk u-vërtetuan.

Që civilizimi, baza e të cilit ishte përbuzja, keqparaqitja dhe përsekutimi i çdo parimi fetar çon n' anën e kundërtë të shpresave q' u mbështetnë mbi 'të.

Që shkencë e famëshme—domethënë ajo q' e quajtëm shkencë, për të mos e quajtur si duhej, akrobaci intelektuale — shkencë pra, q' ishte fjala të bëjë gjëra të mëdha, bëri këtë monstrë q' i thonë „civilizim evropjan modern”.

Që njeriu i kohës s' onë, munt të ketë bërë vërtet përparime të çuditëshme në hollësi, por në problemet e përgjithëshme të jetës, në çështjet themelore për njeriun, do t' a kqyrte më me zell se me cmir të kaluarën!

Që, si pasojë, njeriu „intelektual” i sotçëm, e ka për detyrë t’i kqyrnjë me tjetër sy këta probleme. Të lerë me një anë fjalët boshe dhe egoismën. Të rrëfejë me sinqeritet të metat e tij. Të njohë se ishte një gabim, gabim bile çkatëronjës, mohimi i të vërtetave të përjetëshme e themelore për njerëzin. Dhe sidomos të nxjerë, pa përtypje e pa dredhira, përfundimin e këtij rrëfimi: të provojë nevojën e kthimit në ato të vërteta të përjetëshme.

Do t’ a ketë vall njeriu intelektual i sotçëm këtë sinqeritet?

Shumë shenja nga lëvizja mendore e kohës së fundit e forcojnë shpresën që një përgjegje pozitive do t’i jepet pyetjes së sipërme.

Dëshira pra e realizimit të kësaj shprese, përbën urimin më të mirë e më të nxehtë të çdo njeriu që mendon seriozisht kur sheh lindjen e një viti të ri.

B.

MENDIME T’ARTA

Shumë ligësi sjellin përfundime çkatëronjese jo vetëm për atë që ka këto ligësi, po edhe për brezët e pasardhësve të tij, të cilët i trashëgojnë këto si një trashëgim të rëndë e të rezikshme.

* * *

Më të shumtët e prindërvet u kanë lënë fëmijvet të tyre pasurira të mëdha. Po ca të tjerë prindër, më të mençur e më të zgjuar, u kanë lënë si trashëgim vetëm karakter të mirë e të lartër. Prova e përditëshme dëshmon qartazi, se të parët u kanë lënë fëmijëvet të tyre një armik të rezikshëm, kurse ata të kategorisë së dytë një thesar të paçmuarshëm.

Feja dhe Shkenca

Problemi i lindjes së njeriut.

VI

Shumicë llojesh të ndryshme në mbretërin' e bimëvevet e të kafshëvevet — Ligje që sundojnë e që ruajnë armoninë në marëdhënjet që kanë midis tyre — Ligji i pa ndryshmënisë së llojevet — Fuqija e tij e madhe — Veprimi i tij i përgjithëshëm dhe pa as një përjashtim — Ligji i pandryshmënisë: shkëmb i fortë, ku thyen tërë pretendimet e darvinistëvevet—Prej një lloji nuk mund në asnjë mënyrë të dalë një lloj tjetër — Bashkimi fiziologjik midis llojevet të ndryshme forcon e vërteton ligjin e pandryshmënisë.

Po të hedhim një sy në mbretërin' e bimëvevet, si edhe në atë të kafshëvevet, kemi për të parë se planeti i ynë është mbushur me një numur të math bimësh të shumëllojshme dhe banohet prej shumë krijesash të gjalla, të cilat ndryshojnë në mes të tyre nga trajta e jashtme, nga cilësitë, nga zakonet dhe nga enstiktet e ndryshme. Habitët me të vërtetë njeriu, kur sheh këtë shumicë aqë të madhe bimësh dhe kafshësh që mbulojnë tokën; po habitja bëhet m'e madhe, kur mëson nga natyralistët e nga studjonjësit e zellshëm të natyrës e të fenomenevet të saj, kur mëson pra se tërë kjo shumicë llojesh sundohet e regullohet prej ligjësh që janë të caktuar e që nuk ndryshohen kurrë, prej ligjësh të cilat regullojnë në një mënyrë të çuditëshme

lidhjet e marëdhënjet midis llojevet të ndryshme, ruajnë armonin e tyre, caktojnë kufitë ku duhet të qëndrojë çdo lloj dhe sigurojnë cilësitë e karakteristikat kryesore të se cilit lloj, në mënyrë që të mos shkakëtohet as një përzjerje dhe asnjë ngatërim midis llojevet të ndryshme.

Një nga këto ligjet është dhe ay *i pandryshmënisë së llojevet* si të bimëvet, ashtu dhe të kafshëvevet. Prej një lloji bimësh ose kafshësh mund të dalin shumë të tjerë ose me anën e zgjedhjes artificiale të njeriut, ose me anën e influencës që ushtron redhi, klima dhe kushte të tjerë natyrore. Natyra në këtë pikë është e epëshme dhe ka një lloj lasticiteti, dyke lejuar të prodhohen shumë ndryshime, më të mëdha ose më të vogla të një lloji bime ose kafshe. Po është e pa epur dhe nuk lejon kurrë që prej një lloji bimësh ose kafshësh të dalë një lloj tjetër krejt i ndryshëm dhe me ndryshime themelore. Në disa bimë p. sh. njeriu me anën e një shërbimi të veçantë e të kujdesëshëm mundi të sjellë ndryshime në trajtën e fletëvevet, në ngjyrën e bimës, në lëngun e vajin e bimëvevet të saj, në mbulesën, në kohën e lulëzimit etj; po karakteret e cilësitë kryesore të bimës mbeten të pa ndryshuara dhe me ndryshimet që u sullnë nuk rodhi no një lloj bime krejt e re. Gjithashtu ngjet edhe me kafshët: njeriu d. m. th. me mjete artificiale mundi të nxjerë shumë pullumba (150 lloje) të ndryshme, po ndryshimet midis këtyre pullumbavevet nuk janë aqë të thella, sa të krijojnë një shpend tjetër, një shpend krejt të ri; as nuk mundi kurrë, me gjithë përpjekjet e shumta, t'i ndryshojë zvaranikët p. sh. në shpendë. Gjithashtu s'ka mundur të ndalojë dhe lindjet nga bashkimi i një mashkulli me një femër, sa do lark që të jenë nga trajta e jashtme dhe sa do të mëdha që të jenë ndryshimet midis tyre në punën e cilësivevet, të zakonevet e t'instinktevet. Një mashkull e një femër të një lloji, sado që të ndryshojnë në mes të tyre, po t'i bashkojmë, do të lindin me doemos një fëmijë, e cila do t'i ketë tërë cilësitë e trajtat të llojit ku janë prindërit e saj. Le të marim p. sh. një qen nga Terra Nuova dhe një nga raca Charles-dogs; siç dihet, ndryshimet midis këtyre janë shumë të mëdha si nga ma-

dhësija, si nga lëkura, si nga trajta, si edhe nga enstinktët; me gjith këtë, po të bashkojmë një mashkull prej njerës racë me femër të racës tjetër, kemi për të parë se do të kemi lindje me doemos. Po t'i vemë re me kujdes të 150 llojet e pullumbavet — që krijoi njeriu, siç thamë, me mjete artificiale të ndryshme — dhe po t'i krahasojmë këto në mes të tyre si edhe me pullumbat e egra, nuk do të besojmë se tërë këto pullumba janë të një lloji; aqë të mëdha janë ndryshimet midis tyre! Me gjith këtë bashkimi i një pullumbi me një tjetër, krejt të ndryshme nga trajta e nga cilësitë, përfundon gjithënjë në lindje dhe natyralistët, e si domos darvinistët, nuk kanë mundur, me gjithë mundimet e tyre, të bëjnë të pa frytshëm bashkimin fiziologjik midis kafshëve të një lloji e kështu të këputin vazhdimin e shumëzimitin e tyre. Rëndësin' e këtij fenomeni e kishte pranuar dhe Darvini vetë, i cili me një kthjellësi të lavdëruarshme ka shkrojtur midis të tjeravet edhe këto: 'Unë nuk di as një rasë, e cila të na provojë se bashkimi, i kafshëveve shtëpijake që ndryshojnë shumë midis tyre, nuk ka qënë ndonjë herë pjellore; e kjo me të vërtetë është një gjë shumë' e çuditëshme, sepse të pa numërta janë llojet e ndryshme të pullumbavet, të derravet, të qenveve e të shpendëveve". Dhe s'është kjo vetëm; natyra dyke paravështruar, si të thuash, përpjekjet e njeriut për këputjen e këtij bashkimi fiziologjik e dyke dashur të tregojë së çdo përpjekje për këtë punë është e kotë, bëri që bashkimi i meshkujveve me femërat që janë të një lloji, po që kanë ndryshime të mëdha midis tyre, bëri pra që bashkimi i këtyre, të jetë më pjellor, se sa ay midis atyre që kanë po atë trajtë dhe po ato zakone dhe enstikte. Kështu pra kafshët e një lloji sa më tepër largohen e ndryshojnë midis tyre nga trajta, nga madhësija e nga zakonet, aqë më shumë fuqizohet lindja e tyre fiziologjike dhe aqë më pjellor bëhet bashkimi i tyre. Ligji pra i pandryshmënisë së llojeveve dhe pa mundësija e ndalimit të lindjeveve nga bashkimi i një mashkulli me një femër të një lloji, këto janë dy nga fenomenet që shihen e që sundojnë në mbretërin' e bimëveve, si edhe në atë të kafshëveve.

Një tjetër fenomen që vërteton fuqin e ligjit të pandryshmënisë — fenomen të cilin darvinistët e përdorin për çudi si argument e si provë të theoris së tyre — është dhe ky: nga bashkimi i dy kafshëve që nuk janë të një lloji lindet e rjedh një lloj krejt tjetër si p. sh nga bashkimi i kalit me gomarin lindet mushka, që ndryshon si nga kali, si nga gomari. Po edhe këto përjashtime i ka lejuar si të huash, natyra, për të dhënë provë të re të ligjit të pandryshmënisë. Është e vërtetë se nga bashkimi i kalit me gomarin lind mushka, që mund të quhet si një lloj tjetër, po kjo e fundit mbetet e shterpëtë dhe nuk mund të prodhojë dhe të lindë nonjë trajtë kafshe të re. Në disa rase të tjera prap është e vërtetë se nuk shihet shterpësi, po trajta e re e kafshësh nuk jep pasardhësve të sajë asnjë nga cilësit e reja që ka, e kështu pra pas brezit të parë, ose të dytë, kthehen përsëri dhe pikërisht trajta e lojevet nga të cilët rodhi. Kështu p. sh katsha e re që rjedh nga bashkimi i ulkut dhe i qenit lind gjithënjë ulk ose qen. Kështu pra edhe këto përjashtime në vënt që të forcojnë theorinë e Darwin-it sikundër besuan disa, përkundrazi i japin fuqi e provë të re ligjit të pandryshmënisë së llojevet.

Shpresëtari

Kalendar Kishëtar Orthodoxoks

Dolli prej shtypit Kalendar Kishëtar Orthodoxoks për vitin 1944, i përpiluar prej z. z. Dh. Bedulit e J. Papailia dhe që përmban, përveç të kremtevet fetare, Ungjijt, tingujt dhe mëngjzorët e çdo të Djele, si edhe disa këshilla fetare, dyke patur në mest ikonën e Zotit t'onë Jisu Krisht. Ësht i pari Kalendar Kishëtar që del me këte menyre. Çmimi është lën në dëshirën e gjithsejçilit. Gjëndet në zyrrat e revistës s'onë.

THEMË FILOSOFIKE

LOGJIKA

3. Kuptimi i idevet

Definim. Kuptim (Lat-comprehensio, Germ. inhalt, Frëng. comprehension) i një idëje është gjithia e notave të saj. Nota janë elementet që formojnë një idë; p. sh. idëa *nir* ka këto nota: *trup, organik, sënsibël, vetëdijës*. — Notat quhen dhe *atributa* dhe *predikate*.

Dallim i notave. Notat e idës dallohen në:

a) *nota gjeni* dhe *notë fari* (espice) ose diferencë specifike. Quhen nota gjeni ato që formojnë konceptin e gjenit të idës; p. sh. e idës *nir* notat *trup, organik, sënsibël* janë nota gjeni, se së bashku formojnë konceptin e gjenit *kafshë*. — Koncepti i gjenit enuncohet zakonisht me një emën, p. sh. në vënd të themi *trup organik sënsibël* themi *kafshë*. Por, se pse thuhet me një fjalë, nuk don me thënë se është një notë, por shumë nota t'enuncuëme, për lehtësi, me një emën. Enuncimi i gjenit me një emën quhet *synthetik*; dhe enuncimi i tij me terma, më shumë se një quhet *analytik*. Sa më tepër nota të gjenit enuncohen, aq më tepër *analytik* është espressioni. — Notë fari ase diferencë specifike është ajo notë që ka idëa më të tepër se gjeni i vet; p. sh. për idën *nir*, nota *vetëdijës* është notë fari. Quhet kështu se i përket vetëm idës *nir*, e specifikon këtë dhe e dallon prej idës së gjenit *kafshë* dhe prej idës homogjene *shtazë* (lopë,

qen, ulk ecc) — Kështu, nota e gjenit dallon idén prej idévet heterogjene; p. sh. idén *nir*, nota *kafshë* (= trup organik sensibël) e dallon prej idévet heterogjene *mos-kafshë* (lis, dru, gur, hekur, ecc); nota e farit (dif. specifike) *vetë-dijës* e dallon atë (*idén nir*) prej idévet të gjenit *kafshë* dhe prej idévet homogjene shtazë (lopë, qen ecc).

b) nota *evidente* ase *primitive* ase *origjinale* ase *konstitutive* dhe nota *okulte* ase *derivative*. — Të parat quhen *evidente*, se na bëhen të njohuna pamietaz (immediatement), intuitivaz; quhen *primitive* ase *origjinale*, se janë të parat qi na bëhen të njohuna; quhen *konstitutive*, se kontribuojn në formimin e idévet. — Të dytat quhen *okulte*, se nuk i njohim dot intuitivaz, por i shpulojm me anën e një analize logjike qi konsiston në komparazim dhe syllogjism; quhen *derivative*, se derivojn prej notavet primitive. P. sh. për idén *trikënd*, notat *figurë*, *tri anë*, *tre kënde*, janë *evidente*, se për t'i dijtë s'na duhet të mendohemi, por i njohim me një simpël akt intuitiv (na bien me vrap në syt, e mëndjes); kur-se nota e *barazisë të tre këndeve me dy kënde të drejtë* është *okulte*, se nuk mundemi me e dijtë intuitivaz, por pas një mejtimi d.m.th. pas një analize logjike qi konsiston në një seri komparizimesh dhe syllogjismash. — Për analizë logjike, veç, duhet kuptue vetëm analiza e idévet në notat e tyre dhe jo analiza e sendevet nër elementet e vetë, si p. sh. analiza e ujit në hydrogen e oksigjen. Analiza e sendevet është analizë materiale, punë trupi, qi konsiston në *observim* dhe *experimentim*, dhe gjen fushë sbatimi në skencat empirike. Kur-se analiza logjike është punë mënde. Prej notavet të një idéje, vetëm notat racionale d.m.th. cilsinat ase elementet metafisike janë objekt të analizës logjike; kur-se elementet fizikë të sendevet janë objekt të analizës materiale. Andaj, analiza logjike d.m.th. komparazimi dhe syllogjismi, gjen zbatimin e vet në skencat racionale si metafizikë e matematikë, dhe aspak në skencat empirike. Këtëj del se skencat rigide janë vetëm skencat racionale, se vetëm këto na bëjnë të njohun të vërtetën objektive, realitetin siç është; kur-se skencat empirike janë skencat të fenomenevet, të

botës siç na duket, se për miet dijnë kanë analizën materiale, e cila s'na ofron veç fenoméne dhe aspak realitetin siç është. — E gjithë pun' e skencës nuk konsiston në gjà tjetër, veç në kërkimin dhe gjetjen e notave okulte t'idévet (sa-për skencat racionale) dhe te elementeve okulte të sendeve (sa-për skencat empirike).

c) notat, të kqyrura secila më vëte, janë idéna; pra, vlen barabar dhe për këto dallimi i idévet (shih: dallimi i idévet).

d) mas lojlikës së shkollës, notat dallohen në *essenciale* dhe *aksidentale* ase *mode*. — Essenciale janë notat që marrin pjesë në formimin e idés d.m.th. *nota e gjenit* dhe *nota e farit* (dif. specifike). Aksidentale ase *mode* (*modus*) janë notat që nuk marrin pjesë në formimin e idés. Kështu, p. sh, për idén *trikënd*, notat *figurë*, *tri vija të drejta*, janë esenciale, e para notë gjeni, e dyta notë fari; por nota *isoshál* (*isoscele*) është aksidentale, se nuk mer pjesë, nuk hyn në formimin e idés *trikënd*, pasi trikëndi mund të jetë isoshal por mund të jetë dhe skalén ase isovil (*equilatero*). Gjithashtu, për idén *kafshë*, notat *trup organik*, *sensibël* janë esenciale gjen e differencë), por nota *dykambëshe* është aksidentale, se ka kafshë me dy këmbë, por ka dhe me katër, ka dhe pa këmbë fare (*stërpijt*). — Ky dallim na duket pa vënt. Aksidentale, thonë, janë notat që nuk hyn në formimin e idés. Kjo don të thotë që këto nota jesin jashtë idés, s'janë elemente të sai dhe, me fialë t'jera, për të s'janë nota. Këtej del se një element që të mundë të quhet notë duhe të jetë i domosm (*necessiare*) për formimin e idés, pra, essencial. Emni notë *aksidentale* përmban kontradiksion, se don të thotë notë që s'është notë. Nota, vetëm se është notë, është dhe e domosme, essencial, mbiemën ky që bëhet i tepër. Notat duhen kqyrur në rapport me idén, së cilës formojn kuptimin, dhe jo në rapport me idéna t'jera; p. sh, nota *isoshál* është notë, pra essenciale, për idén *trikënd isoshál*; por, për idén *trikënd* s'është aspak notë, pra as essenciale as aksidentale.

4. Suaza e idévet.

Definim. Suazë (Lat. *extensio*, Germ. *Ausdehnung*, Frëng. *Extension*) e një idëje është gjithia e idévet farore (speciale) të saj; ase suazë e një idëje është gjithia e idévet, i të cilavet kjo është gjen (*genus*); p. sh. suazë e idës *liz* është *plep, dushk, dardhë, mollë* ecc.

Dryshimi midis kuptimit (*komprehensio*) dhe suazës (*extensio, ambitus*) t'idévet është ky: i pari është gjithia e notavet t'idës; i dyti është gjithia e idévet farore (speciale) që dërbahen në atë idë; p. sh. kuptimi i idës *kafshë* është *trup, organik, sensibël*; suaza e saj është: *nir, lopë, qen, ulk* ecc.

Idëa që përmban në suazën e vetë idëna t'jera quhen ndaj këtyne idë *gjeni* (*genus*); idënat që përmbahen në suazën e saj quhen idë *fari* (*espèce*); p. sh. idëa *kafshë* është gjen për idën *lopë*; dhe idëa *lopë* është far për idën *kafshë*.

Fari ka po ato nota që ka dhe gjeni edhe një më tepër; kjo notë e tepër quhet notë fari ase differencë specifike. Gjeni, pra, është më papal (simple) se fari, pasi ka më pak nota; dhe fari është më palosh (komposë) se gjeni, se ka nota më tepër. Kuptohet vetiu që signifikata e termavet *gjen* dhe *far* s'është absolute por vetëm relative, pasi po ajo idë, e krahasuëme me një më papalë (simple), është far; dhe e krahasuëme me një më paloshe (komposë) është gjen; p. sh. idëa *metal* është far ndaj idës *mineral*, dhe gjen ndaj idës *ar*. — Gjeni i gjenit quhet *gjen' i larg* p. sh. idëa *mineral* për idën *ar*; dhe fari i farit quhet *far' i larg*, p. sh. idëa *ar* për idën *mineral*.

Idëa e gjenit është më gjenore (gjenerale) se idëa e farit, se ka suazë më të madhe; dhe idëa e farit është më farore (speciale) se idëa e gjenit, se ka suazë më të vogël; p. sh. idëa *shtazë* është më gjenore se idëa *ulk*, se përmbledh në suazën e vetë gjithë farët e shtazavet (*ulk, qen, luan* ecc); kur-se idëa *ulk* është më farore se idëa *shtazë*, se në suazën e vetë nuk përmbledh veç *ulqt* vetëm. — Idëa sa më gjenore aqë më papalë është; dhe sa më farore aqë dhe më paloshe është. Idë krejt gjenore dhe papalë është ajo që ka suazën krejt të madhe, e cila gjithë idënat e t'jera

i përmban në suazën e sai; e tillë është idëa *gjá*. Idë krejt farore dhe paloshe është ajo qi ka suazën krejt të vogël, ajo qi përmban vetëm idën e nji individi d.m.th idëa individuale (platoni).

5. Rapport midis kuptimit dhe suazës.

Nga sa u-thanë më sipër kuptohet vetiu se kuptimi dhe suaza e idëvet gjinden, njeni ndai t'jetrës, n'arsye inverse; sa më i madh njeni, aqë më e vogël jetra: p. sh. idënat *kafshë* dhe *nir*; e para ndai së dytës, ka kuptimin më të vogël, se ka nota më pak, dhe suazën më të madhe, se përmbledh në qarkun e vet idënat *shtazë* dhe *nir*; e dyta, ndai së parës, ka kuptimin më të madh, se ka nota më tepër, dhe suazën më të vogël, se përmbledh në qarkun e vet vetëm *nierzt*.

6. Sheja e raportit.

Sheja e raportit qi lidh notat e kuptimit të nji idëje është symboli algebrik i shumzimit: pra, po t'a quajm A idën, dhe B, a, b notat e sai, do të kemi: kuptimi i $A = Bab$. — Kur-se si shejë, për të tregue raportin qi lidh pjesët e suazës, përdoret symboli i shtimit (addition); pra, po t'a quajm A idën, dhe B, C, D idënat farore qi përbajn suazën e sai, do të kemi: suaza e $A = B + C + D$.

K. T.

MENDIME T'ARTA

Ay që plotëson detyrën bukur e mirë, do të qëndrojë i patrembur dhe do të përballojë me gjakftohtësi çdo ndryshim që munt të ngjasë në jetën e tij.

* * *

I krishteri i vërtet duhet të durojë pa nonjë ankim çdo fatkeqësi që munt t'i ngjasë në këtë botë.

APOLLOGJIA

e Orthodoxosis Shqipëtare

Të falem ty Fé e lashtë e Vëndit t'im, e mburuar drejt-përdrejt nga Fjala dhe e njëjësuar me Fjalën.

Të falem ty, Fé e qëndrimit dhe e durimit, fé e martirëve dhe e dëshmorëve, fé e paqes dhe e së drejtës.

Të falem ty, Fé e gjyshërve zëmbër-bardhë e shpirt-mbëdhej që të pushtuan sa po u linde e si u linde, që të mbajtën të përgjakur e të përbotur, njëkohë me gjuhën e kombit.

Ti i dhë kombit t'im dritën e Ungjillit dhe kombi im të fali Shën Kostandinë dhe mijra martirë që me gjakun e tyre i bënë të përjetëshme themelet e tua.

Ti frymëzove Gjonin e Vojsavën, në qëndrimin e tyre të përbotur e të përgjakur për mbrojtjen e kësaj Toke.

Ti na dhe Zembër-gurin Gjergj që i vu gjoksin rebeshtit të Asisë.

Ndaj teje Fé e Shën Gjonit dhe e Shën Marenës, thyet gjuri im si u pat thyerë gjuri i atit, i gjyshit dhe i stërgjyshit, gjer më njëzet breza.

Ndaj teje, Fé e manastirëve të gurtë, e ajazmave të shënjta, e alltareve të rënuar, kodër më kodër, të përhapura në gjithë vëndin t'im, ne shtrojmë shpirtet t'ona të përvojtura dhe mbështetëm shpresat t'ona gjithmon të gjalla e të patundura.

Të jam falur e do të falem ty, Fé e shenjtë e grave martire të Sulit, Fé e shenjtë e Papa Kristos nga Negovani, e Papa Dhimitrit nga Ballkameni edhe e gjithë martirëve të Ungjillit shqipëtar.

Ti i mbajte kombit t'onë legjendat e Kostandinëve e të Garentinave, këngët e stërflashta, zakonet e mburuara nga vetë fryma e kësaj toke dhe e këtij kombi.

Mbulesë e shenjtë kundrejt breshërit të kohës, mur i çelniktë kundrejt rebeshave të zeza, anije e mrekulluarshme që shpje ndaj jetës së vërtetë shpirtet t'ona, ti ishe, je e do të jesh përgjithëmonë. Sepse ti mburon nga përjetësija e Fjalës dhe je njëjësuar me Fjalën.

Jeromonahu Dhionis

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

VI.

Për të kuptuar shpirtin apokaliptik dhe iden apokaliptike ruse, duhet të kuptojmë pasivitetin dhe fuqin e orthodhoksisë ruse gjat historis. Orthodhoksia ruse nuk ka dashur të zotërojë botën dhe as nuk është organizuar për këtë qëllim. Orthodhoksia ruse nuk e kqyr kishën si një qytet qiellor, si një mbretëri të Perëndisë mbi dhé. *Orthodhoksia anon më tepër te idea, që Mbretëria e Perëndisë do të vijë me anë të një mrekullije ose katastrofe të mbarimit të botës, e cila do të bëhet një qiell i ri dhe një tokë e re. Kisha dhe mbretëria janë të ndryshme.* Kisha nuk njëjësohet me shtetin dhe me methudhat e veprimit të shtetit. Kisha orthodhokse ka ruajtur një qëndrim pasiv në lidhje me shtetin; kurrë nuk ka dashur të marrë pjesë në çeshtje botërore. Klerikalisma nuk ka ekzistuar në orthodhoksinë ruse. *Fryma orthodhokse karakterizohet me anë të pasivitetit dhe të fuqisë, të cilat kanë krijuar një pozitë të posaçme në marrëdhënjet me shtetin dhe me fuqin perandorake.* Shteti ka për qëllim të organizojë jetën tokësore të popujvet dhe të mbrojë kishën. Nga pikëpamja e jashtme kisha është sunduar, por nga pikëpamja e brëndëshme ka ruajtur lirin individuale. I mbeti besnike kësaj së vërtete, që Mbretëria e Perëndisë do të vijë pa pritur. Ndërgjegja orthodhokse frymëzohet prej asqetismës në marrëdhënëjet e sajë me botën

dhe me Mbretërinë e Perëndisë. Ajo beson se mundemi t'i arrijnë mbretërisë së Perëndisë vetëm dal nga dal.

Kisha katolike, ndonëse ka qënë kundërshtar e evolucionismës, ka pranuar me gjith atë që nga shek. i XIX-të evolucionismën në fenomenet fetare. Ajo njofti mundësinë e çvillimit të dogmave, adaptimin e kishës në punët llaike, me qëllim që të bëhet ajo udhëheqësja në punët botërore. Këjo evolucionismë është përhapur nga dëshira për të zotëruar botën dhe për të krijuar një mbretëri të Perëndisë mbi dhë. Krishterimit i u desht që t'i lerë vënd kishës katolike në tokë për të nënshtruar tokën. Ajo ka qënë një organizatë ushtarake. Mbretëria e Perëndisë duket të ketë qënë zgjidhur në veprimtërinë historike të vazhduarshme të kishës, në përpjekjen e saj për të zotëruar botën. Shpirti ka qënë ndryshuar në një fortesë dhe u-bë i mbyllur për frymën mystike. *Apokalipsa ka qënë kyçur.*

Në iden protestante, vokasioni (Beruf) ose çdo ide fetare ka qënë drejtuar për të zotëruar kulturën. Eshtë me rëndësi të caktohet, që krishterimi Perëndimor, katolik dhe protestant, u aktualizuan në histori, në civilizim, çvillim ky i cili pati si pasoje harxhimin e fuqis shpirtërore të përqëndruar në pritjen e Jerusalemit qiellor, të botës së arthme, të mbretërisë së Perëndisë. Ja çka nuk ka ngjarë në orthodhoksi. Në orthodhoksi ka mbetur e gjallë ndërgegja apokaliptike, që i detyrohet pikërisht pasivitetit. *Shpirtet orthodhoksë s'kanë qënë të organizuar si në një fortesë ose qytet, kanë mbetur të ndijëshme para frymës mystike të së arthmes, ata dëshirojnë Jerusalemin qiellor, botën e arthme.*

Karakterit apokaliptik është pika më e dukëshme e shpirtit dhe të idesë fetare ruse. Shpirti rus nuk është i lidhur prej normave të civilizimit, fuqit shpirtnore nuk i ka aktualizuar në organizimin e kësaj bote. Shkenca, morali, e drejta, nuk i kanë mbuluar Zotin. Gjithashtu lufta, nërmjet Krishtit dhe andi-Krishtit, ndryshimi i arthshëm i botës, ardhja e mbretërisë qiellore, munden t'i zbulohen rusit. *Eshtë një paradoks nërmjet krishterimit rus dhe frymës fetare ruse: Orthodhoksia ruse është pasive dhe statike; dhe për këtë shkak dinamizma fetare drejtohet drejt së arthmës,*

drejt një ere të re në krishterim, drejt apokalipsës, drejt mbarimit të botës. Krishtërimi Perëndimor është dinamik dhe aktiv dhe apokalipsa mbyllet para atij; ay nuk u-kthye drejt një ere të re fetare.

Krishtërimi lindor mbërin aktiv dhe dinamik në momentin mrekullonjës dhe katastrofal, kur ka për t'u kryer kalimi i jetës në përjetësi. Në ndërgjegjen ruse posaçërisht u zbulua konflikti ndërmjet njeriut-Perëndi dhe Perëndis-njeri. Dostoevski ka qënë pararendës i Nietzsche-s. Ndërgjegja ruse ka patur dhuratën të tregojë gënjeshtëtrën e umanizmës, rezikun e sajë vrasës për njeriun. Krishti dhe andi-krishti, Perëndia-njeri dhe njeriu-Perëndi, ka qënë një themë që ka turbulluar popullin rus dhe klasën kulturore ruse. Një themë apokaliptike, e mbarimit të destinimit të njeriut. Në Perëndim kjo themë ka qënë mbuluar prej zhurmës që e shkakëtonte veprimtaria e nxehtë njerëzore.

Në një kuptim të caktuar, orthodhoksia ka qënë më asqetike se krishtërimi perëndimor, ka qënë një fe monahale. Në orthodhoksi u zbulua urtësia hyjnore e krijimit. Ideja e «Sophia-s». «Urtësija Hyjnore» është kryesisht një ide ruse, e cila është zbuluar në ikonografinë fetare ruse dhe në mendimin fetar rus. Në krishtërimin rus dhe në jetën shpirtërore ruse është një shpresë e madhe mesianike.

MENDIME T' ARTA

Çdo program arsimor, që nuk i jep vendin e parë mësimin të fesë, është plot me helm dhe si i këtillë përgatit çkatërrimin moral të brezit të ri.

* * *

Ipokrizija është vdekja e shpresëtarisë dhe e fesë.

* * *

Puna e ndershme shkon krah për krah me detyrën, e providenca hyjnore të dyja këto i ka lidhur dhe i ka bashkuar me lumtërinë dhe fatbardhësinë.

KËNGË PASHKË

Po vijojmë në këtë numur me riprodhimin e disa këngëve popullore, të lashta fort, të lindura në gjirin e Orthodhoksis Shqipëtare.

Janë këngë vallesh të cilat këndoheshin, dikur, në Pogradec, prej burrave dhe prej grave, ditën e Pashkës së Madhe.

Thema e të dy të parave *Ura e Qystendilit* edhe *Qën-kshin, lele, qën-kshin*, është ajo e sakrificës njerzore, për ngrehjen e një ure. Është gjithë ajo themë me qarkullim të përgjithshëm ndaj popujve të Ballkanit, e njohur në Veri në trajtën e gojzdhonës së Kështjellës së Rozafatit.

Gjithë po ay argument gjëndet ndaj serbëve si gojzdhana e ndërtimit të kështjellës së Shkodrës, ndaj Grekëve për ngrehjen e urës së Artës, ndaj bullgarëve për urën e Strumës dhe ndaj rumunëve për ngrehjen e manastirit Arges prej mbretit Neagoe, — me anë të mjeshtërit Manole.

Këtë argument simbolik të sakrificimit të jetës për të kryerë një vepër të madhe ne e shohim të mburojë nga Ungjilli i Shënjtë, ku vetë jeta tokësore e Shpëtimtarit u vu në themelin e Kishës së Tij.

Fakti se kënga këndohet ditën e Pashkëve është dhe ky një nga provat e këtij afrimi.

Është për t'u shtuar këtu ay vizioni i bukur i lajmëtarit të sakrificës:

U doli një plak me mjekër :

— Puna mbarë o djemt e mi ;

— Mir se ardhe, babaj ynë.

Kënga është, si duket, pa rimë — si edhe ajo e Kostandinit të vogëlthit e arbërve të Italisë — gjë e cila provon se është e vjetër të paktën prej disa shekuj.

Kemi shpresë të plotë se tema e më sipërme do ketë motrëzime të tjera në vise të ndryshme të Atdheut. Prandaj u sillemi edhe njëherë klerit dhe besnikëve t'i mbledhin e të na i dërgojnë.

Në kohën e duhur, mbassi të jetë plotësuar një numur

i aftë këngësh, "Jeta Kristiane" do t'i përmbledhë të gjitha në një a më shumë vëllime.

Thema e këngës së tretë, e cila, gjith ashtu, këndohet ë lohet valle për Pashkë, me gjith se frazeologjija duket relativisht e ré, është dhe ajo e vjetër fort, dyke i patur rënjët në periudhën bizantine. Këtë e pohon veçanërisht strofa e fundit:

*Vajti fjala gjer ne Mbreti
U thot Mbreti që nga fronti,
— "Këtë djal m'a falni mua;
T' ia ve emrin Kostandin" —*

Emrin *Kostandin* — emër tradicional për mbretërit në perandorinë e Bizantit — përpara invazonit turk — e gjejmë dhe në legjendën mallëngjenjëse të *Kostandinit të vogëlthit*, që e këndojnë në valle, në festat e Pashkëve, arbërit e Italisë, të cilat kanë mbajtur, sa ka qënë e mundur, traditat orthodhokse në atë vënd të huaj.

Gjith me këtë rast u përsëritim besnikëve t'anë porosinë e mbledhjes të ç'do tjetër legjende ose kënge të lindur edhe të zhvilluar në frymën fetare, si edhe përshkrimin e vëndeve të shënjta — kisha, manastire, paraklise, ajazma — si edhe rrojtjen e kondikeve dhe të sendeve të tjera të shenjta.

Është detyra jonë e rëndë kjo që të gjitha ato që na kanë lënë pleqtë t'anë gojë pas goje t'i a lemë brezave që vijnë, me shkrim.

Edhe kjo jo vetëm si një shprehje fetare po edhe si një njohje e vlerës së naltë artistike dhe historike që përmbajnë këto këngë.

JETA KRISTIANE

KËNGË PASHKE PËR VALLE

V. URA E QYSTENDILIT

*O moj dardha mb' udhë,
Që nuk bënje dardhë kurrë.
Se shkuan ca ustallarë
Shkuan të bëjnë një urë, —*

Urë moj ë zeza urë,
 Puno ditë e shëmbu natë.
 Do t'a bëjmë besa-besë
 Kush të sjellë nesër drekë.
 Ngreu e madhja shpjeru bukë.
 Thot: — Kam djalën të sëmurë.
 Ngreu e mesmja shpjeru bukë,
 — I kam duartë me brumë.
 Ngreu e vogla të çosh bukë
 — E kam djalënë në gjumë.
 Djalënë t'a mbaj unë.
 — Puna mbarë, o ustallarë,
 Urdhëroni zini bukë,
 Ç'ke im-zot që lëshou lotë?
 Më ra unaza në gropë
 — Njërën sis' m'a lini jashtë,
 Të m'a pij' fakiri djalë.

VI. QËNKSHIN, LELË, QËNKSHIN.

Qënkshin, lele, qënkshin,
 Qënkshin tre vëllezër;
 Kurdisn' e bënë një urë:
 Natën bëhshe, ditë prishçe.
 U doli një plak me mjekër:
 — “Puna mbar” o djemt e mij”.
 — “Misardhe, o babaj, ynë
 “Qysh t'ia bëjmë kësaj pune?
 “Natën behet, ditën prishet”.
 — “Të zini me besa-besë
 “Y grave mos u rrëfeni”.
 I madhi do! i pabesë,
 Së shoqes i kish rrëfyer. —
 I mesmi do! i pabesë,
 Së shoqes i kish rrëfyer. —
 — “ Ngreu e madhja shpjerru drekë”
 — “Kam këmishëtë në lumë”
 — “Ngreu e mesmja shpjerru drekë
 — “Kam çyrekëtë në furrë”.

— “Ngreu e vogla shpjerru drekë
 — “Kam Nikollaqnë më gjumë
 Edhe ftinë për të tundur.
 — Nikollaqnë t'a mbaj unë
 “Edhe ftinë t'a tunt unë”
 — “Puna mbar' o t'im kunetër”.
 — “Misardhe, kunata jonë”,
 — “Ç'pat im-zot që ra përmbys” ?
 — “I ra unaza në pus”.
 — “Jam e motr' e gjashtë vëllezër.
 “Tre kujunxhinj, tre papuxhinj,
 “Pa ia tret, ia bëj flori,
 — “Si mjer' ti, ime kunatë,
 “Që do mbërthehesh në urë.
 — “Siç më dridhet zemra mua :
 “Ashtu u drehtë kjo urë,
 “Sa flokë që kam në kokë :
 “Aq njerës rënçin këtunë.
 “Amanet-ni Nikollaqnë,
 “Një gji të ma lini jashtë,
 “Të m'a pijë Nikollaqi”.

VII. TATKË TË THËRRET JOT ËMË.

Tatkë të thërret jot ëmë,

Tintërnanina, / Ref.
 Tintërnauina. \

— Le t'thërrësë sa të dojë,
 Kush i tha të më martojë ;
 Më dha burrë dyzet vjet,
 Që më mot dola me djalë,
 Vajti fjala gjer ne mbreti, —
 U hodh mbreti që nga fronti :
 Këte djal m'a falni mua
 T' ia ve embrin Kostandin.

Mbledhur prej
 M. Kutelit

Fjalor i vogël i Dhjatës së Re

II.

DARKA E PASHKËS.— Për darkën e Pashkës që, për herë të fundit hëngri Zoti ynë Iisu Krisht bashkë me nxënësit e Tij, na japin njoftime, me më shumë ose më pakë hollësira, që të katër ungjilltarët. (Shih: Mat. 26, 20-29; Mark. 14, 17-25; Lluk. 22, 14-30; Joan 13, 1-30). Dihet, që në këtë darkë të fundit, Shpëtimtari themeloi dhe Kungatën e shenjtë. Të katër ungjijt plotsojnë njeri tjetrin në përshkrimin e kësaj ngjarjeje. Eshtë zor të caktojmë rregullin pas të cilit u-çvilluan momentet e ndryshme. Ata që janë marrë me këto shpjegime, kanë pikëpamje të ndryshme. Rregulli që mbahej prej Ebrejvet në të ngrënët e qëngjit të Pashkës, rregull të cilin pak a shumë do t'a ketë respektuar dhe Shpëtimtari, nga sa kuptohet prej Ungjijvet, është ky:

Darka e Pashkës fillonte pas perëndimit të djellit, më 14 Nisan. Në pasdrekën e 14 Nisan-it bëhej therorë në tempull një qëngj ose një keç, të cilin pastaj e piqnin me kujdes pa i thyer ndonjë kockë.

Mbrëmanet pastaj mblihdeshin në gosti, e cila çvillohej pas një rregulli të caktuar. Talmudi na ka ruajtur mjaft hollësira mbi këtë pikë. Në darkën munt të mirnin pjesë jo më pakë se dhjet veta as më shumë se njëzet. Të ftuarit rrinin shtrirë nëpër dysheqet me krahun e majtë të mbështetur mbi jeteqe e me krahun e djathtë krejt të lirë. Kishte mjaft kohë q' ishte lenë zakoni për të ngrënë Pashkën në këmbë, me një shkop në dorë, gati si për udhëtim, gjë që simbolizonte ikjen nga Egjypti, natën e lirisë. (Të dalët 12, 11).

Nisjen e festës së Pashkës e lajmëronte kryetari i familjes me një kupë të mbushur me verë, dyke thënë bekimin në këtë mënyrë: «Kjo është koha e liris s'onë dhe na kujton daljen nga Egjypti. I bekuar qoft Zoti, i panisëshmi, që bëri pemën e rushit!» Pastaj pinte verë prej kupës, të cilën u a jipte dhe të tjerëvet që të bënëin po kështu. Si mbaronte këjo, sillnin një legen me ujë e një peshqir për të larë të gjithë duartë. Pastaj vihej tryeza. Mbi tryezë ishin përveç qëngjit, barishte të hidhëta për kujtim të vuajtjevet që pësuan në Egjypt, buk' e pabrumtë e pa krypë si ajo në kohë

së shpejtë të israilitëvet nga Egjypti, një pjatë me uthull, ose me ujë të krykur. që u kujtonte atyreve lotët e derdhura prej gjyshërvet të tyre; më në fund dhe një lloj të gatuar të quajtur *karoshet*, që bëhej prej mollësh, bajamesh, fiqsh, efj. të ziera me verë. I zoti i shtëpis thoshte: «I bekuar qoftë Zoti, që bëri pemët e dheut!» dhe si merte pastaj barishtet e hidhura, i ngrinte lart e shtonte: «Neve i hamë këto barishte të hidhura, pse Egjyptasit kanë mbushur me hidhërim jetën e atërvet t'anë». I kredhte pastaj në uthull dhe hante një pjesë, gjë të cilën e bënëin dhe të tjerët me radhë. Pas kësaj, hiqej tryeza pak si me një anë dhe kryetari i familjes. ose djali m'i math, lëçitte një pjesë nga bibla si p.sh. nga Nomi i dyt (kr. 26) ose thoshte pakë fjalë mbi pashkën ase për të dalurit nga Egjypti. Passi mbarohej dhe fjalimi, sillej prapë tryeza në mes, këndohej pjesa e parë nga *Hallel-i* (psalmët 113 e 114), pihej kupa e dytë me verë edhe lanin prapë duart. Pas kësaj fillonte darka me kuptimin e plot të fjalës. Kryetari i familjes, dyke patur përpara dy bukë, bekonte njerën, e priste pjesë-pjesë. mirte një copë, e mbështillte me barishte të hidhura, e ngjyente në karoshet dhe, pasi falënderonte Zotin, e hante. Njëkohësisht po këtë punë bënte dhe me qëngjin e Pashkës. Passi domethënë falënderonte Zotin, e priste qëngjin pjesë-pjesë dhe me bukë të pa brumtë, të ngjyer në karoshet, u a ndante të ftuarvet. Në mbarim të darkës, ay qitte dhe kupën e tretë me verë, që quhej kup' e bekimit, se atë kohë falënderonin Zotin për darkën e Pashkës që i vlerësoi të marrin pjesë. Si këndonin pastaj dhe pjesën e dytë nga *Hallel-i* (psalm 115-138) dhe pinin edhe kupën e katërtë, ca herë dhe të pestën po kurrë më shumë, darka merrte fund.

Nëse tani bëjmë një krahasim të njoftimevet të ndryshme që na japin Ungjijt për darkën që Shpëtimtari hëngri për të fundit herë me nxënësit e tij, me zakonet e ndryshme ebraike, arrijmë në këto përfundime:

1. Ipotheza e një darke tjetër, pas Darkës së Pashkës duhet përjashtuar, se është në kundërshtim me zakonet ebraike dhe me njoftimet ungjillore. Ungjijt jo vetëm që nuk lenë të parashikohet as shënja m' e vogël, por e rrëzojmë

plotësisht këtë ipotezë kur thonë që lisuj dhe apostojtë duall-në q'andej pasi kënduan ymnin, nga pjesa e dytë e Hallel-it.

2. Larja e këmbëve u-bë në fillim të darkës: ose kur hynë në dhomë ose pas bekimit të kupës së parë, në kohën kur bëhej të larët e duarvet, para d.m.th. se t' afrohej tryeza me gjellërat. Me gjith këtë, ca shpjegonjës, dyke u-bazuar në fjalët *cena facta* të Vulgatës (Joan. 13, 1), e kanë vënë larjen e këmbëve pas mbarimit të darkës. Dorëshkrimet në gjuhën greke thonë. *dhipnu jinoménu*, gjatë darkës, kur po bëhej darka dhe jo *jenoménu*, pas darkës, gjë që na bën të besojmë pikëpamjen e parë.

3. Koha kur pikërisht u-themelua misteri i kungatës së shenjtë gjat darkës së Pashkës, është zor që të caktohet. Besohet që bekimi i bukës dhe i verës u-bë nga mbarimi i darkës. Ungjilltarët Mattheu (26, 26) dhe Marku (14, 22) tregojnë se të dy bekimet u-bënë në kohën kur ata ishin dyke ngrënë *esthiónton aflón, mandicandibus illis*, ndoshta nga mbarimi, në kupat e fundit me të cilat mbyllej zakonisht darka. Llukaj e thotë më haptas që bekimi i kupës u-bë pasi u-darkuan, *metà tú dhipnise, postquam cenavit*, d. m.th. pas mbarimit të darkës dhe para këndimit të pjesës së dytë nga Hallel-i.

4. Përsa i përket ndodhjes së Judhës kur u-themelua kungata hyjnore si dhe të kungimit të tij, pikëpamjet e shpjegonjësvet ndryshojnë. Atërit dhe shpjegonjësit e vjetër t' Ungjillit pranojnë se Judha ka qenë prezent kur u-themelua misteri i kungatës dhe se u-kungua, kurse një pjesë nga shpjegonjësit e sotëm thonë se Judha nuk u-kungua. Të parët u-bazuan ne Llukaj (22, 21), të fundit ne Joani (22, 26-30). Ndryshimi rrjeth nga që Ungjillorët në rrjeshtimin e ngjarjevet shpesh herë nuk ndjekin rregullin kronologjik.

Shpëtuntari e festoi Darkën e Pashkës në mbrëmjen e ditës së 13 Nisan-it: pra një ditë para fillimit të kremtës së të pa brumtëvet dhe të qëngjit e Pashkës. Atë mbrëmje dhe n'atë darkë Ay themeloi Mysterin e Kungatës hyjnore. Kisha e jonë orthodhokse e mbështetur në këtë fakt, përdor për kungatën hyjnore bukë të brumtë, sepse n'atë moment më 13 Nisan s' kishte bukë të pa brumtë e nga ana tjetër duhej që Dhjata e Re të ndryshonte nga Dhjata e Vjetër, q' ishte hieja e së parës.

PËRSHTYPJE DHE MENDIME

Mesazhi i Kryetarit të Këshillit të Naltë

Me rastin e vitit të ri, Kryetari i Këshillit të Naltë Z. M. Frashëri i lëshoi popullit Shqiptar një mesazh të gjatë, dyke e ftuar popullin të heqë dorë nga grindjet e të bashkohet si një trup, për t'u bërë ballë rrethanave të kritikëshme që po kalojmë. E kënduam këtë mesazh me një gëzim e një kënaqësi të veçantë dhe aprovojmë plotësisht pjesën e tij që flet për bashkim e për vllazërim. Thomi me kënaqësi të veçantë se këto predikime për vëllazërim pajtohen fije për fije me parimet e lartëra të Doktrinës Krishtënore, që mundohet të përhapë revista e jonë. Paqë, dashuri dhe vëllazërim janë parimet themelore, mbi të cilat është ndërtuar ndërtesa e shenjtë e Krishtënitimit dhe rreth këtyre parimevet sillen tërë studimet e artikujt e revistës s'onë gjat katër vjetëve me radhë. Sidomos në këto vjetët e fundit, kur për fat të keq u çfaqnë shenja grindjesh e mosmarëveshjesh midis popullit Shqiptar, revista e jonë e quajti për detyrë të shenjtë që të dyfishojë përpjekjet e saj rreth pikës së bashkimit të kombit të tërë dhe me artikuj e me predikime nga shtyllat e saj të trumbetojë an' e mbanë Shqipërisë të vërtetën historike se vetëm bashkimi e dashurija mund t'i shpëtojnë popujt nga çkatërrimi dhe t'i shpijen në rrugën e përparimit e të lumtërisë. Historia me të vërtetë na mëson se përparimi e lulëzimi i një kombi është lidhur ngushtë

me bashkimin e me dashurinë që kanë në mes të tyre tërë pjestarët e këtij Kombi; kurse prishja dhe çkatërimi i popujvet është pjellë dhe rrjedhje e përçarjevet dhe e grindjevet të tyre me shoq shoqin.

Kjo e vërtetë historike që vërtetohet edhe prej provës së përgjithëshme, është në pajtim të plotë edhe me predikimet e lartëra të dashurisë e të vllazërimit që predikon feja e jonë që kur u çfaq e gjer më ditët të sotme.

Ja pra pse e duartrokitmë mesazhin e Z. M. Fra-shërit dhe theksojmë dhe një herë në këtë shtyllë, se *tërë shqiptarët pa dallim feje dhe pikpamjesh Politike duhet të bashkohen në këto çaste kritike për vëndin t' onë dhe të heqin dorë nga çdo grindje e përçarje dyke i zgjatur dorën njeri t'jatri, për të shpëtuar atdheun e dashur nga pasoje të dëmshme e të rezikëshme.*

„I mëshirëshëm e i dhempshur”

Viti i ri 1944 e gjen përsëri njerëzinë në përleshje të madhe, nënë tmerin e luftës që çpërndan kudo prishje e çkatërim. Edhe çdo-njeri me të drejtë pyet: Ç' do të na sjellë vall ky vit i ri? Do të na sjellë paqën e shumë-dëshiruar a po zgjatjen edhe më të luftës, pra dhe të çkatërimit? Këto pyetje mundet ndoshta të mos shprehen jasht, por ndodhen sigurisht në çdo zemër; edhe siç janë punët sot, s' munt t' u jepet një përgjegje e sigurtë. Mirëpo ajo që në këtë rast nuk duhet të harrohet është, se, sido që të jetë puna, ne jemi nën dorën e fortë të Zotit dhe se lutjet t' ona duhet t' i drejtohen pa pushim Atij, që të tregohet i mëshirshëm e i dhempshur me njerëzinë, të largojë këtë tmer e çkatërim, t' i drejtojë kombet në kuptimin e vërtet të jetës e me anë t' atij në paqën e vërtet' e të sigurtë.

E nesërmja pas luftës

Sikur të mos mjaftonte agonia që na shkaktojnë ngjarjet e tanishme, ka nisur të flitet andej-këtej si do të qëndrojë puna pasi të mbarojë lufta. Do të jet' e fundit vallë këjo luftë a po pas një pushimi të shkurtë, gjat të cilit do të pregatiten armë më të përsosura e më të tmerëshme, do të fillojë përsëri çdukja e sho-shoqit? Këjo pyetje ndonëse duket pak si skolastike, është me gjith këtë themelore për ç'ka ka për t' u-bërë pas luftës. Dhe përgjegja është e lehtë. Nëse e liga do të shërohet që nga rrënja, edhe njerëzia atëhere do të gëzojë një paqë të vazhduarshme; nëse jo, lufta do të ripërsëritet. Edhe e liga kryesore prej së cilës rrjedhin të gjitha të ligat e tjera, është *dëshira e njeriut që, në qendrën e të gjitha sendeve, të verë, në vënt të Perëndisë, vehten e tij*. Do të bindet vall njeriu nga ngjarjet e tanishme e t' arthme, që Perëndinë s' munt t' a zëvendësojë kurr gjë ?

MENDIME T' ARTA

Mjeku gjykon mbi gjëndjen, në të cilën ndodhet zemra e njeriut nga të rrahurat e saja, dhe jo nga fjalët që thotë goja e tij. Pikërisht ashtu edhe mirënjohjtja e njeriut kundrejt mirëbërësve të tij — e sidomos ndaj mirëbërësit më të madh, Krishtit — gjykohet më tepër nga sjellja e tij dhe nga mënyra e jetës, dhe jo nga fjalët shprestarije që thotë orë e çast.

* * *

Shprestarija e vërtetë ka si shenja dallonjëse përlësinë dhe dinjitetin; kurse trimërija e vërtetë dallohet me anën e modestisë dhe të rëndësisë.

* * *

Nga tërë njohënit' e kësaj bote më e vështirë është kjo: t' a njohësh vehtën t' ende, thoshte fillozofi i vjetër Thales Milesiani.

F A R I S E N J Ë T

(Vazhdim)

Nga kjo edhe fjala Farise filloj të shënojë ypokritin. Vetëm një pushtet njihnin Farisenjtë, Hyjnoren, për këtë u kish dhën edhe shumë punë kjo problemë mbi marrëdhënien me zotësimin Romak, për të cilën ja paraqitën edhe Zotit Tonë «Thuaj—na pra, Ç'të duket? është e udhës t'i apëmë pagesë Qesarit, apo jo?» (Matth. 22, 17). Me gjithë se njihnin vetëm pushtetin Hyjner, nuk ishin anëtar të kryengritjes, kundra Romanvet, po shpëtimin e prisnin prej Messisë, për këtë në rrethet farisaike idhet Messijake ishin të shquara e të shvilluara. Këta mbesonin edhe gjendjen e ęngjėvet si edhe gjykimin e ngjalljen sė vdekurish tē njersvet, pēr shėrbimin e secilit pas vepravet tē tij: «*athanaton te ishin taes psihes pistis autois einai i ypo hthonos dhikatoiseis te kai timas, ois aretis i kakias epitidheusis en to bio gegonen*» (Iosipos: Arh. XVIII, 1,3). Me gjithë se mbesonin nē njē person plotpushtetēs Zot, kishin si pas vėrtetimevet tē Iosipojit, edhe mėsım mbi fatin (imarmenis), e cila si pas disa shēnime tē tij, ngrinte krejt lirinē e njerit» *prassesthai te emarmeni ta panda aksiuntes* (Arh. XVIII, 1,3) dhe si pas shumē shēnimesh tē tjera tē shumta po tē ati Iosipojit fati shfaqet e pėrkufizuarē «*oi men oyn Farisaioi tina kai oy panta tis eimarmenis ergon eine legusi, tina dh'ef'eaytois yparhein symbainein te kai mi gignesthai* (Arh. XIII,5,9),.....

«Fati dhe Zoti takojnē gjithnjē, tē bėrēt tē drejtēn ose jo, nē shumic tē njersve ėsht, qē tē ndihmohet edhe prej fatit» (Arh. XVIII,1,3).

Gjer në ç'pik Josipoj na e përshkruan të drejtën e mësimevet të Farisevet, ose thekson shvillimin mbase të mësimit të Farisenjvet për njohjen e provanis (pronoias) Hyjnore, nuk mundemi sigurisht që ta caktojmë.

Në kundërshtim me Farisenjët, u quajtën kështu mbase prej kryetarit të tyre Saddok, i panjohur dhe i paditur nër në. Këta formonin një grup më vehte, të cilën Josipoj, si «Sekt», baras me ate të Farisenjvet e quan.

Në kundërshtim me Farisenjët, Saddukenjët, ishin meitimlirë (me idhera të reja të kohës). Në kundërshtim me Farisenjët nuk pranonin gojddhanat e pasanikvet, njihnin vetëm Ligjin dhe Profitët, mohonin gjendjen e ëngjëvet (Veprat. 23,8) dhe nuk pranonin ngjalljen e të vdekurvet (Matth. 22,23. Vepr. 23,8) kishën përqendruar veshtrimin në jetën tokësore. E lironin njerin nga mësimi i farisenjvet mbi fatin, njihnin lirin e plot të njeriut. Shpëtimin nga rrobërija Romak e prisnin prej fuqisë së popullit të tyre, prej kryengritjes dhe jo prej Messiut, siç thoshnin Farisenjët. Pa ndyshim mësimi i Saddukenjvet kish disa pika që kalonin mësimet farisaike. Për arsye të mos pranimit gojddhanavet Rabbinike, dhe për prierien e tyre fisënore dhe dijen e përjashtme, nuk mundën në shumicën e popullit të kenë fuqin siç e kishën farisenjët. Ndështypija e Saddukenjve ish e kufizuar në rrethet e të pasurve dhe të aristokratvet, kur se Farisenjët admiroheshin prej shumicës, duke u marrë si njerës të posaçmë e të shquarë: «Kaqe fuqi kanë (Farisenjët) në popull sa që po të thoshnin gjë kundra mbretit ose kryepriftit mbesohen.....Saddukenjën bindin vetëm të pasurit, komuniteti nuk është i tyre, kurse Farisenjët ka popullin më vehte» (Josipoj Arh. XII,10,5—6). Po edhe prej rrethit të Farisenjvet nuk mungonin fytyra të shquara (Lluk. 23,50,Io 3,1). Edhe ay Apostoll Pavli dikur bënte pjesë në sektin e Farisenjvet (Vep. 23,6. Filipp. 3,5).

Për këte fuqin e tyre Farisenjët ishin madhështor, lavdidashës, donin të dukeshin dhe qibra, i shquante veprat e tyre. U pëlqente të përshëndeteshin botësisht, të grisheshin në darka e zjafete, të zenë vendin e nderit, dhe

botërisht për dukje plotësonin detyrat e tyre fetare, dhe për këtë Zoti Ynë i luftoj rreptësisht.

Tuke rikqyrur të më sipërmet, shohim se hasidim dhe pasardhësit e tyre Farisenjët e Iudhaismit edhe dobi i bënë fees së tyre po njëkohësisht edhe dëm. I bënë dobi, përse formuan një fuqi mjaft të fort për rruajtjen e fees israilite dhe përmbajtjen e ndërgjegjies kombëtare të Iudhejvet kundra rymës së qytetërimit helinoromak, duke punuar edhe për përhapjen e Iudhaismit (Matth. 23,15 «Mjerë ju Shkronjës edhe Farisenj, ipokritër; se shetitni detin'edhe tokënë për të bërë një të-kthyerë; edhe si të bënëtetë, e bëni ate bir gjeheune dy herë më tepërë se vetëhenë t'uaj»).

Demtuanë më tjetër anë, se mbaitën shpirtin iudhaikë dhe kuptesën e tyre mendore të mbyllur prej rilindjes që bëhesh rreth tyre në Anatoli, dhe mbytën me shenjat e përjashtme të ligjit, dhe mbajtjen e thatë të typeve të përjashtme të fees, frymën e fees israilite. Vetëm një pikpamja, fanatizmi kombëtar (fisënor), i shpjeguar prej ndodhnavet të përjashtme historike, krijimi i that, i përjashtme fetar, që nuk mundi të preki brendësin e shpirtit të njeriut, veprimi dhe lavdidashja, janë shenja të erta të Farisaismit. Kaq këta sa edhe Saddukenjët, ishin larkë nga fryma e vërtetë të fees. Për këtë në Farisenjët me zell e nxehtësi lavrohesh Messianizma, dhe nuk mundën të kuptonin mësimin e lartë të Mësisë. Mungonte prej tyresh fryma e vërtetë fetare, mundësia për pranimin të fees së re të Hyjit-njeri.

Bardhyli

MENDIME T'ARTA

Ajo shoqëri është pa dyshim më e përsosun dhe më e lumtur, e cila përbëhet prej familjesh që çquhen për moralin e për karakterin e mirë.

* * *

Ay që flet keq për baban e tij është sikur fyen Perëndinë.

Nga kryeveprat e Gojartit

Nuk është çështje kohe!

Le të kujdesohemi, vëllezër të dashur, për një çështje aq të rëndësishme, si është ndreqja e shpirtit t'onë. Kur është dëshira dhe vullneti i mirë, abere s'ka asnjë urdhër e asnjë porosi hyjnore, që të mos bëhet prej njeriut. Thonë ca se nuk është e mundur të çkulim nga shpirti veset që kanë hyrë n'atë prej kohe dhe që kanë zënë rënjë shumë fellë. Këtyrevet pra unë po u jap këtë përgjigje: Kur është puna të bëjmë nonjë nga ato që dëshëron e që urdhëron Zoti as koha e gjatë nuk ka rëndësi, as vjetët e pakta nuk lozin nonjë rol; ajo që na duhet për këtë punë është kjo: frika e Perëndisë dhe një shpirt plot me shprestari, me dashuri e me shpresë. Kur kemi këto, fitorja ka për t'ardhur pa t'atër dhe shumë shpejt.

Mund të kujtojë dikush se këto që thom janë të tepëruara dhe nuk mund të besohen aq lehtë. Aspak. Përkundrazi janë të vërteta që provohen prej ngjarjesh që kauë ngjarë në kohët e kaluara. Kush ka qënë më shumë barbar, se Nivevitët? Kush ka qënë më i pa ditur se këta? Me gjithë këtë këta të paditurit e barbarët, këta që s'kishin dëgjuar kurrë nonjë doktrinë filozofike ose nonjë predikim profetësh, këta që s'kishin marë porosi si neve, këta pra ç'bënë dhe si u-suallnë? Posa dëgjuan profetin Jona që tha: "Edhe tri ditë edhe qyteti Nivevi do të shkatrohet", në tri ditë sipër çduknë nga shpirti i tyre çdo ves e zakon të lik. Me një herë pra i padrejti u-bë i drejtë, i ligu u bë i mirë, i egëri u-bë i butë, lakmonjësi dhe vjedhësi u-bënë njerës të urtë e të ndershëm, përtaci u-bë puntor.

Me të vërtet këta nuk çkulnë një, dy ose tre vese të liga që kishin, po tërë zakonet e dobëta i flaknë atje tutje dhe kështu ndreqja shpirtërore u-bë e plotë. E kjo duket nga fjalët e profetit vetë se ky q'i kishte qërtuar reptë për ligësitë, dhe që kishte thënë se ligësija e tyre arivi gjer në qiell, ky prapë foli më vonë krejt ndryshe dhe tha: "Pa Zoti se të gjithë u-larguan nga mekata".

E pastaj, o vëllezër, nuk është turp për neve dhe nuk

duhet të skuqemi nga turpi, kur shohim se njerës barbarë në tri ditë e sipër e shtypnë ligësinë q'i kishte pushtuar, kurse neve na duket gjë e vështirë dhe e madhe të çporim goftë dhe një zakon të keq, ndonse kemi aqë kohë që po dëgjojmë fjalën e Zotit dhe porositë hyjnore? Dhe shih se ata me të vërtet kishin arrirë në kulmin e paudhësivët e të mekatavet, siç e vërtetoi Vetë Perëndija kur tha: "Klithma e ligësisë së tyre u-ngjijt gjer në mua". Me gjithë këtë tri ditë mjaftuan për t'u hedhur në rrugën e vërtetë. Se atje ku është firikë Perëndije, nuk duhen as kohë e gjatë, as shumë ditë. Përkundrazi, kur mungon frika e Zotit nuk të mjaftojnë as vjete të tërë.

Përkthyer prej Shpresëtarit.

LAJME TË MBRENDSHME

—Edhe simvjet të kremtet e shenjta të Krisht Lindjes të Shën-Vasilit dhe të Ujit të Bekuar u-kremtuan madhërisht në Kryeqytet. Kisha ishte plot me besnikë. Ceremonit fetare u kryesuan prej Kr. H. Tij Kryepiskopit Imzot Kristoforit si edhe prej H. P. Imzot Irineut. Kori Mikst këndoi gjith hymnet e shenjta të Meshës. Në fjalimin që Kryehirësija e tij Kryepiskopi mbajti me rastin e Lindjes e së Krishlit çfaqti urimin që Zoti i math t'u ndriçoj mëndjen dirizhonjëset të kombevet për t'i dhënë fund kësaj lufte aqë të tmerëshme dhe të vendoset në botë një paqe me drejtësi.

— Një komision i përbërë prej dy anëtarëvet të këshillit të Hlrëshme Mikst dhe dy të Këshillit Ekonomik të përherëshëm, nën kryesin e Kr. H. Tij Kryepiskopit Imzot Kristoforit, në fillim të muajit Nëntor bëri një lutje për anë Kryekonsullatës

Gjermane në Tiranë për sjelljen mundësisht dhe gjykimin në atdhe të një qind e ca personave nga Vlora që janë internuar jashtë shtetit. Kryekonsulli e siguroj komisionin se lutjen do t'a parashtrjë ku duhet.

— Gjithashtu nën Kryesin e Kryehirësis Tij Imzot Kristoforit një komision tjetër i përbërë prej Z.Z. Dom. Shtjefën Kurti, Ik At Erazmi, Kiço Koçi, Kristaq Zaguridha, Ramazan Jella, Vangjel Manushi, Veli bej Juba, Vangjel Anastasiadhi, Telemak Nushi, Aver Averiku, Spiro Kallco dhe Hysen Çela, vizitoi me 19 të m. Nëntor v. k. Shk. Tij Kryeministrin dhe i paraqiti gjëndjen e t'arestuarvet të Durrësit e të Kavajës. Shk. Tij Kryeministri e siguroi komisionin se çështja do të kqyrej me drejtësi. Edhe vërtet pas pak ditësh pjesa më e madhe e t'arestuarvet është çliruar, gjë për të cilën Kr. H.

Tij Kryepiskopi i paraqiti n' emër të komisionit Shk.Tij Kryepiskopit një shkresë falenderimi duke çfaqur njëkohësisht shpresën se edhe një pjesë tjetër do të lirohej së shpejti.

— Më 31 të muajit të kaluar umbloth nën kryesinë e Kryehirësisë Tij Kryepiskopit Imzot Kristoforit Këshilla Kishtarë e Komunitit Orthodhoks të Tiranës dhe mbylli Hlogarit e Kishës së Re të Shën Prokopit që kapin shumën e përgjithëshme prej Fr. 273.713.91. Gjithashtu vendosi që të vihen dhe kambanat në kambanarjon e re të Kishës Kathebrale.

— Me vendim të Këshillit Ekonomik të Përherëshëm dhe me dekret Kryepiskopal, i përnd. At Aleks Mihali është emëruar igumen i Manastirit të hirëshmë të Kamenicës në qarkun e Korçës.

— Të Përndershmit At Marko Papajani famulltar i Tiranës si edhe të Përnd. Ierom. Dhanielit, igumen i Monastirit të Sh. Gjon Vlladhimirit, u-është dhënë nga ana e Kryesisë së Kishës grada e ekonomit.

— Në rastin e festave të Shenjta Kryesia e Kishës, përveç ndihmave të ndryshme në të holla që u ka dhënë njerëzvet të vobektë, ka ndarë dhe një sasi

gruri nër më se 50 familje të vobekta. Njëkohësisht mjaft familje të këputura qërdhën prej Durrësi i ka vendosur përkohësisht në dhomat boshe si të Seminarit ashtu dhe të Mitropolitë.

— Gjithashtu dhe Kisha Katedrale e Kryeqytetit nga ana tjetër, me rastin e Krisht-lindjes, ndihmën mujore që u jep familjeve të vobekta, për muajin Dhjetor u a dha të dyfishtë, përveç ca ndihmave të tjera nga ana e besnikëve.

— Ka disa kohë që Kryesia e Kishës, tue marrë parasysh Vendimin e Përbashkët të Këshillave Mikst edhe Ekonomik si edhe nevojën që çfaqun në rrethet e Peskopisë edhe të Strugë spër gjykimin e disa çështjeve të rëndit kishtar, urdhëroi formimin e Gjyqit Kishëtar në Strugë, për gjykimin e atyre çështjeve që janë më të ngutëshme. Rellativisht, Kryesia e Kishës ka dhënë instruksionet e duhuna që prej Gjyqit Kishëtar të përmërdur të kryen vetëm çështje pajtimesh midis bashkëshortëve, tue u-përgjashtue tash për tash çështjet e çkunorezimevet, të cilat kanë nevojë për një procedurë të imtë dhe mjaft të gjatë dhe kërkojnë që gjykimi i tyre të bëhet në prezencën e Episkopit kompetent.

JETA KRISTIANE

RIVISTË FETARE E PËRMUAJSHME

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

VIT i IV-të

SHKURT 1944

Nr. 12

LANDA: Të kthehemi në rrugën e Perëndis. — Feja dhe Shkenca. — Joan Kukuzeli nga Durrësi. — Logjika. — Ideja Fetare Ruse. — Cilët janë shkaqet e luftës s'ardhëshme. — Nga thesarët e Orthodhoksis Shqiptare. — Fjalor i vogël i Dhjatës së Re. — Lajme Kishtare.

Të kthehemi në rrugën e Perëndis

Arsya më e thellë e luftave nërkombtare dhe trazirave shoqnore, që kanë mbulue gjithë botën dhe vëndin t'onë dhe i kanë kredhun n'anarkhi e shkatrim, është pa dyshim mungesa e edukatës fetare dhe, pra, largimi i nierzis nga Perëndia, nga feja, nga Kisha.

Sikundër ç'do familje e vogël, për mirëqenien dhe mbarëvajtjen e saj, ka nevojë për një priës, për një babë, ashtu dhe familja e madhe nierzore ka gjithashtu nevojë për një priës, për një babë të madh. Baba i nierzis e i botës është *Perëndia*. Perëndia është aq'e nevojshme për shoqnin nierzore sa dhe baba

për kalamajt e vegjël. Sikundër një familje, kù s'dëgjon i vogli të madhin, bie n'anarkhi, shkatrim e mjerim, ashtu dhe familja e madhe nierzore, kur nierzit s'dëgjojn urdhnat e babës së madh *Perëndi*, bie dhe kjo n'anarkhi, në shkatrim e në mjerim, si ka rã sod.

Nierzia, pra, dhe sikur të mos merte aspak parasysh arsytet theologjike e filozofike, qi imponojn qënien dhe adhurimin e Perëndis, dhe sikur të mos kujdesej aspak për jetën tej varrit dhe për shpëtimin e shpirtit, por të mejtonte vetëm e vetëm interesin e vet në këtë jetë, vetëm nevojën e rendit moral e shoqnuer, pa të cilin s'mund të rrojë kurresi, i duhet, për të mirën e vetë, t'a njohë Perëndin, t'i falet, t'a adhurojë e t'u bindet ligjavet të Sai, se këto ligja janë bash ato ligja morale q'i sigurojn mirëqënien e lumnin në këtë jetë effemere.

Me-qënë-se përfaqesuësi i Perëndis mbi tokë është Kisha e t'ën Zot Jesu Krishtit; kjo Kishë pra, në kujdesin e sai atnuër, fton gjithë bijt e sai Ortodoksë shqiptarë dhe, për të mirën e tyne, i këshillon:

- 1) Merni udhën e drejtë dhe afrohuni te Perëndia.
- 2) Grumbullo-u-ni reth Kishës, s'uaj, si zoqt rotull kllloçkës.
- 3) Eni dëndur në Kishë, për të dëgjuar fjalën e Zotit.
- 4) Jepuni kalamajvet në shtëpi edukatë fetare e morale.
- 5) Nderoni prindët dhe ma të mëdhenjt; dëgjoni këshillat e tyne.
- 6) Dúani njeni-jatrin dhe tregoni solidarsin kristiane ndai atyne qi vuajn.

Feja dhe Shkenca

Problemi i lindjes së njeriut.

VII

Ligji i pandryshmënisë — E vërteton prova e përditëshme — E vërteton historia natyrore prej kohëve më të vjetra — E vërteton arkeologjia dhe mbeturinat e skeleteve në kohët më të lashta — Si qëndron teoria e Darwin-it përpara këtij ligji — Rëzohet krejt ipozeta e rjedhjes së krijesave të gjalla prej një ose tri protoplazmash — Përfundimi ku na shpje kjo teori: krejt të pa arsyeshme dhe andishkencore — Ligji i pandryshmënisë dhe darvinistët — Ç'thotë Darwin-i vetë — Mendimi i natyralistit ingliz Huxley — Ç'thotë filozofi frënk Littrè.

Ligji i pandryshmënisë nuk vërtetohet vetëm me fenomene fiziologjike dhe vështrime të provës së përditëshme; vërtetohet dhe nga zbulimet që ka nxjerë në shesh kazma e arkeologëve dhe është, mund të thomi, ligji i shekujvet që shihet e që provon në çdo kohë e në çdo periudhë. Me të vërtetë; veprat më të vjetra të historisë së natyrës, skeletet e kafshëve të ndryshme që gjetën herë pas here, fytyrat e ndryshme të kafshëve që ka ruajtur gjër sot skulptura dhe mumjet e Egjiptit, tërë këto provojnë dhe vërtetojnë në mënyrë të pa kundërshtuar se ligji i pandryshmënisë ka vepruar pa mëshirë prej kohëve më të vjetra dhe është ay që rregullon e që sundon botën e krijesave

të gjalla. Me anën e studimevet e vërejtjevet gjeologjike u-gjetnë mbeturina llojesh q'u-çduknë e që nuk shihen më në këtë tokë, po kurrë nuk është gjetur no një mbeturi e cila të tregojë se një lloj u-ndërua në një tjetër, ose prej bashkimit midis dy llojevet nuk del asnjë lloj krejt i ndryshmë. Lloji vdes e çduket, po nuk transformohet në një tjetër, e kështu me anën e këtij ligji mbahet e rûhet harmonia e çuditëshme e botës së krijesavet të gjalla në mes të një sasije të panumurtë llojesh të ndryshme.

Tash pra le të hedhim një sy mbi theorin' e Darwin-it e të shohim se si qëndron kjo përpara ligjit të pandryshmënisë. Le të pranojmë se në planetin t'onë u-çfaq *protoplazma e parë* d.m.th. e parë krijes' e gjallë, nga e cila kanë dalë, siç besojnë Darwinistët, tërë krijesat e gjalla, si edhe njeriu vetë. Në se kjo protoplazmë u krijua prej një fuqije sipër natyrore, — sikundër besojnë Lamark-u, Wallas-i dhe Assa Gray — ose dolli dhe u-çfaq vet-vetiu e automatikisht në fund të detit, siç predikon Hekel-i me shokë—këtë nuk e prekim; se këtë çast kërkojmë të gjejmë, në se nga kjo protoplazmë ka qënë e mundur të dalin llojet e shumta të kafshëvevet me anën e çvillimit. E pra mund të thomi pa drojtje fare, se kjo ipothezë është krejt e pa themeltë, se bje dhe rëzohet krejt prej ligjit të pandryshmënisë, i cili nuk lejon n'asnjë mënyrë që prej një lloji të dalë një lloj tjetër. Kështu pra në se protoplazma ka patur formën e peshkut, duhet të pranojmë se tërë krijesat e gjalla që do të rjedhnin prej saj, do të ruanin karakteristikat e peshkut, sa do që të ndryshojë njëra prej tjetrës, dhe se bashkimi i tyre fiziologjik, ka shkakëtuar gjithënjë lindje. Esht' e vërtetë se nga kjo protoplazmë e parë formë peshku do të lindin me mijëra lloje të ndryshme pishqesh që ndryshojnë fort njeri prej tjetrit, po me gjithë këto ndryshime, do t'i ruanin karakteristikat themelore dhe bashkimi fiziologjik i dy nga këto lloje të ndryshme, nuk do të këputej po do t'ishte gjithënjë pjellore e do të shkakëtonte medoemos lindje. Gjithashtu edhe po t'a zemë se nuk ishte një, po tri protoplazmat e para q'u krijuan ose që duallnë prej tokës vet-vetiu e automatikisht, edhe në këtë rasë nuk do t'ishin

më shumë llojet që do të dilnin prej këtyre vet, se, siç u tha nga bashkimi i tyre nuk do të dilte kursesi ndonjë lloj tjetër krejt i ri, po gjithënjë lloje q'u përngjasin të tri protoplazmave në vetiat e në karakteristikat kryesore. Kështu pra llogjikisht e në themel të ligjit të pandryshmënisë — që vepron pa asnjë përjashtim, si ligjet e tjera natyrore — shumica e pa numurtë e krijesave të gjalla që ndodhen në këtë tokë nuk mund të shpjegohet ndryshe përveç se, dyke pranuar se çdo lloj prej tyre u krijua veç e veç dhe u-çfaq në jetë i pajosur që në fillim me të tëra vetiat e shenjat q'e çquajnë nga llojet e tjerë; se, siç e thamë shpesh herë, ligji i pandryshmënisë nuk na jep leje të besojmë se prej një lloji mund të dalë një lloj tjetër krejt i ndryshëm dhe i ri.

Thamë më sipër se ligji i pandryshmënisë është shkëmbi i fortë, ku pengohen e thyen tërë përpjekjet e mundimet e atyre vet që predikojnë teorinë e çvillimit, si dhe t'atyre vet që janë pasonjës të nxehtë të saj. Këtë gjë e kuptojnë dhe e pohojnë vetë darvinistët që nga Darwin-i e gjer te nxënësit më fanatikë të tij. Darwin-i vetë, duke marrë parasysh veprimin e pamëshirëshëm të ligjit të pandryshmënisë, u shtrëngua të thotë: "Natyalistët, të cilëvet u detyron shkenca përparimet më të mëdha të saj, nuk e pranojnë teorinë t'ime, që predikon rjedhjen e njerit lloji nga një tjetër". E le të mos kujtojë kush, se këtë teori e hedhin poshtë vetëm natyalistë që besojnë në krijimin e botës prej një fuqije sipërnatyrore. Jo. Luftën më të reptë i kanë çpallur disa nga materialistët më të mëdhenj e nga ata që kanë përkrahur me tërë forcat e tyre teorinë e lindjes automatike.

Një nga këta ka qënë materialisti ingliz Huxley. I dëshpëruar ky nga përfundimet e kërkimevet e të prova vet, që rëzuan krejt teorinë e lindjes automatike, u-dha për një kohë të gjatë pas studimit të theorisë së Darwin-it dhe mblodhi shumë fenomene e ngjarje, të cilat, si pas mendimit të tij, i jipnin kësaj theorie arsye të forta e themele të shëndosha. Me gjithë këtë ja se ç'shkruante ky në lidhje me ligjin e pandryshmënisë. " Të gjitha janë pun' e

madhe, thoshte, po kur vjen puna të rëzojmë kundërshtimin e kundërshtarëvet, që na nxjerin përpara *ligjin e pandryshmënisë së llojevet*, ahëre me të vërtet nuk kemi se çtë thomi dhe çdo gjë është e humbur. Sa për mua e pranoj theorin' e Darwin-it, po me këtë kusht: të më jepni d.m.th. prova të sakta se prej një lloji bimësh ose kafshësh mund të dalë një lloj krejt tjetër".

Edhe francezi Littré, i cili, siç dihet, anonte nga parimet e materializmës dhe u muar e ky me studimin e theorisë së çvillimit, nuk i fshehu dot dyshimet e forta, q'i kalli veprimi i ligjit të pandryshmënisë së llojevet. "Pëngimi kryesor ku pengohet doktrina e çvillimit, është pandryshmënia e llojevet; gjer tashi nuk mundmë të ndryshojmë as një lloj e të nxjerim prej këtij një tjetër lloj. Ndryshimet e shumta që mundmë të nxjerim, sado që ndryshojnë në mes të tyre, nuk e humbnë formën e tyre të parë, po e ruajnë gjithënjë të pandryshuar, e nuk arrijtmë dot të nxjerim p.sh. qen prej ulkut. Gjer sa prova nuk do të vërtetojë, se mund të ndryshohen llojet, nuk duhet t'i japim theorisë s'onë fuqi të madhe, se sa i përket".

Shpresëtari.

ANEKDOTË

Të tre vështrimet

Pyetën një herë një njeri shpresëtar si mundej dhe mbante në të gjitha vuajtjet ejetës qetësin shpirtërore. Dhe ay u-përgjeggj: «Ç'do mëngjes, para se të shkoj në punën t'ime e të vij në kontakt me njerëzit e tjerë, e çoj mëndjen në tri gjëra të rëndësishme. Së pari ngre syt e mi në qiell dhe sjell ndër mënt se kujdesi m'i math i imi dhe qëllimi më kryesor i përpjekjevet e mia dhe i jetës s'ime duhet të drejtohet për atje. E dyta, kthej syt e mi në tokë dhe mendoj sa vënt të vogël do të zë kur të ydes, kështu që të gjitha sa kam, do të mbeten kot e pa ndonjë dobi për mua. E treta, shoh përçark meje shumicën e njerësvet që vuajnë dhe durojnë më shumë se unë. Dhe ngushëllohem për të gjitha vuajtjet që më ngjajnë dhe kaloj jetën t'ime në paqtim me vet-veten, me të tjerët e me Zotin».

Joan Kukuzeli nga Durrësi

Ata që ndjekin degën e muzikës dhe sidomos të muzikës kishëtare bizantine, është e pamundur të mos e takojnë emnin e Joan Kukuzelit. Them është e pamundur, pse ky personalitet muzikor ka qenë, pas Joan Dhamasqinit, «i dyti burim» i muzikës Kishëtare dhe një nga lëvtronjësit më të çquar të saj. Ishte nga Durrësi dhe ka jetuar, pas disave në shekullin e XII-të pas Kr., ose pas disa të tjerëve, e sidomos pas Krumbacher-it, në shekullin e XIV-të. Për edukimin e tij kulturor edhe fetar është kujdesuar shumë e ëma, se babaj i kishte vdekur. Ishte i squar dhe i urt, por përmbi të gjitha ka patur një zë aqë të bukur e të jashtëzakonëshmë, sa që kur Joani i vogël këndonte në korin e Kishës, i prekte dhe i entusiasmonte pa masë besnikët që vinin me kënaqësi në kishë për t'a dëgjuar dhe që e quanin «zë ëngjëllor».

Fama e kësaj dhurëti të shquar s'vonoi të mërijë dhe gjër në Konstandinupojë, ku shkoi dhe vet Joani, duke fituar atje me të psalurat e tij dashurin e të gjithëve, si në rethin e patrikanës, ashtu dhe në atë të palatit. E futnë atëhere në shkollën e Muzikës për të fituar edhe artin si ndihmës të zërit të tij të pashembëlltë. Dhe kështu Joani, dal-nga-dal u-bë personaliteti muzikor m'i math i kohës së tij, jo vetëm në kryeqytet, por dhe në gjithë perandorin Bizantine. E rethonin të gjithë me nderime; portat e palatit ishin gjithmon të çelura për t'ë dhe populli shpresatar vraponte me gëzim, bile dhe në të kremtet më të vogëla për t'a dëgjuar.

Mirëpo, ndonëse këto çfaqje nderimi munt të kënaqnin çdo tjetër artist, Joanit s' i pëlqenin; e bënë përkundrazi të mërziut e të hidhërohej. Se, me gjith zellin muzikor që kishte, në shpirtin e tij përmbizotëronte ndjenja e shpresatarisë, që bënte të urrente fodullëkun, të cilin, me të drejtë, e quante si ndyrësi shpirtërore. Prandaj, admirimi dhe gëzimi i popullit dhe i parësisë kur ay psalte në kishë, përgëzimet e shumta që takonte në çdo hap, duartrokitjet dhe urimet që i bëheshin prej mbrëtërvet dhe prej kryepfritërinjve, e bënë të trembej se mos lindej diçka mbrënda

në shpirtin e tij, që do t'a largonte nga udha e drejtë. Dhe që të shpëtojë nga ky ngacmim, mendoi të iknjë. Një natë, pra, i veshur me robe shumë të thjeshta që të mos e njihite njeri n'udhë dhe pa treguar emrin e tij të vërtetë, hypi në një anije dhe zbriti një mëngjez të bukur në anëdetin e Malit të Shenjt.

Atje, natyra e pasur në pyje, burimet dhe përenjt, majat e maleve të mbulëna me dëborë dhe manastiret e bukur ku jetonin larg zhurmës së pasioneve ata që i a kishin dedikuar veten shërbimit të Zotit, e preknë pa masë. Dhe pasi, ajo që e interesonte më tepër ishte të mos e njihnin — sepse e dinte mirë që do t'a kërkonin kur të mirnin vesh se ish larguar — u-paraqit si bari bagtish dhe u-lut që t'a mirnin në shërbim atje. Lutja i u-pranua dhe u-ngarkua me kullotjen e cjepëve Këjo ishte një punë që për të tjerët të kategoris së tij dukej si poshtëronjëse; mirëpo shpirtet e lartë e me vlerë të vërtetë, dijnë të nxjerrin dhe nga gjiri i punëve të ulëta, diçka të madhe e kënaqëse. Dhe ay pra, dyke shkuar me kopën e vet ku ishin kullota të përshtatëshme, ose dyke shëtitur atje ku i a kishte ënda, pasi çonte cjepët në mandrë, gjënte kënaqësi shpirti e mëndjeje në pamjen e natyrës dhe n'atë jetë të lirë ku të gjitha i a drejtonin mëndjen te Zoti, dhe kujtonte me dhimbje e mëshirë atë jetë artificiale të palatit, ku ish bashkuar kotësia me çmendësinë.

Joani donte shumë edhe detin; detin, i cili me qetësin e me furtunën, me kthimin e tij të shpejt nga butësia në egërsi pasqyronte dhe pasqyron aqë bukur fazat e shpirtit dhe të jetës s'onë që ndryshojnë aqë lehtë. Dhe një ditë, ndërsa kulloste cjepët në një kep dhe koha ishte e pastër dhe e qetë dhe asnjë shushullimë s'ndihej, vështroi përçark mos ishte ndonjë njeri dhe, si u-bind që s'kishte asnjë, nisi të psalnjë. Dhe këndoi me aqë pasion e melodi, sikur të dëshironte që muzika e tij t'a çpërblente pasurisht për atë kohë të gjatë të heshtjes së tij, sa që edhe kafshët vet, si të prekur prej artit të jashtëzakonëshme të tij, lanë të ngrenët dhe e shikonin në sy.

Po psalte akoma Joani, kur papritur ndjeu se një nje-

ri po i qëndronte pas. Dyke kthyer kryet, pa vërtet një plak, fytyra e të cilit pasqyronte habinë dhe gëzimin. Ishte një asqet, i cili s' dinte si t'a shprehte me fjalë këtë habi q' e kish pushtuar. Kush do t' ishte pra ky psalt i çuditëshmë, që rall munt të gjendej edhe në qytetet edhe në shkretëritrat shembëll si ky? Joani kursesi s' dëgjoi të japë ndonjë njoftim për veten e tij, me gjith lutjet dhe këmbënguljen e plakut flokë-bardhë. Dhe ky, i hidhëruar pse një talent i till muzikor po shkonte kot dyke kullotur cjepët e dyke jetuar nëpër pyjet, erdhi në Manastirin e Llavrës dhe i a njoftoi igumenit këtë ngjarje të bariut të talentuar.

Lajmi dha shkak për dyshime. Mos vall nënë personin e bariut fshihej Kukuzeli i famëshmë? Sepse brënda kësaj kohe, edhe mbreti edhe patriku e kishin kërkuar me anë të dërguarish dhe në Malin e Shënt, ku kujtonin se do të kish shkuar. Mirëpo kalogjerët s' mundnë të apin asnjë informatë. Edhe tani bile igumeni, s' dinte ç' të bënte.

Dhe që t'a hiqte këtë dyshim, dërgoi më një herë një njeri për t'a thirrur atë bari të cjepeve. Kukuzeli u-shqetësua mjaft nga ajo thirrje e shpejtë pas takimit me asqetin. Ç' duhej të bënte pra?

Për një çast mendoi t' ikte larg, shumë larg. Po ku? Ç' vënt tjetër do t' i falte atij një strehim aqë të dashur e të qet si Ajon-orosi, i mbushur me pemë, i rahur prej valash, i ujitur prej aq' e aqë burimesh? Pas një kohe të shkurtër trënditjeje, vendosi të shkojë te igumeni.

Kur arijti atje, s' e mohoi q' ishte ay vet Kukuzeli. Po brënda kësaj kohe s' duhet harruar se ay ishte bërë dhe kallogjer në Llavrën e shentë. Pse pra t'a largojnë nga ay vënt, me të cilin e lidhnin dëshirat e zemrës, kanunet monahale, sigurimi i shpirtit?

Dhe dëshira i u-plotësua. Pas një ndërmjetësimi të përshtatëshmë të igumenit në patrikanë, i u-dha leja të qëndrojë në Malin e shentë. Dhe që të jipej i tërë pas studimit të punëve të shpirtit dhe të punimit t' artit muzikor, qëndroi, me lejën e të parëve të tij, në një qeli jasht Manastirit, ku ishte dhe një kish' e vogël n'emrin e Kryengjeyvet. Për çdo të Djelë pastaj dhe të kremte të madhe,

zbriste dhe në Kishën e Manastirit, drejtonte korin e djatht dhe psalte siç dinte ay vet. Kallogjerët kënaqeshin dhe ngriheshin shpirtërisht në qiell. Vinin bile dhe nga manastiret e tjerë kallogjerë për t'a dëgjuar. Edhe jo vetëm kallogjerë, por edhe shumë laikë të çdo kategorije si nga qytetet e afërmë ashtu dhe nga kryeqyteti vinin atje, sidomos gjat kreshmevet, për të lavdëruar dhe për të falenderuar Zotin me ato shërbesa plot mystiqismë, të shoqëruara dhe prej muzikës së lartë e t'ëmbël të Kukuzelit. N'atë qeli të thjesht ndërroi dhe jetë në mosbë të shkuar.

Kukuzeli s'ka qënë vetëm zbatonjës i shquar i muzikës kishëtare por dhe një nga mësonjësit më të mirë të sajë, duke vënë ay vetë në muzikë kënga kishëtare të ndryshme dhe duke çvilluar e përmirësuar ato që kishin bërë të tjerët para atij. Por edhe si shpirt shpresëtar dhe i zgjedhur, shquhej me besën e tij të plot, me përvulësin, me butësin dhe me të gjithë virtytet e tjerë që burojnë prej dashurisë së krishtere. Për këto të gjitha Kisha e ka radhiditur në shoqërinë e oshënarëve duke e kujtuar më 1 të Shën-Mitrit.

Rreth punimit që ka bërë Kukuzeli muzikës kishëtare bizantine si dhe rreth veprave që ay ka lënë, kemi shkruar një herë tjetër në faqet e kësaj reviste (Shif: Jeta Kristiane, v. II-të f. 125 dhe 154) kur kemi çvilluar themën «*Historia e këngës kishëtare*». Në artikullin e tanishmë, siç e ka parë dhe vet këndonjësi, u-muarmë vetëm me jetëshkrimin e tij, ashtu siç na e tregon i çuari predikator grek Mihail Galanos në veprën e tij «*Jetëshkrimet e shëntorëve*», botuar në Athinë periodikisht nërmjet viteve 1907-1910. Dhe po e mbyllim këtë artikull duke çfaqur një mendim. Do të jetë një gjë shumë e pëlqyer, që për çdo vit, ditën e kujtimit të këtij personelit të lart muzikor dhe oshënarit të besës s'onë të shenjtë, më 1 të muajit Shën-Mitër, të bëhet në Durrës një meshë madhështore gjat së cilës të theksohet kontributi i madh dhe i çmuar që ky bir i lart i Durrësit i ka dhënë muzikës s'onë kishëtare dhe të nxiret në dritë fytyra e tij madhështore si artist dhe shpresëtar. Eshtë mekat që personelite të këtillë t'artit, që çmohen prej të huajvet, të lihen në haresë prej nesh vet. B.

LOGJIKA

7. Kuptim i idevet

Idënat, të krahasueme njena me tjetrën në bazë të kuptimit dhe të suazës, janë: *kongjene* ase të *subordinueme*, *homogjene* ase të *koordinueme* dhe *heterogjene* ase të *disordinueme*.

1.). Kongjene ase të subordinueme janë idënat, të cilat, njena për tjetrën, janë idé gjeni dhe fari; ase njena përmban tjetrën në suazën e sai, p.sh. *metal-ar*. — Sosh, ajo qi përmban quhet *sipërordinueme* ase *superiore* ase *gjen* dhe ajo qi përmbahet quhet *subordinueme* ase *inferiore* ase *far* (*espèce*). — Këto idëna quhen dhe *subalterne*. — Rrapporti midis tyne quhet *subordinim*.

2). Homogjene ase të koordinueme janë idënat qi kanë komune idën e gjenit, ase qi përmbahen në po atë idé superiore, p sh. *ar-hekur* (metal), *ar-mos-ar* (metal). Këto idëna quhen dhe *parallèle*. Idënat homogjene, secila veçaz ndai idës superiore, janë kongjene. Rrapporti midis tyne quhet *koordinim*.

3). Heterogjene ase të disordinueme janë idënat qi kanë të ndryshme idën e gjenit, ase qi përmbahen në idëna superiore të ndryshme, p.sh. *ar* (metal) — *lopë* (kafshë) Relata midis tyne quhet *disordinim*.

Në librat e logjikës figurojn dhe këto relata idënash: *identike*, *kontradiktore*, *kontrare*, *konveniente*, *repugnante* dhe *t'intersektueme*. Por pa arsye.

Idënat identike (equipollente) nuk janë idëna, por emna e formula verbafe ase definime të një ideje të vetme, p. sh. *rezë* dhe *gjysmëdiametër*. Barazimet (equation) matematikë, qi dikush i rjeshton gabimisht nër idënat identike, nuk janë relata kuptimi ase suaze, por relata sasie, pra, s'e kanë këtu vëndin.

Idënat kontradiktore s'janë veç idëna homogjene ase të koordinueme, se kanë komune idën e gjenit, p. sh. *ar-mos-ar* (metal).

Idënat kontrare, gjithashtu, janë idëna homogjene, se

kanë komune idén e gjënit, p. sh. *ar-hekur* (metal), e *bardhë* — e *zezë* (ngyrë). Dryshimi midis idévet kontraktore dhe Kontrare është ky, qi të parat e shkurojn (esaurire) suazën e idés së gjënit, kur-se të dytat nuk e shkurojn.

Idénat konvenciente nuk i referohen krahasimit të dy idëve, njenës me t'jetrën, për të cilin është fjala këtu, por krahasimit të dy idëve me një të tretë; p. sh. idénat *i rënd* dhe *i verdh* janë konvenciente, thonë, se koeksistojn si nota t'idés *ar*. Por, të krahasueme njena me t'jetrën (se për këtë krahasim është fjala këtu), na dalin heterogjene, se kanë gjene të dryshme (*peshtë* dhe *gjyrë*)

Idénat repugante, gjithashtu, nuk i referohen krahasimit të dy idëve, njenës me t'jetrën, por me një të tretë; p. sh. idénat *i gjat* dhe *i shkurtër* janë repugante, thonë, se nuk mund të koeksistojn si nota të një ideje të tretë (një send s'mund të jetë dhe i gjat dhe i shkurtër njëheri). Por, këto idéna, të krahasueme njena me t'jetrën, na dalin homogjene, se kanë komun gjenin (dimension); kuptohet vetiu qi idénat homogjene eskludojn njena t'jetrën (një gjá e gjatë s'mund të jetë dhe e shkurtër; as e bardhë të jetë dhe e zezë).

Idéna t'intersektueme quhen ato idéna qi suaza u-koincidon pjesërisht dhe andaj figurohen skematikisht me dy qarke qi presin njëri-jatrin (intersektohen), p. sh. *i bardh* dhe *nir*, se, thonë, vetëm disa sende të bardhë janë nierz dhe vetëm disa nierz janë të bardhë.—Rapport intersektimi midis idévet s'mund të ketë; është gabim dhe gabimi vjen nga dryshimi i bazës së divisionit (fundamentum divisionis); në rasën e sipërme p. sh. merret për bazë nga njena anë *bardhësia* dhe sendet dahan në të bardhë e mos-të bardhë; nga ana jetër merret për bazë *racionaliteti* dhe sendet dahan në nierz dhe mos-nierz. Shëmbull t'jetër: *eksagon* dhe *polygon i regult*; këtu, nga njena anë merret për bazë divisioni *numri i vijavet* (a i këndevet) dhe dahan polygonët në eksagonë dhe mos-eksagonë; nga ana jetër merret për bazë *regulsia i vijavet* dhe dahan polygonët në të regult e të pa-regult.—Po të bëhet divisioni në bazë të një note vetëm, siç e lypin ligjat logjike të divisionit, intersektimi s'ka

vënd. Intersektimi është i pamundun dhe s'mund të mejtohet, se implikon dy idéna me suazé pjesërisht identike, d. m.th. dy idéna konfuzë.

Nji gabim t'jetër q'i riferohet rapportit të konvencencës, repugnancës dhe intersektimit është ky: qi nër këto rasa krahasohen idéna subsistente me idéna inherente, d.m.th. idéna nature të dryshme, idéna të pakrahasueshme. Krahasim i till është illegitim. Për të qënë legitim krahasimi duhet qi idénat e krahasuëme të jenë të dya subsistente ose të dya inherente.

Për kuptim mâ të kjartë të save u- thanë mâ nalt, shih shkallën ierarhike t'idévet (në numrin qi vjen).

8. Legitimiteti i idévet.

Idéa është legitime d.m.th. konforme me ligjat e mëndjes, kur përmbush këto dy kondita: 1) të mos i kundërthotë vehtes; 2) të jetë e kjartë dhe e dallueme (claire et distincte).

Idéa i kundërthotë vehtes d.m.th. përmban kundërthënë (contradiction) kur i atribuohet donji not e kundërt e asai qi ka, ase i mohohet nji notë qi ka, p.sh. *vijë me dy dimensione* (kurse vija ka nji vetëm dimension; *pikë me dimension* (kurse pika geometrike s'ka asnji); *shpirt landuër* (kurse shpirti është i palëndt); *trup pa estension* (kurse nota kryesore e trupit është estension); *kafshë insensible* (kurse sensibiliteti është not'e kafshës). Nji idé e kundërthënë asgjanon vet-vehten dhe nuk mund as të mendohet as t'esisojë si realitet objektiv.

E kjartë dhe e dallueme. Idéa është e kjartë, kur kemi dijni esakte të kuptimit të sai d.m.th. kur mündim të dallojm e caktojm notat e sai, dhe vetëm këto, asnji mâ pak e asnji ma tepër; për dryshe idéa është e *erret*.— Idéa është e dalluëme, kur kemi dijni esakte të suazës së sai, d. m. th. kur mündim t'a dallojm prej ç'do idéje t'jetër dhe t'a zbatojm mbi individët që hyjn në suazën e sai; për ndryshe idéa është *konfuzë*.

Idëna krejt të kjarta e të dallueme janë vetëm idënat racionale d.m.th. idënat filosofike e matematike, se këto na vijn nga kontakti direkt i shpirtit me botën reale, me botën e vërtetë; kontakt direkt d.m.th. pa nërmietësin e nisavet (senses); andaj notat e këtyne idëve përfaqësojn cilsit metafizike të gjanavet, të sveshuna nga ç'do element sensibil, lakuriq, pure, pra të kjarta e të dallueme dhe adeqate me objektin. Këto idëna na bëjnë të njohun botën tejemperike, sipërsensible, hypërfizike, botën e *Perendis* e të *shpirtit*, me të cilën merret filozofia dhe motra e sai më e madhe *Feja*. — Përkundrazi, idënat empirike d.m.th. idënat e skencavet t'jera, veç filosofis e matematikës, janë pak a shumë t'errëta e konfuze, se na vijn nga kontakti indirekt i shpirtit me botën, d.m.th. nga kontakti për miet nisavet (senses), të cilat e deformatojn botën kryekëput; p.sh vibracionet e ajrit, veshi na i paraqet si zã; vibracionet e etherit, syt na i paraqesin si dritë; një shklop kredhun n'ujë, syt na e paraqesin si të thyer; një rë e zezë n'orizont na duket si mal; shumica e filozofëvet pranojn se cilsit sensible të sendevet si zehtsia, odori, shija, tingulli, ngjyra, akoma dhe figura dhe estensioni nuk janë cilsina objektive të tyne d.m.th. nuk esistojn vërtet nër sendet, por janë gjendje (états) subjektive t'ona, d.m.th. fiesht nima (sensations), të cilavet në realitetin objektiv nuk u-korrispondon kurgjã, veç vibracioni i atomevet a i grimavet (molekules). Idënat emperike, pra, dhe skencat qi bazohennë tó, na bëjnë të njohur, kështu, një botë krejt të deformatueme, një botë qi nuk gjan aspak me vehten e sai të vërtetë. Megjithkëtë, skencat empirike kanë qënë dhe jesin i vetmi miet për t'a njohun e për t'a dominue naturën dhe për t'u-shërbye nevojavet t'ona të jetës praktike. Por kishte me qënë absurde e qesharake qi, me argumentet kaqë të dobta të këtyne skencave, me kontestue e polemizue të vërtetat fetare e filosofike, qi kanë të bëjnë, qi i riferohen një bote krejt t'huaj për ató, botës hyperfizike të *Perendis* e të shpirtit.

K. T.

N. Berdiaeff.

IDEJA FETARE RUSE

VII.

E krenitja më e madhe e Kishës orthodhokse është ajo e Pashkëvet, e ngjalljes së ndritëshme të Krishtit. Krishtërimi perëndimor nuk e njeh këtë gëzim të natës së Pashkëvet. Ekziston një ndryshim i dukëshëm, aq përsa i përket meshës, sa edhe ritit. Në Orthodhoksi, figura e Krishtit është e çfaqur me më shumë fuqi; Orthodhoksia ushqen një dashuri të veçantë për mysterin e Shënjtë të ngjalljes. E krëmtja e Pashkëvet s'është vetëm ngjallja e Krishtit, e thelluar dhe e përjetuar, por edhe paraqitja e ngjalljes kosmike, ngjallja dhe ndriçimi i krijesës pikësëpari. Në katholiqizëm, fytyra e Krishtit të kryqëzuar, bëhet e dukëshme me më shumë fuqi. Duke hyrë në një kishë Katolike, vemë re me një herë fytyrën e Krishtit të kryqëzuar; ajo del në shesh me më shumë fuqi; në kishën Orthodhokse fytyra e Krishtit të ngjallur prej së vdekurish, të bie në sy pikësëpari. Në kishën katolike kryqi është ay që të tërheq vërejtjen. Kisha Orthodhokse është më e thjeshtë, ajo nuk ka parasysh zotërimin dhe glorifikimin e kësaj bote; ajo nuk është vetëm fe e kryqëzimit por edhe e ngjalljes Ajo, ka për qëllim, ose anon nga ngjallja e tërë krijesës Krishtërimi Perëndimor duket sikur të ketë lënë në hareshë ardhjen e dytë të Krishtit. Në hollësitë e thella të Orthodhoksisë, këjo është drejtuar drejt dritës s'Atij që do të vijë, drejt ardhjes së dytë të Krishtit. Prirja për të parë Krishtin që ka për të ardhur, është lidhur me iden e lavdërimit dhe të çpërfytërimit të botës.

Krishti solli me vehte glorifikimin, çpërfytërimin dhe ngjalljen, d.m.th. përmbushjen e mbretërisë së Perëndisë. Ndryshimi i botës s'është një çvillim ose një përparim historik, por është një nrekulli, një katastrojë e përbotëshme pas së cilës qielli i vjetër dhe bota e vjetër do të shduken dhe një qiell i ri dhe një tok'e re do të dalin. Në thellësinë e shpirtit Rus ka ekzistuar gjithënjë kjo pritje e ndryshimit të botës, bile dhe atje ka ndërgjegja fetare ka qen' errësuar. Te njeriu rus del në shesh ndërgjegja që zhvillimi historik, udha e historisë, nuk na çon drejt mbretërisë së Perëndisë, drejt ndryshimit të botës, drejt shpëtimit.

Një ndjenjë moskënaqësi kundrejt civilizimit është vija karakteristike në njerëzit e kulturuar të Rusisë. Njeriu Rus dëshiron të ndeznjë një zjar të përbotësbëm, të shduki botën para së gjithash dhe të kryej një kryengritje botërore, kështu që të tëra vlerat e botës përmbysen. Ideja apokaliptike ruse përfshin në vet-vehte një rezik të brendëshme. Nihilisma ruse e munda apokalipsen Ruse dhe kjo është tragjedia e Rusisë.

Një vijë karakteristike e mendimit Rus është dashja e së mirës së përgjithëshme, aq të popullit sa edhe të njerëzisë. Mëshira ruse qëndron në bazë të këtij aspiracioni.

Dostoievveski e çfaqti bukur iden ruse, duke thënë, *që të tërë janë përgjegjës, njeri për tjetrin.* Përndimi e mbron shpirtin duke krijuar vlera objektive: shkencën, artin, jetën shoqërore. Rusi nuk kënaqet me krijimin e vlerave, *ay kërkon shpëtimin, dhe jo shpëtimin individual,* por atë të përgjithëshëm.

Tërë letërsia ruse është e ujitur prej vuajtjes dhe prej agonisë së popullit, të njerëzisë, të botës së brendëshme; shohim një dëshirë të gjallë për çlirim dhe shpëtim. Gogol, Dostoievveski, Tolstoi, mundohen për destinimin e njerëzisë, ata kërkojnë shpëtim. Mendimi dhe dija ruse nuk kanë qënë kurrë një thellim objektiv, një vëshgim i njohunivët abstrakte; ajo ka ecur gjithëmon drejt zërit të shpëtimit. Kështu kanë qënë: Tchardaieff, slavofilët: Solovieff, Leontief, Fedoroff, etj. dhe po kështu edhe në grupin tjetër atheistët dhe revolucionarët: Bieliński, Hersen, Tcher-

nichevsky, Bakunin, Mikhailovvsky, etj. të cilët nën formën e sekularizimit kërkonin shpëtimin e popullit dhe të njerëzisë, çlirimin dhe shpëtimin. Çlirimi duhej të vinte për popullin dhe jo vetëm për individin. Individualisma ka qënë e huaj për popullin rus. Edhe kjo do të thotë se jo vetëm një individ por shpirti i një populli të tërë ka etje për Zotin. Kisha nuk është një autoritet ierarhik i jashtëm, as një institut dhe organizatë për nevojat e shpëtimit, por për tërë popullin e Krishterë, për tërë njerzit e krishterë. Rusët nën këtë mënyrë u-muarnë me planin e shpëtimit të popullit, të njerëzisë dhe të së vërtetës; ata kanë haruar shpirtet e tyre dhe nevojën e një përmirësimi dhe çpërfytërimit. Ndjenja e përgjegjësisë personale ka mbetur e dobët.

VIII.

Atmosfera apokaliptike—që e ka vetëm Rusia — është një atmosferë e rezikëshme. Kjo, ka një kuptim të dyfishtë. Fytyra e Krishtit ngatërohet me atë të Antikrishtit. E liga paraqitet nën vijat e së mirës, Satanai nën formën e ëngjëllit. Populli Rus ka qënë i kënaqur dhe ka rrojtur nën kamuflaxhin e së vërtetës. Dostoievvski ka treguar se si mëshira mund të kthehet në barbarizmë dhe liria e pa mbarruar të ndryshohet në despotizmë të pakufishme.

Me anë të karakterit të tij populli Rus është një popull i rezikëshëm; lëndat eksplozive janë të fshehura në të. Dhe nëse Rusi ka nisur të besoj në shkencë, ay e ka transformuar në idol; në se ka besuar në socializmë, kjo i ka zënë vëndin Perëndisë. Ay nuk e kupton vëndin dhe vlerat e hierarhisë. Ay i kupton me zor vlerat relative. Bota e Perëndimit caktoi vlerat e hierarhisë, i ka justifikuar në jetë. Dhe prandaj bota e Perëndimit krijoi një civilizim. Kudo popujt latinë kanë patur frymën e formës. Në Rusët çfaqja me karakteristike e kulturës, paraqitet me anë të një apokalipse të kulturës.

Një fe e re s'mund të ekzistojë, pasi krishterimi është një fe e përjetëshme dhe absolute. Por mund të nisët një erë e re në Krishterim. Dhe ideja fetare Ruse, e rënjosur në tokën historike të Orthodhoksisë, është një krishterim

i ri, krishterim apokaliptik i Sh. Joanit, krishtërim i lirisë dhe i dashurisë, krishterim i një qielli dhe i një dheu të ri, krishterimi i çpërfytërimit të përgjithëshëm. Nuk është një krishterim i thjeshtë dhe optimist, është një krishterim tragjik, sepse lirija dhe fryma shkakëtojnë tragjedinë.

Është një lindje, një Asi, kundër se cilës ne duhet të çojmë një luftë shpirtërore. Është lindja monstruoze, Asia jo e krishtere, e cila e mohon njeriun. Lindja jo e krishtere, do të bashkohet me Perëndimin jo të krishterë dhe ky bashkim do të shkaktojë bashkimin e lindjes me Perëndimin e Krishterë.

Ideja fetare Ruse është një ide bashkimi të Lindjes me Perëndimin në një botë të krishtere. Bashkimi shpirtënor i krishterimit të Lindjes me atë të Perëndimit, munt t'u vë përpara fuqivet e pushtetëshme jo të Krishtere, një fuqi të re dhe të pa mposhtur.

Duhet të lindë një kosmos shpirtërore e re — kur njerëzia shpirtërore do të rilindet.

Jetojmë një epokë kalonjëse të rëniet dhe të katastrofave, një epokë lugubre, e cila paratregon dukjen e një epoke të re fetare.

Fund

E përktheu Dh. B.

Kalendar Kishëtar Orthodhoks

Dolli prej shtypit Kalendar Kishëtar Orthodhoks për vitin 1944, i përpiluar prej z. z. Dh. Bedulit e J. Papailia dhe që përmban, përveç të kremtevet fetare, Ungjijt, tingujt dhe mëngjezorët e çdo të Djele, si edhe disa këshilla fetare, dyke patur në mest ikonën e Zotit t'onë Jisu Krisht. Esht i pari Kalendar Kishëtar që del me këte menyre. Çmimi është lën në dëshirën e gjithsecilit. Gjëndet në zyrat e revistës s'onë.

Cilët janë shkaqet e luftës s'ardhme

Me shumë artikuj që janë dhanur në “Jetën Kristiane” me titullin “Lufta dhe morali” patëm për qëllim me dhanë pak shkrime mbi luftën në për prizmen e frymës ungjillore. Këtu sira artikujsh që po e mbyllim me artikullin “Cilët janë shkaqet e luftës s'ardhshme”. të cilin artikull e kemi marrun nga libri “Lufta dhe Bibli” (botuem 1931 Shkup) prej Episkopit Dr Nikollaj Velimiroviqit, kapacitetit të Orthodhoksizmit, i cili asht i njohun dhe në kishat e tjera jo orthodhokse si shkrimtar i shumë librash, orator i famshëm dhe dietar.

Do të kemi luftë a jo, mvaret nga kualiteti i paqes s'onë. Në se neve gjat kohës paqes kishim me rrojtun mbas dëshirës Perëndis, pa fjalë, deri ke lufta nuk do të kishim me mberrimun. Ah! se kur t'ishte kështu! Paqja atheiste asht djepja e luftës. Kur se bakcilët e luftës në paqe shumohen dhe rriten, atëhere lufta pa u përmbajtur vjen. Në daçin njerzit mbat ças ose në mos daçin. Unë nuk do të profetzoj se lufta e ardhshme ka me filluem me vrasjen e ndo një misioneri ose konsulli, ose me mbyttjen e ndo një vaporri fqije, ose me ndo një lloj atentati në person dhe në pasunin e një populli. Mundet lufta dhe me të tilla ngjarje me u çelun ose me ndonji tjetër. Por këto neve nuk na interesojn. Këto aspak nuk kanë randësi kur se flitet për mbi shkaqet e një lufte. Ato janë aformi ose signal për luftë, e cila ma parë, gjat kohës paqes, asht njësh e përnjesh.

Shkaqet e luftës s'ardhshme janë trashiguem prej luftës

shkueme. Ata filluen me u grumbulluem që prej konferencës shkueme të paqes. N'at konferencë ishin mbëledhun shum shtete qi luftuen. Vetëm në te nuk u thir as me lutje as me dhoksologji Ai i Treti, Gjithvështruesi dhe Faktori caktues pa të cilin as nuk mund as nuk munde 1) Konferenca mori fund me shum zor e vështirsi. Gjat vuez-tjevet të luftës Zoti përmendesh dhe për ndihëm thërritesh. Por mbasi u ndalue lufta, njerzit e larguen Perëndin prej punëvet tyne. Prandaj n'at konferencë paqje pak u fol për mbi paqen se sa për mbi damet e luftës. Nuk kishte bekim Perëndije dhe prandaj asht krijuem një paqe e cila e bani botën një fabrikë luftime dhe e cila me gjith fuqitë dhe pasunitë e sajë ju vue në shërbim luftës s'ardhshme. Aleatët urdhënuen kondita paqe, dhe i ndan thesarët e të mundunvet si deshën. A patën ndonji dobi prej atij thesari? I ndaluen të mundunit me pasun ushtri dhe me u armatosun, vehten e tyne e lejuen me pasun nga këto. Pse nuk e ndaluen dhe vehten e tyne? Nuk parashikuen se me këte padrejtësi vuen dhe vehten e tyne në radhën e të mundunvet. Sepse sa thesar muerën prej të mundunvet, a nuk dhan aq deri sot—ose a nuk do t'apin deri nesër për shumimin e ushtrivet tyne dhe për përgatitje të reja luftime? Thesar i pa-bekuem! Fati ma i math i popujvet mundun asht në këte se ju kanë lidhun duerët qi të harxhojnë për ushtri dhe për municion luftime. Ata nuk duhet të zemërohen pse e apin florinin e tyne „fitusvet” Ma mirë asht t'ja falin fqijvet se sa t'ja hudhin në gojë Marsit. Fatkeqsija ma e madhe e Aleatëvevet asht se thesarin e marrun prej anmikut e përdorën për qëllime luftime Të flasim me gjuhën e njeriut: kjo asht hakmarrja e Atij të Tretit, i Cili me as një mënyrë nuk asht thirun në konferencën e paqes. Dhe kjo d.m.th: sa u shue zjerri prap me e lyem qytetin me vojguri.

Ndërmjet gjithë shkaqevet të luftës s'ardhëshme si dhe të luftavet të tjera, shkaku kryesor asht atheizmi dhe e lar-

1) Dihet vetëm për të drejtin Wilson, i cili gjat kohës konferencës paqes mbante Librin e Shejt para vehtes, dhe kohë mbas kohe ulte kryet dhe në vehte i lutesh Perëndis.

guemja prej Perëndisë Vërtet dhe të Gjallë “*Skanë paqe atheistët thot Zot!*” (Isaija 48,22). Shum të krishten t’Evropës dhe t’Amerikës, të cilët gjat kohës luftës me nxitim turrëshin në kishë dhe përpëra meshtimit, vetëm për me zanun vend, filluen mbas luftës me u ftofun ndaj fesë dhe me ularguem prej besës më Perëndin. Kur i tërhiqni ve-rejtjen ata ironikisht përgjigjen se feja u bâ gjâ jo e mo-dës. Si kështu? A mundet me u bam fjalë për moderni-min dhe jo modernimin e realitetit? Perëndija asht reali-teti ma i nalt nga gjithë ato qi quhen realitete. Si besa me Perëndin e cila ka qenë para dhiet vjetve e gjallë dhe e lidhun me realitetin, sot u ba jo moderne? Besimi me Perëndin, thonë ata, d.m.th. besim në kotësi dhe jo në realitet. Si mbas statistikës zyrtare numri i atheistëve në Çekosllovakia u rrit, gjat kohës paqes, ma se një milion qi d.m.th. një i dhietit asht atheist në dhen e bestarit Jan Hu-sit. Ne këte e konstatojmë me dhimbje dhe jo me kënaqsi. Por sëmundja e atheizmit nuk asht një monopol i Çekos-llovakisë. Kjo sëmundje bren dhe shpirtin e Françës, t’Ita-lisë dhe të Gjermanisë. Atheizmi pak a shum zû rrânjë në gjithë shtet e Evropës dhe t’Amerikës, sidomos në për qy-tetet ku ma shum shifen veprat e njeriut se sa veprat e Pe-rëndis. E ç’far fati pret një popull prej Atheistëve të shumt, këndojmë kthjellët në Librin e shejt të Perëndis: “*Ska pa-qe për atheistët!*” — një ky i asht fati, kjo asht shkruem për ta. Luft, pra, asht shkruem për atheistët. Dhe ata skanë me qenë kurr pa luftë në se s’kanë me e lanun athe-izmin. Se atheisti vetëm me këte qi asht atheist “*ban keq përpara Perëndis!*”. Atheizmi asht përbuzje ndaj Krietari dhe Gjith-përmbajtsi i botës, përbuzje dhe përsëri gozhdim i Zotit Krisht mbi kryq, n’emnin e të Cilit popujt e krishten u pagëzuen dhe me pagëzimin bân be për me qëndruem besnikë. Çdo përbuzje e Perëndis, në se nuk falet prej pendimit të shpejt, siell mjerime si: thatsi, sëmundje, çrregu-llim, regres mbë gjithçka, dhe si kunorën e të gjitha këty-neve siell luftën. Ky nuk asht besim i kotë i popullit ka-tundar, por se asht fakt i vërtetuem prej eksperiencës për-diçme dhe të Biblit.

Shkojmë ndashti ma tutje, Atheizmin ose mos-besimin, pa fjalë, e pason idolatrizmi. Se njeriu sa mohon Perëndin e mbush boshin e shpirtit tij me një send tjetër të cilit i përulet si vleftës ose realitetit ma të nalt. Njisinë e Perëndis atheisti e zavendëson me shumicën e idhujvet. As një idololatër nuk i asht përlun vetëm një idoli. Bashk me idolatrizmin vjen dhe turbullimi i shpirtit njeriut, kur se besimi mbë një Perëndi siell në shpirtin e njeriut njisi klasike, thjeshtësi dhe dallim. Aq sa mundet njeriu me kuptue në kaosin e shumicës madhe t'Amerikanvet dhe t'Evropjanvet shkolluem, dhe sa mundet me i numëruem plagët e tyne ma të randa — ata deri tashi kanë pes idhuj kryesor, të cilëvet u apin as gja ma të vögël se sa adhurim hyjnuer.

- I pari idol materija
- I dyti idol ego (unë)
- I treti idol imperija (shteti)
- I katërti idol kombesija
- I pesti idol kultura

Fillojmë me radhë. Dhe ç'ka se flitet e shkruhet se materializmi fillofik, i cili e helmoj frymën e Evropës gjat gjithë shekullit nadëmbëdlijet, asht i vdekur, por asht hashiqare se mbas këtij dhe me emfluëncën e tij mbeti materjalizmi praktik. Prej babës shumtuem ma i shëmtuem i biri. Materja u ba, për Amerikanët dhe Evropejt, si qellim i pjerrjevet dhe i mundimevet tyne, qoft ajo në formë toke, ose parje, ose sendesh, ose kenaqjesh prej këtyneve. Me pasun shumicë materje — a nuk asht ky një turbim i popujvet të krishten në të dy kontinentat e bardh? Etja e pa kufizueme e njerzvet për materien, dhe për kënaqjen në materjen, si mbas vrullit mundet me u krahasuem vetëm me etjen e pa kufizueme, të krishtenvet vërtet për Perëndin dhe për kënaqjen shpirtnore e cila vjen prej Perëndis. Por ata qi e humbën shqizën e të ndjemes dhe të pames për Perëndin janë të dënuem me i u përlun matarjes si idol, me gjithë fuqi, me gjithë mendje dhe me gjithë zemër. Dhe, mbasi po ata objektet e materjes i duen shum njerzë natyrisht krijohet ndyrmjet njerzvet zi-

lija, e keqja, mënjia, çqetsimi dhe përpjekja. Këto janë të gjithë bakcilet e luftës, të cilët kur shumohen ma tepër me doemos bien ndzejen e organizmit — zjarrin e luftës.

Imperija si idhol ka rrymbye fandasinë jo vetëm të popujvet mbëdhej por dhe të popujvet të vegjël. Imperializëm d.m.th. me rrembyem dhën e huej për pushtet, tregëti, strategji, për materijen. Si kur se Zeusi mithiologjik lindi Plutonin, kështu dhe materializmi evropjan lindi imperializmin evropjan. Dhe me të vërtet çasht Zeusi ndërmjet perëndivet, materjalizmi asht ndërmjet idhujvet soçëm. Mbasi etja e shum popujve për imperializëm asht e pa-kufizuese dhe toka e planetës s'onë asht e kufizuese, nuk asht çudi si ndër popujt krijohet ziliija, e keqja, menija, shqetsimi dhe përpjekja. Këto janë, si kur se thamë, bakcilet, të cilët pa fjalë udhëbeqin në ndezjen e luftës.

Kombi si idol përjashton Perëndin, sikurse të gjithë idhujt e përjashtojnë Perëndin. Neve shpesh herë takojmë me atheist si me nacionalist ma të tërbuem. Nacionalizmi i kohës s'onë asht gati me u kthye n'imperializëm dhe gjithmon asht i pa ndamë prej materializmit. Në formën e tij të prishme ai nuk d.m.th. aq dashuni kundrejt popullit tij sa mëni fodulle kundrejt popujvet fqij, e cila asht e vështirë përpara Atij, qi ka krijuem të gjithë popujt.

Personi unë si idol asht gati prezent ndër gjithë njerzit e bardh. Ai zavandson Perëndin, si ke ata qi duen dhe kanë shumë, si ke ata qi njisoj duen e kanë pak ose as pak. Tue vuem personin e tyne në qendrën e sendevet në vend qi të venë personin e Perëndis, njerzit, atëhere pa fjalë, kërkojnë secili për idolin e tij tempull dhe adhurues, dhe shumë ar e arzjgand — ma mirë me thanë materje — qi t'a mbajnë ate në ndriçimin hyjnuer. Kjo llojë idololatizmi ma shumë u manifestue në përpjekjet e partivet t'intelektualvet t'Evropës, në përpjekjet për parsi, pushtet dhe pasani. Karakteristikat e këtij idoli janë: foddulluku, vet-dashja, dhe mos skrupuloziteti, Dhe mbasi në tërbimin e kësajë përpjekje nuk njifet Perëndija dhe Ligja e tij, atëhere lufta mbet mjeti i vetëm për me nxjerrun të dëmunit. Kultura si idol, në ditët e soçme hyn në radhën e idhujvet ma të vërbët. Tue largue Perëndin, i

Cili asht i vetmi inspirues dhe shkaktar i kulturës fisnike të shpirtit dhe të trupit, atheistët filluen me adhuruem punët dhe veprat e veta, të cilat ata i therresin me një fjalë — kulturë. Vështirsija ma e madhe për Perëndin asht me adhuruem kush veprat e njerzvet. Se Perëndija në ligjën e Vet rreptësisht i ndaloi njerzit me adhuruem veprat dhe krijesat e Tij, prej të cilavet dhe ma e pa-njofmtja asht ma e përsosun nga ma e përsosmja kulturë e njeriut. E ku me adhurie veprat e njerzvet! Dhe mbasi kultura asht vue në lidhje me idhujt e tjerë të përmendun, e sidomos me materien, kështu dhe kjo me gjithë fuqi i shërben kulturës së bakcilavet të luftës, të cilët hejrrët a vonë provokojnë ndezjen e luftës.

Prej këtyne pesë idhujve dy munden me u quejtun të marrë e tri hipokrit. Të marrë janë nacionalizmi dhe kultura se shum bërtasin dhe e çfaqin vehten e tyne, dhe, hipokritë janë materializmi, imperializmi dhe egoizmi, sepse mëçifën dhe rrejnjë tue u prezantue me emën tjetër. Të gjithë kto idhuj kishin me u quejtun me gjuhën e Dostojevskit—djaj.

Të gjithë këto dikur ishin vlefte të vërteta dhe prap munden me qenë. Këto janë vlefte të vërteta atëhere kur janë të ndriçuem me besën në Perëndin, në të Vetmin e në të Gjallin; me një fjalë, kur janë caktue apsolutisht për Perëndin dhe shërbejnë për lavdinë e emnit Perëndis. Materja asht prej Perëndis dhe i asht dhanun njerzvet për me i shërbyem, e jo me sunduem ajo shpirtnat e tyne. Imperien Perëndija ja ep disave popujve të talentuem me qëllim për me i shërbyem të dobëvet dhe popujve me ma pak talent, si kur se vllaj ma i shëndoshë vllajt ma të dobët. Kombi asht një gjë e kufizue por fort e bukur dhe mundet me qen mjet i mirë me i shërbye Perëndis dhe njerzvet. Personi unë, shpirtin e logjikshëm ja ka dhuruem Perëndija çdo njeriu, qi me anë të shërbimit dhe të dashunisë t'a ngrejë aq deri sa t'i përgjaj Atij-Kriestarit vet. Kulturën Perëndija e inspiron qi me anë t'asajë të manifestojnë shpirtnat e njerzvet sundimin e tyne mbi botën materiale, ndënshtimin dhe shërbimin Perëndis. Të pest këto marrin fëtyrë engjulli me anë të shërbimit dhe

të dashunisë, si kur se Zoti Krisht rregulloj e urdhnoj. Mirë po si kur se apostati Serafim, dikur i quejtun Lucifer, u kthye për një moment në djall, kështu edhe këta pesë vlefta, me të këputmen e lidhjes e cila i lidhte me Perëndin, u banë idhuj dhe djaj.

Vështroni ndashti qysh e ngimja relative e këtyne pes idhujve i shtynë njerzit deri në përtaci, në prishje, në kalbësinë, në çdo vështirsi (si dhe përpara fundit t' imperatorisë romake); dhe, si pangopshmëniya e tyne i shtynë njerzit deri në zemerimin ma të fund, në zili, në grindje, në pa-përmbajtje, në pa-drejtësi të çdo radhe, dhe prap, në vetvrasje. Në të dy rastet idhujt egërsohen me mëni dhe me përbuzje kundër t'uritit dhe të butit Zotit Krisht, dhe natyrisht i udhëheqin njerzit në luft.

Të mos fillojmë me numëruë gjithë plagët e randa të çeluna n'organizmin e Evropës dhe t'Amerikës, prej kësaj idololatrije pes-fëtyre, sepse kishim me përsërit ate qi dita ditës përsëritet në shtyllat e krimevet si dhe në shtyllat e ngjarjevet të tjera, të cilat kishin me u formullue mohim i Krishtit dhe i Ligjës Tij. Kthjellët asht prej sa u tha ma sipër, se popujt e krishten të cilët qen të martuem shpirtnisht me Krishtin, u banë të pa besë (kurvënuen) dhe hyn në rrelacion me kotsinat, me pluhnin, me hinin dhe hijet. Çdo grue e pabesë, nuk rron me frikë e me siklet për mbrojtjen e jetës sajë? Kjo asht pitura dhe ky asht fryti i idolatrizmit soçëm — frika, dhe prej frikës egoizmi ma ekstrem, një drithtim i math për materjen dhe rrëmbim i materjes. Dhe mbasi për një send material përpigën shumë vet me e pasun, kështu bahet e pa-evitushme përpjekja dhe lufta. Juve po shifni se unë po flas vetëm për popujt e krishten? Jo pa arsye. Ata e ban luftën botnore ata po pregatisin dhe luftën e re. Për njëqind e pesdhjet vjet e fundit, që kur ka filluëm lufta kundër Krishti n' Evropë, popujt e Evropës kanë bam ma shumë lufta, tepër ma shumë se sa e gjithë bota tjetër sëbashku. Kjo asht e rrafmja e Perëndisë qi të ven mend, ata qi skanë mend. Por të çmendunit nuk vunë mend. Ata rrokullisen sa ma poshtë e ma fellë në humbje. Ata, të cilët i zgjodhi Perën-

dija me u bam krypë dhe dritë e botës, e humbën shullinën dhe u erresuen. Me gjithë qi ata shum lavdërohen se janë krypë dhe dritë e botës, por kërkush këte në botë nuk ja beson. As Hindi, as Kina, as Afrika nuk i konsideron ma njerzit e bardh si krypë dhe si dritë, por, për fat të keq, si baltë dhe si errsinë.

Prej gjithë kësajë qi thamë mesimi asht i kthjellët.

1. Se shkaqet e luftës s'ardhshme janë në largimin e njeriut prej Perëndisë dhe në ranjen n'idholatrizëm të popujvet të Krishten ose të kryetarvet tyne.

2. Se këto shkaqe janë të njisojshëm me ato t'zrailit —krypës dhe dritës së botës atëhershme, prej të cilëvet vuejti, dhe prej të cilëvet humbi definitivisht.

3. Dhe në se këta shkaqe nuk çduken shpejt me anë të pendimit dhe të kthimit më Krishtin, luftat me rradhë qi po ja mbërrijnë shpejt dunë me thanë jo vetëm luft, por dhe shkatrimi i popujvet të Krishten—por jo dhe i Krishtnimit.

Përkthim nga
Ushtari i Krishtit

USHTRIME BIBLIKE

S'ka dyshim se këndimi i shkrimit të shenjtë është detyrë e çdo të krishteri dhe se dobia që rrjedh prej këtij këndimi është e dukëshme. Një nga mjetet që na shtyn të këndojmë shkrimin e shenjt është sigurisht dhe paraqitja në revistë të ushtrimevet biblike në formë problemësh, zgjidhja e të cilavet u-lihet këndonjësvet. Për këtë qëllim pikërisht dhe revista e jonë «Jeta Kristiane» duke nisur që nga ky numur, do të botojë nga katër ushtrime biblike, zgjidhjet e të cilëve bashkë me emrat e zgjidhësve do të botohen në numrin tjetër, d.m. th. pas një muaji, kohë e mjaftë besojmë, për zgjidhjen e tyne. Atij që do të zgjidhë që të katër ushtrimet, do t'i dërgohet gratis për një vit «Jeta Kristiane» kurse atyreve që do të zgjidhin më pakë, qoftë edhe një, do t'u botohet emri në revistë, bashkë me emnat e zgjidhësve të tjerë. Ja ushtrimet për këtë numur:

1) Cila fjalë e Zotit t'onë Jisu Krisht. gjëndet në Dhjatën e Rë, por jo në të katër ungjijtë?

2) Sa shë ime të bërë për ditë të shtunë gjejmë në ungjijtë?

3) Cili mbret në Dhjatën e Vjetër ka patur 78 gra dhe 88 fëmijë?

4) Sa Irodhë përment Dhjata e Re?

KANGË LLAZORE

Vemë sot në Vithanija

Vemë sot — në Vithanija,
 Qante Martha — e Marija
 Tri dit'e tre — net thërrisnin
 Llazaraqn'e — logorisnin. —
 Marija me — Magdalinë,
 Gjelnë Zotnë — Krisht mbë-udhë
 Ju derdhë i — ranë më gjunjë
 I folë — me dhëmbje shumë :
 — Ti, o Zot,—të ndodh'sh atynë
 Nuk na vdiste — vëllaj ynë.
 Sa të thënë — këtë fjalë,
 Zoti Krisht — zuri të qajë,
 Zoti Krisht — zuri të qajë:
 — Hajni m'a rrëfeni varrë,
 Të shohim ku kemi Llazarë
 — Ti Llazar — që je këtunë.
 Ke tri dit — po rri në gjumë,
 Mjaft ke ndënjurë — në gjumë.
 Sa të thënë — këtë fjalë,
 Llazari — u ngrit i gjallë
 Apostojt e — Mathitinjtë
 Shëkonin — më Perëndinë
 Dhe Llazarë — po e pyesnin :
 — Ti Llazar që — ishe atjenë
 Vallà si — është xheneti
 — Me fjalë nuk u them dot,
 Mirrni kartal — e këndonin
 Edhë ato — t'i mbesoni.

O PËLLUMP-O, PËLLUP-O

— O pëllump-o, pëllump-o, } ref.
 Llazore ; }

Mos na pe llazuarë,
 — Këtu drejt ka shkuarë,
 Ne gur i fërkuarë
 Ku fërkohen shpatatë
 Shpatat e Sotiritë,
 Ku mbathenë kuajtë,
 Me potkonj të rgjënda
 Me gozhda të arta.

LELE—LELE MOJ LLAZORE

Lele — lele, moj llazore,
 Ngaj na hyre ngaj na dote,
 Njëpër baça flyturove, —
 Lele — lele moj llazore.

SHENIM: Këndohet prej vasha-
 ve ditën e Djelë (E Djela e Dafinës)
 përpara Pashke, njëpër kop
 shte e njëpër obore. dyke lojtur
 valle. sikush prej tyre, me lla
 zore në krahë. Pastaj e zveshën
 llazoren nga rizat e qëndisura e
 nga kaftani i mëndafshtë edhe e
 hedhën në çati që t'a kenë për
 motnë tjetër.

Mledhur në Pogradec
 prej M. KUTELIT

Fjalor i vogël i Dhjatës së Re

III.

DHEKAPOLI.—Siç kuptohet dhe nga etimologjia e fjalës, ishte një grup prej 10 qytetesh në veri-lindje të detit të Galileës, i çkëputur ndoshta prej Pompeut politikisht nga Palestina dhe i lidhur drejt-për-drejt me Romën. Emrat e këtyre qyteteve nuk dihen me siguri. Prej një shënimi që gjindet në *Bellum Iudaicum* të Josif Flavit, dijmë se më i shënuari në këta qytete ka qenë Skythopolis, një qytet në Galilé, në jug të Nain-it. Disa nga shpjegonjësit, në këtë grup përmendim dhe: Hippos-in, Pella-n, Gadara-n, Filadelfia-n, Dioni-n, Ganatha-n, Gjerasa-n dhe Abila-n, pasi të gjithë këta qytete ishin afër Skythopolis-it. Banoheshin më shumë prej paganesh.

FARISENJT.— Ishte një sekt me shumë rëndësi dhe influencë të madhe, që përbënte klasën intelektuale dhe ligjore të Iudhaismës. Emri farisenj, do të thotë *të veçuar nga bota tjetër* dhe tregonte ata nga besëtarët që shquheshin prej popullit për njohurit e tyre të thella në punët e fesë dhe për jetën e tyre të pastër e pas ligjit të shenjtë. Prejardhjen e tyre e gjejmë në kohën pas robërisë. Vuajtjet e rënda të syrgjynit e prishnë popullin e zgjedhur; me kthimin në atdhe, shumë Ebrenj u-dhanë pas studimit me kujdes të shkrimeve të shenjta, pas mbledhjes dhe radhitjes me shkrim të mësimëve dhe të shpjegimeve të ligjit, që gjer n'atë kohë i ruanin gojë pas goje. Më vonë pastaj, kur Iudhenjt për arësye politike erdhën në kontakt me kombet e huaj, duhej të reaksiononin kundër elenismës, që kërcënonte të përpinte fën e vjetër të Moisiut. Dhe kështu lindi sekti i farisenjvet, emri i të cilit përdorej bile që në kohën e Makavenjve, nga mezi i shekullit të II-të para Krishtit. Për hir të emrit të mirë që gëzonin këta në popull, patnë që në fillim një influencë politike shumë të madhe dhe përbënin në shtet një fuqi të rëndësishme sa që vinin mbretër dhe kryepriiftër. Në kohën e Irodhit të Math ky sekt kishte më shumë se gjasht mij antarë. Këta patnë që guxim, sa refuzuan të japin betimin e besës që

u kërkoi mbreti n'emër të perandorit të Romës. Farisenjt përbënin shumicën, në kohë të Shpëtimtarit, nëpër gjykatoret e vendit. Gjithashtu dhe në Këshillën e Madhe, pjesën më të madhe e kishin po ata. Farisenjt pranonin si burim të fesë dhe të ligjit, përveç dokumentave të shkruara, edhe gëjdhënëjen; bile kësaj të fundit i jipnin rëndësi më të madhe. Përveç kësaj ata pranonin ekzistencën e engjëjve dhe të shpirtit të njeriut, pavdekësin e shpirtit, ngjalljen e trupit, jeten tej varrit dhe çpërblimin ose dënimin e njeriut n'atë jetë.

Parimet morale të predikuara prej farisenjvet kishin në fillim një autoritet të math; bile dhe ata vet ishin atëhere shëmbëll virtyti. Mirëpo, pakë nga pakë u-larguan nga fryma e Perëndisë. Në teori, si edhe në praktikë, s'kishin nder më, veçse për ruajtjen e rregulave të jashtëme të fesë, për një formalismë të shtrembëruar e të shtuar, dyke transformuar kështu frymën e parë, serioze dhe morale, në një shenjterim të përdhunuar që fshihte çmirën, urrejtjen, zemërimin dhe lakminë. Tregonin kujdes të math në të shpjeguarët e ligjit dhe në zbatimin e tij në të gjitha çfaqjet e jetës; por dyke e shpjeguar këtë aqë hollësisht, nxuarnë përfundime tepër të gjata dhe mbaruan me krijimin, përsa i përket sidomos pushimit të së shtunës, e një labyrinthi rregullash, urdhërimesh dhe ndalimesh, sa që e transformuan Ligjin në një zgjedhë lodhëse, sa të rëndë, aqë dhe të rrezikëshme. Fariseu e quante veten si njeri që nuk gabon, që nuk bie në mekat, m'i mirë se gjithë të tjerët. Në sinagogji zënte vëndet e para, falej nëpër sheshet, jepte lëshime që të dukej, kishte qef t'a përsëndetnin të tjerët dhe nxinte faqen përmbi masë që të dukej se mbante keshmë. Të tillë njerës, ishte krejt e natyrëshme, që të urrenin Shpëtimtarin, reformatorin e zemravet. Me gjith këtë s'munt të themi se të gjithë farisenjt pa përjashtim ishin të këqinj. Kishte nër ata dhe të mirë, si p. sh. Nikodhimi, Gamaliili e.t.j. por ishin tepër të paktë. Duhet shtuar gjithashtu se farisenjt, përveç disa ndryshimeve të një rëndësie të vogël të doktrinës së vërtetë, ishin me gjith këtë, në krahasim me Sadhuqenjt, për të cilët do të flasim në vëndin e du-

hur, ruajtës besnikë dhe plot me kurajë të Ligjit. Ja pse Shpëtimtari, ndonëse i kritikonte, thoshte se qëndrojnë mbi fronin e Moisiut dhe këshillonte popullin t'u vinte veshin mësimëve të tyre, por jo veprave të tyre (Mathe 23, 2-3). (shih më gjerë gjatë artikullin «Farisenjt» prej Bardhyllit, botuar në revistën: «Jeta Krishtiane» n. 10 e 11-të). Farisenjt ishin shtat llojsh:

1. *Të thyer*, me shpinën të krusur nga rëndësia e Ligjës që mbajnë mbi supet.
2. *Të interesuarit*, që bënin sikur pyesnin për të holla para se të kryenin një porosi morale.
3. *Me ballë të përgjakëshme*, që shkonin me syt mbyllur, gjoja nga shkak i turpiti dhe që pengoheshin me kokë nëpër muret.
4. *Pretendonjësit*, me një robe të gjerë, që zvarisej.
5. *Ata që gjithënjë përshëndesin*, sikur të thonë: ajo që është për të bërë, e bëj unë.
6. *Ata me frikë* si Jobi dhe
7. *Ata me dashuri* si Avraami.

ANEKDOTË

„Ata që mungojnë, janë këtu”

Poeti francez Viktor Ugó, kur ftonte për drekë miqtë e të njohurit e tij, nërmjet fronëve q'ishin përçark tryezës, vinte dhe një fron të posaçëm mbi të cilin s'kishte leje të rrinte njeri. Ndërsa pra fronët e tjerë ishin të zënë, mbi fronin bosh dallohej ky mbishkrim: «Ata që mungojnë, janë këtu».

Shumë herë miqt e tij të ftuar e kishin tallur poetin për këtë gjë, sepse kujtonin që ay mbishkrim ishte vënë gjoja për ndonjë supersticion. Por s'ishte e vërtetë, sepse ay mbishkrim kishte kuptimin më të thellë që, ata, të cilët do të bëheshin objekt diskutimi, s'mungonin po ndodheshin atje. Dhe, nëse prezenca e njerësve të njohur na ndalon t'i marrim nëpër gojë, mungesa e tyre s'na jep të drejtë të lemë gjuhën t'onë të lirë. Dhe sidomos kurse shumë nga ata që janë prezentë, ndonëse do të marrin pjesë në kritikimin e të tjerëve, do të shkojnë nga ana tjetër që t'i a u thonë atyreve çka të tjerët thanë kundër për ata, bile dhe me shtesa të mëdha.

Nëse, pra, në çdo tryezë dhe në çdo mbledhje do të gjëndeje dhe një fron, me mbishkrimin kuptim plot: «ata që mungojnë, janë këtu» do të dëgjoheshin atje shumë më pakë fjalë të këqia kritikimi, urretjeje, çaire dhe mungesë dashurie për ata që mungojnë.

Pse frika e vdekjes

Në qoftë se njerëzit parashikonin prej djepit fatin e tyre dhe vuajtjet e kësaj jete të shkurtër, do të preferonin më shumë vdekjen se sa jetën, e jo jetën se sa vdekja. —

Jeta barazohet me një udhëtim. Me të vërtetë është një udhëtim, i cili fillon pa e ditur ne dhe mbaron po me atë mënyrë. Nuk ndalet kurrë, por si një lumë që nxiton pa u-ndalur gjeti, ashtu dhe udhëtimi i jetës, vijon shpejtësisht rrugën e tija. —

Dalim prej një nate të pa-njohur dhe drejtohemi në tjetrën. Kështu dëshiroj Krijusi Hyjnor. —

Minutat kalojnë me radhë njëra mbas tjetrës, kurse orët presin njëra tjetrën. Gjatë kësaj kohe, neve kalojmë prej vëndesh pitoreske, të cilat me gojën e tyre na thresin për t'u ç'lodhur. Por më kot, ne s'mund t'i dëgjojmë sepse koha s'na pret. As gëzimet që na dalin përpara rrugës s'onë të shkurtër, nuk mund t'i gëzojmë, sepse dhe atë zhduken shpejtë. —

Dielli i ngrohtë i drekës së jetës heth mbi kryet t'ona rezet ngjyrë ari. Me gjithë këto neve nuk n'dalemi por kalojmë ende shumë vënde të tjera pitoreske, të cilat me asndonjë mënyrë nuk mund t'i admirojmë. Ja, ngjyrat perënduse arrijtën. Dielli i jetës po perëndon, mbrapa të cilit duken hijet e natës. Mbrëmja e jetës s'onë arrijti. Sa do të dëshironim për t'u ç'lodhur pak, në mbrëmjen e qetë?! Por jo! Zë i pa-njohur bërtet, oshëtim' i të cilit, jehon an'e mbanë: Ec përpara! Ec; shko!!!

Hija e zezë mbuloj an' e mbanë Qiellin mbarë. Zë s'pipëtin. Të gjitha u-çdukën. Ndenjat t'ona gjetën çlodhjen e shumë-dëshiruar; udhëtim' i jonë mori fund. Ja, ne tek po gjëndemi në mesin e natës, në heshtjen e jetës; tërë-njerëzia na harroj!

Ky ishte fat' i jonë. . . .

E pra o njeri! Që ditët e jetës s'uaj po ikin shpejtësisht, pse nuk i kini frikë natës? Prej së cilës ju duallt për të hyrë në jetë; por i kini frikë asaj nate, që ju me-doemos do t'a kapërxeni?

Çfarë do të thotë vdekje? Vdekje!.... Vdekje do të thotë çdukja prej fytyrës së rregullit tokësor. Një pas-vëndëse; në prehrin e Krijusit Hyjnor.

Përse vallë t'i kemi frikë kësaj vdekjeje? Jo! Jo! S' duhet aspak t'i kemi frikë asaj; por përkundrazi duhet të gëzohemi, tue i-a drejtuar zemrat t'ona lisu Krishtit, për të na i ndriçuar, që t'ecim drejt në rrugën q' Ay na dha. Për të mundur që rrugën e jetës së shkurtër edhe fantastike t'a kalojmë në drejtësi, e pastaj të kapërcejmë natën e vdekjes, e cila s'është tjetër gjë, veçse një kufi që ndan jetën e gënjeshtret prej asaj së vërtetës. Pra le të shpejtojmë për t'arrijtur n'atë jetë të përjetëshme dhe të vërtetë!

A M I N.-

Përktheu S. Fiku

LAJME TË MBRENDSHME

Lajme Kishtare

—Kujdestarët e Kishës Katedrale të Tiranës Z. Z. Anastas Hobdari Gaço Dako, Grigor Kojja, dhe Pavël Buneci pas tre vjetësh shërbimi të frytëshmë, paraqitën dorëheqjen. Këshilla Kishtare e Komunitetit Orthodhoks të Tiranës e mbledhur nën kryesinë e Kryehirësis Tij Imzot Kristoforit Kryepiskop i gjithë Shqipnis emëroi katër kujdestarë të rinj: Z.Z. Kost Mara, Dhimitër Kora, Lil Toka dhe Llazar Kojja.

—Ditën e tre Ierarhëvet në Kishën Katedrale të Tiranës Meshoi Kryehirësia e Tij Imzot Kristofori me pjesëmarjen e gjithë priftërinjve të ndodhur në Kryeqytet. Në kohën e duhur Kryehirësia e Tij me një fjalim të shkurtër tregoi, i mbështetur në jetën dhe veprimtarinë e të

Tre Mësonjësvet të Mëdhenj të Kishës s'onë që janë simboli i kulturës së vërtetë spirituale, cilësit e një intelektual të vërtetë. Kisha ishte mbushur me besnikë ndërsa Kori Mikst i Tiranës këndoi si zakonisht me mjeshtëri hymnet e shenjta të Meshës.

—Dolli prej shtypit pjesa e parë e librit «Fjala e mirë» që përmban shpjegimin e Ungjijvet me nga një fjalim në çdo të Djetë. Libri në fjalë është përpiluar prej Z. Dhimitër Përmetit ish Drejtor i Seminarit Kombëtar Orthodhoks. Është shkruar në një gjuhë të pastër dhe të kuptueshme. Si bazë, duket, se autori ka patur shpjegimet dhe predikimet e shkurtëra që janë botuar në revistën fetare morale greke «Zoi». Libri është shumë i dobishëm jo vetëm për priftërinjtë por edhe për çdo familje orthodhokse. Është botuar, me ndihmat e mbledhura nga besnikët e Fierit. Për së shpejti del dhe pjesa e dytë.

